



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
MEKANIZMI KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS



**AKTIVITETI I AVOKATIT TË POPULLIT TË SHQIPËRISË  
NË ROLIN E  
MEKANIZMIT KOMBËTAR  
PËR PARANDALIMIN E TORTURËS**

**RAPORTI I POSAÇËM**

**2014**



The Danish Neighbourhood Programme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
MEKANIZMI KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS



**AKTIVITETI I AVOKATIT TË POPULLIT TË SHQIPËRISË  
NË ROLIN E  
MEKANIZMIT KOMBËTAR  
PËR PARANDALIMIN E TORTURËS**

**RAPORTI I POSAÇËM**

**2014**

**Institucioni i Avokatit të Popullit**  
Blvd.: “Zhan D’Ark” Nr. 2, Tiranë, Shqipëri, Tel./Fax: +355 (4) 2380 313  
Web: [www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Ky botim u mundësua financiarisht nga Programi Danez i Fqinjësisë



The Danish Neighbourhood Programme

## TABELA E PËRMBAJTJES

1. Kuadri ligjor i funksionimit të MKPT-së .....	1
2. Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet.....	4
3. Vizitat monitoruese, rekomandimet, dhe ecuria e çështjeve mbi rastet e dhunës.....	6
3.1. Rekomandimet.....	7
3.2. Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare.....	7
4. Niveli i respektimit të drejtave të personave të privuar nga liria.....	8
4.1. Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionet Penitenciare.....	8
4.2. Niveli i respektimit të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar në njësitë policore .....	11
4.3. Niveli i respektimit të drejtave të personave me masë “ndalim disiplinor” në Forcat e Armatosura .....	12
4.4. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike .....	13
4.5. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra.....	14
4.5.1. Qendra Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve.....	14
4.5.2. Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç.....	15
4.5.3. Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut, Linzë.....	15
5. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014 në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.....	16
5.1. IEVP Rrogozhinë - Datë 01.02.2014 / Nr. Dok. 201400174.....	16
5.2. IEVP Peqin - Datë 11.02.2014 / Nr. Dok. 201400237 .....	20
5.3. IEVP Zahari, Krujë - Datë 03.04.2014 / Nr. Dok. 201401246.....	21
5.4. Instituti i të Miturve Kavajë - Datë 16.04.2014 / Nr. Dok. 201400765 .....	26
5.5. IEVP “Ali Demi” (325), Tiranë - Datë 30.04.2014 / Nr.Dok. 201400926 .....	34
5.6. IEVP Vaqar 327 - Datë 07.05.2014 / Nr. Dok. 201401019.....	41
5.7. IEVP Kosovë, Lushnjë - Datë 14.05.2014 / Nr. Dok. 201401020 .....	47
5.8. IEVP Peqin - Datë 13.06.2014 / Nr. Dok. 201401474.....	52
5.9. IEVP Shën Koll, Lezhë - Datë 16.06.2014 / Nr. Dok. 201401240.....	57
5.10. IEVP Kukës - Datë 19.06.2014 / Nr. Dok. 201401359 .....	64
5.11. IEVP Tropojë - Datë 20.06.2014 / Nr. Dok. 201401358 .....	67
5.12. IEVP Elbasan - Datë 23.07.2014 / Nr. Dok. 201401357 .....	73
5.13. IEVP “Jordan Misja” Tiranë - Datë 30.06.2014 / Nr. Dok. 201401356.....	79

5.14.IEVP Durrës - Datë 31.07.2014 / Nr. Dok. 201401463 .....	85
5.15.IEVP Durrës - Datë 29.09.2014 / Nr. Dok.201401740 .....	86
5.16.IEVP Fushë Krujë - Datë 01.10.2014 / Nr. Dok. 201401904.....	92
5.17.IEVP Burrel - Datë 06.10.2014 / Nr. Dok. 201401905.....	100
5.18.IEVP Berat - Datë 14.10.2014 / Nr. Dok. 201401923 .....	106
5.19.IEVP “Mine Peza” 302 Tiranë - Datë 17.10.2014 / Nr. Dok. 201401977.....	111
5.20.IEVP Drenovë, Korçë - Datë 29.10.2014 / Nr. Dok. 201402002 .....	116
5.21.IEVP Tepelenë - Datë 10.11.2014 / Nr. Dok. 201402365.....	126
5.22.IEVP Sarandë - Datë 12.11.2014 / Nr. Dok. 201402313.....	133
5.23.IEVP Vlorë - Datë 13.11.2014 / Nr. Dok. 201402366 .....	140
5.24.Institucioni i Veçantë Mjekësor i Burgjeve, Tiranë - Datë 09.12.2014 / Nr. Dok. 201500083.....	150
5.25.IEVP Rrogozhinë - Datë 30.12.2014 / Nr. Dok. 201500038 .....	157
5.26.Rekomandim mbi situatën e mbipopullimit në IEVP - Datë 06.01.2014 / Nr. Dok. 201402452.....	168
<b>6. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014 në Drejtoritë e Policisë së Qarkut dhe në Komisarariatet e varësisë .....</b>	<b>174</b>
6.1. DPQ Durrës dhe komisariate të varësisë.....	174
6.2. DPQ Elbasan dhe komisariate të varësisë.....	179
6.3. DPQ Lezhë dhe komisariate të varësisë.....	184
6.4. Komisariami i Rinasit, Drejtorinë e Kufirit dhe të Emigracionit - Datë 05.06.2014 / Nr. Dok. 201401200 .....	191
6.5. DPQ Peshkopi dhe komisariate të varësisë:.....	194
6.6. DPQ Kukës dhe komisariate të varësisë:.....	199
6.7. DPQ Berat dhe komisariate të varësisë:.....	205
6.8. DPQ Gjirokastrë dhe komisariate të varësisë: .....	211
6.9. DPQ Tiranë dhe komisariate të varësisë .....	217
6.10.DPQ Vlorë dhe komisariate të varësisë.....	227
6.11.DPQ Fier dhe komisariate të varësisë:.....	236
6.12.Rekomandim mbi situatën e mbipopullimit në Drejtoritë e Policisë së Qarqeve dhe Komisarariatet në varësi të tyre - Datë 06.01.2014 / Nr. Dok. 201402451.....	243
<b>7. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014 në Forcat e Armatosura .....</b>	<b>248</b>
7.1. Batalioni i Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë - Datë 02.12.2014 / Nr. Dok. 201500026.....	248

7.2. Komanda e Forcave Tokësore Vau i Dejës, Shkodër - Datë 10.12.2014 / Nr. Dok. 201500023 .....	250
8. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014 në Spitalet Psikiatrike .....	252
8.1. Spitali Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan - Datë 23.06.2014 / Nr. Dok. 201401340.....	252
8.2. Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë - Datë 14.11.2014 / Nr. Dok. 201402312 .....	258
8.3. Spitali Psikiatrik Shkodër - Datë 11.12.2014 / Nr. Dok. 201402546.....	263
9. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014 në Qendra ....	269
9.1. Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit - Datë 03.10.2014 / Nr. Dok. 201401745 ...	269
9.2. Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut - Datë 08.10.2014 / Nr. Dok. 201401744 .....	273
9.3. Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç - Datë 05 dhe 18.11.2014 / Nr. Dok. 201402003...	277
<i>Aneks 1 Bashkëpunimi i MPKT- së me Shoqatat e Shoqërisë Civile.....</i>	284
<i>Aneks 2 Aktivitete të MPKT-së .....</i>	287
<i>Aneks 3 Tabela e Inspektimeve të Kryera nga MPKT gjatë Vitit 2014 Bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve në Bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile .....</i>	290
<i>Aneks 4 Tabela e Rekomandimeve të Dërguara nga MPKT mbi Gjetje të Vitit 2014 .....</i>	293

# AKTIVITETI I AVOKATIT TË POPULLIT TË SHQIPËRISË NË ROLIN E MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

## RAPORTI I POSAÇËM 2014

### 1. Kuadri ligjor i funksionimit të MKPT-së

Institucioni i Avokatit të Popullit funksionon në bazë të attributeve që i jepen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si edhe ligji Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Ky institucion, ka atributin e mbikëqyrjes së zbatimit të standardeve të paracaktuara nga instrumente të ndryshme ndërkombëtare, të cilat kanë në fokus mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Me miratimin e ligjit Nr. 9094, datë 03.07.2003 “Për ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, rrodhi detyrimi për të krijuar një strukturë kombëtare për parandalimin e torturës<sup>1</sup>, funksioni kryesor i së cilës do të ishte monitorimi i të gjitha institucioneve publike ku privohet liria e individit, me qëllim vlerësimin e nivelit të respektimit të drejtave të njeriut në këto institucione, parandalimin e shkeljeve, përmirësimin e standardeve të trajtimit të personave të privuar nga liria dhe promovimin e respektimit të vazhdueshëm të të drejtave të tyre.

Avokati i Popullit, si një institucion i pavarur kushtetues me fokus të veçantë tek të drejtat e njeriut dhe tek “Parimet e Parisit”, u zgjodh nga Parlamenti si autoriteti i duhur për garantimin e funksionimit profesional dhe të pavarur të MKPT-së. Njohja ligjore e MKPT-së, si një strukturë e veçantë pranë Avokatit të Popullit në Shqipëri, u bë efektive me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 ‘Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim’”, i ndryshuar.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) funksionon bazuar në legjislacionin kombëtar, duke u udhëhequr nga parimet e instrumenteve ndërkombëtare: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si edhe protokollet e saj shtesë, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996; Konventa kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose Trajtimit Mizor, Çnjerëzor e Degradues, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 7727, datë 30.06.1993; Protokollin Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT), ratifikuar nga

---

<sup>1</sup> Sipas nenit 17 të Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT), “Çdo Shtet Palë mban, emëron ose krijon ... një ose disa mekanizma parandalues të pavarur kombëtarë për parandalimin e torturës në nivel kombëtar. Mekanizmat e krijuar si njësi të decentralizuara mund të emërohen si mekanizma kombëtarë parandalues për qëllimet e këtij protokollit, nëse ato janë në pajtim me dispozitat e tij.” Në vijim, neni 18 parashikon se “Shtetet Palë garantojnë pavarësinë funksionale të mekanizmave parandalues kombëtarë, si dhe pavarësinë e personelit të tyre.... Kur themelojnë mekanizmat parandalues kombëtarë, Shtetet Palë u kushtojnë vëmendjen e duhur principeve në lidhje me statusin dhe funksionimin e institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.”

Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 9094, datë 2003.07.2003; Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8135, datë 31.7.1996. Lista me këto instrumente të drejtave që udhëheqin punën e Mekanizmit nuk është shteruese, pasi ka një sërë rekomandimesh, veçanërisht të Këshillit të Evropës, të cilët janë të rëndësishëm në garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. Megjithatë, këta instrumente, janë “gurët e themelit” për punën tanimë disa vjeçare të MKPT-së në Shqipëri.

MKPT funksionon në përputhje me legjislacionin vendas, që është një mjet në duart e qytetarëve shqiptarë për të gëzuar të drejtat e tyre të sanksionuara në: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë; Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë; Ligjin Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar; Ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”; Ligjin Nr. 44/ 2012, datë 08.05.2012 “Për shëndetin Mendor”; Ligjin Nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”; Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; Ligjin Nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”; VKM-në nr. 187, datë 17.03.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 303, datë 25.03.2009, të Këshillit të Ministrave ‘Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve’”; Ligjin Nr. 9069, datë 15.5.2003 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin Nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”; VKM-në nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”. Sërish, kjo nuk është një listë shteruese, pasi ka një sërë Vendimesh të Këshillit të Ministrave, si edhe manuale dhe dokumente të tjera pune, zbatimi i të cilave është një garanci për gëzimin e të drejtave.

Legjislacioni shqiptar parashikon që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë se "askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës" (neni 25) dhe se "Askujt nuk mund t'i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose nga një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve" (neni 26). Puna e MKPT-së shkon në të njëjtën frymë, siç edhe shprehet në nenin 15/ 1 të Kushtetutës, ku parashikohet se "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik". Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij”.

Sipas ligjit Nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 ‘Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim’”, i ndryshuar, neni 74/ 1, MKPT vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e Avokatit të Popullit, mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve dhe ka këto kompetenca:

- vëzhgon rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës;

- paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Po kështu, në nenin 74/ 2, të të njëjtit ligj, MKPT-së, gjatë ushtrimit të detyrës, i garantohet:

- marrja e çdo informacioni në lidhje me numrin e individëve që u është hequr liria, në vendet e privimit të lirisë, si dhe numrin e vendeve dhe vendndodhjen e tyre;
- marrja e të gjithë informacionit për trajtimin e këtyre individëve, si dhe për kushtet e tyre të ndalimit;
- hyrja lirisht në të gjitha vendet dhe mjediset ku është kufizuar liria e individit;
- kryerja e intervistave private, pa dëshmitarë, me individët që u është hequr liria, personalisht ose me një përkthyes kur është e nevojshme, si edhe me çdo individ tjetër që mund të japë informacionin e nevojshëm;
- zgjedhja lirisht e vendeve që kërkon të vizitohë dhe e individëve që kërkon të intervistohë.

Format e mbikëqyrjes së MKPT-së parashikohen në nenin 74/ 3, të cilat realizohen nëpërmjet:

- pranimit të kërkesave ose ankesave nga të dënuarit ose të paraburgosurit me shkrim ose drejtpërdrejt;
- marrjes së informacionit, ankesave ose kërkesave të të dënuarit, ose nga individë që kanë statusin e vizitorit apo të organeve shtetërore ose organizatave joqeveritare, të cilat kanë kontrolluar apo vizituar institucionin, sipas kompetencës që u njeh ligji, si dhe nga avokati i të dënuarit ose të paraburgosurit;
- kërkit të informacioneve nga administrata e institucionit;
- kryerja e intervistave private, pa dëshmitarë, me individët që u është hequr liria, personalisht ose me një përkthyes kur është e nevojshme, si edhe me çdo individ tjetër që mund të japë informacionin e nevojshëm;
- verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve ose mjediseve, që kanë lidhje me të dënuarin ose me të paraburgosurin, brenda dhe jashtë institucionit.

Për realizimin e procesit të mbikëqyrjes, MKPT mund të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse. Në çdo rast dhe pavarësisht nëse konstatohen shkelje e parregullsi gjatë verifikimit, specialistët e këtij mekanizmi mbajnë procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij, me të drejtën e pasqyrimit të vërejtjeve.”

Sipas ligjit Nr. 44/ 2012, datë 08.05.2012 “Për shëndetin Mendor”, Neni 31, “Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin Çnjerëzor dhe Poshtërues, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij, vëzhgon rregullisht, me anë të inspektimeve periodike, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, si dhe paraqet rekomandime në organet përkatëse, me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të pacientëve dhe sigurimin e respektimit të plotë të të drejtave të njeriut në institucionet e kujdesit të shëndetit mendor.” Kjo e drejtë e sanksionuar në ligj, ushtrohet duke i garantuar MKPT-së hyrjen lirisht në të gjitha vendet dhe mjediset e informacioneve të shërbimit të shëndetit mendor, si dhe i garantohet marrja e çdo informacioni, sipas legjislacionit në fuqi.



Në zbatim të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, (i ndryshuar), neni 19/ 1, anëtarët e MKPT-së, si persona të autorizuar nga Avokati i Popullit, “kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit), në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.” Hyrja në këto mjedise, sipas po të njëjtit nen, mund të bëhet jo vetëm në kuadër të hetimit të një ankese drejtuar Avokatit të Popullit, por edhe për qëllime inspektimi apo studimit.

## **2. Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet**

Institucioni i Avokatit të Popullit, me qëllimin për t’i garantuar sikurse parashikohet në OPCAT pavarësi funksionale MKPT-së dhe personelit në shërbim të tij, ndërmori procedurat e nevojshme të rekrutimit parashikuar në ligjin Nr. 152/ 2013 “Për nëpunësin civil”, për të strukturuar, plotësuar e rinovuar stafin me anëtarë të rinj, ekspertiza profesionale të të cilëve do të mundësonte plotësimin e detyrimeve për një grup multidisiplinar pune, të aftë për të përmbushur nevojat institucionale. Në prill të vitit 2014, stafit ekzistues të ndihmës komisionerëve të përbërë nga dy ekspertë ligjorë, iu shtua një eksperte ligjore, një mjeke psikiatre dhe një psikologe klinike në rolin e drejtueses së mekanizmit, në thelb koordinuese e punës mes të barabartëve. Procesi i përzgjedhjes së profesionistëve në përbërje dhe drejtim të zyrës, mundësonte mbarëvajtjen e vijimësinë e punës në bazë merite, e të pakushtëzuar nga terma kohorë.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2014, ka bashkëpunuar ngushtësisht me Komitetin për Parandalimin e Torturës (CPT), Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT) dhe Prezencën e OSBE-së në vendet e rajonit, për të siguruar një sistem cilësor mbikëqyrje e raportimi. Bashkëpunimet me këto struktura janë kryer në kuadër të takimeve të përbashkëta e kontakteve të drejtpërdrejta, dhe kanë pasur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe vlerësimin e nevojave e mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria në përmbushje të OPCAT-it.

Në tetor të vitit 2014, MKPT-ja Shqiptare, në bazë merite pranoi propozimin e anëtarëve të Rrjetit dhe mori zyrtarisht për një periudhë një vjeçare Presidencën e Rrjetit të MKPT-ve të Evropës Jug-lindore. Ky rrjet, i jetësuar në vitin 2013 bazuar në Deklaratën e Bashkëpunimit të nënshkruar nga Institucionet e Avokatëve të Popullit të Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Hungarisë, Greqisë dhe Rumanisë, ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e aktiviteteve të tjera të përbashkëta për një përmbushje sa më të qenësishme të mandatit të MKPT-ve në rajon, siç edhe specifikohen në Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit të Egër, Çnjerëzor dhe Degradues.

MKPT gjatë vitit 2014 ka qenë pjesë aktive e Grupit të Punës mbi Reformën në Burgje të drejtuar të organizuar Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri. Po ashtu, gjatë vitit 2014 MKPT ka bashkëpunuar ngushtësisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (DPB) në kryerjen e trajnimeve me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit administrativ e atij të sigurisë brenda sistemit. Në bashkëpunim me DPB-në është mundësuar gjithashtu instalimi i kutive postare për ankesat e të të dënuarve e të paraburgosurve në të gjitha IEVP-të e vendit me qëllim rritjen e transparencës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe mundësimin e dërgimit të ankesave e kërkesave nga vetë të të dënuarit dhe të paraburgosurit në adresë të Avokatit të Popullit të Shqipërisë.

Gjatë vitit 2014 Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim me FRONTEX dhe Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Emigracionit, ka monitoruar operacionet e riadhesimi të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen. Qëllimi i këtyre operacioneve, ishte transferimi sa më i qetë dhe në mënyrë dinjitoze i shtetasve shqiptarë me vendim për riadhesim nga territoret e vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të zonës Shengen. MKPT ishte pjesë e grupit monitorues gjatë operacioneve të riadhesimit, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor dhe kushtetues si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/ 115/ EC të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorim e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës.

Gjithashtu, gjatë vitit 2014 MKPT ka qenë pjesë integrale e takimeve të organizuara nga Komiteti Kombëtar për Shëndetin Mendor, ku janë diskutuar çështje të rëndësishme lidhur me organizimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të shëndetit mendor. Për të adresuar problematikat e ngritura gjatë diskutimeve në këto takime, MKPT ka ofruar sugjerime e rekomandime konkrete me qëllim vendosjen e standardeve në respekt të të drejtave dhe lirive themelore të personave me të trajtuar në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në realizim të funksioneve të tij ligjore, gjatë vitit 2014 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Organizatat e Shoqërisë Civile aktive dhe të specializuara të fushës në vend. Bashkëpunime të frytshme në kryerjen e vizitave inspektuese<sup>2</sup> dhe në organizimin e trajnimeve e aktiviteteve<sup>3</sup> të tjera me natyrë promovuese mbi të drejtat e njeriut për personat e privuar nga liria janë zhvilluar me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Shoqatën Përthyerje, Institutin Evropian të Tiranës dhe Shoqatën e Avokatëve Penalistë Shqiptarë. Si rezultat i këtyre bashkëpunimeve, veprimtaria e MKPT ka pasur rritje cilësore në parandalimin e shkeljeve, promovimin e praktikave të mira, rritjen e transparencës dhe forcimin e dialogut me autoritetet shtetërore.

Në funksion të promovimit të të drejtave të njeriut në vend, ekspertët e MKPT-së gjatë vitit 2014 kanë qenë aktivë në median e shkruar dhe atë elektronike shqiptare, përmes konferencave të shtypit, takimeve të përbashkëta me gazetarët, shkrimeve e intervistave dhe pjesëmarrjes në emisione televizive me qëllim ndërgjegjësimin mbi problematikat dhe arritjet e në fushën e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria.

---

<sup>2</sup> Aneks 1 - Bashkëpunimi me Organizata të Shoqërisë Civile.

<sup>3</sup> Aneks 2 - Aktivitete të MKPT-së.

### 3. Vizitat monitoruese, rekomandimet, dhe ecuria e çështjeve mbi rastet e dhunës

Gjatë vitit 2014, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer 115<sup>4</sup> inspektime, ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe vizita monitoruese në të gjitha institucionet ku privohet liria e individit (institucione penitenciare, njësi policore, spitale psikiatrike, baza ushtarake ku ka dhoma sigurie, qendra ku trajtohen shtetas të huaj, azilkërkues dhe viktimat e trafikut) në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë kryerjes së vizitave monitoruese, MKPT kishte për objekt të punës mbledhjen e informacionit mbi:

- Trajtimin e personave në institucione dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, trajtimit degradues e diskriminues, torturës apo forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative.
- Nivelin e zbatimit të masave mbrojtëse duke krahasuar përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore vendase dhe standardet ndërkombëtare.
- Kushtet materiale të personave të trajtuar në institucione, duke u përqendruar kryesisht në aspekte të tilla si ushqimi dhe shërbimi në kohë i vakteve, ndriçimi natyral e artificial, ventilimi-aspirimi e sistemi ngrohës, respektimi i mundësisë për higjienë personale, kushtet sanitare, veshja, mbipopullimi, kushtet e banimit, etj.
- Vlerësimin e respektimit të të drejtave të personave të trajtuar, sipas specifikave të natyrës së institucionit, për të pasur kontakte me këshilltarët ligjorë e familjarët, për të kryer telefonata, për t'u informuar mbi të drejtat e tyre në një gjuhë që e kuptonin, për t'u informuar nëpërmjet medias elektronike dhe asaj të shkruar, për procedurat e punësimit dhe shpërblihet për punën e kryer, për të drejtën për aktivitete në ajër të pastër, të drejtën e ushtrimit të rriteve fetare, etj.
- Zhvillimin e arsimit të detyrueshëm, kurset profesionale, dhe aktivitetet rekreative e rehabilituese.
- Cilësinë e kujdesit shëndetësor, etj.

Ndryshe nga MKPT-të e tjera, të cilat kryejnë inspektime me përzgjedhje rastësore ose tematike, MKPT-ja shqiptare zgjodhi të ndiqte praktikën më të mirë të viteve të mëparshme të ekzistencës së saj, duke inspektuar në mënyrë të thelluar së bashku me OJF-të e interesuara në fushë, të gjitha institucionet e sipërpërmendura.

Në përputhje me metodologjinë e inspektimit, gjatë vizitave në institucionet e monitoruara ekspertët e MKPT-së morën kontakt me autoritetin drejtues, përgjegjësit e sektorëve, si dhe inspektuan të gjitha ambientet në funksion të personave të trajtuar në këto institucione. Vlen të theksohet se inspektimet janë zhvilluar në një frymë të mirë bashkëpunimi në pothuaj të gjitha institucionet e inspektuara. MKPT-së iu mundësua përmbushja e detyrave institucionale kushtetuese e ligjore, duke iu garantuar akses i plotë në shqyrtimin e të gjitha ambienteve e dokumenteve, si dhe kontakte pa praninë e stafit të institucioneve me personat e privuar nga liria.

---

<sup>4</sup> Aneks 3 - Tabela e Inspektimeve të kryera nga MKPT gjatë vitit 2014 bazuar në planin vjetor të inspektimeve në bashkëpunim me Organizata të Shoqërisë Civile.

### 3.1. Rekomandimet

I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me 81 rekomandime<sup>5</sup> konkrete mbi problematikat dhe fenomenet e konstatuara, të cilat i janë përcjellë me korrespondencë zyrtare institucioneve përgjegjëse.

Institucionet	Numri i rekomandimeve	Specifika mbi rekomandime	
Institucione Penitenciare	26	22	Rekomandime mbi gjetjet nga inspektimet e kryera
		1	Rekomandim specifik mbi fenomenin e mbipopullimit në IEVP
		2	Rekomandime mbi vizitat ad-hoc
		1	Rekomandim me iniciativë
Njësi policore	47	44	Rekomandime mbi gjetjet nga inspektimet e kryera
		1	Rekomandim specifik mbi fenomenin e mbipopullimit në ambientet e sigurisë
		1	Rekomandim mbi proceduarat e riatdhesimit të emigrantëve të paligjshëm nga zona Shengen
		1	Rekomandim për marrjen në analizë të një rasti ushtrimi dhune
Forcat e Armatosura	2	2	Rekomandim mbi vizitat e kryera në baza ushtarake me objekt kushtet dhe trajtimin në dhomat e sigurisë
Spitale psikiatrike	3	3	Rekomandim mbi përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor në këto institucione
Qendra	3	1	Rekomandim mbi përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të Azilkërkuesve në Qendrën Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve, Babrru
		1	Rekomandim mbi përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të të Huajve në Qendrën e Mbyllur për të Huajt, Kareç
		1	Rekomandim mbi përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të Viktimave/ Viktimave të mundshme të trafikimit në Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut, Linzë
<b>TOTAL</b>		<b>81</b>	

Nga përgjigjet e marra mbi rekomandimet, ato rezultojnë të jenë pranuar e të kenë vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Gjithsesi mbeten ende për t'u ndjekur edhe në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të individëve që strehohen në këto institucione. Problematikat e vërejtura nevojitet të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve, dhe mungesës së nxjerrjes së akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

### 3.2. Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare

Për rastet e tejkalimit të forcës të evidentuara gjatë inspektimeve apo nga ankesat e marra përmes postës e telefonit, MKPT ka bashkëpunuar në kryerjen e inspektimeve *ad hoc* me Seksionin e

<sup>5</sup> Aneks 4 - Tabela e rekomandimeve të dërguara nga MKPT mbi gjetje të vitit 2014.

Veçantë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në përmbushje të funksioneve përkatësisht parandaluese e reaktive të dy strukturave.

Për vitin 2014, MKPT dhe Seksioni i Veçantë, kanë trajtuar 35 ankesa të shtetasve me pretendime për tejkalim të forcës së domosdoshme e ushtrim dhune nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe punonjësit e Policisë së Burgjeve, më konkretisht 28 në Komisariate dhe 7 në I EVP.

Nga trajtimi i këtyre rasteve, rezultuan 8 ankesa të provuara, 20 të paprovuara si pretendime, dhe 7 jashtë juridiksionit (për të njëjtat ankesa ishin filluar hetimet organi i SHKB ose i Prokurorisë). Nga 8 rastet e provuara të dhunës të konstatuar në Komisariate dhe I EVP, për 2 raste i është rekomanduar organit të Prokurorisë fillimi i hetimeve ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit për veprën penale të “Torturës”, e kryer në bashkëpunim<sup>6</sup>. Ndërsa për 6 rastet e tjera, organeve të Policisë së Shtetit dhe I EVP-ve, i është rekomanduar marrja në shqyrtim e pretendimeve të ankuesve<sup>7</sup>.

Në përgjigje të këtyre rekomandimeve rezulton se: Organi i Prokurorisë ka filluar hetimet ndaj punonjësve të Njesisë Operacionale të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë dhe të punonjësve të Komisarariatit të Policisë Lezhë; Ndaj punonjësve të Komisarariatit Nr. 4, Tiranë, është dhënë 1 masë disiplinore; Në përgjigje të rekomandimit mbi dy ankesat dërguar Komisarariatit Nr. 4 Tiranë ka filluar Ecuria Disiplinore; Në përgjigje të rekomandimit drejtuar I EVP Vlorë mbi dy ankesa, megjithëse është marrë përgjigje pranuese, nuk ka pasur asnjë reagim me masa administrative. Rekomandimi për rastin e dhunës së provuar nga ana e MKPT-së dhe Seksionit të veçantë, drejtuar I EVP Drenovë, Korçë, rezultoi i papranuar.

#### **4. Niveli i respektimit të drejtave të personave të privuar nga liria**

##### **4.1. Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionet Penitenciare<sup>8</sup>**

Inspektimet në Institucionet Penitenciare kishin si qëllim vlerësimin e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, të parashikuara në ligjin Nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 ‘Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim’”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse. Gjatë inspektimeve u vunë re një serë problematikash të cilat paraqesin nevojë të ngutshme për shqyrtim e përmirësim. Përmbledhtazi gjetjet pasqyrohen në vijim:

<sup>6</sup> Rekomandimi i datës 25.02.2014, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Rekomandimi i datës 10.03.2014, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>7</sup> Rekomandimi i datës 24.06.2014, drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, Komisarariatit Nr.4 Tiranë.

Rekomandimi i datës 06.01.2015, drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, Komisarariatit Nr. 4 Tiranë.

Rekomandimi i datës 14.01.2015, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së I EVP Vlorë.

Rekomandimi i datës 14.01.2015, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së I EVP Drenovë.

<sup>8</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Institucionet Penitenciare janë hartuar 26 rekomandime.

- Vihej re një gjendje alarmante e mbipopullimit në sistemin penitenciar, me deri 1500 persona mbi kapacitet. Veçanërisht problematike paraqitet situata në institucionet e paraburgimit. I EVP-të Jordan Misja, Fushë-Krujë, Rogozhinë, Elbasan, Berat, Drenovë, Vlorë, Tepelenë, Sarandë, Durrës e Lezhë funksiononin në pjesën më të madhe të kohës dukshëm mbi kapacitetin zyrtar. Për arsye të mbipopullimit, në disa prej I EVP-ve e më konkretisht në I EVP Jordan Misja, Drenovë e Sarandë nuk realizohej observimi e më pas sistemimi në dhoma sipas kriterëve të përshtatshmërisë.
- Edhe gjatë vitit 2014, marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/ 2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” nuk ka gjetur zbatim. Trajtimi i kësaj kategorie në I EVP, në kushtet kur në organikat e tyre mungon mjeku psikiatër dhe kur aksesimi për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi, ose në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, duke u reflektuar edhe në problematikën e përgjithshme të mbipopullimit.
- Nga të dënuar e paraburgosur kishte pretendime mbi disa punonjës të I EVP-ve për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike, kryesisht në I EVP Mine Peza, Peqin, Korçë dhe Vlorë. Ankesat u pasuan nga hetime të gjithanshme dhe rekomandime ndaj I EVP-ve përkatëse dhe DPB-së për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.
- Procedurat disiplinore në Institutin e të Miturve Kavajë dhe në Seksionin e të Paraburgosurve të Mitur në I EVP Vlorë, nuk zbatoheshin në mënyrë korrekte. Masat e reja edukative disiplinore, nuk ishin marrë në konsideratë nga ana e stafit të edukimit dhe nuk zbatoheshin sipas procedurave dhe politikave disiplinore e edukative për të miturit, sikurse përcaktohen në udhëzuesin administrativ të DPB-së. Të miturit në këto institucione vendoseshin në kushte që i ngjanin izolimit të vetmuar deri në 20 ditë, masë kjo që mund të komprometojë integritetin e tyre fizik dhe/ ose mendor.
- Në disa institucione, si p.sh., në I EVP Lezhë, Lushnje, Vaqarr, Tepelenë, Fushë-Krujë, Burrel, nuk ofrohej arsimi i detyrueshëm në përputhje me Marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit për arsimin 9-vjeçar.
- Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet (përveç I EVP Burrel) bëheshin me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në këtë kuadër, për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione, nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohe vjetërsie në punë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore.
- Nga pikëpamja infrastrukturore, pjesa më e madhe e I EVP-ve paraqisnin probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, mungesës së ambienteve të edukimit apo ushtrimit të rriteve fetare e veprimtarisë sportive etj. I EVP-të me problematika emergjente infrastrukturore paraqiteshin I EVP Zahari-Krujë, Kosovë e Lushnjës, Rogozhinë, Burrel, Sarandë, Tropojë, Lezhë, Tepelenë, Jordan Misja, Ali Demi, Mine Peza e në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve.
- Në të gjitha I EVP-të, ambientet e takimit me familjarët ishin të papërshtatshme, veçanërisht për takime me të mitur.

- Sipërfaqet e vogla për ajrim në një pjesë të I EVP-ve kushtëzonin zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër gjatë qëndrimit në to, ndërsa në I EVP Jordan Misja, Sarandë, dhe në ambientet e observimit në I EVP Korçë nuk respektohej e drejta e ajrimit sipas parametrave, për arsye të mungesës së ambienteve.
- Në I EVP-të e pa rikonstruara, mjediset e jashtme dhe të brendshme nuk ishin në përputhje me standardet, duke sjellë pengesa në procesin e rehabilitimit psiko-social të burgosurve/ paraburgosurve.
- Numri i kufizuar i aktiviteteve që ofroheshin në institucione, kushtëzohej nga mungesa e ambienteve të përshtatshme, si rezultat i kthimit të tyre në dhoma banimi për efekt mbipopullimi dhe i mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike. Problematike në këtë drejtim ishin I EVP-të Burrel, Korçë, Durrës, Lezhë, Tepelenë, Jordan Misja, Mine Peza, Kosovë-Lushnje etj.
- Në thuajse të gjitha I EVP-të, u konstatua plotësim në mënyrë formale i dosjeve psiko-sociale, sa i përket objektivave të trajtimit, programeve individuale të trajtimit, shënimeve të përmuajshme, e këshillimeve individuale e në grup, të cilat ndonëse shënoheshin si të kryera, realisht nuk zbatoheshin.
- Ambientet e kujdesit shëndetësor në burgje, përjashtuar I EVP Vlorë, ishin përgjithësisht të papërshtatshme për vizita apo manipulime mjekësore, e të pa pajisura me materiale ndihmëse.
- Në shumicën e I EVP-ve, vonesa në pajisjen e të gjithë të dënuarve/ paraburgosurve me librezat shëndetësore, sillte moszbatimin e skemës rimbursuese dhe probleme në furnizimin me medikamente.
- Në shumicën e I EVP-ve, vëreheshin vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike jashtë këtyre institucioneve.
- Shërbimi stomatologjik në I EVP nuk funksiononte normalisht për shkak të mungesave në aparaturo dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.
- Sistemet qendrore të ngrohjes pothuajse në të gjitha I EVP-të ku ishin të instaluar nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/ paraburgosurit përdornin batanijet dhe teshat e fjetjes si të vetmet mjete ngrohjeje.
- Në të gjitha I EVP-të, u konstatuan mungesa në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë.
- Në të gjitha I EVP-të, u konstatuan mungesa në përdorimin e uniformave e të dorezave gjatë shpërndarjes së ushqimit.
- Në shumicën e dhomave të banimit të I EVP-ve mungonin dollapët/ raftet e rrobave. Ato mbaheshin nga të dënuarit/ paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve. Kjo problematikë ndeshet kryesisht në I EVP Lezhë, Tepelenë, Korçë, Durrës, Jordan Misja, Mine Peza, Sarandë, Kukës e Tropojë.

#### **4.2. Niveli i respektimit të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar në njësitë policore<sup>9</sup>**

Inspektimet në njësitë policore kishin si qëllim vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikën e ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, dhe marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të tij”, si dhe të verifikimit të përmbushjeve të rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë sipas standardeve ligjore, heqjen nga përdorimi të dhomave që nuk plotësojnë kriteret e domosdoshme, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit gjatë shoqërimit apo ndalim/ arrestimit të shtetasve. Nga inspektimet e kryera në organet e policisë, u konstatuan:

- Pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimin fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë, sidomos ndaj atyre që dyshohen si autorë të veprave penale, në Komisaritet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6 të DPQ Tiranë, në Komisaritin Shijak të DPQ Durrës, në Komisaritin Lezhë, Mirditë, e Stacionin e Policisë Shëngjin të DPQ Lezhë, në Komisaritin Mat të DPQ Dibër dhe Komisaritin Devoll të DPQ Korçë.
- Moskryerje të detyrimeve ligjore nga personeli policor dhe ai shëndetësor që shërben në ambientet e sigurisë, për raportimin e rasteve ushtrimit të dhunës ndaj të arrestuarve ose të ndaluarve, në DPQ Tiranë dhe në DPQ Lezhë.
- Sjellje pa etikë të disa punonjësve të policisë në komunikimin me qytetarët në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, në Komisaritet e Policisë Nr. 2 dhe 3 Tiranë dhe në Fier.
- Bllokime dhe mbajtje pa të drejtë të sendeve të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar sikurse është konstatuar në Komisaritin e Policisë Nr. 4 Tiranë.
- Shoqërime të shtetasve në organet e policisë, jashtë kriterëve ligjore të parashikuara në dispozitat ligjore, në Komisaritet dhe Stacionet e Policisë Tiranë, Durrës, Kavajë, Shijak, Elbasan, Peqin, Krujë, Kurbin, Fushë Krujë, Mamurras, etj.
- Në shumë komisarite e organe policie nuk ishin ndërtuar apo përshtatur ambientet e shoqërimit sikurse parashikohet në dispozitat e ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur).
- Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariteve nuk i plotësonin standardet për trajtimin dinjitoz të personave, pasi rezultonin të papastrat, të palyera, të pa pajisura me orënditë e nevojshme (karrige, stola, tavolinë) ose edhe atje ku kishte të tilla, ato ishin të dëmtuara.
- Ambientet e sigurisë në rreth 80% të tyre nuk ishin ndërtuar apo përshtatur sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe aktet normative të brendshme.
- Në pjesën më të madhe të komisariteve (si p.sh., në Komisaritet e Policisë Tiranë, si dhe në Komisarite e Policisë Durrës, Kavajë, Shijak, Elbasan, Peqin, Krujë, Kurbin, Fushë Krujë, Mamurras etj.), mungonin regjistrat e përditësuar për personat e shoqëruar dhe personat e ndaluar/ arrestuar. Kryesisht për këtë arsye, u vunë re mangësi për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në dispozitat ligjore për evidentimin në regjistra të

<sup>9</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Njësitë Policore janë hartuar 47 rekomandime.



të dhënave të personave të shoqëruar sipas rubrikave në zë mbi arsyet e shoqërimit dhe njoftimin e personave familjarëve apo të afërme të të shoqëruarve (numrit të telefonit, orës së njoftimit etj.).

- Në një pjesë të konsiderueshme të Komisariateve (Komisariatet dhe Stacionet e Policisë Tiranë, Kavajë, Peqin, Krujë, Fushë Krujë, Kurbin, Mamurras etj.) mungonin posterat për rastet e shoqërimit dhe të drejtat ligjore të të shoqëruarve.
- Në Komisariatet e Policisë Nr. 4 dhe 6 Tiranë, për shkak të mbipopullimit ishin vënë në funksionim si ambiente për mbajtjen e të arrestuarve e ndaluarve edhe disa mjedise që kanë qenë të mbyllura më parë e që nuk plotësonin asnjë kriter e standard minimal jetese.
- Drejtoria e Qarkut Tiranë, Komisariati i Lezhës, i Elbasanit, si edhe Komisariatet nr. 3 dhe nr. 5 të Qarkut Tiranë punonin në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar, në disa raste deri në 3 apo 4 herë më shumë se kapaciteti. Mbipopullimi ishte krijuar kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të shumta të bëra gjatë vitit nga policia për vepra penale të përfshira rishtazi në Kodin Penal, por edhe për shkak se personat e ndaluar/ arrestuar vononin të pranoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për arsye të mbipopullimit në institucionet e paraburgimit.
- Në ambientet e sigurisë të disa prej DPQ-ve dhe komisariateve të varësisë, mbaheshin edhe persona të arrestuar ndaj të cilëve ishte caktuar masë sigurimi personal nga gjykata deri në 20 ditë.
- Shërbimi shëndetësor i ofruar nga DPQ-të ishte problematik sa përket plotësimit korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore, si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e shërbimit shëndetësor. Në një pjesë të konsiderueshme të këtyre institucioneve, vizitat mjekësore kryheshin përtej afatit 12 orësh të përcaktuar në Manualin e Policisë së Shtetit.

#### **4.3. Niveli i respektimit të drejtave të personave me masë “ndalim disiplinor” në Forcat e Armatosura<sup>10</sup>**

Inspektimet e përgjithshme në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, Shkollën e Trupës Bunavi, Vlorë, në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë, në Komandën e Forcave Tokësore Zall-Herr, Tiranë, si dhe në Komandën e Forcave Tokësore Vau i Dejës, Shkodër, kishin si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin Nr. 9069, datë 15.5.2003 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, zbatimin e rregullave të parashikuara në Instruksionin e Kryerjes së Shërbimit të Ruajtjes nga Përgjegjësi i Dhomave të Ndalimit Disiplinor në Policinë Ushtarake, lidhur me kushtet e dhomave të ndalimit disiplinor, procedurat e dhënies së këtyre masave, respektimin e të drejtave të ushtarakëve të dënuar, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhënë gjatë viteve të mëparshme. Gjatë inspektimeve u vunë re disa problematika të cilat paraqesin nevojë për përmirësim. Përmbledhtazi këto gjetje pasqyrohen si më poshtë:

- Kushtet në dhomat e sigurisë në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë ishin të papërshtatshme për t’u ofruar ushtarakëve me masën “ndalimit disiplinor” një akomodim dinjitoz dhe konform standardeve.

---

<sup>10</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Forcat e Armatosura janë hartuar 2 rekomandime.

- Mungonte sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të sigurimit në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë dhe në Komandën e Forcave Tokësore, Reparti Ushtarak Nr.1010 Vau Dejës, Shkodër.
- Kushtet e ambienteve të takimit me familjarët ishin të papërshtatshme krahasuar me standardet.
- Mungonin zilet elektrike në dhomat e sigurisë.
- Ushtarakëve që mbaheshin në këto dhoma nuk u ofrohej një paketë me produkte të higjienës personale.
- Plotësimi i rubrikave në regjistrat për ndalimin disiplinor, ishte i mangët si në Batalionin e Policisë Ushtarake Tiranë ashtu dhe në Komandën e Forcave Tokësore, Reparti Ushtarak Nr.1010 Vau Dejës Shkodër.
- Kishte prani të mjeteve të forcës, shkop gome dhe pranga në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë së Batalionit të Policisë Ushtarake Tiranë.
- Mungonte ngrohja në dhomat e sigurisë të Batalionit të Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë dhe të Komandës së Forcave Tokësore, Reparti Ushtarak Nr.1010 Vau Dejës, Shkodër.

#### **4.4. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike<sup>11</sup>**

Vizitat monitoruese në Spitalin Psikiatrik Elbasan, Spitalin Psikiatrik Vlorë dhe në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër (të cilat kanë në funksionin e tyre trajtimin më të specializuar dhe rehabilitimin e personave me probleme të shëndetit mendor për të cilët kanë shteruar të gjitha mundësitë ekzistuese për të marrë një shërbim të tillë në komunitet, nuk ka mundësi të trajtimit të tyre në kushte ambulatorie apo nevojitet konsulencë psikiatrike nga kërkesat që vijnë nga urgjencat e spitaleve të përgjithshme), përveç objektit të përgjithshëm të vizitave kishin si qëllim specifik: vlerësimin e respektimit të të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, të përcaktuara në ligjin Nr. 44/ 2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”; vlerësimin e procedurave të kryerjes së shtrimeve të pavullnetshëm; masat shtrënguese e kufizimit fizik; kushtet në të cilat mbahen këta persona, trajtimin e tyre mjekësor dhe rehabilitues dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të prezantuara për këto ambiente gjatë viteve të mëparshme. Nga vizitat monitoruese të kryera për vitin 2014 në spitalet psikiatrike të lartpërmendura u konstatuan:

- Mosrespektimi i hapësirës jetike, kushte të papërshtatshme në dhomat e personave të shtuar, dhe mbajtja e tyre për një kohë të gjatë/ kthimi në rezidentë të Spitalit Psikiatrik Elbasan dhe Vlorë.
- Mbajtja e personave me Prapambetje Mendore në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Vlorë.
- Mungesa e dhomave të veçimit, mungesa e një sistemi monitorimi me kamera në ambientet e këtyre spitaleve, si dhe mungesa e regjistrave të unifikuar nga Ministria e Shëndetësisë në të tre Institucionet e lart përmendura, veçanërisht për sa i përket dokumentimit të shtrimeve të pavullnetshme dhe aplikimit të kufizimit fizik.

<sup>11</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Spitalet Psikiatrike janë hartuar 3 rekomandime.

- Mangësi në plotësimin e organikës me mjekë psikiatër në Spitalin Psikiatrik Shkodër, dhe shtimin në organikë të infermierëve dhe kujdestarëve në atë të Elbasanit.
- Problematika e ndjekjes së procedurave për shtrimet e pavullnetshme sipas ligjit të ri për shëndetin mendor dhe akteve nënligjore të tij në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Shkodër, si dhe në disa raste në atë të Vlorës.
- Mungesa e mjeteve të kufizimit fizik në Spitalin Psikiatrik Elbasan, Vlorë dhe Shkodër.
- Mungesa e medikamenteve të grupit të antipsikotikëve, antidepressivëve stabilizuesve të humorit etj. në Spitalin Psikiatrik Elbasan.
- Vonesa në revokimin e masës “mjekim i detyruar”, për personat të cilët trajtoheshin me këtë masë në Spitalin Psikiatrik Shkodër.
- Mungesa e një kabineti stomatologjik konform standardeve, e aparaturës së EKG-së
- Kushtet higjieno-sanitare, thuajse në të gjitha ambientet e këtyre Institucioneve, ishin jashtë standardit e me lagështirë të theksuar

#### **4.5. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra<sup>12</sup>**

##### **4.5.1. Qendra Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve**

MKPT, bazuar në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, inspektoi Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, me objekt vlerësimin e trajtimit të shtetasve të huaj që marrin shërbime në këtë qendër, në përputhje me të drejtat e tyre për trajtim dinjitoz dhe rehabilitues. Gjatë vizitës monitoruese në këtë qendër, u konstatuan zbatime të një pjese të rekomandimeve të bëra më parë nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Problematikat që vazhdonin të ishin të pranishme, paraqiten si më poshtë:

- Mungesa e një juristi, i cili duhet të merret kryesisht me pjesën e dokumentacionit që secilit individ të strehuar në qendër i duhet, duke marrë në konsideratë faktin se kjo qendër strehon shtetas të huaj.
- Organika e parashikuar nuk i plotësonte nevojat me staf me edukatorë, kujdestarë, dhe staf mjekësor.
- Nuk ishte hartuar një marrëveshjeje me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me ofrimin e mundësive për formim profesional në Qendrat e Formimit Profesional në varësi të kësaj Ministrie, si edhe mundësi për punësim pranë Zyrave Rajonale të Punësimit, përsëri në varësi të kësaj Ministrie për të gjithë personat e strehuar në QKPA, që janë të interesuar.
- Personat e strehuar në QKPA nuk trajtoheshin me ndihmë ekonomike siç parashikohet në ligjin nr. 10060, datë 26.01.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”.
- Personat e strehuar në QKPA nuk furnizoheshin me veshmbathje sipas stinës dhe grup-moshave.
- Këndi i lojërave për fëmijët, ndonëse ekzistonte si mjedis, nuk ishte i plotësuar me pajisjet e nevojshme.

<sup>12</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Qendra janë hartuar 3 rekomandime.

#### **4.5.2. Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç**

Inspektimi i Qendrës së Mbyllur për Të Huajt, Kareç, të ngritur me VKM nr. 1083, datë 28.10.2009, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 83 të ligjit Nr. 9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, për strehimin e të huajve e parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, u krye me qëllim vlerësimin e kushteve të trajtimit të personave të trajtuar në të. Qendra e Mbyllur është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Migracionit dhe Ripranimeve, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme. Gjatë vizitës monitoruese në këtë Qendër, u konstatua se:

- Organika e parashikuar nuk i plotësonte nevojat me staf për komunikime në gjuhën dominante të të huajve, shërbime psiko-sociale, juridike dhe mjekësore.
- Mungonin pajisjet në ambientet rekreative dhe sportive.
- Mungonin aparatet kartfonike, televizorët e antenat për të mundësuar informimin e të huajve mbi ato çfarë ndodhin jashtë qendrës e në vendet e tyre të.
- Mungonin aktivitete kulturore, argëtuese e sportive. i vetmi aktivitet sportiv ishte ai me top në një fushë të papërshtatshme për lojëra me këmbë.
- Mungonin aktivitetet për të miturit, fëmijët e rritur dhe gratë.
- Kamerat në perimetrin e jashtëm të godinës nuk ishin funksionale.
- Sistemi i ngrohjes ishte jofunksional.
- Kishte mangësi në furnizimin me produkte higjieno-sanitare, pajisje vetjake sipas grupmoshave.

#### **4.5.3. Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut, Linzë**

Inspektimi i Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut e cila strehon personat e identifikuar në bazë të Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/ Viktimave të Mundshme të Trafikut, u krye me qëllim vlerësimin e kushteve të trajtimit të personave të trajtuar në të. Kjo qendër e mbyllur, e sigurisë së lartë është ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”, i cili, ndër të tjera, përveçse nuk parashikon detyrat funksionale të këtij institucioni apo shërbimet që ofrohen në të, parashikon në pikën 3 të tij se në këtë qendër trajtohen edhe emigrantë klandestinë që kalojnë përmes Shqipërisë. Gjatë vizitës monitoruese në këtë Qendër, u konstatuan:

- Nevoja për ndryshime të bazës ligjore të funksionimit të QKPVT-ja, duke marrë në konsideratë vërejtjet sa më lartë.
- Mangësi në furnizimin periodik të përfituesve me pajisje vetjake sipas grupmoshave.
- Mungesa e një marrëveshjeje me institucionet përkatëse për arsimimin në vijim të përfituesve.
- Nevoja për të kryer rikonstruktimin e brendshëm dhe të jashtëm të dy godinave ekzistuese.
- Probleme të mosfunksionimit të sistemit ngrohës.
- Mungonte ambienti i përshtatshëm aktivitetet për të miturit.

- Probleme të mosfunksionimit të pajisjeve kompjuterike për përfituesit.
- Mangësi në organikë sa i përket pranisë së një psikologu dhe përkthyesi me kohë të plotë në qendër.

## **5. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014 në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale**

### **5.1. I EVP Rrogozhinë - Datë 01.02.2014 / Nr. Dok. 201400174**

#### *Shënime paraprake*

Avokati i Popullit, në përmbushje të kompetencave kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij, pasi u njoh nga media vizive mbi ngjarjen e rënies së zjarrit më datë 31.01.2014 në I EVP Rrogozhinë, dërgoi në vend më datë 01.02.2014 një grup pune për hetim administrativ.

Në përputhje me metodologjinë e vizitës fakt mbledhëse dhe procedurave hetimore, grupi i punës kreu fillimisht takim me Drejtorin e Institucionit dhe Shefin e Policisë, të cilëve u shpjegoi qëllimin e vizitës si dhe u kërkoi shpjegime lidhur me situatën e institucionit dhe gjendjen shëndetësore të të paraburgosurve të përfshirë në ngjarjen e rënies së zjarrit në natën e datës 31.01.2014. Në vijim, ekspertët vizituan ambientet e sektorit të paraburgimit ku kishte ndodhur rënia dhe përhapja e zjarrit, dhe morën takim më vete me të paraburgosurit e ndodhur në dhomë në momentin e ngjarjes. Po ashtu, në kuadër të monitorimit të gjendjes së përgjithshme shëndetësore të të gjithë personave të prekur nga ngjarja, grupi i monitorimit kreu vizita në Spitalin e Kavajës dhe mori kontakte të veçanta me të paraburgosurit e transferuar në I EVP Peqin pas ngjarjes.

Gjatë vizitave dhe intervistave, u konstatuan një sërë problematikash, të cilat së bashku me analizën ligjore referuar akteve ndërkombëtare apo legjislacionit vendas në fuqi, renditen në vijim:

Me urdhër nr. 329, datë 15.01.2009, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar, “Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogozhinë kategorizohet burg i sigurisë së zakonshme me një seksion paraburgimi”. Kapaciteti maksimal i kësaj I EVP-je për të paraburgosurit është 115 persona. Në momentin e rënies së zjarrit më datë 31.01.2014, rreth orës 20:00, në paraburgim ishin të strehuar 217 të paraburgosur.

Nga përfaqësuesit e institucionit u informuam se, më datë 31.01.2014, rreth orës 20:00, në godinën 3, dhoma 1 të paraburgimit, e cilësuar si dhomë observimi, ishte përhapur një zjarr i cili kishte rrezikuar jo vetëm jetët e 21 personave që gjendeshin me banim në atë dhomë, por edhe të shumë të paraburgosurve të tjerë në 6 dhomat e tjera të seksionit si rezultat i shpërndarjes së tymrave toksike.

Ndihma e menjëhershme dhe efektive kishte ardhur nga të dënuarit e sektorit të sigurisë së zakonshme, të cilët kishin ndihmuar punonjësit e paktë në numër të sigurisë së turnit, për hapjen e dyerve dhe shpërndarjen e skarave të dritareve, me qëllim nxjerrjen e menjëhershme të të paraburgosurve nga godina, korridori dhe dhomat e përfshira nga flakët dhe tymi asfiksues.

Sipas drejtuesve, nga hetimet paraprake të zhvilluara nga OPGJ të Policisë Kavajë natën e ngjarjes në bashkëpunim me punonjësit e sigurisë së IEVP Rrogozhinë, ishte arritur në dyshimin e arsyeshëm të zjarr vënies së qëllimshme nga ana e dy të paraburgosurve, të cilët sipas Shefit të Sigurisë së institucionit kishin pohuar faktin. Gjithashtu ekzistonin pamje filmike nga kamerat e sigurisë të cilat e mbështesnin këtë version. Sipas Drejtorit ishin dërguar për ndihmë mjekësore në Spitalin e Kavajës 21 persona me probleme respiratore dhe 1 person me plagë të marra nga djegiet. Gjithashtu ishin transferuar në IEVP Peqin 78 të paraburgosur nga IEVP Rrogozhinë për efekt të menaxhimit të situatës dhe uljes së mbipopullimit.

Grupi i monitorimit kërkoi nga drejtuesit e institucionit që t'i viheshin në dispozicion fotokopje të raportit të shërbimit lidhur me ngjarjen, por materialet nuk u dorëzuan, me pretekstin se nuk ishin plotësuar pasi gjatë natës së ngjarjes kishte pasur prioritete të tjera. Kaseta e regjistrimeve filmike të ngjarjes, sipas Shefit të Policisë dhe procesverbalit të shënuar në regjistrin përkatës në dhomën e kontrollit të kamerave, ishte tërhequr me urdhër verbal nga DPBurgjeve dhe në këto kushte grupit të inspektimit nuk iu mundësua monitorimi i pamjeve filmike të ngjarjes në godinën e paraburgimit.

### ***Trajtimi***

Gjatë kësaj vizite monitoruese, në kontaktet personale dhe në privatësi që ekspertet e grupit të monitorimit patën me të paraburgosurit e ndodhur në kohën e ngjarjes në ambientet e përfshira nga zjarri, u parashtrua një ankesë për keqtrajtim fizik nga ana e Shefit të Policisë së Burgut ndaj të paraburgosurit, L.Gj., me synimin që i akuzuari për zjarr vënie të qëllimshme të pranonte fajin. (Lidhur me këtë ankesë u mor procesverbal i pyetjes së shtetasit).

Grupi i monitorimit vizitoi ambientet e dëmtuara nga zjarri. Në kohën e monitorimit asnjë i paraburgosur nuk gjendej në këto ambiente, pasi ishte bërë evakuimi i plotë i godinës. Godina 3, dhoma 1, si edhe korridori, ishin të dëmtuara nga zjarri dhe tymi. Tavanet e termoizoluara nga shtresa polisteroli me trashësi 10 cm dhe dyshekët e shtruar në tokë së bashku me rrobat e fjetjes ishin shkak kryesor i përhapjes së shpejtë të flakëve dhe tymrave asfiksues. Në këtë dhomë kishin qenë të akomoduar 21 persona, nga të cilët 14 flinin në 7 shtretër marinarë, 5 të tjerë flinin në dyshekë përtokë dhe dy të paraburgosur të tjerë flinin me turne apo dy veta në një shtrat.

Nga ana e të paraburgosurve u ngrit shqetësimi në lidhje me kushtet e jetesës në këtë sektor si dhe mostrajtimi i ankesave të tyre nga ana e institucionit, pasi sipas pretendimeve të tyre, ankesat në shumicën e rasteve nuk kishin gjetur zgjidhje. Dhoma ku kishte ndodhur ngjarja, me përmasa 6 x 7m, shërbente si dhomë observimi. Mbiipopullimin e saj, banorët e vuanin prej më se dy muajsh. Sipas përfaqësuesit të institucionit ky problem vinte për shkak të mbiipopullimit të institucionit dhe të mungesës së ambienteve për akomodim të të paraburgosurve. Ky mbiipopullim i përgjithshëm dhe i tejskajshëm sillte kufizimin e sipërfaqes së banimit për

person, si dhe të kubaturës standard të parashikuar për të paraburgosurit në dhomat e tyre të banimit. Rasti i dhomës 1, godina 3, me përmasa rreth 6mx7mx2.50m, ku banonin 21 persona, faktori shkëlqen e standardit ligjor si të sipërfaqes ashtu edhe të kubaturës së banimit për person. Po kështu, mbipopullimi në ambientet e paraburgimit sillte përsëritjen e rasteve kur banorët në këto dhoma, flinin përtokë, gjë që përbën trajtim jo human dhe jo dinjitoz për këtë kategori personash.

Grupi monitorues konstatoi se në disa dhoma banimi, kishte shtretër të mjaftueshëm për të paraburgosurit, por mungonte një shpërndarje e drejtë e tyre. Ky fakt ishte konstatuar edhe gjatë vizitës monitoruese të institucionit të Avokatit të Popullit në muajin nëntor 2013. Kontrasti i trajtimit ndërmjet të paraburgosurve, hedh dyshime për trajtim të diferencuar të të paraburgosurve nga ana e personelit të institucionit.

Problemi kryesor i mbipopullimit përkeqësonte përmbushjen e detyrimeve funksionale të punonjësve të sigurisë, stafit shëndetësor dhe atij psiko-edukues etj. Mbiipopullimi rëndonte gjithashtu më tej situatën higjienike jo të mirë të konstatuar në ambientet e përbashkëta e në ato brenda qelive si dhe vështirësonte procesin e shpërndarjes së ushqimit.

Duset ishin të përbashkëta për të 4 sektorët e të paraburgosurve. Të paraburgosurit bënin dush 1 herë në javë, sipas një planifikimi të bërë nga ana e përfaqësuesve të institucionit. Nga ana e të paraburgosurve, ekspertët morën ankesa lidhur me përdorimin e kufizuar të dushit nga ana e tyre kjo për shkak të mbipopullimit, si dhe të kufizimit të orarit të ujit të rrjedhshëm, shkaqe këto të cilat sillnin radhë, vonesa dhe herë-herë pamundësi në zbatimin e grafikut të dushit. Shumica dërmuese e të paraburgosurve plotësonin nevojën për dush me mjete të improvizuara (pasi pothuajse në të gjithë ambientet e përbashkëta mungonin kokat e dusheve), duke pasur parasysh se edhe uji i rrjedhshëm ishte me orar.

Grupi monitorues vizitoi gjithashtu I EVP Peqin për të konstatuar trajtimin dhe gjendjen e të paraburgosurve të transferuar nga I EVP Rrogozhinë. Sipas personelit të I EVP Peqin, rreth orës 03:00 të mëngjesit të datës 01.02.2014, me urdhër të DPB-së ishin transferuar në këtë institucion 78 të paraburgosur nga I EVP Rrogozhinë. Nga këta, vetëm 2 persona kishin ardhur më vonë në I EVP Peqin nga Spitali i Kavajës ku kishin marrë mjekim dhe u ishin nënshtruar ekzaminimeve mjekësore të specializuara si rezultat i problemeve me frymëmarrjen të shkaktuara prej zjarr vënies në I EVP Rrogozhinë. Personat e tjerë të transferuar nuk ishin banues të dhomës 1, të Godinës 3, të përfshirë nga zjarri. Sipas tyre, transferimi ishte bërë nga DPB për të zhvendosur vëmendjen nga problemet e shumta të akumuluar në 2 muajt e fundit në I EVP Rrogozhinë.

Sipas dëshmive të të transferuarve, problemet që kishin shkaktuar pakënaqësi dhe ishin bërë edhe shkak aksidenti ishin:

- Mbiipopullimi i papërbalueshëm në Sektorin e Paraburgimit dhe degradimi i shërbimeve.
- Mungesa e ujit dhe shërbimeve sanitare.
- Mungesa e dusheve si rezultat i defekteve të shpeshta elektrike në bojlerë.
- Mungesa e vazhdueshme e energjisë elektrike dhe e ngrohjes në dhoma, si dhe mos

riparimi i xhamave të thyer të dritareve.

- Mungesa e shërbimeve shëndetësore dhe cilësia shumë e dobët e ushqimit të burgut. Ata u shprehen se kishin rreth një vit që konsumonin përditë të njëjtin ushqim.

Të paraburgosurit e transferuar ishin sistemuar provizorisht në dhomat e takimit me familjarët në seksionin e sigurisë së lartë dhe të mesme duke u siguruar nga një dyshek në tokë. Në çdo dhomë ishin vendosur nga 8 deri 10 veta. Nga ana e Shefit të Regjimit të Brendshëm u sqarua se të paraburgosurit do të qëndronin provizorisht në këto kushte deri ditën e hënë, kur do të bëhej sistemimi definitiv i tyre në dhomat e regjimit të paraburgimit. Të paraburgosurit e ardhur nga Spitali i Kavajës, ishin sistemuar direkt në dhomat e paraburgimit të IEVP Peqin, në ambiente të veçuara nga ato ku ishin sistemuar shumica e të paraburgosurve të tjerë të transferuar.

Nga ana e të paraburgosurve të transferuar pati ankesa për një transportim degradues dhe jo të sigurt, pasi gjatë udhëtimit në furgonin 6 vendesh të policisë ishin transportuar njëherazi rreth 15 të paraburgosur, shtuar këtu edhe forcat e policisë që i shoqëronin. Procedurat e pranimit ishin bërë konform rregullores në praninë e komisionit të pritjes.

Grupi i monitorimit kreu edhe një vizitë në Spitalin e Kavajës për të marrë informacion lidhur me trajtimin dhe gjendjen shëndetësore të të paraburgosurve të IEVP Rrogozhinë, të dëmtuar nga rënia e zjarrit. Shefi i Repartit të Urgjencës, deklaroi se natën e datës 31.01.2014 ishin shtruar dhe trajtuar 21 të paraburgosur në Repartin e Urgjencës dhe Reanimacionit. Njëri prej të paraburgosurve, A.H., ishte dërguar në Spitalin "Shefqet Ndroqi" në Tiranë, për trajtim të plagëve të marra nga djegiet. Ndërsa 2 persona, respektivisht M.Q. dhe I.N., ishin dërguar për trajtim të mëtejshëm polmonar pranë Sanatoriumit Tiranë. Personat e tjerë, pasi ishin ekzaminuar me anë të analizave dhe radiografisë, si dhe ishin trajtuar me medikamente, kishin kaluar natën në spital dhe me vendim të shefit të pavijonit, ishin nxjerrë nga Spitali në gjendje të stabilizuar dhe të mirë shëndetësore. Gjatë trajtimit të tyre në Spitalin e Kavajës, mjekët e këtij spitali kishin ushtruar të gjithë kompetencat për një trajtim cilësor ndaj pacientëve dhe personeli i sigurisë nuk kishte ndikuar në punën e tyre.

Në përfundim të monitorimit në institucione, grupi i ekspertëve të MKPT-së konstatoi degradimin e kushteve materiale dhe shërbimeve esenciale ndaj të paraburgosurve në IEVP Rrogozhinë. Degradimi kishte ardhur si rezultat i mbipopullimit të tejskajshëm të sektorit të paraburgimit, i cili ka krijuar situatë pakënaqësie dhe tensioni në këtë sektor, duke sjellë dhe premisa për aksidente. Në dhomat e paraburgimit të IEVP Rrogozhinë kishte lidhje elektrike të ekspozuara dhe të pa izoluara që përbëjnë burim rreziku konstant për të paraburgosurit dhe vetë personelin e shërbimit në këto ambiente.

Në përfundim të konstatimeve të mësipërme, Avokati i Popullit vlerësoi se duhej të shikohej me prioritet investimi për mirëmbajtjen e institucionit, zgjidhjen e problematikës së mbipopullimit dhe përmirësimin e kushteve materiale.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave nga ana e institucionit për delegimin e hetimeve të mëtejshme organit të Prokurorisë për të Paraburgosurit, L. Gj. dhe J. M., lidhur me akuzën e zjarr vënies së



- qëllimshme.
2. Marrja e masave të menjëhershme që personeli i Policisë së Burgut të respektojë me rigorozitet standardin dhe detyrimin ligjor të mospërdorimit të dhunës fizike dhe psikologjike ndaj tyre.
  3. Marrja e masave të menjëhershme për verifikimin e mungesave të pajisjeve të domosdoshme në dhomat e banimit, me qëllim pajisjen e menjëhershme me mjetet e munguara.
  4. Marrja e masave të menjëhershme për sistemimin e personave që flinin përtokë, në krevatet e lirë në dhomat e personave të "privilegjuar", duke filluar me të paraburgosurit që ndodheshin në dhomat e observimit ndërkohë që kishin kaluar periudhën kohore të observimit të parashikuar me ligj.
  5. Marrja e masave për sqarimin e situatës së diskriminimit nga ana e personelit të paraburgimit; Marrja e masave të menjëhershme për ata individë të personelit të institucionit, të cilët me ose pa shkak, kishin lejuar situata të tilla diskriminimi.
  6. Marrja e masave të menjëhershme për sigurimin e ujit të rrjedhshëm 24 orë në ditë, nëpërmjet ri-vënies në funksion të depozitave të ujit dhe motor-pompës ekzistuese në institucion, si dhe sigurimit të kokave të dusheve për dushet ekzistuese të pa pajisura me to.
  7. Marrja e masave të menjëhershme për eliminimin dhe riparimin e instalimeve elektrike provizore e të ekspozuara në dhoma dhe banja, të cilët përbëjnë rrezik për sigurinë e jetës të të paraburgosurve.
  8. Marrja në analizë dhe nxjerrja e konkluzioneve lidhur me funksionimin e planit të evakuimit të mjediseve të I EVP Rrogozhinë në raste zjarri dhe aksidentesh të ngjashme.

## **5.2. I EVP Peqin - Datë 11.02.2014 / Nr. Dok. 201400237***Shënime paraprake*

Në përputhje me procedurën e vizitës, grupi monitorues zhvilloi fillimisht takimin me Drejtuesin e Institucionit të cilit i shpjegoi se qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i situatës së grevës së urisë së të paraburgosurve të transferuar në këtë I EVP. Grupi i kërkoi drejtuesit, shpjegime lidhur me situatën në institucion dhe trajtimin e të paraburgosurve të transferuar nga I EVP Rrogozhinë në I EVP Peqin, në natën e datës 31.01.2014. Nga përfaqësuesi i institucionit, grupi monitorues u informua se 59 të paraburgosurit e transferuar vazhdonin të qëndronin të akomoduar në ambientet e improvizuara të takimit të dënuarve me familjarët në I EVP Peqin dhe se transferimi i tyre në I EVP Rrogozhinë do realizohej në varësi të përfundimit të riparimeve të godinës së dëmtuar nga zjarri.

### ***Trajtimi***

Grupi i monitorimit konstatoi kushte degraduese materiale dhe mungesë të shërbimeve esenciale ndaj 59 të paraburgosurve të akomoduar në ambientet e takimeve me familjarët. Kjo gjendje kishte ardhur si pasojë e pamundësisë për akomodimin e tyre në regjime, në kushtet e mbipopullimit të tejskajshëm të sektorëve në I EVP Peqin.

Gjatë kësaj vizite monitoruese, përmes kontakteve personale e në privatësi me të paraburgosurit e ndodhur në ambientet e përshtatura të takimeve të të dënuarve me familjarët, u konstatuan shumë ankesa. Në njërin prej dhomave me sipërfaqe 4 x 5m, ndodheshin 12 persona të cilët flinin me dyshekë përtokë. Në dhoma nuk kishte asnjë orendi apo pajisje që të krijonte kushte minimale jetese. Mungesa e hapësirës jetike prej mbipopullimit kishte ndikuar në krijimin e një gjendje pakënaqësie e tensioni tek të të paraburgosurit, duke sjellë reagime për refuzim ushqimi dhe ankesa në grup të të paraburgosurve. Nga bisedat me ta, rezultonte se dhe shërbime e aktivitete të tilla si ajrimi, larja në dushe, telefonatat dhe kujdesi shëndetësor, ishin ofruar në minimumin e mundshëm, për shkak të mbipopullimit dhe ambienteve të papërshtatshme të akomodimit.

Nisur nga vlerësimi real i gjendjes në ambientet e akomodimit emergjent të 59 të paraburgosurve, të transferuar nga I EVP Rrogozhinë në I EVP Peqin më datë 31.02.2014, u konstatua se nëse transferimi apo akomodimi i tyre sipas standardeve nuk realizohet brenda afatit të premtuar në datat 15 dhe 16.02.2014, ekzistonte rreziku për trazira dhe aksidente në sektor. Marrja masave për transferim kishte karakter emergjent dhe të domosdoshëm, pasi edhe nga aktet ndërkombëtare dhe legjisllacioni në fuqi, trajtimi i tyre në këto kushte konsiderohet shkelje flagrante e të drejtave të njeriut.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për transferimin e 59 të paraburgosurve të akomoduar në ambientet e takimit të dënuarve me familjarët në I EVP Peqin, brenda datave të premtuara 15 dhe 16.02.2014.
2. Marrja e masave të menjëhershme për akomodimin e të paraburgosurve në dhoma në sektorë të paraburgimit dhe trajtimin e tyre sipas standardeve ligjore.

### **5.3. I EVP Zahari, Krujë - Datë 03.04.2014 / Nr. Dok. 201401246**

#### ***Shënime paraprake***

I EVP Krujë kategorizohet si institut i veçantë dhe përbëhet nga seksioni i personave me probleme të shëndetit mendor, seksioni me të dënuar mbi moshën 65 vjeçare, seksioni me të sëmurë kronikë dhe seksioni me persona me aftësi të kufizuara. Institucioni ka kapacitet maksimal prej 180 personash. Në momentin e inspektimit, ishin të strehuar 189 persona, nga të cilët 95 persona ishin të dënuar, ndërsa 94 të tjerë kishin statusin e trajtimit mjekësor me vendim gjykate. Nga këta të fundit, 6 prej tyre ishin me vendim gjykate për shtrim të përkohshëm, ndërsa pjesa tjetër prej 88 personash ishin me vendim gjykate për mjekim të detyruar.

Për këtë institucion mbetet ende shqetësuese, mbajtja e personave me masën mjekësore “mjekim i detyruar” në kundërshtim flagrant me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Po ashtu, edhe pse me status të veçantë, ky institucion duhet të këtë një seksion paraburgimi, megjithëse, prej vitesh nuk akomodon persona të kësaj kategorie.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me zëvendësdrejtorin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e

qëllimit të inspektimit. Ai informoi se problematika e amortizimit të godinës vijonte të ishte e pranishme si rrjedhojë e mungesës së fondeve në këtë drejtim. Për shkak të problematikës së ujit të rrjedhshëm, si edhe kubaturës së përcaktuar për çdo të dënuar, që sipas drejtuesit të institucionit ishte e pamjaftueshme, ky i fundit informoi se ishte bërë e mundur hapja e një pusi, dhe sipas tij nuk kishte kufizime uji brenda në regjim.

### ***Trajtimi***

Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të burgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Në dhomat e banimit, në pjesën dërrmuese të tyre, banonin 4-6 apo 9 persona. Në përgjithësi dhomat nuk kishin lavaman, tualet apo dush të përfshirë në to. Në raste shumë të rralla, në institucion kishte ambiente banimi të pajisura me ËC, lavaman dhe dush, që banoheshin nga një person i vetëm. Ky fenomen bënte të qartë diskriminim ndërmjet banorëve të institucionit, të lejuar nga punonjësit.

Dhomat e banimit të personave me probleme të shëndetit mendor, ishin jo të përshtatshme për një jetesë normale, si rrjedhojë e amortizimit dhe lagështisë së tyre.

### ***Masat mbrojtëse***

IEVP Krujë kishte një regjim burrash, të ndarë sipas kategorive të të dënuarve, ata me shtrim të përkohshëm dhe ata me mjekim të detyruar. Kjo ndarje respektohej dhe nuk u konstatuan shkelje.

E drejta për të kontaktuar me të afërmit zbatohet me rigorozitet. Të dënuarit kishin të drejtë të kryenin jo më pak se tetë telefonata në muaj me kartë të parapaguar. Gjithsesi, nga bisedat e me stafin e institucionit, kategoria e personave të dënuar me probleme të shëndetit mendor në këtë institucion, përgjithësisht, ishte e braktisur nga familjarët. Gjatë inspektimit u konstatua se telefoni në sektorin B1 nuk funksiononte. Nga stafi i institucionit, u mësua se ishin marrë masat për rregullimin sa më të shpejtë të tij. Gjatë kësaj kohe, të gjithë të dënuarit që, sipas grafikut, kishin ditën për të kryer telefonata mund të përdornin telefonin e brendshëm (të policisë), duke mos u privuar nga kjo e drejtë.

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Mjekja bënte pjesë si në Komisionin e Pritjes, ashtu edhe në Komisionin Disiplinor. Lidhur me këtë të fundit, MKPT, bazuar në Rekomandimin e CPT-së për Shqipërinë, për vitin 2010, vuri në dukje faktin se mjeku nuk duhet të jetë pjesë e Komisionit Disiplinor, por ai ka detyrimin që të ndjekë minimalisht një herë në ditë gjendjen shëndetësore të të burgosurit me masë disiplinore dhe në çdo rast kur vlerëson se shëndeti i të burgosurit vihet në rrezik si rrjedhojë e qëndrimit në izolim, duhet të informojë Drejtorin e Institucionit.

### ***Kushtet materiale***

Institucioni ishte i ndarë në dy sektorë të veçantë, sektori A (A1/ A2) dhe sektori B (B1/ B2). Ashtu siç u konfirmua nga zëvendësdrejtori i institucionit dhe siç ishte konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, mjedisi në regjim vijonte të ishte tejet i amortizuar dhe me lagështirë. Jo të gjitha dhomat e banimit e respektonin standardin e hapësirës jetike për person. Gjatë inspektimit, referuar edhe të dhënave për numrin e personave në këtë institucion në momentin e monitorimit, të përmendura në paragrafët e mësipërm, konstatoi se në IEVP-në Krujë kishte mbipopullim. Për shkak të mbipopullimit në regjim, dhoma e kufizimit fizik (sektori A), si edhe infermiera ishin kthyer në mjedise banimi. Dhoma e kufizimit fizik (sektori A) ishte e pajisur me një krevat të palëvizshëm dhe me rripa fiksues për gjymtyrët e sipërme, mesin dhe gjymtyrët e poshtme.

Kushtet materiale në seksionin e personave me probleme të shëndetit mendor nuk ishin të përshtatshme. Higjiena e dhomave, por edhe e të sëmurëve linte për të dëshiruar. Edhe shtrojat e tyre ishin të pandërruara e të palara. Dhomat ishin mjaft të çrregullta. Gjatë vizitës u konstatua se dhoma e veçimit për të sëmurët mendorë, ishte kthyer në një dhomë të zakonshme të qëndrimit të sëmurëve të dënuar.

Ambientet e përbashkëta të tualeteve, lavamanëve dhe dusheve, për çdo kat e sektor ishin të amortizuara dhe me lagështi. Jo të gjitha dushet, lavamanët dhe tualetet ishin funksionale. Uji në institucion sigurohej nëpërmjet depozitave. Problemet me ujin shfaqeshin veçanërisht në stinën e verës.

Në sektorin e të sëmurëve paraplegjikë mungonin hapësirat dhe ambientet ndihmëse për këtë kategori të sëmurësh, si shkallët e adaptuara për lëvizjen e karrocave të tyre, ashtu dhe banjat e dushet.

Në institucion kishte persona diabetikë, të cilët trajtoheshin në mënyrë të veçantë nga kuzhina, brenda parametrave të lejuara. Gjithashtu, kampionet e ushqimit ruheshin në dhomë frigoriferike, sipas standardeve të paracaktuara.

Institucioni kishte një ambient lavanderie, të pajisur me 3 makina larëse, dy prej të cilave (një e madhe e një e vogël), ishin në gjendje pune.

Në sektorin A1/ A2, ndodhej një dhomë e pajisur me televizor, karrige e tavolina, e cila nuk kishte lidhje të drejtpërdrejtë me regjimin e brendshëm të këtij sektori, por ishte e pozicionuar si aneks dhe menjëherë pas tij ishte dalja për në ambientet e ajrimit. Ky mjedis shërbente edhe si bibliotekë, edhe si dhomë për aktivitetet ditore të organizuara nga stafi psiko-social. Kushtet materiale në të ishin minimaliste, por në gjendje të mirë fizike (jo të amortizuara). Biblioteka ishte e pajisur me tituj të ndryshëm librash dhe për të kujdesej një i dënuar i punësuar. Ky ambient për shkak të strukturës dhe funksionimit të tij nuk ofronte kushtet e përshtatshme për seanca individuale këshillimi, por ishte shumë i përshtatshëm për ndërhyrje në grup.

Në sektorin B1/ B2, ndodhej një dhomë, e cila kishte lidhje të drejtpërdrejtë me regjimin e brendshëm të sektorit B. Në të kishte një televizor, tavolinë pingpongu dhe një bibliotekë. Ky

ambient ishte i ngjashëm si strukturë, funksionim, bazë materiale me sektorin A dhe ofronte të njëjtin shërbim si ky i fundit.

Në institucion nuk kishte sistem qendror ngrohjeje.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Gjatë inspektimit, grupi i ekspertëve konstatoi se, të gjitha planet e aktiviteteve të brendshme dhe të jashtme (ajrimi), nuk ishin të afishuara pranë dhomave të banimit, por vetëm në ambientet e policit të kolonës, gjë që e bënte të pamundur aksesin në to nga ana e të dënuarve.

Ajrimi i të dënuarve kryhej një herë në ditë me nga tre orë. Orar suplementar për ajrim ishte për të dënuar të cilët vuanin nga sëmundje të ndryshme sipas vlerësimit nga stafi mjekësor. Sipas shefit të policisë, gjatë periudhës së verës kohëzgjatja e ajrimit rritej dhe ndahej në dy pjesë (paradite/ pasdite). Ambientet e ajrimit gjithsej ishin katër, të ndara me rrjeta, ku njëri prej tyre funksiononte sipas rastiit si fushë futbollit, basketbollit dhe volejbollit.

Instituti ishte i pajisur me dy dhoma kulti (kishë/ xhami). Kisha Katolike dhe Shoqata Kristiane e burgjeve shqiptare ishin aktive në këtë institucion për kryerjen e shërbesave fetare.

Organika e shërbimit psiko-social përbëhej nga katër punonjës, një psikologe klinike dhe tre punonjës edukimi. Ky staf i kryente aktivitetet sipas sektorëve: sektori A 8.00-11.00, ndërsa sektori B 11.00-13.00. Aktivitet kryesorë që zhvilloheshin nga ky staf varionin nga këshillime individuale ose në grup, biseda të lira etj. Gjithashtu, në ambientet e brendshme, zhvilloheshin edhe një sërë aktivitetesh të tjera të lojërave të tavolinës, si pingpong, shah, domino, tavëll, etj., kurse në ambiente e jashtme lojëra sportive të tilla si futboll etj.

Në këtë institucion nuk zhvilloheshin programe arsimore apo kurse të formimit profesional formal apo jo-formal, pavarësisht se në këtë institucion ishin identifikuar 3 persona analfabetë. Kjo për shkak të një urdhri të D.P.B që i kishte pezulluar këto lloj aktivitetesh nisur nga kontingjenti i këtij instituti. Ky pezullim i ka privuar këta persona nga e drejta për arsimim dhe ka ngushtuar planin e ndërhyrjes psiko-sociale si mjet rehabilitues dhe terapeutik.

Dosjet e stafit psiko-social mbaheshin të mbyllura në dollap me dry. Nga dosjet psiko-sociale të shqyrtuara, u vu re se në to ishin të pasqyruara diagnozat mjekësore të përcaktuara në kartelë, por jo me një plan specifik ndërhyrjesh të lidhura me diagnozën. Sipas stafit të kujdesit social të gjithë të dënuarit kishin Programe Individuale Trajtimi (PIT), por u konstatua që jo të gjithë ishin pasqyruar në dosjet psiko-sociale. Duke marrë parasysh që ky institucion është i veçantë dhe ka gjysmën e kontingjentit të tij me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, ku shumica e tyre paraqesin probleme të shëndetit mendor, këto dosje duhet të ofrojnë informacion paralel në mbështetje të dosjes mjekësore si plane ndërhyrjeje në bazë të nevojave psiko-sociale të dënuarit, të cilat mund të provojnë se të dënuarit marrin ndërhyrje multidisiplinare.

Në momentin e inspektimit ishin 20 të dënuar, të punësuar në këtë institucion, me pune të tilla si magazinier i brendshëm, sanitar, ndihmëskuzhinierë, punonjës biblioteke, mirëmbajtës ambientesh sportive, etj.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e sektorit shëndetësor përbëhej nga dy mjekë psikiatër (pozicione këto të paplotësuara), një mjek toksikolog, një mjek i përgjithshëm, një stomatolog, një farmacist, 12 ndihmësmjekë, 3 kujdestarë, 5 sanitarë.

Gjatë intervistës me të gjithë të dënuarit, në sektorin e të dënuarve me mjekim të detyruar, e të dënuarve të tjerë të sëmurë mendorë, të dënuar paraplegjikë, dhe të dënuar mbi 65 vjeç, u vërejt se kishte një vlerësim përgjithësisht të mirë të shërbimit shëndetësor. Por, ankesa të shumta kishte në lidhje me ilaçet, të cilat mungonin si për rastet urgjente, ashtu edhe për të sëmuret kronik. Po ashtu kishte nevojë për konsulta e ndjekje më rigoroze të rasteve me çrregullime mendore, pasi edhe mjekimet e tyre kishin nevojë për rivlerësim. Nga të dënuarit paraplegjikë kishte ankesa, për sa i përket mungesës së shërbimit sanitar 24 orësh për ta.

Ambulanca e institucionit ishte tejet e amortizuar dhe nuk funksiononte. Megjithëse ekzistonte një laborator bio-kimik, ai nuk ishte funksional për shkak të mungesës së laborantes në organikën e institucionit. Po ashtu, ekzistonte edhe aparati i EKG-së, por ai nuk ishte vënë në funksionon, pasi mungonte infermieri i specializuar për përdorimin e tij.

Mungesa të theksuara kishte edhe në dhomën e stomatologut me instrumente e materiale dentare. Dhoma e infermierisë, megjithëse mbahej me rregull, kishte mangësi të theksuara në ilaçe.

Nga këqyrja e dokumentacionit mjekësor rezultoi se ato mbaheshin me rregull. Si regjistrat, ashtu dhe kartelat ishin të mbyllura me kyç. Në bazë të këtij dokumentacioni, të sëmurë mendor me mjekim të detyruar ishin 92, 14 të dënuar me diabet, 7 paraplegjikë dhe të tjerët me sëmundje kronike.

Të gjithë të dënuarit e këtij institucioni ishin të pajisur me librezë shëndetësore dhe skema e rimbursimit të ilaçeve kishte funksionuar mirë deri para pak javësh. Për shkak të vonësive në shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj depos farmaceutike me të cilën institucioni kishte një kontratë, kjo skemë nuk funksiononte më.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për sistemimin e personave me masën “mjekim i detyruar” në institucione që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë, deri në ngritjen e një institucioni të posaçëm për këtë kategori të dënuarish.
2. Marrja e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në të gjithë sektorët e regjimit dhe respektimin e hapësirës personale.
3. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me kushtet higjieno-sanitare të të gjitha mjediseve të regjimit, veçanërisht në lidhje me lagështirën dhe me amortizimin e të gjithë ambienteve të brendshme të institucionit.
4. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e godinave me mjedise të përshtatshme dushesh.
5. Marrja e masave për përmirësimin e kushteve të tualeteve.

6. Marrja e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të observim/ veçimit.
7. Marrja e masave që mjeku të mos jetë pjesë e Komisionit Disiplinor, pasi kjo ndikon në cilësinë e marrëdhënies mjek-pacient.
8. Marrjen e masave për vënien në dispozicion të dhomës së veçimit, si mjet i nevojshëm për rastet e veçanta të trajtimit (axhitim psiko-motor apo tentativa suicidale).
9. Marrja e masave nga ana e stafit psiko-social për hartimin e planeve individuale të trajtimit sipas grupeve vulnerabël që ka ky institucion.
10. Marrja e masave urgjente për pajisjen e farmacisë me ilaçe si të urgjencës, ashtu dhe të ilaçeve të tjera për sëmundjet kronike.
11. Marrja e masave për një rivlerësim të mjekimit të të sëmurëve mendore me konsulta periodike me psikiatrin, duke bërë të mundur përshtatjen e dozave e të llojeve të neuroleptikëve në varësi të diagnozës e të gjendjes së të dënuarve.
12. Marrja e masave për furnizimin e dhomës së stomatologut me instrumente e materiale dentare.
13. Marrja e masave të menjëhershme për rivënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve.
14. Marrja e masave për pajisjen urgjente të institucionit me një ambulance të re.
15. Marrja e masave për vënien në punë të EKG-së dhe të laboratorit, duke plotësuar organikën e sektorit shëndetësor me specialistët përkatës.
16. Marrja e masave për t'u ofruar akses të dënuarve paraplegjikë në mënyrë që të lehtësohen lëvizjet e tyre në të gjithë ambientet e institucionit, veçanërisht për banjat dhe dushet të cilat duhet të kenë mjete ndihmëse në funksion të nevojave të tyre.

#### **5.4. Instituti i të Miturve Kavajë - Datë 16.04.2014 / Nr. Dok. 201400765**

##### ***Shënime paraprake***

Instituti i të Miturve Kavajë ka kapacitet maksimal prej 40 personash, duke përfshirë një sektor të vuajtjes së dënimit me kapacitet prej 20 personash, dhe një sektor paraburgimi me kapacitet prej 20 personash. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 26 të mitur, 24 prej të cilëve të paraburgosur dhe 2 të burgosur. 25 të mitur kishin përfituar nga amnistia e shpallur me Dekret të Presidentit të Republikës Nr. 8523, datë 24.03.2014.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues, duke pasur parasysh se Instituti i të Miturve Kavajë është një institucion i ndërtuar rishtas dhe i vënë në funksion sipas parametrave të larta Evropiane, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të miturve si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni në vitin 2013. Nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve iu bë me dije se ndaj individëve që ishin akuzuar për ushtrim dhune dhe trajtim jo dinjitoz të të miturve në institucion, ishin bërë hetime dhe ishin marrë masat e duhura administrative. Lidhur me problemet e mirëmbajtjes strukturore dhe shërbimeve ndaj të miturve të evidentuara nga

vizita pararendëse, nga ana e përfaqësuesit të institucionit u sqarua se ishin marrë masat e mundshme për minimizimin apo eliminimin e problematikave të evidentuara.

Në kohën e monitorimit nuk kishte të mitur në dhomat e observimit. Po ashtu në dhomën e veçimit nuk kishte asnjë person ndaj të cilit të ishte marrë masë disiplinore.

Në momentin e inspektimit ishin 24 të paraburgosur, pra 4 persona mbi kapacitetin normal, dhe 2 të burgosur. Gjatë inspektimit u konstatua se në mjediset e paraburgimit kishte 2 persona që sapo kishin mbushur 18 vjeç.

Referuar në informacionin e marrë dhe të konfirmuar me listën zyrtare të të punësuarve, në institucion në kohën e monitorimit figuronin 6 të paraburgosur të punësuar.

### *Trajtimi*

Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të miturit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture. Për rastet kur kishte ndodhur përdorimi i tepruar i forcës, personat përgjegjës ishin ndëshkuar me masa administrative nga ana e drejtuesve të institucionit. Këto raste u gjendën edhe të regjistruara në dokumentacionin shëndetësor konkretisht në regjistrin e evidentimit të rasteve të dëmtimeve fizike nga ushtrimi i dhunës dhe trajtuar nga ana e stafit mjekësor. Në këtë regjistër u evidentuan dy raste të ushtrimit të dhunës fizike ndaj të të miturve nga efektivë të grupit të gatshëm të institucionit. Lidhur me këto dy raste u administrua nga ana e ekspertëve të MKPT i gjithë dokumentacioni i masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Pavarësisht masave të marra në këtë drejtim nga ana e drejtuesve të institucionit ndaj akteve të tilla të pa tolerueshme, grupi inspektues i MKPT nga intervistat e zhvilluara në privatësi me të miturit konstatoi përtej pretendimeve dhe dyshimeve të arsyeshme se ende në këtë institucion kishte persona të caktuar në stafin e sigurisë të cilët e ushtonin dhunën fizike dhe psikologjike si formë presioni dhe ndëshkimi. Po ashtu u konstatua se dhe nga stafi psiko-social masat disiplinore përdorshin përtej kompetencave si formë presioni pa ndërgjegjësimin që përbënin dhunë psikologjike. Grupi inspektues i MKPT i referoi këto informacione me të dhëna konkrete drejtuesve të institucionit duke u bërë të qartë se raste të tilla nuk mund të tolerohen dhe se nuk mund të kalojnë të pandëshkuara sipas legjislacionit në fuqi.

Nga ana e administratës së institucionit, ekspertëve iu bë me dije se sjellja e mirë, harmonike dhe korrekte e të miturve ndërmjet tyre, por edhe ndaj punonjësve të institucionit, kishte sjellë që për një kohë të gjatë të mos kishte situata të përdorimit të masave disiplinore ndaj të miturve. Nga ana e ekspertëve të MKPT u vlerësua ky fakt, pasi vendosja e të miturve në kushte veçimi është një masë e cila sjell pasoja në integritetin e tyre fizik dhe psikik, e si e tillë duhet të merret në raste shumë të rralla dhe të konsiderohet si mjeti disiplinor më ekstrem që duhet dhënë për një kohë sa me të shkurtër në garantim të kohës së plotë të ajrimit dhe të literaturës didaktike dhe letrare. Në këtë drejtim u vlerësuan rekomandimet e DPB në zbatimin e praktikave të mira Evropiane në fushën e drejtësisë për të miturit mbi zbatimin e masave alternative disiplinore në institucion përkundër masës së “veçimit”.



Masat e reja edukative disiplinore nuk ishin kuptuar siç duhet nga ana e stafit të edukimit dhe zbatoheshin jashtë procedurave dhe politikave disiplinore dhe edukative për të miturit sikurse përcaktohen në udhëzuesin administrativ të DPB. Masat edukative për vetë funksionin pedagogjik të tyre duhet të përdoren në mënyrë të drejtë, të duhur dhe të paanshme. Procedura e dhënies së tyre duhet të jetë transparente dhe i mituri duhet të dëgjohet gjatë marrjes së vendimit dhe të ketë mundësinë të shpjegohet lidhur me arsyen dhe veprimet e tij. Procedura duhet të jetë e thjeshtë dhe e lehtë për t'u kuptuar nga ana e të miturit. Lidhur me llojet e masave edukative dhe kohëzgjatjen e tyre parashikohet:

- a. Pushim/ përjashtim nga aktiviteti edukativ nga 10-15 minuta deri në 25-30 minuta në rastet e mungesës së reflektimit. (Këtë masë mund ta japë personeli i edukimit).
- b. Përjashtim nga pjesëmarrja në njërin nga aktivitetet e dëshiruara prej të miturit gjatë ditës, jo më shumë se 50-60 minuta. (Këtë masë mund ta japë personeli i edukimit me miratimin e Përgjegjësit të Sektorit të Kujdesit Social).
- c. Përjashtim nga aktivitetet ditore në grup dhe qëndrim gjatë ditës në dhomë. Në këtë rast qëndrimi me dhomë nuk mund të zgjasë më shumë se 15 orë (këtë masë mund ta japë Drejtori i Institucionit bazuar në relacionin me shkrim të Përgjegjësit të Sektorit të Kujdesit Social).

Në kundërshtim me sa më lartë, grupi i inspektimit konstatoi rastin e një të mituri, të cilit, nga ana e stafit të edukimit, më saktë, njëra prej specialisteve të edukimit, sigluar nga përgjegjësja e sektorit social, i ishte dhënë një masë edukative “me përjashtim nga aktivitetet për një ditë” në tejkalim të kompetencave procedurale. Për më tepër, i mituri nuk ishte informuar, apo t'i ishte dhënë mundësia të shpjegohej lidhur me problematikën e sjelljes së pretenduar dhe as mbi kohëzgjatjen e masës disiplinore. Lidhur me vendosjen e dhënies së masës edukative dhe kohën e përfundimit të saj duhet të zbatohen procedurat ligjore të cilat në vetvete mbartin një funksion edukues. Në rastin në fjalë, pika c nuk ishte zbatuar.

Gjatë takimit me të miturit, grupi i inspektimit mori dijeni për të miturin P. Xh., i datëlindjes 11.04.1997, i cili dyshohej të kishte kryer veprën penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, neni 283/ 2 i Kodit Penal, për të cilin, masa e sigurisë ishte caktuar “arrest në burg” me afat 30 ditë. I mituri ishte arrestuar më datë 07.03.2014, rrjedhimisht, duke u bazuar në nenin 250 të Kodit të Procedurës Penale, pika 1 që thotë se “efektet e paraburgimit fillojnë të ecin nga çasti i arrestimit ose ndalimit” sipas përlllogaritjeve, afati i masës së sigurisë së tij duhej të përfundonte me datë 07.04.2014. Në momentin e kontaktimit me grupin e monitorimit më datë 16.04.2014, i mituri vijonte të mbetej në mjediset e paraburgimit, i painformuar dhe i pasqaruar se përse vijonte të qëndronte në paraburgim. Grupi i inspektimit mori takim me përgjegjësën e sektorit ligjor, dhe prej tij u informua se institucioni ishte në pritje të komunikimit të prokurorisë, me anë të të cilit i mituri ose do të lirohej, ose do t'i jepej një masë tjetër sigurie. Grupi monitorues u informua nga përgjegjësi i sektorit ligjor se problematika në fjalë ishte identifikuar dhe e njohur nga ana e tij dhe të vetë Institutit të të Miturve Kavajë. Kjo problematikë bëhej e theksuar për të paraburgosurit me masë sigurie me afat, pasi njoftimi nga ana e prokurorisë për vijimësinë e çështjes vinte pothuajse në çdo rast e vonësë. Pavarësisht se nga ana e përgjegjësit ligjor u shpjegua se në të tilla raste, përkrah komunikimit zyrtar shkresor me prokurorinë përkatëse, ai personalisht mbante komunikim telefonik me prokurorët e çështjeve, në rastin e të miturit të sipërcituar, nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim shkresor, duke e lënë të miturin pa

informacion dhe për më tepër, në parim, duke i privuar lirinë pa një dokument të vlefshëm ligjor. Përgjegjësi i sektorit ligjor, pas diskutimit me grupin e monitorimit për rastin në fjalë, gjatë takimit përmbyllës, informoi se ndërkohë kishte pasur një komunikim telefonik me prokurorin e çështjes, prej të cilit ishte vënë në dijeni se të miturit i ishte dhënë një masë tjetër sigurie pa afat, për të cilën, sërish i mituri nuk ishte vënë në dijeni.

Në bazë të Nenit 35, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale, të miturit duhet t'i sigurohet ndihma si juridike, ashtu edhe ajo psikologjike, me praninë e prindit ose të personave të tjerë “të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon”. Për më tepër, në nenin 14, të ligjit nr. Nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar, “Për të dënuarit e mitur organet e ekzekutimit njoftojnë paraprakisht edhe prindin ose kujdestarin”. Në kontaktin që inspektuesit patën me të miturin, të paraburgosurit e tjerë të mitur, si dhe me personelin, u informuan se i mituri nuk kishte marrë asnjë lloj kontakti me të afërmit e tij që prej ditës së arrestimit, e deri në momentin e kontaktit me grupin monitorues.

### ***Masat mbrojtëse.***

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Për rastet e dhunës së konstatuar nga Komisioni kishte një regjistër të veçantë që mbahej nga mjekja e institucionit. Mjekja bënte pjesë edhe në Komisionin Disiplinor, por si vëzhguese pa të të drejtë vote gjatë procesit.

Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të institucionit, u konstatua se kishte një dhomë të posaçme për Komisionin e Pritjes dhe dy dhoma takimi brenda standardeve që lejonin takimin pa pengesa mes të miturit dhe vizituesit.

Në muret dhe hollin e çdo kati ishin afishuar të drejtat dhe detyrimet e të miturve. Dhoma e veçimit dhe dy dhomat e vëzhgimit ishin të pajisura me krevate e shtroje, por kishin probleme në sistemin elektrik (tela të pa izoluar jashtë kutie) dhe atë hidraulik (probleme me ujin, rubinetet, ËC-në), duke u bërë të papërshtatshme për banim. Korridori në të cilin ndodheshin këto dhoma ishte i pambuluar me kamera sigurie.

Pothuajse të gjithë të miturit pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonit me kartë që ndodhej në mjedisin e përbashkët.

Ekzistonte sistemi i kërkesë/ ankesave. Të miturit plotësonin një formular të thjeshtë të hartuar nga vetë institucioni, të cilin ia dorëzonin edukatorit. Ky i fundit ia kalonte Drejtorit të Institucionit, i cili përgjithësisht brenda të njëjtës ditë, takohej me të miturin duke i dhënë udhë zgjidhjes së problematikës së të miturit kërkuar/ ankues.

### ***Kushtet materiale***

Institucioni ishte i pajisur me sistem ventilimi dhe ngrohjeje qendrore, si dhe me sistem të mbrojtjes kundër zjarrit. Gjithashtu institucioni kishte ambient sportiv (fushë futbollit/ kalçeto), lavanderi, kuzhinë moderne, klasa në formë laboratorit për punë me dru dhe metal si dhe artesh të

aplikuara gjithashtu dhe ambient për dhomë kulti, bibliotekë, infermieri, si dhe ambient palestres të cilësuar nga vetë institucioni si jo funksional.

Mjediset e të paraburgosurve ishin të ndara nga ato të të burgosurve. Sektorët, në të cilët ishin dhe dhomat e banimit të të paraburgosurve dhe të miturve të dënuar ishin të organizuar në këto ambiente: dhoma banimi, ambiente të përbashkëta, dhomë këshillimi, klasa, banjë e jashtme e përbashkët me ambiente dushi. Sektori i paraburgimit në Kavajë është i organizuar në tre seksione njeri në katin e parë dhe dy në katin e dytë të ndërtesës. Secili nga seksionet kishte pesë dhoma me kapacitet mbajtës dy persona në dhomë, si dhe ambiente të dusheve më vete për çdo seksion. Dhomat ishin pajisur me orenditë e nevojshme dhe me banja. Mjediset në njërin prej sektorëve të paraburgimit ishin më higjienike. Gjatë inspektimit u konstatua se institucioni po lyhej. Si në paraburgim, ashtu edhe në burgim, tualetet e vendosura brenda në dhomat e banimit kishin nevoja imediate për ndërhyrje në shmangien e lagështirës dhe në disa raste për vendosjen e ndriçimit artificial dhe lavamanëve.

Nuk kishte probleme në furnizimin e vazhdueshëm me energji elektrike dhe me ujë të ngrohtë për dushet. Megjithatë, këto të fundit, kishin problematika të theksuara lagështie dhe amortizimi: në një total prej 9 dushesh, vetëm 3 punonin normalisht, kurse të 12-të lavamanët e vendosur në të njëjtin ambient nuk ishte funksionalë. Në ambientin e dushit të njërit prej sektorëve të paraburgimit, mungonte energjia elektrike dhe kishte rrjedhje të pakontrolluara të ujit. Përgjithësisht ambientet e dushit ishin shumë të ftohta për të funksionuar në normalitet.

Ngrohja mbetej problem edhe për ambientet e tjera, pasi kaldaja ndizej vetëm në darkë për disa orë dhe fikej sërish vetëm kur temperaturat uleshin nën 5 gradë.

Në mjedisin e përshtatur si lavanderi ishin 5 makina larëse, por 2 prej tyre ishin jashtë funksionit. Tharja kryhej brenda të njëjtit ambient, në dy kremstarë dhe karrige.

Mjedisi i kuzhinës ishte i pastër dhe i mirë pajisur. Menyja javore ishte e afishuar dhe brenda në frigorifer ishin ruajtur mostrat e ushqimit ditor në një kuti plastike të vulosur. Cilësia e ushqimit dhe larmia e tij ishte një problem për të cilin grupi i inspektimit mori ankesa nga të gjithë të miturit. Problematika u nxorën në pah edhe për produkte specifike të tilla si vezët, mishi dhe qumështi, të cilët përveç aromave të pakëndshme, shërbeheshin në pjata dhe gota të papastra. Palestra e institucionit kishte rreth 3 muaj e gjysmë që ishte mbyllur me pretendimin që veglat kishin defekte dhe si të tilla krijonin rrezikshmëri për të miturit. Grupi i inspektimit këqyri ambientin e palestrës dhe verifikoi se ajo ishte në kushte optimale për përdorim dhe se vetëm disa vegla kishin nevojë për riparime minimale.

Lidhur me furnizimin me pajisje hotelerie apo të higjienës personale apo të përbashkët, të miturit pohuan se furnizimi me artikuj të tillë si furça dhëmbësh, pasta, letra higjienike, etj. ishte i pamjaftueshëm dhe se pjesa më e madhe e tyre furnizoheshin nga familja.

Vijonte i njëjti problem i konstatuar edhe gjatë inspektimit të kaluar, lidhur me blerjen e artikujve të ndryshëm pranë dyqanit të institucionit për shkak të mospasjes së kartës përkatëse të debitit. Në këtë mënyrë, të miturit nuk kishin mundësinë të blinin produkte sipas dëshirës, por mbeteshin tek artikujt e dërguar nga familja.

## ***Regjimi dhe aktivitetet***

Çështja e ajrimit u verifikua si problematike nga ana e grupit të inspektimit. Drejtuesit e institucionit nuk ishin në dijeni që me ndryshimet e reja ligjore, të miturit duhet të kenë ajrosje deri në 3 orë në ditë. Ata u shprehën se me rregullore të miturit dilnin 2 orë në ditë për ajrim dhe se aktivitetet sportive përfshihen brenda këtij orari. Ndërkohë që nga të miturit mësuam se ata dinin kryesisht rreth 45 minuta paradite dhe po aq pasdite, por edhe kjo ndodhte edhe me përzgjedhje duke krijuar standarde të dyfishta sjelljeje dhe trajtimi ndaj të miturve brenda të njëjtë institucion, madje edhe brenda të njëjtë seksion. Të miturit, pohuan se ajrimi bëhej edhe sipas dëshirës së personelit të sigurisë në kohë dhe kohëzgjatje.

Të miturit kishin mundësi të ndiqnin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar të ndarë përkatësisht në cikël të lartë e të ulët. Për të miturit e ardhur rishtazi kërkesat dërgoheshin pranë Drejtorive Arsimore Rajonale/ Zyrave arsimore të rretheve nga vijnë të miturit, mbi arsimin përkatës të tyre. Mësimdhënia kryhej nga Shkolla “Rilindja” Kavajë. Regjistrimi në klasat përkatëse bëhej mbi bazën e dokumentimit përkatës (kur ky disponohej) ose në bazën e testimit. Me mbarimin e klasës apo lirim/ transferimin e të miturit, ky i fundit pajisej me dëftesën ose vërtetimin përkatës të njëvlershëm me atë të përfutur nga shkolla e të njëjtë nivel jashtë Institutit.

Procesi i formimit profesional (kurse për saldator, hidraulik dhe punë me dru) zhvillohej nga Instruktorët e Qendrës së Formimit Profesional Durrës, nga e hëna në të premte, në orën 14.30 deri më 16.00.

Të miturit gëzonin të drejtën për të frekuentuar bibliotekën si dhe për të marrë pjesë në recensionet e librave e temat sociale që zhvilloheshin nga stafi i edukimit përmes edukatorëve përkatës.

Aktivitetet sportive konsistonin kryesisht në lojëra tavoline, lojëra futbollit, basketbollit dhe volejbollit.

Aktivitetet fetare kryheshin në bashkëpunim me Kishën Ortodokse dhe Myftininë Kavajë, përkatësisht nga një orë në javë.

Shërbimi psiko-social u vlerësua nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimi me të miturit dhe komunikimi me stafin. Dosjet psiko-sociale mbaheshin të mbyllura me çelës. Ato ishin të plotësuara me cilësi të ndryshme në varësi të specialistit që i mbulonte. Përgjithësisht shënimet e veçanta ishin të përnuajshme, por të shkruara në mënyrë standarde e të paspecifikuar. Programet individuale të trajtimit, në rastet kur ishin të përfshira, ishin të paplotësuara në të gjitha zërat. Kishte raste mungesash në hartimin e planeve të ndërhyrjes. Mungonin testet diagnostikuese. Sa i përket këshillimeve individuale, ato rezultonin të ishin kryer jo në përputhje me standardet profesionale (psikologjike). Këshillime në grup konsideroheshin kryesisht bisedat e lira gjatë trajtimit të temave sociale. Të miturit kishin ankesa për sa i përket cilësisë së shërbimit psikologjik.

## ***Shërbimi shëndetësor***

Stafi i kujdesit shëndetësor ishte i plotësuar sipas organikës me një mjekë me kohë të plotë, një farmacist- ndihmës mjek me kohë të plotë, një stomatolog me kohë të pjesshme dhe katër ndihmës mjekë. Nga intervistat me të paraburgosurit dhe të dënuarit pranë këtij institucioni, nuk u konstatuan probleme të shëndetit fizik. Ata u shprehën të kënaqur me ndjekjen dhe vlerësimin e mjekes për çdo ankesë të tyre, si dhe shërbimin shëndetësor në përgjithësi. Nuk kishte të mitur që vuanin nga sëmundje kronike. Rastet e konstatuara me probleme të shëndetit fizik ishin trajtuar në mënyrë korrekte. Mjekja e institucionit pasi bënte një vlerësim të përgjithshëm të gjendjes së tyre shëndetësore, kur konstatonte probleme që kërkonin një vlerësim më të specializuar, rekomandonte konsulta përkatëse në spitalin e rrethit apo/ dhe në QSB Tiranë, në varësi të patologjisë organike nga e cila vuante pacienti. Në ditën e inspektimit, në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, një I paraburgosur (S. M.) pasi ishte diagnostikuar me Formacion Femoral sinister, ishte dërguar në QSB-Tiranë për një konsultë më të zgjeruar e planifikim të ndërhyrjes kirurgjikale.

Për sa i përket trajtimit të problemeve të shëndetit mendor, në institucion gjendej vetëm një i dënuar minoren i diagnostikuar me prapambetje mendore të lehtë. Gjithsesi, gjatë inspektimit u konstatua një minoren i cili manifestonte çrregullime të gjumit, ankthit dhe luhatje të vazhdueshme humori, i cili duhej vlerësuar nga stafi psiko-social dhe nga një specialist (mjek psikiatër) për të dhënë rekomandimet e duhura terapeutike.

Nga inspektimi i dhomës së mjekes, farmacistit, stomatologut e infermierisë, u vërejt se ato ishin në kushte të mira higjieno-sanitare, të rregullta e të mirëmbajtura, por u konstatuan mangësi në mjete mjekësore për manipulime të ndryshme. Në farmaci, kishte mungesa në medikamente, veçanërisht në medikamente të urgjencës. Në dhomën e stomatologut, uniti funksiononte me probleme (poltroni defektoz, pështymore pa ujë), dhe mungonte autoklava e instrumentet dentare. Ambulanca e institucionit ishte jashtë funksionit.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekes u konstatua ekzistenca e një regjistri të evidentimit të rasteve të ushtrimit të dhunës fizike. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura në rregull. Në to u vërejtën dy raste të ushtrimit të dhunës nga individë pjesë e grupit të gatshëm të institucionit, për të cilët nga stafi drejtues i institucionit ishin marrë masa administrative konkrete. Regjistrat e informacionit 24orësh të infermierëve ishin të rregullta. Kartelat mjekësore ishin të plotësuara në mënyrë korrekte dhe mbaheshin të mbyllura me çelës.

Me libreza shëndetësore ishin të pajisur dy të burgosurit dhe vetëm gjashtë prej të paraburgosurve. Për 18 të paraburgosurit e tjerë mungonin librezat shëndetësore. Nga stafi i Institucionit grupi inspektues u informua që pajisja me libreza shëndetësore nuk ishte kryer për të gjithë të miturit, pasi ishin hasur probleme në plotësimin me dokumentacionet identifikuese. Në institucion ende nuk ishte vënë në zbatim skema e re e rimbursimit të ilaçeve.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për mbulimin me sistem monitorimi (kamera) për të gjitha mjediset pa monitorim, në veçanti pranë dhomave të observimit dhe veçimit, si edhe në klasa.
2. Marrja e masave për vënien në funksionim të të gjitha makinave larëse dhe sigurimin e mjediseve të mjaftueshme për tharjen e teshave.
3. Marrja e masave të menjëhershme për trajtimin e njëlojtë të të gjithë të miturve të paraburgosur në aspektin e pastërtisë, ajrimit, aktiviteteve të tjera, etj.
4. Marrja e masave të menjëhershme për rregullimin e tualeteve të vendosura në ambientet e banimit për ndriçim artificial, lavamanë dhe izolimin e lagështirës së theksuar.
5. Marrja e masave të menjëhershme për rregullimin e dusheve, lavamanëve dhe ndriçimit artificial në këto ambiente, mundësimin e një mjedisi me ngrohje normale që bëjnë të mundur bërjen e dushit pa rrezikuar shëndetin, si edhe izolimi i lagështirës së theksuar, e cila mund të krijojë rrezikshmëri të lartë për sistemin elektrik. duke rrezikuar kështu shëndetin e të miturve.
6. Marrja e masave për përmirësimin e ushqimit në drejtim të larmisë së menysë, përmirësimit të cilësisë së qumështit, vezëve dhe mishit, si edhe përmirësimi i higjienës së enëve ku gatuhet dhe shërbehet ushqimi.
7. Marrja e masave të menjëhershme për sigurimin e ngrohjes së vazhdueshme në mjediset e banimit.
8. Marrja e masave për mundësimin e blerjes nga ana e të miturve e artikujve të dëshiruar pranë dyqanit të institucionit. Në përgjigjen e dërguar nga Institucioni i të Miturve Kavajë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit me nr. 448 prot., datë 04.03.2014, shpjegohen masat e marra në drejtim të zgjidhjes së kësaj problematike me subjektin bankës për pajisjen e të miturve me karta debiti. Gjithsesi konstatohet se problematika vijon të mbetet e njëjtë, duke privuar kështu të miturit nga blerjet e personalizuar.
9. Marrja e masave të menjëhershme për riparimin e veglave në ambientet e palestrës, duke e rivendosur atë menjëherë në funksionim.
10. Marrja e masave të menjëhershme për furnizimin e të miturve me pajisje hotelerie dhe të higjienës personale e të përbashkët.
11. Marrja e masave të menjëhershme për ndjekjen më rigoroze e të paraburgosurve/ burgosurve të mitur si nga ana e stafit mjekësor ashtu dhe atij psiko-social për sa i përket statusit mendor të tyre e gjendjes së përgjithshme psiko-emocionale, duke pasur parasysh edhe faktin e traumës që institucionalizimi mund të shkaktojë.
12. Marrja e masave të menjëhershme për mundësimin e riparimit të ambulancës ose pajisjen e institucionit me një autoambulancë të re.
13. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e dhomës së stomatologut me autoklavë e instrumente dentare.
14. Marrja e masave të menjëhershme për furnizimin e farmacisë me medikamente, veçanërisht me ato të urgjencës.
15. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen me libreza shëndetësore të gjithë të paraburgosurit.
16. Marrja e masave të menjëhershme për vënien në funksion të plotë të skemës së rimbursimit të ilaçeve.

17. Marrja e masave për zbatimin me rigorozitet të Udhëzuesit Administrativ të DPB lidhur me aplikimin e masave edukative për të miturit dhe respektimin e procedurave ligjore gjate aplikimit të këtyre masave.
18. Marrja e masave në lidhje me rritjen e mbikëqyrjes dhe vëmendjes kundrejt rasteve të pretenduara nga ana e të miturve për raste dhune fyerje apo kërcënimi ndaj tyre nga ana e ndonjë efektivit të sigurisë me prirje të tilla në institucion.
19. Marrja e masave për përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve këshillimore psikologjike.
20. Marrja e masave për përmirësimin e cilësisë së plotësisë të dosjeve psiko-sociale.
21. Hartimi i një marrëveshje mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Prokurorisë së Përgjithshme për të zgjidhur në mënyrë të menjëhershme çështjen e vonesave në komunikim mes prokurorive të rretheve gjyqësore dhe I EVP-ve lidhur me revokimin, shuarjen apo zëvendësimin e masës së sigurisë, veçanërisht kur ajo është me afat. Vonesa në komunikimin e sipërcituar çon në privimin e padrejtë të lirisë së personit të mitur. Për rastin e konstatuar nga grupi i monitorimit, Institucioni i të Miturve Kavajë duhet të informojë menjëherë Institucionin e Avokatit të Popullit lidhur me zgjidhjen e problematikës.
22. Lidhur me Rekomandimet 17 dhe 18, të merret në analizë procesi i trajtimit të rasteve përkatëse dhe të nxirren konkluzionet dhe masat përkatëse.

#### **5.5. I EVP “Ali Demi” (325), Tiranë - Datë 30.04.2014 / Nr.Dok. 201400926**

##### ***Shënime paraprake***

Institucioni ka kapacitet maksimal prej 148 personash, ku përfshihen një sektor i vuajtjes së dënimit për meshkuj me kapacitet prej 80 personash dhe një sektor të vuajtjes së dënimit për femra me kapacitet prej 68 personash. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 39 femra dhe 52 meshkuj, gjithsej 91 persona të dënuar. Nga amnistia e shpallur me Dekret të Presidentit të Republikës Nr. 8523, datë 24.03.2014, kishin përfituar 86 persona, përfshirë këtu femra dhe meshkuj.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve iu bë me dije se vijonte të ishte e pranishme problematika e amortizimit të godinës, si dhe mungesa e fondeve për këtë drejtim, pavarësisht se po shfrytëzoheshin të gjitha mundësitë për të siguruar një mjedis më të mirë për të burgosurit që vuanin dënimin në këtë I EVP. Ai informoi se kishte donacione dhe projekte të ndryshme nga ana e OJF-ve, por ato ishin të orientuara drejt shërbimeve ndaj të dënuarve dhe jo në fushën e mirëmbajtjes së institucionit.

Gjatë inspektimit u konstatua se, si në sektorin e burrave ashtu dhe në atë të grave, kishte ambient observimi/ veçimi. Në regjimin e meshkujve kishte 2 persona në dhomat e observimit dhe të veçimit, përkatësisht nga një në secilën prej tyre. Në regjimin e femrave kishte 3 femra me probleme të shëndetit mendor, të cilat ishin të vendosura në 2 dhoma të veçuara nga pjesa tjetër e

banimit, ndonëse brenda në regjim. Në këtë seksion të veçantë, përveç dhomave në fjalë, gjendeshin edhe dhomat e observimit dhe të veçimit.

Në regjimin e femrave ndodhej edhe një çerdhe e mirë pajisur me 4 dhoma në një mjedis të pastër, të rregullt dhe miqësor për fëmijët deri në 3 vjeç. Në momentin e inspektimit nuk kishte të mitur të akomoduar.

Referuar në informacionin e marrë dhe të konfirmuar me listën zyrtare të të punësuarve, në institucion në kohën e monitorimit figuronin të punësuar 6 të burgosur meshkuj dhe 23 të burgosura femra.

### ***Trajtimi***

Grupi i monitorimit pati për objektiv kryesor të punës së tij mbledhjen e informacionit për identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik, të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të burgosurit femra dhe meshkuj, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Gjatë inspektimit u konstatua se në mjediset e seksionit të grave kishte nëna të fëmijëve të vegjël të moshës 3-5 vjeç të cilat kërkonin që të trajtoheshin më me prioritet në procedurat e dhënies së lejeve shpërblyese, bazuar në domosdoshmërinë dhe interesin e fëmijës për një kontakt më të shpeshtë me prindin.

### ***Masat mbrojtëse.***

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Mjekja bënte pjesë si në Komisionin e Pritjes, ashtu edhe në Komisionin Disiplinor. Lidhur me këtë të fundit, MKPT, bazuar në Rekomandimin e CPT-së për Shqipërinë, për vitin 2010, vuri në dukje faktin se mjeku nuk duhet të jetë pjesë e Komisionit Disiplinor, por ai duhet të ndjekë minimalisht një herë në ditë gjendjen shëndetësore të të burgosurit me masë disiplinore dhe në çdo rast kur vlerëson se shëndeti i të burgosurit vihet në rrezik si rrjedhojë e qëndrimit në izolim, duhet të informojë Drejtorin e Institucionit.

Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të institucionit, u konstatua se kishte dy dhoma takimi (një për regjimin e femrave dhe një për atë të meshkujve) që lejonin takimin e 3 familjeve njëkohësisht.

Dhomat e veçimit dhe izolimit ishin brenda sektorit të veçantë në regjimin e femrave, të cilat së bashku me dhomat e veçimit dhe observimit të regjimit të meshkujve rezultuan të ishin shumë problematike.

Pati ankesa nga ana e të dënuarave për ndarje të zhdrejtë të personave në dhoma banimi. Nga disa prej tyre u kërkuar një ndarje e vendosjes së të dënuarave në mjedise banimi sipas veprave penale për të cilat po vuanin dënimin.



Ekzistonte sistemi i kërkesë/ ankesave. Në bibliotekën e regjimit të femrave ishte një kuti, e cila shërbente si për letrat që vinin apo dërgoheshin për dhe nga të burgosurat, ashtu edhe për kërkesat dhe ankesat e tyre. Kjo kuti hapej nga një personel i sigurisë, i cili bënte më pas edhe shpërndarjen e tyre. I njëjti sistem ekzistonte edhe në regjimin e meshkujve. Grupi i inspektimit vuri re se një sistem i tillë nuk plotëson kriteret e urdhrat të DPB ku orientohet qartë se administrimi i kutive duhet të bëhet nga sektori i edukimit.

Të gjithë të dënuarit e intervistuar, si në regjimin e femrave ashtu edhe në atë të meshkujve, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonit me kartë që ndodhej në mjedisin e regjimeve përkatëse (3 telefona funksionalë në secilin prej regjimeve pranë të cilëve ishte dukshëm i afishuar edhe numri i Avokatit të Popullit). Gjithsesi, mbi procedurat e zbatuara gjatë bisedave telefonike me familjarë, të afërm dhe miq nga ana e të dënuarve në përgjithësi, rezultoi se nga ana e institucionit zbatohet Udhëzimi i DPB nr. 597, datë 24.01.2007, i cili pengonte zhvillimin e telefonatave në privatësi. Nga ana e stafit të sigurisë, u bë me dije se zbatimi i këtij udhëzimi vijonte, pasi ka pasur shumë raste të telefonatave problematike ndaj të tretëve të bëra nga ana e të dënuarve. Grupi i inspektimit vuri në pah faktin se ky udhëzim është zëvendësuar me standarde të reja, të cilat i japin kontaktit të të dënuarve me botën e jashtme një kuptim dhe dimension të ri në funksion të rehabilitimit.

### ***Kushtet materiale***

Ashtu siç u konfirmua nga Drejtuesi i Institucionit dhe siç është konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, mjedisi në të dy regjimet vijonte të ishte tejet i amortizuar dhe me lagështirë. Dhomat e banimit në të dy regjimet akomodonin nga 2-8 persona, duke respektuar standardin e hapësirës jetike për person, dritës natyrale në dhoma, pajisjes së dhomave me orenditë e nevojshme dhe furnizimit me ujë të ngrohtë të dusheve. Në institucion nuk kishte sistem qendror ngrohjeje.

Nga inspektimi i dhomës së mjekes u konstatua se ajo ishte e papërshtatshme, si nga hapësira, ashtu edhe për sa i përket lagështirës dhe kushteve minimale për të kryer vizita. E njëjta gjë mund të thuhej edhe për dhomën e farmacistit e të infermierisë. Te kjo e fundit, kushtet ku mbaheshin ilaçet ishin jo të mira, mungonte frigoriferi dhe lavamani ishte jashtë funksionit. Dhoma e stomatologut ishte përgjithësisht brenda parametrave, me unit të mirë e autoklavë funksionale, por kishte mangësi në instrumente e materiale dentare.

Sa i përket çështjes së sigurisë, të dy regjimet kishin mangësi kamerash sigurie. Secili prej tyre kishte 3 kamera sigurie, të cilat mund të mbulonin të gjithë perimetrin e regjimit nga tre kënde të ndryshme, por nuk kishte kamera në korridoret e dhomave të veçim/ observimit.

**Në regjimin e femrave**, pavarësisht se të burgosurat, së bashku me stafin përkatës, kishin arritur të krijonin një mjedis të pastër dhe të rregullt si brenda mjediseve të banimit, ashtu edhe në mjedisin jashtë tyre, amortizimi i përgjithshëm, veçanërisht sa i përket lagështirës, vijonte të ishte problematik.

Grupi i monitorimit konstatoi se për të dënuarat femra, nuk kishte mjedis sportiv. Kishte një rrobaqepësi, një parukeri dhe një bibliotekë, ku bëheshin kurse të ndryshme për të burgosurat, pjesa më e madhe e të cilave siguroheshin nga organizata jo-fitimprurëse me të cilat Drejtoria

kishte marrëveshje bashkëpunimi. Mjedisi i rrobaqepësisë përdorej gjithashtu edhe si dhomë shërbesash fetare.

Biblioteka ishte një mjedis i pastër, i rregullt me një numër të konsiderueshëm botimesh, të cilat administroheshin me kujdes nga një e burgosur e punësuar aty. Kishte një regjistër të veçantë për marrjen dhe dhënien e librave. Në këtë mjedis të burgosurat kishin ekspozuar edhe punimet e tyre artizanale, me të cilat kishin marrë pjesë edhe në panairë e ekspozita të ndryshme. Në bibliotekë kishte edhe një televizor, ku, sipas orareve të caktuara, të burgosurat mund të shikonin programet e tyre. I njëjti mjedis përdorej për të zhvilluar edhe kurse të Anglishtes dhe të kujdestarisë.

Në regjimin e femrave tualet vijonin të ishin të instaluar jashtë mjedisit të banimit, ashtu siç ishin edhe dushet. Tualetet ishin të ndara sipas dhomave dhe pavarësisht kushteve të një amortizimi të përgjithshëm ishin të pastra dhe funksionale. Mjedisi i tualeteve kishte edhe një ambient për të larë teshat, si edhe një mjedis me 8 lavamanë, të cilët kishin ujë të rrjedhshëm gjatë gjithë kohës. Grupi i inspektimit u informua se pavarësisht se uji vinte me orar, institucioni kishte siguruar depozita uji për të bërë të mundur furnizimin e regjimit gjatë gjithë kohës me ujë të rrjedhshëm. Regjimi kishte 8 dushe. Në momentin e inspektimit, MKPT konstatoi se njëri prej bojlerëve ishte i prishur dhe sillte rrezikshmëri për përdorim, për të cilin u informua se pritej të vinte një hidraulik për ta rregulluar. Gjithashtu, 2 prej dusheve kishin probleme me kokat. Pajisjet e hotelerisë, të higjienës personale dhe të përbashkët siguroheshin si nga institucioni, ashtu edhe nga organizata të ndryshme jo-fitimprurëse apo nga familjet e të burgosurave.

Kuzhina, primitive por e pastër ishte në sektorin e grave dhe përdorej për të dy regjimet. Në të punonte një kuzhinierë dhe 3 të burgosura të punësuar si ndihmëskuzhinierë. Kampionët e ushqimit mbaheshin sipas standardeve. Gjithashtu, kishte edhe një mensë, ku të burgosurat që dëshironin, përveçse mund të hanin, mund edhe të gatuanin. Mensa, relativisht e pastër, ishte e pajisur me orënditë e nevojshme dhe me dollapë për secilën prej të burgosurave.

Gratë e burgosura ishin të punësuar edhe në serën e institucionit, ku mbillnin perime për përdorim të brendshëm. Ato i pohuan grupit të inspektimit se ishin tepër të kënaqura me këtë punë dhe se një pjesë tjetër e tyre punonin edhe vullnetarisht.

Brenda në regjimin e femrave kishte edhe një seksion të veçantë për të burgosurat me probleme të shëndetit mendor me 2 dhoma, ku, në momentin e inspektimit, akomodoreshin 3 persona. Mjedisi ishte relativisht i pastër, i pajisur me orëndi modeste.

Në po këtë seksion ishin të vendosura edhe 2 dhoma veçimi dhe observimi, mjedis, ky, i ndarë nga pjesa tjetër e seksionit me derë skare hekuri që mbyllej me shul me dry. Të dy dhomat ishin jashtë standardeve, me përmasa 2 x 2.5 m me një krevat dhe dyshek, pa dritare, pa orëndi të nevojshme si tavolinë, karrige etj. Në korridorin me përmasa 6 x 1.5 m ndodhej tualeti i pajisur edhe me dush, që nuk plotësonte kushtet minimale të privatësisë. Këto ambiente përdorreshin dhe nga seksioni i veçantë i grave me probleme të shëndetit mendor dhe si rezultat i mbikëqyrjes intensive për të parandaluar raste të vetëvrasjes prej tyre, privatësia e këtij ambienti ishte plotësisht jashtë standardit për përdorim nga gratë e vendosura në regjimin e veçim/ observimit.

Gjithashtu, në regjimin e femrave kishte një godinë, e cila ishte e pajisur dhe shërbente si çerdhe për fëmijët deri në moshën 3 vjeç, por që, për momentin nuk kishte asnjë të tillë. Çerdhja ishte në vartësi të sektorit të shëndetësisë. Ambientet ishin të mirë organizuara të ndara në katër dhoma për fëmijë: një dhomë për nëna me fëmijë, një dhomë vetëm për fëmijë, një dhomë lodrash dhe një dhomë për edukatore, të pajisura sipas standardeve me orenditë e nevojshme dhe me materiale shëndetësore e informuese për nënat me fëmijë. Çerdhja kishte një personel prej 5 vetash, të ndarë në 2 edukatore, 2 infermiere dhe një kujdestare.

Grupi i inspektimit konstatoi se ekzistonte shërbimi për porosi dhe blerje të artikujve të lejuar në IEVP, por listat e produkteve dhe çmimet përkatëse nuk ishin të afishuara. Menaxhimi i kërkesave të të burgosurave për blerje, bëhej nga njëra prej tyre e punësuar për këtë qëllim, e cila mbante me rregull të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

**Në regjimin e meshkujve** kishte një hapësirë që përdorej për aktivitete sportive dhe disa vegla që improvizonin një palestër të hapur. Kishte një punëtor, e cila në momentin e inspektimit ishte e pa pajisur me vegla pune, me një tavan tejet të amortizuar dhe me probleme të theksuara të instalimeve elektrike. Kishte një ambient të përbashkët, i cili në përdorimin institucional ishte mensë, por duke marrë në konsideratë faktin se të dënuarit hanin nëpër dhomat e tyre, ajo ishte kthyer në një sallë ku mund të luanin pingpong, shah, etj., veçanërisht gjatë ditëve me shi. Salla ishte e varfër në orendi dhe me lagështirë. Në regjim kishte edhe një bibliotekë.

Në hyrje të regjimit të meshkujve, të veçuara nga pjesa tjetër e regjimit, ishin dy dhomat e veçim/ observimit. Në këto dhoma, në momentin e inspektimit, gjendeshin dy persona. Në njërin dhomë i dënuari R. SH., i cili ishte transferuar nga IEVP Fushë-Krujë, mbahej prej katër ditësh në këtë ambient për arsye të një konflikti të hershëm me një të dënuar në këtë IEVP. Për arsye sigurie, drejtuesit e IEVP 325, kishin vendosur mbajtjen e të dënuarit në ambientet e veçimit deri në momentin e transferimit në një burg tjetër. Kërkesa për transferim ishte bërë nga ana e IEVP 325 pranë DPB, por në të tilla raste proceduara zgjat me javë dhe nganjëherë dhe me muaj. I dënuari u ankua lidhur me kushtet materiale të qelisë dhe nivelit të lagështirës e të të ftohtit në këtë ambient.

Dhoma, sipas grupit të inspektimit ishte 2 x 2 m me një krevat marinar me dy nivele, pa asnjë orendi tjetër dhe me një dritare të vogël me hekura, e cila nuk lejonte hyrjen normale në qeli të dritës natyrale. Kishte një prezencë të lartë lagështie dhe shtrojat e pakta të fjetjes nuk ishin në proporcion me temperaturën e ulët në ato ambiente.

Në dhomën tjetër të veçimit ndodhej i dënuari A. Sh. në shlyerje të një mase disiplinore me afat 10 ditor, dhënë nga ana e Komisionit Disiplinor për shkelje të rregullores. I dënuari ishte i vetëdijshëm dhe e pranonte masën, por u ankua lidhur me kushtet e vuajtjes së saj. Edhe kjo dhomë, gjithashtu, ishte identike si e para, dhe nuk ofronte minimumin e respektimit të dinjitetit njerëzor.

Në momentin e inspektimit të dënuarve në këto ambiente, u ishte shërbyer ushqimi i drekës, i cili në mungesë të tavolinës, karriges apo të tavolinës, konsumohej në një mënyrë denigruese. Kushtet materiale dhe mbajtja në kushte izolimi e të dënuarve në këto ambiente (mbi tre ditë) konsiderohet trajtim degradues dhe jo human.

## ***Regjimi dhe aktivitetet***

Si në sektorin e meshkujve, ashtu dhe në atë të femrave, jeta zhvillohej në regjim të hapur. Nga grupi monitorues u vërejt se fryma e bashkëpunimit në grup gjatë aktivitete të përbashkëta dhe gjatë kohës së lirë, ndihmonte në formimin e një klime jo konfliktuale.

Në të dy regjimet, në dyert e dhomave ishte i afishuar orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj.

Në këtë institucion zhvilloheshin kurse formale të formimit profesional të kategorizuara sipas grupmoshave, 18-21 vjeç (4 të dënuar), gra (39 të dënuara), burra (29 të dënuar). Nga intervistat e kryera, grupi i inspektimit u informua se femrave u ofroheshin 2 herë në javë kurse për rrobaqepësi, parukeri, kujdestari dhe anglisht. Këto dy të fundit zhvilloheshin në bibliotekë. Meshkujve u ofroheshin kurse kompjuteri, që zhvilloheshin pranë bibliotekës. Ata ishin të përfshirë në më së shumti në aktivitete sportive si futboll, basketboll, pingpong, etj.

Në regjimin e meshkujve, kishte një dhomë të posaçme shërbesash fetare, ku të dënuarit besimtarë ushtronin ritet e tyre të besimit dhe merrnin pjesë në lutje të udhëhequra nga udhëheqës shpirtërorë të komuniteteve fetare, që vizitonin sipas një plani të caktuar nga institucioni. Këtë funksion, në regjimin e femrave e kryente biblioteka.

Stafi psiko-social, si në regjimin e meshkujve, ashtu edhe në atë të femrave, zhvillonte veprimtaritë e veta kryesisht pranë bibliotekës. Në regjimin e femrave, përveç bibliotekës, kishte edhe një dhomë këshillimi, e përdorur nga stafi psiko-social, e cila përdorej edhe për shërbesa fetare.

Dokumentacioni i stafit psiko-social ishte i mbajtur me rregull, si raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori, dosjet psiko-sociale, ashtu edhe programet individuale të trajtimit për të dënuarat me probleme të shëndetit mendor, për grup moshat 18-21 vjeç dhe/ apo abuzuesit me substanca.

## ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e stafit mjekësor përbëhej nga një mjek, një stomatolog, një farmacist, katër ndihmësmjekë, si dhe çerdhja e institucionit, që përfshinte dy edukatore, dy ndihmësmjeko dhe një kujdestare.

Në inspektimin e regjimit të meshkujve dhe atë të femrave, mendimi për shërbimin shëndetësor në përgjithësi ishte pozitiv, si për mjeken e infermieret ashtu edhe për stomatologun. Të dënuarit ishin të kënaqur me shërbimin mjekësor dhe vlerësonin gatishmërinë e gjithë stafit sa herë që ata kërkonin ndihmë mjekësore.

Megjithatë, grupi i inspektimit konstatoi të dënuar me probleme të shëndetit mendor, si në regjimin e femrave, ashtu edhe në atë të meshkujve. U konstatuan katër femra, të cilat manifestonin çrregullime të ankthit, çrregullime somatoforme dhe çrregullime të personalitetit. Në këto kushte, ato kishin nevojë për një vlerësim më të specializuar dhe trajtim nga psikiatri. Në

regjimin e meshkujve kishte një të dënuar të sapo transferuar në këtë IEVP, që kishte qenë në proces trajtimi me metadon. Për këtë rast, grupi i inspektimit u informua se ishin bërë të gjitha procedurat për transferimin e dokumentacionit të nevojshëm për të siguruar sa më shpejt vijimin e trajtimit.

Farmacia kishte mungesa të theksuara në medikamente, kryesisht në ato të urgjencës. Kishte raste që trajtimin me medikamente të burgosurit e merrnin me kërkesën e familjarëve nga jashtë (familja), pasi ishin të pakënaqur me cilësinë e ilaçeve që rimburoheshin.

Gjatë vizitës në sektorin e veçantë për të sëmurët mendorë, grupi i ekspertëve konstatoi se gjendja e tyre mendore ishte në përgjithësi e stabilizuar. Ato ishin të kënaqura me shërbimin që u ofrohej nga stafi mjekësor.

Nga shqyrtimi i kartelave mjekësore u vu re se mjekimi i disa prej të dënuarave kishte nevojë për rivlerësim: një e sëmurë që shfaqte tazikinezi nga neuroleptiku duhej kaluar në antipsikotik atipik; një tjetër që trajtohej me antidepressiv triciklik kishte nevojë për zëvendësim të mjekimit me antidepressiv të ri (SSRI), pasi pacientja ishte në moshë madhore dhe trajtohej për Hipertension Arterial.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të mjekes, formatet e kontrollit mjekësor, regjistri i vizitave, ai themeltar për kartelat dhe ai i rasteve të evidentimit për dhunë fizike mbaheshin me rregull. Gjithashtu, ishin të plotësuara mirë dhe kartelat. I gjithë dokumentacioni i mjekes mbahej në dollap me çelës. Po ashtu të rregullt ishin edhe regjistrat e stafit të infermierisë.

Të gjithë të dënuarat në regjimin e femrave ishin të pajisura me librezë shëndetësore, ndërkohë që nga regjimi i meshkujve, 31 të dënuar ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Pjesa tjetër e të dënuarve që sapo kishin ardhur në këtë IEVP, prisnin transferimin e dokumentacionit përkatës nga IEVP-të prej nga kishin ardhur. Skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte dhe nuk kishte vonesa në zbatimin e saj.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për trajtimin me prioritet në procedurat e dhënies së lejeve shpërblyese, të nënave të dënuara të cilat kanë fëmijë të moshës 3-5 vjeç, bazuar në domosdoshmërinë dhe interesin e fëmijës për një kontakt më të shpeshtë me nënën.
2. Marrja e masave nga ana e sektorit të sigurisë në institucion lidhur me rregullat dhe udhëzimet e reja të DPB, për të drejtat dhe standardet e kontakteve me botën e jashtme të të dënuarve si në vizitat me familjarët, të afërmit dhe miqtë, ashtu dhe gjatë bisedave telefonike.
3. Marrja e masave nga ana e sektorit të edukimit për zbatimin me rigorozitet të urdhrat të DPB lidhur me procesin e trajtimit të ankesave/ kërkesave.
4. Marrja e masave për afishimin në ambientet e përbashkëta të listës së artikujve dhe çmimeve respektive.
5. Marrja e masave për përmirësimin e kushteve të tualeteve dhe dusheve, veçanërisht të pajisjeve/ instalimeve elektrike në to.

6. Marrja e masave për pajisjen dhe përshtatjen e ambienteve të tualetit dhe dushit në seksionin e veçim/ observimit sipas standardeve lidhur me privatësinë dhe dinjitetin njerëzor, pasqyruar këto në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
7. Marrja e masave për mbulimin me kamera në korridoret pranë dhomave të veçim/ observimit.
8. Marrja në shqyrtim nga ana e ekspertëve të sigurisë dhe edukimit të mundësisë së ndarjes në dhoma banimi, duke mbajtur në konsideratë grupimin e veprave penale dhe masën e dënimit, bazuar kjo edhe në nenin 20 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
9. Marrja e masave urgjente për transferimin e të dënuarit nga qelia e observim/ veçimit në kushte regjimi normale.
10. Marrja e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të observim/ veçimit.
11. Marrja e masave për mundësimin e konsultave psikiatrike periodike për rivlerësim dhe trajtim më të specializuar të të dënuarve që njihen me probleme të shëndetit mendor.
12. Marrja e masave që mjeku të mos jetë pjesë e Komisionit Disiplinor, pasi kjo ndikon në cilësinë e marrëdhënies mjek-pacient. Në mënyrë që mjeku të sigurojë që masa disiplinore nuk cenon shëndetin e pacientit, ai duhet të të ndjekë së paku një herë në ditë gjendjen shëndetësore të të burgosurit me masë disiplinore, dhe në çdo rast kur vlerëson se shëndeti i të burgosurit vihet në rrezik si rrjedhojë e qëndrimit në izolim, të informojë Drejtorin e Institucionit, sikurse parashikohet në Rekomandimin e CPT-së për Shqipërinë në vitin 2010.
13. Marrja e masave për mundësimin e konsultave psikiatrike periodike për vlerësim të të dënuarve që rezultojnë aktualisht të pa diagnostikuar, por që shfaqin problematika të shëndetit mendor.
14. Marrja e masave për sigurimin e një dhome më të përshtatshme për mjeken, farmacistin dhe infermierinë, në mënyrë që të plotësohen kushtet për një shërbim më të mirë shëndetësor.
15. Marrja e masave për kompletimin e dhomës së stomatologes me instrumente dhe materiale dentare.
16. Marrja e masave për furnizimin e menjëhershëm të farmacisë me medikamentet e urgjencës, me medikamentet të domosdoshme për mjekimin e të sëmurëve kronikë, si dhe medikamentet të tjera bazë.

#### **5.6. I EVP Vaqar 327 - Datë 07.05.2014 / Nr. Dok. 201401019**

##### ***Shënime paraprake***

IEVP “Vaqar” është një institucion i sigurisë së zakonshme, i cili nuk ka seksion të veçantë për të miturit, apo për të dënuarit e moshës 18-21 vjeç. Institucioni ka kapacitet maksimal prej 176 personash. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 164 persona të dënuar. Një numër i konsiderueshëm personash të dënuar kishin përfituar nga amnistia e shpallur me Dekret të Presidentit të Republikës Nr. 8523, datë 24.03.2014.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit

të inspektimit. Nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve iu bë me dije se problematika e amortizimit e të gjithë godinës, dhe mungesa e fondeve për këtë drejtim, vijonte të ishte prezent. Grupi i inspektimit u bë me dije se, duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet e mëparshme të institucionit të Avokatit të Popullit, dezinfektimet kryheshin çdo gjashtë muaj dhe dezinfektimi i radhës planifikohej për datën 15 qershor.

Për shkak të problematikës së ujit të rrjedhshëm, si edhe kubaturës së përcaktuar për çdo të dënuar, që sipas drejtuesit të institucionit ishte e pamjaftueshme, ky i fundit informoi se ishte bërë e mundur hapja e një pusi, dhe rrjedhimisht, uji nuk kishte kufizime brenda në regjim.

Në kohën e monitorimit, kishte 5 dhoma observimi/ veçimi brenda në regjim, në të cilin, gjatë momentit të inspektimit kishte 5 persona në dhomat e observimit dhe të veçimit, të cilët ishin vendosur aty jo për shkak të ndonjë mase disiplinore, apo për shkak të sapo-ardhjes në IEVP. Personat e dënuar qëndronin në këto dhoma pasi një pjesë e tyre kishin probleme shëndetësore.

Referuar në informacionin e marrë dhe të konfirmuar me listën zyrtare të të punësuarve, në institucion në kohën e monitorimit figuronin të punësuar 27 të burgosur.

### ***Trajtimi***

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të burgosurve, në identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të burgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Në IEVP “Vaçar”, në momentin e inspektimit, kishte një numër të konsiderueshëm të dënuarish të huaj, të cilët, nga intervistat që grupi i inspektimit kreu me ta, ishin të kënaqur me trajtimin që iu bëhej. Megjithatë, ata kishin shumë ankesa lidhur me trajtimin e çështjeve të tyre penale, kryesisht lidhur me kërkesat për transferim, që ata kishin bërë pranë autoriteteve përkatëse. Kishte edhe nga ata syresh, të cilët, pretendonin se dokumentet e procesit, i kishin vetëm në gjuhën shqipe dhe jo në gjuhën e tyre amtare.

Pati ankesa nga ana e të dënuarave lidhur me çmimet e larta në dyqanin e institucionit, lidhur me mungesën e medikamenteve dhe se lavanderia përdorej në mënyrë preferenciale. Ankesa kishte edhe lidhur me ushqimin, si në drejtim të cilësisë së gatimit, ashtu edhe në drejtim të larmisë së vakteve. Ankesa kishte edhe lidhur me dietat e posaçme që duhet të kishin disa prej të burgosurve të sëmurë, veçanërisht ata me diabet. Kuzhinieri, i bëri me dije grupit të inspektimit se, sipas rregullores, emrat e të burgosurve që kishin nevojë për dietë të posaçme, ishin të afishuara në kuzhinë, por të burgosurit, preferonin të hanin ushqimet nga familja dhe jo ato të gatuar në institucion.

Nga intervistat me të dënuarit, grupit të inspektimit iu shprehën ankesa edhe lidhur me transferimet. Nga ana e tyre pretendohet se ato bëheshin pa kriter dhe në disa raste edhe si masë ndëshkimi. I burgosuri A.B. bëri me dije ekspertët se ai ishte transferuar 3 herë brenda 2 muajve

e gjysmë dhe aktualisht, dokumentacioni i tij nuk kishte ardhur ende në institucion, ndërkohë që, sipas legjislacionit në fuqi, dokumentacioni transferohet bashkë me të dënuarin. Vonesa të tilla në transferimin e dosjeve të të burgosurve të transferuar, ishin prezent gjatë intervistave, që grupi i ekspertëve zhvilloi gjatë inspektimit.

### ***Masat mbrojtëse***

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Mjekja bënte pjesë si në Komisionin e Pritjes, ashtu edhe në Komisionin Disiplinor. Lidhur me këtë të fundit, MKPT, bazuar në Rekomandimin e CPT-së për Shqipërinë, për vitin 2010, vuri në dukje faktin se mjeku nuk duhet të jetë pjesë e Komisionit Disiplinor, por ai duhet të ndjekë minimalisht një herë në ditë gjendjen shëndetësore të të burgosurit me masë disiplinore dhe në çdo rast kur vlerëson se shëndeti i të burgosurit vihet në rrezik si rrjedhojë e qëndrimit në izolim, duhet të informojë Drejtorin e Institucionit.

Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të regjimit, u konstatua se kishte 3 dhoma takimi, të vogla dhe në kushte jo të mira higjienike, njëra prej të cilave përdorej edhe për Komisionin e Pritjes, edhe për Komisionin Disiplinor, përveçse për takime me familjarët dhe fëmijët e mitur. Dhoma tjetër përdorej për takimet me avokatin, por edhe me persona të moshuar. Mjedisi i tretë për takimet ishte ambient jo i pastër, me ndarje skare hekuri, ku në njërin anë qëndronin familjarët e në tjetrën të burgosurit.

Dhomat e veçimit dhe izolimit ishin në regjim, por jashtë godinës së dhomave të banimit, të cilat rezultuan të ishin shumë problematike.

Ekzistonte sistemi i kërkesë/ ankesave. Në hyrje të godinës kishte një kuti, e cila shërbente për kërkesat dhe ankesat e të burgosurve. Kjo kuti hapej nga një personel i sigurisë, i cili bënte më pas edhe shpërndarjen e tyre. Grupi i inspektimit vuri re se një sistem i tillë nuk plotëson kriteret e urdhrit të DPB, ku orientohet qartë se administrimi i kutive duhet të bëhet nga sektori i edukimit.

Të gjithë të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit (në çdo kat kishte 2 telefona, ku linja e ofruar nga e Albtelekom ishte ndërprerë, ndërkohë që ajo e ofruar nga Mobitel është dy herë më e shtrenjtë). Pranë tyre nuk ishte afishuar numri i Avokatit të Popullit.

Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte mangësi kamerash sigurie. Në korridore kishte kamera sigurie, por kishte kënde, të cilat nuk mbuloheshin nga ato. Nuk kishte kamera në korridoret e dhomave të veçim/ observimit.

Në korridoret e dhomave të banimit kishte dritë artificiale, por instalimet elektrike ishin në sipërfaqe.

Gjatë shqyrtimit të masave disiplinore, grupi i inspektimit konstatoi se një pjesë e mirë e tyre, ishin dhënë për shkak se gjatë inspektimeve të personelit të sigurisë, të burgosurve i ishin gjetur sende të ndaluar, të tillë si telefona celularë. Lidhur me këtë, grupi i monitorimit kërkoi



informacion të mëtejshëm nëse ishte hapur ndonjë hetim lidhur me “furnizuesit” e mjetit të ndaluar. Nga ana e drejtuesit të institucionit dhe shefit të sigurisë, grupi i inspektimit u informua se asnjë hetim i kësaj natyre nuk ishte hapur dhe nuk ishte iniciuar, duke e përjashtuar veten e tyre nga hetime të tilla. Grupi i inspektimit vuri në pah faktin se nëse hetime të tilla nuk hapen, kjo gjë mundëson dhe lë vend për ngjarje të tjera të këtij lloji.

Grupi i inspektimit konstatoi gjithashtu, se një person, me masë disiplinore, vijonte të qëndronte në dhomën e veçimit, pavarësisht se kjo masë kishte përfunduar efektet e saj 24 orë më parë. Drejtuesi i institucionit na informoi se personi kishte probleme me disa persona të tjerë në regjim, dhe rrjedhimisht, me kërkesën edhe të dënuarit vijonte të ishte aty.

### ***Kushtet materiale***

Ashtu siç u konfirmua nga Drejtuesi i Institucionit dhe siç është konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, mjedisi në regjim vijonte të ishte tejet i amortizuar dhe me lagështirë. Dhomat e banimit akomodonin nga 4, 6 ose 8 persona, por jo të gjitha dhomat respektonin standardin e hapësirës jetike për person. Megjithatë, në përgjithësi, dhomat kishin dritë natyrale mjaftueshëm, ishin të pajisura me orenditë e nevojshme dhe kishin furnizimi me ujë të ngrohtë të dusheve, që ndodheshin në tualetet brenda dhomave të banimit. Grupi i inspektimit konstatoi se përveçse tualetet brenda dhomave të banimit ishin tejet të amortizuara, me lagështirë të theksuar, dushet ishin gjithashtu problematike, me mungesa kokash të dusheve dhe në një dhomë, automati i bojlerit ishte shqyer dhe telat ishin të ekspozuara duke krijuar kërcënim për jetën e të burgosurve që bënin dush aty. U konstatua, gjithashtu, se në disa prej dhomave kishte prezencë të insekteve.

Në institucion nuk kishte sistem qendror ngrohjeje.

Në këqyrjen e dhomave të mjekut, të stomatologut, të farmacisë dhe të infermierisë u vu re se ato ishin të amortizuara dhe kishin nevojë për lysterje dhe rikonstruksion. Farmacia kishte mangësi të theksuara në ilaçe, si për sëmundjet kronike ashtu dhe për mjekime të urgjencës. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me autoklavë, uniti funksiononte mirë, por kishte mungesa në instrumente e materiale dentare, për rrjedhojë nuk kryheshin ekstraksione e mbushje të dhëmbëve.

Grupi i monitorimit konstatoi se kishte një mjedis sportiv të jashtëm, i cili përdorej edhe për ajrim, dhe disa vegla që improvizonin një palestër të hapur. Mensa dhe klasa, në momentin e inspektimit, ishin në rikonstruksion. Biblioteka ishte një mjedis relativisht i pastër, por numri i titujve ishte i varfër. Një pjesë e mjedisit të bibliotekës përdorej edhe nga një i burgosur për të pikturuar. Në bibliotekë kishte edhe një televizor, ku, të burgosurit mund të shikonin programet e preferuara. I njëjti mjedis përdorej edhe për të zhvilluar takime këshilluese me stafin psiko-social.

Kuzhina, ishte primitive, me kushte të varfra higjieno -sanitare. Në të punonte një kuzhinier dhe 3 të burgosur të punësuar si ndihmëskuzhinierë. Kampionët e ushqimit mbaheshin në një frigorifer të posaçëm të pakyçur, pra, jashtë standardeve. Të gjithë të burgosurit hanin nëpër dhoma, ku nëse dëshironin mund edhe të gatuanin.

Në regjim kishte edhe 5 dhoma veçimi/ observimi, mjedis, ky, jashtë godinës së dhomave të banimit. Të gjitha dhomat ishin jashtë standardeve, me përmasa rreth 2 x 2.5 m me krevat marinar, dy nivele, pa asnjë orendi tjetër dhe me një dritare të vogël me hekura, pjesa më e madhe e të cilave ishin pa xhama dhe nuk lejonte hyrjen normale në qeli të dritës natyrale. Kishte një prezencë të lartë lagështie dhe shtrojat e pakta të fjetjes nuk ishin në proporcion me temperaturën e ulët në ato ambiente. Tualeti e dushi i këtij sektori ishin jashtë standardeve. Sektori i veçim/ observimit nuk ishte i monitoruar nga kamerat. Grupi i inspektimit konstatoi se në momentin e monitorimit, dhomat e observim/ veçimit nuk përdorshin për arsyet ligjore për të cilat ato janë krijuar. Kryesisht, personat, që grupi i ekspertëve gjeti gjatë inspektimit në këto dhoma, e kishin kërkuar vetë qëndrimin aty, për shkak se kishin probleme shëndetësore (me sëmundje kardio-vaskulare dhe pulmonare, etj.).

Grupi i inspektimit konstatoi se ekzistonte shërbimi për porosi dhe blerje të artikujve të lejuar në IEVP, dhe listat e produkteve dhe çmimet përkatëse ishin të afishuara. Menaxhimi i kërkesave të të burgosurve për blerje, bëhej nga një person i punësuar për këtë qëllim, i ndihmuar nga një i burgosur i punësuar aty. Dyqani ishte me larmi produktesh, por të burgosurit shprehën shqetësimin e tyre për çmimet e larta.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Në çdo kat të godinës së dhomave të banimit, ishte i afishuar orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimit e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj. Gjithashtu, ishte afishuar edhe orari suplementar i ajrimit, i cili u jepej personave të sëmurë, që sipas edhe mendimit të mjekes, kishin nevojë suplementare për ajrim. Aktivitetet që zhvilloheshin nga ky sektor ishin kryesisht sportive (futboll dhe basketboll). Mungonin kurset e formimit profesional. Kurset e kompjuterit dhe të anglishtes që ishin zhvilluar më parë, prej dy muajsh nuk organizoheshin, pasi mungoni mësuesit dhe kishte probleme me bazën materiale. Nuk zhvilloheshin as lojërat me dorë, pingpong e shah, pasi mjediset për këto ishin në rikonstrukcion.

Salla e bibliotekës shërbente si kinema, për këshillime dhe për kryerjen e shërbesave fetare. Këto shërbesa kryheshin në ditë të veçanta, përkatësisht, të premtëve kryheshin ato të besimit mysliman, ndërsa të hënave ato të besimit të krishterë. OJF-të që kishin një marrëveshje bashkëpunimi me këtë institucion ishin SH.K.B.SH, Dëshmitarët e Jehovait dhe Kisha Ortodokse Autoqefale, të cilat ofronin kurse edukative biblike, shfaqje filmike me tematikë fetare etj.

Organika e sektorit të kujdesit të shërbimit social përbëhej nga një psikologe dhe katër punonjës socialë (edukatore).

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të stafit psiko-social, si raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori, dosjet psiko-sociale, ashtu edhe programet individuale të trajtimit mbaheshin me rregull dhe të mbyllura me çelës. Programet individuale të trajtimit ishin të ndara sipas grupeve vulnerabël, përkatësisht për të sëmurë mendor, për persona me varësi nga substancat narkotike, për të dënuarit nga 18-21 vjeç, si dhe për të dënuar në prag lirim.

Në momentin e inspektimit 27 të dënuar ishin të punësuar në këtë institucion, me pune të tilla si ngarkim/ shkarkim, magazinier i brendshëm, sanitar, bojaxhi, saldator, ndihmëskuzhinierë, berber, punonjës biblioteke, mirëmbajtës ambientesh sportive, lulishtar, llogaritar etj.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e sektorit shëndetësor përbëhej nga një mjek, një stomatolog, një farmacist e katër ndihmës mjekë.

Gjatë inspektimit të regjimit të brendshëm u mor një informacion i përgjithshëm për shërbimin shëndetësor, për të cilin nga të dënuarit me të cilët grupi i ekspertëve mori kontakt, kishte ankesa sa i përket prezencës së mjekes në regjim. Po ashtu, të dënuarit kishin ankesa lidhur me ofrimin e shërbimit shëndetësor, sa i takon vonesave në kryerjen e vizitave (për konsulta në regjim apo në spitale). Kishte të sëmurë kronik, të cilët megjithëse ishin të diagnostikuar e nën mjekim, kishin nevojë për rivlerësim më të shpeshtë të ecurisë së sëmundjes e për rrjedhojë edhe të mjekimit. Të dënuarit ankoheshin edhe për mbulimin me ilaçe për të sëmurët kronik nga ana e institucionit. Megjithëse të dënuarit ishin të pajisur me libreza shëndetësore dhe skema e rimbursimit të tyre funksiononte, kishte vonesa në zbatimin e saj. Gjithashtu, për të sëmurët me diabet u konstatua se nuk kishte rregull në administrimin e ushqimit me dietë speciale, sipas protokollit të trajtimit të kësaj kategorie sëmundjesh. Grupi inspektues vërejti se të dënuar me varësi nga substancat narkotike, apo të tjerë që vuanin nga çrregullime të ankthit dhe të personaliteti trajtoheshin me benzodiazepina, për një periudhë të gjatë kohore, gjë që rrishte rrezikun për varësi nga këto substanca.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të mjekes, u konstatua se ato mbaheshin me rregull, si formatet e kontrollit mjekësor, regjistri i vizitave, ai themeltar i kartelave, ashtu edhe regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës fizike. Kartelat dhe e gjithë pjesa tjetër e dokumentacionit mbaheshin në një dollap me dry. Po ashtu, të rregullta ishin edhe regjistrat e infermierisë.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me dezinfektimin e mjediseve të dhomave të banimit.
2. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me kushtet higjieno-sanitare të të gjitha mjediseve të regjimit, veçanërisht në lidhje me lagështirën.
3. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me mbajtjen e kampionëve ushqimore sipas standardeve të parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
4. Marrja e masave nga ana e sektorit të edukimit për zbatimin me rigorozitet të urdhrat të DPB lidhur me procesin e trajtimit të ankesave/ kërkesave.
5. Marrja e masave për përmirësimin e kushteve të tualeteve dhe dusheve, veçanërisht të pajisjeve/ instalimeve elektrike në to.
6. Marrja e masave për pajisjen dhe përshtatjen e ambienteve të tualetit dhe dushit në seksionin e veçim/ observimit sipas standardeve lidhur me privatësinë dhe dinjitetin njerëzor, pasqyruar këto në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.
7. Marrja e masave për mbulimin me kamera në korridoret pranë dhomave të veçim/ observimit.

8. Marrja e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të observim/ veçimit.
9. Marrja e masave lidhur me fillimin e hetimeve për “furnizuesin” në rastet e masave disiplinore për gjetje të sendeve të ndaluara.
10. Marrja e masave që mjeku të mos jetë pjesë e Komisionit Disiplinor, pasi kjo ndikon në cilësinë e marrëdhënies mjek-pacient. Në mënyrë që mjeku të sigurojë që masa disiplinore nuk cenon shëndetin e pacientit, ai duhet të të ndjekë së paku një herë në ditë gjendjen shëndetësore të të burgosurit me masë disiplinore, dhe në çdo rast kur vlerëson se shëndeti i të burgosurit vihet në rrezik si rrjedhojë e qëndrimit në izolim, të informojë Drejtorin e Institucionit, sikurse parashikohet në Rekomandimin e CPT-së për Shqipërinë në vitin 2010.
11. Marrja e masave për mundësimin e kryerjes së konsultave të vazhdueshme në regjim nga ana e mjekes për një vlerësim adekuat të ecurisë së sëmundjes, si dhe mbikëqyrje të mjekimit përkatës.
12. Marrja e masave për krijimin e kushteve më të mira në dhomat ku mjeku kryen vizitat.
13. Marrja e masave për vënien në efikasitet të plotë dhe pa vonesa të skemës së rimbursimit të ilaçeve.
14. Marrja e masave për kompletimin e dhomës së stomatologut me materiale e instrumente dentare.
15. Marrja e masave për mundësimin e furnizimit të menjëhershëm të farmacisë me medikamentet e urgjencës, me ilaçe të domosdoshme për të sëmurët kronik, si dhe mjekime të tjera bazë.

### **5.7. IEVP Kosovë, Lushnjë - Datë 14.05.2014 / Nr. Dok. 201401020**

#### ***Shënime paraprake***

IEVP Kosovë, Lushnjë është një institucion i sigurisë së zakonshme, i cili nuk ka seksion të veçantë për të miturit, apo për të dënuarit e moshës 18-21 vjeç. Institucioni ka kapacitet maksimal prej 176 personash. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 221 persona të dënuar. Pavarësisht se persona që vuanin dënimin në këtë institucion kishin përfituar nga amnistia e shpallur me Dekret të Presidentit të Republikës Nr. 8523, datë 24.03.2014, mbipopullimi ishte problematikë e pranishme me 45 të dënuar mbi kapacitetin zyrtar.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni.

Nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve iu bë me dije se në momentin e inspektimit kishte 16 të dënuar të moshës 18-21 vjeç. Ai, gjithashtu, informoi se problematika e amortizimit e të gjithë godinës, e ujit të rrjedhshëm që vijonte të ishte me orar, si dhe mungesa e fondeve për këtë drejtim, vijonte të ishte prezent.

Në kohën e monitorimit, dhomat e observimi/ veçimit gjendeshin në Godinën nr. 2 të banimit, kati i parë, të cilat për shkak të mbipopullimit ishin kthyer në mjedise banimi. Rrjedhimisht, këto dhoma kishin humbur qëllimin e tyre ligjor dhe ishin në shkelje të standardit për sipërfaqen dhe kubaturën e banimit për person.

Referuar në informacionin e marrë dhe të konfirmuar me listën zyrtare të të punësuarve, në institucion në kohën e monitorimit figuronin të punësuar 36 të burgosur.

### ***Trajtimi***

Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të burgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Në IEVP Kosovë, Lushnjë, në momentin e inspektimit, pati ankesa nga ana e të dënuarave lidhur me çmimet e larta në dyqanin e institucionit dhe lidhur me mungesën e medikamenteve. Ankesa kishte edhe lidhur me ushqimin, si në drejtim të cilësisë së gatimit, ashtu edhe në drejtim të larmishmërisë së vakteve. Ankesa kishte edhe lidhur me shpërblimin për punën e kryer nga ana e të dënuarve të punësuar, të cilët, sipas legjislacionit në fuqi, për punën e bërë, shpërbleheshin 3.9 ditë/ muaj ulje dënimi. I dënuari P.M. ankohej lidhur me çështjen e lejes shpërblyese, të cilën, sipas tij kishte rreth një vit pa e marrë. Grupi i inspektimit, verifikoi rastin në fjalë dhe rezultoi se i dënuari kishte marrë masë disiplinore më datë 29.04.2014, rrjedhimisht, sipas legjislacionit në fuqi, për vitin në vijim, atij nuk i takonte të përfitonte leje shpërblyese.

### ***Masat mbrojtëse***

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Mjekja bënte pjesë si në Komisionin e Pritjes, ashtu edhe në Komisionin Disiplinor. Lidhur me këtë të fundit, MKPT, bazuar në Rekomandimin e CPT-së për Shqipërinë, për vitin 2010, vuri në dukje faktin se mjeku nuk duhet të jetë pjesë e Komisionit Disiplinor, por ai duhet të ndjekë minimalisht një herë në ditë gjendjen shëndetësore të të burgosurit me masë disiplinore dhe në çdo rast kur vlerëson se shëndeti i të burgosurit vihet në rrezik si rrjedhojë e qëndrimit në izolim, duhet të informojë Drejtorin e Institucionit.

Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të regjimit, u konstatua se kishte një mjedis të veçantë për takimet e të dënuarve me familjarët, i cili kishte 5 ndarje, të vogla, në kushte jo të mira higjienike, pa stola/ karrige për ta akomoduar palët në takim, me kamera vëzhgimi në secilin prej ndarjeve nga ana e familjarëve. Mjedisi i qëndrimit kishte ndarje skare hekuri, ku në njërin anë qëndronin familjarët e në tjetrën të burgosurit.

Dhomat e veçimit dhe izolimit ishin në regjim, por rezultuan të ishin shumë problematike dhe të pamonitoruara nga kamerat e vëzhgimit.

Ekzistonte sistemi i kërkesë/ ankesave. Në hyrje të të dy godinave kishte një kuti, e cila shërbente për kërkesat dhe ankesat e të burgosurve. Kjo kuti hapej nga një personel i sigurisë, i cili i dërgonte tek sekretaria e Drejtorit të Institucionit. Ankesat dhe kërkesat protokolloheshin dhe i kalonin Drejtorit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të dënuarit, sipas

legjislacionit në fuqi. Grupi i inspektimit vuri re se një sistem i tillë nuk plotëson kriteret e urdhrin të DPB, ku orientohet qartë se administrimi i kutive duhet të bëhet nga sektori i edukimit.

Të gjithë të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit.

Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte mangësi kamerash sigurie. Nuk kishte kamera në korridoret e dhomave të veçim/ observimit.

### ***Kushtet materiale***

Ashtu siç u konfirmua nga Drejtuesi i Institucionit dhe siç është konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, mjedisi në regjim, në të dy godinat, vijonte të ishte tejet i amortizuar, me lagështirë dhe me probleme të theksuara të kanalizimeve të ujërave të zeza, gjë që reflektohej në erën e rëndë që e karakterizonte si mjedisin brenda, ashtu edhe jashtë godinës së banimit.

Dhomat e banimit akomodojnë nga 4, 6 ose 8 persona, por jo të gjitha dhomat respektonin standardin e hapësirës jetike për person, duke marrë në konsideratë edhe faktin e mbipopullim në të dy godinat brenda në regjim. Në godinën nr. 1, ku qëndronin 92 të dënuar, vetëm 2 dhoma kishin tualete brenda dhomës së banimit. Pjesa tjetër, kryenin nevojat personale në tualetet e përbashkëta – 2 për çdo kat, ku në çdo kat kishte 8 dhoma banimi. Tualetet e përbashkëta ishin në kushte shumë të këqija higjieno-sanitare. Kishin një paradhomë, e cila mund të përdorej edhe për t'u larë, pavarësisht se nuk plotësonte as kushtet minimale të funksionimit. U konstatua, gjithashtu, se në disa prej dhomave kishte prezencë të insekteve.

Në përgjithësi, dhomat kishin dritë natyrale mjaftueshëm dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte me kufizime oraresh dhe dushet nuk ekzistonin në regjim të godinës 1. Për të luajtur rolin e dusheve ishin improvizuar 2 mjedise të vogla jashtë godinës së banimit, të cilat nuk kishin dritare, as pajisje për t'u larë dhe në gjendje tepër të rënduar higjieno-sanitare e me lagështirë të theksuar. Të dënuarit merrnin ujin e ngrohtë nga bojlerët e instaluar në njërin prej mjediseve të mësipërme, dhe laheshin në mënyrë primitive në mjedisin tjetër. Gjithsej ishin 2 bojlerë, njëri prej të cilëve përbënte rrezik për jetën e të dënuarve, pasi instalimet elektrike të automatit të tij ishin krejtësisht të ekspozuara.

Në institucion nuk kishte sistem qendror ngrohjeje.

Grupi i inspektimit këqyri dhomën e mjekut, të farmacisë dhe të infermierisë dhe konkludoi se ato ishin të amortizuara dhe kishin nevojë për lysterje dhe rikonstruksion. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt dhe në përputhje me standardet. Farmacia kishte mangësi të theksuara në ilaçe, si për sëmundjet kronike, ashtu edhe për mjekime të urgjencës. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me autoklavë, uniti ishte i ri dhe funksiononte mirë, por kishte mangësi për sa i përket materialeve dentare. Për rrjedhojë, nuk kryheshin ekstraksione e mbushje të dhëmbëve. Vetëm në raste urgjente stomatologu punonte me medikamente e materiale dentare, të cilat i siguronte privatisht.

Grupi i monitorimit konstatoi se kishte një mjedis të jashtëm, i cili përdorej për ajrim. Pranë godinës së parë kishte edhe një palestër me një tavolinë pingpongu dhe disa vegla modeste, menjëherë pas së cilës vinte klasa, e cila përdorej për kurse profesionale. Këto të fundit, në momentin e inspektimit nuk zhvilloheshin. Në klasë kishte disa tavolina dhe 4 ekrane kompjuteri pa njësitë përkatëse, për të cilat, stafi i institucionit nuk kishte dijeni. Si palestra, ashtu edhe klasa ishin në gjendje shumë të keqe higjieno-sanitare, me shumë lagështirë dhe dritaret ishin pa xhama.

Biblioteka ishte një mjedis relativisht i pastër, shumë i vogël, me një numri të varfër titujsh, ku ishte i punësuar një i dënuar. Në këtë mjedis bëheshin edhe këshillime me stafin psiko-social.

Në regjim, jashtë godinës së banimit nr. 1 ishte dhe një dhomë e vogël dhe me kushte jo të mira higjieno-sanitare e cila përdorej nga një i dënuari i punësuar si berber.

Kuzhina, ishte e amortizuar, me kushte të varfra higjieno-sanitare. Në të punonte një kuzhinier dhe 4 të burgosur të punësuar si ndihmëskuzhinierë. Të gjithë të burgosurit e konsumonin ushqimin nëpër dhoma dhe shpërndarja e ushqimit bëhej nga të dënuar të punësuar për këtë qëllim.

Grupi i inspektimit konstatoi se ekzistonte shërbimi për porosi dhe blerje të artikujve të lejuar në IEVP, dhe listat e produkteve dhe çmimet përkatëse ishin të afishuara. Menaxhimi i kërkesave të të burgosurve për blerje, bëhej nga një i burgosur i punësuar për këtë qëllim. Dyqani ishte me larmi produktesh, pavarësisht se të burgosurit shprehën shqetësimin e tyre për çmimet e larta.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj., nuk ishte i afishuar. Nga bisedat me të dënuarit, grupi i inspektimit mori informacionin se ajrimi ishte një aktivitet i kryer sipas standardeve. Sipas grafikut, orari i ajrimit ishte 08-13:00 dhe 15-18:00. Aktivitetet që zhvilloheshin nga të dënuarit kryesisht ishin sportive, në palestër, sipas një grafiku, dhe lojëra tavoline që kryesisht bëheshin në bibliotekë, e cila ishte e pajisur me një numër të varfër tituj librash. Mungonin kurset e formimit profesional, të cilat më parë kishin një program të zgjeruar të tillë si për mekanik, xhenerik, kurse kompjuteri, gjuhëve të huaja, etj.

Nga shefi i stafit psiko-social, grupi i inspektimit u informua se klasa do të vihej së shpejti në përdorim, pasi njëra prej organizatave jo-fitimprurëse, që mbështeste institucionin, do ta rindëronte atë në kuadër të një projekti për këtë qëllim. Megjithatë, sektori psiko-social organizonte edhe aktivitete me tematika të veçanta, ku përfshihej një pjesë e konsiderueshme e të dënuarve në të dy godinat e banimit. Këshillimet nga ana e stafit bëheshin në dhomat e të dënuarve brenda në regjim.

Nga stafi psiko-social grupi i inspektimit u informua se në godinën nr. 1 më parë kishte pasur një mjedis të veçantë për kryerjen e shërbesave fetare, por për shkak edhe të mbipopullimit, ky mjedis ishte kthyer në dhomë banimi për të dënuarit. Aktualisht shërbesat fetare zhvilloheshin vetëm në raste festash, tek biblioteka.

Sipas organikës së miratuar të sektorit të kujdesit psiko-social, ky shërbim përbëhej nga një përgjegjës sektori dhe 5 specialistë, 2 prej të cilëve kishin arsimim “punë sociale” dhe “psikologji”.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të stafit psiko-social, si raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori, dosjet psiko-sociale, ashtu edhe programet individuale të trajtimit mbaheshin me rregull dhe të mbyllura me çelës. Programet individuale të trajtimit ishin të ndara sipas grupeve vulnerabel, përkatësisht për të sëmurë mendor, për persona me varësi nga substancat narkotike, si dhe për të dënuarit nga 18-21 vjeç.

Në momentin e inspektimit ishin 36 të dënuar, të punësuar në këtë institucion, me pune të tilla si ngarkim/ shkarkim, magazinier i brendshëm, sanitar, bojaxhi, saldator, ndihmëskuzhinierë, berber, punonjës biblioteke, mirëmbajtës territori etj.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga një mjek me kohë të pjesshme, një farmacist, një stomatolog, dhe katër ndihmës mjekë me kohë të plotë.

Në momentin e inspektimit në këtë institucion, grupi i ekspertëve vërejti se kishte një vlerësim të mirë të shërbimit shëndetësor në përgjithësi nga të gjithë të dënuarit. Ata ishin të kënaqur me shërbimin shëndetësor që i ofrohej. Në të dy sektorët, të dënuarit shpreheshin se kishte gatishmëri nga ana e stafit shëndetësor ndaj kërkesave dhe ankesave të tyre në lidhje me shëndetin. Ata të cilët vuanin nga sëmundje akute apo/ dhe kronike shpreheshin se nuk kishte vonesa as në kryerjen e konsultave jashtë institucionit.

E vetmja problematikë që u vu re në të dy sektorët ishte mungesa në ilaçe. Gjithsesi në momentin e vizitës doli në pah nevoja për një ndarje më adekuate të të dënuarve sipas sëmundjeve nga të cilat vuanin. U konstatua një i sëmurë mendor, i cili qëndronte në korridor, në kushte aspak të përshtatshme, gjë që ndikonte në rëndimin e gjendjes së tij psiko-emocionale. Po ashtu, edhe një i dënuar, i cili vuante nga një sëmundje dermatologjike kronike (Psoriasis), qëndronte në kushte absolutisht të papërshtatshme, gjë që nuk ndihmonte aspak në lehtësimin e gjendjes së tij shëndetësore, përkundrazi, në rëndimin e saj. Në total ishin 25 të dënuar me sëmundje kronike, kardio-vaskulare, pulmonare, endokrine, gastro-hepatike, hematologjike, si dhe sëmundje neuro-psikiatrike.

Institucioni kishte një ambulancë, e cila funksiononte mirë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, në veçanti të mjekut, u konstatua ekzistenca e një regjistri themeltar vizitash i të sëmurëve kronikë. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura në rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve ishin të rregullta. Kartelat mjekësore ishin të plotësuar në mënyrë korrekte dhe mbaheshin të mbyllura me çelës. Me librezë shëndetësore ishin të pajisur 125 të dënuar. Pjesa tjetër që ishin transferuar nga I EVP-të e tjera prisnin plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me librezë shëndetësore.



Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në regjim dhe respektimin e hapësirës personale.
2. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me kushtet higjieno-sanitare të të gjitha mjediseve të regjimit, veçanërisht në lidhje me lagështirën dhe me kanalizimet e ujërave të zeza.
3. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e godinave me mjedise të përshtatshme dushesh.
4. Marrja e masave për përmirësimin e kushteve të tualeteve.
5. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me dezinfektimin e mjediseve të dhomave të banimit.
6. Marrja e masave nga ana e sektorit të edukimit për zbatimin me rigorozitet të urdhrimit të DPB lidhur me procesin e trajtimit të ankesave/ kërkesave.
7. Marrja e masave për hapjen e një zyre për këshillim psiko-social brenda regjimit.
8. Marrja e masave për mbulimin me kamera në korridoret pranë dhomave të veçim/observimit.
9. Marrja e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të observim/veçimit.
10. Marrja e masave që mjeku të mos jetë pjesë e Komisionit Disiplinor, pasi kjo ndikon në cilësinë e marrëdhënies mjek-pacient. Në mënyrë që mjeku të sigurojë që masa disiplinore nuk cenon shëndetin e pacientit, ai duhet të të ndjekë së paku një herë në ditë gjendjen shëndetësore të të burgosurit me masë disiplinore, dhe në çdo rast kur vlerëson se shëndeti i të burgosurit vihet në rrezik si rrjedhojë e qëndrimit në izolim, të informojë Drejtorin e Institucionit, sikurse parashikohet në Rekomandimin e CPT-së për Shqipërinë në vitin 2010.
11. Marrja e masave për ndarjen e të dënuarve të grup moshës 18-21 vjeç, në sektor të veçantë.
12. Marrja e masave për vendosjen në dhoma të veçanta dhe më të përshtatshme të të sëmurëve kronik.
13. Marrja e masave urgjente për pajisjen e farmacisë me ilaçe si dhe orenditë e përshtatshme për mbajtjen e tyre.
14. Marrja e masave për furnizimin e dhomës së stomatologut me materiale dentare.

#### **5.8. IEVP Peqin - Datë 13.06.2014 / Nr. Dok. 201401474**

##### ***Shënime paraprake***

IEVP Peqin është kategorizuar burg i sigurisë së lartë, i përbërë nga 4 seksione: seksioni i sigurisë së lartë, seksioni i sigurisë së zakonshme, seksioni i të paraburgosurve dhe seksioni i vëzhgimit. Institucioni ka kapacitet maksimal prej 600 personash. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 750 të dënuar. Institucioni nuk strehonte të dënuar/ paraburgosur të grup moshës së mitur.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues zhvilloi fillimisht takimin me drejtorin e institucionit dhe i komunikoi atij qëllimin e vizitës. Nga ana e funksionarit në fjalë u shpreh gatishmëria e tij personale, si dhe e stafit në drejtimin e tij për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit monitorues. Në takimin me drejtorin e I EVP Peqin, i emëruar prej dy ditësh në kohën e vizitës, grupi monitorues u informua për situatën e përgjithshme në institucion. Të dënuarit e moshës 18-21 vjeçare mbaheshin në një seksion të veçantë. Të dënuar që ishin të veçuar me masën disiplinore ishin 4 prej të cilëve 2 të dënuar dhe 2 të paraburgosur. Kishte 33 të dënuar me probleme të shëndetit mendor, por nuk ekzistonte një seksion i veçantë për ta. Organika ishte e plotësuar, por kishte mungesa në sektorin e shëndetësisë për arsye të paaftësisë së përkohshme në punë (me raport të zgjatur mjekësor 2 mjekë).

Institucioni kishte 6 dhoma observimi, të cilat për shkak të mbipopullimit në sektorët e kryerjes së dënimit, kishin humbur funksionin e tyre dhe përdorshin si dhoma banimi, për të dënuar me konflikte në regjim të cilët nuk kishin gjetur ende përshtatshmëri. Gjithashtu, në institucion kishte edhe 6 dhoma të veçimit nga aktivitete e përbashkëta.

### ***Trajtimi***

Nga bisedat në grup dhe në privatësi me vetë të dënuarit/ paraburgosurit, gjendja e përgjithshme në drejtim të rasteve të torturës, trajtimit degradues e diskriminues, përdorimit të tepruar të forcës apo dhunës psikologjike nga ana e punonjësve të kësaj I EVP-je, paraqitej jo problematike.

Grupi monitorues konstatoi se në ambientet e këtij institucioni mungonin posterat me të drejtat e të dënuarve/ paraburgosurve.

Një problematikë tjetër e pa zgjidhur, kishte të bënte me mos furnizimin në sasi të mjaftueshme të të dënuarve/ paraburgosurve me produkte të higjienës së përbashkët dhe personale si detergjente, qese plehrash, shampo, etj.

### ***Masat mbrojtëse***

Lidhur me pritjen e të dënuarve/ paraburgosurve në institucion dhe funksionimin e komisionit të pritjes si dhe në plotësimin e regjistrave e dosjeve personale të të dënuarve, rezultoi se pranimi i të dënuarve në institucion bëhej në respekt të standardeve ligjore.

Nëpërmjet verifikimit fizik të librit përkatës, u konstatua se respektohej e drejta e të dënuarve për të bërë ankesa, si drejtuar institucionit ashtu edhe jashtë tij, por ata shpesh nuk merrnin përgjigje për ankesat e tyre. Në të gjitha seksionet mungonin kutitë e ankesave/ kërkesave dhe të dënuarit ua dorëzonin ankesat/ kërkesat edukatorëve, të cilët i përcillnin në sekretarinë e institucionit.

Në institucion kishte pasur një ngjarje të rëndë në datën 9 qershor 2014, ku në mjediset e ajrimit i dënuari M.B., ishte goditur nga 4 të dënuar të tjerë. I dënuari ishte plagosur dhe kishte një të çarë në kokë, që ishte qepur nën mbikëqyrjen e mjekut të institucionit nga një ndihmësmjek në kushtet e infermierisë së institucionit. Pasi u pa anamneza e të dënuarit, si dhe u morën informacione dhe sqarime nga stafi për ngjarjen, grupi inspektues vlerësoi se i dënuari duhej të ishte dërguar në Spitalin e Peqinit për një asistencë të specializuar kirurgjike, por nuk ishte

dërguar për mungesë të autoambulancës së institucionit. Ekspertët e MKPT-së lidhur me këtë ngjarje zhvilluan një hetim të plotë duke ekzaminuar pamjet filmike të ngjarjes dhe duke administruar dokumentet në të cilët pasqyroheshin rrethanat e ngjarjes dhe veprimet apo mosveprimet e sektorëve përgjegjës për menaxhimin e kësaj ngjarje. Ngjarja rezultonte e rëndë dhe serioze, si për sa i përket sigurisë së jetës të të lënduarit, ashtu edhe për cenimin e sigurisë së institucionit. Sipas pamjeve filmike rezultoi se grupi i gatshëm kishte ndërhyrë vetëm pasi katër të burgosur kishin goditur dhunshëm për disa minuta rresht duke e lënë të dëmtuar shtetasin M.B. Kjo vonesë në ndërhyrje kërkon një analizë të thellë në hartimin dhe zbatimin e skemës së sigurisë dhe veprimeve në institucion pasi ruajtja e jetës dhe sigurisë në IEVP duhet të jenë parësore. Nga hetimi rezultoi gjithashtu se Drejtoria e Institucionit dhe Zyra Juridike nuk ishin njoftuar sipas procedurave nga sektori i sigurisë për delegimin për kompetencë Sektorit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë e Rrethit Elbasan dhe se ishin bërë tentativa që kjo vendimmarrje t'i jepej si zgjedhje personale personit të dëmtuar.

Në drejtim të sistemit të monitorimit të ambienteve më kamera, IEVP Peqin për shkak të strukturës bashkëkohore të saj nuk paraqitej problematike. Gjithsesi nga monitorimi u konstatua se hapësira e shkallëve zbritëse të katit të dytë të sektorëve të Sigurisë së Lartë për në ambientet e ajrimit, nuk ishte e monitoruar me kamera.

### ***Kushtet materiale***

Mbipopullimi ndër të tjera kishte shkaktuar mosfunksionimin e dhomave të observimit si të tilla, pasi në I.E.V.P Peqin marrja e masave të sigurisë për shmangien e incidenteve në sektorët e kryerjes së dënimit, i kishte detyruar drejtuesit e këtij institucioni të përdorin të gjithë hapësirat për strehimin e banorëve.

Në seksionin e sigurisë së zakonshme kishte dhoma për aktivitete të përbashkëta të pajisura varfër, por që gjithsesi të dënuarit kërkonin që të përdorej për një kohë më të gjatë.

Në ambiente e kryerjes së dënimit pajisja me mjete akomoduese të tilla si tavolinë dhe karrige, ishte e përshtatshme. E njëjta gjendje paraqitej dhe në drejtim të cilësisë së batanijeve dhe çarçafëve. Gjithsesi, problematike në ambientet e paraburgimit ishte mos pajisja e dhomave të banimit mjaftueshëm me dollapë për rroba, gjë që i detyronte të paraburgosurit/ dënuarit t'i mbanin rrobat në qese plastike ose në thes, kryesisht poshtë shtretërve.

Uji i rrjedhshëm vijonte të ishte me orar të reduktuar. Gjithsesi, nga drejtoria ishin marrë masa që dushi të realizohej sipas një grafiku një herë në shtatë ditë. Dushet në seksionin e sigurisë së zakonshme nuk funksiononin për shkak të mirëmbajtjes së keqe dhe vështirësive të buxhetit të institucionit. Në paraburgim dushet ishin të përbashkëta. Ambienti në fjalë përbëhej nga 10 poste dushi, ndërkohë që vetëm gjysma ishin funksionale, megjithëse edhe këta pa dorezë dhe kokë dushi.

Problematike paraqitej gjendja në katër sektorë të Sigurisë së Lartë, ku në dhomat respektive nuk kishte banja. Lidhur me këtë fakt, fillimisht duhet theksuar se mungesa në fjalë kishte ardhur si rrjedhojë e mosparashikimit në projektin e fundit restaurues të kryer në këtë IEVP. Gjendja në këtë aspekt paraqitej mjaft problematike, pasi 60 të dënuar të dy sektorëve të sigurisë së lartë në

katin e parë të seksionit të sigurisë së lartë, dhe po aq në katin e dytë të këtij seksioni, ishin të detyruar të frekuentonin banja të përbashkëta. Ambienti i banjave në fjalë përdorej dhe për shërbime të tjera, si p.sh. për të mbushur ujë, për të larë rrobat vetjake etj., gjë që për rrjedhojë kishte sjellë probleme të higjienës dhe dëmtime të pajisjeve hidro-sanitare.

Në IEVP Peqin, lavanderia ishte funksionale dhe përdorej për të plotësuar nevojat e institucionit për larjen e rrobave të fjetjes të dënuarve/ paraburgosurve, por jo të rrobave të tyre personale. Të dënuarit/ paraburgosurit nuk mund të lanin veshjet e tyre në institucion, por duhej t'i lanin me dorë në dhomat e tyre.

Ushqimi në institucion shërbehej në tre vakte gjatë ditës. Përgjithësisht të dënuarit u ankuan për cilësinë e ushqimit dhe mungesës së larmisë e tij. Nga vizita në kuzhinën e institucionit, rezultoi se ushqimi i përgatitur për vaktin e drekës ishte i cilësisë së kënaqshme, por kuzhina dhe magazina e ushqimeve kishin nevojë për higjienizim dhe dezinfektim sepse kishte insekte të kuzhinës (furrtare). Punonjësit në kuzhinë ishin të pajisur me doreza. Kampionët e menysë ditore ruheshin në kushte frigoriferike. Punonjësit e kuzhinës u shprehën se aty gatuhej në mënyrë të diferencuar për banorët me regjim ushqimor të kushtëzuar për shkak të sëmundjeve (p.sh., personat me diabet). Megjithatë, grupi monitorues nuk konstatoi ruajtjen e kampioneve të ushqimit për këtë kategori banorësh.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Grupi i monitorimit u informua lidhur me respektimin e së drejtës së të dënuarve për të pasur kontakte me familjarët dhe vëzhgoi në vend dhomat e takimit.. Si dhe në IEVP të tjera, u vu re mungesa e një ambienti takimi të përshtatshëm për fëmijë. Dhoma e takimeve speciale ishte e papastër dhe e pajisur shumë varfër.

Të gjithë të dënuarit / paraburgosurit dilnin për ajrim dy herë në ditë. Ambientet e ajrosjes ishin të mjaftueshme, ndërkohë që nevojitej detyrimisht mbulimi me strehë i një pjese të tyre, pasi në rastet kur moti ishte me reshje apo në temperatura të larta, përdorimi i ambienteve në fjalë bëhej gati i pamundur.

### ***Shërbimi mjekësor***

Organika e sektorit të shëndetësor përbehej nga tre mjekë, por vetëm një mjek punonte në këtë institucion. Kishte një stomatolog, një ndihmës mjek/ farmacist, një laborant dhe 7 ndihmësmjekë.

Gjatë inspektimit në këtë institucion si dhe në bazë të intervistave me të dënuarit, u konstatua se shërbimi shëndetësor në këtë institucion ishte jo i mirë e me problematika, si për sa i përket përgjigjes në kohë të kërkesave për vizita, ashtu edhe për konsultat jashtë institucionit me mjekë specialiste në spitalin e rrethit. Kjo për shkak edhe të mungesës së mjekëve, pasi me kapacitetin e institucionit duheshin së paku tre mjekë, të punësuar në këtë sektor.

Shërbimi shëndetësor në këtë institucion ofrohej në një ambient të veçantë, i cili shërbente si spital. Aty kishte 4 dhoma të cilat akomodonin 5 të dënuar, të shtruar për probleme të shëndetit

fizik, me patologji kardiake, nefrologjike, neurologjike etj. Edhe këta të dënuar kishin ankesa për sa i përket mungesës së ilaçeve e shërbimit të konsultave jashtë institucionit. Kishte të sëmurë kronikë, të cilët megjithëse ishin të diagnostikuar e nën mjekim, kishin nevojë për rivlerësim më të shpeshtë të ecurisë së sëmundjes e për rrjedhojë edhe të mjekimit. Të dënuarit ankoheshin edhe për mbulimin me ilaçe për të sëmurët kronik nga ana e institucionit. Kishte vonesa në vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve sidomos për rastet me sëmundje akute. Shumica e të dënuarve i siguronin medikamentet privatisht nga familja.

Në këtë institucion, trajtoheshin nga ana e sektorit shëndetësor, 34 të dënuar me probleme të shëndetit mendor dhe 32 të dënuar abuzues me substancat narkotike.

Kushte e përgjithshme në këtë ambient ishin të mira. Dhomat e pacientëve mbaheshin të pastra e me rregull nga personeli sanitar i stafit shëndetësor.

Ambulanca mungonte prej kohësh në këtë institucion.

Dhoma e mjekut, e stomatologut si dhe farmacia ishin të rregullta dhe të mirëmbajtura. Ato ishin në kushte fizike dhe materiale të mira dhe të rregullta. Dhoma e stomatologut ishte e pajisur me unit, autoklavë, të cilat funksiononin mirë, por mungonin materialet dhe instrumentet dentare.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash, themeltar i të sëmurëve kronike, regjistri për konsultat jashtë institucionit. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermiereve, gjithashtu. Kartelat mjekësore kishin mangësi, nuk ishin të plotësuara në mënyrë korrekte dhe nuk mbaheshin të mbyllura me çelës. Me libreza shëndetësore ishin të pajisur vetëm 120 të dënuar. Pjesa tjetër që ishin transferuar nga IEVP-të e tjera prisnin plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me libreza shëndetësore .

Sektorin e kujdesit social kishte hartuar programe individuale të trajtimit për të paraburgosurit/dënuarit dhe organizonte aktivitete të përbashkëta, kryesisht diskutime në grup për tema sociale. Dosjet psiko-sociale të të dënuarve të moshës 18-21 vjeç ishin të gjitha të plotësuara dhe të përditësuara me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit. Një problem që ishte evident për sektorin e kujdesit social ishte mungesa e mjediseve të veçanta brenda në seksione për punën me të dënuarit, mungesë që ndikonte drejtpërdrejtë në cilësinë e punës së stafit me të dënuarit.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në IEVP Peqin.
2. Marrja në analizë e ngjarjes së datës 09.05.2014 me pasoja rrezikimin e jetës të të paraburgosurit M.B., shqyrtimi i arsyeve se pse kjo ngjarje nuk i ishte dërguar për kompetencë Sektorit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë e Rrethit Elbasan, si dhe vlerësimi i ligjshmërisë së tentativave që vendimmarrja t'i jepej si zgjedhje personale personit të dëmtuar.
3. Marrja e masave të menjëhershme për rregullimin e menjëhershëm të duzëve në sektorin e sigurisë së zakonshme.

4. Marrja e masave të menjëhershme për pastrimin e mjediseve të takimeve me familjarët dhe pajisjen e tyre me sendet e domosdoshme për të mundësuar krijimin e një klime në respekt të dinjitetit të të dënuarve dhe familjarëve vizitorë në institucion.
5. Rishikimi i mundësisë që të dënuarit të shfrytëzojnë mjediset e përbashkëta dhe në orarin e pasdites, veçanërisht për të dënuarit në seksionin e sigurisë së zakonshme.
6. Krijimi i mundësisë për mjedise të punës me të dënuarit për punonjësit e sektorit të kujdesit social brenda në seksionet e institucionit.
7. Marrja e masave për vendosjen e kutive të kërkesë/ ankesave në seksione, mundësisht afër telefonave, që të dënuarit ta ushtrojnë të drejtën e ankimit.
8. Marrja e masave për përcaktimin e një procedure për nxjerrjen e kërkesë/ ankesave nga seksionet, regjistrimin e tyre në regjistrë dhe menaxhimin e kthimit të përgjigjeve apo zgjidhjes së tyre brenda afateve të përcaktuara në ligj.
9. Marrja e masave për afishimin e menysë së miratuar javore në kuzhinën e institucionit.
10. Marrja e masave për higjienizimin dhe dezinfektimin e kuzhinës dhe magazinës së ushqimeve në mënyrë periodike.
11. Gjetjen e një zgjidhjeje për të ofruar shërbimin e lavanderisë për të dënuarit (veshjet e tyre) nga institucioni.
12. Mbajtja e kontakteve të rregullta midis IEVP Peqin dhe sektorit të ekzekutimit të vendimeve penale në Prokuroritë e Rrethit Elbasan si një detyrim ligjor dhe njoftimi i tyre për ngjarje të rënda si: plagosje të të dënuarve (rasti i M.B. në IEVP Peqin) duhet të jetë i detyrueshëm. Staf i menaxhues i IEVP-së dhe sektori juridik duhet të njihet me këtë detyrim nëpërmjet një udhëzimi të nxjerrë nga Drejtori i Institucionit.
13. Marrja e masave urgjente për shtimin në organike e të paktën dy mjekëve të tjerë në sektorin shëndetësor.
14. Marrja e masave urgjente për furnizimin me medikamente të farmacisë së spitalit duke vënë në zbatim skemën e rimbursimit të ilaçeve.
15. Marrja e masave të menjëhershme për rivlerësim të diagnozës dhe mjekimit për të dënuarit me sëmundje kronike.
16. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me autoambulancë.
17. Marrja e masave për pajisjen e të gjithë të dënuarve me librezë shëndetësore, duke përshpejtuar procedurën e plotësimit me dokumente përkatëse në rastet e transferimeve nga një IEVP në tjetrën.
18. Marrja e masave të menjëhershme për furnizimin e shërbimit stomatologjik me instrumente e materiale dentare.

## **5.9. IEVP Shën Koll, Lezhë - Datë 16.06.2014 / Nr. Dok. 201401240**

### ***Shënime paraprake***

IEVP Shën Koll, Lezhë është një institucion i sigurisë së zakonshme, me një seksion paraburgimi dhe një seksion paraburgimi për të mitur. Kapaciteti maksimal është 700 persona. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 753 persona, një numër që tregonte dukshëm mbipopullimin në institucion. Regjimi i brendshëm i këtij institucioni përbëhej nga 5 godina ndarë në 2 seksione, si edhe një seksion observim/ veçimi. Seksioni i paraburgimit kishte 2 godina ndërsa seksioni i të dënuarve 3. Veçim/ observimi ishte godinë më vete. Në ditën e inspektimit në seksionin e paraburgimit për të mitur ndodheshin gjithsej 8 persona.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtues të institucionit, përkatësisht me Shefin e Sigurisë, si edhe me Zëvendësdrejtorin e institucionit, të cilët u shprehën të gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Në përmbyllje të inspektimit, ekspertët morën takim me Drejtorin e Institucionit.

Nga ana e drejtuesve të institucionit, ekspertëve iu bë me dije se nuk kishte seksion të veçantë për të paraburgosurit apo për të dënuarit e moshës 18-21 vjeç, të cilët në momentin e inspektimit ishin 48 persona, 14 prej të cilëve ishin të dënuar dhe pjesa tjetër të paraburgosur. Me probleme të shëndetit mendor ishin gjithsej 22 persona dhe 4 trajtoheshin me metadon.

Ata, gjithashtu, informuan se problematika e amortizimit e të gjithë godinës, e ujit të rrjedhshëm që vijonte të ishte me orar, si dhe mungesa e fondeve për këtë drejtim, vijonte të ishte prezent.

Në kohën e monitorimit, seksioni i observim/ veçimit gjendej në një godinë më vete me 11 dhoma (6 observimi dhe 5 veçimi) ku, në momentin e inspektimit, gjendeshin 20 persona.

Referuar në informacionin e marrë dhe të konfirmuar me listën zyrtare të të punësuarve, në institucion në kohën e monitorimit figuronin të punësuar 70 të dënuar dhe 1 i paraburgosur. Asnjë prej tyre nuk ishte i mitur.

### ***Trajtimi***

Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të burgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Në IEVP Lezhë, në momentin e inspektimit, pati ankesa nga ana e të dënuarave lidhur me mungesën e informacionit në disa raste të dinamikës së të dënuarve, si edhe ndaj sistemit gjyqësor. Ankesa të tjera vinin lidhur me çmimet e larta në dyqanin e institucionit si dhe me mungesën e medikamenteve. Ankesa të tjera të përgjithshme kishte edhe lidhur me ushqimin, si në drejtim të cilësisë së gatimit, ashtu edhe në drejtim të larmishmërisë së vakteve.

### ***Masat mbrojtëse***

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Mjeku bënte pjesë si në Komisionin e Pritjes, ashtu edhe në Komisionin Disiplinor, pavarësisht se në këtë të fundit luante rolin e vëzhguesit. Lidhur me këtë të fundit, MKPT, bazuar në Rekomandimin e CPT-së për Shqipërinë, për vitin 2010, vuri në dukje faktin se mjeku nuk duhet të jetë pjesë e Komisionit Disiplinor, por ai duhet të ndjekë minimalisht një herë në ditë gjendjen shëndetësore të të burgosurit me masë disiplinore dhe, në çdo rast, kur vlerëson se shëndeti i të burgosurit vihet në rrezik si rrjedhojë e qëndrimit në izolim, duhet të informojë Drejtorin e Institucionit.

Gjatë inspektimit u konstatua se kishte një mjedis të veçantë për takimet e të dënuarve me familjarët, të cilat rezultuan se nuk ishin të përshtatshme as për nga higjiena, as për nga pajisjet. Ekspertët konstatuan se edhe në takimet me fëmijët, në dhomën e posaçme për këtë gjë, kishte

kufizime fizike, dhe pajisje të tilla si karriget dhe tavolinat ishin shumë të amortizuara. Takimet me fëmijët pa kufizime fizike realizoheshin me leje dhe kërkesë të veçantë.

Dhomat e veçimit dhe izolimit ishin në regjim, në godinë më vete dhe rezultuan të ishin shumë problematike, por të monitoruara me kamera vëzhgimi.

Ekzistonte sistemi i kërkesë/ ankesave. Të burgosurit dhe të paraburgosurit në këtë IEVP, plotësonin një formular kërkesë/ ankesa dhe ia dorëzonin më pas edukatorit në zarf ose jo. Ky i fundit i dërgonte në protokoll. Pas protokollimit i kalonin Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të dënuarit, sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, grupi i inspektimit konstatoi se pothuajse në të gjitha seksionet e regjimit mungonin kutitë e ankesave/ kërkesave, madje në godinën nr. 2 kishte pretendime se kërkesat/ ankesat e bëra nuk merrnin përgjigje në kohën e duhur, në rastin më të mirë, ose nuk merrnin përgjigje fare, në rastin më të keq.

Sa i përket masave disiplinore, u informuam se lidhur me të miturit, stafi i IEVP Lezhë, punonte fort për të mos dhënë masa disiplinore, por me anë të takimeve dhe këshillimeve, të krijonin një mjedis kolektiviteti, gjë që ndihmonte në formimin e një klime jo konfliktuale. Sa i përket të rriturve, kishte një numër të madh masash disiplinore, kryesisht lidhur me gjetjen e sendeve të ndaluara në institucion. Vetëm gjatë muajit qershor, deri në momentin e inspektimit, ishin marrë 13 masa disiplinore.

Të gjithë të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit, pranë të cilëve, nuk kishte numra telefoni për Avokatin e Popullit. Megjithatë, ankesa të shumta pati lidhur me kartat e telefonit (Mobitel), për të cilat pretendohesh se shpenzimi ishte më i madh se me ofrues të tjerë shërbimi telefonie, gjë që rëndonte në xhepat e të burgosurve/ paraburgosurve.

Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte kamera të jashtme dhe të brendshme, gjithsej 92 kamera, vetëm 3 prej të cilave nuk ishin në funksion. Në korridoret e dhomave të veçim/ observimit kishte kamera.

### ***Kushtet materiale***

Ashtu siç u konfirmua nga Drejtuesit e Institucionit dhe siç është konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, mjedisi në regjim, në të gjitha godinat, vijonte të ishte tejet i amortizuar dhe me nivel të lartë lagështire, me probleme të theksuara të kushteve higjieno-sanitare dhe problematika të insekteve.

Dhomat e banimit akomodonin nga 2, 4, 6 ose 10 persona, por jo të gjitha dhomat respektonin standardin e hapësirës jetike për person, duke marrë në konsideratë edhe faktin e mbipopullim në të gjitha godinat brenda në regjim. Tualetet ishin brenda dhomave të banimit me kushte të amortizuara dhe me lagështirë. Duset, në përgjithësi në të gjitha godinat ishin tejet të amortizuar, në kushte shumë të këqija higjieno-sanitare dhe me lagështirë të theksuar, e cila krijonte rrezikshmëri të lartë për problematika me instalimet elektrike. Automatët e bojlerëve, si rrjedhojë e amortizimit dhe mos mirëmbajtjes, ishin rrezik permanent për çdo person që afrohej



për shkak të ekspozimit të telave që përcjellin energjinë elektrike, pasi instalimet elektrike të automatit të tij ishin krejtësisht të ekspozuara. Dritaret e dusheve kryesisht ishin pa xhama, dhe postet e dusheve, për çështje të privatësisë, mbuloheshin me batanije, të cilat për shkak edhe të lagështirës së theksuar (tavane që pikonin), mbanin erë të rëndë.

Në përgjithësi, dhomat kishin dritë natyrale dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, të cilat, theksohet se ishin tejet të vjetruara. Dyshekët ishin prej sfungjeri të vjetruar dhe në pjesën dërrmuese jastëkët dhe çarçafët siguroheshin nga familjarët. Batanijet e siguruara nga institucioni ishin tejet të vjetruara me kushte të varfra higjienike, të cilat për shkak të mosfunksionimit me rregull të lavanderisë, një ankesë e bërë nga të burgosurit dhe të paraburgosurit, dhe mos pasjes së një vendi të posaçëm tharjeje, pavarësisht se në lavanderi kishte 2 tharëse, ishte tepër e vështirë për t'u pastruar. Gjithashtu, nga intervistat e kryera, grupi i inspektimit u bë me dije se institucioni siguronte vetëm detergjent për larjen e enëve ("test") dhe asnjë lloj detergjenti, apo pajisje tjetër hotelerie apo higjienike. Të gjitha pajisjet e nevojshme, të burgosurit dhe të paraburgosurit i siguronin nga familjarët e tyre.

Lidhur me pajisjet elektro-shtëpiake, pas ankesave të marra nga të burgosurit dhe të paraburgosurit, të cilët shprehën shqetësimin se ishin të detyruar që televizorët dhe frigoriferët t'i blinin nga institucioni dhe jo t'i merrnin nga familjarët, grupi i inspektimit kërkoi informacion të mëtejshëm. Stafi i institucionit, i bëri me dije ekspertëve se Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Nr. 3895, datë 09.04.2013, në mjediset e banimit, lejon vetëm pajisjet që blihen nga institucioni me një komision të posaçëm. Këto pajisje mund të blihen me fondet e të dënuarit/paraburgosurit prej institucionit.

Në regjim ishte një godinë të veçantë për observim/ veçim, e cila përbëhej nga 11 dhoma me një kapacitet maksimal prej 36 personash. Në momentin e inspektimit gjendeshin 20 persona, 3 prej të cilëve kishin probleme të shëndetit mendor. Dhomat në këtë mjedis ishin tejet të amortizuara, me dritare pa xhama dhe me kushte tepër të rënduara higjieno-sanitare. Një pjesë e personave në dhomat e observim/ veçimit flinin pa dyshekë dhe në shtroje tejet të vjetruara. Në fund të korridorit të këtij ambienti ndodhej mjedisi i dusheve dhe tualeteve, përkatësisht me 3 çezma funksionale prej 6 faktike, 3 tualete dhe 2 dushe funksionale prej 3 faktike. Nuk kishte energji elektrike dhe dritaret nuk kishin xhama. I gjithë mjedisi ishte tejet i amortizuar, tejet i papastër duke e bërë funksionimin e këtij mjedisi pothuajse të pamundur.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar, gjë që bënte të mundur aksesin e personave për të përmbushur normalisht nevojat e tyre. Megjithëse, në disa raste, pati ankesa, veçanërisht në mjediset e observim/ veçimit, për moslejim të bërjes së dushit. U konstatua, gjithashtu, se në disa prej dhomave kishte prezencë të insekteve.

Në institucion nuk kishte sistem qendror ngrohjeje.

Grupi i monitorimit konstatoi se kishte disa mjedise të jashtme, të cilat përdoreshin për ajrim. Për aktivitete sportive kishte edhe palestër. Në godinën e paraburgimit për të miturit kishte një klasë e pajisur me 8 kompjuter, e cila përdorej për kurset e kompjuterit.

Biblioteka kishte në mesin 1, 5 dhe 4 me mjedis relativisht të pastër, të vogël, me një numri të varfër titujsh, të cilët, kryesisht, ishin ofruar nga organizata Save the Children, e cila kishte bërë edhe riparime në mesin 1, paraburgimi i të miturve. Në këtë mjedis bëheshin edhe këshillime me stafin psiko-social.

Kuzhina ishte në kushte relativisht të mira higjienë ku nuk mungonin pajisjet dhe uji. Në momentin e inspektimit u konstatuan insekte, megjithëse ushqimi ishte i mbuluar. Ekspertët konstatuan se kampionët e ushqimit ruheshin për 24 orë, por jo në kushte frigoriferike. Kishte persona diabetikë, të cilët kishin nevojë për dietë specifike. Për këtë kategori institucioni përgatiste menu të veçantë. Megjithatë, përgjithësisht, nga intervistat e kryera, u konstatua se kjo kategori personash, kryesisht, ose gatuanin vetë, ose e merrnin ushqimin nga familja.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimit dhe dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj., ishte i afishuar. Nga bisedat me të dënuarit, grupi i inspektimit mori informacionin se ajrimi ishte një aktivitet i kryer sipas standardeve dhe bazuar në një grafik paraprak.

Aktivitetet që zhvilloheshin nga të dënuarit kryesisht ishin sportive, sipas një grafiku të paracaktuar, ku përfshiheshin futbollit dhe lojëra tavoline. Në përgjithësi mungonin kurset e formimit profesional. Në momentin e inspektimit kishte 4 të mitur, të cilët vijonin sistemin e detyruar arsimor. Mësimi zhvillohej nga 2 mësues prej orës 9:00-12:00 çdo ditë paradite në klasa me kushte shumë të mira dhe me të gjitha mjetet e nevojshme, financuar nga Save the Children. Megjithatë, sektori psiko-social organizonte edhe aktivitete me tematika të veçanta, ku përfshihej një pjesë e konsiderueshme e të dënuarve në të gjitha godinat e banimit, si edhe programe individuale të trajtimit për të dënuarit. Mungonin kurset e formimit profesional.

Në mesin 2 të paraburgimit kishte 2 dhoma kulti, përkatësisht për besimin e krishterë dhe për atë mysliman. Shërbesat kryheshin çdo të premte nga imami për besimin mysliman dhe çdo të hënë për besimin e krishterë. Mjediset ishin të mirëmbajtura dhe të pastra.

Sipas organikës së miratuar të sektorit të çështjeve shoqërore, ky shërbim përbëhej nga një përgjegjës sektori, 5 specialistë-edukatorë, njëri prej të cilëve me arsimim “punë sociale” dhe 4 specialistë punonjës socialë, një prej të cilëve me arsimim “juridik”.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të stafit psiko-social, si raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori, dosjet psiko-sociale, ashtu edhe programet individuale të trajtimit ishin të gjitha të plotësuar dhe të përditësuar me takimet me të dënuarit dhe vlerësimet e tremujorit të fundit. Ekspertët konstatuan se mungonin mjediset e veçanta brenda në regjim për stafin psiko-social.

Në momentin e inspektimit ishin 70 të dënuar, të punësuar në këtë institucion, si dhe një i paraburgosur, me punë të tilla si ndihmëskuzhinierë, shpërndarës ushqimi, ndihmës magazinier, llogaritar, sanitar, bojaxhi etj.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e sektorit shëndetësor përbehej nga një mjek, i cili ishte komanduar rishtazi dhe kryente edhe funksionin e përgjegjësit të sektorit të shëndetësisë, një ndihmësmjek stomatolog, një ndihmës farmacistë, dhe 7 ndihmësmjekë.

Ambulanca ekzistonte dhe ishte në funksion.

Në IEVP kishte një mjedis të etiketuar si Spitali i Institucionit, i përbërë nga 3 dhoma ku gjendeshin 8 persona me probleme shëndetësore. Dhomat ishin të amortizuara, krevatet me shtroje të vjetruara dhe me kushte të varfra higjieno-sanitare. Pas dezinfektimit të fundit, në momentin e inspektimit, nuk u konstatua prezencë e insekteve.

Dhoma e mjekut, ku ky i fundit zhvillonte vizitat, ishte tërësisht jashtë standardit, e amortizuar, ku mungonin orenditë e domosdoshme për kryerjen e një shërbimi sa më adekuat. Një problematike të theksuar kishte edhe dhoma e infermierisë me një ambient jashtë standardit dhe me lagështirë, me një dollap tejet të vjetër, ku mbaheshin medikamentet. Dhoma e stomatologut ishte më e rregullt, e pajisur me unit dhe autoklavë, të cilat funksiononin mirë. Megjithatë, materialet dhe instrumentet dentare mungonin dhe për pasojë nuk bëhej asnjë lloj punimi nga dentisti i Institucionit. Në rastet e problemeve dentare ndërhyhej vetëm me ekstraksione.

Gjatë inspektimit në këtë institucion, si dhe në bazë të intervistave me të dënuarit, ekspertët konstatuan se në lidhje me shërbimin shëndetësor, në përgjithësi kishte një vlerësim të ulët, si për sa i përket përgjigjes në kohë të kërkesave për vizita, ashtu edhe për konsultat jashtë institucionit me mjekë specialistë në spitalin e rrethit. Kjo për shkak edhe të mungesës në organikë të mjekëve, pasi me kapacitetin që ka ky institucion duheshin, së paku, tre mjekë të punësuar në këtë sektor. Mbetet për t'u vlerësuar fakti që nga ana e institucionit janë bërë përpjekje për të mbuluar pjesërisht problematikën e ilaçeve, si për rastet urgjente, ashtu edhe për mjekimin e të sëmurëve kronikë.

Në këtë institucion trajtoheshin nga ana e sektorit shëndetësor 40 të sëmurë kronikë, 22 të sëmurë mendorë dhe 4 të dënuar që kishin abuzuar me substancat narkotike, të cilët merrnin metadon.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti të atij të mjekut, u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash, regjistri themeltar të të sëmurëve kronikë dhe regjistri për konsultat jashtë institucionit. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, gjithashtu. Kartelat mjekësore ishin të plotësuara në mënyrë korrekte, por nuk mbaheshin të mbyllura me çelës. Me librezë shëndetësore ishin të pajisur vetëm 120 të dënuar. Pjesa tjetër që ishin transferuar nga IEVP-të e tjera prisnin plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me librezë shëndetësore.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në regjim dhe respektimin e hapësirës personale.

2. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me kushtet higjieno-sanitare të të gjitha mjediseve të regjimit.
3. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me lagështirën në dushe dhe tualete dhe përmirësimin fizik të këtyre të fundit.
4. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me dezinfektimin (dezinfektimin) e mjediseve të dhomave të banimit.
5. Marrja e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të observim/veçimit.
6. Marrja e masave për krijim e kushteve normale higjieno-sanitare të mjediseve për takime me familjarët dhe pajisjen e tyre me orenditë e domosdoshme.
7. Marrja e masave për takimin e të dënuarve me fëmijët e tyre pa kufizime fizike për të shmangur traumatizimin e fëmijëve.
8. Marrja e masave për krijimin e mjediseve të punës për punonjësit e sektorit të kujdesit social brenda në regjim.
9. Marrja e masave që mjeku të mos jetë pjesë e Komisionit Disiplinor, pasi kjo ndikon në cilësinë e marrëdhënies mjek-pacient. Në mënyrë që mjeku të sigurojë që masa disiplinore nuk cenon shëndetin e pacientit, ai duhet të të ndjekë së paku një herë në ditë gjendjen shëndetësore të të burgosurit me masë disiplinore, dhe në çdo rast kur vlerëson se shëndeti i të burgosurit vihet në rrezik si rrjedhojë e qëndrimit në izolim, të informojë Drejtorin e Institucionit.
10. Marrja e masave për ndarjen e të dënuarve të grup moshës 18-21 vjeç, në sektor të veçantë.
11. Marrja e masave për të përshtatur arsimimin me pozicionin e punës në sektorin e shërbimeve shoqërore.
12. Ndryshimi i Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Nr. 3895, datë 09.04.2013, me qëllim që të burgosurit/ paraburgosurit të lejohen të marrin pajisjet elektroshtëpiake edhe nga familjarët, duke shmangur diskriminimin, stigmatizimin dhe pretendimet për abuzime apo favorizime.
13. Marrja e masave urgjente për të rregulluar ambientet e dhomave ku sektori shëndetësor kryen shërbimet; dhomën ku mjeku bën vizitat, dhomën e infermierisë dhe ato të farmacisë.
14. Marrja e masave urgjente për shtimin në organikë të të paktën dy mjekëve të tjerë në sektorin shëndetësor.
15. Marrja e masave për kompletimin e dhomës së stomatologes me instrumente dhe materiale dentare.
16. Marrja e masave për pajisjen e të gjithë të dënuarve me librezë shëndetësore, duke përshtatur procedurën e plotësimit me dokumentet përkatëse në rastet e transferimeve nga një IEVP në tjetrën.

## **5.10. I EVP Kukës - Datë 19.06.2014 / Nr. Dok. 201401359**

### ***Shënime paraprake***

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës ndodhet në verilindje të qytetit, brenda ambienteve të Drejtorisë së Policisë së Qarkut. I EVP Kukës është marrë nën varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve më 1 tetor 2007. Kapaciteti i paraburgimit është 36 persona. Në ditën e inspektimit në institucion gjendeshin 27 të paraburgosur, prej të cilëve një i mitur, një shtetas maqedonas dhe disa shtetas kosovarë.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi monitorues zhvilloi fillimisht takimin me përfaqësuesit e lartë të institucionit. Nga ana e përfaqësuesve të lartë të institucionit u shpreh një frymë shumë të mirë bashkëpunimi. Në bisedën paraprake, grupi monitorues evidentoi problemet e konstatuara në këtë institucion gjatë vizitës monitoruese të vitit 2013, kryesisht mbi ambientet tejet të amortizuara të këtij institucioni, mbi mungesën e kushteve për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, etj. Drejtori i institucionit informoi për situatën e përgjithshme në institucion duke evidentuar si problematikën më kryesore faktin që I EVP ndodhet pjesërisht nëntokë. Në ditën e inspektimit, nuk rezultoi të paraburgosur me masa disiplinore, probleme të shëndetit mendor ose të sëmurë kronik. Organika ishte e plotësuar.

### ***Trajtimi***

Nga inspektimi nuk u konstatuan raste të ushtrimit të dhunës fizike e psikologjike ndaj të paraburgosurve nga ana e punonjësve të institucionit. Nga ana e administratës së institucionit ekspertëve iu bë me dije sjellja e mirë, harmonike dhe korrekte e të paraburgosurve ndërmjet tyre, por edhe ndaj punonjësve të administratës, gjë që kishte sjellë mos përdorimin për një kohë të gjatë të masave disiplinore.

Ankesat e të paraburgosurve lidheshin kryesisht me hapësirën e kufizuar të ajrimit, mungesën e aktiviteteve sportive, mungesën e furnizimit me detergjente, numrin e pamjaftueshëm të dusheve, si dhe mungesën e shërbimit dentar.

Përsa i përket trajtimit të shtetasve të huaj nga Maqedonia dhe Kosova nuk kishte diferencim në trajtim gjë kjo u pohua prej tyre. Takimet, telefonatat dhe shërbimet e tjera ofroheshin në mënyrë të barabartë për të gjithë.

Vetë institucioni organizonte spartakiada të ndryshme mes ekipeve në shah dhe domino.

### ***Masat mbrojtëse***

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga sekretarja e protokollit në një zyrë të veçantë.

Dhoma e veçimit kishte të njëjtat kushte me dhomat e tjera dhe në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person në veçim.

Për hartimin e ankesë/ kërkesave ekzistonte një format i veçantë, por në IEVP nuk kishte kuti ku ankesë/ kërkesat të vendoseshin në mënyrë anonime. Ato i dorëzohen punonjësesh sociale të hapura dhe pasi tërhiqeshin prej saj, seleksionohen në drejtori për të përcaktuar destinacionin e tyre.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit.

Për sa i përket takimeve, në institucion ishte një ambient të posaçëm të pajisur me një tavolinë dhe disa stola në kushte jo të mira, në të cilin të paraburgosurit mund të takoheshin me familjarët e tyre. Nuk kishte ankesa prej të paraburgosurve për sa i përket takimeve, pasi ato zhvilloheshin në rregull sipas planifikimeve, dhe mbikëqyreshin në distancë nga punonjësit e sigurimit.

Në regjim kishte kamera të jashtme dhe të brendshme që survejonin institucionin për 24 orë.

### ***Kushtet materiale***

IEVP Kukës ishte ndërtuar në kohën e monizmit dhe me gjithë ndryshimet e modifikimet e bëra trashëgonte infrastrukturë tejet të amortizuar. Regjimi i brendshëm ndodhej nëntokë, në një nivel lartësie prej gati 1.80m nga niveli i tokës. Kishte mungesë të sistemeve të ventilimit, ajrimit, ngrohjes qendrore, e për rrjedhojë kishte mjaft lagështi. Të paraburgosurit nuk kishin mundësi të kryenin asnjë lloj aktiviteti fizik, përveç ecjes në ambientin e ngushtë të ajrimit.

Institucioni, kishte 17 dhoma, prej nga një dhomë aktivitetesh, një dhomë takimi me familjarët, një dhomë takimi me avokatin/ prokurorin, një dhomë kulturi, një dhomë observimi, një dhomë veçimi dhe ambientin e ajrimit. Të paraburgosurit ishin vendosur nga 1-4 persona në qeli.

Institucioni për vetë pozicionimin e tij, i privonte të paraburgosurit nga ndriçimi natyror. Mungonte gjithashtu ajrosja e mjaftueshme për shkak të pozicionimit të ndërtesës, dhomave të vogla dhe korridoreve të ngushta. Në momentin e inspektimit të paraburgosurit ngritën si shqetësim lejimin e hapjes së dyerve për të lehtësuar ajrosjen. Ata kishin bërë kërkesë për hapjen e dyerve të qelive gjatë ditës, por kërkesa nuk u ishte miratuar nga institucioni.

Në një përshkrim të regjimit të brendshëm, dhomat e banimit, kryesisht për 4 persona, nuk kishin tualete dhe lavaman brenda, si dhe ajrimi e ndriçimi natyral ishte i pamjaftueshëm. Dhoma dhe korridoret ishin të pastra. Dritaret në dhomat e banimit ishin të siguruara me hekura dhe rrjetë të dendur hekuri, gjë që e bënte të vështirë ndriçimin natyral dhe ajrimin. Në dhoma kishte ndriçim artificial. Dhomat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme. Çarçafët, jastëkët dhe batanijet në shumicën e rasteve ishin sjellë nga familjarët. Dyshekët ishin prej sfungjeri dhe në kushte të mira.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar, gjë që bënte të mundur aksesin e personave për të kryer normalisht nevojat e tyre. Megjithatë, në disa raste, pati ankesa, për mungesën e ujit të ngrohtë.

Gjatë dimrit ngrohja realizohej me sobë me dru, ndërsa në verë nuk kishte një mjet ftohje që të plotësonte kërkesat e të gjithë institucionit.

Për sa i përket pajisjeve elektro-shtëpiake kishte dhoma ku nuk mungonin pajisjet si TV dhe frigorifer por dhe të tjera ku mungonin pasi paraburgosurit ishin aty për një kohë të shkurtër.

nga ata që deklarorin se shërbimi dentar u ishte ofruar një muaj pasi i paraburgosuri kishin bërë kërkesën. Ankesa kishte edhe për sa i përket furnizimit me medikamenteve nga ana e institucionit.

Ambulanca mungonte prej kohësh në këtë institucion.

Dhoma e mjekut, infermierisë dhe e farmacisë ishin të rregullta dhe të mirëmbajtur, megjithëse me infrastrukturë të vjetër e të varfra me orendi. Aty nuk mungonin pajisjet e nevojshme.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash, themeltar, regjistri për konsultat jashtë institucionit, si dhe regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermiereve, gjithashtu. Kartelat mjekësore, megjithëse mbaheshin të mbyllura me çelës, ato nuk plotësoheshin me rregull dhe në disa raste mungonte anamneza.

Asnjë nga të gjithë të paraburgosurit nuk ishte i pajisur me librezë shëndetësore, për rrjedhojë mungonte shërbimi me medikamente sipas skemës së rimbursimit të ilaçeve. Të paraburgosurit i siguronin ato privatisht. Problemi i furnizimit me ilaçe vinte dhe për shkak të mungesës së depos farmaceutike.

Në momentin e inspektimit, në institucion ndodheshin tre të sëmurë kronik, të cilët ishin diagnostikuar një me Diabet Mellitus, një me Çrregullime të Sjelljes dhe një me Çrregullime të Ankthit.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për rregullimin e menjëhershëm të dusheve dhe tualeteve me qëllim ofrimin e larjeve të të dënuarve më shpesh, sidomos në periudhë vere.
2. Marrja e masave për pajisjen e dhomës së takimeve me sende të domosdoshme që krijojnë klimën e një takimi familjar në respekt të dinjitetit të të dënuarve dhe familjarëve vizitorë në institucion.
3. Marrja e masave për vendosjen e kutisë së kërkesë/ ankesave që duhet te ekzistojë në seksione, mundësisht afër me telefonin, që të dënuarit ta shfrytëzojnë të drejtën e ankimit.
4. Marrja e masave për lejimin e hapjes së dyerve për të lehtësuar ajrosjen për arsye se korridori është shumë i ngushtë dhe dhomat ndodhen në katin përdhes të godinës gjë e cila pengon dhe nuk lejon ajrosjen e mirë të dhomave.
5. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me autoambulancë.
6. Marrja e masave urgjente për shtimin në organikë e mjekut me kohë të plotë në sektorin shëndetësor.

7. Marrja e masave për pajisjen e të gjithë të paraburgosurve me libreza shëndetësore, duke përshpejtuar procedurën e plotësimit me dokumente përkatëse edhe në rastet e transferimeve nga një IEVP në tjetrën.
8. Në përfundim, bazuar në kushtet e konstatuara në monitorimin e kryerjes së vizitës, në vizitën pararendëse, në analizimin e progresit apo mundësinë për progres në arritjen e standardeve, grupi i monitorimit arriti në konkluzionin se kjo IEVP është tejet e amortizuar dhe se kushtet e saj dëmtojnë shëndetin fizik dhe mendor të të paraburgosurve, cenojnë dinjitetin njerëzor të tyre. Në kushtet kur nuk ka asnjë mundësi që këto të korrigjohen, rekomandohet mbyllja e kësaj IEVP-je dhe shpërndarja e të paraburgosurve në paraburgimet e tjera.

### **5.11. IEVP Tropojë - Datë 20.06.2014 / Nr. Dok. 201401358**

#### *Shënime paraprake*

Vizita monitoruese pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë tepër të mirë bashkëpunimi. Nga Drejtori i Institucionit grupit monitorues iu ofrua mundësia për akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhet të monitoroheshin.

Gjatë vizitës monitoruese u vizitua, ndërtesën aktuale e IEVP-së, si dhe ndërtesa e re e institucionit të paraburgimit e cila nuk ishte vënë ende në përdorim. Edhe në këtë vizitë monitoruese, sikurse edhe në atë të mëparshmen, autoritet drejtuese të IEVP Tropojë, bënë me dije se punimet në godinën e re kishin përfunduar dhe së shpejti kjo godinë do merrej në dorëzim nga autoritetit e institucionit. Duhet theksuar se kjo godinë duhej të kishte përfunduar dhe të ishte dorëzuar brenda muajit shtator 2013. Godina e vjetër sërish u gjet në kushtet e një amortizimi të plotë dhe e papërshtatshme.

Qëllimi i vizitës së grupit monitorues, përfshinte verifikimin e përmbushjes së standardeve si në godinën aktuale, ashtu edhe në godinën e re ende jo në gjendje pune, ndaj sa me poshtë përfshin konstatimet e grupit monitorues në të dyja godinat.

Gjatë inspektimit të Komisarariatit të Policisë Tropojë, nga Shefi i Rendit të këtij komisaritati, grupit të inspektimit ju bë me dije se ky komisarariat kishte 3 dhoma sigurie, të cilat në bazë të një marrëveshjeje me IEVP Tropojë, ndodheshin në mjediset e këtij të fundit. Ekspertët u informuan se në këtë IEVP, përkrah efektivëve të policisë së burgjeve, ishin edhe efektivët e Policisë së Shtetit. Një fakt i tillë nuk u konstatua nga ekspertët gjatë monitorimit në IEVP Tropojë, institucion i monitoruar në të njëjtën ditë nga i njëjti grup monitorimi. Megjithatë, ekspertët kërkuan kopje të marrëveshjes së përmendur nga ana e Shefit të Rendit të Komisarariatit të Policisë Tropojë, e cila u vu menjëherë në dispozicion të grupit të inspektimit. Akt-Marrëveshja mes Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë “Mbi kalimin e ambienteve të paraburgimit dhe ndihmëse në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, nr. 5740, datë 03.10.2007, dhe më pas akt-marrëveshja e nënshkruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në zbatim të aktmarrëveshjes së sipërcituar mes dy Ministrive, nr. 1414, datë 01.09.2007, përcakton se mjediset e kaluara në vartësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë:



1. Godina e Repartit të Policisë së Rendit 2 katesh me të gjitha ambientet e saj;
2. Sheshi para godinës (lulishtja e pasme);
3. Sipërfaqja sipër godinës, deri para Stacionit të PMNZSH Tropojë;
4. Ambientet e kuzhinës së policisë.

Siç edhe konstatohet, në asnjërën prej akt-marrëveshjeve nuk bëhej fjalë për situatën e bashkë-administrimit të dhomave të sigurisë së Komisarariatit të Policisë Tropojë brenda mjediseve të IEVP Tropojë. Për më tepër, një fakt i tillë nuk iu raportua dhe nuk iu bë me dije ekspertëve të MKPT-së gjatë takimit me drejtuesit e IEVP-së Tropojë.

### ***Të dhëna të përgjithshme mbi godinën e re (jo funksionale) të paraburgimit Tropojë***

Gjatë takimit me drejtorin e IEVP-së, grupit monitorues morri informacion të detajuar mbi godinën e re, ku do të transferoheshin të paraburgosurit. Drejtori u shpreh se ky transferim ishte penguar për mungesë fondesh për të plotësuar me pajisje dhomat dhe ambientet mbështetëse.

Nga vizita në ambientet e reja paraburgimit, grupi monitorues konstatoi se në pjesën më të madhe ato ishin të përfunduara e të gatshme për funksionin që do të kryenin. Ndërtesa e re parashikohet të ketë një kapacitet maksimal për 26 persona. Në këtë ndërtesë janë parashikuar gjithsej 8 dhoma për të paraburgosurit, 6 prej të cilave me 4 krevate, 1 me dy krevate, një dhomë observimi me dy shtretër dhe një dhomë veçimi me dy shtretër.

Ndërtesa përbëhej nga dy kate dhe një kat pjesërisht nëntokë (nën nivelin 0) vetëm nga njëri krah. Ky i fundit kishte dalje drejtë për së drejti mbi tokë (nga krahu tjetër), jashtë godinës pasi vetë ndërtesa ishte e pozicionuar mbi një pjesë kodrinore. Në këtë kat, pjesërisht nëntokë, ishin të projektuara disa ambiente, që sipas shpjegimeve të marra nga punonjësit e institucionit, njeri do të shërbente për kuzhinë ose për vendosjen e kaldajës (ende nuk ishte përcaktuar) ndërsa tjetri do të përdorej për magazinë (edhe kjo ende e papërcaktuar saktë, pasi si magazinë mund të përdorej edhe një ambient në katin e parë (nivel mbi 0) i ndodhur menjëherë në krahun e djathtë në hyrjen e katit të parë.

Në katin e parë të ndërtesës, ishte projektuar, dhoma e takimit me familjaret dhe avokatin, vendqëndrimi i forcave të ndërhyrjes së shpejtë, një ambient për magazine (i përmendur më lart i cili mund të shfrytëzohej edhe për kaldajë) dhe regjimi i brendshëm. Në regjimin e brendshëm, ndodheshin ambientet e dushit (nga dy poste të ndara që siguronin privatësi) si dhe dalja për në ajrim. Hapësira e ajrimit ishte e papërshtatshme për organizimin e lojërave me top, pasi edhe kjo hapësirë ishte e ndarë në dy poste të veçuara.

Dhomat ishin të pajisura tualete të ndara me mur, por ende pa derë. Sipërfaqja që zinte ambienti i tualetit ishte: 1.5 m<sup>2</sup> (1m x 1.50m). Dhomat ishin të pajisura me krevate, sipas kapacitetit, 4 shtretër tip marinari, dhe 2 shtretër tip marinari.

U matën përmasat e dhomave, të cilat ishin standarde sipas kapacitetit pritës, e konkretisht: për dhomat me kapacitet për 4 persona 4m x 4m x 2.80m (përfshirë këtu edhe hapësirën e ndarë me mur të tualetit). Sipërfaqja e banimit e llogaritur për person në dhomat për 4 veta ishte 4 m<sup>2</sup> për person. Deri këtu sipërfaqja e banimit ishte në përputhje me standardin e kërkuar, por po t'i

heqim kësaj sipërfaqe, sipërfaqen e ambientit të tualetit, sipërfaqja e banimit ulet nën këtë standard. Vëllimi i ambientit të banimit të dhomave me 4 persona, ishte 11.2 m<sup>3</sup> për person, që do të thotë mbi standardin minimum të kërkuar nga ligji. Për dhomat 2-she, përmasat ishin si në vijim: 4m x 2.50m x 2.80m (përfshirë këtu edhe hapësirën e ndarë me mur të tualetit). Sipërfaqja e banimit për person, në dhomat e projektuara për dy persona ishin: 5 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi për person (përfshirë këtu edhe hapësirën e ndarë me mur të tualetit), ndërsa kubatura ishte 14 m<sup>3</sup> për person. Në të dyja rastet respektoheshin parametrat e përcaktuar nga aktet normative në fuqi. Dhomat e banimit ishin të pajisura me dritare me përmasa përafërsisht 1.20 x 60, të siguruara me hekura, të cilat siguronin një ndriçim të bollshëm në dhomat e banimit.

Në katin e dytë të ndërtesës ishin parashikuar ambiente të punës së administratës së institucionit, si dhe sipas informacionit të marrë nga punonjësit e institucionit që na shoqëronin, janë parashikuar gjithashtu, dhomë për bibliotekën dhe sallë kompjuterësh.

Në këndvështrimin e grupit monitorues ndarja arkitekturore e ambienteve në funksion të qëllimit të shërbimeve në institucion u vlerësua e pa realizuar mirë. Konkretisht, kuzhina, pavarësisht se ende e pa vendosur përfundimisht, ishte parashikuar të vendosej jashtë regjimit të brendshëm. Nëse do të vendoset përfundimisht kështu, transporti i ushqimit nga kuzhina në ambientet e brendshme, do të realizohet në mënyrë fizike nga jashtë, gjë që nuk plotëson kushtet higjienike dhe ato të sigurisë. Ushqimi zakonisht transportohet dhe shpërndahet nga të paraburgosur të punësuar, të cilët mund të vendosen në kushte pasigurie për jetën, pasi për të hyrë në kuzhinë do t'u duhet të dalin jashtë murit të ngritur për të ulur vazhdueshmërinë nga pallati i lartë që ndodhet thuhetse përballë IEVP-së, duke u bërë shënjestra të mundshme. Po kështu, zgjidhja arkitekturore e vendosjes së bibliotekës apo sallës së kompjuterëve në katin e dytë, detyrimisht kërkon që të paraburgosurit të cilët do të duan t'i shfrytëzojnë ato, të dalin nga regjimi i brendshëm për t'u ngjitur sipër në katin e dytë. Kjo mund të sjellë probleme në lidhje me sigurinë e tyre, të jetës apo shëndetit, pasi kati i dytë është i dukshëm nga pallati në fjalë por, nga ana tjetër do të kërkojë edhe marrjen e masave në lidhje me sigurimin e tyre për të evituar tentativat për t'u arratisur, gjë që kërkon vëzhgim e mbajtje në kontroll të vazhdueshëm të tyre nga forcat e sigurisë në institucion, thënë ndryshe, më shumë efektivë policie në institucion.

Nga informacioni i shkëmbyer me punonjësit e institucionit, ishte i qartë ambienti i veçimit, por ende ishte i paqartë dhoma e observimit, si dhomë me vete. Krijohet përshtypja, që punonjësit e institucionit të paraburgimit IEVP Tropojë, nisur edhe nga përvoja në paraburgimin e vjetër, ku disa dhoma përdorshin nga Komisariati i Tropojës për të ndaluarit/ arrestuarit deri në 72 orë, do të përdornin vetëm një dhomë veçimi, meqë e nënkuptonin observimin si të realizuar gjatë periudhës së ndalim/ arrestimit. Arsyeshem ngrihet dyshimi që ata parashikojnë të bëjnë të njëjtën zgjidhje edhe në godinën e re. Për këtë arsye, grupi i monitorimit rekomandon përcaktimin e saktë të një dhome të tillë, duke sugjeruar përcaktimin e dhomës me dy shtretër, si dhomë observimi.

### ***Trajtimi***

Gjatë monitorimit të grupit monitorues dhe bisedave në privatësi që u bënë gjatë intervistave me të paraburgosurit nuk u konstatuan raste të përdorimit të forcës fizike, ushtrimit të dhunës, presionit psikologjik apo raste torture. Marrëdhëniet mes stafit të regjimit të brendshëm dhe atij

të edukimit me të paraburgosurit dukeshin të mira dhe nuk linin shkas për dyshime mbi përdorimin e formave të keqtrajtimit psikologjik apo fizik.

Ankesat që ishin në momentin e inspektimit kishin të bënin më shumë me hapësirën e kufizuar të ajrimit, kushtet e tualetit dhe dusheve të cilat ndodheshin të vendosura së bashku në të njëjtin ambient, lagështira dhe mungesa e ndriçimit natyral, si dhe mungesa e medikamenteve mjekësore dhe e shërbimit dentar.

Një nga problemet kryesore të evidentuara ishte mosfunksionimi i skemës së rimbursimit të ilaçeve, që për pasojë bënte që të paraburgosurit me probleme shëndetësore t'i paguanin vetë medikamentet e tyre. Gjithsesi, nga monitorimi u vlerësua se njërit prej të paraburgosurve që vuante nga sëmundje kronike i ishin plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme sipas kërkesës së tij dhe rekomandimit të mjekut.

### ***Masat mbrojtëse***

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve u vlerësua se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga sekretarja e protokollit në një zyrë të veçantë.

Dhoma e veçimit kishte të njëjtat kushte me dhomat e tjera: hapësirë e vogël, pa krevat, jo e pastër. Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person në veçim apo me masë disiplinore, e cila u konfirmua jo vetëm nga bisedat në privatësi me të paraburgosurit, por dhe nga verifikimi i regjistrave të masave disiplinore. Nga vëzhgimi në dhomën e veçimit, u vu re një kabull i cili varej deri poshtë afër dyshemesë. Nga punonjësi i regjimit të brendshëm u pohua se ajo dhomë ishte përdorur më përpara jo për veçim dhe se aty kishte pasur TV nga një i paraburgosur tjetër, ndaj kabulli është lënë për këtë arsye.

Për hartimin e ankesë/ kërkesave ekzistonte një format i veçantë, por në I EVP nuk kishte kuti ku ankesë/ kërkesat të hidheshin në mënyrë anonime. Ato i dorëzoheshin stafit të edukimit të hapura dhe pasi tërhiqeshin prej tij, seleksionoheshin në drejtori për të përcaktuar destinacionin e tyre. Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit.

Për sa i përket takimeve, ekzistonte një ambient në të cilin të paraburgosurit mund të takoheshin me familjarët e tyre. Ky ambient ishte i hapur, e i pajisur me një tavolinë dhe disa karrige të vjetra në kushte jo shumë të mira. Nuk kishte ankesa prej të paraburgosurve për sa i përket takimeve: ato zhvillohen në rregull sipas planifikimeve dhe mbikëqyreshin në distancë nga punonjës të sigurimit. Në dhomën e takimeve mungonin sende dhe orendi të cilat do të mund të krijonin klimën e një takimi familjar në respekt të dinjitetit të të paraburgosurve dhe familjarëve vizitorë në institucion.

Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte kamera të jashtme dhe të brendshme, por që ishin jashtë shërbimit.

### ***Kushtet materiale***

Godina aktuale e I EVP Tropojë, gjendet brenda territorit të Komisarariatit të Policisë Tropojë Kapaciteti zyrtar i institucionit është 24 persona. Në momentin e inspektimit gjendeshin vetëm 4 të paraburgosur, mes tyre asnjë i mitur, i huaj apo me probleme të shëndetit mendor. Nga personat e paraburgosur nuk kishte persona të kategorisë 18-21 vjeçare. Nuk kishte persona të veçuar e gjithashtu asnjë person të punësuar. Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj., ishte i afishuar. Aktivitetet fillonin në orën 07.00 dhe mbylleshin në orën 22.30.

Në aspektin e infrastrukturës, kjo ndërtesë ishte e papërshtatshme dhe jashtë standardeve për funksionin për të cilin ekziston. I EVP Tropojë ka një vendosje gjeografike që i privon të paraburgosurit nga ndriçimi natyror. Gjithsej institucioni ka 11 dhoma, 2 prej të cilave përdorshin nga Komisariami i Policisë Tropojë. Nga 11 dhoma, 8 prej tyre ishin dhoma për një person, ndërsa 2 dhoma me nga 4 krevate secila, dhe 1 dhomë veçimi. Dy prej të paraburgosurve ishin vendosur nga 1 për dhomë, ndërsa në një dhomë tjetër ishin vendosur dy të tjerët. Të paraburgosurit e strehuar në dhoma për një person flinin në dyshek të vendosur sipër një dërrase në lartësi 10 cm nga toka. Dyshekët ishin prej sfungjeri dhe në kushte disi të mira. Shumica e ndërresave dhe shtresave të gjumit si çarçafë e batanije ishin sjellë dhe laheshin nga familjarët. Për sa i përket pajisjeve elektro-shtëpiake në një nga dhomat ku ndodheshin dy të paraburgosur kishte TV, ndërsa elektro-shtëpiake të tjera nuk u vunë re.

Inventari nëpër dhoma ishte i plotësuar (krevate, tavolina, dollapë etj.), por kushtet brenda dhomave ishin të mjerueshme dhe jashtë standardeve të jetesës. Mungonte ajrosja e mjaftueshme për shkak të pozicionit të ndërtesës dhe dritareve shumë të vogla dhe në një lartësi fare pranë tavanit. Korridoret gjithashtu ishin mjaft të ngushta, me lagështirë, e të palyera për një kohë shumë të gjatë.

Tualeti (një WC *alla turka*) dhe dushi ishin në të njëjtin ambient që nuk plotësonte standardet e kushteve të jetesës brenda institucionit. Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar. Aksesorët e dushit ishin në kushte jo të mira. Bojleri i ujit të ngrohtë ishte i montuar jashtë godinës por nga kontrolli që ne i bëmë ujit rezultoi që uji i ngrohtë nuk mungonte. Kalendari i dusheve nuk ndodhej i afishuar, por nga pohimet e të paraburgosurve u konstatua se nuk kishte pengesa dhe kufizime në bërjen e dusheve.

Gjatë dimrit ngrohja realizohej me sobë me dru ndërsa për stinën e verës nuk kishte pajisje ventilimi që të plotësonte kërkesat e të gjithë institucionit megjithëse konsiderohej si godinë e freskët në verë për shkak dhe të mungesës së rrahjes së saj prej rrezeve të diellit.

Problematike dhe mjaft shqetësuese ngeleshin kabllot dhe telat e energjisë elektrike të cilat ishin tejet të amortizuara dhe përbënin një kërcënim për jetën e vetë stafit dhe të paraburgosurve brenda këtij institucioni.

Mungon salla e aktiviteteve ku mund të zhvilloheshin programe dhe aktivitete të ndryshme. Mungonin gjithashtu mjediset e jashtme të cilat mund të përdorshin për aktivitete sportive si futboll, basketboll etj. I vetmi ambient ishte ai i ajrosjes i cili ishte i kufizuar në hapësirë e që

ofronte mundësi të kufizuar edhe për ecje. Të paraburgosurit e përdornin këtë ambient kryesisht për të luajtur shah dhe domino, 2 orë paradite dhe 1 orë pasdite. Ndërsa gjatë dimrit këto aktivitete zhvillohen nëpër dhoma për arsye se brenda regjimit mungonin hapësirat e nevojshme.

Biblioteka ishte vendosur në godinën e re, jashtë regjimit dhe brenda zyrave të stafit psiko-edukativ. Punonjësi Social merrej me pasurimin e bibliotekës. Ai i informonte të paraburgosurit rreth librave që gjendeshin në bibliotekë dhe më pas sipas kërkesave të tyre ai ua sillte këtyre të fundit librat brenda regjimit.

Nga vizita në kuzhinën e I EVP-së u vu re që ishte e vogël por me kushte shumë të mira. Kjo godinë ndodhej jashtë godinës së institucionit dhe funksiononte edhe për Komisaratin e Policisë së Bajram Currit. E vendosur nën nivelin e tokës, ajo ishte e pastër dhe me pajisjet e domosdoshme për gatim dhe mirëmbajtjen e ushqimeve në kushte shumë të mira. Në të gjendej e afishuar menyuja ditore. Ushqimi i përgatitur ishte i cilësisë së kënaqshme, me gramatura brenda standardeve. Kampionët e ushqimeve të gatuar një ditë më parë ruhen në kushte frigoriferike. Në kuzhinë punonte një kuzhinier dhe një ndihmës kuzhinier. Pothuajse të gjithë të paraburgosurit e konsumonin ushqimin në institucion dhe pohuan se ishte i kënaqshëm për nga cilësia dhe shija. I vetmi problem ngelet larmishmëria e tij.

Nga takimi me stafin e sektorit të kujdesit social u vu re një komunikim dhe bashkëpunim shumë i mirë. Vetë punonjësi social e shoqëroi grupin gjatë gjithë inspektimit dhe informoi për aktivitetet, temat e ndryshme dhe programet që zbatoheshin në institucion. Grupi vlerësoi dosjet psiko-sociale të cilat rezultuan të plotësuar shumë mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të paraburgosurit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

### ***Shërbimi Shëndetësor***

Organika e sektorit shëndetësisë përbëhej nga një mjek me kohë të plotë dhe tre ndihmës mjekë. Ndërkohë që mungonte farmacisti, punën e tij e mbulonte mjekja e këtij institucioni.

Nga të katër të paraburgosurit që gjendeshin në këtë institucion vetëm njëri vuante nga HTA dhe Hipertrofi të Prostatës, i cili e siguronte nga familja mjekimin për këto sëmundje.

Gjatë kësaj vizite monitoruese, u vu re se asnjëri nga personat që ndodhej në këtë institucion nuk ishte i pajisur me librezë shëndetësore e rrjedhimisht skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte. Gjithashtu vështirësi kishte edhe në kryerjen e konsultave në spitalin rajonal, sidomos për shkak të mungesës së specialistëve në këtë spital.

Shërbimi stomatologjik mbulohej privatisht një dentiste shkolle, e cila është kontraktuar nga institucioni. Ky i fundit rimbursonte çdo shpenzim për shërbimin dentar që i bëhej të paraburgosurve.

Për sa i përket dhomës së mjeku dhe të farmacisë, ato rezultuan të rregullta, por në kushte tejet të amortizuara. Farmacia ishte e furnizuar me medikamente të urgjencës.

Nga këqyrja e të gjithë dokumentacionit të këtij sektori u konstatua se ato mbaheshin me rregull. Kartelat, regjistri i vizitave dhe ai i konsultave plotësoheshin duke pasur një ndjekje në dinamikë të rasteve me probleme shëndetësore. I gjithë dokumentacioni mbahej i mbyllur me dry.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për kryerjen e riparimeve dhe ndryshimeve të nevojshme për të mundësuar kalimin sa më të shpejtë të të paraburgosurve në ambientet e reja të I EVP Tropojë.
2. Marrja e masave për aktivizimin e kurseve të formimit arsimor e profesional.
3. Marrja e masave për mbështetjen me bazë materiale e financiare për të mundësuar realizimin e aktiviteteve e veprimtarive me karakter edukativ, social, artistik, kulturor e fetar.
4. Marrja e masave për vënien në zbatim të marrëveshjes trepalëshe për medikamentet edhe në këtë I EVP të vendosur në zona ku nuk ka depo farmaceutike.
5. Marrja e masave për shtimin në organikë të farmacistit në sektorin shëndetësor.
6. Marrja e masave urgjente për furnizimin me medikamente të farmacisë së I ENP-së, si për sëmundjet kronike ashtu edhe ato akute.
7. Marrja e masave për pajisjen e të dënuarve me librezë shëndetësore dhe vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve.
8. Marrja e masave për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së vendosjes së dhomave të sigurisë së Komisarariatit të Policisë Bajram Curri në ambientet e I EVP Tropojë me prezencë të dyfishtë të personelit policor.

#### **5.12. I EVP Elbasan - Datë 23.07.2014 / Nr. Dok. 201401357**

##### ***Shënime paraprake***

I EVP Elbasan është një institucion i ndërtuar në 2010-ën dhe infrastruktura e tij është e një standardi të lartë. Kapaciteti është 120 persona, ndërkohë që institucioni është i pajisur me 143 shtretër. Në ditën e inspektimit ndodheshin 212 të paraburgosur në kushte mbipopullimi 92% mbi kapacitet.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi zhvilloi fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit dhe shefin e sigurisë, nga ana e të cilëve u shpreh gatishmëria për bashkëpunim. Problematika më e madhe në gjykimin e tyre ishte mbipopullimi i këtij institucioni i cili sillte për pasojë uljen e cilësisë së shërbimeve për të paraburgosurit.

Institucioni ndahet në dy seksione të mëdha A dhe B. Përpara hyrjes në seksione kishte 2 dhoma observimi dhe 2 dhoma transiti, seksioni A për të dënuar mbi 21 vjeç dhe seksioni B për 18-21 vjeçarët. Seksionet ndaheshin në sektorë të organizuar në këto ambiente: dhoma banimi, dhomë këshillimi, banjë e jashtme e përbashkët, ambient dushi për një person dhe magazinë. Dhomat e banimit ishin projektuar për 1, 2, 3, 4 e 5 persona. Dhomat e banimit ishin të pajisura të gjitha me ambient banje. Ambientet e përbashkëta (klasa, bibliotekë, palestër) ishin vetëm për sektorin B

Institucioni kishte ambient sportiv (fushë futbollit/ kalçeto), lavanderi, kuzhinë moderne, dhomë kulti, bibliotekë, spital/ infermieri, si dhe ambient palestere, por ende jo funksional.

Organika e stafit ishte e plotësuar. Institucioni ishte i pajisur me sistem ventilimi dhe ngrohjeje qendrore, si dhe me sistem të mbrojtjes kundër zjarrit.

IEVP Elbasan ofronte punësim, por të paraburgosurit nuk paguheshin për punën e kryer në institucion. Ky paraburgim nuk njihte as uljen e katër ditëve në muaj nga dënimi për punën e kryer. Nga sa rezultoi prej takimeve, të paraburgosurit e punësuar nuk ishin të informuar për faktin se atyre nuk do t'u njihej puna e kryer.

### ***Trajtimi***

Nga informacioni i marrë, si nga drejtuesit e institucionit, ashtu edhe nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të paraburgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast torture apo përdorimi të tepruar të forcës apo dhunës psikologjike nga ana e personelit të IEVP-së Elbasan ndaj të paraburgosurve.

Në ditën e monitorimit në institucion kishte mbipopullim dhe 40% e të dënuarve flinin në tokë me dyshekë. Të paraburgosur që ishin të veçuar me masën disiplinore të veçimit ishin 2. Kishte 6 persona me probleme të shëndetit mendor, por nuk ekzistonte një seksion i veçantë për ta. Nuk kishte shtetas me kombësi të huaj, veç një të paraburgosuri, D.M., godina B, kati II, dhoma 1, i cili pretendonte se ishte me nënshtetësi Bullgare, por nga dokumentet ai rezultonte me nënshtetësi Shqiptare.

Ankesat që u paraqitën në momentin e inspektimit kishin të bënin më shumë me mbipopullimin e dhomave, cilësinë e ushqimit, mungesën e detergjenteve, mungesën e dusheve, mungesën e medikamenteve mjekësore, si dhe mungesën për regjimin e sektorit A të aktiviteteve e të ambienteve (klasa, bibliotekë, palestër) brenda regjimit, ashtu sikurse ishin në sektorin B.

### ***Masat mbrojtëse***

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve, rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga sekretarja e protokollit në një zyrë të veçantë.

Sistemi ankesë / kërkesave funksiononte dhe ekzistonin të gjitha format e gatshme të kërkesë ankesave të cilat mbaheshin nga stafi i edukimit. Për të bërë një ankesë/ kërkesë të paraburgosurit në këtë IEVP, plotësonin një formular kërkesë/ ankese dhe ia dorëzonin më pas edukatorit, në zarf ose jo. Ky i fundit e dërgonte në protokoll. Pas protokollimit i kalohej Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të paraburgosurit, sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, grupi i inspektimit konstatoi se pothuajse në të gjitha seksionet e regjimit mungonin kutitë e ankesave/ kërkesave dhe çdo dokument përcillej dorazi.

Dhomat e veçimit dhe izolimit ishin në katin e parë të godinës dhe rezultuan të ishin të mbipopulluara dhe të pa pajisura me mjetet e nevojshme për akomodim. Këto dhoma ishin të

monitoruara me kamera vëzhgimi. Gjendeshin 2 dhoma observimi dhe 2 dhoma transiti. Në ditën e inspektimit tek dhomat e observimit ndodheshin 6 persona përkatësisht të ndarë 2 tek një dhomë dhe 4 persona të tjerë në dhomën tjetër. Këto dhoma ishin mjaft të vogla dhe në secilën prej tyre kishte vetëm nga dy shtretër dhe dyshekë. Në observim mungonin karriget dhe shtrojat (çarçafët, batanijet dhe jastëkët). Në dhomën ku gjendeshin katër persona, 2 prej tyre flinin bashkë në tokë në një dyshek. Brenda një korridorit të vogël jashtë ndodhej tualeti dhe dushet për dhomat e observimit dhe transitit.

Personat në observim gjatë bisedave në privatësi u ankuan për mungesën pajisjeve të tilla si pjata, lugë dhe gota. Ushqimi u ishte ofruar për të gjitha vaktet, por ata përgjithësisht kishin preferuar ta merrnin nga familjarët. Ata kishin 3 ditë në observim dhe nuk kishin bërë as ajrim as dush.

Gjatë inspektimit u konstatuan në veçim dy persona me masa disiplinore. Me datë 13/ 06/ 2014 kishte ndodhur një konflikt mes dy të rinjve F.H. dhe R.C. dhe të paraburgosurit A.C. Të dy këta persona pasi ishin kontrolluar dhe kishin dalë në ajrim, kishin goditur me grushte të paraburgosurin A.C. Ky konflikt ishte shmangur në kohën e duhur pa i shkaktuar lëndime të paraburgosurit. Ndaj dy të paraburgosurve ishte marrë masë disiplinore me veçim për 20 ditë dhe përjashtim nga të gjitha aktivitetet e përbashkëta, por atyre nuk u ishte dhënë një kopje e masës disiplinore. Sipas stafit të edukimit kjo kopje i bashkëngjitej dokumenteve të tyre dhe futej në dosjen psiko-sociale.

Për sa i përket takimeve, në I EVP Elbasan ekzistonin dy ambiente në të cilat të paraburgosurit mund të takoheshin me familjarët e tyre. Këto ambiente ishin të ndara me xham ku familjarët e të paraburgosurit qëndrojnë përtej xhamit dhe ata komunikojnë me anë të telefonit me njëri tjetrin. Nuk kishte ankesa prej të paraburgosurve për sa i përket takimeve. Ato zhvilloheshin në rregull sipas planifikimeve dhe mbikëqyreshin në distancë nga punonjës të sigurimit. Në rastet kur të paraburgosurit kishin fëmijë nën tre vjeç ose prindër të moshuar, takimet zhvilloheshin në dhomën ku bëheshin takimet me avokatin. Në fakt në I EVP ekzistonte një ambient takimi për fëmijët, i pajisur më së miri me të gjitha orënditë e nevojshme e me mure ku ishin pikturuar të personazhet e filmave vizatimorë për fëmijë, por nga konstatimi i bërë rezultoi se kjo sallë takimesh akoma nuk kishte filluar të vihej në funksionim.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Megjithatë, ankesa të shumta pati lidhur me kartat e telefonit (Mobitel), për të cilat pretendohet se shpenzimi ishte më i madh se me ofruet të tjerë shërbimi telefonie, gjë që rëndonte në xhepat e të paraburgosurve.

Gjatë inspektimit në ambientet brenda institucionit u vu re se në muret e institucionit nuk ishin të afishuara numrat e telefonit dhe adresat e Avokatit të Popullit dhe OJF-ve që merren drejtpërsëdrejti me të drejtat e personave të dënuar dhe të paraburgosur, por ato gjendeshin në sallën e këshillimit.

Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte kamera të jashtme dhe të brendshme që survejonin institucionin për 24 orë.



### ***Kushtet materiale***

Dhomat e banimit brenda regjimit akomodonin nga 1 deri në 4 persona në dhomë. Institucioni ofronte 143 shtretër, ndaj jo të gjithë të paraburgosurit kishin krevat. Në të gjitha dhomat kishte nga 1 e deri në 2 të dënuar që flinin me dyshek përtokë. Dhomat ishin të përmasave të ndryshme, por kryesisht të vogla në kubaturë. Kishte dhe dhoma me një të dënuar ku dhoma ishte e vogël me hapësirë sa për një krevat. Tualete ishin nëpër dhoma dhe në kushte shumë të mira.

Në dhoma sigurohej ndriçim natyror dhe artificial. Dritaret ishin të mëdha dhe nuk e pengonin dritën e diellit dhe futjen e ajrit të pastër. Dhomat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolinë, karrige dhe dollap. Çarçafët, jastëkët dhe batanijet në shumicën e rasteve ishin sjellë nga familjarët. Dyshekët ishin prej sfungjeri dhe në kushte të mira. Në disa prej qelive u ngrit si problem nderja e ndërresave në dritare, gjë e cila nuk lejohej për shkak se pengonte mbikëqyrjen me kamera.

Për sa i përket pajisjeve elektro-shtëpiake nga grupi inspektues u grumbulluan shumë ankesa prej të paraburgosurve të cilët nuk mund të merrnin nga të afërmit pajisje të tilla si TV dhe frigorifer në kushtet kur nuk kishin mundësit për t'i blerë ato përmes institucionit, pasi i kufizonte Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, nr. 3895, datë 09.04.2013, sipas të cilit në mjediset e banimit, lejohen vetëm pajisjet që blihen nga institucioni me një komision të posaçëm.

Mjediset e korridoreve, dhomat e takimit, ambientet e përbashkëta, banjat dhe kuzhina e institucionit ishin të pastra. Çdo sektor kishte nga 4 dushe por higjiena në to nuk ishte e mirë në momentin e inspektimit. Institucioni i lejonte të paraburgosurit të bënin dush një herë në javë (planifikuar me kalendar), por nga intervistat me të paraburgosurit dushet më shumë bëheshin në tualetet e dhomave dhe kjo u konstatua dhe gjatë inspektimit të dusheve sepse ato ishin të thata dhe mbanin erë të ndenjtur. Të paraburgosurit kanë bërë kërkesë që të shpeshtohet bërja e dusheve por kërkesa e tyre është refuzuar. Problematike për sa i përket higjienës paraqitej situata në dhomat e observimit. Ato e kishin tualetin e përbashkët, por nuk mundësohej bërja e dusheve duke bërë që të paraburgosurit që gjendeshin në këto ambiente të kalonin një periudhë deri në 10 ditë pa bërë dush.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar. Gjithsesi, në disa raste pati ankesa për mungesën e ujit të ngrohtë.

Gjatë dimrit ngrohja realizohej me kaldajë qendrore, ndërsa në verë nuk kishte mjete ventilimi që të plotësonin kërkesat e të gjithë institucionit.

Biblioteka ishte e pasur dhe ofronte larmi librash. Ajo ndodhej mes sektorëve A dhe B dhe shfrytëzohej nga të dy seksionet pavarësisht se këtu pati ankesa nga sektori A se ata nuk kishin të njëjtin akses si sektori B.

Nuk mungonin dhomat e besimit fetar të të dy besimeve. Këto salla ishin të pajisura shumë mirë dhe aty ofroheshin të gjitha ritet fetare për të paraburgosurit. Në raste festash fetare organizoheshin dhe aktivitete të mbështetura nga institucionet fetare.

Nga vizita në kuzhinën e IEVP-së u konstatua se ajo ishte e madhe dhe mjaft moderne. Në të ishte afishuar menyja ditore. Ushqimi i përgatitur nga kuzhinieri dhe ndihmës kuzhinieri ishte i pastër e i cilësisë së kënaqshme. Gramaturat dhe kaloritë ishin brenda standardeve. Kampionët e ushqimeve të gatuar një ditë më parë ruheshin në kushte frigoriferike. Një ambient i veçantë i brenda kuzhinës ishte dhe reparti i prodhimit të ëmbëlsirave i cili ishte mjaft modern dhe i pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme, por që nuk funksiononte për shkak të mungesës së fondeve për asortimentet e nevojshme.

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj., ishte i afishuar.

Mjediset e jashtme kishin hapësirë të kënaqshme dhe përdorshin për aktivitete sportive si futboll, basketboll etj. Madje vetë institucioni organizonte spartakiada të ndryshme mes ekipeve.

Në lidhje me ajrimin, përveç bisedës me të paraburgosurit, u kërkua informacion nga stafi dhe rezultoi se në sektorin A dhe B të paraburgosurit qëndronin 3 orë në ajrim, 2 orë paradite dhe 1 orë pasdite. Dy orët e paradites shfrytëzoheshin për aktivitete fizike, kryesisht futboll. Jo të gjithë të paraburgosurit bëjnë aktivitete në klasa. P.sh. në godinën A problemi qëndronte se klasat nuk ishin brenda në regjim si në godinën B. Aty ishte vetëm një sallë e vogël këshillimi në të cilën ishte e pamundur që të zhvilloheshin aktivitete me më shumë se 3 veta. Sipas të paraburgosurve ata kishin dëshirë të përfshiheshin në shumë aktivitete, por kjo nuk ndodhte për shkak se stafi i punonjësve nuk kishte klasa me hapësira të mjaftueshme në dispozicion.

Nga takimi me stafin e sektorit të kujdesit social u vu re një komunikim dhe bashkëpunim shumë i mirë. Ata informuan rreth aktiviteteve dhe programeve që zbatoheshin në institucion si dhe vunë në dispozicion dosjet psiko-sociale të të paraburgosurve. Stafi organizonte aktivitete të përbashkëta me të paraburgosurit, kryesisht diskutime në grup për tema sociale dhe aktivitete sportive, programe arti në pikturë, vizatim dhe krijime artistike me objekte të ndryshme. Në shumë nga ambientet e përbashkëta u vunë re muret e pikturuara, piktura dhe punime të cilat ishin varur në muret e sallave të aktiviteteve dhe bibliotekës. Për sa i përket dosjeve psiko-sociale, ato rezultojnë të plotësuar mirë me programet individuale të trajtimit për të paraburgosurit, me përmbledhjet nga takimet e fundit, me të dhëna mbi aktivitetet e zhvilluara në mënyrë individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

### ***Shërbimi Shëndetësor***

Organika e sektorit të shëndetësisë përbehej nga 4 ndihmësmjekë dhe një mjek me kohë të pjesshme.

Gjatë inspektimit në këtë institucion si dhe në bazë të intervistave me të paraburgosurit, u konstatua se shërbimi shëndetësor ishte relativisht i mirë dhe të paraburgosurit nuk kishin ankesa ndaj stafit.

Nga të gjithë personat që ndodheshin në këtë institucion vetëm 180 ishin të pajisur me librezë shëndetësore, ndërsa pjesa tjetër ishte në proces të plotësimit të dokumentacionit përkatës.

Megjithëse ekzistonte një kontratë trepalëshe për sigurimin e medikamenteve për të sëmurët kronikë, skema e rimbursimit të ilaçeve në këtë institucion nuk funksiononte, gjë që për rrjedhojë sillte mungesa të theksuara në medikamente, si ato të urgjencës ashtu dhe ato për të sëmurët kronik. Në shumicën e rasteve mjekimet merreshin privatisht nga familjarët.

Në ditën e inspektimit, nga stafi grupi inspektues u informua se në këtë institucion ndodheshin 28 të sëmurë kronikë, të cilët ishin diagnostikuar me: Diabet Mellitus, HTA Stadi i II-të, Astma Bronkiale, Psoriasis Vulgaris, Epilepsia. Këtu përfshiheshin edhe 8 të paraburgosur me çrregullime mendore të formave të Çrregullimeve Bipolare, të Ankthit si dhe Skizoafektive. Të sëmurët me probleme të shëndetit mendor mbaheshin në dhoma më vete në ato raste kur ishin problematikë dhe shfaqnin kriza, si p.sh. rasti i E. B dhoma nr.17 i cili mbahej në një dhomë më vete me mjekim të detyruar. Ndërsa persona abuzues me substancat narkotike ishin 20, por vetëm tre prej tyre merrnin Metadon.

Konsultat jashtë institucionit zhvilloheshin në bashkëpunim me poliklinikën dhe spitalin e rrethit pa pengesa apo vonesa.

Në dhomën e stomatologut mungonin të gjitha instrumentet dhe materialet dentare për ofrimin e një shërbimi sa më efikas.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash themeltar, regjistri për konsultat jashtë institucionit, si dhe regjistri i evidentimit të rasteve të dhunës. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermiereve, gjithashtu. Kartelat mjekësore mbaheshin të mbyllura me çelës, ato plotësoheshin me rregull.

Nga inspektimet brenda në dhoma (dhoma 22, kati II) u kontaktua dhe një i sëmur me gurë në veshka i cili para se të fillohej inspektimi ishte dërguar në spitalin e Elbasanit për të marrë ndihmën e nevojshme mjekësore. Në momentin që i paraburgosuri u kontaktua ishte më i qetë, kishte marrë shërbimin e nevojshëm si dhe recetën me mjekime të cilat do t'ia sillte mjeku në dhomë. Për momentin gjendja e tij ishte e mirë dhe vetë ai pohoi se kujdesi shëndetësor nuk i kishte munguar dhe i ishte dhënë në momentin e duhur.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në IEVP-në Elbasan dhe respektimin e hapësirës personale.
2. Marrja e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve në dhomat e observim/ veçimit.
3. Marrja e masave për krijimin e mjediseve të punës për punonjësit e sektorit të kujdesit social brenda në regjim për Godinën A.
4. Marrja e masave urgjente për shtimin në organikë e mjekut me kohë të plotë në sektorin shëndetësor.
5. Marrja e masave për pajisjen e të gjithë të paraburgosurve me librezë shëndetësore, duke përsheptuar procedurën e plotësimit me dokumente përkatëse edhe në rastet e transferimeve nga një IEVP në tjetrën.

6. Marrja e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve.
7. Marrja e masave të menjëhershme për furnizimin e dhomës së stomatologut me instrumente dhe materialet dentare.
8. Marrja e masave për pajisjen/ përmirësimin e cilësisë së rrobave të fjetjes si çarçafëve, jastëkëve dhe batanijeve për të gjithë të paraburgosurit.
9. Marrja e masave për vënien në përdorim të lavanderisë për larjen e ndërresave dhe teshave të tjera të të paraburgosurve.
10. Marrja e masave për njohjen e ditëve të uljes së dënimit për të ata që punësohen brenda institucionit.
11. Marrja e masave për akomodimin e të paraburgosurve me probleme të shëndetit mendor në një seksion të veçantë.
12. Marrja e masave për respektimin e procedurës për komisionet disiplinore, procedurë që kërkon pajisjen e të paraburgosurit me një kopje të vendimit të komisionit si dhe informimin e tij për mundësinë e ankimit te drejtori i institucionit dhe/ ose në gjykatë.
13. Marrja e masave për mbajtjen hapur të dhomës së aktiviteteve jo vetëm gjatë orarit të paradites, por edhe për aktivitete pasdite.
14. Marrja e masave për pajisjen e dhomave të veçimit me mjetet e nevojshme si dhe ofrimin e shërbimit në këto dhoma në mënyrë dinjitoze.
15. Marrja e masave për krijimin e mundësisë për vënien në funksionim të pjesës së Kuzhinës së programuar për përgatitjen e ëmbëlsirave si një mundësi programi dhe formimi profesional për të paraburgosurit.

### **5.13. IEVP “Jordan Misja” Tiranë - Datë 30.06.2014 / Nr. Dok. 201401356**

#### ***Shënime paraprake***

IEVP Jordan Misja është ndërtuar si godinë në vitin 1929. Në vitin 1955 me urdhër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku burgjet u emëruan reparte, burgu i Tiranës “Jordan Misja” u quajt reparti 313. Në nëntor të vitit 1967, godina e vjetër e burgut u mbyll dhe në vitin 1999 të arrestuarit dhe të dënuarit u vendosën në godinën në të cilën ndodhet burgu në ditët e sotme. Godina ekzistuese ka një kapacitet për 320 persona. Sipas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, ky institucion është paraburgim i kategorizuar i sigurisë së lartë e i ndarë në tre sektorë për burra, gra dhe të mitur.

Në ditën e inspektimit, në IEVP “Jordan Misja” ndodheshin 543 të dënuar e të paraburgosur, me një mbipopullim prej 223 personash. Grupi monitorues në përputhje me metodologjinë e punës, mori fillimisht kontakt me stafin drejtues, stafin mjekësor dhe atë të kujdesit social. Paraprakisht, nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve ju bë e ditur se, në aspektin material, pjesërisht, infrastruktura e institucionit ishte e vjetruar e vazhdonte të mbetej e tillë edhe pas rikonstruktiveve të vazhdueshme.

## ***Trajtimi***

Grupi monitorues u fokusua në evidentimin dhe vlerësimin e fakteve të mbledhura nga dëshmitë të të paraburgosurve gjatë kontakteve personale e kolektive në privatësi të plotë, nga bisedat e zhvilluara me vetë punonjës të institucionit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës lidhur me aspekte të përdorimit të forcës apo keqtrajtimi fizik e psikologjik, marrjen e masave disiplinore me veçim nga aktivitetet e përbashkëta, etj. Përgjithësisht nga të paraburgosurit u pohua raporti i mirë që ekzistonte ndërmjet tyre dhe forcave të ruajtjes së sigurisë në institucion, Prej tyre u mohuan rastet e keqtrajtimit apo të ushtrimit të dhunës nga ana e stafit të punonjësve të sigurisë.

## ***Masat mbrojtëse***

Nga monitorimi i dokumentacionit të të paraburgosurve në institucion, u vërejt se gjithçka ishte plotësuar konform kërkesave të ligjit. Sipas dokumentacionit, të paraburgosurit pritës, kalonin në Komisionin e Pritjes dhe më pas mbaheshin në observim.

Komisioni i masave disiplinore për të paraburgosurit në institucion funksiononte rregullisht. Në ditën e monitorimit u konstatua vetëm një i paraburgosur, i cili vuante masën disiplinore të veçimit për 20 ditë. I paraburgosuri E.P. i cili qëndronte në dhomën e veçimit, nuk kishte asnjë kopje të vendimit të komisionit disiplinor për masën e dhënë. Për më tepër, dhoma e veçimit nuk ishte e pajisur me sendet e duhura të akomodimit ndaj i paraburgosuri e hante ushqimin në tokë, gjë kjo që përbën trajtim degradues e çnjerëzor. Pas bisedës me të paraburgosurin dhe pas leximit të raportit të shërbimit për ngjarjen, grupi monitorues vlerësoi se masa e dhënë nuk ishte në përpjesëtim me shkeljen e kryer.

Nga vizita brenda në regjim u konstatua se nuk ishte krijuar ende nuk një sektor i veçantë për të paraburgosurit e rinj (18-21 vjeçarë), por këta të fundit bashkëjetonin në dhoma dhe kryenin aktivitetet e përbashkëta me të paraburgosurit e tjerë madhorë, sikurse shpreheshin në shumicën e rasteve me pëlqimin apo me kërkesën e tyre.

Në të gjitha seksionet mungonin kutitë e ankesave/ kërkesave dhe të paraburgosurit ua dorëzonin ankesat/ kërkesat edukatorëve të cilët administronin regjistrin e kërkesë/ ankesave të institucionit.

## ***Kushtet materiale***

Nga grupi i monitorimit u monitorua edhe aspekti i respektimit të standardeve normale të jetesës. Të paraburgosurit u pyetën mbi respektimin e këtyre kushteve, si dhe u vëzhguara në terren cilësia dhe standardi i tyre.

Në institucion kishte mbipopullim të tejskajshëm. Kjo sillte shkeljen e standardit të sipërfaqes së banimit për banor në dhomë banimi, ku shumica e të paraburgosurve banonin në më pak se 3m<sup>2</sup>. Më kritike ishte situata në dhomat me sipërfaqe 8.8m<sup>2</sup> ku akomodoheshin 8 persona dhe sipërfaqja për banor ishte 1.1m<sup>2</sup> për person.

Grupi monitorues, gjatë vizitës së tij, konstatoi raste të shumta kur të paraburgosurit nuk kishin shtretër dhe për pasojë flinin përtokë. Përgjithësisht dritaret e dhomave ishin nën përmasat minimale të standardit të vendosur me akt normativ për ndriçim dhe ajrim të mjaftueshëm. Nga ekspertët u konstatua se qelitë ishin pa banja brenda. Në qeli u konstatua mungesa e lavamanëve.

Banjat ishin të përbashkëta e në të njëjtin ambient me dushet e në kushte tejet të amortizuara. Në to nuk sigurohej privatësia, pasi si dushet, ashtu edhe banjat ishin pa dyer ndarëse. Dushet realizoheshin sipas një grafiku, që duhej t'i mundësonte çdo të paraburgosuri të drejtën për të bërë dush 2 herë në javë. Në realitet, për shkak të amortizimit të dusheve, nga të paraburgosurit ekspertët u bënë me dije se ky standard nuk kishte mundësi të respektohej.

Në dhomën e observimit dhe veçimit mungonin tavolinat dhe karriget, ndaj të paraburgosurit e konsumonin ushqimin në krevat ose në këmbë.

Përsa i përket furnizimit të të paraburgosurve me produkte të higjienës personale dhe të asaj të përbashkët, ekspertët u informuan nga vetë të paraburgosurit, por dhe u konstatuan nga monitorimi se, mungonin qeset e plehrave, detergjentet larës, shampot, pastat e dhëmbëve, etj., Sipas të paraburgosurve këto produkte mundësoheshin nga familjarët.

Ushqimi shërbehej në 3 vakte, në orare të caktuara. Kuzhina ishte konform kërkesave ligjore për sa i përket dokumentacionit dhe ruajtjes së kampioneve dhe kushteve higjienike. Në kohën e monitorimit po përgatitej dreka e cila rezultoi të ishte e cilësisë së kënaqshme.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Orari i veprimeve në të gjithë institucionin ishte i njëjtë, që do të thotë se të dënuarit në seksionin e të paraburgosurve burra, sektori i të paraburgosurve gra, seksionit të paraburgimit për të miturit dhe seksionit të vëzhgimit i nënshtroheshin të njëjtit regjim.

Nga kontakti i ekspertëve me të paraburgosurit u konstatua se si takimet me familjarët ashtu edhe telefonatat respektoheshin konform kërkesave të legjisllacionit. Nuk pati ankesa për regjimin e telefonatave dhe të takimeve. Grupi monitorues monitoroi edhe vendin e takimit me familjarët, i cili ishte i ndarë në dy pjesë, ku nga njëra anë hynin familjarët dhe nga ana tjetër rrinin të paraburgosurit. Këto dy pjesë ishin të ndara me zgarë hekuri dhe xham dhe të dyja anët ishin të pajisura me stola për t'u ulur. Ambienti ishte i papërshtatshëm për takim me familjarë të mitur.

Nga ana e institucionit ofrohej punësimi i të paraburgosurve në institucion, në kushte të kufizuara, sipas listës së punësimit të miratuar nga DPBSH. Një fakt i konstatuar nga ekspertët ishte se të paraburgosurit e punësuar nuk paguheshin për punën që bënin, si dhe nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe librezë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pra për pasojë ata nuk përfitonin kontributin shoqëror e shëndetësor. Ato trajtoheshin vetëm me ulje dënimi, në rast se ata do të merrnin dënim. Në dispozicion të grupit monitorues u vu lista e personave të punësuar, prej ku u verifikuan emrat e të paraburgosurve që ishin të punësuar, por që nuk ishin në dijeni nëse rezultonin si të tillë. Të paraburgosurit e punësuar nuk firmosnin për ditët e tyre të punës dhe nuk kishin dijeni mbi përfitimet e tyre. Të tjerë të paraburgosur nuk kishin dijeni mbi mënyrën se si mund të përfshiheshin në organikën e punës.

Nga takimi me stafin e sektorit të kujdesit social grupi monitorues u informua për aktivitetet dhe programet që zbatoheshin në institucion si dhe u shqyrtuan me zgjedhje disa dosje psiko-sociale të të paraburgosurve të mitur. Aktivitetet e përbashkëta me të paraburgosurit konsistonin kryesisht në diskutime në grup për tema sociale si dhe në aktivitete sportive. Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale, u vu re se dosjet ishin të plota me informacion të përgjithshëm dhe në rastet e gjykuara të përshtatshme edhe me programe individuale trajtimi. Vijonin të mos përdreshin testet diagnostikuese. Dosjet psiko-sociale të të miturve ishin të plotësuara në kohën e pritjes së të miturit, por kërkonin rifreskim me përmbledhje nga çdo takim me të paraburgosurit.

### **Sektori i burrave**

Në sektorin IV të të paraburgosurve burra u konstatuan ankesa mbi bashkëjetesën me të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor gjë që sillte probleme sa i përket qetësisë dhe mirëkuptimit në dhoma. Të paraburgosurit u ankuan edhe për mungesën e ujit, mbipopullimin dhe fjetjen me dyshekë në tokë, dhe ndarjen me hekura në dhomat e takimit me familjarët. Gjithashtu ata u ankuan se ajrosjen e bënin vetëm 3 herë në javë me nga 1 orë në ditë. Mbi çështjen e ajrimit grupi i ekspertëve kërkoi informacion nga stafi dhe rezultoi se pretendimet ishin të bazuara. Ndërkohë, në dhomën e veçimit ndodhej prej 7 ditësh me masë disiplinore i paraburgosuri E.P., i cili nuk ishte nxjerrë asnjëherë në ajrim. Theksojmë se ajrimi është e drejtë e rëndësishme që garantohet nga Ligji Nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 ‘Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim’”, i ndryshuar, dhe që duhet të sigurohet në çdo rast.

### **Sektori i grave**

Gjatë vizitës monitoruese, grupi i ekspertëve konstatoi amortizim të theksuar të të gjithë ambienteve të këtij sektori, me një mbipopullim i cili cenonte standardin për hapësirën jetike. Fillimisht grupi inspektues vizitoi dhomën e aktiviteteve e cila shërbente si bibliotekë, si dhomë këshillimi individuale ose në grup. Ajo gjithashtu shfrytëzohej për zhvillimin e kurseve informate të trajnimit për rrobaqepësi, parukeri, pikturë etj.

Aktualisht në këtë sektor ndodheshin 42 gra. Dhomat ishin të ftohta e me lagështirë, me një ndriçim natyral të pa mjaftueshëm. Në çdo dhomë ishin të akomoduar nga 4, 5, 7 gra në një hapësirë 2mx3m, ku në shumicën e rasteve flinin dy veta në një krevat.

Në këtë sektor kishte shumë ankesa jo vetëm për kushtet fizike dhe materiale, por edhe për një shërbim shumë të dobët kuzhine. Kushtet e banjave dhe dusheve ishin tejet të amortizuara me probleme në furnizimin me ujë.

Në të gjithë ambientet e këtij seksioni mungonin kutitë e ankesave/ kërkesave dhe të dënuarat ua dorëzonin ankesat/ kërkesat edukatorëve të cilët administronin regjistrin e kërkesë/ ankesave të institucionit. Po ashtu, mungonin edhe posterat për të drejtat dhe liritë e njeriut.

## **Sektori i të miturve**

Nga vizita në sektorin e të paraburgosurve të mitur, rezultoi se korridori dhe mjediset e përbashkëta ishin të pastra, por dhomat e të miturve ishin të pajisura në disa raste shumë varfër dhe dyshekët ishin të papërshtatshëm si dhe kishte të mitur që nuk kishin çarçafë për fjetje. Ankesat e të miturve ishin kryesisht mbi kohëzgjatjen e qëndrimit në arrest me burg, gjë që vinte si rrjedhim i vonesave në procesin e hetimit, edhe për akuza për vepra jo të dhunshme.

Gjatë vizitës monitoruese, disa prej të miturve qëndronin në dhomat e tyre, disa ishin në takim në bibliotekë me punonjësen sociale, ndërsa një dhomë ishte e mbyllur nga punonjësit e sigurisë me justifikimin se ata ishin përfshirë në një zënkë me të miturit e një dhome tjetër, ditën e shtunë (28 Qershor 2014, ora 13.30). Të miturit e përfshirë në këtë zënkë prisnin të dilnin në komision disiplinor, por deri në orën 14.00 të ditës së hënë, komisioni disiplinor nuk ishte mbledhur akoma.

Dhoma e aktiviteteve të përbashkëta dhe e TV ishte e mbyllur në orarin e vizitës monitoruese 09.00-13.00.

## ***Shërbimet shëndetësore***

Organika e këtij sektori përbëhej nga një mjeke, një stomatolog, një farmacist, dhe ndihmës mjekë. Nga stafi i këtij sektori, trajtoheshin 53 të sëmurë kronikë, 12 të sëmurë mendorë, dhe 6 abuzues me substanca narkotike.

Nga bisedat me të dënuarat, grupi inspektues konstatoi se në këtë institucion ofrohej një shërbim shëndetësor përgjithësisht i mirë, i cili kishte mangësi për shkak të mbipopullimit, duke sjellë vonesa në kryerjen e vizitave apo të konsultave të domosdoshme nga specialistët në spital. Gjatë monitorimit u konstatuan shumë ankesa rreth mungesës së medikamenteve si për raste urgjente ashtu edhe për sëmundje kronike.

Ky institucion ishte i pajisur me autoambulancë, e cila ishte në funksion të plotë. Dhoma e mjekut ku kryheshin vizitat megjithëse ishte e amortizuar ishte e mbajtur e pastër e me rregull. Farmacia ishte e pastër dhe e kompletuar me medikamente, megjithëse nga të dënuarit e këtij institucioni morëm shumë ankesa në lidhje me ofrimin medikamenteve sipas skemës së rimbursimit të ilaçeve. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me unit, autoklavë, por mungonin instrumente e materiale dentare duke ofruar një shërbim të cunguar dentar, vetëm me ekstraksione.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri vizitash, themeltar i të sëmurëve kronike, regjistri për konsultat jashtë institucionit. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermiereve, gjithashtu. Kartelat mjekësore ishin të plotësuara në mënyrë korrekte, por nuk mbaheshin të mbyllura me çelës. Të gjithë të dënuarit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Një pjesë e vogël që ishin transferuar nga I EVP-të e tjera, prisnin plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me to.



Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për mbylljen e këtij paraburgimi, si i papërshtatshëm me standardet e trajtimit të paraburgosurve të parashikuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. Marrja e masave të menjëhershme për të ulur mbipopullimin në institucion duke i garantuar të gjithë të paraburgosurve nga një krevat dhe hapësirën jetike të parashikuar në ligj.
3. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin real të kushteve materiale në dhoma, banja dhe ambiente të përbashkëta për të paraburgosurit.
4. Marrja e masave për t'u siguruar të paraburgosurve produktet e nevojshme për mbajtjen e higjienës në përputhje me standardet ligjore.
5. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e dhomave të observimit/ veçimit me orenditë e nevojshme me qëllim respektimin e dinjitetit të të paraburgosurve.
6. Marrja e masave për të përshtatur ambientet rekreative e për të aktivizuar kurset profesionale e arsimore.
7. Marrja e masave për shtimin e numrit të konsultave të kryera nga mjeku psikiatër në përputhje me kërkesat e ligjit për shëndetin mendor.
8. Marrja e masave për rregullimin e menaxhimit të procesit të kërkesë/ ankesave, vendosjen e kutive në seksione dhe përcaktimin e një procedure për nxjerrjen e kërkesë/ ankesave nga seksionet, regjistrimin e tyre në regjistër dhe menaxhimin e kthimit të përgjigjeve apo zgjidhjes së tyre brenda afateve të përcaktuara në ligj.
9. Marrja e masave akomodimin e të paraburgosurve me probleme të shëndetit mendor në një seksion të veçantë.
10. Marrja e masave për garantimin e të drejtës së të paraburgosurve për të pasur ajrim dhe aktivitete sportive në terren sipas parametrave ligjore çdo ditë, si dhe zbatimin e kësaj të drejte dhe për të paraburgosurit me masa disiplinore.
11. Marrja e masave për respektimin e procedurës për komisionet disiplinore, procedurë që kërkon pajisjen e të paraburgosurit me një kopje të vendimit të komisionit si dhe informimin e tij për mundësinë e ankimit te drejtori i institucionit dhe/ ose në gjykatë.
12. Marrja e masave për nxjerrjen sa më të shpejtë të të paraburgosurve në komision disiplinor, me përparësi të miturit.
13. Marrjen e masave për të siguruar akses në dhomën e aktiviteteve ku ndodhet TV për të miturit që nuk kanë TV në dhoma, jo vetëm gjatë orarit të paradites, por edhe për aktivitete pasdite.
14. Marrja e masave për sigurimin e higjienës në dhomat e veçimit, pajisjen e tyre me tavolina dhe stola dhe ofrimin e shërbimeve për këto dhoma në mënyrë dinjitoze.
15. Marrja e masave urgjente për shtimin në organike e të paktën dy mjekteve në sektorin shëndetësor.
16. Marrja e masave të menjëhershme për furnizimin me medikamente të farmacisë së spitalit duke vënë në zbatim skemën e rimbursimit të ilaçeve.
17. Marrja e masave të menjëhershme për rivlerësim të diagnozës dhe mjekimit të të paraburgosurve me sëmundje kronike dhe të dënuarve me probleme të shëndetit mendor.
18. Marrja e masave për pajisjen e të gjithë të paraburgosurve me librezë shëndetësore, duke përshpejtuar procedurën e plotësimit me dokumentet përkatëse në rastet e transferimeve nga një IEVP në tjetrën.

19. Marrja e masave të menjëhershme për furnizimin e shërbimit stomatologjik me instrumente e materiale dentare.

#### **5.14. I EVP Durrës - Datë 31.07.2014 / Nr. Dok. 201401463**

##### ***Shënime paraprake***

Avokati i Popullit, në përmbushje të kompetencave kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij, pasi u njoh përmes medias më datë 31/ 07/ 2014 mbi tentativën për vetëlëndim të një paraburgosuri të I EVP Durrës, të ndodhur nën shoqërimin e grupit të sigurisë së I EVP Durrës në ora 10.30 në ambientet e Gjykatës së Rrethit Durrës, ngarkoi një grup pune për hetim administrativ të ngjarjes.

Në përputhje me metodologjinë e vizitës fakt mbledhëse dhe procedurave hetimore, grupi i punës kreu fillimisht një vizitë në Spitalin Rajonal Durrës, ku kontaktoi me Shefin e Shërbimit të Urgjencës, i cili ofroi një informacion të përgjithshëm për rastin. Të dhënat më të detajuara u pasqyruan nga mjeku i Urgjencës së Spitalit. Në bazë të informacionit të marrë nga ky i fundit, si dhe në bazë të fletë-observacionit të plotësuar prej tij, rezultonte se i paraburgosuri A.P., ishte sjellë në urgjencën e spitalit në orën 10.45 i shoqëruar nga stafi i sigurisë së I EVP-Durrës. Gjatë vizitës së përgjithshme ishte dalë në përfundimin se i dënuari kishte marrë tre tableta metforminë (doza ditore e kurës që i dënuari merrte për diabetin) të cilat i ishin dhënë nga stafi mjekësor i I EVP-së. Nga ekzaminimi dhe analizat që i ishin bërë në Spitalin e Durrësit, i paraburgosuri rezultoi me të gjithë parametrat vital në normë: puls, TA, frekuencë kardiake normal. Megjithatë, mjeku i urgjencës kishte gjykuar që për një vlerësim më të specializuar mbi mundësinë e një intoksikacioni, i dënuari të dërgohej në repartin e toksikologjisë pranë Qendrës Spitalore të Burgjeve, Tiranë.

Mbas administrimit të kartelës mjekësore dhe dokumenteve relevantë pranë këtij institucioni, grupi i punës vijoi me vizitën në I EVP Durrës, ku kontaktoi me stafin e sektorit shëndetësor dhe atij psiko-social. Në bazë të gjithë të dhënave dhe dokumentacionit përkatës rezultoi se i paraburgosuri kishte bërë edhe dy tentativa të tjera suicidale, të cilat sipas vlerësimit të stafit psiko-social dhe mjekes psikiatre të institucionit, kishin qenë demonstrative dhe në terren të një ngarkese emocionale të të dënuarit për shkak të problemeve familjare, sociale dhe ekonomike. Për sa i përket tentativës së fundit, të paraburgosurit i ishte dhënë terapia ditore nga stafi i sektorit të shëndetësisë për ta administruar vetë, pasi kishte një seancë gjyqësore. Sipas punonjësve të sektorit psiko-social dhe atij shëndetësor, ai e ka përdorur këtë dozë për të simuluar vetëhelmimin, në mënyrë që të tërhiqte vëmendjen e opinionit publik lidhur me pakënaqësitë e tij me sistemin gjyqësor, i cili në seancën gjyqësore të asaj dite i rikonfirmoi masën e sigurisë me burg.

Në vazhdim të verifikimeve të bëra, grupi hetimor, administroi kopje të raporteve të shërbimit të rasteve të tjera të tentativës së vetëvrasjes nga ana e të paraburgosurit A.P., të dosjes psiko-sociale, kopje të librit të lëvizjeve të të dënuarve dhe të paraburgosurve nga regjimi.

Në vijim, grupi hetimor kreu dhe një vizitë në QSB, ku mori kontakt dhe informacion me shkrim nga ana e mjekes psikiatre në shërbim. Sipas saj, i paraburgosuri ishte sjellë në këtë institucion me rekomandim nga mjeku i Urgjencës së Durrësit me diagnozën: Intoksikacion multimedikamentoz. Që në momentin e parë të mbërritjes në QSB, i paraburgosuri ishte konsultuar nga mjeku toksikolog dhe mjeku psikiatër. Në përfundim të të gjitha analizave dhe ekzaminimeve ishte konstatuar se mungonin elementet toksikë dhe parametrat e rëndësishëm vital ishin në normë. Ndonëse gjendja e përgjithshme fizike dhe mendore e të paraburgosurit ishte e mirë, ishte vendosur që ai të mbahej për observim pranë QSB.

Më pas grupi hetimor zhvilloi një takim me të paraburgosurin në ambientet e observimit. Gjatë bisedës me të u konstatua se gjendja e tij ishte e mirë. Ai deklaroi se akti i tij nuk kishte të bënte me keqtrajtim apo trajtim degradues në IEVP Durrës, por me pakënaqësinë ndaj vendimit gjyqësor për ri konfirmimin e masës së sigurisë qëndrim në burg. Gjithashtu, ai shprehte shqetësimin e tij për gjendjen shëndetësore të gruas të shtruar në Spitalin e Durrësit.

Nisur nga verifikimet në terren, dokumentacionit të administruar dhe konstatimet se i paraburgosuri A.P., kishte manifestuar luhajte të humorit, me ngarkesë emocionale të shprehur në formën e tentativës për vetëlëndim, në rrethana, kohë dhe vende të ndryshme duke rrezikuar sigurinë e jetës së tij dhe duke krijuar probleme të sigurisë në këtë institucion, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për vlerësimin e gjendjes psiko-emocionale të të paraburgosurit, statusit të tij mendor dhe ndërhyrjet përkatëse terapeutike, duke u mbajtur në observim të vazhdueshëm nga stafi psiko-social dhe sektori shëndetësor, në mënyrë që të parandalohet përsëritja e rasteve të tilla.
2. Marrja e masave të menjëhershme për administrimin nga ana e stafit të sektorit shëndetësor të medikamenteve për të paraburgosurit nën mjekim, duke u dhënë dozat ditore të ndara sipas rekomandimit të mjekes dhe gjithmonë nën mbikëqyrjen e ndihmësmjekut në turnin e shërbimit, duke asistuar deri në konsumimin e plotë të tij.

#### **5.15. IEVP Durrës - Datë 29.09.2014 / Nr. Dok.201401740**

##### ***Shënime paraprake***

IEVP Durrës është një institucion paraburgimi me kapacitet maksimal zyrtar prej 300 personash, i cili ka një sektor të kujdesit të veçantë kapacitet 50 personash ku mbahen persona me probleme të shëndetit mendor. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 384 persona. Mbipopullimi ishte problematikë e pranishme me 84 të paraburgosur mbi kapacitetin zyrtar.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni.

Nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve iu bë me dije se IEVP Durrës në vizitës së grupit të inspektimit, në sektorin e kujdesit të veçantë kishte të akomoduar 29 të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor në katin e parë dhe 21 të paraburgosur në katin e dytë, të cilët akomodoheshin në këtë sektor për shkak të mbipopullimit.

Në institucion nuk kishte seksion të veçantë për të miturit, apo për të paraburgosurit e grup-moshës 18-21 vjeçare, pavarësisht se në momentin e inspektimit, akomodoheshin 52 të paraburgosur të kësaj kategorie. Gjithashtu, nga ana e drejtuesit të institucionit, grupi inspektues u informua se problematika e amortizimit e të gjithë godinës, e ujit të rrjedhshëm që vijonte të ishte me orar, si dhe mungesa e fondeve për këtë drejtim, vijonte të ishte e pranishme.

Dhomat e observim/ veçimit, të vendosura në katin e parë të godinës gjendeshin në kushte mjaft të këqija. Gjithsej ishin 4 dhoma observim/ veçimi, dy prej të cilave ishin kthyer në tualete për shkak të mbipopullimit. Në ditën e inspektimit në njërin nga dhomat ishte një i veçuar me masë disiplinore. Nga vëzhgimi i regjistrave të masave disiplinore rezultonte se po atë ditë në datë 29/ 9/ 2014 me masë disiplinore ishin 3 të paraburgosur, por asnjëri prej tyre nuk dispononte një kopje të masës së marrë disiplinore.

Në këtë institucion gjendeshin 21 të paraburgosur të punësuar si pastrues, shpërndarës ushqimi, në bibliotekë etj.

### ***Trajtimi***

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të paraburgosurve, në identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të burgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Në IEVP Durrës, në momentin e inspektimit, pati ankesa nga ana e të dënuarave lidhur me çmimet e larta në dyqanin e institucionit, veçanërisht për çmimet e kartave të telefonit, si dhe me mungesën e medikamenteve. Ankesa kishte edhe lidhur me ushqimin, si në drejtim të cilësisë së gatimit, ashtu edhe në drejtim të larmisë së vakteve dhe pastërtisë gjatë shpërndarjes së ushqimit.

### ***Masat mbrojtëse.***

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Mjekja bënte pjesë në Komisionin e Pritjes. Në Komisionin Disiplinor ajo ishte vëzhguese pa të drejtë vote.

Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të regjimit, u konstatua se kishte një mjedis të veçantë për takimet e të paraburgosurve me familjarët, i cili kishte 7 ndarje me xham për të akomoduar palët në takim. Aty kishte edhe dy sportele të kontrollit të ushqimit. Edhe në këtë IEVP, grupi i monitorimit vuri në dukje problematikën e mospasjes së një mjedisi të posaçëm për takimet me të miturit. Takimet me familjarët bëheshin një herë në javë.

Ekzistonte sistemi i kërkesë/ ankesave dhe kutitë përkatëse në regjim për depozitimin e tyre. Pavarësisht këtyre të fundit, të paraburgosurit ia dorëzonin kërkesë/ ankesat punonjësit të edukimit, i cili ia kalonte shefit të sigurisë. Ky i fundit ia dorëzonte drejtorit të institucionit, i cili bënte shpërndarjen e tyre. Grupi i inspektimit u informua nga drejtori i institucionit se kërkesë/ ankesat e të paraburgosurve, përgjithësisht gjenin zgjidhje brenda 24 orëve. Grupi i inspektimit vuri re se një sistem i tillë nuk plotëson kriteret e urdhrin të DPB, ku orientohet qartë se administrimi i kutive duhet të bëhet nga sektori i edukimit.

Të gjithë të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit, por çmimi i këtyre të fundit ishte shumë i lartë krahasimisht me jashtë institucionit.

Sa i përket çështjes së sigurisë, IEVP Durrës ishte e pajisur me kamera sigurie, si në mjediset e jashtme, ashtu edhe në ato të brendshmet, përfshirë këtu edhe korridoret e dhomave të veçim/ observimit.

### ***Kushtet materiale***

Ashtu siç u konfirmua nga Drejtuesi i institucionit dhe siç është konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, mjedisi në regjim, vijonte të ishte i amortizuar dhe me lagështirë.

Dhomat e banimit akomodonin nga 4, 6 ose 7 persona, por jo të gjitha dhomat respektonin standardin e hapësirës jetike për person. Nëpër dhoma, kryesisht në katin e parë, kishte rreth 6 persona në dhomë, 3 prej të cilëve flinin në krevate dhe 3 të tjerë në dysheme si rrjedhojë kjo e mbipopullimit, i cili shprehej qartë në katin e parë të regjimit, ku pothuajse të gjitha dhomat e aktiviteteve të përbashkëta, si dhoma e riteve të krishtera, dhoma e këshillimit, etj., ishin kthyer në mjedise banimi. Rrjedhimisht, ato nuk kishin tualet të brendshëm, dhe të paraburgosurit përdornin tualetet e përbashkëta, përfshirë këtu edhe dy tualetet e improvizuara të dhomave të observim/ veçimit. Në përgjithësi, dhomat kishin dritë natyrale mjaftueshëm dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, pavarësisht se jo në çdo dhomë. Mungesa e dritareve në disa prej dhomave në regjim përbën një problematikë të qenësishme, veçanërisht me afrimin e stinës së dimrit. Në mjediset e banimit u konstatua prani e insekteve dhe në mjediset jashtë dhomave të observim/ veçimit, grupi i inspektimit u përball me praninë e brejtësve.

Tualetet e përbashkëta ishin jashtë çdo standardi, në kushte shumë të këqija higjiëno-sanitare, gjë që vihej re edhe nga era e rëndë në të gjithë korridorin e katit të parë. Për të gjithë katin e parë kishte vetëm dy tualete të cilat nuk kishin as dush, as lavaman, as ujë të rrjedhshëm dhe vetëm dy banja në kushte të mjerueshme dhe pa aksesor përshtatës për shkarkimin e ujit.

Në dhomat e observim/ veçimit mungonin dritaret, nuk kishte as ujë të rrjedhshëm për kryerjen e nevojave personale.

Në përgjithësi, në të gjitha intervistat e kryera, grupi i inspektimit u njoh me pretendimin se të gjitha shtrojat ishin marrë nga familjarët dhe se në rastet kur ishin të institucionit ishin shumë të vjetra dhe të amortizuara. Grupi i inspektimit konstatoi se kishte mungesa të theksuara në

furnizimin e të paraburgosurve me shtroje, mjete të tjera të higjienës personale dhe asaj të përbashkët dhe se të paraburgosurit furnizoheshin nga familjarët.

IEVP Durrës ka edhe një Sektor të Veçantë për trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor. Ky sektor me kapacitet prej 50 personash ishte i shpërndarë në dy kate. Në katin e parë kishte 8 dhoma ku, në ditën e inspektimit, akomodoheshin 29 të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor, ndërsa në katin e dytë kishte 11 dhoma, në të cilat akomodoheshin 21 të paraburgosur, të cilët nuk kishin probleme shëndetësore. Dhomat e këtij sektori ishin të gjitha të pajisura me tualet brenda, kurse dushet ishin të përbashkëta: 7 në katin e parë të gjitha funksionale dhe 7 në katin e dytë ku 4 ishin funksionale dhe 3 jofunksionale. Në këtë sektor nuk ndjehej as mbipopullimi e as mungesa e kushteve hijeno-sanitare. Mjediset këtu bënin një kontrast të dukshëm nga mjediset e tjera në regjim si në drejtim të mirëmbajtjes, ajrimit ndriçimit, ashtu edhe të mbipopullimit.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte me kufizime oraresh. Pavarësisht se nga drejtuesi i institucionit, grupi i inspektimit u informua se kishte depozita për ujë, ato duhej të mirëmbaheshin dhe, siç edhe u konstatua brenda në regjim, furnizimi me ujë të rrjedhshëm vijonte të ishte problematik. Po kaq problematike ishte edhe çështja e ujit të pijshëm, i cili vijonte të blihej nga të paraburgosurit, pasi uji i çezmës nuk ishte i pijshëm. Në katin e parë kishte 2 dy dushe, bojlerët e të cilave përbënin rrezik për jetën e të paraburgosurve, pasi instalimet elektrike të automateve të tyre ishin krejtësisht të ekspozuara. Lagështira ishte e pranishme edhe në 7 postet e tjera të dusheve, të cilat ishin plotësisht funksionale. Një faktor madhor mjaft shqetësues ishte mungesa e ujit të ngrohtë nëpër dhoma apo edhe në dushet e përbashkëta. Për këtë arsye të paraburgosurit ishin detyruar që ujin ta ngrohnin me rezistenca primitive.

Në institucion nuk kishte sistem qendror ngrohjeje. Rrjedhimisht, gjatë dimrit, ngrohja bëhej me mjete rrethore nga ana e të paraburgosurve.

Grupi i monitorimit konstatoi se kishte një mjedis të jashtëm, i cili përdorej për ajrim. Siç është përmendur edhe më lartë, mjediset e përbashkëta në katin e parë ishin kthyer në mjedise banimi, rrjedhimisht, kurset apo/ dhe aktivitetet në momentin e inspektimit nuk zhvilloheshin.

Biblioteka ndodhej në katin e parë të godinës. Ajo ishte një mjedis i vogël, relativisht i pastër, me një numri të varfër titujsh. Sipas stafit psiko-social e frekuentonin rreth 97 të paraburgosur nga të cilët 20 ishin të grup moshës 18-21 vjeç, ndërsa përballë saj ndodhej një dhomë tjetër e cila shërbente si dhomë këshillimi, por shfrytëzohej edhe për kurse të anglishtes dhe italishtes.

Grupi i inspektimit vuri re se kuzhina e IEVP Durrës ishte relativisht e pastër dhe e rregullt. Menyja e përditshme ishte e afishuar dhe gramaturat e afishuara në përputhje me rregulloren. Megjithatë, grupi i inspektimit tërhoqi vëmendjen për ruajtjen e kampionëve ushqimorë, të cilët nuk ruheshin në mjedis frigoriferik. Në kuzhinë kishte të paraburgosur të punësuar që merreshin kryesisht me pastrimin dhe shpërndarjen e ushqimit. Kjo e fundit, nuk kryhej me doreza.

Grupi i inspektimit konstatoi se ekzistonte shërbimi për porosi dhe blerje të artikujve të lejuar në IEVP, dhe listat e produkteve dhe çmimet përkatëse ishin të afishuara. Dyqani kishte larmi produktesh.

## ***Regjimi dhe aktivitetet***

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj., ishte i afishuar në sallën e edukimit dhe kryhej deri në orën 15:00. Nga bisedat me të paraburgosurit, kryesisht në katin e parë, grupi i inspektimit u informua se në lidhje me ajrimin, kishte diferencime. Ata pretendonin se u lejohej që të dilnin në ajrim vetëm një orë pasdite. Në I EVP Durrës, veprimtaria e aktiviteteve, në veçanti për sektorin e katit të parë ishte problematike, për vetë faktin e shprehur të transformimit të dhomave të përbashkëta për aktivitete në mjedise banimi. Rrjedhimisht, të paraburgosurit shprehën ankesa për mungesë aktivitetesh dhe veprimtarish social-kulturore.

Sipas informacionit të marrë nga stafi psiko-social, 16 të paraburgosur do të rinisnin programin mësimor për ciklin e ulët dhe atë 9-vjeçar. Gjithashtu, në institucion po bëheshin përgatitjet për kampionatin e futbollit midis institucioneve. Kishte të paraburgosur që merreshin me aktivitete artistike si pikturë, shkrim dhe poezi. Të vetmet kurse që grupi i inspektimit konstatoi ishin ato të gjuhëve të huaja anglisht dhe italisht. Frekuentimi i palestrës nuk ishte i mundur pasi disa të paraburgosur kishin konflikte me të paraburgosur të tjerë.

Biblioteka funksiononte dhe kishte një numër të konsiderueshëm titujsh. Tërheqja dhe kthimi i librave bëhej duke shënuar të dhënat përkatëse në një kartelë personale të të paraburgosurit. Stafi psiko-social bëri me dije grupin e inspektimit se biblioteka ishte një aktivitetet me interes për të paraburgosurit.

Në katin e parë të regjimit kishte një mjedis të veçantë për kryerjen e shërbesave fetare, për komunitetin mysliman, i pastër dhe i rregullt. Ritet fetare të krishtera kryheshin në një prej zyrave të specialistëve të sigurisë, pasi dhoma e përdorur më parë për këtë qëllim ishte shndërruar në dhomë banimi.

Sipas organikës së miratuar të sektorit të kujdesit psiko-social, ky shërbim përbëhej nga një përgjegjës sektori dhe 10 specialistë, 2 prej të cilëve kishin arsimim “psikologji”, 2 “punë sociale” një “sociologji” dhe pjesa tjetër jo me formimin përkatës.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të stafit psiko-social, si raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori, dosjet psiko-sociale, ashtu edhe programet individuale të trajtimit mbaheshin me rregull dhe të mbyllura me çelës. Programet individuale të trajtimit ishin të ndara sipas grupeve vulnerabël, përkatësisht për të sëmurë mendor, për persona me varësi nga substancat narkotike, si dhe për të dënuarit nga 18-21 vjeç.

## ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga përgjegjësja e sektorit, e cila ishte dhe mjekja psikiatre e institucionit, dy mjekë të përgjithshëm, një stomatolog, një farmacist, 10-të ndihmës mjekë, dhe tre sanitare.

Grupi i inspektimit këqyri dhomën e mjekut, të farmacisë dhe të infermierisë dhe konkludoi se ato ishin të amortizuara të pajisura me mobilie të vjetra dhe jashtë standardit.

Dhoma e stomatologut ishte gjithashtu e amortizuar dhe jo në përputhje me standardet. Ajo ishte e pajisur me një unit, por që ishte plotësisht jashtë funksionit, mungonte autoklava dhe materialet dentare, për rrjedhojë nuk kryheshin as mbushje as ekstraksione nga ana e stomatologut, përveç mjekimeve anestezike, ku edhe këto të fundit i siguronte vetë me rrugë private.

Farmacia ishte gjithashtu tepër e varfër me medikamente. Po ashtu, dhoma e infermierisë ishte e pajisur me dollap të vjetër, ku mungonin mjekimet bazë të urgjencës. Në momentin e vizitës u gjetën vetëm një sasi e vogël me Prednizolon, Analginë, Furosemid dhe një sasi e vogël Solucionesh Fiziologjike e Glukozat Kalciumi.

Gjatë e vizitës monitoruese në këtë institucion, u vu re se kishte një vlerësim të mirë për shërbimin shëndetësor në përgjithësi, nga të paraburgosurit në të gjithë sektorët. Ata shpreheshin se kishte gatishmëri nga ana e stafit shëndetësor ndaj kërkesave dhe ankesave të tyre në lidhje me shëndetin e për rrjedhojë nuk u konstatuan raste që mbaheshin në këtë institucion të pa trajtuar dhe të pa konsultuar dhe kjo ishte evidente edhe e mirë reflektuar edhe në dokumentacionin e stafit të sektorit shëndetësor. Por, ankesa të shumta u vunë re për sa i përket shërbimit dentar, ku të paraburgosurit pretendonin se nuk merrnin asnjë lloj shërbimi. Sipas stomatologut, ai kryente veç ndonjë mjekim të urgjencës, ndërkohë që ndërhyrjet e tjera ofroheshin në shërbime stomatologjike private.

Për sa i preket sektorit të kujdesit të veçantë ku trajtoheshin të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor, ata shpreheshin se mjekja psikiatre ishte prezent çdo ditë në këtë sektor, duke iu gjendur pacientëve me gjithë kërkesat dhe ankesat e tyre në lidhje me shqetësimet mjekësore që manifestonin.

Një tjetër problematikë e konstatuar, jo vetëm në sektorin e kujdesit të veçantë, ishte mungesa e theksuar e ilaçeve. Personat me probleme të shëndetit mendor që mbaheshin në këtë sektor ishin 22 të paraburgosur, të cilët ishin diagnostikuar me Skizofreni, Çrregullim Skizoafektiv, Çrregullim Bipolar, Çrregullime të Ankthit e deri në Çrregullime të Personalitetit. Ndërkohë që ishin 27 të paraburgosur të vendosur në sektorë të tjerë të cilët vuanin nga sëmundje kronike si Diabet mellitus, HTA, Epilepsi post traumatike, Azëm bronkiale etj.

Nga informacioni që u morr nga sektori psiko-social dhe ai shëndetësor, në këtë IEVP kishte 12 persona abuzues me substanca narkotike, që trajtoheshin me Metadon.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, në veçanti të mjekut, u konstatua ekzistenca e një regjistri themeltar vizitash i mjekut të përgjithshëm dhe një për të sëmurët kronikë. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura në rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve ishin të rregullta. Kartelat mjekësore ishin të plotësuara në mënyrë korrekte, por nuk mbaheshin të mbyllura me çelës. Me libreza shëndetësore ishin të pajisur të gjithë të paraburgosur e këtij institucioni. Pjesa tjetër, që sapo ishin akomoduar në këtë institucion, prisnin plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me libreza shëndetësore. Skema e rimbursimit të ilaçeve ishte në funksion të plotë për të sëmurët kronik, ndërkohë që për rastet akute kjo skemë nuk funksiononte.



Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në regjim, veçanërisht në katin e parë dhe respektimin e hapësirës personale.
2. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me kushtet higjieno-sanitare të të gjitha mjediseve të regjimit, veçanërisht në katin e parë.
3. Marrja e masave të menjëhershme në mënyrë që dy dhomat e observim/ veçimit të kthyera në tualete të pajisen në mënyrë të përshtatshme për të funksionuar si të tilla.
4. Marrja e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të observim/ veçimit.
5. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me dezinfektimin e mjediseve të dhomave të banimit si edhe të mjedisit të jashtëm.
6. Marrja e masave nga ana e sektorit të edukimit për zbatimin me rigozitet të urdhrin të DPB lidhur me procesin e trajtimit të ankesave/ kërkesave.
7. Marrja e masave për ndarjen e të paraburgosurve të grup moshës 18-21 vjeç, në sektor të veçantë.
8. Marrja e masave për organizimin e aktiviteteve të ndryshme sociale, si dhe të përdorimit të palestrës nga të gjithë të paraburgosurit sipas një grafiku të caktuar.
9. Marrja e masave për verifikimin e çmimeve në dyqanin e institucionit me qëllim adresimin e shqetësimit të të paraburgosurve për çmimet e larta.
10. Marrja e masave për adresimin e çështjes së çmimit të kartave telefonike për impuls.
11. Marrja e masave për shtimin në organikë të një mjeku psikiatër.
12. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me një autoambulancë.
13. Marrja e masave urgjente për pajisjen e farmacisë me medikamente të urgjencës, si dhe orenditë e përshtatshme për mbajtjen e tyre.
14. Marrja e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të sëmurët akut.
15. Marrja e masave për pajisjen e dhomës së stomatologut me autoklavë, vënien në funksion të unitit dhe furnizimin me materiale dentare.

#### **5.16. I EVP Fushë Krujë - Datë 01.10.2014 / Nr. Dok. 201401904**

##### ***Shënime paraprake***

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimit Penale Fushë-Krujë është krijuar në korrik të vitit 2008. Me Urdhër nr. 329, datë 15/ 01/ 2009, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar, “Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fushë-Krujë kategorizohet burg i sigurisë së lartë, me një seksion burg i sigurisë së zakonshme dhe një seksion paraburgimi”. Kapaciteti maksimal zyrtar i kësaj I EVP-je është 312 persona. Në kohën e vizitës, institucioni strehonte 420 persona (një prej të cilëve ishte dërguar në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve), me një mbipopullim prej 107 persona mbi kapacitetet. Ndarja nëpër sektor në momentin e inspektimit ishte: 140 të paraburgosur, 100 siguri e lartë dhe 180 persona siguri e zakonshme. Seksioni i të paraburgosurve me kapacitet për 30 persona, figuron i ndarë në dy sektorë, përkatësisht sektori 3 me dhjetë dhoma, dhe sektori 4 me 7 dhoma.

Në mungesë të drejtorit të institucionit grupi monitorues u prit nga përfaqësuesi ligjor shefi i sektorit juridik. Vizita monitoruese pranë I EVP Fushë-Krujë u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi, me akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë ambientet që ekspertët do të monitoronin. Objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishin kushtet dhe trajtimi i të burgosurve dhe të paraburgosurve.

Institucioni strehonte në kohën e vizitës 8 të paraburgosur të grup moshës 18-21 vjeçare. Të paraburgosurit, strehoheshin kryesisht në dhoma me dy shtretër, por për shkak të mbipopullimit në disa raste në dhomat me dy shtretër strehoheshin 4-5 vetë. Të paraburgosurit e grup moshës 18-21 vjeçare nuk ishin të sistemuar në seksion më vete, por ata strehoheshin në dhoma së bashku me të paraburgosurit e rritur.

Në institucion ndodheshin 4 shtetas të huaj maqedonas dhe bullgarë me të cilët nuk paraqiteshin probleme komunikimi, pasi të gjithë e flisnin gjuhën shqipe.

Kategori të veçanta në I EVP Fushë-Krujë ishin 7 të sëmurë mendorë dhe 5 me trajtim me metadon.

### *Trajtimi*

Grupi i monitorimit pati si objektiv mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve, në identifikimin e rasteve të përdorimit të torturës, trajtimin degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike përtej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si dhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore të veçimit nga aktivitetet e përbashkëta. Lidhur me këtë fakt, nga informacioni i marrë nga bisedimi në grup dhe në privatësi me vetë të dënuarit dhe të paraburgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast torture, përdorimi të tepruar të forcës apo dhunë psikologjike nga ana e punonjësve të kësaj I EVP-je ndaj të burgosurve dhe paraburgosurve.

Sipas sektorëve dhomat e banimit brenda regjimeve akomodonin nga 1 deri në 9 persona. Institucioni aktualisht ka 420 të paraburgosur dhe të dënuar për vetëm 312 shtretër; për këtë arsye jo të gjithë të paraburgosurit kanë krevat, një pjesë prej tyre flinin në tokë me dyshekë. Në kohën e monitorimit në institucion në dhomat e parashikuara për dy persona flinin 3 apo 4 persona. Kjo gjë sillte shkeljen e standardit të sipërfaqes së banimit për person (3.25 m<sup>2</sup> nga 4 m<sup>2</sup> që parashikohet në ligj). U konstatua gjithashtu se, personi i tretë apo i katërt si në sektorin 3 dhoma 4, 5, 10; sektori 4 dhoma 7, etj., flinte në tokë. Gjithashtu në sektorin 2 dhoma 5 gjendeshin 9 veta në dhomë me sipërfaqe 25m<sup>2</sup>, nga të cilët 3 veta flinin me dyshek në tokë. Në sektorin 1 dhe 2 në shumicën e dhomave me sipërfaqe 25m<sup>2</sup> flinin 8 veta ku 6 prej tyre flinin në krevate dhe 2 të tjerë me dyshekë në tokë.

Këto të dhëna me mbipopullimin e ambienteve të sektorit të paraburgimit në I EVP Fushë-Krujë përveç problemeve të degradimit strukturorë të ndërtesës dhe përkeqësimit të shërbimeve ndaj personave të privuar nga liria ngrenë shqetësimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me respektimin e te drejtave të njeriut në një vend demokratik. Fakti i një numri të konsiderueshëm të paraburgosurish të cilët flinin me dyshek në tokë, konsiderohet trajtim degradues e jo human.

## *Masat mbrojtëse*

Ekspertët morën informacion në lidhje me pritjen e të burgosurve/ paraburgosurve në institucion dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes, si dhe në lidhje me plotësimin e regjistrave e dosjeve personale të tyre. Nga biseda me Drejtuesin e Institucionit dhe verifikimeve në dosje grupi monitorues konstatoi se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte.

Kategoria e grup moshës së të paraburgosurve 18-21 vjeçare, jo vetëm që nuk ishin të sistemuar në seksion më vete, por banonin në dhoma së bashku me të paraburgosurit e rritur dhe aktivitetet e përbashkëta i kryenin së bashku me grup moshën e rritur. Nga kontakti me vetë të paraburgosurit e kategorisë 18-21 vjeçare, ekspertët u bënë me dije se banimi me të rriturit ishte zgjedhje e tyre në shumicën e rasteve për shkak e të lidhjeve shoqërore që kishin me bashkëjetuesit, dhe pamundësisë të alternativave për shkak të mbipopullimit në institucion.

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga Sektori i Edukimit. Të paraburgosurit në këtë IEVP, plotësonin një formular kërkesë/ ankesë dhe ia dorëzonin më pas edukatorit në zarf ose jo. Ky i fundit i dërgonte në protokoll. Pas protokollimit i kalonin Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të dënuarit. Pjesa e kërkesë/ ankesave që nuk është e destinuar për drejtorin postoheshin. Kjo procedurë nuk garanton ruajtjen e fshehtësisë dhe konfidencialitetit të shkrimit apo materialit të hedhur në letër. Përgjigjet e kërkesë/ ankesës përgjithësisht jepen brenda 24 orëve, por jo të gjithë kishin marrë një përgjigje kaq të shpejtë. Sipas intervistave kishte pasur raste kur ankesave dhe nuk i ishte kthyer përgjigje ose ishte kthyer me shumë vonesë.

Për sa i përket masave disiplinore në momentin e inspektimit dhe nga vizita që u bë në sektorin e veçim-izolimit pati mospërputhje mes personave që gjendeshin në këto ambiente dhe masave të dhëna sipas verifikimeve të regjistrave. Në regjistrin e masave disiplinore nuk ishte e dokumentuar masa e dhënë për personat që gjendeshin në ambientet e veçim/ izolimit masa të parashikuara sipas nenit 53 të ligjit nr. 40 / 2014 për "Të drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosur"

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Ajo për të cilën të paraburgosurit u ankuan për sa i përket telefonave është çmim i lartë i impulseve i ofruar nga operatori Abcom, ndërsa shërbimi i Albtelecom ishte ndërprerë pa ndonjë arsye. Të paraburgosurit dhe të dënuarit ankoheshin pasi sipas tyre shërbimi i Abcom ishte shumë më i kushtueshëm se i Albtelecomit.

Për sa i përket punësimit në këtë IEVP punonin 1 i paraburgosur dhe 33 të dënuar kryesisht si pastrues, sanitar dhe shpërndarës ushqimi. Nga intervistat e bëra me disa prej tyre rezultonte se disave nuk u ishte dhënë dinamika e punës edhe pse e kishin kërkuar. Kishte ankesa për abuzime mbi ditët e punës që u regjistroheshin të tjerëve që nuk kishin punuar. Një i dënuar i cili kishte një muaj që punonte, dhe që njihej nga stafi si i tillë, u ankua se nuk kishte asnjë informacion nëse ekzistonte në organikën e të punësuarve. Nga verifikimet e bëra në dokumentacionin përkatës, ai nuk figuronte në organikën e muajit Shtator 2014.

Ambientet e takimeve me familjarët ishin të përbashkëta për të dy sektorët. Në dhomën e takimeve gjendeshin 8 sportele të ndara me xham dhe dy sportele të kontrollit të ushqimit. Të paraburgosurit mund të takoheshin me familjarët e tyre një herë në javë. Nuk kishte një mjedis të veçantë ose dhomë për të paraburgosur që kanë fëmijë të vegjël ose të moshuar me të cilët mund të takoheshin pa kufizime dhe të lirshëm.

### ***Kushtet materiale***

Institucioni i Fushë-Krujës nuk ishte i pajisur me sistem ventilimi. Ajrosja në institucion realizohej në mënyrë natyrale, nëpërmjet dritareve, me masa brenda kërkesave të standardit. Një problem i konstatuar nga grupi monitorues ishte mungesa e ngrohjes për stinën e dimrit, problem i cili ekzistonte prej kohësh në këtë institucion. Në institucion ekzistonte një impiant ngrohjeje, por ishte i pa aktivizuar ende për këtë vit.

Grupi i monitorimit monitoroi ambientet e banimit në regjimin e brendshëm. Dhomat e banimit, të cilat ishin standard dhe të pajisura me nyje sanitare dhe lavaman, kishin përafërsisht këto përmasa: 4.5m x 2.5m x 2.8m dhe dhoma më të mëdha 5 x 5 x 2.8m.

Shtresat për fjetje ishin garantuar nga institucioni. Gjatë momentit të vizitës ambientet e banimit u gjetën higjenikisht në rregull. Në dhoma mungonin karriget e dollapët e rrobave, dhe këto të fundit mbaheshin nga të paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve.

Gjatë vizitës në dhomat e të burgosurve/ paraburgosurve, u konstatua se uji i rrjedhshëm vazhdonte të ishte me orar të reduktuar: 06.30-07.30; 09.30-10.30; 14.30-15.30; 18.30-20.30. Ky fakt mund të shërbejë si premisë për mosrespektimin e higjienës personale të të paraburgosurve dhe si rrjedhojë nuk plotëson kërkesat e Rregullave Minimale të Trajtimit të të Burgosurve, ashtu si edhe kërkesat e Rregullave Evropiane të Burgut. Një faktor mjaft shqetësues ishte mungesa e ujit të ngrohtë nëpër dhoma apo edhe në dushet e përbashkëta. Për këtë arsye të paraburgosurit ishin detyruar që ujin ta ngrohnin me rezistenca primitive dhe shumë të rrezikshme për jetën.

Grupi i monitorimit monitoroi në vend ambientet e përbashkëta të dusheve. Edhe pse ambientet dhe pajisjet e dusheve ishin pothuajse të reja, duke u nisur si nga bisedat me të paraburgosurit, ashtu edhe nga konstatimi në vend i grupit monitorues, apo edhe gjatë bisedës me drejtuesin e institucionit, u arrit në konkluzionin se ato nuk funksiononin siç duhej.

Lavanderia edhe pse ishte në gjendje funksionale, nuk ishte në shërbim të të paraburgosurve. Ata i lanin rrobat e tyre vetë apo përmes familjarëve të tyre.

Për sa i përket pajisjes së rregullt të të paraburgosurve me produkte të higjienës së përbashkët dhe të asaj personale si detergjente, qese plehrash, shampo, e artikuj të tjerë, institucioni nuk realizonte në mënyrë të plotë dhe sistematike një detyrim të tillë. Të paraburgosurit pajiseshin me këto artikuj kryesisht nga familjarët.

Gjatë inspektimit u vu re se kushtet në 10 dhomat e sektorit të veçim/ izolimit nuk ishin të mira. Dhomat kishin tualete brenda dhe inventari i orendive si karrige, tavolinë dhe krevat ishte i

plotësuar pavarësisht se në kushte jo fort të mira, por kishte dhe dhoma në të cilat mungonin disa prej tyre. Higjiena nuk ishte në standardet e duhura dhe ambienti kishte shumë lagështirë. Çdo dhomë izolim/ veçimi kishte ambientin personal të ajrimit të ndarë nga ajrimi i dhomave të tjera. Dushi është i përbashkët, por në momentin e inspektimit ai nuk funksiononte si i tillë pasi mungonte çdo lloj aksesorë që mund ta bënte të funksiononte normalisht.

Ambientet e observimit përbëheshin nga 5 dhoma 2 prej të cilave kishin tualete brenda ndërsa 3 të tjerat kishin tualet të përbashkët. Në ditën e inspektimit në observim ndodheshin 11 persona. Edhe pse maksimalisht një person mund të qëndrojë në observim deri në dhjetë ditë, nga bisedat rezultoi se kishte të dënuar të cilët kishin mbi 15 ditë madje dhe muaj që qëndronin në ambientet e observimit. Përveç lagështirës vihej re higjiena e munguar. Për dhomat të cilat nuk kishin tualet në dhomë, gjendej një tualet i përbashkët në kushte shumë të këqija, ku mungonin aksesorët për larje, normale dhe përdorimin e ujit.

Seksioni i paraburgimit që ishte i ndarë në paraburgim siguri e zakonshme dhe paraburgim siguri e lartë të cilët, gjendej në katin e parë të godinave respektive. Në paraburgimin e sigurisë së lartë numri i të paraburgosurve varioje nga 3 deri në 4 persona për dhomë. Ky seksion kishte katër sektorë me nga shtatë deri në dhjetë dhoma. Dhomat kishin tualete brenda. Në seksionin e paraburgimit të sigurisë së zakonshme kishte gjithashtu katër sektorë me nga pesë deri në gjashtë dhoma për sektor. Të gjitha dhomat kishin një numër nga 7-9 të paraburgosurish, ku në çdo dhomë kishte nga 2 të paraburgosur që flinin me dyshek në tokë. Dhomat kishin tualetet brenda. Duset ishin të përbashkëta, por pjesa më e madhe e tyre nuk ishin funksionale. Ndërmjet seksioneve ndodheshin dhomat e aktiviteteve të përbashkëta.

Në katet e dyta ndodheshin seksioni i sigurisë së lartë dhe seksioni i sigurisë së zakonshme. Çdo seksion kishte dy sektorë. Në seksionin e burgut të sigurisë së zakonshme kishte rreth gjashtë dhoma për sektor me nga 4-6 persona. Dhomat ishin të pajisura me tualete brenda ndërsa duset ishin të përbashkëta në kushte aspak funksionale dhe të mira.

Nga vizita në institucion në sektorin e vëzhgim/ veçimit, observimit, vizitat në mjediset e takimeve me familjet, kuzhinës, bisedat me të paraburgosurit dhe të dënuarit, kushteve të dhomave dhe aktiviteteve të ofruara, rezultoi se ajo që të binte në sy që në momentin e parë që hyje në këtë institucion ishte vazhdimi i prezencës së lartë të lagështirës. Ky ka qenë një nga shqetësimet kryesore në vite i cili vazhdon të ngelet problem. Pothuajse të gjitha dhomat kishin lagështirë tej normës së lejuar.

Grupi monitorues gjatë vizitës në IEVP Fushë- Krujë vuri re se kuzhina ishte e pastër dhe e rregullt. Cilësia dhe gramaturat e ushqimit të gatuar ditën e vizitës ishin brenda standardeve. Në të punonin kuzhinierë, ndihmës kuzhinierë dhe 7 persona që vuajnë dënimin në institucion. Menyja e përditshme ishte e afishuar. Kampionët e ushqimit të gatuar një ditë më parë ruheshin në kushte frigoriferike. Pjesa më e madhe e të paraburgosurve nuk e konsumonin ushqimin e institucionit por e merrnin nga familjarët. Ankesat nga të paraburgosurit për cilësinë dhe gatimin e ushqimit ishin të shumta. Ankesat kryesisht ishin lidhur me gatimin jo të mirë që i bëhet ushqimit, mungesën e larmisë, si dhe shërbimin jo në kushtet e duhura sanitare. Për sa i përket qumështit ai shpërndahej një herë në javë sipas gramaturës së përcaktuar, por sipas të paraburgosurve dhe të dënuarve ai nuk plotësonte kushtet e cilësisë.

## ***Regjimi dhe aktivitetet***

Grupi i monitorimit u informua lidhur me respektimin e së drejtës së të burgosurve/paraburgosurve për të pasur kontakte me familjarët dhe monitoroi dhomat e takimit. Këto të fundit ishin konform parametrave të kërkuar. Ambienti i takimit ishte i ndarë me xham dhe pjesa e familjarëve dhe e të burgosurve mund të komunikonin lirshëm, ulur në stola, gjithmonë nën vëzhgimin në distancë të punonjësit të policisë. Respektohej privatësia. Takimi zgjaste rreth 30 minuta. Nga biseda me të burgosurit mbi këtë temë nuk pati ndonjë ankesë.

Nuk kishte më shqetësime nga të burgosurit për sa i takon numrit të telefonatave që ata mund të kryenin gjatë një muaji.

Institucioni kishte bibliotekë dhe ambient leximi, si dhe ekzistonte mundësia që të burgosurit/paraburgosurit të merrnin libra për t'i lexuar në dhomat e tyre. Kishte një numër të konsiderueshme librash, por që nuk i përmbushin të gjitha kërkesat. Të paraburgosurit dhe të dënuarit e regjistruar janë rreth 17 të paraburgosur, 203 të dënuar që frekuentojnë dhe kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave.

E drejta e besimit respektohej dhe në institucion kishte hapësira të veçanta për ushtrimin e fesë, e cila realizohej në ditët e caktuara. Aktivitete fetare me tematik kulturore ofroheshin nga komuniteti Mysliman Shqiptar dhe Shoqata Kristiane e të Burgosurve Shqiptar.

Aktivitetet sportive, përveç lojërave të tavolinës, për të burgosurit/paraburgosurit e interesuar, konsistonin edhe në kalçeto dy herë në javë. Një fushë e re kalçetoje me standarde të larta ishte ndërtuar me ndihmën e Federatës Shqiptare të Futbollit. Gjatë ditës së inspektimit, në institucion po bëheshin përgatitjet për spartakiadës e futbollit midis institucioneve të tjera.

Sektori i shërbimit të kujdesit social vazhdonte të kishte të njëjtën organikë prej dhjetë punonjësish.

Gjatë inspektimit të të gjitha ambienteve të përbashkëta u vu re se sallat e veprimtarive si klasa edukimi, këshillimi etj., ishin të zbrazura. Sipas orarit të veprimtarive gjatë kësaj kohe nuk u vu re dhe nuk u kontaktua asnjë prej punonjësve të sektorit të kujdesit social të cilët duhej të ishin brenda në regjim, në sallat e aktiviteteve duke ofruar programe individuale apo këshillim. Për sa i përket orarit të veprimtarive ai vazhdonte të ishte i njëjtë për të gjithë sektorët pavarësisht nivelit të sigurisë.

Në lidhje me ajrimin gjatë muajve të verës nuk kishte pasur ankesa, por në stinën e dimrit me orarin e ri të ajrimit të reduktuar shumica e të paraburgosurve dhe të dënuarve ishin të shqetësuar dhe të pakënaqur. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë u përgjigjën se bënë vetëm ajrim, kalçeto dhe aktivitete fetare. Qartazi në këtë institucion nuk zhvillohet ndonjë veprimtari tjetër integruese, social-kulturore apo formim profesional. Sipas stafit të institucionit të paraburgosurit dhe të dënuarit regjistroheshin në disa aktivitete, por jo gjithmonë i frekuentonin. Së shpejti pritej të fillonte kursi i anglishtes i cili ishte ndërprerë, si dhe procesi mësimor edhe pse me shumë vonesë. Për

programin mësimor për ciklin e ulët dhe 9-vjeçar institucioni ishte duke rinisur procesin mësimor për 11 të paraburgosur.

Dosjet psiko-sociale të të paraburgosurve dhe të dënuarve, kishin programe individuale të trajtimit për të dënuarit, si dhe informacione mbi organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me ta, kryesisht diskutime në grup për tema sociale dhe aktivitete sportive. Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuar mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Në këtë IEVP organika për kujdesin shëndetësor ishte e plotësuar sipas përcaktimeve. Në të punonin 1 përgjegjës sektori shëndetësor (mjek), 1 mjek specialist, 1 stomatolog, 5 ndihmës mjekë dhe 1 farmacist.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë.

Në IEVP ekzistonte edhe një godinë e cila shërbente si spitali i këtij Institucioni. Në katin e parë të tij ndodhej dhoma e stomatologut, dhoma e vizitave të mjekut si dhe farmacia. Ndërsa në katin e dytë ishte një pavijon me shtretër në kushte të këqija higjieno sanitare me shumë lagështirë, pa ngrohje, banja me dushe jashtë standardit dhe pa bojler për ujë të ngrohtë. Në korridor ndodheshin dy telefona të cilët, në momentin e vizitës ishin funksionale.

Dhoma e mjekut ishte rregullt e pastër e mirëmbajtur dhe e pajisur me një krevat vizitash, një dollap ku mbaheshin ilaçet e urgjencës dhe një tjetër ku mbaheshin kartelat mjekësore të kyçura me dry.

Dhoma e stomatologut gjithashtu ishte e rregullt, e pajisur me unit dhe autoklavë funksionale, si dhe instrumente e materiale dentare.

Farmacia e këtij institucioni ishte e varfër me medikamente.

Sipas informacionit që u mor nga përgjegjësi i sektorit shëndetësor, në këtë institucion vuanin dënimin 7 persona me çrregullime të shëndetit mendor, 3 nga të cilët ishin të diagnostikuar me Skizofreni, 2 me çrregullime të personalitetit një me çrregullim bipolar dhe një me çrregullim psikik të paspecifikuar. Nga të dënuarit/ paraburgosurit abuzues me substanca narkotike, 5 prej tyre trajtoheshin me Metadon. Gjithashtu kishte edhe persona të tjerë të cilët vuanin nga sëmundje kronike ku 6 me Diabet Mellitus, 13 me HTA, 2 me astma bronkiale, 4 me Epilepsi, etj.

Gjatë vizitës në këtë IEVP si dhe nga intervistat me të dënuarit u konstatuan problematika të ndryshme sa i përket shërbimit shëndetësor në këtë institucion. Ato ishin kryesisht të lidhura me mjekimet, të cilat shpesh mbulohehin me ilaçe që silleshin nga familja. Gjithashtu, kishte pretendime për sa i përket përgjigjes në kohë të kërkesave të të dënuarve për vizita mjekësore në varësi nga problematikat që manifestonin. Kishte pacientë që vuanin nga Diabeti Mellitus, të cilët merrnin mjekim, por nga ana e stafit të kujdesit shëndetësor, nuk bëheshin thujtë fare

matje të nivelit të glicemisë, dhe sipas kartelave të këtyre pacientëve dietat diabetikë nuk ishin të pasqyruar në to.

Gjatë intervistave u konstatuan një sërë ankesash në lidhje me realizimin e konsultave jashtë institucionit, sidomos të rasteve që kishin kryer një ndërhyrje kirurgjikale dhe që i nevojiteshin konsulta një herë në muaj sipas rekomandimit të specialistëve. Gjithashtu, ankesa kishte edhe në drejtim të shërbimit stomatologjik, për mungesë shërbimi sa i përket mjekimeve mbushjeve ashtu dhe ekstraksioneve. Nga mjekja stomatologe u pretendua që personave të ankuar u ishte dhënë shërbimi, ndërkohë që nga shqyrtimi i dokumentacioni u provua që personat e ankuar për mungesë shërbimi, nuk ishin pasqyruar në regjistrin përkatës.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri të vizitave të të dy mjekëve, regjistri themeltar i të dënuarve, regjistri i evidentimit të rasteve të rënda, libri i shkarkimit të medikamenteve, libri i medikamenteve që siguroheshin nga familja si dhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve. Kartelat mjekësore ishin të mbajtura me rregull dhe të mbyllura në dollap me dry. Problem kishte për rastet me Diabet Mellitus, në kartelat e të cilëve nuk shënohej dieta përkatëse.

Skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte për 277 të dënuar/ të paraburgosur të cilët ishin të pajisur me libreza shëndetësore.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, në respekt të Nenit 24 të Ligjit nr.8328 dt.16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve", i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje dhe standardi që çdo qeli të ofrojë minimalisht 4m2 hapësire jetike për person.
2. Marrja e masave të menjëhershme për sigurimin me karrige dhe dollapë të dhomave për çdo të dënuar.
3. Marrja e masave të menjëhershme për ndarjen e të rriturve nga ata të grup-moshës 18-21 vjeçare, duke shmangur kështu bashkëjetesën e të rriturve me 18-21 vjeçarë (brenda sektorit të paraburgimit) si dhe për organizimin e ajrosjes në mënyrë të ndarë.
4. Marrja e masave të menjëhershme për rregullimin dhe vënien në përdorim të sistemit të ngrohjes për muajt e ftohtë të vitit.
5. Marrja e masave për krijimin e një ambienti të përshtatshëm në rastet e takimit të të burgosurve/ paraburgosurve me familjarë të mitur.
6. Marrja e masave për të mbajtur aktive kurset e arsimit dhe ato profesionale.
7. Marrja e masave për shtimin e aktiviteteve riintegruese dhe social-kulturore në përgjithësi dhe në veçanti për 18-21 vjeçarët.
8. Marrja e masave të nevojshme nga personeli përgjegjës për të mundësuar këshillime individuale e në grup në dhoma të planifikuara për këshillim.
9. Marrja e masave për furnizimin me detergjente me qëllim higjienizimin e dhomave të banimit, ambienteve të jashtme, kuzhinës dhe magazinës së ushqimeve në mënyrë periodike
10. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve higjieno- sanitare, lagështirës dhe ngrohjes në ambientet e spitalit.



11. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin kushteve të tualeteve dhe dusheve në ambientet e spitalit, si dhe sigurimin e ujit të ngrohtë në to.
12. Marrja e masave që në pamundësi të pajisjes së institucionit me një mjek psikiatër, të vihet në dispozicion mjeku psikiatër i zonës për të kryer vlerësime psikiatrike më të shpeshta dhe më të shumta në numër.
13. Marrja e masave nga ana e stafit të sektorit shëndetësor për përgjigjen në kohë të kërkesave të të dënuarve, në lidhje me vizitat mjekësore si dhe konsultat e specializuara në qendrat spitalore.
14. Marrja e masave për ofrimin e një shërbimi efikas stomatologjik me ndërhyrjet përkatëse, mbushje apo ekstraksione, duke qenë se nuk mungonin materialet dhe instrumentet dentare në dhomën e stomatologut.

#### **5.17. IEVP Burrel - Datë 06.10.2014 / Nr. Dok. 201401905**

##### *Shënime paraprake*

Vizita monitoruese pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë shumë të mirë bashkëpunimi. Në mungesë të Drejtorit nga ana e shefit të sektorit të sigurisë dhe zyrat e shërbimeve të institucionit grupit monitorues iu ofrua mundësia që të kishte akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që u monitoruan.

Në bazë të urdhrin të Ministrit të Drejtësisë nr. 329, datë 15/ 01/ 2009, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel kategorizohet “Burg i sigurisë së lartë, me një seksion të sigurisë së zakonshme dhe një seksion paraburgimi”. Kapaciteti aktual i institucionit është 198 persona.

Në datën 6.10.2014 në këtë institucion gjendeshin 211 persona me një mbipopullim prej 13 të dënuarish. Ndarja në sektorë ishte: 76 të paraburgosur, 28 siguri e lartë dhe 107 të dënuar në sektorin e sigurisë së zakonshme. Në institucion përdorreshin 3 dhoma si mjedise observim-veçimi. Në IEVP Burrel nuk kishte një sektor të veçantë për 18-21 vjetarët, megjithëse në kohën e inspektimit ishin 8 të dënuar që i përkisnin kësaj grup moshe. Kategori të veçanta në këtë institucion ishin 6 të sëmurë mendorë dhe 1 përdorues droge.

Gjatë takimit prezantues, drejtuesit e seksioneve pranuan se në aspektin material infrastruktura e institucionit është e vjetërsuar dhe e degraduar pavarësisht përpjekjeve për ta riparuar. Mundësitë ishin të kufizuara nga mungesa e fondeve të konsiderueshme për të ndërmarrë një iniciativë të tillë. Në përgjigje, grupi i monitorimit sqaroi se mendimi i Institucionit të Avokatit të Popullit i shprehur dhe në rekomandimet e shkuara ishte marrja në konsideratë nga ana e DPB-së për hartimin dhe miratimin e një projekti për ndërtimin e një institucioni të ri.

Gjatë vizitave të vazhdueshme në këtë institucion është konstatuar mungesa e ambienteve të tualeteve në dhoma në sigurinë e lartë dhe dusheve brenda sektorit. Në përgjithësi kushtet e godinave ishin jo të mira dhe të pamjaftueshme për aktivitete social-kulturore. Në to vihej re mungesa e një sistemi efikas ngrohjeje për periudhën e dimrit dhe e sistemit të ajrimit të mjaftueshëm. Gjithashtu edhe instalimet elektrike e ato hidrosanitare rezultojn të amortizuara.

## ***Trajtimi***

Nga informacioni i marrë, si nga drejtuesit e institucionit, ashtu edhe nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të paraburgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast torture, përdorimi të tepruar të forcës apo dhunë psikologjike nga ana e personelit të IEVP-së Burrel ndaj të dënuarve/ paraburgosurve.

Ankesat që u paraqitën në momentin e inspektimit kishin të bënin kryesisht me hapësirën e kufizuar në dhoma, cilësinë e ushqimit, mungesën e dusheve në sektor në rastin e sigurisë së lartë, mungesën e medikamenteve mjekësore si dhe mungesën e aktiviteteve. Gjithashtu kishte ankesa në lidhje me mungesën e ngrohësve për periudhën e dimrit mungesën e detergjenteve për pastrim.

Ajo që u vu re gjatë vizitës monitoruese ishte mungesa e një seksioni të veçantë për 18-21 vjeçarët, gjë që u pohua dhe nga takimi me stafin e institucionit. Ata ishin akomoduar në dhoma me të paraburgosur apo të dënuar që kishin afërsi moshe dhe interesa të përafërta.

Të dënuarit dhe të paraburgosurit u ankuan për mjediset e ajrimit, të cilat ishin shumë të zhveshura dhe të betonizuara dhe të papërshtatshme për stinën e verës dhe të dimrit.

## ***Masat mbrojtëse***

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve lidhur me sistemin e kërkesë/ ankesave rezultoi se çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga Sekretaria e institucionit. Të paraburgosurit/ dënuarit plotësonin një formular kërkesë/ ankesë dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte vetë të dënuarit. Megjithatë, sipas intervistave ekzistonte pretendimi se kishte pasur raste që ata kishin bërë një ankesë dhe nuk u ishte kthyer përgjigje ose ishte kthyer me shumë vonesë.

Për sa i përket masave disiplinore në momentin e inspektimit dhe nga vizita që u bë në sektorin e veçim-izolimit rezultoi se nuk kishte të dënuar/ paraburgosur të veçuar.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe personat e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Ajo për të cilën të dënuarit/ paraburgosurit u ankuan lidhur me telefonatat ishte çmimi i lartë i impulseve.

Nuk pati ankesa nga të dënuarit/ paraburgosurit për mosrespektim të numrit të takimeve me familjet, por u konstatuan ankesa nga shumë të dënuar për mënyrën e kryerjes së kontrollit të ushqimeve nga stafi i institucionit.

Nuk kishte një mjedis të veçantë ose dhomë për të paraburgosur/ dënuar që kishin fëmijë të vegjël ose të moshuar me të cilët mund të takoheshin pa barriera apo kufizime fizike dhe ku të miturit të ndiheshin në një ambient miqësor dhe të lirshëm.

Në IEVP Burrel punonin 18 të dënuar, kryesisht si pastrues, sanitar, shpërndarës ushqimi etj., të cilët trajtoheshin me pagesën 90 Lekë/ muaj, por që nuk përfitonin ulje dënimi si në institucionet e tjera. Një ankesë u mor nga i dënuari P.R., i cili punonte prej 7 muaj e gjysmë dhe nuk ishte paguar. Kjo sipas shefes së sektorit të financës kishte ndodhur pasi për arsye të shumës së papërfillshme, ajo kishte mbledhur disa muaj dhe pastaj kishte bërë depozitim të shumës në bankë.

### ***Kushtet materiale***

Ndërtesa e kësaj IEVP-je, si strukturë e trashëguar nga sistemi diktatorial, përveç se ishte e vjetërsuar, nuk i plotësonte kushtet e përshtatshme higjienike e fizike për strehimin e të dënuarve sipas standardeve të burgjeve evropiane. Muret kishin mjaft lagështirë dhe pavarësisht përpjekjes për të realizuar lyerje të shpeshta, njollat e lagështirës dhe rëniet e suvasë faktonin një ambient jo të shëndetshëm. Në mjaft raste viheshin re priza të pasigurta dhe instalime elektrike të zhveshura dhe jashtë parametrave të sigurimit teknik, veçanërisht në instalimet e bojlerëve të ngrohjes së ujit në banjat e përbashkëta të regjimeve.

Gjatë inspektimit u vu re se sektori i observim/ veçimit kishte 3 dhoma. Në momentin e inspektimit kishte 6 të dënuar në observim dhe asnjë në veçim. Në dy sektorë, dhomat ishin të pajisura me tualete brenda ndërsa dushet ishin të përbashkëta në kushte lagështie dhe të pa mirëmbajtura. Ndërsa në seksionin e sigurisë së lartë banjat ishin të përbashkëta në kushte higjienike dhe pajisjesh të pa përshtatshme, dyer të vjetra dhe jofunksionale, pa lavamanë dhe rubinete funksionale. Në këtë seksion problematike mbetej vendndodhja e dusheve të përbashkëta jashtë godinës së sektorit. Të dënuarit duhet të kalonin sidomos gjatë dimrit në kushte të ftohti apo reshjesh përmes oborrit të hapur të ajrimit për të bërë dush në ambientet e dusheve të përbashkëta.

Me gjithë mbipopullimin e lehtë, nuk kishte të dënuar apo të paraburgosur që flinin në dyshekë në tokë. Dhomat ishin të përmasave të ndryshme dhe pavarësisht konstatimit se mbipopullimi nuk përbënte problemin kryesor në institucion, kishte përgjithësisht kufizimin të hapësirave jetike nën standardin ligjor prej 4m<sup>2</sup> për person në dhoma. Kishte ndriçim artificial, por përgjithësisht në sektorë, dritaret ishin të vogla dhe pengonin dritën e diellit dhe futjen e ajrit të pastër.

Pavarësisht se në ambientet e sigurisë së zakonshme, të cilat u vizituan nga grupi i ekspertëve, u konstatuan pajisje për ngrohje (kaloriferë) apo pajisje kaldaje, nga komunikimi me të burgosurit, u pohua fakti se ato nuk ndizeshin rregullisht dhe mjaftueshëm në kohën e dimrit dhe ngrohja realizohej kryesisht nëpërmjet batanijeve dhe rrobave personale apo ndonjë ngrohëse të siguruar nga vetë të dënuarit. Në ambientet e sigurisë së lartë mungonin pajisjet e kaldajës dhe ngrohja në qeli.

Dhomat përgjithësisht ishin të pajisura me orëditë e nevojshme si tavolinë, karrige dhe dollap, por kishte ankesa nga disa të paraburgosur që nuk lejoheshin të merrnin pajisje të përdorura, si TV dhe frigorifer nga të afërmit, dhe që nga ana tjetër nuk mund t'i blinin të reja pasi nuk i kishin mundësitë financiare. Pengesë sipas tyre ishte Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të

Burgjeve, nr. 3895, datë 09.04.2013, i cili lejon në mjediset e banimit vetëm pajisjet e reja që blihen nga institucioni me një komision të posaçëm.

Gjatë vizitave në mjediset e korridoreve, dhomat e takimit, ambientet e përbashkëta, kuzhina e institucionit, etj., u vu re një higjienë e mirë, pasi në momentin e inspektimit u konstatua që institucioni ishte përfshirë rishtas në një aksion i përgjithshëm pastrimi. Ndërsa nga intervistat e bëra nëpër dhoma pati shumë ankesa për mungesën e detergjenteve. Nuk vihej re prezencë insektesh ngaqë vetë institucioni kishte marra masa për dezinfektimin e të gjithë godinës.

Kuzhina ishte e pastër dhe e rregullt. Kampionët e ushqimit të gatuar një ditë më parë ruheshin në kushte frigoriferike. Të dënuarit u ankuan për cilësinë e bukës dhe kërkuan që buka t'u vinte e prerë nga furnitori, pasi siç u verifikua, ajo vinte e paprerë dhe ndahej me dorë nga të dënuarit. Shumica e të paraburgosurve pohuan se ata preferonin ta merrnin ushqimin nga familjarët pasi cilësia e gatimit sipas tyre linte për të dëshiruar.

Për bërjen e dusheve nuk pati ankesa, pasi problematika e dusheve e përmendur më lartë ishte zgjidhur nga të dënuarit duke marrë ujë të ngrohtë në dushet e përbashkëta dhe duke realizuar larjen në banjat e dhomave të tyre.

Për sa i përket larjes së ndërresave: në këtë institucion çarçafët, jastëkët dhe batanijet në shumicën e rasteve vazhdonin të laheshin nga familjarët, pasi akoma nuk kishte një lavanderi që të mund ta ofronte këtë shërbim.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Gjatë inspektimit u vu re se nuk zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta në mjediset e edukimit. Gjatë inspektimit në regjimin e brendshëm u takuan punonjësit e sektorit psiko-social të cilët merrnin kontakte me të dënuarit/ paraburgosurit.

Në lidhje me ajrimin nuk kishte pasur probleme, por me orarin e ri të ajrimit shumica e të paraburgosurve dhe të dënuarve ishin të shqetësuar dhe nuk binin dakord pasi i kufizonte shumë. Shumë prej të intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë kërkuan të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive, më shumë mjete dhe pajisje sportive. Për programin mësimor për ciklin e ulët dhe 9-vjeçar institucioni nuk kishte kryer akoma marrëveshjen me Drejtorinë Arsimore për vazhdimësinë e procesit mësimor për 6 të dënuar/ paraburgosur.

E drejta për të mbajtur kontakte me familjarët dhe miqtë zbatohet përgjithësisht sipas Rregullores. Takimet realizoheshin mesatarisht rreth 4 herë në muaj, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Takimi me familjarët zgjaste rreth 20 minuta. Nuk u konstatuan ankesa nga ana e të dënuarve lidhur me kryerjen e telefonatave të cilat lejoheshin edhe pas orës 14.00, kohë e cila është më e favorshme për disponibilitetin e familjarëve dhe praninë e tyre në banesë. Të dënuarit kishin mundësi të kufizuar për të shfrytëzuar librat në bibliotekë, lojërat e tavolinës dhe aktivitete të tjera rekreative si rezultat i ambienteve të përbashkëta të përshtatshme.

Ishin në përdorim të vazhdueshëm ambientet e jashtme të cilat përveç ajrimit përdoreshin sistematikisht për të luajtur futboll sipas një grafiku paraprakisht të miratuar. Sipërfaqja e ambienteve të ajrimit ishte brenda standardeve të pranuar.

Mungonte një ambient i përshtatshëm që të shërbente si sallë për ushtrimin e besimeve fetare, gjë kjo për të cilën pati ankesa të shumta nga ana e të dënuarve/ paraburgosurve. Aktualisht lidhur me këtë funksion në IEVP Burrel përdoret ambienti i bibliotekës, pasi ajo ishte në gjendje shumë të varfër me libra apo tituj. Në këtë ambient kryheshin zakonisht aktivitete fetare që ofroheshin nga Komuniteti Mysliman Shqiptar.

Mundësia për trajnime profesionale mbetet e kufizuar pasi në këtë rajon shërbimet shtesë të ofruara nga OJF ishin joekzistente.

Mungonin kurset për arsimimin e vazhdueshëm dhe të personave analfabetë. Nga institucioni nuk u vërejt një iniciativë në lidhje me arsimin dhe trajnimin profesional për të burgosurit në përgjithësi.

Përsa i përket mbështetjes psiko-sociale që merrnin të burgosurit, vihej re se kishte kontakte me të shpeshta të të dënuarve/ paraburgosurve me punonjësit përkatës të kujdesit social. Gjithsesi, mungesa e ambienteve të përshtatshme për këshillim individual, kufizonte përfshirjen në procesin e rehabilitimit. Nevojitej vëmendje më e madhe për sa i përket trajtimit individual të dosjeve, vlerësimeve psikologjike apo të ndërhyrjes së ofruar prej tyre, si dhe për përpjekjeve për të vendosur ura komunikimi me familjet e personave që nuk kishin kontakte.

### ***Shërbimi Shëndetësor***

Organika e stafit mjekësor në këtë institucion përbëhej nga një mjek, me kohë të plotë, 3 ndihmës mjekë, 1 stomatologe dhe 1 farmacistë. Gjatë vizitës në këtë IEVP si dhe nga intervistat me të dënuarit problematikat më të shumta që u konstatuan në këtë institucion sa i përket shërbimit shëndetësor, kryesisht të lidhura me mjekimet, të cilat shpesh mbuloheshin me ilaçe që sillleshin nga familja, pasi vetë institucioni kishte mangësi të theksuara të ilaçeve.

Për sa i përket shërbimit stomatologjik, ai ishte i mangët dhe nuk ofronte tjetër veçse mjekime dhe ekstraksione.

Ndërkohë nga të dënuarit u dhanë vlerësime pozitive për mjeken e këtij institucioni, e cila kryente vizita të rregullta në regjim, iu përgjigjej në kohë dhe në çdo rast kërkesave të të dënuarve/ paraburgosurve, dhe sa herë nevojitej realizonte konsulta të specializuara jashtë institucionit.

Sipas informacionit që u mor nga përgjegjësi i sektorit shëndetësor në këtë institucion vuanin dënimin 7 persona me çrregullime të shëndetit mendor, 3 nga të cilët ishin të diagnostikuar me Skizofreni, 2 me çrregullime të personalitetit një me çrregullim bipolar dhe një me çrregullim psikik të paspecifikuar. Nga të dënuarit/ paraburgosurit abuzues me substanca narkotike asnjë prej tyre nuk trajtohej me Metadon. Gjithashtu kishte edhe persona të tjerë të cilët vuanin nga sëmundje kronike ku 6 me Diabet Mellitus, 13 me HTA, 2 me astma bronkiale, 4 me Epilepsi, etj.

Institucioni nuk dispononte një autoambulancë për shërbime urgjence apo shërbime të tjera shëndetësore.

Dhoma e mjekut ishte rregullt e pastër e mirëmbajtur dhe e pajisur me një krevat vizitash, një dollap ku mbaheshin ilaçet e urgjencës dhe një tjetër ku mbaheshin kartelat mjekësore të kyçura me dry.

Dhoma e stomatologut gjithashtu ishte e rregullt, e pajisur me unit autoklavë dhe instrumente dentare të amortizuara, por funksionale, ndërkohë që materialet dentare siguroheshin privatisht nga stomatologu.

Dhoma e infermierisë e cila ndodhej brenda në regjim në sektorin B1, shfrytëzohej për vizitat e mjekes. Dhoma e ishte e pajisur me dy krevate, tavoline, ndërsa mjekimet e urgjencës mbaheshin në një çantë e cila shërbente edhe për sektorët e tjerë, duke qenë se këta të fundit nuk kishin një dhomë infermierie.

Farmacia e këtij institucioni ishte e rregullt dhe e pajisur me ilaçe për sëmundjet kronike, por mungonin ato për sëmundjet akute.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri të vizitave të mjekes, regjistri themeltar i të dënuarve/ paraburgosurve dhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, ndërsa mungonte regjistri i evidentimit të rasteve të rënda të dhunës. Kishte kartela mjekësore të plotësuara mirë por kishte edhe nga ato, sidomos të personave që kishin manifestuar probleme të shëndetit mendor apo komorbiditet me abuzimin me substancat narkotike, të cilat vazhdonin të mbaheshin me të njëjtën terapi me sedativo-hipnotikë apo antidepresiv prej kohësh pa realizuar konsulta që të bënin një rivlerësim si të diagnozës ashtu dhe të mjekimit.

Me librezat shëndetësore ishin të kompletuar vetëm të dënuarit, ndërsa të paraburgosurit nuk ishin të pajisur me librezat për shkak të vonësive në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale. Ndërkohë që skema e rimbursimit të ilaçeve ishte funksionale vetëm për sëmundjet kronike, por kjo skemë s'kishte zbatueshmëri për sëmundjet akute, pasi sipas mjekes së institucionit këtë nuk e mundëson ISKSH-ja.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lysterje të dhomave të dënuarve.
2. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e ambienteve të përbashkëta të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme të banjave të përbashkëta në sektorë, riparimin e tubacioneve dhe pajisjeve hidrosanitare të prishura, ndriçuesve dhe lidhjeve elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik.
3. Marrja e masave të menjëhershme për respektimin e hapësirës personale prej 4m<sup>2</sup> në dhoma.

4. Marrja e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit të jenë të pajisur me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjienës personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar qelitë e tyre.
5. Marrja e masave për sigurimin e ngrohjes në të gjithë sektorët, sipas standardeve të parashikuara në rregulloren e burgjeve.
6. Marrja e masave për vënien në zbatim të marrëveshjes ekzistuese në mes të IEVP Burrel dhe DAR për arsimimin e detyruar të personave analfabet dhe atyre që nuk e kanë përfunduar arsimin e detyruar.
7. Marrja e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjithë të dënuarit/ paraburgosurit edhe për sëmundjet akute.
8. Marrja e masave për kryerjen e konsultimeve më të shpeshta për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor, në mënyrë që të rivlerësohet dhe saktësohet diagnoza dhe mjekimi përkatës.
9. Marrja e masave për ofrimin e një shërbimi të plotë dhe adekuat stomatologjik.
10. Marrja e masave për sigurimin dhe vënien në përdorim të një ambienti të përshtatshëm për ushtrimin e besimeve fetare për të dënuarit.
11. Marrja e masave për përmirësimin e ambienteve të takimeve me familjarët dhe krijimin e një dhome të veçantë dhe të përshtatshme për takime të të dënuarve me fëmijë të mitur.
12. Marrja e masave për ndarjen dhe krijimin e një sektori të veçantë për 18-21 vjeçarët.
13. Marrja e masave për të përmirësuar mjedisin e ajrimit për t'iu përshtatur kushteve klimaterike edhe nevojës për gjelbërim.
14. Marrja e masave për gjetjen e një zgjidhjeje për të ofruar shërbimin e lavanderisë nga institucioni për veshjet dhe rrobat personale për të dënuarit.
15. Marrja e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi dhe aktivitete social-kulturore-sportive.
16. Marrja e masave për unifikimin e trajtimit të dënuarve/ paraburgosurve të punësuar në gjithë sistemin si dhe përmirësimin e situatës së pagesës së tyre.

#### **5.18. IEVP Berat - Datë 14.10.2014 / Nr. Dok. 201401923**

##### ***Shënime paraprake***

IEVP Berat ka kapacitet maksimal prej 37 personash dhe 46 shtretërish. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 75 persona të paraburgosur. Rrjedhimisht, mbipopullimi ishte problematikë e pranishme me pothuajse dyfishin e personave mbi kapacitetin zyrtar.

Bazuar në Marrëveshjen e lidhur mes Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë të vitit 2012 “Për mbajtjen dhe trajtimin e përkohshëm të arrestuarve/ ndaluarve të komisariteve të policisë Berat, Sarandë dhe Tropojë në ambientet e IEVP, të Ministrisë së Drejtësisë”, brenda mjediseve të IEVP-së gjendeshin 2 dhomat e sigurisë së Komisarariatit të Policisë Berat. Në ditën e inspektimit, në këto dhoma gjendeshin 7 persona. Gjithashtu, në IEVP Berat, në ditën e inspektimit kishte 4 persona të diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit

të inspektimit. Nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve iu bë me dije se IEVP Berat është një institucion paraburgimi, i cili nuk ka seksion të veçantë për të paraburgosurit e moshës 18-21 vjeç. Megjithatë, në institucion, në momentin e inspektimit kishte 10 të paraburgosur të moshës 18-21 vjeç. Ai, gjithashtu, informoi se problematika e amortizimit e të gjithë godinës, si dhe mungesa e fondeve për këtë drejtim, vijonte të ishte prezente.

Në kohën e monitorimit, dhomat e observimi/ veçimit për shkak të mbipopullimit ishin kthyer në mjedise banimi. Rrjedhimisht, këto dhoma kishin humbur qëllimin e tyre ligjor dhe ishin në shkelje të standardit për sipërfaqen dhe kubaturën e banimit për person.

### ***Trajtimi***

Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të paraburgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Në IEVP Berat, në momentin e inspektimit, pati ankesa të cilat kishin të bënin me cilësinë e ushqimit, si në drejtim të cilësisë së gatimit, ashtu edhe në drejtim të larmishmërisë së vakteve dhe tej zgjatjen e proceseve gjyqësore, mbipopullimin në dhoma, dhe mungesën e medikamenteve.

### ***Masat mbrojtëse***

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm.

Dhoma e observim/ veçimit ishte në regjim, por për shkak edhe të mbipopullimit e kishte humbur qëllimin e tij ligjor dhe ishte kthyer në mjedis banimi.

Ekzistonte sistemi i kërkesë/ ankesave. Të paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ ankese dhe ia dorëzonin psikologut, i cili i dërgonte në protokoll. Pas protokollimit Drejtori i Institucionit, kthente përgjigje brenda ditës ose brenda 3 ditëve.

Të gjithë të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte kamera sigurie.

### ***Kushtet materiale***

Ashtu siç u konfirmua nga Drejtuesi i Institucionit dhe siç është konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, mjedisi në regjim, i përbërë nga një kat me 22 dhoma, 2 prej të cilave, bazuar në marrëveshjen e lartpërmendur mes MPB dhe MD përdorëshin nga Komisariati i Policisë Berat, vijon të jetë tejet i amortizuar dhe me lagështirë.

Dhomat e banimit akomodonin nga 2, 6 ose 8 persona, por jo të gjitha dhomat respektonin standardin e hapësirës jetike për person, duke marrë në konsideratë edhe faktin e mbipopullimit.



Grupi i inspektimit konstatoi se për shkak të mbipopullimit një pjesë e mirë e të paraburgosurve flinin mbi shtroje në dysheme.

Gjithashtu, u konstatua se jo të gjitha dhomat ishin të pajisura me tavolina, karrige, apo pajisje elektro-shtëpiake. Dhomat nuk kishin tualete të brendshme. Për të gjithë regjimin kishte vetëm 2 tualete të përbashkëta, të cilat ishin tejet të amortizuara dhe me kushte të varfra higjieno-sanitare. Pavarësisht se nuk kishte probleme me ujin e rrjedhshëm dhe atë të ngrohtë, dushi bëhej me grafik në 2 dushet e përbashkëta ku lagështira ishte në ekstremitet.

Në ditën e inspektimit u konstatua gjithashtu, një i paraburgosur me probleme të shëndetit mendor, i cili nuk kishte krevat, por flinte për tokë me një dyshek tërësisht jashtë standardit, në një hapësirë ku këmbët e të paraburgosurit ishin të futura poshtë krevatit të një personi tjetër, gjë që përbente një trajtim diskriminues, degradues dhe çnjerëzor.

Grupi i inspektimit konstatoi se dhomat në regjim kishin shumë pak ndriçim natyral dhe artificial, pasi dritaret ishin tepër të vogla dhe të mbuluara me rrjetë teli, gjë që pengonte hyrjen e dritës natyrale dhe ajrimin brenda në dhomë.

Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të regjimit, në I EVP Berat, kishte 2 dhoma, të cilat përdorshin si për takimin me familjarët, ashtu edhe për takimin me avokatët dhe për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës, të cilat kishin dy dritare me skarë hekuri dhe me rrjetë teli, që e bënë të pamundur komunikimin vizual normal dhe pa probleme me familjarët. Grupi i inspektimit konstatoi se takimi me familjarët kryhej me familjarët që qëndronin në këmbë në pjesën e jashtme të institucionit dhe të paraburgosurit në pjesën e brendshme. I njëjti mjedis përdorej dhe për fëmijët. Drejtuesi i institucionit informoi grupin e inspektimit se kishte dhënë një urdhër lidhur takimet e të paraburgosurve me fëmijët deri në 10 vjeç, të kryheshin në korridor, me ndarëse skare. Ky ambient përveçse sa më lartë, përdorej edhe për manipulime apo ekzaminime mjekësore, pasi dhoma përkatëse e mjekut mungonte.

Në institucion nuk kishte sistem qendror ngrohjeje. Grupi i inspektimit u informua nga drejtuesi i institucionit, si edhe nga vetë të paraburgosurit gjatë intervistave me ta, se për shkak se dhomat ishin me përmasa tepër të vogla për të akomoduar numrin e madhe të të paraburgosurve, në muajt e nxehtë të verës, dyert e dhomave në regjim mbaheshin të hapura dhe shtoheshin orari i ajrimit.

Korridori i ambientit të I EVP-së, ishte tejet i amortizuar me tela të rrymës elektrike të ekspozuara, të cilat përbënin rrezikshmëri të lartë.

Vlen të theksohet fakti se nuk kishte ambiente për aktivitete këshilluese, fetare, kulturore, sportive etj. Biblioteka konsistonte në disa rafta në korridorin e jashtëm në hyrje të institucionit.

Grupi i inspektimit konstatoi se kishte një mjedis të jashtëm, i cili përdorej për ajrim, ku të paraburgosurit dilnin nga ora 9:00 deri në 13:00 dhe nga ora 15:00 deri në 17:00. Nga intervistat brenda në regjim u konstatua se të paraburgosurit lejoheshin të dilnin në ajrim dhe se nuk kishin pasur probleme në këtë drejtim.

Ndërkohë që pajisja e të paraburgosurve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjente, pasta dhe furça dhëmbësh, etj., ishte e pamjaftueshme, pothuajse inekzistente. Pavarësisht sa më lartë, grupi i inspektimit nuk vuri re prani insektesh apo brejtësish.

Kuzhina, ishte një mjedis tepër i vogël i amortizuar dhe me kushte të varfra higjieno-sanitare. Pajisjet ishin tepër të amortizuara ku përfshihej soba të tipit kamping dhe kampionët ushqimorë mbaheshin në një frigorifer kampingu të mbyllur me zinxhirë dhe dry. Në kuzhinë punonin një kuzhinier dhe ndihmës kuzhinier. Menyja e përditshme është e afishuar. Nga intervistat e kryera me të paraburgosurit, grupi i inspektimit u informua se pjesa më e madhe e të paraburgosurve nuk e konsumonin ushqimin e institucionit, por e gatuanin vetë ose e merrnin nga familjarët.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj., ishte i afishuar. Nga bisedat me të paraburgosurit, grupi i inspektimit mori informacionin se ajrimi ishte një aktivitet i kryer sipas standardeve. Sipas grafikut, orari i ajrimit ishte nga ora 9:00 deri në 13:00 dhe nga ora 15:00 deri në 17:00. Ky i fundit shtohet gjatë muajve të verës dhe në raste mbipopullimi, siç edhe ishte në momentin e inspektimit.

Duke marrë në konsideratë faktin se në regjim nuk kishte mjedise të përshtatshme, në IEVP Berat nuk kishte mundësi realizimi të thujse asnjë aktiviteti kulturor, edukativ, fetar, përfshirë këtu edhe kurset profesionale.

Nga takimi me punonjësin e sektorit të kujdesit social, si edhe nga intervistat e kryera me të paraburgosurit, grupi i inspektimit vuri re një komunikim dhe ndërveprim shumë të mirë të ndërsjellë mes tij dhe të paraburgosurve. Disa nga dosjet ishin të rregullta, ku përfshiheshin përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse, ndërsa në disa të tjera kishte ende elementë për të plotësuar.

Në momentin e inspektimit ishin 3 të paraburgosur të punësuar në këtë institucion, si sanitar dhe shpërndarës ushqimi.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e stafit mjekësor në këtë institucion përbëhet nga një mjek me kohë të pjesshme dhe tre ndihmës mjekë.

Gjatë inspektimit në këtë IEVP, si dhe nga intervistat me të paraburgosurit, u konstatua se kishte një sërë problematikash sa i përket shërbimit shëndetësor në këtë institucion. Ato ishin kryesisht të lidhura me mjekimet, të cilat në shumicën e rasteve mbuloheshin me ilaçe që siguroheshin nga familja. Probleme të shumta kishte gjithashtu në realizimin e konsultave jashtë institucionit. Grupi i inspektimit konstatoi se të gjithë veprimet, vizitat dhe ndërhyrjet mjekësore nga ana e stafit mjekësor bëheshin në një ambient krejtësisht të papërshtatshëm, jashtë standardit, në kushte çnjerëzore dhe degraduese.

Gjithashtu, ankesa të shumta kishte edhe për shërbimin stomatologjik, i cili sipas pretendimit të personave të intervistuar, ofrohej vetëm privatisht, megjithëse kishte një kontratë me Qendrën Stomatologjike Berat. Kjo pasi ky institucion nuk kishte në organikë e tij një stomatolog. Rastet me probleme dentare, sipas informacionit të marrë nga mjeku i institucionit, ishin mjekuar me antibiotik për infeksion dentar, dhe më pas kishin vazhduar trajtimet përkatëse në Qendrën Stomatologjike të rrethit Berat.

Sipas statistikës së muajit shtator në këtë I EVP ndodheshin 22 të paraburgosur të sëmurë kronikë, të cilët vuanin nga sëmundje kardiake, neurologjike, okulistike, hematologjike, etj. Nga këta, 4 të paraburgosur ishin diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor, dhe 5 njiheshin si abuzues me substanca narkotike.

Në këtë institucion nuk kishte dhomë mjeku, farmacisti, apo infermierie. Si dhomë e tillë shërbente dhoma e takimit me familjarët, duke shkelur standardet e trajtimit mjekësor të personave në këtë institucion. Gjithashtu, mungesa të theksuara kishte edhe në pajisjen me medikamente si të urgjencës, ashtu dhe për të sëmurët kronik.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti ai i mjekut, u konstatua ekzistenca e një regjistri të vizitave të mjekut, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve dhe kartelave mjekësore, të cilat ishin mbajtur me rregull.

Në ditën e inspektimit ishte vetëm një i paraburgosur i pajisur me librezë shëndetësore. Për rrjedhojë, skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte për asnjë person që mbahej në këtë institucion.

Në përfundim të inspektimit, grupi i inspektimit, u shoqërua nga drejtuesi i institucionit në mjediset e I EVP-së së re, e financuar me fonde të BE-së, e cila, përgjithësisht përmbush të gjitha standardet sipas legjislacionit në fuqi. Nga Drejtori i I EVP Berat, grupi inspektues u informua se kjo godinë, ishte në momentet e fundit të marrjes në dorëzim.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për marrjen në dorëzim të godinës së re për I EVP Berat, gjë që do të sillte përmbushjen e të gjitha standardeve jetësore për të paraburgosurit.
2. Marrja e masave lidhur me uljen e mbipopullimit në godinën aktuale të I EVP Berat.
3. Marrja e masave lidhur me kushtet higjieno-sanitare dhe lagështirën në tualete dhe dushe.
4. Marrja e masave lidhur me instalimet e ekspozuara elektrike, të konstatuar si tepër të rrezikshme në korridorin e regjimit.
5. Marrja e masave për kryerjen e këshillimeve psiko-social, si edhe të aktiviteteve të tjera me këtë fokus, brenda regjimit në një mjedis të përshtatshëm për këtë gjë.
6. Marrja e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të mjediseve të banimit.
7. Marrja e masave për krijimin e kushteve të përshtatshme të takimit të të paraburgosurve me familjarët, avokatët, por veçanërisht me fëmijët.

8. Marrja e masave lidhur me plotësimin e dosjeve psiko-sociale të paplotësuara.
9. Marrja e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së këtij institucioni me një mjek me kohë të plotë.
10. Marrja e masave të menjëhershme për mundësisë e krijimit në këtë institucion të një dhome të posaçme me kushte optimale për mjekun, farmacinë dhe infermierinë në mënyrë që të ofrohet një shërbim shëndetësor sa më dinjitoz për të gjithë të paraburgosurit që mbahen aty.
11. Marrja e masave të menjëhershme për krijimin e kushteve të jetesës, si dhe atyre higjieno-sanitare më të përshtatshme, për persona të diagnostikuar me sëmundje kronike e në veçanti ata të diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor.
12. Marrja e masave të menjëhershme për vënien në funksion të plotë të skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe pajisjen me libereza shëndetësore të të gjithë paraburgosurve.
13. Marrja e masave të menjëhershme për kompletimin e farmacisë me medikamente, kryesisht të urgjencës.

#### **5.19. IEVP “Mine Peza” 302 Tiranë - Datë 17.10.2014 / Nr. Dok. 201401977**

##### ***Shënime paraprake***

IEVP Mine Peza një institucion ka kapacitet maksimal prej 170 personash, i kategorizuar në një seksion të sigurisë së lartë dhe një të sigurisë së zakonshme. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 237 persona të paraburgosur dhe 8 persona të tjerë në QSB. Rrjedhimisht, mbipopullimi ishte problematikë e dukshëm e qenësishme.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit.

##### ***Trajtimi***

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të paraburgosurve, me identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të paraburgosurit, grupi monitorues pati pretendime për ushtrim dhune, të cilat, pavarësisht përpjekjeve të grupit inspektues, nuk u vërtetuan përtej çdo dyshimi.

Në takimin paraprak grupi i inspektimit u informua se me masë disiplinore kishte vetëm dy persona me përjashtim nga ajrimi, ndërkohë që nga regjistri i masave disiplinore dhe konstatimet nga vëzhgimi i grupit të inspektimit, si edhe dokumenteve të marra kishte mospërputhje. Kështu, në raportin e shërbimit thuhej se i paraburgosuri Y.J., kishte thyer llambën e ndriçimit në kohën që kishte qenë në veçim, ndërkohë që, sipas datave, ky person që duhej të ishte në veçim në datën që është bërë inspektimi, në fakt nuk është gjetur fizikisht aty. Gjithashtu, për shkak edhe të rasteve konkrete të pretendimeve për dhunë, apo tejkallim të kompetencave nga ana e stafit të institucionit, MKPT kërkoi edhe këqyrjen e kamerave të vëzhgimit në datat dhe orët e

pretenduara nga të paraburgosurit. Pavarësisht hezitimit të drejtuesit të institucionit, me ndërhyrjen edhe të Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, me asistencën e ardhur nga DPB, MKPT mori akses të plotë në vëzhgimin e kamerave të sigurisë. Nga këqyrja e bërë, u konstatua se menjëherë pas ardhjes së grupit të inspektimit në institucion, nga dhomat e veçimit kanë dalë 3 persona.

Po nga vëzhgimi i bërë kamerave të vëzhgimit, u vu re se në ndërrim të turnit të stafit, apeli bëhej i shoqëruar me grupin e gatshëm, një praktikë kjo e pavërejtur në institucione të tjera. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Burgjeve i vuri në dispozicion grupi të inspektimit Urdhrin e DPB nr. 274, datë 14.10.2014 “Për zbatimin e përkrahimit të detyrave të policisë së burgjeve dhe skemave të vendosjes së shërbimeve në IEVP “Mine Peza””, ku në interpretim të pikës 7/ 3, jepej mundësia për të bërë apelin në çdo turn me këtë procedurë. Një pjesë e mirë e të paraburgosurve përmendën punonjësit e sigurisë G.R., në ankesat e tyre për komunikim dhe sjellje të ashpër gjatë këtyre veprimeve, si edhe për ushtrim dhune, vendosje zinxhirësh, prangash dhe skafandrash, kryesisht në dhomën e avokatit, si edhe në mjediset e banimit, në shkallë, pikërisht në mjediset e pa monitoruara nga kamerat e vëzhgimit.

Në IEVP Mine Peza, në momentin e inspektimit, pati edhe ankesa të cilat kishin të bënin me cilësinë e ushqimit, si në drejtim të cilësisë së gatimit, ashtu edhe në drejtim të larmisë së vakteve dhe tej zgjatjen e proceseve gjyqësore, mbipopullimi në dhoma, dhe mungesën e medikamenteve.

### ***Masat mbrojtëse***

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm.

Dhomat e observim/ veçimit ishin në regjim, por rezultuan të ishin me kushte të varfra higjieno-sanitare.

Ekzistonte sistemi i kërkesë/ ankesave. Të paraburgosurit në këtë IEVP, plotësonin një formular kërkesë/ ankesë dhe ia dorëzonin më pas edukatorit në zarf ose jo. Ky i fundit i dërgonte në protokoll. Pas protokollimit i kalonin Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të dënuarit, sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, sipas intervistave ka pasur raste që kishin bërë një ankesë dhe nuk i ishte kthyer përgjigje ose ishte kthyer me shumë vonesë.

Të gjithë të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit, sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, pati pretendime për favorizime të të paraburgosurve të caktuar. Grupi i ekspertëve vuri re favorizime të disa të paraburgosurve, të cilët mund të lëviznin lirisht në mjediset e regjimit të brendshëm të IEVP Mine Peza.

Sa i përket çështjes së sigurisë, në regjim kishte kamera funksionale sigurie. Problematika e tyre kishte të bënte vetëm me çështjen e ruajtjes së regjistrimeve, të cilat, sipas informacionit të marrë edhe nga personi përgjegjës për këtë çështje në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, qëndronin vetëm për 2 javë në memorie, më pas zhdukeshin.

### ***Kushtet materiale***

Mjedisi në regjim vijon të jetë tejet i amortizuar, me lagështirë dhe i karakterizuar nga mbipopullimi.

Dhomat janë të përmasave të ndryshme, por për shkak të mbipopullimit jo të gjitha dhomat respektojnë standardin e hapësirës jetike për person. Grupi i inspektimit konstatoi se për shkak të mbipopullimit jo të gjithë paraburgosurit flinin në krevate, një pjesë e mirë e tyre flinin mbi shtroje në dysheme. Gjithashtu, u konstatua se jo të gjitha dhomat ishin të pajisura me tavolina, karrige, apo pajisje elektro-shtëpiake. Megjithatë, kishte mungesa detergjentesh, shtrojash, mjete të higjienës personale etj.

Të gjitha dhomat kishin tualete brenda, por në përgjithësi kishte kushte të varfra higjieno-sanitare dhe në çdo vend kishte prezencë insektesh. Disa prej dhomave kishin dritare, që bënë mundur ndriçimin e mjaftueshëm natyral dhe ajrit të pastër, por kishte edhe dhoma, të cilat kishin dritare tepër të vogla, ose ku pengoheshin nga tualetet dhe rrjedhimisht mungonte ajri i pastër.

IEVP Mine Peza, nuk ka ngrohje qendrore dhe grupi i inspektimit konstatoi se të paraburgosurit përdornin mjete të siguruara nga vetë ata si në dimër, ashtu edhe në verë.

Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të regjimit, në IEVP Mine Peza, ka një mjedis për takimet me familjarët, me 4 sportele të ndara me skarë hekurash, që monitorohet me kamera vëzhgimi. Nuk ka një mjedis të veçantë takimi pa kufizime për të paraburgosur që kanë fëmijë të vegjël ose të afërm të moshuar. Ka gjithashtu, një mjedis të posaçëm për takimin me avokatët të pajisur sipas standardeve.

Në sektorin e I-rë të katit të I-rë, ku ndodhen edhe dhomat me të paraburgosurit 18-21 vjeçarë kishin dushe të përbashkëta, të cilat përdorshin sipas një grafiku të paracaktuar.

Pati ankesa nga të paraburgosurit lidhur me mungesën e aktiviteteve në institucion, pavarësisht se në hyrje të institucionit ndodhet fusha e volejbollit, si i vetmi mjedis për aktivitete sportive. Grupi i inspektimit konstatoi se ka një mjedis për aktivitete këshilluese dhe bibliotekë, pavarësisht se me pak tituj. I njëjti mjedis përdoret edhe për aktivitete të tilla si fetare, social-kulturore, për ditë të veçanta festash etj. Në bibliotekë gjenden dhe 4 kompjuterë, të cilët përdoren për tema të ndryshme, si dhe një tryezë pingpongu.

Grupi i inspektimit konstatoi se kishte një mjedis të jashtëm, i cili përdorej për ajrim, ku të paraburgosurit dilnin për ajrim vetëm paradite nga dy orë në ditë. Mjedisi i ajrimit nuk kishte strehë, gjë që në raste shiu e bënte të pamundur kryerjen e orarit të caktuar të ajrimit.

Kuzhina, ishte një mjedis në hyrje të regjimit, e pastër dhe e pajisur me mjetet e nevojshme për gatim. Gjithashtu kampionët mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të kyçura. Grupi i inspektimit konstatoi se për personat diabetikë kishte të njëjtin ushqim, por të gatuar sipas dietës përkatëse. Menyja e përditshme ishte e afishuar. Nga intervistat e kryera me të paraburgosurit, grupi i inspektimit u informua se pjesa më e madhe e tyre nuk e konsumojnë ushqimin e institucionit për

shkak të cilësisë dhe mungesës së larmisë. Gjithashtu, grupi i inspektimit konstatoi fizikisht vërtetësinë e ankesave lidhur me bukën, e cila ishte e fortë dhe e vjetër për t'u konsumuar.

Në hyrje të mjedisit të ajrimit ndodhej dhe dyqani i institucionit. Dyqani ishte i vogël dhe nuk ofronte shumë larmi artikujsh. Lista e çmimeve të produkteve ndodhej e afishuar.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj., ishte i afishuar. Megjithatë, nga bisedat me të paraburgosurit, grupi i inspektimit mori informacionin se nuk kishte aktivitete dhe se të paktën aktivitetet sportive të ishin më të shpeshta tek fusha e vetme sportive në këtë institucion.

Nga intervistat e realizuara me të paraburgosurit në lidhje me aktivitetet apo programet që zhvillohen në këtë institucion, ata pretendonin se aktivitetet e përbashkëta edukative ose sportive, ishin të rralla dhe thuajse mungonte mundësia e shfrytëzimit dhe lejimit të përdorimit të fushës së volejbollit, e cila ndodhej në oborr në pjesën e përparme të godinës. Sipas tyre mungesa të theksuara kishte për sa i përket edhe mjeteve/ pajisjeve sportive.

Sa i takon programit mësimor për ciklin e ulët dhe 9-vjeçar, grupi i inspektimit u informua se institucioni ishte në prag të fillimit të procesit mësimor për 4 të paraburgosur. Gjithashtu, kishte filluar edhe regjistrimi për kurset profesionale të tilla si për hidraulik, ku do të përfshihen 24 persona, 3 prej të cilëve 18-21 vjeçarë, kursi i anglishtes ku do të përfshihen 28 persona, 2 prej të cilëve 18-21 vjeçarë, si dhe kursi i kuzhinës.

Grupi i inspektimit konstatoi se biblioteka ishte një mjedis shumë-funksional, pavarësisht se me pak tituj ku në momentin e inspektimit po mbahej një aktivitet fetar nga SHKBSH-ja. Kjo e fundit i organizonte aktivitete e veta çdo të premte, ndërkohë që aktivitetet e besimit mysliman zhvilloheshin çdo të mërkurë. Ky ambient përdorej si për këshillime individuale, aktivitete të ndryshme fetare, ashtu edhe për kurset profesionale. Një mjedis tjetër i cili përdorej për këshillime individuale dhe kurse për analfabetët ndodhej në katin e parë e cila ishte e pajisur me një tavolinë të gjatë, gjashtë karrige, një dollap me disa revista dhe disa piktura të varura në mur.

Në dosjet psiko-edukative nuk mungonin programe individuale të trajtimit si dhe organizimi i aktivitete të përbashkëta me ta, kryesisht diskutime në grup për tema sociale dhe aktivitete sportive. Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

Në momentin e inspektimit ishin 15 të paraburgosur të punësuar në këtë institucion, kryesisht si pastrues, sanitar, shpërndarës ushqimi etj.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e sektorit të shëndetësisë përbëhej nga përgjegjësjë e sektorit, e cila ishte dhe mjekja e institucionit, një stomatolog, një farmacist, 4 ndihmës mjekë.

Gjatë inspektimit në këtë institucion, si dhe gjatë intervistave me të paraburgosurit pretendohet nga shumica e të intervistuarve se nuk ofrohej një shërbim efikas shëndetësor, kryesisht ai dentar, ku sipas të intervistuarve stomatologu nuk kryente asnjë shërbim tjetër përveç ekstraksioneve. Në ankesat e tyre të paraburgosurit shpreheshin se kërkesat e tyre për vizita nga mjekja e institucionit, ekzaminime e analiza laboratorike nuk merreshin në konsideratë ose kishte vonesa në shërbimet që sektori shëndetësor duhej ti ofronte. Gjithashtu, ankesa të shumta kishte edhe për mangësitë në ilaçe si për rastet urgjente ashtu edhe për të sëmurët kronik të cilët shpesh detyroheshin që mjekimin ta siguronin nga jashtë nëpërmjet familjes. Një tjetër problematikë e pretenduar nga të intervistuarit ishte edhe vonesa të theksuara në kryerjen e ekzaminimeve, analizave laboratorike e konsultave në qendrat e specializuara mjekësore.

Nga të dhënat e marra nga sektori i kujdesit shëndetësor, rezulton se në këtë institucion trajtoheshin me probleme të shëndetit mendor 5 të dënuar, 2 të diagnostikuar me Epilepsi, 10 të diagnostikuar me Diabet Mellitus, 13 me patologji të tjera kardiake e pulmonare dhe një i diagnostikuar me HIV/ AIDS. Gjithashtu, në këtë institucion vuanin dënimin 5 shtetas abuzues me substanca narkotike, nga të cilët 4 prej tyre trajtoheshin me Metadon.

Institucioni ishte i pajisur me një autoambulancë, gjë që lehtësonte transportin e të paraburgosurve në qendra mjekësore të specializuara

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, në veçanti të mjekut, u konstatua ekzistenca e një regjistri themeltar, dhe një regjistër vizitash të sekretuar. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura në rregull. Kartelat mjekësore ishin të plotësuara në mënyrë korrekte dhe mbaheshin të mbyllura me çelës. Me gjithë vështirësitë e hasura për arsye të brendshme apo/ dhe të jashtme të institucionit, konsultat dhe ekzaminimet në qendra të specializuara spitalore ishin realizuar duke i dhënë prioritet rasteve emergjente si dhe për rastet e moshuara, duke i dokumentuar edhe në kartelat përkatëse. Me librezë shëndetësore ishin të pajisur 190 të paraburgosur. Pjesa tjetër, që sapo ishin akomoduar në këtë institucion, prisnin plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me librezë shëndetësore. Skema e rimbursimit të ilaçeve ishte në funksion të plotë për të sëmurët kronik dhe ata akut. Përjashtim bënin rastet që me kërkesën e të paraburgosurve apo/ dhe familjarëve të tyre, mjekimi sigurohej nga jashtë institucionit.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për marrjen në analizë të rasteve të pretenduara të dhunës, si edhe marrjen e masave përkatëse administrative ndaj personave përgjegjës.
2. Marrja e masave të menjëhershme për ndryshimin e pikës 7/ 3 të Urdhrit të DPB nr. 274, datë 14.10.2014 “Për zbatimin e përshkrimit të detyrave të policisë së burgjeve dhe skemave të vendosjes së shërbimeve në IEVP “Mine Peza”, që jep mundësinë për të bërë apelin me grup të gatshëm në çdo turn, pasi kjo procedurë lë vend për ngritje dyshimi dhe pretendimesh për dhunë fizike e presion psikologjik.
3. Marrja e masave për plotësimin e saktë të regjistrit të masave disiplinore, duke saktësuar masën e dhënë dhe kohëzgjatjen e masës për çdo shkelje të bërë nga të paraburgosur,



sipas nenit 53 të ligjit nr. 40/ 2014 për "Të drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosur", i ndryshuar.

4. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me uljen e mbipopullimit në këtë institucion.
5. Marrja e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të mjediseve të banimit.
6. Marrja e masave për krijimin e kushteve të përshtatshme të takimit të të paraburgosurve me familjarët, veçanërisht me fëmijët.
7. Marrja e masave për përshtatjen dhe krijimin e kushteve sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të veçimit.
8. Marrja e masave lidhur me kushtet higjieno-sanitare dhe lagështirën në tualete dhe dushe.
9. Marrja e masave për kryerjen e më shumë aktiviteteve, kryesisht ato sportive.
10. Marrja e masave për mbulimin e një pjese të mjedisit të ajrimit, në mënyrë të tillë që ky i fundit të shfrytëzohet edhe në raste shiu.
11. Marrja e masave për kryerjen në vizitave më të shpeshta të mjekes së institucionit brenda në regjim.
12. Marrja e masave për ofrimin e një shërbimi më efikas shëndetësor duke i dhënë mundësinë të paraburgosurve për ekzaminime dhe konsulta në qendra spitalore të specializuara sipas rasteve që paraqesin nevoja për konsulta më të specializuara.
13. Marrja e masave për ofrimin e një shërbimi stomatologjik të plotë dhe efikas nga ana e stomatologut.
14. Marrja e masave për pajisjen e dhomës së stomatologut me materiale dhe instrumente dentare.
15. Marrja e masave nga ana e stafit drejtues të institucionit për furnizimin e farmacisë me ilaçe si për rastet akute ashtu dhe ato kronike duke vënë në zbatim e skemën e rimbursimit të ilaçeve më me efikasitet.

#### **5.20. I EVP Drenovë, Korçë - Datë 29.10.2014 / Nr. Dok. 201402002**

##### ***Shënime paraprake***

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në I EVP "Drenovë" për vitin 2014. Institucioni ka kapacitet maksimal prej 312 personash ndarë në 4 seksione, konkretisht seksionin e sigurisë së lartë, seksionin e sigurisë së zakonshme, seksionin e paraburgimit dhe seksionin e paraburgimit për të mitur.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit, duke ofruar akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhej të monitoroheshin. Grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion mbi situatën aktuale në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni.

Drejtori i institucionit parashtrroi situatën duke theksuar si problemin më kryesor mbipopullimin, i cili kishte sjellë për pasojë reduktimin e kushteve të jetesës brenda institucionit si dhe vështirësi

në ofrimin e shërbimeve cilësore. Në ditën e inspektimit në institucion ndodheshin 452 persona (140 persona mbi kapacitet), prej nga 11 persona të moshës 18-21 vjeçare, 3 të mitur, 11 persona me probleme të shëndetit mendor dhe 9 persona me varësi nga substancat. Për të miturit dhe personat me probleme të shëndetit mendor ekzistonte një seksion i veçantë.

Sipas drejtorit ngjarje të rënda ishin disa raste me tentativa vetëvrasje të cilat ishin parandaluar në momentin e duhur nga stafi.

Referuar në informacionin e marrë dhe të konfirmuar me listën zyrtare të të punësuarve, në institucion në kohën e monitorimit figuronin të punësuar 30 të punësuar të gjithë të dënuar.

Organika nuk ishte e plotësuar. Gjatë vëzhgimit të dokumenteve dhe intervistave me stafin dhe vetë të dënuarit dhe parburgosurit rezultoi se kishte disa mungesa. Konkretisht në sektorin juridik mungonte juristi, në sektorin psiko-social mungonte psikologja (e cila ishte me leje lindje) dhe atë të shëndetësisë ku ishte vetëm një mjek psikiatër me kohë të pjesshme por mungonte mjeku i përgjithshëm (ndërkohë që janë parashikuar të jenë dy mjekë me kohë të plotë).

### ***Trajtimi***

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të parburgosurve, identifikimin e rasteve të përdorimit të torturës, trajtimin degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore të “veçimit nga aktivitetet e përbashkëta“. Lidhur me sa më sipër, gjatë inspektimit në sektorin e sigurisë së lartë grupi monitorues i MKPT u ndesh me një denoncim nga ana e disa të dënuarve të këtij sektori të cilët pretendonin se ndaj bashkëvuajtësit të tyre S.S. ishte ushtruar dhunë fizike nga ana e grupit të gatshëm me datë 25.10.2014 gjatë një kontrolli për sende të ndaluara në dhomën e tij dhe se i dënuari S. S., ishte dërguar në ambientet e veçimit pasi pas ushtrimit të dhunës ndaj tij ishte dhënë dhe një masë disiplinore 20 ditë veçim. Lidhur me këtë ngjarje dhe në shqyrtim të ankesës të të dënuarit S.S se ndaj tij ishte ushtruar dhunë fizike nga ana e forcave të sigurisë, Institucioni i Avokatit të Popullit ngriti në vijim të vizitës monitoruese një grup ad-hoc, i cili administroi procesverbalet e pyetjes së shtetasve që kishin dijeni për çështjen në fjalë. Gjetjet paraqiten në vijim:

Dhoma e S.S., ndodhej ishte në seksionin e Sigurisë së Lartë dhe në dhomë të qëndronte një person. Sipas ankuesit dhuna ka qenë e urdhëruar nga ana e Shefit të Sigurisë B.K., si ndëshkim lidhur me probleme personale të mbartura nga Burgu i Peqinit, nga ku ishin transferuar për në IEVP Drenovë si i dënuari S.S. ashtu dhe Shefi i Sigurisë B.K. Nga ana e ankuesit dhe nga pyetjet e të dënuarve nga ana e ekspertëve u identifikuan dy dëshmitarë të cilët kishin dijeni për ngjarjen dhe dëshmuan lidhur me rrethanat e ndodhjes së saj. Sipas procedurave hetimore u administruan procesverbalet e pyetjes së dy dëshmitarëve, ku njëri pretendonte se kishte dëgjuar por nuk kishte parë gjë pasi ndodhej në dhomën ngjitur në krah të djathtë, ndërsa tjetri deklaroi se kishte parë efektivet e ndërhyrjes së shpejtë të ushtronin dhunë ndaj S.S. gjatë prangosjes së tij për ta shoqëruar në ambientet e veçimit.

Grupi hetimor mori në pyetje dhe administroi proces-verbalet e dy punonjësve të policisë pjesëtarë të grupit të gatshëm prezent në institucion gjatë vizitës monitoruese, të cilët deklarorin se kishin marrë pjesë në shoqërimin e ankuesit nga dhoma në ambientet e veçimit, por që në momentin e hyrjes së tyre në dhomën e tij S.S., ishte i prangosur nga kolegët e tyre ishte bërë gati për t'u shoqëruar në ambientet e veçimit. Sipas thënieve të tyre nuk ishte ushtruar dhunë nga kolegët, por vetëm force proporcionale për prangosje në zbatim të rregullores pas mosbindjes, fyerjes dhe rezistencës së shfaqur nga ana e ankuesit në kundërshtim të kontrollit të dhomës për sende të ndaluara.

Në përfundim të hetimit, ekspertët e MKPT bazuar në dëshmitë e marra dhe në konstatimin e shenjave të lëna në trupin e të dënuarit S.S. si rezultat i përdorimit të shkopit të gomës, arriti në dyshimin e arsyeshëm se ka pasur përdorim të tepruar të forcës nga ana e forcave të grupit të gatshëm. Praktika të tilla janë të papranueshme dhe personat të cilët përdorin praktika të keqtrajtimit fizik të paraburgosurve apo përdorim të tepruar të forcës duhet të vihen para përgjegjësisë. Drejtuesit e institucionit duhet të marrin hapa konkrete lidhur me çrrënjosjen e rasteve të keqtrajtimit fizik të të burgosurve nga stafi i sigurisë, duke përmirësuar menaxhimin dhe mekanizmat mbikëqyrës. Hetime të shpejta dhe efektive, të cilat mundësojnë identifikimin dhe marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës për keqtrajtim ndaj të burgosurve, janë esenciale për t'i dhënë vlerë reale parimit dhe detyrimit ligjor për ndalimin e torturës dhe trajtimit degradues dhe jo human dhe ndëshkues në burgjet tona.

Në vijim të vizitës monitoruese, nga informacioni i marrë gjatë bisedave në grup dhe në privatësi me vetë të dënuarit dhe të paraburgosurit, grupi monitorues konstatoi shumë ankesa në lidhje me trajtimin, të lidhura kryesisht me pasojat që kishte sjellë mbipopullimi, probleme me lejet shpërblyese e ato të veçanta, mungesën e ngrohjes gjatë dimrit, mungesën e ofrimit të ajrimit për sektorin e paraburgimit të mbivendosur në seksionin e Observimit, kushtet e dhomave veçanërisht të atyre në seksionin e observimit, ambientet e ajrimit, mungesën e aktiviteteve, çmimet e larta të dyqanit, si dhe mbi mungesën e detergjenteve për pastrim.

Në ditën e inspektimit personat e privuar nga liria në institucion nuk kishin asnjë mjet ngrohje dhe sipas udhëzimit të DPB-së ngrohja qendrore do të ndizej me datë 15 nëntor deri më 31 dhjetor vetëm për 4 orë në ditë, gjë që për kushtet klimaterike ku ndodhet institucioni nuk rezulton e mjaftueshme. Po kështu, reshjet dhe borës pasojnë me mbushen me ujë të ambienteve të ajrimit, të cilat duke qenë se janë të pambuluara dhe të padrenazuara për kullimin e ujit, nuk funksionojnë për ajrosje deri në momentin që uji thahet nga kushtet natyrale.

Në trajtimin brenda institucionit u vu re një diferencim në kushtet e dhomave ndërmjet sektorëve. Nga vëzhgimet në Sektorin A rezultonte të kishte shtretër bosh, ndërkohë që në ambientet e Observimit situata paraqitej tej mase të mbipopulluar, me persona që flinin kryesisht me dyshek përtokë prej muajsh në kushte të papërshtatshme e që për pasojë kishin shfaqur probleme të herëpashershme shëndetësore. Dushet për këtë sektor mundësoheshin vetëm një herë në muaj ndërsa mungonte ajrimi dhe aktivitetet. Pritej që personat në observim të akomodoheshin së shpejti në ambientet e sektorëve të tjerë.

Për sa i përket trajtimit të të miturve në këtë institucion rezultonte se atyre nuk u sigurohej procesi mësimor dhe kjo sipas stafit të edukimit vinte si pasojë e mos përzierjes së tyre me

madhorët. Mungonin për ta edhe kurset profesionale. Ajrimi për këtë kategori ishte i njëjtë me atë të të rriturve, dhe ofrohej vetëm 2 orë në ditë në ambiente të veçanta. Ankesat e tyre ishin të lidhura me mungesën dusheve, ujit dhe sidomos atij të ngrohtë dhe mungesën e tualeteve në dhoma.

Për sa i përket 18-21 vjeçarëve, nga vëzhgimet dhe intervistat e kryera rezultonte se ata ishin të shpërndarë nëpër dhoma të ndryshme. Orari i veprimtarive dhe aktiviteteve ishte i njëjtë.

Sa i përket personave me probleme të shëndetit mendor, nga vëzhgimi i grupit monitorues brenda në regjim, rezultoi se personat me probleme të shëndetit mendor ndodheshin të shpërndarë nëpër dhoma të ndryshme. Nga shumë prej tyre pati ankesa për trajtim jo të mirë dhe mungesa e vizitës nga mjeku.

Për sa i përket ushqimit pati shumë ankesa. Shumica e të dënuarve dhe paraburgosurve pohuan gjatë intervistave se gatuanin vetë ose se ushqimet ua sillte familja. Ankesat vinin kryesisht për cilësinë e ushqimit dhe mungesën e larmishmërisë së gatimit. Më problematik paraqitej vakti i darkës në të cilin parashikohej gjithmonë fasule.

Ankesa të tjera gjatë intervistave pati dhe për çmimet e disa produkteve dhe artikujve të dyqanit, pasi nga verifikimet e grupit monitorues, çmimet ishin shumë herë më të larta në raport me njësitë tregtare jashtë institucionit.

### ***Masat mbrojtëse***

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga Sektori i Edukimit. Të paraburgosurit/ dënuarit në këtë IEVP, plotësonin një formular kërkesë/ ankesë dhe ia dorëzonin më pas edukatorit. Ky i fundit i dërgonte në protokoll. Pas protokollimit i kalonin Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të dënuarit, sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, sipas intervistave ka pasur raste që kishin bërë një ankesë dhe nuk i ishte kthyer përgjigje ose ishte kthyer me shumë vonesë.

Për sa i përket masave disiplinore në momentin e inspektimit dhe nga vizita që u bë në sektorin e veçim-izolimit u kontaktuan 4 persona me masë disiplinore. Të gjithë këtyre personave nuk u ishte dhënë një kopje e masës disiplinore, por masa u ishte komunikuar verbalisht. Nga vëzhgimi i regjistrave të masave disiplinore nuk pati mospërputhje.

Sa i përket lejeve shpërblyese dhe atyre të veçanta, sipas të dënuarve institucioni ishte i ngurtë në dhënien e tyre dhe pavarësisht se shumë prej të dënuarve i plotësonin kriteret e parashikuara, institucioni nuk ua miratonte.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Ajo për të cilën të dënuarit/ paraburgosurit u ankuan lidhur me telefonatat ishte çmimi i lartë i impulseve.

Nuk pati ankesa nga të dënuarit/ paraburgosurit për mosrespektim të numrit të takimeve me familjet, por u konstatuan ankesa nga shumë të dënuar për mënyrën e kryerjes së kontrollit të fëmijëve dhe grave sikurse dhe ushqimeve nga stafi i institucionit. Për të dënuarit e sigurisë së zakonshme dhe të paraburgosurit takimi me fëmijët e vegjël dhe prindërit e moshuar, zhvillohej në të njëjtat ambiente të takimit për personat e sigurisë së lartë. Ky takim zhvillohet pa kufizime fizike, por që për fëmijët nuk ofron një ambient të ngrohtë dhe mikpritës në përputhje me moshën e tyre.

Për sa i përket punësimit në këtë IEVP punonin 30 të dënuar të cilët pajiseshin me dinamikë pune dhe u njiheshin 3.9 ditë ulje dënimi. Në momentin e inspektimit pati disa ankesa për mos futjen në organikë pune të një personi i cili megjithëse punonte (pranuar kjo nga personat e tjerë të sektorit dhe stafi i sigurisë), nuk e kishte emrin në organikë, gjë e cila u verifikua me dokumentet përkatëse. Kërkesa të shumta kishte për hapjen e vendeve të reja të punës për të paraburgosurit sikurse funksionon në IEVP-të e tjera.

### ***Kushtet materiale***

IEVP Drenovë ka filluar funksionimin në vitin 2008. Pothuajse në të gjitha seksionet si ai i sigurisë së zakonshme dhe ai i sigurisë së lartë baza materiale ishte e plotësuar me përjashtim të seksionit të paraburgimit dhe dhomave në Seksionin e Observimit të kthyer në dhoma banimi për të paraburgosurit. Dhomat nuk ishin të gjitha të pajisura me televizor dhe frigorifer. Kryesisht çarçafët dhe batanijet e të dënuarve dhe të paraburgosurve për të gjithë sektorët ishin sjellë nga familjarët pasi institucioni nuk u vendoste në dispozicion çarçafë, por vetëm batanije të cilat rezultojnë mjaft të vjetruara. Larja e tyre mundësohej në lavanderi.

Problem kryesor dhe ankesa të shumta kishte në lidhje dhe me furnizimin me detergjent të higjienës personale dhe materialeve sanitare për pastrim të dhomave dhe tualeteve. Sipas të intervistuarve Institucioni kishte rreth nëntë muaj që nuk i pajiste të dënuarit dhe paraburgosurit me detergjent dhe kishte shumë persona që nuk kishin mundësi ekonomike për t'i blerë vetë ato. Disa prej të paraburgosurve dhe të dënuarve që nuk vizitoheshin nga familjarët e që nuk kishin mundësi ekonomike kishin mungesë të detergjenteve të higjienës personale dhe mungesë të çarçafëve.

Dushet ndodheshin në çdo seksion, përjashtuar ambientin e parashikuar për observim. Në ambientet ku bëhej dushi kishte lavamanë dhe katër ose pesë dushe. Kishte prani lagështire. Këtyre ambienteve nuk u mungonin pajisjet, por në momentin e vizitës monitoruese në institucion nuk kishte ujë. Në një pjesë të konsiderueshme, duke qenë se ishin pa sistem ngrohjeje, ato funksiononin thjesht për të marrë ujin e ngrohtë me orar dhe grafik. Nga intervistat që u bënë në të gjitha sektorët u pohua se kishte raste që dushi realizohej një herë në dhjetë ditë.

Për sa i përket dritës dhe ajrit, megjithëse shumica e dhomave ishin të vogla në kubaturë, nuk mungonte ajri dhe drita natyrore.

Furnizimi me ujë kryhej me orar përmes dy puseve, pasi nuk ekzistonte lidhja me rrjetin. Shumica e të intervistuarve pohuan se e blinin ujin e pijshëm pasi uji prej rubinetit ishte jo i mirë dhe nuk mund të pijej.

Në këtë IEVP ekzistonte një godinë e cila shërbente si spitali i këtij institucioni. Në katin e parë të tij ndodhej dhoma e stomatologut, dhoma e vizitave të mjekut si dhe farmacia. Ndërsa në katin e dytë ishte një pavijon me shtretër me 8 dhoma, ku një dhomë që mbahej për rastet me sëmundje infektive, për shkak të mbipopullimit ishte shndërruar në dhomë banimi për të mitur (dhoma nr. 6). Dhoma ofronte 1 krevat marinar dhe 1 krevat tek për 3 të miturit, si dhe 2 dyshekë në të cilin flinin përtokë personat e moshës 18-21vjeçare që gjendeshin në të. Përgjithësisht në pavijonin ku ishin të akomoduar të miturit kushtet e higjienës nuk ishin aspak të mira. Në godinë ndodheshin banjat me dy tualete dhe një post dushi jashtë standardit, ku mungonte uji i ngrohtë. Përfunduar dhomës së mjekut, stomatologut, dhe farmacisë, kushtet higjieno-sanitare ishin mjaft të këqija, të ftohta, pa ngrohje dhe me shumë lagështirë.

Ndërtesa në të cilën zhvilloheshin takimet me familjarët ishte një godinë më vete e cila shërbente vetëm për të kryer këtë funksion. Në këtë ambient ndodhen dy dhoma takimesh për sigurinë e lartë të cilat monitoroheshin me kamera, e ishin të pajisura me tavolinë dhe karrige në kushte të mira. Takimet për sigurinë e zakonshme dhe paraburgimin zhvilloheshin në një ambient të përbashkët, të ndarë në shtatë poste me sportele xhami në kushte të mira.

Seksioni i sigurisë së zakonshme ishte i vendosur në godinën B. Kjo godinë ishte e përbërë nga dy kate me nga katër sektorë për kat. Në dhoma ishin akomoduar tre deri në gjashtë persona, por kishte edhe raste ku në dhomë mund kishte vetëm një të dënuar.

Seksioni i sigurisë së lartë ishte i vendosur në sektorin A. Ky seksion ishte i ndarë në 4 sektorë për të dënuar me siguri e lartë, dhe 4 sektorë për të paraburgosur siguri e lartë. Kryesisht kati i parë i sektorit të të dënuarve kishte një shpërndarje nëpër dhoma me nga një të dënuar. Dhomat ishin të pajisura me tualete brenda. Ndërsa kati i dytë i këtij sektori të paraburgimit shfaqej shumë i mbipopulluar. Kryesisht nëpër dhoma ishin të akomoduar 3 deri në 4 persona ku në shumicën e rasteve 2 persona flinin me dyshek në tokë.

Observimi ishte i përbërë nga 10 dhoma ku në momentin e inspektimit u gjet në funksionin e një sektori paraburgimi si rrjedhojë e mbipopullimit të përgjithshëm. Por edhe në këtë sektor mbipopullimi shfaqej tejet normës së lejuar. Kështu p.sh., në dhomën nr. 9 mungonin krevatet, tavolina dhe karriget dhe në momentin e inspektimit në këtë dhomë u gjetën të akomoduar 9 veta të cilët flinin të gjithë në tokë me dyshek sfungjeri. Në ditën e monitorimit në këtë seksion qëndronin 56 persona. Në këtë sektor, dhomat ishin pa tualete brenda. Kishte dhoma të cilat nuk plotësonin asnjë standard jetese, me lagështi e myk, si dhe dritare që nuk mund të hapeshin. Në këtë sektor gjendeshin dy tualete të përbashkëta për të gjitha dhomat. Shqetësues ngelej fakti i kryerjes së dusheve jashtë kësaj godine. Sikurse u pasqyrua edhe më lart, nuk kishte hapësirë për ajrosje.

Funksionet e observimit i kryente seksioni i Veçimit, ku personat për observim mbaheshin 5 ditë. Në të gjendeshin gjithashtu 10 dhoma të pajisura me tualete brenda. Kishte dhoma në të cilat mungonin tavolinat dhe karriget. Ky seksion kishte ambient ajrimi.

Në IEVP kishte palestra, klasa dhe dhoma këshillimi. Gjithsesi, megjithëse ekzistonin si klasa dhe ambiente të përbashkëta, shumë prej tyre ishin bosh. Kishte një sallë kompjuterësh me të

gjithë kompjuterët ishin në gjendje funksionale. Palestrat nuk ofronin mundësi aktiviteti sportiv dhe e kishin humbur funksionin si të tilla. Aktivitetet sportive konsistonin kryesisht në kalçeto dhe lojëra tavoline. Klasat ishin të boshatisura dhe nuk ofronin mjetet e nevojshme si karrige, tavolinë, materiale promovuese shtesë etj.

Brenda sektorëve gjenden telefonat dhe kutitë e kërkesë/ ankesave.

Në IEVP kishte një mjedis biblioteke me 1929 artikuj dhe një ambient kulti i cili funksiononte si i tillë.

Kuzhina e institucionit ishte e madhe dhe moderne, me higjienë të kënaqshme, por punonjësit nuk mbanin doreza. Në kuzhinë ndodhej regjistri i gramaturave, menyja ditore, dhe kampionet ushqimore të gatuar një ditë më parë të ruajtura në kushte frigoriferike. Nuk kishte menu të veçantë për personat diabetikë. Në të punonin pesë të dënuar.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Në momentin e inspektimit nuk u vu re prania e punonjësve të edukimit dhe punonjësve social, megjithëse ata ishin në orarin e punës. Të pyetur për këtë fakt ata u përgjigjen se ka një mbingarkesë tej normës pasi një punonjës i edukimit duhet të mbulojë 4 sektorë dhe kjo është e parealizueshme deri në orarin zyrtar që ata duhet të kenë brenda në regjim që është deri në orën 13.00.

Për sa i përket orarit të veprimtarive ai vazhdonte të ngelej i njëjtë për të gjithë sektorët pavarësisht nga siguria që ata kishin, dhe aktivitetet e zhvilluara ishin shumë të varfëra sipas të intervistuarve. Megjithëse nuk mungonin ambientet për aktivitete social-kulturore këto aktivitete realizoheshin shumë rrallë. Aktivitetet kryesore konsistonin në shfaqjen e filmave ose festa me rastin e datave të rëndësishme.

1929 artikujt që gjendeshin në inventarin e bibliotekës iu jepeshin të dënuarve/ të paraburgosurve për të lexuar sipas kërkesave. Mungonte një specialist biblioteke, ndaj administrimi i bibliotekës mbulohej nga punonjësit e tjerë.

Në ambientin e kultit në orën 12:00-13:00 mblidheshin praktikuesit e fesë myslimane nën drejtimin e një të dënuari dhe praktikonin të gjitha ritet e tyre fetare. Ndërsa të martën, të enjten dhe të shtunën mblidhen praktikuesit e fesë katolike nën drejtimin e një të dërguari nga kisha e Korçës.

Salla e kompjuterëve përdorej për tema të ndryshme dhe kryesisht nga të miturit.

Aktualisht nuk ofrohej asnjë kurs profesional dhe i fundit kishte përfunduar në muajin Shtator 2014.

Në këtë institucion kishte 2 mësues të cilët mbulonin procesin arsimor dhe 47 persona që e ndiqnin atë. Asnjë nga të miturit nuk është pjesë e këtij procesi, me justifikimin se ata nuk duhej të përziheshin me të rriturit.

Grupi i ekspertëve konstatoi se ajrimi prej datës 20 tetor ofrohej dy orë në ditë, me minimumin e parashikuar, nga ora 09:00-11:00 dhe 11:00-13:00. Për periudhën përpara kësaj date, të dënuarit/paraburgosurit u shprehën se kishin edhe një orar ajrimi pasdite në orën 15:00-18:00. Për sa i përket kushteve të ambienteve të ajrimit, ato ishin plotësisht të hapura dhe nuk ofrohet një ambient i mbuluar dhe i siguar për rastet e shiut, borës dhe diellit gjatë verës.

Dyert e dhomave të institucionit qëndronin të mbyllura 20 orë në ditë, ndaj ajrosja dy orëshe, kalçetoja brenda orarit të ajrosjes dhe aktivitetet për ditë festash, dhe kurset arsimore për të regjistruarit në to, dhe aktivitetet fetare, ishin shumë të pakta për të plotësuar nevojat e të gjithë të paraburgosurve e të dënuarve në këtë IEVP.

Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale të të paraburgosurve/ dënuarve, u vu re që për personat me varësi nga substancat propozimet për ndërhyrje ishin këshillimi individual, këshillim në grup dhe terapi okupacionale. Sipas të paraburgosurve/ dënuarve këto këshillime nuk kryheshin, ndonëse ato ishin të pasqyruara në dosje. Këshillimi në grup konsistonte në diskutimin e temave, këshillimi individual konsistonte në takimet e disa prej stafit në dhoma, ndërkohë që terapia okupacionale shihej e lidhur me punësimin, por jo e pastër si e tillë. Për personat që kishin shfaqur tentativa vetëvrasje propozimet për ndërhyrje ishin akomodimi në dhomë me bashkëvuajtësit dhe këshillim për përbalimin emocional të situatës.

Nga vëzhgimet e dosjeve psiko-sociale u vu re që vlerësimi i ecurisë së planit të vuajtjes së dënimit plotësohej periodikisht çdo 3 muaj. Ndërsa vlerësimet për sjelljen në institucion plotësoheshin periodikisht çdo muaj, por përshkrimet ishin kryesisht standarde. Në dosjet e temave dhe programeve që stafi psiko-edukativë duhet të ofronte, nuk mungonin programe individuale të trajtimit si dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta megjithëse këto ishin thuajse inekzistente.

### ***Shërbimi Shëndetësor***

Stafi mjekësor në këtë institucion përbëhej nga përgjegjësi i sektorit i cili kishte formimin si ndihmës mjek, një mjek psikiatër me kohë të pjesshme (parashikuar mjek me kohë të plotë), 6 ndihmës mjekë, 1 stomatolog dhe 1 farmacist. Mungonte mjeku i përgjithshëm megjithëse ishte i parashikuar në organikë. Mungesa në organikë e mjekut u verifikua pas pretendimeve nga ana e të dënuarve dhe të paraburgosurve, të cilët u shprehën se nuk e njihnin mjekun e këtij institucioni dhe se vizitat e tij në regjim nuk kryheshin. Funksionin e mjekut e mbulonte përgjegjësi i sektorit.

Gjatë vizitës së grupit monitorues si dhe nga intervistat me të dënuarit u konstatuan problematika të ndryshme sa i përket shërbimit shëndetësor në këtë institucion. Ato ishin kryesisht të lidhura me mjekimet, të cilat shpesh mbulohehin me ilaçe që silleshin nga familja. Gjithashtu, kishte pretendime për sa i përket përgjigjes në kohë të kërkesave të të dënuarve për vizita mjekësore në varësi nga problematikat që manifestonin.



Ankesa kishte edhe në drejtim të shërbimit stomatologjik, i cili mungonte, si për sa i përket mjekimeve ashtu dhe mbushjeve apo ekstraksioneve, madje gjatë vizitës grupi ynë inspektues konstatoi raste konkrete të cilat kishin nevojë për ndërhyrje emergjente nga ana e stomatologut.

Kishte pacientë që vuanin nga Diabeti Mellitus, të cilët ushqimin e përgatisnin vetë pasi nga kuzhina ushqimi nuk vinte me dietën përkatëse.

Spitali i këtij institucioni ku ndodhej dhoma e stomatologut, dhoma e infermierisë, farmacia, pavijoni me 8 dhoma, banjat me dy tualete dhe një post dushi jashtë standardit, ishte pa ngrohje dhe me shumë lagështirë. Pavijoni ishte në kushtet higjieno-sanitare të papërshtatshme.

Dhoma e infermierisë, ku bëheshin edhe vizitat, si dhe injeksionet apo perfuzionet sipas nevojave, ishte e rregullt, e pastër e mirëmbajtur dhe e pajisur me një krevat vizitash, një dollap ku mbaheshin ilaçet e urgjencës dhe një tjetër ku mbaheshin kartelat mjekësore të kyçura me dry.

Dhoma e stomatologut gjithashtu ishte e rregullt, e pajisur me unit, autoklavë funksionale, si dhe instrumente e materiale dentare.

Farmacia e këtij institucioni ishte gjithashtu e mirëmbajtur dhe me larmi medikamentesh. Medikamente e urgjencës siguroheshin me fondet e institucionit, ndërsa ato për sëmundjet kronike nga skema e rimbursimit të ilaçeve. Problem për këtë institucion ishte mbulimi me ilaçe për sëmundjet akute.

Sipas informacionit që u mor nga përgjegjësi i sektorit shëndetësor në këtë institucion vuanin dënimin 11 persona me çrregullime të shëndetit mendor. Nga 9 të dënuarit/ paraburgosurit abuzues me substanca narkotike vetëm njëri prej tyre trajtohej me Metadon. Gjithashtu kishte edhe persona të tjerë të cilët vuanin nga sëmundje kronike ku 6 me Diabet Mellitus, 8 me patologji kardiake, 8 gastro-hepatologjike, 5 urologjike, 4 onkologjike, 2 neurologjike, etj.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri të vizitave mjekësore që plotësohej nga mjeku psikiatër, regjistri themeltar i të dënuarve dhe një formular kërkesash për vizita mjekësore, i cili plotësohej nga infermieri i turnit, libri i medikamenteve që siguroheshin nga familja si dhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve. Kartelat mjekësore ishin të mbajtura me rregull dhe të mbyllura në dollap me dry.

Skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte për 200 të dënuar, të cilët ishin të pajisur me librezë shëndetësore, ndërkohë që kishte vështirësi në zbatimin e kësaj skeme për të paraburgosurit, të cilët për shkak të vonësive në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale e kishin të pamundur sigurimin e ilaçeve me anë të skemës së rimbursimit të ilaçeve.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për analizimin e situatës së përdorimit të tepruar të forcës nga ana e personelit të sigurisë ndaj të dënuarit S.S., dhe konkluzionet lidhur me

përgjegjësitë dhe masat disiplinore ndaj përgjegjësve t'i komunikohen institucionit të Avokatit të Popullit brenda afatit ligjor.

2. Marrja e masave të menjëhershme nga ana e Drejtuesit e institucionit lidhur me eliminimin e rasteve të keqtrajtimit fizik të të burgosurve nga stafi i sigurisë, duke përmirësuar menaxhimin dhe mekanizmat mbikëqyrës të cilët mundësojnë vënien para përgjegjësisë të personave të cilët përdorin praktika të keqtrajtimit fizik të paraburgosurve apo përdorim të tepruar të forcës.
3. Marrja e masave urgjente për plotësimin e organikës sipas parashikimeve.
4. Marrja e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, në respekt të Nenit 24 të Ligjit nr.8328 dt.16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve", i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje dhe standardi që çdo qeli të ofrojë minimalisht 4m<sup>2</sup> hapësirë jetike për person.
5. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen me shtroje, karrige dhe dollapë dhe furnizim të të dënuarve dhe të paraburgosurve me detergjente të higjienës vetjake.
6. Marrja e masa për adresimin e situatës së mbipopullimit në seksionin e observimit që funksionon si sektor paraburgimi ku nuk ofrohet asnjë nga shërbimet si ajrim, aktivitete dhe mundësi për dush brenda godinës, për shkak të mungesës së hapësirave brenda këtij sektori.
7. Marrja e masave të menjëhershme për t'i dhënë zgjidhje problemit të dusheve dhe të ujit në sektorin e observimit dhe sektorin e shëndetësisë ku gjenden të akomoduar të paraburgosur dhe të miturit.
8. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve higjieno sanitare të ambienteve të spitalit, në mënyrë që të ofrohet një trajtim njerëzor e dinjitoz për personat të cilët vuajnë dënimin në këtë institucion.
9. Marrja e masave për kryerjen e vizitave më të shpeshta të mjekut/ ndihmës mjekut të institucionit brenda në regjim dhe ofrimit të një shërbimit më efikas mjekësor nga ana e tij.
10. Marrja e masave për ofrimin e një shërbimi stomatologjik me të gjitha ndërhyrjet e nevojshme.
11. Marrja e masave për sigurimin e ushqimit me diete diabetike nga kuzhina e institucionit për të dënuarit e diagnostikuar me Diabet Mellitus.
12. Marrja e masave për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për sëmundjet akute.
13. Marrja në shqyrtim të mundësisë për krijimin e një sektori të veçantë për personat me probleme të shëndetit mendor.
14. Marrja e masave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga stafi psiko-social, si për shtimin e kontakteve ashtu edhe për shtimin e aktiviteteve riintegruese dhe social-kulturore në përgjithësi dhe në veçanti për të miturit dhe 18-21 vjeçarët.
15. Marrja e masave për rifillimin e aktiviteteve mësimore dhe kurseve profesionale për të miturit.
16. Marrja e masave për zgjerimin e organikës së punësimit jo vetëm për të dënuarit por dhe për të paraburgosurit.
17. Marrja e masave për verifikimin e çmimeve të produkteve dhe cilësisë së tyre në njësinë tregtare pranë institucionit si dhe për rritjen e mbulimit me artikuj.

18. Marrja e masave për sigurimin e përshtatshëm me ngrohje për një periudhë më të gjatë se 4 orë në ditë marrë në konsideratë kushtet klimaterike ku ndodhet institucioni.
19. Marrja e masave për drenazhimin e bokseve të ajrimit si dhe mbulimit të një pjese të bokseve të ajrimit në mënyrë që kjo veprimtari të mos ndërpritet në raste reshjesh apo temperaturash të larta.
20. Marrja e masave për vlerësimin me vëmendjeje dhe prioritet të lejeve shpërblyese e të veçanta ku të bëhet një verifikim i qartë dhe adekuat i vlerësimeve dhe kushteve të besueshmërisë së personit i cili pretendon se e meriton këtë leje dhe i është mohuar.

## **5.21. I EVP Tepelenë - Datë 10.11.2014 / Nr. Dok. 201402365**

### *Shënime paraprake*

Kapaciteti zyrtar i I EVP-së është 86 të paraburgosur dhe të dënuar, por gjatë vizitës në të kishte 160 persona, prej nga 32 të dënuar dhe 128 të paraburgosur. Në kategorinë e personave me probleme të shëndetit mendor ishin 4 persona, por për ta nuk kishte një ambient të veçantë trajtimi. Në kategoritë e tjera të veçanta ishin 8 persona 18-21 vjeçarë, 4 përdorues të lëndëve narkotike dhe 3 të alkoolizuar. Të punësuar në I EVP Tepelenë ishin 11 të dënuar.

Në fillim të takimit ekspertët u takuan me drejtorin e institucionit. Vizita monitoruese pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Nga Drejtori i Institucionit ekspertëve të grupit monitorues iu ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që do të monitoroheshin. Gjatë takimit, Drejtori parashtrroi situatën në institucion duke evidentuar si problemin më kryesor në institucion mbipopullimin. Drejtori bëri me dije se në I EVP nuk ka pasur ngjarje të rënda. Masat disiplinore, kryesisht masa me përjashtim nga aktivitetet e përbashkëta, ishin përdorur për të dënuarit që kishin shkelur Rregulloren e institucionit. Këto masa ishin ekzekutuar në dhomat e tyre pasi ambientet e izolim/veçimit ishin kthyer në dhoma banimi duke e humbur kështu funksionin si ambiente për qëllim shlyerjen e masave disiplinore, kjo për shkak të mbipopullimit të institucionit.

Organika e të punësuarve në institucion ishte pjesërisht e plotësuar, pasi kishte mungesa të stafit mjekësor dhe një shkurtim të stafit psiko-edukativ. Këto mungesa në staf, në kushtet e mbipopullimit rezultoi në probleme.

Nga vizita pararendëse, në këtë institucion u konstatuan probleme në lidhje me mbipopullimin, infrastrukturën, higjienën personale dhe të përbashkët, etj. Këto të meta të vërejtura nga monitorimi pararendës dhe masat e marra në lidhje me reduktimin apo përmirësimin e tyre ishin gjithashtu pjesë e diskutimit paraprak.

Në aspektin e infrastrukturës, institucioni i Tepelenës, paraqitej tërësisht i amortizuar, pavarësisht përpjekjeve modeste nga ana e drejtuesit të institucionit për të adaptuar, riparuar apo përshtatur godinën ekzistuese në funksion të realizimit të qëllimit të saj në respekt të standardeve.

Aktivitetet dhe trajtimi edukativ në këtë institucion ishin të porealizueshme kjo si pasojë e mbipopullimit të skajshëm, mungesës së ambienteve dhe e bazës materiale të varfër për t'i zhvilluar ato.

### ***Trajtimi***

Në kuadër të monitorimit të drejtave të dënuarve/ paraburgosurve, grupi i monitorimit zhvilloi një vizitë monitoruese në ambientet e brendshme të institucionit, si dhe komunikoi në privatësi me të dënuarit/ paraburgosurit. Gjatë takimeve private me vetë të dënuarit/ paraburgosurit dhe bisedave me ta, grupi monitorues pyeti në lidhje me raste të ekzistencës së ushtrimit të dhunës fizike e psikologjike, apo shfaqjeve të sjelljes në mënyrë fyese ndaj tyre nga ana e punonjësve të institucionit. Në përgjithësi, prej të dënuarve/ paraburgosurve ekspertët mësuan se ekzistonte një raport i mirë ndërmjet të dënuarve/ paraburgosurve dhe punonjësve të institucionit.

Grupi monitorues mori informacione për ushtrim dhune dhe përdorim të tepruar të forcës nga ana e forcave të sigurisë së DAP-it. Një rast i tillë ekspertëve iu bë me dije nga i paraburgosuri K.T., i cili në muajin Shtator 2014 kishte qenë subjekt i përdorimit të tepruar të forcës, si dhe i ushtrimit të dhunës, duke u qëlluar me shkop gome dhe duke u mbajtur i lidhur edhe me pranga. Shkak për këtë ishte bërë një informacion (i cili rezultoi i pavërtetë) për ekzistencën e një celulari në dhomën e tij ku forcat e DAP-it ushtruan një kontroll të hollësishëm. Gjatë kontrollit i paraburgosuri K.T. ishte goditur më shkop gome, ishte prangosur dhe vendosur me fytyrë nga muri në ambientet e jashtme të qelisë deri sa kishte mbaruar kontrolli i hollësishëm në dhomën e tij. Mbas kontrollit, këtij të paraburgosuri i ishte bërë dhe presion psikologjik për të treguar se ku e kishte fshehur celularin. Gjithashtu dhe gjatë shoqërimit të tij në dhomë dhe pas heqjes së prangave i paraburgosuri K.T ishte vazhduar te goditej me shkop gome nga ana e forcave të DAP-it. Ky fakt, i cili u konfirmua dhe nga të paraburgosur të tjerë dëshmitarë okularë të ngjarjes në fjalë, iu referua drejtorit të I EVP Tepelenë duke i kujtuar se në të gjithë kohën është ai dhe vetëm ai përgjegjës për rregullin dhe sigurinë në institucion dhe se forcat e sigurisë së D.P.B-së janë në mbështetje të operacioneve të sigurisë së përbashkëta në I EVP dhe duhet të koordinohen dhe monitorohen nga drejtuesit e institucionit.

Ankesat të tjera në lidhje me trajtimin i referoheshin kryesisht cilësisë së ushqimit, mbipopullimit në dhoma, mungesës apo cilësisë së dyshekëve, mungesës së medikamenteve dhe të shërbimit të stomatologjisë, si dhe orareve të reja të ajrimit që i privonin nga ajrimi gjatë pasdites. Një shqetësim tjetër që u ngrit gjatë intervistave ishte mungesa e ngrohjes dhe mosfunksionimi i kaldajave për periudhën e dimrit.

Të dënuarit dhe të paraburgosurit u ankuan për mjediset e ajrimit, të cilat ishin të zbuluara pa tenda mbrojtëse nga reshjet apo dielli, dhe për vetë faktin se terreni në të cilin ndodhet ky institucion ofron klimë të ftohtë dhe të lagësht pothuajse për pjesën më të madhe të vitit, kryerja adekuate e ajrimit në të gjitha stinët ishte e pamundur.

Mjediset e përbashkëta ku duhej të ofroheshin aktivitetet arsimore, kurset e formimit profesional, aktivitetet për zhvillim të aftësive individuale, aktivitetet social-kulturore dhe asistencë shpirtërore mungonin krejtësisht. Kthimi i këtyre ambienteve në dhoma banimi kishte sjellë pengimin e zhvillimit të aktiviteteve integruese dhe uljen e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

## *Masat mbrojtëse*

Të paraburgosurit në institucionin e Tepelenës, të kategorive të rritur dhe të grup-moshave 18-21 vjeçar nuk ishin të ndarë në seksione. Për efekt të mbipopullimit në paraburgim, nuk ishte e mundur një ndarje e tillë në seksion të veçantë për grup-moshën 18-21 vjeçar, si rezultat dhe ajrimet dhe aktivitetet e përbashkëta grup-moshat 18-21 vjeç i zhvillonin jo të veçuar nga të paraburgosurit e tjerë të rritur.

Gjithashtu, në regjimin e brendshëm, kati i dytë, në një sektor, por me dhoma të ndara, banonin dhe të paraburgosur dhe të burgosur, të cilët aktivitetet i kryenin të veçuar nga njëri - tjetri.

Grupi i monitorimit u njoh me faktin se ambientet ku ekzekutohej masa e mbajtjes në veçim të përkohshëm, kryesisht masa me përjashtim nga aktivitetet e përbashkëta, janë kthyer në dhoma banimi duke e humbur kështu funksionin si ambiente për qëllim ekzekutimin e masave disiplinore.

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve nuk u konstatuan parregullsi. Çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga Sektori i Edukimit. Lidhur me funksionimin e sistemit të ankesë/ kërkesave të paraburgosurit dhe të dënuarit në këtë IEVP, plotësonin një formular kërkesë/ ankese dhe ia dorëzonin më pas edukatorit në zarf ose dorazi. Ky i fundit i dërgonte këto ankesa në protokoll. Pas protokollimit i kalonin Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte personalisht të dënuarit, sipas legjislacionit në fuqi.

Telefonat ishin në gjendje pune dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit. Pati ankesa për sa i përket telefonave për çmimin e lartë të impulseve.

Ambientet e takimeve me familjarët ishin të përbashkëta për të dy sektorët. Në dhomën e takimeve gjendeshin 3 sportele të ndara me xham dhe kangjella hekuri. Të paraburgosurit/ dënuarit mund të takoheshin me familjarët e tyre një herë në javë. Nuk kishte një mjedis të veçantë ose dhomë për të paraburgosur me fëmijë të vegjël. Një dhomë e vogël që gjendej në hyrje të godinës zakonisht përdorej për takime me të moshuarit, fëmijët dhe gratë shtatzëna, por në fakt nuk ofronte asnjë kusht për t'u konsideruar si ambient takimi, megjithëse kjo ishte e vetmja mundësi e parë si zgjidhje nga ana e institucionit për shkak të mbipopullimit dhe mungesës së ambienteve shtesë.

Të gjitha kamerat e sigurisë në institucion ishin prishur si rezultat i një shkarkimi elektrik nga një rrufe dhe nuk funksiononin. Lidhur me këtë problematikë të rëndësishme, nga ana e Drejtorit të institucionit na u komunikua se ishte lajmëruar D.P. Burgjeve dhe një fond i veçantë ishte kërkuar për riparimin e shpejtë të sistemit të vëzhgimit me kamera.

### ***Kushtet materiale***

Në fokus të ekspertëve të grupit të monitorimit ishin edhe respektimi i standardeve normale të jetesës. U vizituan ambientet dhe u bisedua me të dënuarit/ paraburgosurit mbi respektimin e këtyre standardeve, si dhe u vëzhgua në terren cilësia dhe respektimi i këtyre standardeve.

Sipas informacionit të marrë nga ana e të dënuarve/ paraburgosurve kryesisht ata e kalonin pjesën më të madhe të kohës në dhoma. Kjo, edhe për arsye se sipas tyre, nuk zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta në institucion. Dhomat ishin të pajisura me banja (nyje sanitare dhe me lavaman), si ndarje më vete, të cilat ishin pajisur së fundmi me dyer. Grupi i monitorimit vizitoi shumicën e dhomave të banimit.

Ndriçimi natyral ishte konform standardeve. Drita natyrale dhe ajrimi, sigurohej në dhoma përmes dritareve, të cilat ishin konform standardit të kërkuar.

Sipas informacionit të të dënuarve/ paraburgosurve, këta të fundit furnizoheshin jo rregullisht nga ana e institucionit me produkte higjiene-sanitare, kryesisht me sapun, detergjent pastrimi dhe mjete për pastrimin e ambientit të përbashkët. Mungonte furnizimi nga ana e institucionit me produkte të domosdoshme për mbajtjen e një higjiene personale si: shampo flokësh, pastë e furçë dhëmbësh, të cilat, sipas të paraburgosurve, vinin nga familja ose kush kishte mundësi financiare i blinte pranë dyqanit të burgut.

Pati ankesa nga ana e të dënuarve/ paraburgosurve edhe ndaj përmbushjeve të kërkesave të tyre personale për blerje, për shkakun që kishte të bënte me mosfunksionimin e mirë të vetë dyqanit dhe aplikimeve të çmimeve të larta në krahasim me tregun.

Grupi monitorues vizitoi ambientin e dusheve, i cili ishte i përbashkët. Nga tre poste për dushe, vetëm njëri prej tyre ishte funksional, dhe ky pa kokë dushi. Gjithashtu, grupi monitorues konstatoi edhe lidhje elektrike të ekspozuara dhe jashtë kushteve të sigurimit teknik në pajisjet e dushit. Gjithsesi dushet përdorshin me grafik dy herë në javë. Sipas dëshmive të paraburgosurve këto dushe ishin të pamjaftueshëm për numrin e të dënuarve/ paraburgosurve në institucion dhe zgjidhja e vetme e aplikuar ishte se ato lejoheshin të mbushin ujë të ngrohtë me kova për të bërë dush më pas në dhomat e tyre. Pavarësisht se grafiku i dushit (dy herë në javë) ishte konform kërkesave të ligjit, grupi i ekspertëve arriti në konkluzionin se praktikisht, me një dush në dispozicion të të gjithë katit të parë, ishte e pamundur të realizohej ai grafik.

Furnizimi me ujë dhe drita ishte i pandërprerë.

Në dhomat e inspektuara nga grupi i ekspertëve monitorues u vu re se baza materiale ishte deri diku e plotësuar, por kishte edhe dhoma të cilat për shkak të mbipopullimit, nuk ofronin kushtet e nevojshme për jetesë. Në shumë prej dhomave, të paraburgosurit nuk kishin shtretër, por flinin me dyshek në tokë. Konkretisht në dhomën nr. 24, me përmasa 4 m x 6 m afërsisht 24 m<sup>2</sup>, flinin 12 persona nga të cilët 4 persona flinin me dyshekë në tokë. Dhoma 16 me përmasa 5m x 5m përafërsisht 25m<sup>2</sup> flinin 12 veta nga të cilët 4 veta flinin me dyshekë në tokë. Dhoma 14 me përmasa 2.50mx4m përafërsisht 10 m<sup>2</sup> flinin 5 veta nga të cilët 1 person flinte me dyshek në tokë. Shumica e dhomave ishin të këtyre dy përmasave dhe karakterizoheshin nga mbipopullimi,

mungesa e hapësirës së banimit sipas standardeve, dhe persona që flinin me dyshek në tokë. Këto të dhënat lidhur me mbipopullimin e skajshëm në ambientet e IEVP Tepelenë përveç problemeve të degradimit strukturor të ndërtesës dhe përkeqësimit të shërbimeve ndaj personave të privuar nga liria, ngrenë edhe shqetësimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në një vend demokratik.

Kjo situatë e mbipopullimit në IEVP Tepelenë me përafërsisht 100% mbipopullim nga kapaciteti zyrtar, sjell shkeljen e një serë të drejtave të të burgosurve/ paraburgosurve, pasi si rrjedhojë e mbipopullimit jo vetëm që ka më pak hapësira jetike për çdo të burgosur, por ofrohen edhe më pak shërbime, të cilat në kushtet e një numri të paracaktuar stafi janë edhe më pak cilësore. Kësisoj, lëvizja në dhomë dhe ambiente të përbashkëta ishte e kufizuar si dhe kishte pakënaqësi lidhur me programet e edukimit dhe rehabilitimit të cilat në ato kushte mbipopullimi dhe përdorim të ambienteve dhe klasave si dhoma banimi ishin inekzistente.

Gjatë vizitave në mjediset e korridoreve, duševe të përbashkëta, dhomave u vu re një higjienë e munguar kryesisht për arsye të mungesës së detergjenteve personalë dhe pajisjes me detergjent dhe klorizim të duševe dhe tualeteve. Në shumicën e rasteve të gjitha detergjentet dhe pajisjet sanitare siguroheshin nga vete të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Ushqimi shërbehej në 3 vakte, në orare të caktuara. Përgjithësisht pati ankesa nga ana e të dënuarve/ paraburgosurve mbi cilësinë e ushqimit. U verifikua në terren kuzhina, e cila ishte në gjendje funksionale. Kuzhina ishte ri konstruktuar, por pajisjet e gazhinës nuk plotësonin standardet e një kuzhinë të gatimit të ushqimit social. Përsa i përket kërkesave në përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit, u konstatua se respektoheshin kërkesat ligjore. Ushqimi përgatitej sipas një liste të miratuar më parë dhe kampionet e ushqimit ruheshin në kushte frigoriferike. Por, në lidhje me sasinë dhe sidomos me cilësinë e ushqimit, u shfaqën shumë vërejtje nga ana e të dënuarve/ paraburgosurve.

Për sa i përket larjes së teshave, në shumicën e rasteve vazhdonin të laheshin nga familjarët dhe akoma nuk kishte një lavanderi që të mund ta ofronte këtë shërbim, ndaj vetë të paraburgosurit dhe të dënuarit mundësonin larjen e rrobave të fjetjes dhe atyre personale.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Nga takimi me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social u vu re një bashkëpunim i mirë. Pengesë për kryerjen e punës nga stafi i edukimit ishte mungesa e ambienteve të përbashkëta dhe klasave gjë e cila kishte sjellë pengesa në zbatimin e punës nga ekspertët e edukimit. Në rastet kur kërkohej këshillim apo bashkëbisedim ai ofrohej në dhomën e improvizuar të takimeve me avokatin.

Grupi monitorues u informua për aktivitetet dhe programet që zbatoheshin në institucion si dhe shqyrtoi me zgjedhje disa dosje psiko-sociale të të paraburgosurve dhe të dënuarve, dosje të 18-21 vjeçarëve, si edhe të personave me probleme të shëndetit mendor. Në dosjet nuk mungonin shënime lidhur me programe individuale të trajtimit për të dënuarit si dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me ta, megjithëse shumë prej tyre ishin formale sa për t'u shënuar, pasi mungesa e ambienteve të përshtatshme dhe klasave për t'i zhvilluar ato i bënin të përealizueshme këto

programe. Kryesisht pretendohej se ofroheshin diskutime në grup për tema sociale dhe organizoheshin aktivitete sportive në ambientet e ajrimit. Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të dënuarit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse.

Përsa i përket bibliotekës ajo mungonte dhe nuk kishte një ambient të veçantë për një funksion të tillë. Ato pak libra të trashëguara në institucion mbaheshin në ambientet e zyrave të institucionit dhe shpërndaheshin sipas kërkesave të bëra nga vetë të paraburgosurit dhe të dënuarit, por faktikisht gjatë intervistave me të burgosurit/ paraburgosurit rezultoi se nuk ofroheshin libra leximi nga ana e institucionit, por vetëm nga familjarët.

Ajrimi është i vetmi aktivitet të cilin të paraburgosurit mund të kryenin së bashku për shkak të mungesës së hapësirave. Ajrimi në stinën e dimrit kryhej dy orë paradite. Institucioni ofronte dy ambiente ajrimi një ambient për kategori të veçanta siç janë 18-21 vjeçarët, për personat me probleme të shëndetit mendor, si dhe për situata të veçanta në raste konfliktesh dhe mosmarrëveshesh mes grupeve. Të dy katet e kryenin ajrimin të ndarë. Por në të dy fushat e ajrimit konstatohet situatë jo e mirë, pasi ambientet e ajrimit ishin plotësisht të zbuluar dhe nuk ofronin kushte për kryerjen e ajrimit në rastet kur moti është me shi, borë apo diell të nxehtë.

Për sa i përket punësimit në këtë I EVP punonin 11 të dënuar kryesisht si pastrues, sanitar, shpërndarës ushqimi etj. Nga intervistat e bëra me disa prej tyre rezulton se nuk kishte probleme me dinamikën e punës.

### ***Shërbimet shëndetësore***

Organika e shërbimit shëndetësor në këtë institucion ishte e përbërë nga një mjek me kohë të pjesshme, një ndihmës mjek-farmacist, katër ndihmës-mjekë dhe një stomatolog.

Gjatë vizitës së grupit monitorues, si dhe nga intervistat me të dënuarit u konstatuan problematika të ndryshme sa i përket shërbimit shëndetësor në këtë institucion. Ato ishin kryesisht të lidhura me prezencën e mjekut në regjim dhe me vonesat e theksuara në përgjigje të kërkesave të të dënuarve për vizita mjekësore në varësi të problematikave që manifestonin.

Gjithashtu, ankesa të shumta kishte edhe në lidhje me konsultat dhe ekzaminimet në qendrat spitalore në varësi të nevojave të dënuarve/ paraburgosurve të cilët vuanin nga sëmundje kronike, ku rivlerësimet e gjendjes dhe të mjekimeve janë të domosdoshme.

Një tjetër problematikë e hasur në këtë institucion për sa i përket shërbimit shëndetësor ishin edhe mjekimet, të cilat në shumicën e rasteve mbulohehin me ilaçe që silleshin nga familja.

Gjatë intervistave u vërejtën edhe shumë ankesa në drejtim të shërbimit stomatologjik, i cili mungonte, si për sa i përket mjekimeve ashtu dhe mbushjeve apo ekstraksioneve, madje megjithëse vizita e grupit inspektues zhvillohej brenda orarit zyrtar, stomatologu i institucionit nuk ishte prezent.



Institucionit nuk kishte një autoambulancë për shërbimet që duhej t'i ofrohej të dënuarve/paraburgosurve me konsulta, ekzaminime dhe analiza të specializuara në qendra spitalore.

Dhoma e infermierisë, e cila ndodhej brenda në regjim, ku bëheshin vizitat mjekësore, injeksionet apo perfuzionet sipas nevojave, ishte jashtë standardit, megjithëse e pajisur me një krevat vizitash, një tavolinë dhe tre stola, ato ishin të vjetra dhe tej mase të amortizuara. Aty ndodhej edhe një kuti ilaçesh që duhej të shërbente për medikamentet e urgjencës, e cila ishte bosh.

Dhoma e farmacisë ishte inekzistente në këtë institucion, për arsye se mungonte një ambient që mund të shërbente si e tillë. Të gjitha ilaçet mbaheshin në dhomën e mjekut, jashtë regjimit, në zyrat e administratës, por nga grupi inspektues u konstatua një mangësi e theksuar e tyre, si për medikamentet e urgjencës, ashtu dhe për sëmundjet kronike.

Në dhomën e mjekut mbaheshin edhe kartelat mjekësore të kyçura me dry, por grupi i inspektimit nuk arriti të kishte akses në to, për shkak të mungesës së mjekut në institucion gjatë këtij inspektimi. Një problematikë tjetër ishte edhe fakti se në të gjithë dokumentacionin e mjekut, veçanërisht kartelat mjekësore, nuk kishte akses as ndihmës mjeku.

Dhoma e stomatologut nuk u verifikua nga grupi i inspektimit, meqenëse stomatologu nuk ishte në institucion dhe askush tjetër nuk kishte akses përveç tij në atë dhomë.

Skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte fare në këtë institucion, për pasojë kishte dhe mangësi të theksuara në medikamente. Nga ana e stafit drejtues të institucionit u konfirmua se shumica e të dënuarve/paraburgosurve nuk ishin të pajisur me librezë shëndetësore e për rrjedhojë edhe skema e rimbursimit të ilaçeve ishte efektive.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për të kufizuar mbipopullimin në I EVP Tepelenë me objektivin që çdo çeli të ofrojë minimalisht 4m<sup>2</sup> hapësirë jetike për person.
2. Marrja e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, në respekt të Nenit 24 të Ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve", i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.
3. Marrja e masave të menjëhershme për mbështetje me bazë materiale e financiare për të mundësuar realizimin e aktiviteteve e veprimtarive me karakter edukativ, social, artistik e kulturor në I EVP Tepelenë.
4. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e punës në sektorin e kujdesit social me qëllim që të mundësohet kryerja e këshillimeve dhe realizimi i temave sociale, si dhe që të mundësohet rritja e bashkëpunimit me institucionet, me qëllim rehabilitimin e të dënuarve/paraburgosurve.
5. Marrja e masave për plotësimin e organikës me psikolog;
6. Marrja e masave të menjëhershme për mundësimin e një ambienti të dedikuar për trajtimin psikoterapeutik të të dënuarve;

7. Marrja e masave të menjëhershme për furnizimin e të paraburgosurve me produkte të domosdoshëm higjieno-sanitare.
8. Marrja e masave të nevojshme për riparimin dhe vënien në kapacitet të plotë të dusheve në institucion duke siguruar dhe parametrat e sigurimit teknik në lidhjet elektrike.
9. Marrja e masave të nevojshme për ndarjen në sektor të veçantë të paraburgosurve të grupmoshës 18-21 vjeçar, për të evituar kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta me të paraburgosurit madhorë.
10. Merrja në analizë dhe raportimi pranë DPB-së i rastit të ushtrimit të dhunës nga forcat e DAP-it në Shtator të 2014 ndaj të paraburgosurit K.T.
11. Marrja e masave të menjëhershme për parandalimin e ushtrimit të tepruar të forcës dhe përdorimin e mjeteve si shkopinj gome apo pranga gjatë kontrolleve rutinë për sende të ndaluara në dhoma. Në këtë aspekt drejtoria e institucionit duhet të jetë me e vëmendshme dhe të marrë drejtimin e operacioneve të sigurisë në rastet e operacioneve të përbashkëta me forcat e DAP-it.
12. Marrja e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së sektorit shëndetësor me një mjek me kohë të plotë.
13. Marrja e masave të menjëhershme për kryerjen e vizitave të rregullta nga ana e mjekut të këtij institucioni, në mënyrë që të ofrohet një shërbim adekuat shëndetësor.
14. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me një autoambulancë.
15. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e të gjithë të dënuarve/ paraburgosurve me librezë shëndetësore.
16. Marrja e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve, në mënyrë që edhe furnizimi me ilaçe si për sëmundjet akute ashtu dhe ato kronike të kryhet sipas kësaj skeme.
17. Marrja e masave të menjëhershme për sigurimin nga ana e drejtuesit të këtij institucioni e një fondi për medikamentet e urgjencës.
18. Marrja e masave të menjëhershme për krijimin e një ambienti të përshtatshëm dhe konform standardeve të një dhome vizitash brenda në regjim.
19. Marrja e masave për ofrimin e një shërbimi të plotë stomatologjik me të gjitha ndërhyrjet e domosdoshme nga ana e stomatologut të institucionit.
20. Marrja e masave të menjëhershme për riparimin e kamerave të sigurisë në institucion.

## **5.22. I EVP Sarandë - Datë 12.11.2014 / Nr. Dok. 201402313**

### ***Shënime paraprake***

IEVP Sarandë është një institucion paraburgimi me kapacitet maksimal zyrtar prej 31 personash. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, në mungesë të Drejtuesit të Institucionit në momentin e vizitës, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me shefen e sektorit juridik, e cila u shpreh e gatshme për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Vizita u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Nga ana e stafit drejtues të Institucionit, ekspertëve të grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhet të monitoronin.

Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni. Drejtori i Institucionit kontaktoi me grupin monitorues përgjatë vizitës dhe ishte i pranishëm në takimin përfundimtar ku u paraqitën gjetjet e monitorimit.

Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 58 persona. Mbipopullimi ishte problematikë e pranishme me 27 të paraburgosur, përafërsisht dyfishi i kapacitetit zyrtar. Si rrjedhojë e mbipopullimit, nëpër dhoma kishte të paraburgosur që flinin në dysheme në kushte të një trajtimi çnjerëzor dhe degradues. Disa prej dhomave ishin aq të vogla në kubaturë sa të paraburgosurit që flinin me dyshekë në dysheme këmbët i shtrinin poshtë krevateve ose ngjitur me derën e dhomës. Në këtë mbipopullim kishte ndikuar dhe fakti që një pjesë e qelive përdorshin për trajtimin e të ndaluarve/ arrestuarve të Komisariateve të Policisë Sarandë, në bazë të Marrëveshjes dypalëshe të vitit 2012 ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme “Për mbajtjen dhe trajtimin e të ndaluarve/ arrestuarve” të Komisariateve të Policisë Sarandë, Berat dhe Tropojë në ambientet e I.E.V.P-ve.

Sipas informacionit që u mor nga ana e shefes së sektorit juridik në I EVP Sarandë nuk ka pasur ngjarje të rënda.

Gjatë vizitës, grupi i inspektues konstatoi se godina e këtij institucioni në të cilin mbaheshin të paraburgosurit ndodhej në bodrum, gjysmë nëntokë e me nivel të lartë lagështire.

Ky institucion nuk kishte seksione të veçanta. Në momentin e inspektimit nuk kishte të paraburgosur të kategorisë 18-21 vjeç.

Persona përdorues të lëndëve narkotike nuk kishte. Kishte të sëmurë kronikë, por që në momentin e vizitës ndodheshin në Institucionin Shëndetësor të Veçantë të Burgjeve.

Dhoma e observim/ veçimit gjendej në fund të korridorit të regjimit. Ajo paraqitej jashtë standardeve, në kushte jo të mira higjieno-sanitare, pa ndriçim e me ajrosje që sigurohej nga një dritare shumë e vogël.

Organika nuk ishte e plotësuar pasi mungonte stomatologu dhe farmacisti.

Në këtë institucion gjendeshin 2 të paraburgosur të punësuar si shpërndarës të ushqimit.

### ***Trajtimi***

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të paraburgosurve, në identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të paraburgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast të përdorimit të forcës fizike, ushtrimit të dhunës dhe presionit psikologjik, rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Në IEVP Sarandë, në momentin e inspektimit, ankesa pati kryesisht në lidhje me mbipopullimin në dhoma, cilësinë e ushqimit, mungesën e ujit të ngrohtë, kushtet higjieno-sanitare në dushe dhe tualete, mungesën e ngrohjes e mosfunksionimin e kaldajave për periudhën e dimrit, si dhe mbi mungesën e aktiviteteve të përbashkëta. Ankesa kishte gjithashtu edhe për mungesën e medikamenteve dhe të shërbimit të stomatologjik si dhe për ambientin e ajrimit i cili ishte i papërshtatshëm për kryerjen e një funksioni të tillë.

Ajrimi në këtë institucion ndodhej në një dhomë me hapësirë 6m<sup>2</sup>, me tavan e mure në tre anë dhe me skarë hekuri në anën tjetër, që nuk përmbushte standardet për ajrim, dhe ishte e papërshtatshme për të plotësuar kërkesat për aktivitete sportive të të parburgosurve. Situata bëhej shqetësuese për faktin që në dhomat e të parburgosurve thuajse mungonte ajri i pastër dhe drita natyrale, për shkak të dritareve shumë të vogla si dhe pozicionit të regjimit gjysmë nën tokë.

Mjediset e përbashkëta që duhet të ofronin arsimim, formim profesional, zhvillim të aftësive individuale, aktivitete sociale, sportive, këshillime individuale dhe në grup mungonin krejtësisht. Mungesa e këtyre ambienteve kishte sjellë pengesa në zhvillimin e aktiviteteve integruese dhe psiko-sociale.

Në këtë institucion mungonte dyqani për blerjen e produkteve bazë sipas nevojave të të parburgosurve. Për rrjedhojë këto produkte siguroheshin nga familjarët, pasi i nënshtroheshin kontrollit sipas rregullores i kalonin personit përkatës.

### ***Masat mbrojtëse.***

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Mjekja bënte pjesë në Komisionin e Pritjes ndërsa në Komisionin Disiplinor ajo ishte vëzhguese pa të drejtë vote, sikurse parashikojnë standardet.

Ekzistonte regjistri i ngjarjeve të rënda si dhe ai i masave disiplinore, ku masa e fundit disiplinore e dhënë dhe e regjistruar ishte e datës 04.08.2014. I gjithë dokumentacioni i sektorit juridik, regjistri i masave disiplinore, si dhe dosjet personale të të parburgosurve, administroheshin nga shefi i kujdesit psiko-social.

Në këtë institucion ekzistonte sistemi i monitorimit me gjashtë kamera brenda në regjim dhe jashtë tij, të gjitha funksionale.

Gjatë inspektimit të ambienteve të brendshme të regjimit, u konstatua se kishte një mjedis të veçantë për takimet e të parburgosurve me familjarët, i cili kishte një ndarje me skarë për të akomoduar palët në takim, të monitoruar nga një kamera vëzhgimi. Edhe në këtë I.E.V.P, grupi i monitorimit vuri në dukje problematikën e mospasjes së një mjedisi të posaçëm për takimet me të miturit. Takimet me familjarët bëheshin një herë në javë.

Ekzistonte sistemi i kërkesë/ ankesave, por të parburgosurit ia dorëzonin kërkesë/ ankesat punonjësit të edukimit, i cili ia kalonte shefit të sigurisë. Ky i fundit ia dorëzonte Drejtorit të Institucionit, i cili bënte shpërndarjen e tyre. Grupi i inspektimit u informua nga Drejtori i

Institucionit se kërkesë/ ankesat e të paraburgosurve, përgjithësisht, gjenin zgjidhje brenda 24 orëve, megjithëse kishte ankesa të cilat kishin vonesa në përgjigje. Vlen për t'u theksuar se një sistem i tillë nuk plotëson kriteret e urdhrit të DPB, ku orientohet qartë se kërkesë/ ankesat duhet të depozitohen fillimisht në kuti të mbyllura dhe administrimi i këtyre të fundit duhet të bëhet nga sektori i edukimit.

Të gjithë të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit, por ata ankoheshin më së shumti në lidhje me çmimi i këtyre të fundit, i cili ishte shumë i lartë krahasimisht me ç 'është jashtë I.E.V.P-së.

Sa i përket çështjes së sigurisë, I.E.V.P Sarandë ishte e pajisur me gjashtë kamera sigurie, si në mjediset e jashtme, ashtu edhe në ato të brendshmet, përfshirë këtu edhe korridoret.

### ***Kushtet materiale***

Ashtu siç u konfirmua nga stafi drejtues i Institucionit dhe siç është konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, mjedisi në regjim vijon të jetë i amortizuar dhe me lagështirë.

Në katin e dytë të zyrave të administratës u konstatuan disa ambiente të cilat ishin nën varësin e komisarit të Sarandës. Siç u përmend edhe në shënimet paraprake, Marrëveshja dypalëshe mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme "Për mbajtjen dhe trajtimin e përkohshëm të arrestuarve/ ndaluarve të komisarateve të policisë Sarandë, Berat, dhe Tropojë në ambientet e I.E.V.P-ve të Ministrisë së Drejtësisë kishte krijuar një problematikë të theksuar sa i përket administrimit dhe menaxhimit të këtyre ambienteve. Zyrat që komisarati ka brenda territorit të administratës së I.E.V.P-së ishin kryesisht magazina të cilat mbanin brenda uniforma dhe materiale të tjera për komisaratin. Sipas Drejtorit të I.E.V.P-së, nëse marrëveshja do të zgjidhej, kalimi i dy kateve nën administrim e plotë të tij do të mundësonte ndryshime në infrastrukturë, e konkretisht riorganizimin dhe krijimin e ambienteve të reja dhe të mjaftueshme për ajrimin, rikthimin e magazinave dhe depove në ambiente takimi për fëmijët, dhoma aktivitetesh dhe salla të përbashkëta për aktivitete të ndryshme sociale, edukative apo/ dhe fetare.

Në ditën e inspektimit, në regjim gjendeshin 12 dhoma banimi, të cilat akomodonin nga 4, 6 ose 10 persona dhe asnjë nga dhomat nuk respektonin standardin e hapësirës jetike për person. Një magazinë dhe dhoma e avokatit ishin kthyer në dhoma banimi për shkak të mbipopullimit. Nëpër dhoma, kishte të paraburgosur që flinin në dysheme në kushte të një trajtimi çnjerëzor dhe degradues si rrjedhojë kjo e mbipopullimit.

Problematikë të theksuar paraqisnin edhe dritaret e dhomave të cilat ishin shumë të vogla e të pamjaftueshme për ajrosje dhe ndriçim natyral dhe pothuajse në të gjitha dhomat kishte lagështirë të theksuar. Disa dhoma ishin të pajisura me ventilatorë që siguronin qarkullimin e ajrit. Nga ana e Drejtorit të Institucionit ishte bërë e mundur hapja e herëpashershme e dyerve me qëllim sigurimin e ajrosjes. Si pasojë e mbipopullimit si dhe e hapësirave shumë të vogla të banimit në dhomat ku mbaheshin të paraburgosurit mungonin orenditë e domosdoshme si tavolina, karrige apo stola.

Gjithashtu, në shumë dhoma mungonin pajisje të tilla si frigorifer, televizor, dollapë etj., pasi sipas urdhrimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nr. 3895 datë 09/ 04/ 2013 ato duhej të bliheshin të reja nga Institucioni me një komision të posaçëm, por mundësitë financiare të të paraburgosurve nuk e lejonin një gjë të tillë. Në përgjithësi, në të gjitha intervistat e kryera, grupi i inspektimit u njoh me pretendimin se të gjitha shtrojat ishin marrë nga familjarët dhe se në rastet kur ishin të Institucionit ishin shumë të vjetra dhe të amortizuara.

Grupi i inspektimit konstatoi se kishte mungesa të theksuara në furnizimin e të paraburgosurve me mjete të tjera të higjienës personale dhe asaj të përbashkët si sapun, shampo, detergjente pastrimi etj., dhe se të paraburgosurit në shumicën e rasteve i siguronin ato nga familjarët.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte po aq problematik sa ishte edhe çështja e ujit të pijshëm, i cili vijonte të blihej nga të paraburgosurit. Tualetet dhe dushet ishin të përbashkëta dhe gjithsej gjendeshin vetëm dy tualete dhe një dush në këtë institucion. Një pretendim që ngrinin të paraburgosurit, ishte edhe fakti se këto ambiente shërbenin për larjen e enëve dhe të ushqimit, fakt ky që përbënte problem serioz për sa i përket kushteve higjieno-sanitare.

Në këtë institucion dushet zhvilloheshin dy herë në javë dhe gjatë intervistave konfidenciale me të paraburgosurit, ata deklarorin se shpesh mungonte uji i ngrohtë.

Si lavanderi e këtij institucioni shërbente një lavatriçe e cila ishte e vendosur në hyrje të tij. Ajo ishte funksionale çdo 15 ditë dhe vetëm për larjen e batanijeve apo të çarçafëve, por sipas pretendimit të paraburgosurve këto shtroja vonoheshin shumë ndaj dhe preferonin që këtë shërbim ta merrnin nga familja.

Në institucion nuk kishte sistem qendror ngrohjeje. Rrjedhimisht, gjatë dimrit, ngrohja bëhej me pajisjet e siguruar nga vetë të paraburgosurit.

Dhoma e observim/ veçimit gjendej në fund të korridorit të regjimit në kushte mjaft të këqija, me një dritare shumë të vogël e cila nuk lejonte as ajrosje dhe as ndriçim natyral. Edhe ndriçimi artificial ishte shumë i dobët.

Nga këqyrja e dhomës së mjekut, e cila ndodhej brenda në regjim, u konstatua se ajo ishte e amortizuar, e pajisur me mobilie të vjetra dhe një kuti e ndihmës së shpejtë, e cila ishte bosh. Ndërsa paradhoma e saj ishte kthyer në dhomë takimi me avokatin, si dhe në raste të veçanta për takimin me familjarët e mitur.

Kuzhina e IEVP Sarandë e cila ndodhej në një ambient shumë të vogël pranë zyrave të administratës rezultoi të ishte e pastër dhe e rregullt, por kishte mangësi të disa pajisjeve bazë, të tilla si aspirator dhe bojlerë. Rrjedhimisht në kuzhinë mungonte uji i ngrohtë. Menyja e ditës dhe gramaturat ishin të afishuara në përputhje me rregulloren. Megjithatë, grupi i inspektimit tërhoqi vëmendjen për mbajtjen e kampionëve ushqimorë, të cilët nuk ruheshin në mjedis frigoriferik, pasi sipas punonjësve në këtë sektor frigoriferi ishte jashtë funksionit. Në institucion nuk kishte persona të cilët të kishin nevojë për dietë ushqimore specifike.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Sipas organikës së miratuar, sektori i kujdesit psiko-social përbëhej nga një përgjegjës sektori si specialist i kujdesit social. Orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin e pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, punës edukative e profesionale etj., ishin të afishuara.

Në IEVP Sarandë, aktivitetet sociale mungonin plotësisht, për shkak të mungesës së ambienteve të përbashkëta për kryerjen e tyre. Biblioteka nuk ekzistonte si ambient për këtë institucion.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit të stafit psiko-social, si raportet mujore mbi aktivitetin e këtij sektori, dosjet psiko-sociale, ashtu edhe programet individuale të trajtimit, rezultoi që ato mbaheshin me rregull dhe të mbyllura me çelës, ndonëse plotësimet e shumë prej tyre ishin formale, pasi mungesa e ambienteve të përbashkëta e bënte të pamundur realizimin e tyre.

Në IEVP Sarandë gjendeshin dy të paraburgosur të punësuar në kuzhinë.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e sektorit të shëndetësisë nuk ishte e plotësuar. Ajo përbëhej nga përgjegjësi i sektorit, një mjek me kohë të pjesshme, tre ndihmës mjekë, por mungonte farmacisti dhe stomatologu.

Gjatë vizitës në këtë institucion, u vu re se kishte shumë ankesa për sa i përket shërbimit shëndetësor. Të paraburgosurit kishin pretendime se mjeku i këtij institucioni nuk iu përgjigjej në kohë kërkesave të tyre për vizita mjekësore, kishte mangësi të theksuara në ilaçe si për rastet me sëmundje kronike ashtu dhe ato akute, ndaj dhe mjekimi sigurohej nga familja. Gjithashtu, ankesa të shumta kishte edhe në lidhje me shërbimin stomatologjik, i cili sipas stafit drejtues të këtij institucioni ofrohej në saje të një kontrate të nënshkruar nga Drejtori i këtij Institucioni me Shërbimin Stomatologjik Shtetëror, nga një stomatolog shkolle. Gjithsesi nga pretendimet e ngritura nga të paraburgosurit, atyre nuk u ofrohej thuajse fare një shërbim i tillë. Gjatë vizitës u konstatuan raste që kishin nevojë për ndërhyrje prej rreth një muaji dhe nuk kishin marrë asnjë lloj shërbimi.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit të shërbimit shëndetësor, në veçanti të mjekut, u konstatua se ekzistonte një regjistër i hapjeve të kartelave dhe një regjistër i shtrimeve në spitalin e qytetit, por nuk u arrit të këqyrej regjistri i vizitave mjekësore të mjekut, i cili sipas pretendimit të stafit gjendej në kartotekë dhe arshivisti nuk ndodhej në institucion. Kjo rezultoi në kundërshtim me standardet pasi regjistri i vizitave duhej të administrohet dhe të plotësohet vetëm nga mjeku i institucionit. Të gjithë regjistrat që u këqyren në këtë sektor ishin të pa sekretuar. Ndërkohë që kartelat mjekësore, të cilat nuk mbaheshin të mbyllura me kyç, ishin të fotokopjuara pasi ky institucion nuk ishte furnizuar nga DPB. Në këtë I.E.V.P nuk u gjetën formate të kontrollit mjekësor, ndërkohë që regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve ishin të rregullta.

Në këtë IEVP ishin të pajisur me libreza shëndetësore vetëm 36 të paraburgosur. Pjesa tjetër, që sapo ishin akomoduar në këtë institucion, prisnin plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me libreza shëndetësore.

Skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte, dhe thuajse të gjithë rasteve që kishin nevojë për trajtim medikamentoz, iu përshkruhej receta për të marrë ilaçe nga familja. Mangësi të theksuara kishte edhe sa i përket medikamenteve bazë të urgjencës.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për adresimin e çështjes së ambienteve të këtij Institucioni të vëna në shërbim të Komisarariatit të Rrethit Sarandë, në përmbushje të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj së Brendshme. Në kushtet kur institucioni funksionon në mbipopullim, dhe për mungesë ambienti nuk u ofron dot shërbimet e nevojshme të paraburgosurve të kësaj I.E.V.P-je, përjashtimi i Institucionit nga kjo marrëveshje, do të ishte zgjidhja e duhur për të mundësuar rikonstrukcionin e plotë të IEVP Sarandë me qëllim përmbushjen e kushteve dhe standardeve e vendosura nga legjislacioni në fuqi dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
2. Marrja e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, në respekt të Nenit 24 të Ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me Burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.
3. Marrja e masave për krijimin e mundësisë që çdo qeli të ofrojë minimalisht 4 m<sup>2</sup> hapësirë jetike për person, si dhe për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe lagështirës në të gjitha ambientet e këtij Institucioni.
4. Marrja e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës të dhomës së observim/ veçimit, sipas standardeve të vendosura nga kuadri ligjor në fuqi dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.
5. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me administrimin dhe menaxhimin e regjistrave të masave disiplinore dhe dosjeve personale të të paraburgosurve nga sektori juridik dhe jo ai psiko-social.
6. Marrja e masave nga ana e sektorit të edukimit për zbatimin me rigorozitet të urdhrin të DPB lidhur me procesin e trajtimit të ankesave/ kërkesave.
7. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e kuzhinës me frigorifer, aspirator e bojlerë dhe ruajtjen e kampionëve ushqimor në kushte frigoriferike.
8. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e të paraburgosurve me paketën bazë të higjienës personale si dhe me detergjente.
9. Marrja e masave për riparimin e plotë të dusheve dhe tualeteve, si dhe përmirësimin e kushteve higjieno sanitare të tyre.
10. Marrja e masave për vënien në shërbim të të paraburgosurve të një dyqani për blerjen e produkteve bazë sipas nevojave të tyre.
11. Marrja e masave për krijimin e ambienteve të përbashkëta për të mundësuar zhvillimin e aktiviteteve fetare, kulturore dhe sportive nga ana e stafit të kujdesit psiko-social.
12. Marrja e masave për shtimin në organikë të një mjeku me kohë të plotë, në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më efikas shëndetësor.



13. Marrja e masave për shtimin në organikë të një stomatologu dhe një farmacisti në mënyrë që të ofrohet një shërbim adekuat dentar dhe shëndetësor në përgjithësi.
14. Marrja e masave për pajisjen e Institucionit me një autoambulancë.
15. Marrja e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve.
16. Marrja e masave urgjente për pajisjen e farmacisë me ilaçe të urgjencës si dhe ilaçe për sëmundjet kronike.
17. Marrja e masave lidhur me administrimin dhe plotësimin e regjistrit të vizitave mjekësore vetëm nga mjeku/ ndihmësmjeku i Institucionit.
18. Marrja e masave të menjëhershme për sekretimin e të gjithë regjistrave që administrohen nga sektori shëndetësor.

### **5.23. I EVP Vlorë - Datë 13.11.2014 / Nr. Dok. 201402366**

#### ***Shënime të përgjithshme***

Vizita monitoruese e stafit të MKPT-së pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë shumë të mirë bashkëpunimi. Nga Drejtori i Institucionit ekspertëve ju mundësua kryerja e inspektimit të jashtëm dhe të brendshëm në Institucion në përputhje me standardet e përgjithshme të Drejtave të Njeriut, brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që do të monitoroheshin. Objektivi kryesor i vizitës monitoruese ishte vlerësimi i kushteve dhe trajtimi i të dënuarve/ paraburgosurve.

Me urdhër nr. 329, datë 15/ 01/ 2009, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë kategorizohet “institucion paraburgimi, me një seksion paraburgimi për të mitur dhe një seksion burg i sigurisë së zakonshme.” Kapaciteti maksimal i kësaj I EVP -je është 115 persona. Në kohën e vizitës, I EVP Vlorë strehonte 197 të dënuar/ paraburgosur, duke shënuar një mbipopullim prej 82 personash.

Gjatë kësaj vizite grupi monitorues pati si fillim një takim me drejtorin e Institucionit, i cili parashtrroi situatën aktuale në institucion. Drejtori evidentoi se një nga problemet kryesore të institucionit ishte mbipopullimi. Në momentin e inspektimit personat të ndarë sipas kategorive ishin 28 të mitur dhe 169 të rritur mes të cilëve 14 ishin 18-21 vjeçarë, 2 persona me probleme të shëndetit mendor dhe 8 persona të sëmurë kronikë. I EVP Vlorë ofronte mundësi punësimi për 21 të paraburgosur.

Në momentin e inspektimit në institucion kishte persona ndaj të cilëve ishte marrë masë disiplinore, mes të cilëve pesë ishin të mitur, të akuzuar për mbajtje të sendeve të ndaluara, dhe dy të rritur të akuzuar për mosbindje ndaj personelit të sigurisë në I EVP. Sipas drejtorit një nga problemet më shqetësuese përveç mbipopullimit ishin të miturit të cilët në pjesën dërrmuese ishin recidivistë.

## *Trajtimi*

Në kuadër të respektimit të së Drejtës për Dinjitet Njerëzor dhe të asaj Kundër Torturës, grupi monitorues vizitoi dhe kontaktoi me të paraburgosurit e mitur (14-18 vjeç), me ata të kategorisë 18-21 vjeçare dhe me ata të rritur. Lidhur me ndarjen në seksione, të paraburgosurit e mitur ishin të ndarë në seksion më vete nga të paraburgosurit e tjerë. Ata realizonin edhe ajrimin dhe aktivitetet e tjera të përbashkëta të veçuar nga të paraburgosurit madhorë. Ndërsa të paraburgosurit 18-21 vjeçarë, ishin të grupuar në dhoma me vete, por në të njëjtin sektor me të rriturit, duke i kryer edhe aktivitetet e përbashkëta së bashku me madhorët.

Gjatë intervistave që grupi monitorues zhvilloi me të miturit u konstatuan ankesa për raste sporadike ushtrimi të dhunës fizike dhe asaj psikologjike ndaj tyre nga ana e personelit të sigurisë në institucion. Sipas tyre, kjo dhunë shkaktohej jo e paramenduar, por si rezultat i veprimeve ndëshkimore mbas një shkeljeje disiplinore apo zënie mes të miturve. Gjithashtu gjatë bisedave dhe intervistave konfidenciale kishte ankesa nga ana e të miturve për dhënien ndaj tyre të masave të shpeshta dhe të gjata të masave disiplinore dhe ekzekutimin e tyre në dhomat e veçimit që ndodhen në katin e parë të godinës. Të miturit ndjeheshin të kërcënuar dhe nën presion psikologjik nga ana e stafit psiko-social se nëse nuk silleshin mirë dhe prishin qetësinë në godinë, ndaj tyre merreshin masa disiplinore deri në 20 ditë veçim, masë të cilën do e vuanin në dhomat e veçimit.

Të miturit u ankuan se në raste të veçanta ata shoqëroheshin në ambiente të pambuluara nga vëzhgimi i kamerave ku ushtrohej presion psikologjik dhe dhunë fizike nga ana e stafit të sigurisë. Këto ambiente të pretenduara ishin kryesisht dhoma e takimit me avokatin, kolona dhe ambienti me shkallë dalës nga seksioni. Grupi monitorues verifikoi dhe konstatoi se ky ambient realisht ishte i pa monitoruar me kamera.

Në momentin e inspektimit të miturit u gjetën të ndarë fizikisht në dy grup/ seksione dhe përkundrejt tyre ishte marrë masë kolektive me përjashtim nga ajrimi prej 3 orësh në ditë (sipas parashikimit ligjor). Ajrimi ofrohej vetëm 30 minuta në ditë për secilin grup, pasi nga ana e stafit të sigurisë dhe atij psiko-social pretendohet se këto dy grupe të miturish kishin konflikt mes tyre dhe nuk ishte e mundur të zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta ndërmjet tyre për arsye sigurie. Nga kontakti dhe bisedat e zhvilluara me të miturit dhe më pas me stafin psiko-social, rezultoi se situata konfliktuale mes dy grupeve të të miturve, ndërmjet njëri-tjetrit dhe gjithashtu dhe ndaj stafit policor kishte filluar para një muaji, si rezultat i një tentative zënke midis tyre dhe ndërhyrjes së stafit policor, i cili si reagim kishte zhvilluar kontrolle dhe kishte gjetur sende të ndaluara në dhomat e të miturve. Si masë parandaluese ishte urdhëruar ndarja fizike e të miturve në 2 grup-sektorë dhe gjithashtu ishin marrë disa masash disiplinore ndaj të miturve.

Nga vizita monitoruese në 3 seksionet e tjera të paraburgimit dhe intervistat konfidenciale më të paraburgosurit madhorë brenda nëpër dhoma, u konstatuan problematika të ndryshme. Gjatë monitorimit të dhomave të veçim/ izolimit, grupi monitorues konstatoi një rast të përdorimit të mjeteve të kufizimit fizik (pranga) brenda dhomës së veçimit dhe përdorim të shkopit të gomës. Gjatë intervistave që grupi zhvilloi në këto ambiente si me personelin e sigurisë ashtu dhe me personat e veçuar rezultoi se ndaj të paraburgosurve K. Xh dhe L. Z ishte ushtruar dhunë fizike nga pjesëtarë të grupit të gatshëm gjatë shoqërimit të tyre nga ambientet e ajrimit në ambientet e

veçimit pas një konflikti<sup>2</sup> verbal të tyre me punonjës të sigurisë në shërbimi. Nga ana e ekspertëve të MKPT u konstatuan në shpatullën e majtë të të paraburgosurit L. Z. dy shenja goditje me shkop gome të cilat u konfirmuan dhe nga ekspertiza e mjekut të institucionit.

Vendosja brenda dhomës së veçimit dhe lënia të prangosur e dy të paraburgosurve, u pohua dhe nga ana e efektivit të grupit të gatshëm, A.K, i cili në procesverbalin e marrjes në pyetje të shtetasit nga ana e MKPT-së u shpreh se: “Personat në fjalë pas prangosjes forcërisht i kemi shoqëruar nga ambienti i ajrimit në ambientet e veçimit dhe i kemi lënë të prangosur në këto ambiente pasi gjendja e tyre vazhdonte të ishte agresive pasi këta të paraburgosur vazhdonin të shanin punonjësit e policisë”.

Lidhur me praktikën e përdorimit të prangave brenda ambienteve të veçimit MKPT vlerëson se kjo praktikë është e papranueshme dhe mund të konsiderohet si një situatë e trajtimit degradues dhe jo njerëzor meqë kjo praktikë zbatohet në një ambient të konsideruar i sigurisë të lartë dhe me personel të trajnuar dhe prezent gjatë gjithë kohës. Kjo praktikë dhe në literaturën e standardeve ndërkombëtare konsiderohet si një praktikë ndëshkuese dhe jo proporcionale.<sup>13</sup>

Lidhur me konstatimet e grupit monitorues për përdorimin të tepruar të forcës fizike nga efektivë të grupit të gatshëm ndaj të paraburgosurve K. Xh dhe L. Z, si dhe goditjeve të tyre me shkop gome, duke i lënë shenja të dukshme në trup, me dt.13.11.2014 rreth orës 12.00 gjatë shoqërimit dhe vendosjes së tyre në ambientet e veçimit vërejmë se: Praktika të tilla janë të papranueshme dhe personat të cilët përdorin praktika të keqtrajtimit fizik të paraburgosurve apo përdorim të tepruar të forcës duhet të vihen para përgjegjësisë. Drejtuesit e institucionit duhet të marrin hapa konkrete lidhur me çrrënjosjen e rasteve të keqtrajtimit fizik të të burgosurve nga stafi i sigurisë duke përmirësuar menaxhimin dhe mekanizmat mbikëqyrës. Hetime të shpejta dhe efektive, të cilat mundësojnë identifikimin dhe marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës për keqtrajtim ndaj të burgosurve, janë esenciale për t'i dhënë vlerë reale parimit dhe detyrimit ligjor për ndalimin e torturës dhe trajtimit degradues dhe jo human dhe ndëshkues në burgjet tona.

Përsa i përket trajtimit dhe kushteve të dhomave të izolim/ veçimit, në të cilat të paraburgosurit mbahen në raste të masave disiplinore, ishin mjaft të këqija dhe nuk përmbushin asnjë standard të trajtimit dinjitoz dhe human të të paraburgosurve. Në dy nga dhomat e izolimit në të cilat kishte persona nuk kishte as stola dhe as dyshekë. Të paraburgosurit F. R., i veçuar me masë disiplinore për fyerje të stafit mjekësor, i ishte dhënë masa disiplinore 20 ditë veçim. Sipas informacionit të marrë nga mjeku i këtij institucioni, ky i paraburgosur, manifestonte probleme të shëndetit mendor, ndaj dhe mbajtja në të tilla kushte dhe kaq gjatë me masë disiplinore është totalisht në shkelje të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kushtet e dhomës në të cilën mbahej ky i paraburgosur ishin mjaft të këqija. Atij nuk i ishte lejuar të bënte dush edhe pse kishte 6 ditë në veçim. Ushqimi i servirej dhe mbahej në dhomë në kushte aspak higjienike dhe dinjitoze.

### ***Masat mbrojtëse***

Në momentin e vizitës monitoruese institucioni i paraburgimit Vlorë rezultoi me mbipopullim, i cili, siç u pranua edhe nga vetë drejtuesit e këtij institucioni, në ditët para kryerjes së këtij

---

<sup>13</sup> Hungary: CPT Visit 2009[par.57]

monitorimi ka qenë edhe më i lartë. Të paraburgosurit në IEVP-në Vlorë, ishin të ndarë në seksione, të mitur dhe të rritur. Për efekt edhe të mbipopullimit, nuk kishte një ndarje në seksion të veçantë për grup-moshën 18-21 vjeç, e cila ndodhej në të njëjtin sektor me të rriturit, por në dhoma të veçanta, me raste përjashtimore, siç u shpjegua edhe më sipër. Ajrimet dhe aktivitetet e përbashkëta të miturit i kryenin të veçuar nga grup-moshat e tjera.

Ekspertët morën informacion në lidhje me pritjen e të burgosurve/ paraburgosurve në institucion dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes, si dhe në lidhje me plotësimin e regjistrave e dosjeve personale të tyre. Nga biseda me Drejtuesin e Institucionit dhe verifikimeve në dosje grupi monitorues konstatoi se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte.

Për sa i përket masave disiplinore në momentin e inspektimit dhe nga vizita që u bë në sektorin e të miturve, u konstatua mospërputhje mes personave që gjendeshin në këto ambiente dhe masave të dhëna sipas verifikimeve të regjistrave. Në regjimin e të miturve kishte një dhomë të veçantë e cila përdorej si dhomë veçimi për të miturit me probleme të sjelljes dhe subjekte të masave disiplinore. Në regjistrin e masave disiplinore jo gjithmonë ishin të dokumentuara masat e dhëna për të miturit që mbaheshin në këtë ambient veçim/ izolimit, masa këto të parashikuara sipas nenit 53 të ligjit nr. 40 / 2014 për "Të drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosur"

Lidhur me këtë rast, MKPT shpreh shqetësimin për vendosjen e të miturve në kushte që i ngjajnë izolimit të vetmuar deri në 20 ditë, një masë që mund të komprometojë integritetin e tyre fizik dhe/ ose mendor. MKPT vëren se marrja e këtyre masave disiplinore duhet të konsiderohet si masë e jashtëzakonshme dhe duhet të jetë për afatin më të shkurtër të mundshëm dhe, në të gjitha rastet, të miturve duhet t'u garantohet kontakt i përshtatshëm njerëzor, t'u jepet akses në materiale leximi dhe t'u ofrohet të paktën ajrimi në qiell të hapur çdo ditë. Lidhur me këtë çështje është shprehur dhe Komiteti për Parandalimin e Torturës i Këshillit të Evropës(CPT)<sup>14</sup> i cili në raportin e tij të vitit 2010 për Shqipërinë, i rekomandon autoriteteve shqiptare që, masat disiplinore në kushte veçimi ndaj të miturve të privuar nga liria duhet të konsiderohen të rralla dhe të përdoren për periudha sa më të shkurtra të mundura (preferencialisht, për një periudhë e cila nuk i kalon 3 ditët)<sup>15</sup>.

Të gjitha procedurat disiplinore që zbatohen për të mitur duhet të shoqërohen nga garanci zyrtare dhe të regjistrohen në regjistrat përkatës. Në veçanti, të miturit duhet të kenë të drejtën të dëgjohen mbi temën e shkeljes që ato pretendohet se kanë kryer, dhe të ankohen te një organ më i lartë ndaj sanksioneve të vëna; hollësitë e plota të këtyre sanksioneve duhet të regjistrohen në një regjistër të mbajtur posaçërisht në institucione ku të miturit privohen nga liria. Të miturit duhet të informohen me shkrim lidhur me shkeljet dhe akuzat kundër tyre dhe sistematikisht të pajisen me një kopje të vendimit të komisionit disiplinor i cili të përfshijë dhe mundësinë dhe modalitetet e apelimit në një instancë më të lartë. Lidhur me vendosjen e dhënies së masës edukative dhe kohën e përfundimit të saj duhet të zbatohen procedurat ligjore të cilat në vetvete mbartin një funksion edukues rigoroziteti ligjor.

---

<sup>14</sup> Albania: Visit 2010 [par. 98]

<sup>15</sup> Raporti i 18-të i përgjithshëm i CPT-së (CPT/ Inf(2008)25), paragrafi 26.

Në këtë drejtim, IEVP Vlorë duhet të marrë në konsideratë rekomandimet e DP Burgjeve në zbatimin e praktikave të mira Evropiane në fushën e drejtësisë për të miturit, mbi zbatimin e masave alternative disiplinore në institucion përkundër masës së “veçimit“. Gjatë inspektimit u konstatua se masat e reja edukative disiplinore nuk ishin marrë në konsideratë nga ana e stafit të edukimit dhe nuk zbatoheshin sipas procedurave dhe politikave disiplinore dhe edukative për të miturit sikurse përcaktohen në udhëzuesin administrativ të DP Burgjeve. Masat edukative për vetë funksionin pedagogjik të tyre duhet të përdoren më shpesh dhe mundësisht të zëvendësojnë masat disiplinore të parashikuara për të rriturit. Gjithashtu dhe dhënia e këtyre masave duhet bërë në mënyrë të drejtë, të duhur dhe të paanshme. Procedura e dhënies së tyre duhet të jetë transparente dhe i mituri duhet të dëgjohet gjatë marrjes së vendimit dhe të ketë mundësinë të shpjegohet lidhur me arsyen dhe veprimet e tij. Procedura duhet të jetë e thjeshtë dhe e lehtë për t’u kuptuar nga ana e të miturit. Lidhur me llojet e masave edukative dhe kohëzgjatjen e tyre parashikohet:

- a. Pushim/ përjashtim nga aktiviteti edukativ nga 10-15 minuta deri në 25-30 minuta në rastet e mungesës së reflektimit. (Këtë masë mund ta japë personeli i edukimit).
- b. Përjashtim nga pjesëmarrja në njërin nga aktivitetet e dëshiruara prej të miturit gjatë ditës, jo më shumë se 50-60 minuta. (Këtë masë mund ta japë personeli i edukimit me miratimin e Përgjegjësit të Sektorit të Kujdesit Social).
- c. Përjashtim nga aktivitetet ditore në grup dhe qëndrim gjatë ditës në dhomë. Në këtë rast qëndrimi me dhomë nuk mund të zgjasë më shumë se 15 orë (këtë masë mund ta japë Drejtori i Institucionit bazuar në relacionin me shkrim të Përgjegjësit të Sektorit të Kujdesit Social).

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga Sektori i Edukimit. Të paraburgosurit në këtë IEVP, plotësonin një formular kërkesë/ ankesë dhe ia dorëzonin më pas edukatorit në zarf. Ky i fundit i dërgonte në protokoll. Pas protokollimit, ankesat i kalonin Drejtorit të Institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim, apo i takonte të dënuarit.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit.

### ***Kushtet materiale***

Grupi i monitorimit mblodhi informacion dhe monitoroi aspektet e ndryshme të kushteve materiale të të paraburgosurve në institucion dhe u përqendrua kryesisht në këto aspekte: mbipopullimi, kushtet e banimit, ushqimi, ndriçimi, ventilimi, higjiena personale, kushtet sanitare, veshja, etj.

Infrastruktura e IEVP-s Vlorë ishte relativisht e re. Institucioni ishte i pajisur me sistem ventilimi e aspirimi funksional. Megjithatë nga ana e të paraburgosurve ekspertëve ju bë me dije fakti se sistemi i ventilimit dhe ajrimit, pavarësisht se funksional, vihej në punë me orare të reduktuara.

Nisur nga infrastruktura relativisht e re e institucionit, dhomat e banimit ishin të pajisura me tualet brenda, (nyje sanitare dhe lavaman), ndërsa dushet ishin të përbashkëta. Lidhur me

furnizimin me ujë të rrjedhshëm nëpër dhomat e banimit, nga ana e drejtorisë, ekspertëve iu bë me dije se ky problem ishte zgjidhur nëpërmjet vendosjes së depozitave. Nga ana e të parburgosurve nuk u shpreh ndonjë pakënaqësi në këtë drejtim.

Përsa i përket dusheve, të parburgosurit reklamuan vështirësi të krijuara nga kushtet natyrore në të cilat ata ishin të detyruar të bënin dush, sidomos gjatë stinës së dimrit (mungesës së ngrohjes në këto ambiente). Grupi monitorues verifikoi dushet dhe sipas verifikimit në vend të tyre rezultoi se jo të gjitha ishin funksionale pasi kishte mungesa të kokave të rubineteve dhe kokave të dusheve.

Nga vizita në dhomat e banimit tek sektori i të miturve u konstatua që dhomat, tualetet brenda në dhoma, mjetet e jetesës dhe higjiena linin shumë për të dëshiruar. Dyshekët ishin në kushte shumë të këqija dhe pothuajse të gjitha ndërresat si çarçafë, batanije, peshqirë dhe detergjente për të miturit siguroheshin nga familjarët. Këto dhoma banimi nuk ofronin një klimë të ngrohtë, të pastër dhe të rregullt ku të miturit të ndjehen në kushte stimuluese në drejtim të rehabilitimit të tyre. Dyert e tualeteve ishin të dëmtuara dhe në shumë prej dhomave mungonin dhe ishin zëvendësuar me çarçafë apo mbulesa të vjetra. Stolat plastikë në shumicën e rasteve ishin pothuajse të dëmtuar dhe nuk kryenin funksiononin si të tillë. Ankesat nga të miturit ishin më shumë për kushtet e dhomave, dyshekët, mungesës së detergjenteve për higjienën personale dhe të pastrimit të tualeteve dhe dhomave. Problem në dhomat e banimit të të miturve ishin dhe mungesa e disa kapakëve të prizave elektrike ku dukeshin instalime elektrike të ekspozuara dhe të pa izoluar jashtë rregullave të sigurimit teknik të cilët përbënin një rrezik për jetën e të miturve.

Në dhomat e të miturve u konstatuan se shumë pak dhoma ishin të pajisur me TV. Sipas pretendimit të të miturve, këto pajisje ishin shpërndarë nga stafi i institucionit, por disa kanë pajisje në dhoma dhe disa të tjerë nuk kanë përfituar nga kjo shpërndarje.

Në dhomat e inspektuara në sektorët e madhorëve nga grupi i ekspertëve monitorues u vu re se baza materiale ishte deri diku e plotësuar por kishte dhe dhoma në të cilat për shkak të mbipopullimit nuk ofroheshin kushtet e nevojshme për jetesë. Në shumë prej dhomave së paku një i parburgosur nuk kishte shtrat, por flinte me dyshek në tokë.

Konstatimet lidhur me mbipopullimin e skajshëm në ambientet e I EVP Vlorë përveç problemeve të degradimit strukturor të ndërtesës dhe përkeqësimit të shërbimeve ndaj personave të privuar nga liria, ngrenë edhe shqetësimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në një vend demokratik.

Kjo situatë e mbipopullimit në I EVP Vlorë me përafërsisht 80% mbipopullim nga kapaciteti zyrtar sjell shkeljen e një serë të drejtave të parburgosurve, pasi si rrjedhojë e mbipopullimit jo vetëm që ka më pak hapësira jetike për çdo të burgosur, por ofrohen edhe më pak shërbime, të cilat në kushtet e një numri të paracaktuar stafi janë edhe më pak cilësore. Kësisoj, lëvizja në dhomë dhe ambiente të përbashkëta ishte e kufizuar, kishte pakënaqësi lidhur me programet e edukimit e rehabilitimit të cilat në ato kushte mbipopullimi ishin të vakëta.

Jo të gjitha qelitë kishin TV dhe frigorifer. Përgjithësisht në të gjitha dhomat kishte tavolina por mungonin stolat për të gjithë të paraburgosurit. Kushtet e tualeteve dhe higjiena në to ishte mjaft problematike. Në pjesën më të madhe të dhomave tualetet ishin pa dyer ose me dyer të dëmtuara, të mbuluara me çarçafë të vjetër të improvizuar nga vetë të paraburgosurit.

Krejt ndryshe shfaqej situata në ambientet e përbashkëta të cilat ishin përgjithësisht të pajisura me të gjitha mjetet dhe materialet e nevojshme si dhe me një higjienë relativisht të mirë.

Ushqimi shërbehej në 3 vakte, në orare të caktuara. Grupi u njoh edhe me ndonjë ankesë nga ana e të paraburgosurve në lidhje me cilësinë e ushqimit. Këto ankesa u krahasuan edhe me dokumentacionin zyrtar të kuzhinës dhe u pa në vend cilësia e ushqimit, të cilat u konstatuan sipas kërkesave ligjore. U verifikua në terren kuzhina, e cila ishte sipas standardeve, në kushte të mira të ruajtjes së higjienës. Ushqimi përgatitej sipas planifikimit ditor dhe kërkesave të miratuara dhe shpallura për gramatura dhe vlera kalorike për person. Kampionet e ushqimit ruheshin në mënyrë korrekte në kushte frigoriferike, siguroheshin 24 orë dhe zëvendësoheshin pas këtij orari me kampionet e ushqimeve të servirura.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Nga kontakti me të paraburgosurit, ekspertët morën informacionin se e drejta për të mbajtur kontakte me familjarët takimet me familjarët dhe telefonatat respektoheshin në nivelet e standardit të kërkuar. Telefonatat me kërkesë mund të ishin të përditshme. Ato zgjasnin 5-20 minuta dhe mund të kryheshin prej orës 8.00 deri më 14.00.

Grupi monitorues u njoh me dhomat ku kryheshin takimet, të cilat ishin të ndara me xham, ndërmjet të paraburgosurve dhe familjarëve. Nga vëzhgimet tona rezultoi se nuk kishte një ambient të veçantë për takime me të miturit i cili të ishte i pajisur me bazën materiale që të ofrojë një ambient të ngrohtë dhe familjar. Zakonisht, për takimet me të miturit, përdorej një ambient i cili ishte pak më i hapur se të tjerët dhe lejonte pak më shumë hapësirë për kontakt fizik ndërsa për raste të veçanta përdorej dhe dhoma e takimit me avokatin.

Ekspertët monitoruan edhe vendosjen e kutive të kërkesë-ankesave dhe të kutisë përkatëse të Avokatit të Popullit, të cilat u konstatuan në rregull dhe funksionale.

Aktivitetet kulturore dhe artistike për madhorët ishin të rralla. Të paraburgosurit kishin mundësi të shkonin sipas një grafiku të paracaktuar në palestër, të luanin futboll dy herë në javë.

E drejta e besimit respektohej, dhe në institucion kishte 2 dhoma për ushtrimin e besimit (kishë dhe xhami). Në sektorin e të miturve ndodhej ende dhoma e kinemasë, por ajo jo gjithmonë ishte funksiononte për arsye të defekteve teknike të pajisjeve.

Lidhur me ofrimin e aktiviteteve në sektorin e të miturve u konstatua një përkushtim nga ana e stafit të sektorit të edukimit për të realizuar planet e tyre edukative. Të miturit u shprehën se marrin pjesë rregullisht në aktivitete të ndryshme dhe kurse profesionale për elektrikist, kurse informatike dhe të gjuhës angleze. Ndarja e tyre në dy grupe ndikonte në cilësinë e zhvillimit të këtyre aktiviteteve pasi orët mësimore përsëriteshin për të dy grupet. Në momentin e inspektimit

ishite duke u përgatitur cikli tjetër i zhvillimit të këtyre kurseve, ku ishin identifikuar personat të cilët do të merrnin pjesë në to, si dhe ishin shtuar dhe dy kurse të reja, për berber dhe kuzhinier.

Gjithashtu, përveç ajrimit të reduktuar që e kryenin vetëm 30 minuta në ditë të miturit ishin të përfshirë në aktivitete të tjera që mundoheshin t'i ndiqnin rregullisht. Këto aktivitete ishin tema dhe diskutime në grupe, ofrimi i kinemasë, laborator informatike në sallën e kompjuterëve, lojëra të ndryshme si: pingpong, kalçeto etj.

Një aktivitet tjetër mjaft i rëndësishëm që ofrohet në këtë IEVP ishte zhvillimi i arsimit të detyrueshëm 9-vjeçar. Për këtë aktivitet edukativ kishte klasa ku baza materiale ishte e mirë. Mësimdhënia kryhej nga dy mësues të cilët zhvillonin mësimin e ciklit mësimor 9-vjeçar sipas programit. Orari i mësimit ishte 08:30-11:30 dhe mësimin e frekuentonin 18 të mitur.

Gjatë takimit me stafin e sektorit të kujdesit psiko-social u vu re një komunikim dhe bashkëpunim i mirë. Grupi i inspektimit u informua për aktivitetet dhe programet që zbatoheshin në institucion, si dhe u panë, me zgjedhje, disa dosje psiko-sociale të të miturve, të paraburgosurve dhe dosje të 18-21 vjeçarëve. Në dosjet psiko-edukative nuk mungonin programe individuale të trajtimit për të paraburgosurit si dhe shënimet lidhur me organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me ta. Gjithashtu dhe vlerësimet periodike ishin të plotësuara mirë.

Të pyetur për situatën e gjetur në sektorin e të miturve, stafi u përgjigj se ishte në dijeni dhe ndarja e sektorit në dy grupe ishte bërë nga stafi i sigurisë për të shmangur konfliktet e mundshme. Ndërsa përjashtimi kolektiv i të miturve nga ajrimi i zakonshëm 3 orë në ditë ishte marrë gjithashtu si masë e përkohshme për të shmangur konfliktet dhe se ata ishin duke punuar për të organizuar takime grupi dhe aktivitete të përbashkëta në mënyrë që të rrisnin kohezionin në grup dhe të zbusin konfliktet mes të miturve. Organizimi i diskutimeve dhe temave në grupe si dhe ofrimi i kinemasë në grupe ishin dy nga nismat imediate që ky staf do të ndërmernte për t'iu ardhur në ndihmë të miturve.

### ***Shërbimet shëndetësore***

Organika e stafit të këtij sektori nuk ishte e plotësuar. Ai përbëhej nga 1 mjek me kohë të pjesshme, 4 ndihmës mjekë, 1 stomatolog dhe 1 farmacistë.

Gjatë vizitës monitoruese në këtë IEVP si dhe nga intervistat me të dënuarit kishte ankesa të shumta për sa i përket shërbimit shëndetësor në këtë institucion. Ato ishin kryesisht të lidhura me mjekimet, të cilat shpesh mbulohehin me ilaçe që silleshin nga familja. Gjithashtu, kishte pretendime për sa i përket përgjigjes në kohë të kërkesave të dënuarve/ paraburgosurve për vizita mjekësore, kryesisht në sektorin e të miturve në varësi nga problematikat që manifestonin, por kjo u justifikua nga stafi drejtues i institucionit me faktin se, mjeku i këtij sektori ishte i punësuar në këtë institucion me kohë të pjesshme. Gjithashtu, ankesa kishte edhe në drejtim të shërbimit stomatologjik. Sipas pretendimeve të ngritura nga të dënuarit/ paraburgosurit ky shërbim ishte i mangët. Stomatologu i këtij institucioni realizonte vetëm mjekime të urgjencës, ndërsa mbushjet dentare dhe terapitë më specifike mungonin. Kjo pasi kishte mangësi të theksuara të materialeve dentare.



Për sa i përket rastit të dhunës të sipërpërmendur, mjeku i këtij institucioni pasi konstatoi shenjat e dhunës në trupin e shtetasit L.Z ndoqi të gjithë procedurën e nevojshme për të plotësimin e dokumentacionit përkatës, si formatin e kontrollit mjekësor ashtu dhe regjistrin e evidentimit të rasteve të dhunës, fotokopjet e të cilave u morën në administrim nga grupi i ekspertëve të MKPT-së.

Në këtë I.E.V.P, ekzistonte edhe një godinë e cila shërbente si spitali i këtij Institucioni. Në këtë ndërtesë gjendeshin katër dhoma të cilat ishin të mirë pajisura me orendi, me nga një krevat për dhomë dhe në kushte të mira higjieno-sanitare. Në momentin e vizitës nuk gjendej asnjë i dënuar/ paraburgosur në këto dhoma.

Gjithashtu, në këto ambiente gjendeshin edhe dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e stomatologut dhe farmacia. Dhoma e mjekut ishte e pajisur me një krevat vizite, tavolinë, karrige dhe një dollap ku mbaheshin të kyçura kartelat mjekësore. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt e pajisur me një poltron, unit funksional, por mungonin autoklava dhe materialet bazë dentare. Gjithashtu, farmacia ishte e rregullt, por për sa i përket furnizimit me medikamente, një sasi e vogël e tyre siguroheshin nga DPB, ndërsa pjesa tjetër duhej të sigurohej nëpërmjet skemës së rimbursimit të ilaçeve, cila nuk funksiononte në këtë institucion. Megjithatë, në lidhje me ankesat që kishin të intervistuarit në regjim sa i përket mbulimit të plotë me ilaçe nga institucioni, farmacistja ngriti pretendimin se kjo vjen si pasojë e preferencave të vetë të dënuar/ paraburgosurve për të zgjedhur një lloj medikamenti “më të shtrenjtë dhe më të mirë” dhe rrjedhimisht kjo i shtynte të dënuarit/ paraburgosurit t’i siguronin nga jashtë institucionit nëpërmjet familjes.

Vlen për t’u theksuar fakti se, nga ana e mjekut të këtij institucioni ishte treguar kujdes i veçantë ndaj të sëmurëve mendor, duke i siguruar konsultime të vazhdueshme dhe vlerësime të herëpashershme të diagnozave dhe mjekimeve, të cilat mbuloreshin nga psikiatrit e rrethit Vlorë.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut u konstatua ekzistenca e një regjistri të vizitave mjekësore, regjistri të mjekimeve, regjistri për konsultat e specializuara në Spitalin Rajonal të Vlorës, regjistri për të sëmurët mendor dhe abuzuesit me substanca narkotike/ alkoolin, regjistri i personave që refuzojnë terapinë, regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, të cilat ishin të gjithë të sekretuar dhe të mbajtur me rregull. Kartelat mjekësore ishin gjithashtu të mbajtura me rregull dhe të mbyllura në dollap me dry.

Një problematikë e gjetur në këtë institucion ishte edhe pajisja e të dënuarve/ paraburgosurve me libreza shëndetësore. Vetëm 20 prej tyre ishin të kompletuar me këto libreza. Pjesa tjetër për shkak të mungesës së dokumenteve të identifikimit, apo vonesave në transferimin e tyre nga institucionet ku këta të dënuar/ paraburgosur vuanin dënimin më parë, ka sjellë pengesa në kompletimin e tyre me libreza shëndetësore. Për rrjedhojë në këtë institucion nuk funksiononte skema e rimbursimit të ilaçeve, gjë që sillte edhe vështirësi në sigurimin e medikamenteve me nëpërmjet kësaj skeme.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për të kufizuar mbipopullimin në I EVP Vlorë me objektivin që çdo çeli të ofrojë minimalisht 4m<sup>2</sup> hapësirë jetike për person.
2. Marrja e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, në respekt të, Nenit 24 të Ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 *”Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”*, i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.
3. Marrja e masave të menjëhershme nga ana e Drejtuesit e institucionit lidhur me çrrënjosjen e rasteve të keqtrajtimit fizik të të burgosurve nga stafi i sigurisë duke përmirësuar menaxhimin dhe mekanizmat mbikëqyrës të cilët mundësojnë vënien para përgjegjësisë të personave të cilët përdorin praktika të keqtrajtimit fizik të paraburgosurve apo përdorim të tepruar të forcës.
4. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me ndërprerjen e praktikës së përdorimit të prangave brenda ambienteve të veçimit si një praktikë e papranueshme e cila mund të konsiderohet si një situatë e trajtimit degradues dhe jo njerëzor të të burgosurve.
5. Marrja e masave të menjëhershme për ndërprerjen e penalizimeve kolektive ndaj të miturve të cilat reduktonin aktivitetin e ajrimit prej 3 orësh dhe ofrimin i tij vetëm 30 minuta në ditë.
6. Marrja e masave lidhur me ndalimin e praktikës për vendosjen e të miturve në kushte që i ngjajnë izolimit të vetmuar deri në 20 ditë, masë kjo që mund të komprometojë integritetin e tyre fizik dhe/ ose mendor.
7. Të konsiderohen masat disiplinore në kushte veçimi ndaj të miturve si raste të rralla dhe të përdoren për periudha sa më të shkurtra të mundura (preferencialisht, për një periudhë e cila nuk i kalon 3 ditët).
8. Marrja e masave lidhur me përdorimin e masave edukative për të miturit të vlefshme për funksionin e tyre pedagogjik të cilët mundësisht të zëvendësojnë masat disiplinore të parashikuara për të rriturit.
9. Marrja e masave të menjëhershme që të gjitha procedurat disiplinore që zbatohen për të mitur të shoqërohen nga procedura zyrtare dhe të regjistrohen në regjistrat përkatës dhe hollësitë e plota të këtyre sanksioneve të regjistrohen në një regjistër të mbajtur posaçërisht në institucion.
10. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me organizimin e aktiviteteve në grup mes të miturve në mënyrë që të rritet kohezioni në grup, dialogu mes tyre me qëllim pajtimin dhe krijimin e situatave sociale përbashkuese dhe shmangien e konflikteve dhe incidenteve në ambientet e ajrimit dhe ambientet e përbashkëta.
11. Marrja e masave për përdorimin dhe mbajtjen hapur të dhomës së aktiviteteve ku ndodhet TV për të miturit që nuk kanë TV në dhoma, jo vetëm gjatë orarit të paradites por edhe për aktivitete gjatë pasdites.
12. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të jetesës të dhomave të të miturve, riparimin e tualeteve dhe përmirësimin e higjienës në dhoma.
13. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e të miturve dhe paraburgosurve të rritur me paketa bazë të higjienës personale dhe me detergjente.
14. Marrja e masave të menjëhershme për pastrimin e dhomave të veçimit pajisjen e tyre me tavolina dhe stola në mënyrë që të mundësohet ushqimi dhe kushtet bazë të jetesës në mënyrë njerëzore.

15. Marrja e masave të menjëhershme për mbulimin me kamera të sigurisë të ambienteve të korridorit të hyrjes së godinës “A”.
16. Marrja e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së sektorit të shëndetësisë, minimalisht me një mjek me kohë të plotë.
17. Marrja e masave nga ana e mjekut të këtij institucioni për marrjen e kontakteve më të shpeshta me të dënuarit/ paraburgosurit veçanërisht në sektorin e të miturve si grup vulnerabel që vuajnë dënimin në këtë IEVP, si dhe për shkak të problematikave të ndryshme që ata manifestojnë asht dhe për përgjigjen në kohë të kërkesave të tyre për vizita mjekësore.
18. Të merren masa për furnizimin e kabinetit të stomatologut me autoklavë dhe materiale dentare, si dhe ofrimin e një shërbimi stomatologjik adekuat dhe në kohë me ndërhyrjet përkatëse.
19. Marrja e masave për pajisjen e këtij institucioni me një autoambulancë.
20. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e të gjithë të dënuarve/ paraburgosurve të këtij institucioni me librezë shëndetësore.
21. Marrja e masave të menjëhershme për vënien në funksion të skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe sigurimin kështu të furnizimit të rregullt me to në bazë.

**5.24. Institucioni i Veçantë Mjekësor i Burgjeve, Tiranë - Datë 09.12.2014 / Nr. Dok. 201500083**

***Shënime paraprake***

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me Drejtuesin e Institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Nga ana e Drejtuesit të Institucionit, ekspertëve të grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhej të monitoronin.

Drejtuesi i këtij Institucioni bëri me dije se në bazë të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr.3187/2, datë 13.06.2011, ndryshohet emërtesa e këtij Institucioni nga “Qendër Spitalore e Burgjeve” në “Instituti i Veçantë Shëndetësor i Burgjeve”, një kopje e të cilit u administrua nga grupi i ekspertëve monitorues të MKPT-së. Gjithashtu në bazë po të këtij urdhri në I.V.SH.Burgjeve ishte shtuar një seksion për personat “bashkëpunëtorë të drejtësisë”.

I.V.SH.Burgjeve ka një kapacitet zyrtar prej 99 personash. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit gjendeshin 97 pacientë, dy prej të cilëve ishin për konsulta të specializuara, njëri në Qendrën Spitalore të Traumës dhe tjetri në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”. Në këtë Institucion nuk kishte mbipopullim.

Në I.V.SH.Burgjeve trajtoheshin të dënuar me masë sigurie “mjekim i detyruar”, me masë “shtrim i përkohshëm” dhënë nga gjykatat respektive, dëshmitarë procesi gjyqësor në gjykim, dhe të dënuar që prisnin të kryenin ekspertizën mjeko-ligjore. Pjesa tjetër e të dënuarve/ paraburgosurve që gjendeshin në këtë institucion, ishin sjellë për trajtim më të specializuar sipas

patologjive të ndryshme që kishin manifestuar në I.E.V.P-të përkatëse. Shërbimi kryesor në I.V.SH.B është ai i kujdesit shëndetësor dhe psiko-social.

Në momentin e vizitës monitoruese, në këtë Institucion gjendeshin 51 të sëmurë mendorë, nga të cilët 19 persona që ishin me masën “*mjekim të detyruar*” dhe 23 me masën “*shtrim të përkohshëm*”.

Në këtë Institucion nuk kishte sektor të veçantë për të mitur apo 18-21 vjeçarë. Në momentin e inspektimit nuk gjendeshin të dënuar/ paraburgosur të kësaj kategorie.

Në I.V.SH.B. nuk kishte një ndarje në sektor për të paraburgosur dhe të dënuar, por kjo bëhej sipas sëmundjeve për të cilat ata shtroheshin në këtë institucion, ndaj dhe ndarja ishte në tre pavijone: Patologjia, Psikiatria, dhe Infektiv.

Në pavijonin e patologjisë gjendeshin të shtruar 15 pacientë, si dhe 3 pacientë në dhomën e observimit, e cila përdorej për rastet më të rënda që kishin nevojë për një monitorim të vazhdueshëm nga ana e stafit mjekësor.

Në pavijonin e infektivit gjendeshin të shtruar 15 pacientë. Në këtë pavijon gjendej edhe një sektor i veçantë me 6 dhoma, i cili shërbente për shtrimin e pacienteve gra. Në ditën e inspektimit në të gjendeshin 5 gra me masën “*mjekim të detyrueshëm*”.

Në pavijonin e psikiatrisë gjendeshin të shtruar 34 pacientë. Në këtë pavijon kishte 10 dhoma.

Organika e stafit të këtij Institucioni ishte e plotësuar, por nga ana e Drejtorit të I.V.SH.Burgjeve u theksua fakti se ishte bërë e domosdoshme shtimi i stafit të sigurisë sidomos kur bëhej fjalë për shoqërimin dhe transportimin, e të sëmurëve në kushte sigurie pranë shërbimeve të tjera të QSU “Nënë Tereza” Tiranë, sipas nevojave dhe kërkesave që këta pacientë kishin për konsulta të specializuara. Sektori shëndetësor ishte i plotësuar me mjekë të specialiteteve të ndryshme, ndërkohë që sipas Drejtorit të këtij Institucioni, kishte nevojë për shtim të organikës me infermierë dhe kujdestarë.

Sipas informacionit që u mor nga ana e Drejtuesit, në këtë Institucioni nuk kishte pasur ngjarje të rënda.

Gjatë vizitës, grupi i inspektues konstatoi se godina e këtij institucioni në të cilin mbaheshin pacientët, ishte tej mase e amortizuar dhe me nivel të lartë lagështie në të gjithë ambientet e saj ku dhe mungonte ngrohja.

### ***Trajtimi***

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e pacientëve (të dënuarve/ paraburgosurve), dhe identifikimin e rasteve të presionit psikologjik apo të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative ndaj kësaj kategorie. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me ta, grupi

monitorues nuk konstatoi ndonjë rast të presionit psikologjik, të përdorimit të tepruar të forcës fizike, apo rast flagrant torture.

Në I.V.SH.Burgjeve Tiranë, në momentin e inspektimit, ankesa pati kryesisht në lidhje me kushtet higjieno-sanitare në dhoma, dushe dhe tualete e mungesën e një sistemi qendror të ngrohjes.

Ajrimi në këtë institucion bëhej në dy ambiente me hapësirë 10-12m<sup>2</sup>, por të pambuluara.

Mjediset e përbashkëta që duhet të ofronin zhvillim të aftësive individuale, aktivitete sociale, sportive, këshillime individuale dhe në grup ishin të mangëta.

Në këtë institucion mungonte dyqani për blerjen e produkteve bazë sipas nevojave të të dënuarve/ paraburgosurve. Për rrjedhojë këto produkte siguroheshin nga familjarët, pasi i nënshtroheshin kontrollit sipas rregullores i kalonin personit përkatës.

Në këtë institucion kishte një mjedis të veçantë për takimet e pacientëve me familjarët, i cili gjendej në hyrje të regjimit. Ky mjedis kishte një dhomë të papërshtatshme për të kryer funksionin e një ambienti takimesh, pasi aty nuk kishte tavolina e karrige. Takimet zhvilloheshin në këmbë nga të dy anët e zagares së hekurit.

### ***Masat mbrojtëse.***

Komisioni i Pritjes funksiononte normalisht. Të dhënat regjistroheshin në një regjistër të posaçëm. Rolin kryesor në pritjen dhe pranimin e personave që sillen në këtë Institucion, e luanin mjekët specialistë. Kjo për faktin se ky Institucion ka si parim primar të punës së tij ofrimin e shërbimit shëndetësor të specializuar.

Sa i përket çështjes së sigurisë, I.V.SH.B Tiranë ishte e pajisur me kamera sigurie, si në mjediset e jashtme, ashtu edhe në ato të brendshme përfshirë këtu edhe korridoret.

Takimet me familjarët zhvilloheshin 4 herë në muaj, në një mjedis të veçantë të parashikuar për këtë qëllim. Dhoma nuk i plotësonte kushtet specifike për takimet me të miturit.

Ekzistonte sistemi i kërkesë/ ankesave, i cili administrohej nga sektori i psiko-social, i cili më pas ia kalonte këto kërkesë/ ankesa Drejtorit të Institucionit. Ky i fundit, pas shqyrtimit të tyre, kthen përgjigje verbale ose me shkrim brenda 24 orëve, nëpërmjet punonjësve socialë dhe edukatorëve. Nuk pati ankesa në lidhje me kohëzgjatjen e dhënies së përgjigjes nga ana e Drejtuesit të këtij Institucioni. E gjithë procedura e ndjekur nga ana e sektorit të edukimit dokumentohej në një regjistër të kërkesë/ ankesave i cili mbahej me rregull nga ana e këtij stafi.

Mjetet e kufizimit fizik në këtë institucion ishin rripa prej lëkure të cilat sipas stafit të këtij Institucioni përdoreheshin shumë rrallë dhe në raste ekstreme sipas rekomandimit të mjekes psikiatre.

Pacientëve që trajtoheshin në këtë institucion, iu lejoheshin 8 telefonata në muaj.

Një problematikë e hasur në pavijonet e këtij Institucioni ishte mungesa e zileve elektronike në dhomat e pacientëve, gjë e cila pengonte komunikimin e përshtatshëm të pacientëve me stafin në rastin e nevojave emergjente për ndihmë nga ana e tyre.

### ***Kushtet materiale***

Ashtu siç u konfirmua nga Drejtuesi i Institucionit dhe siç është konstatuar edhe në inspektimet e mëparshme, mjedisi në regjim, vijonte të ishte tej mase i amortizuar dhe me lagështirë të theksuar.

Godina e këtij institucioni ishte e ndërtuar para shumë vitesh dhe investimet për rikonstruksionin e saj kanë qenë të rralla. Drejtori i këtij Institucioni bëri me dije se kohët e fundit ishte investuar në riparimet e ambientit të administratës dhe në riparimin dhe hidro-izolimn e jashtëm të godinës, ndërkohë që kërkesat e tij ishin të vazhdueshme për sigurimin e fondeve për një rikonstruksion të plotë të saj.

Në këtë Institucion mungonte një sistem qendror për ngrohjen gjë që u konstatua menjëherë nga grupi inspektues. Edhe pse temperaturat në mjediset e jashtme ishin të tolerueshme, në momentin e hyrjes në mjedisin e spitalit kishte një ndryshim të theksuar të tyre, pasi në dhomat e pacientëve nuk lejohej përdorimi i mjeteve të tjera ngrohëse. Në lidhje me këtë problematikë, Drejtori i institucionit u shpreh se ekzistonte një marrëveshjeje ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, sipas së cilës Drejtoria e QSU “Nënë Tereza” kishte detyrimin të siguronte ngrohjen e IVSHB-së. Megjithëse drejtuesi I.V.SH.B-së i ishte drejtuar me kërkesa të vazhdueshme Institucionit në fjalë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, këto përpjekje nuk kishin rezultuar e frytshme. Ngrohja mungonte në të gjithë ambientet e këtij institucioni.

Në katin e parë të regjimit të brendshëm në I.V.SH.B gjendej pavijoni i patologjisë, i cili kishte 8 dhoma me banja brenda, kushtet higjieno-sanitare të cilave linin shumë për të dëshiruar. Në dhomën 2 të këtij pavijoni gjendej edhe një pacient me aftësi të kufizuar, i diagnostikuar me Sklerozë Multiple, për të cilin vlen të theksohet se i ishin krijuar kushte lehtësuese për kryerjen e nevojave personale si në dhomë ashtu dhe në korridorët që çojnë drejt ajrimit.

Dushet gjendeshin në fund të korridorit me 4 poste, prej nga, vetëm njëri kishte kokë dushi. Dushet zhvilloheshin disa herë në javë dhe pa një grafik të veçantë, por gjatë intervistave konfidenciale me pacientët u morën ankesa për sa i përket mungesës së herë pas hershme të ujit të ngrohtë në to.

Pranë kolonës gjendej një ambient me 4 telefona të cilët ishin funksionalë. Gjithashtu, aty gjendej edhe dhoma e këshillimit të sektorit të edukimit, ku zhvilloheshin këshillime individuale e tema sociale me grupe të vogla pacientësh. Në këtë pjesë të këtij pavijoni gjendej edhe njëri nga ambientet e ajrimit.

Pavijoni i infektivit kishte gjithashtu 8 dhoma ku njëra prej tyre shërbente si dhomë observimi. Kushtet higjieno-sanitare në këto dhoma ishin gjithashtu të papërshtatshme, me hapësirë të vogël e lagështirë të theksuar. Edhe në këtë sektor banjat dhe dushet ishin në kushte amortizimi të skajshëm. Dushet kishin një vaskë dhe dy poste ku vetëm njëra prej tyre ishte funksionale. Në

këtë pjesë të pavijonit ndodhej edhe një shesh tjetër ajrimi me thujse të njëjtën sipërfaqe dhe kushte si ai në pavijonin e patologjisë.

Pavijoni i psikiatrisë kishte 10 dhoma me mangësi në pajisjen e tyre e tavolina, karrige. Çarçafët dhe dyshekët e këtyre dhomave ishin shumë të vjetër e të dëmtuar. Nga ana e stafit, grupit të ekspertëve ju bë me dije se kjo ishte një problematikë specifike e këtij pavijoni, pasi dëmtimi i këtyre pajisjeve bëhej herë pas here nga vetë pacientët e trajtuar në të. Gjithsesi ky pretendim nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar faktin që këta pacientë mbahen në kushte të tilla degraduese dhe jo humane.

Në katin e dytë të kësaj godine kishte dhe një pavijon tjetër, ku në njëri krah mbaheshin pacientë të tjerë me probleme të shëndetit mendor dhe në krahun tjetër pacientë me sëmundje të brendshme, kushtet e të cilët ishin gjithashtu jashtë standardit.

Dhomat, tualetet dhe dushet e tyre ishin në kushte të amortizimit të skajshëm. Megjithëse në dhoma kishte tualete, në pjesën dërrmuese të tyre mungonin aksesoret.

Ndriçimi natyral në dhomat e pacientëve ishte i dobët, pasi dritaret ishin të vogla. Ndërsa ndriçimi artificial në secilën prej dhomave sigurohej nga një llampë e vogël e vendosur mbi dyert e dhomave në pavijoneve, e cila ishte gjithashtu e pamjaftueshme.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm në këtë institucion nuk paraqiste probleme, ndërkohë që për sa i përket ujit të pijshëm ai blihej nga familjarët e pacientëve.

Nga bisedat në privatësi me pacientët u konstatua se kishte mungesa në furnizimin e pacientëve me produkte të higjienës personale si sapun, shampo etj.

Kuzhina ishte e pastër, e rregullt, por me lagështirë si gjithë ambientet e tjera të institucionit. Ajo shërbente vetëm për shpërndarjen e vakteve në pavijone, pasi ushqimi sigurohej me catering nga kuzhina e QSU “Nënë Tereza”. Menyja ditore ishte e afishuar dhe kampionet ushqimore ruheshin në kushte frigoriferike të mbyllura me dry.

Si lavanderi e këtij institucioni shërbenin dy lavatriçe të cilat ishin të pamjaftueshme për të siguruar një shërbim të plotë të këtij lloji, ndaj pacientët preferonin që këtë shërbim ta merrnin nga familja.

Biblioteka nuk ekzistonte si ambient për këtë institucion. Mungonte gjithashtu edhe një ambient kulturi.

Dhomat e vizitave të mjekëve brenda në regjim, ishin të vendosura sipas pavijoneve, ku njëra prej tyre shërbente edhe si dhomë e ekspertëve mjeko-ligjor, dy të tjerat shërbenin si dhoma vizitash. Ashtu si të gjithë ambientet e brendshme të këtij Institucioni edhe këto dhoma ishin tej mase të amortizuara, me gjithë përpjekjet e stafit për ti mirëmbajtur ato.

Dhomat e infermierisë ishin të ndara sipas pavijoneve. Dy të tilla gjendeshin në pavijonin e patologjisë dhe të psikiatrisë, ndërsa tjetra funksiononte edhe si dhomë e mjekimeve kirurgjikale. Ato ishin të rregullta, por të amortizuara dhe të varfra me pajisje.

Dhoma e takimit me familjarët ishte e papërshtatshme për këtë qëllim, pasi kishte një nivel i lartë lagështie, me suva të rënë në mure dhe e pa pajisur me tavolina e karrige, dhe nuk i plotësonte standardet për takimet me të mitur.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Sipas organikës së miratuar të sektorit të kujdesit psiko-social, ky shërbim ishte i kompletuar me staf dhe përbëhej nga përgjegjësjë e sektorit dhe dy specialiste edukimi.

Nga kontakti me stafin e kujdesit psiko-social si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultonte se në I.V.SH.Burgjeve Tiranë, aktivitetet ishin të vagëta, si rrjedhojë e mungesës së ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e tyre, por edhe specifikës së lidhur me vështirësitë që vinin nga gjendja shëndetësore e pacientëve dhe mundësive të tyre për të qenë aktiv. Gjithsesi, bashkëpunimet e këtij institucioni me SHKBLSH, Komunitetin Mysliman dhe QSHPLI ishin të shumta, gjë që grupi inspektues e vlerësoi si shumë të dobishëm për pacientët e këtij spitali.

Nga ana e stafit psiko-social, dy herë në muaj zhvilloheshin aktivitete në grupe të vogla ku trajtoheshin temave sociale mbi tematika aktuale.

Këshillimet në grup mungonin, ndërsa nga ana e këtij stafi bëheshin përpjekje për realizimin e këshillimeve individuale 1 herë në muaj me secilin pacient sipas planit të punës ose sipas kërkesave nga vetë pacientët. Këshillimet ofroheshin në dhomën e këshillimit.

Sipas stafit psiko-social, në institucion zhvillohej terapi arti sipas interesit dhe prirjeve që shfaqnin pacientët, si dhe terapi okupacionale në ambientet e jashtme për pastrim kopshti, mbjellje dhe ujitje lulesh etj.

Dosjet psiko-sociale në të cilat ishin të përfshira programet individuale të trajtimit mbaheshin përgjithësisht me rregull dhe të mbyllura me çelës, megjithëse plotësimet e shumë prej tyre ishin formale. Planet individuale të trajtimit ishin kryesisht të përqendruara në personat të cilët kishin kryer tentativë për vetëvrasje dhe në ata abuzues me substanca narkotike.

Planet e ndërhyrjes nga ana e këtij stafi sidomos në rastet me probleme të shëndetit mendor nuk rezultonin të bashkërenduara kënaqshëm me stafin mjekësor, edhe si rrjedhojë e mungesës së kushteve dhe ambienteve për t'i realizuar ato. Gjithsesi, punonjësit e këtij sektori ishin prezentë në vizitat e mëngjesit që bënte stafi mjekësor në pavijone.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e sektorit të shëndetësisë ishte e plotësuar. Ajo përbëhej nga 8 mjekë specialistë, 1 kryeinfermier, 17 infermier, 1 laborant radiolog, 1 farmacist, 3 kujdestarë dhe 11 sanitarë,



megjithëse nga ana e drejtuesit të këtij Institucioni u shpreh si domosdoshmëri shtimi i kësaj organike me infermierë dhe kujdestarë.

Gjatë vizitës në këtë institucion, u vu re se pacientët në të gjithë pavijonet ishin të kënaqur sa i përket kujdesit shëndetësor të ofruar në këtë institucion si dhe kontaktet e shpeshta që stafi i këtij sektori realizonte me to. Kjo reflektohej edhe në kërkesën e pacientëve për të qëndruar më gjatë në këtë institucion edhe pse gjendja e tyre shëndetësore nuk e lejonte një gjë të tillë. Gjithashtu, sipas intervistave të marra në privatësi me pacientët, konsultat në shërbimet e QSUT-së kryheshin sa herë të ishte e domosdoshme dhe me përgjigje në kohë të nevojave të tyre.

Dhomat e infermierisë ishin të ndara sipas pavijoneve. Dy të tilla gjendeshin në pavijonin e patologjisë dhe të psikiatrisë, ndërsa tjetra funksiononte edhe si dhomë e mjekimeve kirurgjikale. Ato ishin të rregullta, por të amortizuara dhe të varfra me pajisje. Në këto dhoma mbaheshin terapitë ditore të pacientëve si dhe ilaçet e urgjencës.

Mjekët e këtij Institucioni zhvillonin vizita çdo mëngjes në pavijone duke konstatuar problematikat e hasura në pasdrekën paraardhëse, si dhe duke i dhënë zgjidhje rast pas rasti me konsultat dhe ekzaminimet përkatëse.

Farmacia kishte pasur mungesa të theksuara në ilaçe. Kohët e fundit, pas një fondi shtesë të siguruar nga Drejtuesi i këtij Institucioni, ajo ishte pajisur me larmi ilaçesh. Kjo u vu në dukje edhe nga mjekët specialistë që punonin në këtë Institucion. Megjithatë, Drejtuesi i këtij Institucioni theksoi faktin se vështirësi ishte hasur në sigurimin e trajtimit me medikamente të personave me sëmundje tumorale, për shkak edhe të kostos së lartë të këtyre lloj medikamenteve.

Institucioni kishte një autoambulancë të re të siguruar para disa muajsh nga ana e Drejtorit të këtij Institucioni.

Shërbimi stomatologjik në këtë institucion mbulohej nga stomatologu i I.E.V.Penale “Ali Demi”, i cili kryente vizita çdo javë dhe në varësi të problematikave të hasura ndërhyrjet i zhvillonte në kabinetin e tij pranë kësaj I.E.V.P-je.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit të shërbimit shëndetësor, në veçanti të mjekut, u konstatua se ekzistonte një regjistër i hapjeve të kartelave, regjistri i vizitave mjekësore të mjekut, të cilët ishin të sekretuar dhe të mbajtur me rregull. Kartelat mjekësore ishin gjithashtu të plotësuara rregullisht nga mjekët, ku pasqyrohej në detaje informacioni mbi gjendjen shëndetësore të pacientit dhe terapia ditore e tij. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve ishin të rregullta.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave urgjente për rikonstruksionin e plotë të I.V.SH.Burgjeve Tiranë, pasi ky është një Institucion që ofron kryesisht shërbim shëndetësor, ndaj dhe kushtet e trajtimit të pacientëve duhet të përmbushnin standardet e një shërbimi shëndetësor adekuat konform legjislacionit në fuqi dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

2. Marrja e masave për ndarjen e pacientëve në sektorë të veçantë për të paraburgosur e të burgosur sikurse parashikojnë standardet.
3. Marrja e masave për krijimin e një ambienti të përshtatshëm dhe konform standardeve për takimet e pacientëve me familjarët e rritur e të mitur.
4. Marrja e masave për pajisjen e çdo dhome të regjimit të brendshëm me zile elektronike, në mënyrë që të lehtësohet komunikimi i pacientëve me stafin në rastin e nevojave emergjente për ndihmë nga ana e tyre.
5. Marrja e masave të menjëhershme për sigurimin e ngrohjes në të gjithë ambientet e këtij Institucioni përmes vënies në zbatim të marrëveshjes me drejtorinë e QSUT-së.
6. Marrja e masave për pajisjen e dhomave të pacientëve me orendi, çarçafë, dyshekë, karrige e tavolina, me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës sipas standardeve të vendosura nga kuadri ligjor në fuqi dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.
7. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e pacientëve me paketën bazë të higjienës personale.
8. Marrja e masave për riparimin e plotë të dusheve dhe tualeteve, si dhe përmirësimin e kushteve higjieno sanitare të tyre.
9. Marrja e masave për vënien në shërbim të pacientëve të një dyqani brenda institucionit, në mënyrë që pacientët të kenë mundësi të sigurojnë produktet bazë jetike.
10. Marrja e masave për krijimin e ambienteve të përbashkëta për të mundësuar zhvillimin e aktiviteteve fetare, kulturore dhe sportive nga ana e sektorit të kujdesit psiko-social.
11. Marrja e masave për shtimin në organikë të personelit të mesëm mjekësor duke pasur parasysh kategorinë e veçantë të personave që trajtohen në këtë Institucion.
12. Marrja e masave për shtimin në organikë të një stomatologu në mënyrë që të ofrohet një shërbim adekuat dentar.
13. Marrja e masave për krijimin e një fondi rezervë për të sëmurët me sëmundje tumorale, trajtimi i të cilët kërkon medikamente të kushtueshme.
14. Marrja e masave për shtimin e organikës së stafit policor në mënyrë që të bëhet shoqërimi i të sëmurëve në qendrat e tjera spitalore brenda QSUT-së pa cenuar kushtet e sigurisë.

## **5.25. I EVP Rrogozhinë - Datë 30.12.2014 / Nr. Dok. 201500038**

### ***Shënime të përgjithshme***

Vizita monitoruese e Avokatit të Popullit dhe stafit të MKPT-së pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë shumë të mirë bashkëpunimi. Nga Drejtoria e Institucionit, Avokatit të Popullit dhe ekspertëve iu mundësua kryerja e inspektimit të jashtëm dhe të brendshëm në Institucion, brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që do të monitoroheshin. Objektivi kryesor i vizitës monitoruese ishte vlerësimi i kushteve dhe trajtimi i të dënuarve/ paraburgosurve.

Me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 329, datë 15.01.2009 “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar, I EVP Rrogozhinë kategorizohet “Burg i sigurisë së zakonshme me një seksion paraburgimi.” Kapaciteti maksimal i tij është 345 persona. Në kohën e vizitës, I EVP Rrogozhinë strehonte 462 të dënuar/ paraburgosur.

Gjatë vizitës, grupi monitorues pati si fillim një takim me Shefin e Sigurisë së Institucionit, i cili bëri një pasqyrë të situatës aktuale në institucion duke evidentuar se një nga problemet kryesore të institucionit ishte mbipopullimi. Në momentin e inspektimit ky institucion kishte një numër prej 462 personash, të cilët ishin të ndarë sipas kategorive, 309 të paraburgosur dhe 153 të dënuar. I EVP Rrogozhinë ofronte mundësi punësimi për 8 të paraburgosur dhe 44 të dënuar. Kryesisht të dënuarit/ paraburgosurit punonin në kuzhinë, lulishte, pastrim, bibliotekë, mirëmbajtje, etj. Nuk pati ankesa për sa i përket njohjes së ditëve të punës dhe dhënies së dinamikave të punësimit personave të interesuar.

Kategori të veçanta ishin 2 persona me probleme të shëndetit mendor, 5 persona të sëmurë kronik të dërguar për trajtim të specializuar mjekësor pranë IVSHB Tiranë dhe 20 persona të grup-moshës 19-21 vjeçare.

Në I EVP Rrogozhinë, me datë 28.12.2014, ora 03.00, kishte pasur një ngjarje të rëndë me pasoja vdekjen e të paraburgosurit Qamil Zela si rezultat i një akti suicidal. Lidhur me këtë rast, një grup pune u dërgua nga Avokati i Popullit po më datë 28.12.2014 pranë I EVP Rrogozhinë për të verifikuar rrethanat e kësaj ngjarje të rëndë për të cilën referohet më tej në material.

### ***Trajtimi***

Gjatë vizitës monitoruese grupi i ekspertëve vizitoi dhe kontaktoi me të dënuarit/ paraburgosurit në të gjitha ambientet e I EVP Rrogozhinë. Në lidhje me respektimin e të drejtave të tyre si ajrimi, takimi me familjarët, telefonatat, servirja e rregullt e ushqimit etj., të dënuarit/ paraburgosurit u bënë me dije eksperteve se përgjithësisht u respektoheshin këto të drejta.

Gjatë intervistave grupi monitorues konstatoi ankesa për raste të ushtrimit të dhunës fizike dhe asaj psikologjike nga ana e personelit të sigurisë në institucion ndaj dy të paraburgosurve Sh.S dhe E.G të vendosur prej 30 ditësh në dhomën e veçimit nr.7. Dy të paraburgosurit u ankuar se ishin goditur dhe fyer rëndë nga ana e punonjësve të policisë së I EVP Rrogozhinë në ditët e para të ardhjes në këtë I EVP. Ata gjithashtu pretenduan se nuk ishin nxjerrë në ajrim dhe nuk kishin dalë nga dhoma gjatë 30 ditëve të qëndrimit në ambientet e veçimit. Dhoma ku ata ishin vendosur ishte e përmasave 2x4m me një dritare të vogël që nuk lejonte aspirimin apo hyrjen e dritës natyrale sipas parametrave ligjorë. Gjithashtu në këtë dhomë krahas dy krevateve, nuk kishte tavolinë, stola apo dollapë për mbajtjen e rrobave. Grupi monitorues u informua nga i paraburgosuri E.G se në kushte të rënda psiko-emocionale të shkaktuara nga kushtet dhe situata në të cilën ai gjendej, para dy javëve kishte kryer tentativë suicidale duke tentuar të priste damarët e duarve.

Në seksionin e veçim/ izolimit për shkak të mbipopullimit, mbaheshin dhe të dënuar/ paraburgosur të tjerë për periudha të gjata kohe, ndërkohë që këto ambiente janë të destinuara për përdorim sa më të shkurtër në kohë dhe se vendosja në to duhet të bëhet vetëm me vendim të komisionit disiplinor.

Në dhomën e veçimit nr.3, mbahej shtetasi S. F, i dënuar në mungesë me heqje lirie, 60 ditë burg. I dënuari kishte kaluar 7 ditë në këto ambiente dhe ankohej se nuk i ishte dhënë

informacion nëse do të akomodohej në ambiente të tjera të përshtatshme për banim. Gjithashtu, shtetasi G.H, i paraburgosur për vepra me rrezikshmëri të ulët shoqërore (akuzuar për vjedhje të energjisë elektrike) kishte kaluar 40 ditë në këto ambiente. Përgjigja e autoriteteve të institucionit ndaj kërkesës së tij për t'u transferuar në regjimin e paraburgimit, ishte se nuk kishte vende të lira. Shtetasi, F. K, 62 vjeç, kishte gjithashtu një muaj i vendosur në këto dhoma pa asnjë shpresë për t'u transferuar në rregjim normal. Shtetasi, A.Sh., ishte ndëshkuar me masë disiplinore prej 20 ditësh me veçim dhe përjashtim nga aktivitete të përbashkëta, por kishin kaluar 30 ditë dhe akoma qëndronte në ambientet e izolimit/ veçimit dhe nuk ishte transferuar ende në dhomën e tij.

MKPT i kushton vëmendje të veçantë personave të dënuar/ paraburgosur, të mbajtur për çfarëdo arsye (për qëllime disiplinore si rezultat i sjelljes së tyre “të rrezikshme” ose “shqetësuese” për interes të hetimit penal apo për arsye sigurie apo me kërkesën e tyre), në kushte të ngjashme me izolim të zgjatur. Parimi i përpjesëtueshmërisë (proporcionalitetit) kërkon të ruhet një ekuilibër ndërmjet kërkesave të çështjes, dhe zbatimit të regjimit tip - izolim i tej zgjatur, i cili është një vendimarrje që mund të ketë pasoja shumë të dëmshme për personat në fjalë. Izolimi i tej zgjatur, në disa rrethana, mund të arrijë në trajtim poshtëruës e çnjerëzor. Në çdo rast, të gjitha format e izolimit duhet të jenë sa më të shkurtra që është e mundur.

Në rastin kur një regjim i tillë imponohet ose zbatohet me kërkesë nga vetë i dënuari, një garanci thelbësore është prezenca e vazhdueshme e mjekut në ambientet e veçimit, me synimin që personeli mjekësor të kryejë ekzaminimin mjekësor të burgosurve në mënyrë të vazhdueshme. Rezultatet e këtyre ekzaminimeve, përfshirë këtu një përkrahje të gjendjes fizike dhe mendore si dhe pasojat e parashikueshme të izolimit të vazhduar, duhet t'u paraqiten rregullisht me anë të një deklarate me shkrim nga ana e mjekut, autoriteteve kompetente për çështjet e regjimit dhe sigurisë në I EVP.

### ***Masat mbrojtëse***

Në momentin e vizitës monitoruese I EVP Rrogozhinë rezultoi me mbipopullim, i cili, siç u pranua edhe nga vetë drejtuesit e këtij institucioni, në vazhdimësi gjatë gjithë vitit ka qenë i lartë.

Lidhur me ndarjen në seksione, të paraburgosurit ishin të ndarë në seksion më vete nga të dënuarit. Ata realizonin ajrimin dhe aktivitetet e tjera të përbashkëta veçmas nga të dënuarit. Për efekt edhe të mbipopullimit, nuk kishte një ndarje në seksion të veçantë për grup-moshën 18-21 vjeç. Ata ishin vendosur në të njëjtin sektor me të rriturit, por në dhoma të veçanta. Aktivitetet e përbashkëta 18-21 vjeçarët i kryenin së bashku me madhorët.

Ekspertët morën informacion në lidhje me pritjen e të burgosurve/ paraburgosurve në institucion dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes, si dhe në lidhje me plotësimin e regjistrave e dosjeve personale të tyre. Nga biseda me Drejtuesit e Institucionit dhe verifikimeve në dosje grupi monitorues konstatoi se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve, çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej. Regjistrat mbaheshin nga Sektori i Edukimit. Brenda në regjim kishte kuti postare ku mund të hidheshin ankesat/ kërkesat. Të dënuarit/ paraburgosurit mundej gjithashtu të zgjidhnin që ankesat/ kërkesat e tyre t'ua jepnin punonjësve të edukimit, të cilët ia dorëzonin drejtorit të institucionit. Kërkesë/ ankesat që nuk ishin të destinuara për drejtorin e institucionit

postoheshin. Nuk pati ankesa në lidhje me dhënien e përgjigjes nga ana e institucionit për ankesat ose kërkesat. Kryesisht kthimi i përgjigjes bëhej verbalisht, brenda afatit të parashikuar kohor.

Telefonat punonin në çdo kohë dhe të dënuarit / paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin me të afërmit e tyre sa herë të dëshironin deri në ora 19.00 nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit.

Takimet me familjarët në I EVP Rrogozhinë zhvilloheshin rregullisht. Në ambientet e takimeve, gjendeshin disa sportele të ndara me hekura dhe në dy anët e sporteleve. Familjarët zhvillonin biseda me të dënuarit/ paraburgosurit pa pasur mundësinë e kontaktit fizik që do të mund të krijonte takimi rreth një tavoline në kushte të tjera. Nga vëzhgimet e grupit inspektues, rezultoi se nuk kishte një mjedis të veçantë për takimet me personat e moshuar, apo me të miturit, të cilët nuk duhej të takonin të afërmit e tyre të dënuar/ paraburgosur përmes hekurave, por mundësisht në një mjedis më miqësor për këto kategori.

Institucioni kishte në funksion sistemin e monitorimit me kamera dhe në regjim u konstatuan se kishte kamera vëzhgimi të cilat mbulonin kryesisht pjesën e korridorit dalës tek pjesa e kolonës. Vëzhgimi kryhej për 24 orë.

Gjatë intervistave dhe bisedave konfidenciale, rezultoi se trajtimi me leje të veçanta dhe shpërblyese ishte një nga arsyet e ankesave të shumta nga të gjithë të dënuarit. Megjithëse shumë prej të dënuarve i kishin përmbushur kriteret për përftimin e lejeve, ata ishin penguar nga Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë Nr. 103, datë 17.02.2014, për njohje dhe zbatim të Udhëzimit të Ministrit "Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta personave të dënuar me burgim", udhëzim ky i pasuar gjithashtu në muajin Shtator 03.09.2014 me një urdhër të dalë nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, i cili porositi të zbatohen me përpikëri kërkesat ligjore që rrjedhin nga ligji Nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë nr. 103, datë 14.02.2014, i cili kërkon ndryshim të procedurave të dhënies së lejeve për të dënuarit për vepra penale të neneve 100, 101, 102, 103 dhe 104, sipas të cilit para se të jepej leje, duhej të merrej një miratim paraprak për arsye sigurie dhe nga komisariati i policisë së zonës së cilës i përket i dënuari që përmbush kriteret për përftimin e lejes.

### ***Kushtet materiale***

Në dhomat e inspektuara në sektorët e të dënuarve/ paraburgosurve, u vu re se baza materiale ishte deri diku e plotësuar, por kishte edhe dhoma të cilat për shkak të mbipopullimit nuk ofronin kushtet e nevojshme për jetesë. Në I EVP Rrogozhinë, kushtet materiale në 7 dhomat e seksionit të veçim/ izolimit paraqiteshin problematike dhe aspak në kushte të mira, me një infrastrukturë shumë të amortizuar, me lagështirë të skajshme dhe më një higjienë që linte për të dëshiruar. Këto dhoma ishin të palyera, të papastra, pa orenditë e nevojshme. Edhe dushet në këtë seksion nuk funksiononin normalisht. Nga të dënuarit/ paraburgosurit e dhomave 3 dhe 4 të këtij seksioni, pati ankesa se ata nuk ishin larë me ujë të ngrohtë prej një periudhe të gjatë, pasi dushi kishte pësuar defekt prej 3 muajsh dhe nuk ishte riparuar.

Më e rënduar paraqitej situata në sektorin e paraburgimit dhe veçanërisht në dhomën numër 1 të godinës 3 të observimit, ku në ditën e inspektimit ishin të akomoduar 23 persona. Në këtë dhomë, me përmasa 6x7x2.5m, kishte 16 shtretër. 5 persona flinin me dyshekë në tokë dhe 2 të tjerë flinin me turne apo dy veta në një krevat. Lidhur me këto kushte ekstreme, të paraburgosurit në dhomën e observimit, u shprehën se situata ishte shumë e rënduar pasi edhe ngrënia e ushqimit bëhej në kushte jo dinjitoze në kushtet e mungesës së hapësirës së nevojshme për tavolina dhe karrige. Ky rast faktori shkëlqen e rëndë të standardit ligjor si të sipërfaqes ashtu dhe të kubaturës së banimit për person.<sup>16</sup> MKPT lidhur me një situatë të ngjashme të mbipopullimit në këtë dhomë observimi, më datë 04.02.2014, ka rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen e problemit të mbipopullimit në këtë dhomë, pasi kjo situatë kishte krijuar premisat për rënien e zjarrit në godinë duke rrezikuar seriozisht jetën e të paraburgosurve. Pavarësisht rekomandimit gjendja jo vetëm nuk ishte përmirësuar, por ishte përkeqësuar.

Konstatimet lidhur me mbipopullimin e skajshëm në ambientet e I EVP Rrogozhinë, përveç problemeve të degradimit strukturor të ndërtesës dhe përkeqësimit të shërbimeve ndaj personave të privuar nga liria, ngrënë edhe shqetësimin e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në një vend demokratik.

Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT) me rastin e vizitës në Shqipëri, në vitin 1997, i ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare: Të dënuarit/ paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo më pak se 22 m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu dhe dhomat më të vogla se 6m<sup>2</sup> nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi.

Situata në I EVP Rrogozhinë me përafërsisht 35% mbipopullim mbi kapacitetin zyrtar, sjell shkëlqen e një sërë të drejtave të të burgosurve/ paraburgosurve, pasi si rrjedhojë e mbipopullimit, jo vetëm që ka më pak hapësira jetike për çdo të burgosur, por ofrohen edhe më pak shërbime, të cilat në kushtet e një numri të paracaktuar stafi, janë edhe më pak cilësore. Për rrjedhojë, në I EVP Rrogozhinë ishin krijuar premisa për incidente të rënda dhe kishte pakënaqësi lidhur me programet e edukimit, rekreacionit dhe rehabilitimit, të cilat edhe nga monitorimi rezultuan të ishin të vakëta e të pamjaftueshme.

Dhomat e tjera në Sektorin e Paraburgimit kishin dritare të mëdha duke mundësuar ndriçim natyral dhe ajrosje të përshtatshme. Dhomat ishin të përmasave të ndryshme, megjithëse me mbipopullimin e personave për dhomë, kjo hapësirë ngelej e kufizuar dhe jashtë standardeve të respektimit të sipërfaqes dhe kubaturës për person. Në shumicën e dhomave 2, 3 apo më shumë persona flinin me dyshek në tokë. Nuk kishte tualet në dhoma. Ato ishin të përbashkëta dhe në kushte aspak të mira higjieno-sanitare. Në çdo godinë, kishte 2 dhoma me një korridor të vogël, i cili mundësonte kryerjen e gatimit për të paraburgosurit dhe një oborr për ajrim.

**Sektori i të dënuarve** përbëhej nga 4 ndërtesa një katëshe ku akomodoheshin 153 të dënuar. Çdo ndërtesë kishte 6 dhoma të ndara dy e nga dy në formë apartamenti. Banjat ishin të përbashkëta për çdo apartament me 2 dhoma dhe në pjesën e jashtme të dhomave gjendej një

---

<sup>16</sup> Shiko nenin 22 pika 1 e Vendimit Nr. 303, datë 25.03.2009 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.

korridor, i cili shërbente për shërbime dhe gatimin e ushqimit. Situata në këtë seksion shfaqej disi më e mirë se në sektorin e paraburgimit, për vetë faktin se numri i të dënuarve ishte më i vogël në raport me të paraburgosurit.

Gjatë vizitës monitoruese, si në sektorin e të paraburgosurve ashtu edhe në atë të të dënuarve, u vu re se kishte diferenca në kushtet materiale nëpër dhoma. Kishte dhoma të veçanta ku kishte ngrohje (madje dy ngrohëse), por dhe të tjera ku nuk kishte asnjë të tillë, kjo edhe për shkak të vonesës së procedurave për të futur një ngrohëse në institucion ose të pamundësisë financiare për t'u siguruar nga vetë të dënuarit. Në disa dhoma u vu re se kishte xhama të thyer, gjë që e lejonte të ftohtin të hynte në dhomë.

Për sa i përket pajisjeve elektro-shtëpiake, kishte dhoma ku ato nuk mungonin, por dhe të tjera që nuk kishin për arsye të pamundësisë financiare nga ana e të dënuarve/ paraburgosurve për t'i siguruar ato.

Gjatë monitorimit në godina u konstatuan probleme me instalimet dhe rrjetin elektrik, për arsye të mungesës së sigurimit teknik. Të shumta ishin rastet kur kutitë shpërndarëse elektrike, instalimet provizore dhe lidhjet elektrike të ekspozuara të bojlerëve të dusheve të bënin masë e të merrnin flakë, duke rrezikuar seriozisht jetën e të dënuarve / paraburgosurve. Ky problem u konstatua edhe gjatë inspektimit. Megjithëse ishin marrë masa dhe riparimet bëheshin herë pas here, rrjeti elektrik ishte tejte i amortizuar dhe i mbingarkuar nga lidhjet provizore amatore dhe nuk e përballonte ngarkesën elektrike në godina.

Shqetësuese për të dënuarit/ paraburgosurit ishte edhe cilësia e ujit. Sipas informacionit të marrë dhe konstatimeve në vend, rezultonte se IEVP Rrogoshinë furnizohej me ujë nëpërmjet puseve. Uji shpesh dilte me përbërje dheu dhe i ndotur, e për rrjedhojë nuk ishte i pijshëm, të dënuarit/ paraburgosurit ankoreshin se edhe larja në dush apo larja e teshave shpesh ishte e vështirë për shkak të përqindjes së lartë të dheut në ujë.

Higjiena në mjediset e korridoreve, në ambientet e takimit me familjarët, në ambientet e përbashkëta, si dhe në kuzhinën e institucionit ishte relativisht e kënaqshme.

Në të kundërt, tualetet në të gjitha seksionet paraqiteshin me kushte higjienike jashtë çdo standardi. Veçanërisht në dhomat e mbipopulluara të paraburgimit, të cilat kishin vetëm një tualet për 19 ose më shumë persona, higjiena linte shumë për të dëshiruar.

Në të gjitha regjimet tualetet dhe dushet ishin të përbashkëta. Në disa raste të paraburgosurit u ankuan për mungesë të ujit të ngrohtë dhe për mungesë të aksesorëve të dusheve (ku të shpeshta ishin rastet që të paraburgosurit laheshin me kanoçe). Më e rënduar paraqitej situata në dhomën e observimit, me 23 të paraburgosur dhe me një tualet, pa ujë të ngrohtë për arsye të defektit teknik në bojler. Gjithsesi kishte ankesa të tilla dhe në dhoma të tjera të paraburgimit. Institucioni i lejonte të paraburgosurit që të bënë dush sa herë kishin nevojë, megjithatë nuk kishte në çdo kohë ujë të rrjedhshëm dhe as ujë të ngrohtë.

Larjen e çarçafëve, jastëkëve dhe batanijeve të paraburgosurve e të dënuarve në shumicën e rasteve ua mundësonin familjarët.

Një nga problemet emergjente të këtij institucioni ishte prezenca e parazitëve, furrtareve dhe insekteve të tjerë. Pavarësisht se IEVP-ja kishte bërë disa herë dezinfektimin e ambienteve, ky problem nuk ishte zgjidhur dhe kjo gjë u konstatua edhe nga ekspertët gjatë monitorimit.

Nga vizita në kuzhinën e IEVP-së, u vu re se cilësia dhe gramaturat e ushqimit të gatuar ditën e vizitës paraqiteshin të kënaqshme. Menyja e përditshme ishte e afishuar dhe gramaturat ishin në rregull. Kampionët e ushqimit ruheshin në kushte frigoriferike. Gjithsesi pjesa më e madhe e të dënuarve/ paraburgosurve nuk e konsumonin ushqimin e institucionit sepse e gatuanin vetë, ose e merrnin nga familjarët. Nga vëzhgimi i menisë së disa ditëve, u vu re se gatimi ishte i njëjtë për çdo ditë dhe nuk ofronte larmi, gjë që u ngrit si shqetësim edhe nga të dënuarit/ paraburgosurit.

### ***Regjimi dhe aktivitetet***

Në IEVP Rrogozhinë, për seksionin e paraburgimit, ofroheshin shumë pak aktivitete, kjo edhe për shkak të mungesës së hapësirave dhe mbipopullimit. Biblioteka ishte shumë e varfër, në tituj e sasi librash.

Në lidhje me ajrimin, të dënuarit/ paraburgosurit nuk kishin ankesa. Ata ishin të kënaqur me oraret e ajrimit, të cilat ishin konform standardeve dhe rregulloreve të institucionit. Dyert e dhomave mbaheshin hapur për ajrim prej orës 07.00 - 19.00. Ndërkohë, ambientet e ajrosjes lejoheshin të përdreshin nga të paraburgosurit vetëm për aktivitete sportive, por këto të fundit mund të siguroheshin me radhë, vetëm për ata që bënin kërkesë.

Stafi kishte pësuar lëvizje gjë që e kishte vështirësuar mbarëvajtjen e aktiviteteve në institucion. Vetë Drejtori, Shefi i Sigurisë, Shefi i Sektorit të Kujdesit Shëndetësor ishin emëruar rishtas në muajin Dhjetor.

Aktualisht stafi i kujdesit social ishte i paplotësuar, pasi në përbërje të tij kishte vetëm punonjës socialë dhe mungonte prania e psikologut. Në ditën e monitorimit gjendeshin 2 persona të identifikuar me probleme të shëndetit mendor, por për ta nuk kishte programe të individualizuara trajtimi.

Për sa i përket aktiviteteve edukuese e rehabilituese në këtë IEVP, nga ana e ekspertëve të MKPT -së u konstatua se të vetmet aktivitete nga të cilat mund të përfitonin të dënuarit/ paraburgosurit ishin ndjekja e televizorit, lojërat e tavolinës dhe ndeshjet e futbollit kur këto ishin të mundura. Në ambientet e paraburgimit nuk kishte dhomë kulturi. Ambientet e kultit gjendeshin vetëm në seksionin e të dënuarve. Nuk kishte dhomë këshillimi në seksione.

Nga takimi me stafin e sektorit të kujdesit social u vu re një komunikim dhe bashkëpunim i mirë. Ata informuan për aktivitetet dhe programet që zbatoheshin në institucion si dhe mundësitë vlerësimin e dosjeve psiko-sociale të dënuarve/ paraburgosurve. Përgjithësisht punonjësit e stafit të kujdesit social kishin hartuar programe individuale të trajtimit për të paraburgosurit dhe të dënuarit. Aktivitetet e përbashkëta, realizoheshin më shumë me të dënuarit, pasi në paraburgim pamundësia e realizimit të tyre vinte si rezultat i mungesës së ambienteve të përbashkëta për kryerjen e tyre.



Një problematikë e përmendur nga stafi ishte mungesa e hapësirave për të kryer këshillimin individual ose për të kryer diskutimet në grup. Këto kryheshin në pjesën e korridorit në secilën nga ndërtesat, ndërsa kur këshillimet ishin të nevojshme të kryheshin individualisht, përdreshin mjediset e bibliotekës. Mungesa e privatësisë, si një kusht themelor për një këshillim të frytshëm, cenonte dhe minimizonte punën e këtyre punonjësve.

Nga vëzhgimi i dosjeve psiko-sociale, u vu re se ato ishin të plotësuara mirë, me përmbledhjet nga takimet e fundit me të paraburgosurit dhe të dënuarit, me programet individuale dhe në grup, me vlerësimet e cilësuara tre mujore dhe dokumente të tjera mbështetëse.

### ***Shërbimet shëndetësore***

Organika e stafit të këtij sektori nuk ishte e plotësuar. Ai përbëhej nga 2 mjekë, por vetëm njëri prej tyre kishte marrë emërimin një javë para vizitës monitoruese të MKPT-së. Në organikë bënin pjesë edhe 1 stomatolog me kohë të pjesshme, 1 farmacistë dhe 5 ndihmësmjekë.

Nga intervistat me të dënuarit/ paraburgosurit përgjatë vizitës monitoruese në këtë IEVP, u konstatuan ankesa të shumta sa i përket shërbimit shëndetësor. Ato ishin kryesisht të lidhura me mungesën e gjatë të mjekut në institucion, gjë që kishte bërë që dhe kërkesat e tyre për vizita mjekësor të merrnin rrallë përgjigje, me gjithë përpjekjet e ndihmësmjekëve për të mundësuar realizimin e këtyre vizitave ose konsultave jashtë Institucionit.

Gjithashtu, ankesa të shumta ishin të lidhura me mjekimet e personave që vuanin nga sëmundje kronike, të cilat në shumicën e rasteve mbulohehin me ilaçe që sillleshin nga familja. Kjo problematikë vinte kryesisht nga mosfunksionimi i kontratës trepalëshe ndërmjet DRSKSH-së, IEVP-së dhe depos farmaceutike Omega Farma. Gjithashtu, ankesa kishte edhe në drejtim të shërbimit stomatologjik i cili rezultonte të ishte i mangët.

Gjatë intervistave, në sektorin e paraburgimit, grupi inspektues konstatoi një të paraburgosur i cili kishte të amputuar krahun e djathtë dhe dorën e majtë e kishte pjesërisht funksionale, pas një aksidenti të ndodhur vite më parë kur ishte i lirë. Për këtë gjendje fizike ai trajtohej me pension invaliditeti të grupit të parë. Në kushte të tilla fizike ky shtetas duhej të kishte asistencë nga një person tjetër 24 orë në 24 për kryerjen e nevojave vetjake. Megjithëse gjatë kohës që ndodhej në IEVP Rrogozhinë, ai është asistuar nga shokët e tij të dhomës, kjo ndihmë kishte rezultuar e pamjaftueshme, duke e rënduar së tepërmi gjendjen e tij.

Në këtë Institucion nuk kishte një statistikë mujore të personave që trajtoheshin për probleme të shëndetit mendor apo për sëmundje kronike, kardiake, neurologjike, nefrologjike, gastro-intestinale etj. Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës disa mujore të mjekut në Institucion. Por, gjatë vizitës monitoruese u konstatua se mjeku i sapo emëruar kishte kërkuar konsulta psikiatrike për 4 persona, të cilët sipas tij, kishin manifestuar simptoma të formës së çrregullimeve mendore.

Dhoma e vizitave mjekësore ishte e pajisur me orenditë e domosdoshme, por kushtet fizike të saj reflektonin amortizimin e theksuar të gjithë godinave të këtij Institucioni. Kutia e ndihmës së shpejtë ishte zbrazët.

Dhoma e stomatologut ishte gjithashtu e amortizuar, e pajisur me unit dhe autoklavë, ndërsa instrumentet dhe materialet dentare dentisti i Institucionit përpiqej t'i siguronte në rrugë private. Rrjedhimisht ndërhyrjet konsistonin kryesisht në mjekime të urgjencës dhe ekstraksione. Rrallë kryheshin mbushje apo terapi dentare specifike.

Farmacia ishte e rregullt, por sa i përket furnizimit me medikamente, një sasi e vogël e tyre siguroheshin nga DPB, ndërsa pjesa tjetër duhej të sigurohej nëpërmjet marrëveshjes trepalëshe ndërmjet DRSKSH-së, I.E.V.P-ve dhe depos farmaceutike Omega Farma si dhe mirë funksionimit të skemës së rimbursimit të ilaçeve. Si pasojë e mungesës së mjekut, Institucioni kishte tre muaj që nuk furnizohej me ilaçe për të sëmurët kronikë. Vetëm muajin dhjetor ka pasur një kontingjent medikamentesh të cilat ishin siguruar si ndihma nga DPB. Institucioni kishte një autoambulancë funksionale.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti dokumentacioni i mjekut, u konstatua ekzistenca e regjistrit të vizitave mjekësore, regjistrit për të sëmurët kronikë, regjistrin të shpërndarjes së medikamenteve, regjistrin të ilaçeve që siguroheshin nga familja si dhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve. Këta regjistra ishin të sekretuar e të mbajtur në rregull. Përfundimisht bënte regjistri për konsultat jashtë Institucionit, i cili ishte i pa sekretuar. Kartelat mjekësore ishin gjithashtu të mbajtura me rregull dhe të mbyllura në dollap me dry.

Në këtë Institucion mungonin formatet e kontrollit mjekësor.

Një problematikë e gjetur në këtë institucion ishte edhe pajisja e të dënuarve/ paraburgosurve me libreza shëndetësore. Vetëm 13 prej tyre ishin të kompletuar me këto libreza. Skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte. Shkak i kësaj ishte edhe mosfunksionimi i kontratës trepalëshe ndërmjet DRSKSH-së, I.E.V.P-ve dhe depos farmaceutike Omega Farma gjë që sillte edhe vështirësi në sigurimin e medikamenteve nëpërmjet kësaj skeme.

Parandalimi i vetëvrasjes është një tjetër çështje që hyn brenda kompetencës dhe fushës së shërbimit të kujdesit shëndetësor dhe atij social në burgje. Dy shërbimet duhet të sigurojnë ndërgjegjësim të plotë për këtë çështje në gjithë instancat e institucionit dhe të ushtrojnë ekspertizën e duhur për të përcaktuar qartë procedurat e përshtatshme parandaluese. Në këtë kontekst kontrolli mjekësor që në momentin e parë të pranimin të paraburgosurve në institucion gjithashtu dhe në procesin e pranimin në tërësi, ka një rol të rëndësishëm, pasi i kryer siç duhet, ai mund të identifikojë të paktën disa prej personave të rrezikuar dhe të lehtësojë disi ankthin që përjetojnë të gjithë të paraburgosurit e porsa ardhur në institucion. Personeli i burgut, cilado qoftë detyra e tyre e veçantë, duhet të ndërgjegjësohet dhe duhet trajnuar për të njohur simptomat e rrezikut të vetëvrasjes, veçanërisht gjatë periudhave menjëherë para dhe pas gjyqimit. Gjithashtu personeli duhet të trajnohet edhe mbi çrregullimet e shëndetit mendor që përmbajnë rrezik të shtuar për vetëvrasje.

Në rastin e ngjarjes së rëndë të ndodhur në IEVP Rrogozhinë më datë 28.12.2014 me pasojë vdekjen e të paraburgosurit Q. Z., u konstatua se ishin identifikuar shenja të gjendjes së rënduar psiko-emocionale të paraburgosurit që më datë 11.12.2014 nga ana e sektorit psiko-social. Gjithashtu ishin mbajtur shënime dhe identifikuar në dosjen e tij se personi ishte trajtuar me medikamente lidhur me probleme psiko-emocionale dhe në jetën e lirë. Po në këtë dosje më datë

22.12.2014 ishte shënuar se me personin në fjalë ishin mbajtur kontakte të vazhdueshme nga ky sektor për arsye se gjendja e tij emocionale vazhdonte të ishte e paqëndrueshme. Gjithashtu në dosje ishte shënuar se personi merrte rregullisht terapinë medikamentoze për shkak të ngarkesës emocionale të vazhdueshme që ai manifestonte.

Nga konstatimet e mëtejshme rezultoi se sektori i kujdesit shëndetësor e kishte trajtuar të paraburgosurin me medikamente (Diazepam) për probleme serioze psikologjike të paraqitura nga ana e tij, por në kartelën e tij klinike nuk rezultonin shënime të diagnostikimit, vizitave mjekësore apo të një plani trajtimi dhe observimi mjekësor që rekomandohet për raste të tilla. Gjithashtu nuk rezultonte një komunikim dhe bashkëveprim me efekt parandalues ndërmjet sektorëve psiko-social atij shëndetësore dhe të sigurisë lidhur me një rast tipik me risk të lartë të identifikuar nga njëri sektor.

Një person i identifikuar si rrezik vetëvrasje duhet, për sa kohë është e nevojshme, të mbahet nën një skemë të veçantë vëzhgimi në ambiente observimi mjekësor. Më tej, një person i tillë nuk duhet të ketë akses të lehtë të mjeteve me të cilat mund të shkaktojnë vetëvrasjeje (hekurat e dritares së qelisë, xham i thyer, lidhëse, rripa mesi etj.)<sup>17</sup>

Duhet të merren masa gjithashtu për të siguruar rrjedhën e duhur të informacionit brenda në institucion, veçanërisht ndërmjet shërbimeve të kujdesit shëndetësor atij psiko-social dhe atij të sigurisë për personat që janë identifikuar si potencialisht në rrezik për kryerjen e vetëvrasjes.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për të kufizuar mbipopullimin në I EVP Rrogozhinë me objektivin që çdo qeli të ofrojë minimalisht 4m<sup>2</sup> hapësirë jetike për person.
2. Marrja e masave të menjëhershme për zgjidhjen e situatës së mbipopullimit, në respekt të Nenit 24 të ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”, i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.
3. Marrja e masave të menjëhershme nga ana e Drejtuesit të Institucionit lidhur me analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisve për mos koordinimin nga ana e sektorëve të sigurisë dhe atij shëndetësor dhe psiko-social në parandalimin e rastit të vetëvrasjes ndodhur më datë 28.12.2014.
4. Marrja e masave të menjëhershme për ndërprerjen e përdorimit të ambienteve të izolim/ veçimit për të dënuarit/ paraburgosurit përtej kohës së parashikuar nga ana e komisionit të disiplinës, dhe për ndërprerjen e vendosjes për një kohë të gjatë në këto ambiente të personave që nuk janë subjekt i masave disiplinore.
5. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të jetesës të dhomave të të paraburgosurve, riparimin e tualeteve dhe përmirësimin e higjienës në dhoma.
6. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e dhomave të veçimit me tavolina, e dollapë rrobash në mënyrë që të mundësohet ushqimi dhe kushtet bazë të jetesës në mënyrë dinjitoze dhe njerëzore.

---

<sup>17</sup> Raporti i III i Përgjithshëm i Komitetit për Parandalimin e Torturës (1992 [par.59])

7. Marrja e masave të menjëhershme për riparimin e bojlerëve për sigurimin e ujit të ngrohtë për larje në sektorin e veçimit atë të observimit dhe në ambiente të tjera ku ato ishin me defekt.
8. Marrja e masave për riparimin e instalimeve elektrike dhe disiplinimin e lidhjeve elektrike provizore të ekspozuara sipas normave të sigurimit teknik.
9. Marrja e masave të menjëhershme për dezinfektimin efikas të ambienteve të banimit të dënuarve/ paraburgosurve.
10. Marrja e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së sektorit shëndetësor me një mjek.
11. Marrja e masave nga ana e personelit mjekësor të këtij institucioni për kryerjen e kontakteve të shpeshta me të dënuarit/ paraburgosurit dhe përgjigjen në kohë të kërkesave të tyre për vizita mjekësore, si për evidentimin e rasteve të reja ashtu dhe për ndjekjen e të sëmurëve kronikë.
12. Marrja e masave të menjëhershme për ta dërguar në Institucionin e Veçantë të Burgjeve shtetasin i cili është invalid i grupit të parë, ku ai mund të ketë një trajtim më të specializuar, dhe ku ai mund të vazhdojë kryerjen e dënimit.
13. Marrja e masave për furnizimin e kabinetit të stomatologut me instrumente dhe materiale dentare, me qëllim ofrimin e një shërbimi stomatologjik adekuat dhe në kohë me ndërhyrjet përkatëse.
14. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e të gjithë të dënuarve/ paraburgosurve të këtij institucioni me libreta shëndetësore.
15. Marrja e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të marrëveshjes trepalëshe ndërmjet DRSKSH-së, IEVP-së dhe depos farmaceutike Omega Farma, në mënyrë që të vihet në funksion të skema e rimbursimit të ilaçeve, si për sëmundjet kronike ashtu dhe për ato të urgjencës, duke siguruar kështu një furnizim të rregullt të këtij Institucioni me medikamente.
16. Marrja e masave të menjëhershme për furnizimin e Institucionit me medikamente kryesisht të urgjencës.
17. Marrja e masave të nevojshme nga ana e personelit përgjegjës për të mundësuar këshillime individuale e në grup në dhoma të planifikuara për këshillim si dhe shtimin e aktiviteteve social-kulturore-sportive me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi dhe ri-integrimi.
18. Marrja e masave për krijimin e një mjedisi të veçantë të pajisur me sendet e nevojshme dhe klimë të ngrohtë dhe miqësore për takimet e të dënuarve/ paraburgosurve me fëmijët e mitur dhe të moshuarit.
19. Marrja e masave për unifikimin e praktikës së dhënieve së lejeve shpërblyese dhe ato të veçanta sipas ligjit Nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar, dhe Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
20. Marrja e masave për pezullimin e praktikës së dhënieve të lejeve shpërblyese në varësi të miratimit paraprak nga ana e komisariateve të policisë së cilës i përket i dënuari që përmbush kriteret për përfitimin e lejes, si një praktikë e paparashikuar në kriteret e Ligjit 8328, datë 16.04.1998 "Për trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar.

**5.26. Rekomandim mbi situatën e mbipopullimit në I EVP - Datë 06.01.2014 /  
Nr. Dok. 201402452**

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet ligjore për të kryer inspektime në të gjitha institucionet e privimit të ligjshëm të lirisë, e në zbatim të planit për vitin 2014, ka kryer inspektime në të gjitha I EVP-të në rang vendi.

Nga inspektimet e bëra, numri i personave të paraburgosur/ të dënuar për I EVP-të përkatëse, si edhe kapacitetet e tyre zyrtare<sup>18</sup>, rezultojnë të jenë:

Nr.	I EVP	Kapaciteti zyrtar (persona)	Numri i të dënuarve/ paraburgosurve në momentin e inspektimit
1.	I EVP Zahari, Krujë	196	189
2.	Instituti i të Miturve Kavajë	40	26
3.	I EVP Ali Demi (325)	80	91
4.	I EVP Vaqarr	146	164
5.	I EVP Kosovë, Lushnjë	189	221
6.	I EVP Peqin	685	750
7.	I EVP Shën Koll, Lezhë	703	753
8.	I EVP Kukës	36	27
9.	I EVP Tropojë	25	4
10.	I EVP Elbasan	120	212
11.	I EVP Jordan Misja (313)	320	543
12.	I EVP Durrës	300	384
13.	I EVP Fushë-Krujë	312	419
14.	I EVP Burrel	198	211
15.	I EVP Berat	37	75
16.	I EVP Mine Peza (302)	170	237
17.	I EVP Drenovë	312	452
18.	I EVP Tepelenë	70	160
19.	I EVP Sarandë	31	58
20.	I EVP Vlorë	125	197
21.	IVSHB Tiranë	99	95
22.	I EVP Rrogozhinë	343	462

Sikurse pasqyrohet në tabelë, me përjashtim të I EVP-ve Zahari- Krujë, Instituti i të Miturve Kavajë, Kukës dhe Tropojë, I EVP-të në momentin e inspektimit rezultojnë të mbipopulluara, ndërsa institucionet e paraburgimit me mbipopullim të shkajshëm, qartazi mbi kapacitetin zyrtar.

Për secilën prej I EVP-ve, pas inspektimit MKPT ka hartuar rekomandime të veçanta ku ka përfshirë dhe çështjen e mbipopullimit. Në vijim paraqiten të dhëna për disa prej I EVP-ve që rezultojnë ndër më problematike në respektimin e standardeve minimale të kubaturës:

- **Paraburgimi “Jordan Misja”** gjatë inspektimit kishte një popullim prej 543 të paraburgosurish, nga 320 parashikuar në kapacitetin zyrtar. Si rrjedhojë e këtij

<sup>18</sup> Sipas shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Nr. 9812/ 1 Prot., datë 14.10.2014.

mbipopullimi, hapësira jetike e shumicës së të parburgosurve ishte më pak se 3m<sup>2</sup> për person. Në disa dhoma me përmasa 8.8m<sup>2</sup> ku ishin akomoduar 4 persona, hapësira jetike për person shkonte edhe në nivelet e 2.2m<sup>2</sup>. Në këtë IEVP fjetja me dyshek në tokë ishte e pranishme pothuajse në çdo dhomë.

- **IEVP Fushë-Krujë** kishte një mbipopullim prej 107 personash. Ky mbipopullim paraqitej në proporcion të zhdrejtë për sa i përket sektorëve: në sektorët e të dënuarve të sigurisë së lartë dhe të zakonshme hapësira jetike për person respektohej, ndërsa në sektorin e parburgimit në dhomat e destinuar për 6 persona u gjetën 8-9 persona, nga të cilët 2-3 veta flinin me dyshek në tokë.
- **IEVP Rrogozhinë** u vizitua nga ana e MKPT-së me dt. 04.02.2014, me qëllim evidentimin e shkaqeve lidhur me ngjarjen e rënies së zjarrit dhe rrezikimin e jetës së parburgosurve në sektorin e parburgimit në këtë institucion. Kapaciteti maksimal i kësaj IEVP-je për të parburgosurit është 115 persona. Në momentin e rënies së zjarrit me dt. 31.01.2014 rreth orës 20.00 në parburgim ishin të akomoduar 217 të parburgosur. Grupi monitorues konstatoi se dhoma ku kishte rënë zjarri (dhoma 1 godina 3) ishte e përmasave 6x7x2.50m dhe banohej prej muajsh nga 21 të parburgosur. Në këtë dhomë 14 veta flinin në 7 shtretër me dy kate, 5 të tjerë flinin me dyshek në tokë dhe dy të parburgosur të tjerë flinin me turne apo dy veta në një krevat. Ky mbipopullim i skajshëm, paralelisht me kufizimin e sipërfaqes së banimit dhe të kubaturës për person të parashikuar sipas standardit ligjore si dhe degradimit të shërbimeve e kushteve materiale të ambienteve, ishin shkaku kryesor i premisave të ndodhjes së aksidentit të rënies së zjarrit në ambientet e parburgimit në IEVP Rrogozhinë.
- **Parburgimi i Elbasanit** hyri në shërbim në vitin 2012. Kapaciteti zyrtar fillimisht ishte për 120 të parburgosur. Aktualisht janë shtuar shtretër në dhoma për të akomoduar 143 të parburgosur dhe në datën e inspektimit ndodheshin 212 të parburgosur nga të cilët 69 të parburgosur flinin me dyshekë në tokë. Shumica e dhomave të banimit në këtë institucion me përmasa 3x4 m të destinuar për akomodim të dy personave me dy krevate, në momentin e inspektimit banoheshin nga 4 persona prej nga gjysma flinin me dyshekë në tokë.
- **Parburgimi Berat** me një kapacitet zyrtar prej 37 personash në momentin e inspektimit akomodonte 75 veta, ndërsa disa ditë përpara transferimit të tyre kishte arritur deri në 90 persona. Në këtë institucion situata e mbipopullimit ishte kritike për arsye të mungesës totale të aktiviteteve psiko-sociale, ambienteve adekuate të ajrimit dhe kufizimit në nivele degraduese të hapësirës jetike për person në dhomat e banimit.
- **IEVP Drenovë** gjatë inspektimit operonte me 140 persona mbi kapacitetin zyrtar prej 312 personash. Dhomat e observimit dhe ambientet e përbashkëta të aktiviteteve ishin kthyer në dhoma banimi për të parburgosurit të cilët kishin muaj që flinin me dyshekë në tokë në dhoma pa asnjë orëndi: tavolina, karrige apo rafte për të vendosur rrobat personale etj. Në një dhomë aktiviteteve në këtë sektor me përmasa 5x5 m qëndronin prej 10 muajsh 9 persona të gjithë flinin me dyshekë në tokë. Ndërsa në 8 dhomat e observimit me përmasa 2.50x3.50m të destinuar për akomodimin e 2 personave, ishin vendosur 4-6 veta, ndër të cilët shumica pa krevat. Të parburgosurit e këtij sektori, për shkak të mbipopullimit, ishin të privuar nga të gjitha aktivitetet e përbashkëta, përfshirë dhe ajrimin në ambiente ajrimi të hapura sipas parashikimeve ligjore.
- **IEVP Peqin** gjithashtu kishte një mbipopullim prej rreth 100 personash gjatë gjithë vitit 2014, me mbipopullim të theksuar në sektorët e parburgimit. Me transferimin në muajin

Shkurt të 78 të paraburgosurve nga Paraburgimi Rrogozhinë, në IEVP Peqin numri i personave të privuar nga liria kapi shifrën 861.

- **Paraburgimi Durrës** gjatë inspektimit kishte një mbipopullim prej 84 vetash. Dhomat e banimit akomodonin nga 4, 6 ose 7 persona, dhe shumica e dhomave nuk respektonin standardin e hapësirës jetike për person. Nëpër dhoma, kryesisht në katin e parë, kishte rreth 6 persona në dhomë, 3 prej të cilëve flinin në krevate dhe 3 të tjerë në dysheme si rrjedhojë e mbipopullimit. Ky i fundit shprehej qartë në katin e parë të regjimit, ku pothuajse të gjitha dhomat e aktiviteteve të përbashkëta, si dhoma e rriteve të krishtera, dhoma e këshillimit, etj., ishin kthyer në mjedise banimi. Rrjedhimisht, ato nuk kishin tualet të brendshëm, dhe të paraburgosurit përdornin tualetet e përbashkëta, përfshirë këtu edhe dy tualetet e improvizuara të dhomave të observim/ veçimit. Tualetet e përbashkëta ishin jashtë çdo standardi, në kushte shumë të këqija higjieno-sanitare. Për të gjithë katin e parë kishte vetëm dy tualete të cilat nuk kishin as dush, as lavaman, as ujë të rrjedhshëm, por vetëm dy ËC në kushte të mjerueshme dhe pa aksesor përshtatës për shkarkimin e ujit.

Për të studiuar edhe më mirë fluksin ditor në IEVP, krahas inspektimeve, MKPT i drejtoi një kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, më datë 9.10.2014, mbi ngarkesën ditore për çdo IEVP, për një periudhë kohë dy javore, nga data 24 shtator deri më datën 8 tetor. Statistikat e marra në përgjigje të kërkesës, të rirenditura sipas ditëve kur është kryer inspektimi në IEVP-të përkatëse, paraqiten në vijim:

Nr.	IEVP	Kapaciteti zyrtar (persona)	Datat sipas muajve														
			Shtator							Tetor							
			24	25	26	27	28	29	30	1	2	3	4	5	6	7	8
1	IEVP Zahari, Krujë	196	204	202	203	205	205	207	206	204	203	201	205	205	203	197	199
2	Instituti i të miturve Kavajë	40	55	62	60	59	59	61	60	58	57	59	56	56	53	52	51
3	IEVP Ali Demi (325)	80	104	104	103	104	105	104	104	108	108	108	110	110	110	112	112
4	IEVP Vaqarr	146	163	160	156	158	157	160	161	162	160	160	161	163	162	163	164
5	IEVP Kosovë, Lushnjë	189	232	232	227	232	233	226	225	228	233	233	236	236	235	235	232
6	IEVP Peqin	685	768	772	773	774	777	767	768	773	769	769	784	781	772	775	771
7	IEVP Shën Koll, Lezhë	703	712	702	698	704	703	707	707	749	749	750	746	748	751	744	744
8	IEVP Kukës	36	40	41	42	42	42	41	42	42	42	38	38	38	39	40	40
9	IEVP Tropojë	25	5	5	6	6	6	6	6	6	8	9	9	9	9	9	9

10	IEVP Elbasan	120	218	210	208	213	215	216	213	213	214	215	220	222	222	217	216
11	IEVP Jordan Misja (313)	320	540	539	527	522	524	538	542	493	503	495	494	498	511	521	517
12	IEVP Durrës	300	359	362	366	364	364	363	371	375	370	372	375	377	376	373	374
13	IEVP Fushë-Krujë	312	425	424	422	426	426	421	419	422	422	423	422	422	419	422	426
14	IEVP Burrel	198	219	215	215	213	213	212	213	213	211	211	212	212	209	209	208
15	IEVP Berat	37	76	76	76	76	77	78	78	75	78	78	81	82	79	80	80
16	IEVP Mine Peza (302)	170	238	234	230	231	229	234	234	233	236	235	231	231	231	229	233
17	IEVP Drenovë	312	429	432	432	435	444	444	438	437	437	436	436	441	434	431	433
18	IEVP Tepelenë	70	158	159	159	159	153	153	151	150	152	156	156	156	153	155	155
19	IEVP Sarandë	31	60	60	60	60	60	59	58	58	60	60	60	60	62	62	62
20	IEVP Vlorë	125	189	189	193	191	192	192	186	186	186	186	186	187	189	186	187
21	IVSHB Tiranë	99	91	95	95	90	90	91	94	99	97	91	87	87	92	92	96
22	IEVP Rrogozhinë	343	444	437	440	445	445	447	444	445	445	445	444	446	455	454	448

Sikurse pasqyrohet më lartë, me përjashtim të IEVP Tropojë dhe Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve, të njëzetë IEVP-të e tjera kanë pasur mbipopullim në pjesën më të madhe të periudhës së marrë në shqyrtim. Marrë në total, nga 4537 kapacitet maksimal, në pikun e periudhës së muajit Tetor me 5767 të paraburgosur/ të dënuar, 1230 persona kanë qenë mbi kapacitet. Ndërkohë, gjatë muajve Nëntor dhe Dhjetor tendenca ka qenë në rritje, duke kaluar shifrën e 6000 personave.

### **Problematikat e mbipopullimit**

Situata e mbipopullimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale përbën një sfidë të madhe për administrimin e burgjeve dhe për sistemin gjyqësor në përgjithësi sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut dhe menaxhimit efikas të IEVP-ve.

Të dhënat lidhur me mbipopullimin e ambienteve të Burgjeve dhe Paraburgimeve në Shqipëri gjatë vitit 2014, përveç problemeve të degradimit strukturor të ndërtesave dhe përkeqësimit të shërbimeve ndaj personave të privuar nga liria, ngrenë edhe shqetësimin e institucioneve



kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në një vend demokratik.<sup>19</sup>

Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitës në Shqipëri në vitin 1997 ka rekomanduar: Të dënuarit/ paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m<sup>2</sup> në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu dhe dhomat me të vogla se 6m<sup>2</sup> nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi.<sup>20</sup>

Situata e mbipopullimit në burgje sjell shkeljen e një serë të drejtave e të burgosurve/ paraburgosurve, pasi si rrjedhojë e mbipopullimit jo vetëm që ka më pak hapësira për çdo të burgosur, por ofrohen edhe më pak shërbime, të cilat në kushtet e një numri të paracaktuar stafi janë edhe më pak cilësore. Kësisoj, lëvizja në dhomë dhe ambiente të përbashkëta është e kufizuar, ka pakënaqësi lidhur me programet e edukimit e rehabilitimit, e madje edhe për ushqimin. Për vetë të dënuarit dhe të paraburgosurit, mbipopullimi do të thotë më pak pjesëmarrje në aktivitete dhe perceptim ndarje në mënyrë të padrejtë.

Një burg i mbipopulluar shkakton edhe fillimin dhe/ apo përkeqësimin e problemeve psikologjike të dënuarve. Kur në një IEVP ka më shumë të burgosur se kapaciteti, efekti zinxhir i pasojave negative çon në rëndimin e klimës në institucion dhe kryerjen e sjelljeve të dhunshme si nga ana e të dënuarve/ të paraburgosurve ashtu edhe nga ana e stafit të sigurisë. Pas daljes nga burgu, të dënuarit që kanë vuajtur dënimin të burgjeve të mbi populluara dhe me mungesë personeli, kanë më shumë vështirësi të përshtaten me jetën normale. Në kushtet kur nuk përfitojnë nga marrja e plotë programit të rehabilitimit apo dhe nga terapia mjekësore gjatë qëndrimit në burg, ata nuk janë të përgatitur për t'u rikthyer në komunitet dhe shpesh bien në recidivizëm. Të burgosurit e liruar nga IEVP të mbipopulluara kanë tendencë të jenë të përkeqësuar çka reflektohet në sjellje të dhunshme, përdorim droge, probleme për të rivendosur marrëdhënie dhe recidivizëm.

Jo vetëm të paraburgosurve dhe të dënuarve, por dhe punonjësve të IEVP-ve u krijohen probleme nga mbipopullimi i burgjeve. Punonjësit kanë kohë më të kufizuar për t'u marrë me sjelljen e pahijshme dhe shkeljet e rregullores, më pak burime për t'u marrë me krimin dhe dhunën brenda në burg, dhe më pak shanse për të vëzhguar dhe identifikuar të dënuarit e

---

<sup>19</sup> Një çështje e tillë është gjykuar nga Gjykata e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës në rastin Sulejmanovic kundër Italisë. Gjykatësit e Strasburgut në vendimin e tyre kanë cilësuar se kufizimi i hapësirës jetike ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve përtej standardeve ligjore të shteteve pale dhe ato të Konventave Ndërkombëtare përbëjnë shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Rasti i referohet një shtetasi të Bosnje-Hercegovinës i cili vuante dënimin në Burgun e Rebibbias ne Itali i cili pretendonte se kishte qene subjekt i trajtimit jo human dhe degradues pasi kishte qëndruar për disa muaj së bashku me 5 bashkëvuajtës në një dhomë 16.20 m<sup>2</sup>. Gjykata e të Drejtave të Njeriut ka përdorur si parametra vlerësues rekomandimet dhe standardet e Komitetit për Parandalimin e Torturës (CPT). Në rastin e mësipërm, Gjykata e Strasburgut ka vlerësuar se situata e mbipopullimit në burgun e Rebibbias Itali ka qene evidente, dhe se vendosja e një personi në kushtet e një hapësire jetike prej 2.7 m<sup>2</sup>, larg standardeve minimale të CPT-së, përbën trajtim degradues dhe jo human dhe shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në përfundim të gjykimit nga ana e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut shteti Italian detyrohet të paguajë një shumë monetare ndaj të burgosurit Sulejmanovic për dëme morale dhe trajtim jo njerëzor dhe degradues.

<sup>20</sup> Albania: Visit 1997 [par.127]

rrezikshëm. Punonjësit gjithashtu kanë më pak kohë të qëndrojnë me të dënuarit/ paraburgosurit dhe kanë vështirësi të sigurojnë pjesëmarrjen e të dënuarve/ paraburgosurve në programe edukimi dhe rehabilitimi. Punonjësit e burgjeve të mbipopulluar janë më të ekspozuar të bëhen traget keqtrajtimit nga të dënuarit.

### **Qasjet për një menaxhim efikas të problemit të mbipopullimit**

Privimi i lirisë nëpërmjet dhënies së masës së sigurimit arrest në burg, duhet konsideruar jo si opsioni kryesor, por si masa më e rëndë që jepet vetëm në rastet e parashikuara në nenet 228 dhe 229 të K.Pr. Penale, duke mbajtur parasysh arsyetimin e Gjykatës së Lartë (vendimet 8, datë 19.1.2001 dhe 46, datë 28.1.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë) ku përcaktohet se: "...për caktimin si masë sigurimi arrest në burg për të pandehurin duhet të ekzistojë një dyshim i bazuar se i pandehuri mund t'i shmanget gjyqimit apo ekzekutimit të vendimit, apo se ai ka rrezik të kryejë ndonjë vepër penale tjetër të rëndë apo të të njëjtit lloj me atë për të cilën është proceduar..."si dhe "...Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret...".

Vlerësojmë gjithashtu se duhet inkurajuar mundësia për marrjen në konsideratë të dënimeve apo masave të sigurisë të tilla si: gjysmë-liria, dënim në institucionet me regjim të hapur, etj. Lirimi me kusht duhet konsideruar si një nga mënyrat me efikase dhe më konstruktive që jo vetëm reduktojnë kohë zgjatjen e dënimit, por kontribuojnë ndjeshëm në rikthimin në komunitet të të dënuarve.

Duhet bërë përpjekje për reduktimin e dhënies së dënimeve me qëndrim të gjatë në burg që përbën një barrë të rëndë për sistemin. Dënimet me punë shoqërore në komunitet duhet të zëvendësojnë vendimet me burgim me afat të shkurtër dhe gjykatësit dhe prokurorët duhen nxitur t'i përdorin ato sa më gjerësisht. Në mënyrë që dënimet me shërbime komunitare të jenë alternativa të besueshme të burgimit afatshkurtër, duhet siguruar zbatimi me efikasitet i këtyre masave përmes sigurimit të infrastrukturës për ekzekutimin dhe monitorimin e tyre.

Duhet marrë në konsideratë dekriminalizimi ose riklasifikimi i disa lloje shkeljesh/ krimesh në mënyrë që për to të mos jepen dënime që konsistojnë në privimin nga liria.

Duhet vënë theksi tek parimet e dinjitetit njerëzor, tek angazhimi i administratës së burgjeve që të sigurojnë trajtim njerëzor, tek ndërgjegjësimi për rolin e stafit dhe metodat moderne e efikase të menaxhimit.

Duhet vënë në dispozicion burime financiare dhe njerëzore si dhe duhen zhvilluar mjetet e duhura procedurale dhe teknika menaxheriale, për një përdorim efikas dhe human të paraburgimit dhe të dënimit me burg.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për respektimin në frymë dhe letër të Kodit të Procedurës Penale, kryesisht Neni 251 dhe neni 255 lidhur me procedurat dhe detyrimet e OPGJ-ve gjatë ndalimit/ arrestimit të personave.
2. Marrja e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, respektimit të Kodit të Procedurës Penale, Nenin 259 të KPP, par. 3, 4, lidhur me afatet sa i takon ndalimit/ arrestimit të personave.
3. Marrja e masave për alokimin e fondeve lidhur me rikonstrukcionin në përputhje me standardet dhe vënien në funksionim të dhomave të mbyllura të sigurisë.
4. Marrja e masave të menjëhershme për adresimin e çështjes së dhomave të sigurisë brenda IEVP-ve, si një praktikë jo e mirë, që rëndon situatën e vetë IEVP-ve, por edhe të personave të ndaluar/ arrestuar.

## **6. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014 në Drejtoritë e Policisë së Qarkut dhe në Komisaritet e varësisë**

### **6.1. DPQ Durrës dhe komisaritate të varësisë:**

Komisariati i Policisë Krujë, datë 22.04.2014 / Nr. Dok. 201400840

Komisariati i Policisë Fushë-Krujë, datë 22.04.2014 / Nr. Dok. 201400841

Komisariati i Policisë Shijak, datë 23.04.2014 / Nr. Dok. 201400842

Komisariati i Policisë Durrës (DPQ), datë 23.04.2014 / Nr. Dok. 201400843

### ***Shënime paraprake***

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, grupi i monitorues, në secilin prej subjekteve të lartpërmendura, u takua fillimisht me titullarin e organit, për t'i komunikuar qëllimin e inspektimit. Vlen të theksohet fakti se të gjithë drejtuesit e organeve të inspektuara treguan bashkëpunim gjatë gjithë kohës që grupi ishte në inspektim.

Gjithashtu, pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, mori takim privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi ambientet e shoqërimit e të sigurisë dhe zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse. Më konkretisht, gjendja e përgjithshme si dhe problematikat e konstatuara në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës dhe në organet e policisë në varësi të saj pasqyrohen më poshtë:

### ***Kushtet e ambienteve të shoqërimit***

**Në Komisaritin e Policisë Durrës**, dhomat e shoqërimit dhe ato të sigurisë, janë ndërtuar të reja dhe sipas të gjitha kërkesave të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e të Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.

Brenda mjediseve të këtij Komisarati, kishte 4 dhoma shoqërimi, 3 prej të cilave me përmasa 3x4 m, të pajisura me tavolina dhe me karrige, sipas standardeve. Kishte dritare me pajisura me skarë dhe rrjetë hekuri, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Të tri dhomat kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dyert ishin prej druri, të cilat, kishin mundësi për t'u mbyllur nga jashtë, dhe kishin një hapësirë në pjesën e sipërme të pajisur me rrjetë hekuri. Dhoma e katërt ishte me përmasa më të vogla 1.5 x 3 m, e pajisur vetëm me stol dhe pa tavolinë. Në përgjithësi, të 4 dhomat ishin të pastra dhe ishin të pajisura me kamera monitorimi. Sistemi i monitorimit mbulonte edhe korridorin e këtij ambienti. Në korridor ishin vendosur postera me të drejtat e personave të shoqëruar, ndërsa në dhomat e shoqërimit jo.

Në ditën e inspektimit ishte vetëm një person i shoqëruar për tentativë vetëvrasjeje. Grupi i inspektimit mori kontakt me personin në mënyrë private dhe u informua se atij i ishte marrë celulari, rripi i pantallonave, si edhe lidhëset e këpucëve. Ai pohoi se nuk kishte marrë takim as me psikologun, as me mjekun e institucionit. Grupi i inspektimit kërkoi shpjegime lidhur me rastin në fjalë dhe shkëljen e bërë lidhur me sekuestrimin e sendeve private, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, dhe u informua nga Shefi i Komisarati se personi i shoqëruar është agresiv dhe nuk ishte hera e parë që ai shoqërohej në mjediset e këtij Komisarati. Sendet personale i ishin marrë duke marrë në konsideratë faktin se personi ishte shoqëruar për shkak të tentativës për vetëvrasje dhe ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sipas tij, me të do të kryheshin veprime procedurale si person ndaj të cilit zhvilloheshin hetime.

**Në Komisaratin e Policisë Shijak,** brenda mjediseve të komisarati kishte 3 dhoma shoqërimi të ndara përkatësisht për femra, meshkuj dhe të mitur. Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Dhomat e shoqërimit ishin me përmasa 4x3 m, me dritare me përmasa që siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Të tri dhomat kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Njëra prej dhomave ishte në rikonstruksion dhe në takimin me Shefin e Komisarati dhe Shefin e Rendit, grupi i inspektimit u informua se punimet do të përfundonin brenda 2 javëve të para të muajit maj. Dyert e dhomave të shoqërimit ishin prej druri, të pajisura me 2 shula të mëdhenj që mbylleshin nga jashtë me dry. Në fund të korridorit kishte një tualet funksional. Dhomat ishin të pastra e të pajisura me stol dhe tavolinë. Në dhoma, sikurse edhe në korridor, ishin afishuar postera me të drejtat e personave të shoqëruar.

**Në Komisaratin e Policisë Krujë,** kishte 2 dhoma shoqërimi, të cilat ndodheshin jashtë godinës së komisarati. Të dyja dhomat ishin relativisht të pastra, me dritare që siguronin dritë natyrale të nevojshme, ndërkohë që drita artificiale mungonte sepse ishin djegur llambat ndriçuese dhe nuk ishin zëvendësuar. Brenda dhomave kishte stol dhe tavolinë, ndërkohë që dyert ishin prej druri dhe mbylleshin me dry nga jashtë. Në ambientet e dhomave të shoqërimit nuk kishte tualet dhe nuk kishte të afishuar postera me të drejtat e të shoqëruarve. Në ambientet e shoqërimit nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera. Në hyrje të komisarati ishin të vendosura postera të pa përditësuar me ndryshimet e bazës ligjore mbi rastet e shoqërimit të shtetasve. Në kohën e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

**Në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë,** kishte 2 dhoma shoqërimi, brenda mjediseve të komisarati, të cilat ishin të ndara një për të mitur dhe një për të rritur (femra dhe meshkuj). Dhomat ishin me përmasa 2.5 x 3 m, me dritare 1 x 0.5 m, por të papastra. Dhomat ishin të pajisura me stol dhe tavolinë. Dyert e dhomave ishin të përbëra nga 2 dyer, e para duralumini

dhe e dyta hekuri me shul që mbyllet me dry. Në korridorin e dhomave kishte një tualet, i cili për shkak të amortizimit ishte pothuajse i papërdorshëm. Ndiriçimi artificial nuk ishte i vazhdueshëm për shkak të mungesës së herëpashershme të energjisë elektrike. Në korridor ishin vendosur postera me të drejtat e personave të shoqëruar, ndërsa në dhomat e shoqërimit nuk ishin vendosur të tillë. Gjatë inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

### ***Kushtet në ambientet e sigurisë***

**Në Komisariatin e Policisë Durrës**, kishte 8 dhoma sigurimi, 1 për femra dhe 1 për të mitur dhe të tjerat për meshkuj të rritur. Gjatë inspektimit në këto dhoma kishte 4 persona të ndaluar dhe të arrestuar. Dhomat e sigurisë ishin brenda të gjitha standardeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Ato ishin të pajisura me dhomë/ paradhomë, me ndriçim natyral të mjaftueshëm dhe ndriçim artificial. Komunikimi i shpejtë me personelin e shërbimit në rast nevojë bëhej i mundur me pajisjen e çdo dhome me zile funksionale. Dhomat ishin të pajisura me krevate, sipas standardeve, shtresat ishin të vjetra, ndërsa çarçaf nuk kishte. Dhomat ishin të pajisura me sistem ngrohjeje të vendosur në paradhomë. Kjo e fundit ndahej nga mjedis tjetër me skarë hekuri, që mbyllet nga ana e brendshme e paradhomës, pa dorezë. Korridori i ambientit të sigurisë ishte i pajisur me sistem monitorimi. Banjat në çdo dhomë ishin funksionale dhe të pastra. Në çdo paradhomë kishte lavamanë, të cilët gjithashtu, ishin funksionalë, përveçse në një të dhomë, për të cilën, gjithsesi, stafi u vu menjëherë në lëvizje për të marrë masat e duhura për riparim dhe transferimin e personit në një dhomë tjetër. Të ndaluarit dhe të arrestuarit mund të laheshin në 2 dushet e posaçme për ta, me ujë të rrjedhshëm dhe të ngrohtë gjatë gjithë kohës. Posterat me të drejtat ligjore të të ndaluarve dhe të arrestuarve ishin të vendosura në korridor dhe brenda dhomave.

**Në Komisariatin e Policisë Krujë** kishte 4 dhoma sigurie, të vendosura jashtë godinës së Komisarariatit. Dhomat ishin plotësisht jashtë standardeve: me parket të amortizuar, pa krevat, pa sistem ngrohje dhe pa ËC. Gjatë momentit të inspektimit në një të dhomave ndodhej një person i ndaluar, i cili flinte mbi dyshek dhe mbulohej me batanije të vjetra pa çarçafë. Dushi, i cili në momentin e inspektimit nuk kishte ujë të ngrohtë, dhe banjat, ndodheshin në një kthinë të mjedisit të dhomave të sigurisë. Ky mjedis nuk siguronte aspak privatësi, ishte i ftohtë dhe nuk lejonte funksionimin normal. Qëndrimi i shtetasve në këto kushte, përbën trajtim degradues, si edhe cenon dinjitetin e çdo personi që shoqërohet në këto ambiente.

### ***Trajtimi i të ndaluarve/ arrestuarve në ambientet e sigurisë***

Të ndaluarit/ arrestuarit trajtoheshin me ushqim tri herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Urdhrin e Përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë. Në Komisariatin e Durrësit dhe në atë të Krujës ushqimi ofrohej nga kuzhina e institucionit.

Në të dy komisarimat me dhoma sigurie, të ndaluarit/ arrestuarit kishin ujë të rrjedhshëm në çdo kohë. Ujë të ngrohtë kishte vetëm në dushet e Komisarariatit të Policisë Durrës. Ndërkohë që në të dy komisarimat, pajisja e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjente, pasta dhe furça dhëmbësh, etj., ishte e pamjaftueshme, ndaj personat pajiseshin nga familja.

Në të dy institucionet e lartpërmendura, siç u informuam nga personeli, por edhe nga personat e intervistuar gjatë inspektimit, mungonte literatura informuese/ didaktike/ letrare, ndonëse kjo është një e drejtë e personave të ndaluar/ arrestuar. Gjithsesi, nga intervistimi i të ndaluarve/ arrestuarve rezultoi se pak prej tyre kishin dëshirë për të lexuar.

Në asnjërin prej komisariateve të inspektuar nuk ofrohej mundësia për ajrim në ambient të jashtëm.

Sa i përket trajtimit mjekësor të të ndaluarve/ arrestuarve, nga informacioni që u morr nga stafi drejtues i Komisarariatit të Policisë Durrës, në organikën e institucionit, është një mjek i përgjithshëm. Me Urdhër të brendshëm të titullarit të institucionit Nr. 26 prot., datë 01/ 04/ 2014, detyra e mjekut i është deleguar mjekut të përgjithshëm të Qendrës Shëndetësore nr. 7 të qytetit të Durrësit. Gjatë inspektimit, grupi monitorues konstatoi se vizitat për të ndaluarit/ të arrestuarit kryheshin rregullisht nga mjeku, i cili plotësonte më pas edhe kartelat mjekësore, sipas legjislacionit në fuqi. Ekzistonte gjithashtu, edhe një regjistër vizitash, i cili, së bashku me kartelat mbaheshin në një dollap me çelës.

Në vrojtimin e dhomës së mjekut, u vu re një ambient i papërshtatshëm për kryerjen e vizitave, përfshirë këtu edhe kubaturën e vogël të tij. Krevati i vizitave ishte i papërshtatshëm, dollapi për mbajtjen e medikamenteve ishte jashtë standardit, mungonin ilaçet bazë të urgjencës, si edhe ilaçe të tjera të domosdoshme për një shërbim efikas shëndetësor, si dhe mungonte aparati i tensionit. Nuk kishte frigorifer për mbajtjen e ilaçeve të posaçme.

### ***Ambientet e intervistimit***

Në Komisarariatit të Policisë Durrës kishte një dhomë të posaçme dhe të përshtatshme për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës dhe për takim me avokatët. Në Komisarariatit të Policisë Krujë kjo dhomë mungonte dhe në vend të saj përdorej dhoma e shërbimit të punonjësve të shërbimit.

Gjatë inspektimit u këqyrën të gjitha zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha Komisarariatet në fjalë, por këto mjedise nuk ishin të monitoruara. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/ merren në pyetje.

Vlen të theksohet fakti se në të gjitha Komisarariatet vijon problematika e mbajtjes së provave materiale nëpër zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore, e cila është pasojë e mungesës së ambienteve të veçantë për ruajtjen e provave materiale.

### ***Monitorimi i ambienteve të shoqërimit, të sigurisë dhe hetimit***

Sistemi i monitorimit audio-viziv përbën një ndër aspektet më të rëndësishme sa i përket parandalimit të të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Komisarariatit të Policisë Durrës ishte një model i mirë i këtij sistemi, me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të sigurisë dhe shoqërimit, si edhe me sistem

monitorimi brenda dhomave të shoqërimit. Ky sistem monitorimi mungonte në Komisaritet e Policisë Shijak dhe Krujë dhe Stacionin e Policisë Fushë-Krujë.

***Libri i personave të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar, si edhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia***

Në zbatim të Ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e të Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jenë të pajisur me regjistrat përkatës, Regjistri për personat e shoqëruar dhe Regjistri për personat e ndaluar/ arrestuar. Të gjitha Komisaritet e inspektuara ishin të pajisura me regjistrat e lartpërmendur.

***Ndihma juridike dhe psikologjike***

Gjatë inspektimit u konstatua se në të gjitha rastet kur të ndaluarit/ arrestuarit madhorë që nuk kanë mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat dhe kërkojnë ndihmë juridike, atyre iu është ofruar një avokat. Lista me emrat dhe kontaktet e avokatëve që pajtohen kryesisht ishin të afishuara.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për mbylljen e menjëhershme të dhomave të sigurisë në Komisaritetin e Policisë Krujë, pasi qëndrimi i shtetasve në këto kushte, përbën trajtim degradues, si edhe cenon dinjitetin e çdo personi që mbahet në këto ambiente.
2. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në dhomat e shoqërimit të Komisariateve të Policisë Shijak dhe Krujë, si dhe Stacionin e Policisë Fushë-Krujë.
3. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret ku ndodhen dhomat e ndalim/ arrestimit në Komisaritetin e Policisë Shijak dhe Krujë, si dhe Stacionin e Policisë Fushë-Krujë.
4. Marrja e masave për përfundimin e rikonstruksionit të njëres dhomë shoqërimi në Komisaritetin e Policisë Shijak dhe kompletimin e saj me pajisjet e nevojshme.
5. Marrja e masave për ndërtimin apo rikonstruksionin e dhomave të shoqërimit, si edhe tualeteve përkatëse, në Stacionin e Policisë Fushë-Krujë, duke ndërtuar tre dhoma të tilla sipas parashikimit dhe parametrave të përcaktuara në Ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”.
6. Marrja e masave për pajisjen e dhomave të mjekut në Komisaritetin e Policisë Durrës dhe Krujë, sipas kriterëve të përcaktuara në Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.

## **6.2. DPQ Elbasan dhe komisariate të varësisë:**

Komisariati i Policisë Peqin, datë 18.05.2014 / Nr. Dok. 201401083

Komisariati i Policisë Cërrik, datë 18.05.2014 / Nr. Dok. 201401084

Komisariati i Policisë Gramsh, datë 18.05.2014 / Nr. Dok. 201401085

Komisariati i Policisë Librazhd, datë 19.05.2014 / Nr. Dok. 201401086

Komisariati i Policisë Elbasan (DPQ), datë 19.05.2014 / Nr. Dok. 201401087

### ***Objektivat specifike të monitorimit:***

Monitorimi kishte si objekt kryerjen e vizitave, vëzhgimin, mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave, veprimeve dhe praktikave të ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në Ligjin Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”.

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, grupi i punës zhvilloi fillimisht takimin me drejtuesit e këtyre institucioneve dhe ju komunikoi atyre qëllimin e vizitës. Nga ana e drejtuesve të këtyre organeve u shpreh gatishmëri për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit inspektues. Në vijim të inspektimit, ekipi pati konsultime të frytshme me Drejtorin e Policisë së Qarkut, Shefat e Rendit dhe të Sigurisë Publike në Komisaritet e Policisë Elbasan, Librazhd, Peqin dhe Gramsh si dhe me zyrtarë të tjerë të këtyre njësisve policore.

Grupi i punës mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës si dhe kontaktoi privatisht me personat e privuar nga liria. Inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore si dhe u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Por gjatë inspektimit grupi i punës ka konstatuar se, përsëri vazhdojnë të jenë prezent disa problematika dhe konkretisht:

### ***Kushtet e ambienteve të shoqërimit:***

**Në Komisariatin e Policisë Elbasan** ka dy ambiente shoqërimi të cilat ndodhen në dy ndërtesa të ndryshme, brenda territorit të Komisariatit të Policisë. Njëra dhomë është me përmasa 4m x 3.5m, me derë hekuri dhe ka një dritare me përmasa 1.3m x 1.5m, e cila siguron ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Ajo është e pajisur me orëditë e nevojshme, si tavolinë dhe stola, por është e pa lyster dhe e pa pastër. Në këtë dhomë nuk ka tualet dhe në rast nevojë të shoqëruarit dërgohen në tualetin e Komisariatit të Policisë i cili përdoret edhe nga punonjësit e këtij komisarati. Dhoma përdoret vetëm për personat e shoqëruar madhorë meshkuj.

Ambienti tjetër plotëson të gjitha kërkesat e Ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, pasi është i ndarë më vete për femra dhe të mitur. Ai përbëhet nga dy dhoma me përmasa 4x4m, me korridor 4x2m, i mobiluar me tavolina, karrige dhe kolltukë. Dhomat janë me ndriçim të plotë natyral pasi kanë dritare normale, me ndriçim nga rrjeti si dhe me tualet të kompletuar dhe me ujë të rrjedhshëm. Megjithatë këto dhoma, në ditën e inspektimit u gjetën jashtë përdorimit për arsye se ato ishin kthyer në magazina të pajisjeve dhe provave materiale



duke i nxjerrë ato nga funksioni si dhoma shoqërimi të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

**Në Komisariatin e Policisë Librazhd**, u konstatua se ambientet e vjetra të shoqërimit ishin nxjerrë jashtë funksionit, me Urdhër Nr.239, datë 28.05.2012 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si ambiente jashtë standardeve të përcaktuara në aktet normative, në zbatim të rekomandimit të bërë nga Avokati i Popullit. Sipas këtij urdhri, mbajtja dhe trajtimi i personave të shoqëruar në këtë komisarjat do të kryhej në ambientet e zyrave të punonjësve të policisë në një kohë sa më shpejtë të jetë e mundur dhe jo detyrimisht 10 orë. Personat nuk duhet të qëndrojnë të mbyllur dhe pa prezencën e punonjësit të policisë. Mirëpo gjatë inspektimit grupi i monitorimit konstatoi se një dhomë shoqërimi, e cila sipas rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit, ishte ri konstruktuar dhe plotësonte pjesërisht standardet e kërkuara dhe mund të përdorej deri në rikonstruktimin e plotë të dhomave të shoqërimit të katit të parë te godinës së Komisarariatit Librazhd sipas Manualit. Sa më sipër sqarojmë se, kushtet e ambientit të shoqërimit do të ishin sipas standardeve të përcaktuara, nëse kjo dhomë nuk do të ishte e pajisur me derë hekuri me shul dhe me dry.

**Në Komisariatin e Policisë Peqin**, ambienti i shoqërimit ishte përshtatur sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, pasi ishte i ndarë për femra, meshkuj dhe të mitur. Dhomat ishin me dyer duralumini me brava të zakonshme, të lyera, të pastra dhe me sipërfaqe të bollshme për qëndrim, por mungon ndriçimi nga rrjeti elektrik. Në të tre dhomat kishte ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, pasi ishin hapur dritare sipas rekomandimit të bërë nga Avokati i Popullit. Tuelalet ndodhet brenda ambienteve të shoqërimit, i pastër, me ujë të rrjedhshëm dhe i pajisur me të gjitha orenditë e nevojshme. Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

**Në Komisariatin e Policisë Gramsh**, dhoma e shoqërimit për shtetasit e shoqëruar madhorë ishte nxjerrë jashtë funksionit sipas rekomandimit të bërë nga Avokati i Popullit. Aktualisht në këtë komisarjat kishte tre dhoma shoqërimi, të cilat përmbushin kërkesat kryesore të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, pasi janë të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur. Dhomat janë me dyer druri me brava të zakonshme, me ndriçim nga rrjeti, me dritare të cilat kanë përmasa normale që lejojnë hyrjen e dritës e të ajrimit të plotë natyral, me tavolina e karrige, të lyera e të pastra. Brenda dhomave nuk ka tualet dhe në rast nevoje të shoqëruarit dërgohen në tualetin e komisarariatit i cili përdoret edhe nga punonjësit e policisë. Në ditën e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

**Në Komisarariatet e Policisë Elbasan, Gramsh dhe Peqin** posterat për të drejtat e personave të shoqëruar janë të vendosura në të gjitha ambientet e shoqërimit, në korridore si dhe në hyrje të këtyre institucioneve.

#### ***Kushtet e ambienteve të sigurisë (paraburgimit):***

Në strukturën e Komisarariatit të Policisë Librazhd, Peqin dhe Gramsh nuk ka ambiente të sigurisë dhe personat e ndaluar/ arrestuar dërgohen në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Elbasan.

**Në Komisarlatin e Policisë Elbasan** ka 17 dhoma sigurie të mbartura nga ish dhomat e paraburgimit. Këto dhoma ishin ndërtuar në vitin 1962 dhe ishin jashtë çdo standardi për jetesë. Aktualisht përdoren vetëm shtatë dhoma nga të cilat një dhomë për femra, një për fëmijë dhe pesë për madhorë. Në këto shtatë dhoma ishin akomoduar 16 persona të ndaluar arrestuar nga të cilët dy të mitur. Edhe pse nga punonjësit dhe drejtuesit e këtij komisarati tregohet kujdes i veçantë për higjienën, dhomat nuk plotësonin standardet e përcaktuara në Ligjin Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualit “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, pasi ishin me shumë lagështi dhe me mundësi të pakët ajrimi. Gjendja në të cilën ato ndodhen dëmton rëndë shëndetin e personave të ndaluar/ arrestuar të cilët ka raste që qëndrojnë disa ditë, por dhe të punonjësve të policisë që shërbejnë në këto ambiente. Brenda tyre ishin vendosur rrobat e fjetjes, dyshek batanije, jastëk etj. por mungonin pajisjet dhe orenditë e nevojshme për jetesë, si tavolinë stola dollap për vendosjen e rrobave dhe sendeve personale.

Tualeti ishte i pastër dhe me ujë të rrjedhshëm, por nuk ishte i mbyllur me derë. Kishte akses për tu larë pasi dushi ishte në gjendje pune. Nuk kishte ndriçim natyral dhe ventilim.

Në dhoma nuk kishte zile të emergjencës, për pasojë mundësia e komunikimit me shërbimin e policisë në një moment pasigurie mungonte. Nuk kishte ambient ajrimi më vete që personat e ndaluar/ arrestuar të dalin në ajrim sipas kërkesave të ligjit (jo më pak se dy orë në ditë). Në ambientet e brendshme të këtyre dhomave ishin të afishuara të drejtat e personave të ndaluar/ arrestuar.

Në korridorin e dhomave të sigurisë, kishte telefon dhe citofon për të komunikuar në raste emergjente, me personelin e shërbimit të informacionit. Ambientet e dhomave të sigurisë ishin të monitoruara nga sistemi i kamerave, njëra prej të cilave ishte në korridorin e këtyre dhomave. Ishin tre monitorë, një në sallën e shërbimit të informacionit, një në sallë dhe një në zyrën e Drejtorit të Policisë së Qarkut.

#### ***Trajtimi i të ndaluarve/ arrestuarve në ambientet e sigurisë:***

Të ndaluarit/ arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave.

Në Komisarlatin e Policisë Elbasan kishte kuzhinë për përgatitjen e ushqimit, e cila ishte e re dhe e pajisur me orenditë të kohës.

Të ndaluarve/ arrestuarve iu bëhej kontrolli mjekësor sipas kërkesave të ligjit (brenda 24 orëve) shoqëruar me kartelën mjekësore për secilin. Në organikën e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Elbasan kishte një mjek të përgjithshëm, i cili kishte një ambient (dhomë) të përshtatshme për të bërë vizita. Medikamentet e kutisë së ndihmës së shpejtë siguroheshin në mënyrë të vazhdueshme me fondet e Drejtorisë së Policisë. Ambulancë për rast urgjence apo për rastet kur policia kryen operacione policore nuk kishte.

Të ndaluarve/ arrestuarve u ofrohej mundësia të lexonin shtypin e ditës, i cili sigurohej me shpenzimet e veta si dhe iu lejohej mbajtja e letrës dhe lapsit për të shkruar, pasta dhe furça e dhëmbëve, pasta e rrojës dhe brisqe rroje të plastifikuar.

Të ndaluarve/ arrestuarve u sigurohet nga komisariatet e policisë sapun, detergjente, letër higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqir e mjete të tjera për ruajtjen e higjienës vetjake e të ambientit ku qëndrojnë.

Të ndaluarit/ arrestuarit nuk kishin mundësi të dilnin në ajrim apo të zhvillonin ndonjë aktivitet fizik jashtë qelive të tyre.

Brenda dhomave të sigurisë kishte të vendosur postera për të drejtat e personave të ndaluar dhe arrestuar në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja.

Të ndaluarit/ arrestuarit nuk pajiseshin me procesverbal të depozitimit të sendeve personale, pasi nuk kishte ambiente të cilësuar për magazinimin e tyre.

#### ***Ambientet e intervistimit dhe të hetimit:***

Vetëm në Komisarlatin e Policisë Elbasan ishte ndërtuar një ambient intervistimi për të shoqëruarit, i cili përbëhej nga një sallë, e ndarë në mënyrë të tillë ku mund të punohej me gjashtë qytetarë njëkohësisht. Ambienti ishte i kompjuterizuar, me sistem monitorimi me kamera, i pastër, i mobiluar, i ngrohtë dhe me drite natyrale të bollshme.

Në zyrat e oficerëve të policisë nuk u gjetën sende apo prova materiale, prania e të cilave mund të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.

#### ***Monitorimi i ambienteve të shoqërimit, të sigurisë dhe të hetimit:***

Duke përjashtuar Komisarlatin e Policisë Elbasan, në komisariatet e tjera nuk ka sistem monitorimi me kamera për të mbajtur të mbikëqyrur ambientet e shoqërimit, të sigurisë dhe të hetimit. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit me kamera vëzhgimi një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

#### ***Libri i personave të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia:***

Në të katër komisariatet e policisë të DPQ Elbasan u konstatua se, libri i shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të shtetasve është ndërtuar sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, pasi në ta janë hapur të gjitha rubrikat ku duhet të pasqyrohen të dhëna për personat e shoqëruar, ndaluar/ arrestuar por, disa prej rubrikave nuk plotësohen sipas kërkesave të ligjit dhe konkretisht:

Në rubrikën ku flitet për arsyet e shoqërimit vërehet se, në të gjithë komisariatet e policisë, në shumicën e rasteve, personat e shoqëruar trajtohen si të dyshuar për kryerjen e një vepre penale. Trajtimi i tyre në këtë mënyrë vjen në kundërshtim me nenin 11 pika 6 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” sipas të cilit, i shoqëruar konsiderohet një person që ka shkelur një rregull administrativ

dhe jo një person që dyshohet si autor i një vepre penale apo i arrestuar në flagrancë. Gjatë inspektimit grupi i punës ka konstatuar raste konkrete të trajtimit të personave të ndaluar/arrestuar si të shoqëruar dhe konkretisht:

Në rubrikën e njoftimit të familjarëve, jo gjithmonë pasqyrohet saktë, emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar si dhe fakti i shoqërimit, ndalimit apo arrestimit. Konstatohet se kjo rubrikë plotësohet duke shënuar “*u njoftua familja, babai, djali, e ëma*” pa specifikuar emrin e personit që u njoftua, ora e njoftimit dhe numri i telefonit të tij. Pavarësisht se nga punonjësit e policisë u pretendua se familjarët e personave të mbajtur në komisariatet e policisë njoftohen, gjykojmë se ky pretendim duhet provuar duke bërë plotësimin e rubrikës së njoftimit të familjarëve sipas kërkesave të lartpërmendura.

Gjithashtu fenomeni i konstatuar nga Avokati i Popullit lidhur me orën faktike të ndalimit apo arrestimit në flagrancë të shtetasve ishte prezent në këtë Drejtori Policie dhe komisariatet në varësi të saj. Nga krahasimi që bëri grupi i inspektimit ndërmjet orës së vendosur në procesverbalet e ndalimit apo arrestimit në flagrancë, të dy shtetasve të arrestuar që ndodheshin në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Elbasan gjatë momentit të inspektimit, me orën që ishte shënuar në rubrikën e ndalim/ arrestimit në librin e të ndaluarve/ arrestuarve u arrit në konkluzionin se, në procesverbalet e ndalimit apo arrestimit në flagrancë nuk shënohet ora e kapjes faktike të personit, por vihet ora e përpilimit të procesverbalit.

Libri i ankesave të qytetarëve të shoqëruar, ndaluar/arrestuar ishin hapur, por nuk ishin vënë në funksionim pasi mungon shënimi dhe prania e ankesave.

### ***Ndihma juridike dhe psikologjike:***

Gjatë inspektimit, u konstatuan raste që të ndaluarit/ arrestuarit kishin kërkuar ndihmë juridike dhe ishin pyetur pa praninë e mbrojtësit. P.sh shtetasi L.P., arrestuar në Belsh pretendonte se nuk i ishte dhënë mundësia të kontaktojë me avokat. Ndërsa për të ndaluarit/ arrestuarit e mitur, për të cilët ndihma juridike dhe psikologjike është e detyrueshme u konstatua se, ky detyrim ligjor përmbushej meqenëse në organikën e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Elbasan ishte parashikuar një specialist psikolog.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit në Komisarariatet e Policisë Librazhd sipas kërkesave të ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “*Për Policinë e Shtetit*” dhe në zbatim të Letër–Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 703, datë 07.08.2008, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
2. Marrja e masave për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë në Komisarariatet e Policisë Elbasan sipas kërkesave të ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “*Për Policinë e Shtetit*”, Manualit “*Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*” .
3. Marrja e masave për plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar.

4. Marrja e masave për kthimin e menjëhershëm në gjendjen e tyre funksionale të dhomave të shoqërimit për femra dhe të mitur në Komisariatin e Elbasanit.
5. Marrja e masave për respektimin e dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimi/ndalimit të shtetasve dhe të mos trajtohen fillimisht si të shoqëruar.
6. Marrja e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit me kamera në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të hetimit në të gjithë Komisaritet e Policisë të DPQ Elbasan ku ai mungon. Monitorimi duhet të fillojë nga hyrja e ndërtesës së komisarariatit, me qëllim për të mos pasur asnjë moment shkëputje deri në ambientin ku personi do qëndrojë.
7. Marrja e masave për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për rastet e konstatuara në Komisaritet e Policisë Elbasan dhe Librazhd, ku të dyshuarit si autor të mundshëm të kryerjes së veprës penale, apo me cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për hetimin janë trajtuar si të shoqëruar.
8. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e një dhome për mbajtjen e sendeve personale për personat e ndaluar/ arrestuar, si dhe dhënien e një kopje të procesverbalit të kontrollit personal.
9. Marrja e masave për vënien në funksion të librit të ankesave të shtetasve të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar.

### **6.3. DPQ Lezhë dhe komisariate të varësisë:**

Komisariati i Policisë Kurbin, datë 23.05.2014 / Nr. Dok. 201401125

Komisariati i Policisë Mirditë, datë 23.05.2014 / Nr. Dok. 201401126

Stacioni i Policisë Mamurras, datë 23.05.2014 / Nr. Dok. 201401127

Komisariati i Policisë Lezhë (DPQ), datë 23.05.2014 / Nr. Dok. 201401128

### ***Shënime paraprake***

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, grupi monitorues, në secilin prej subjekteve të lartpërmendura, u takua fillimisht me titullarin e institucionit, për t'i komunikuar qëllimin e inspektimit. Në përgjithësi, të gjithë drejtuesit e institucioneve të inspektuara treguan bashkëpunim gjatë gjithë kohës që grupi ishte në inspektim. Vlen të theksohet fakti se një gjë e tillë nuk u konstatua në Komisariatin e Policisë Mirditë, ku, nga ana e drejtuesit të këtij komisaritati, u bënë përpjekjet maksimale për të penguar punën e grupit të inspektimit.

Pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, mori takim privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi ambientet e shoqërimit e të sigurisë dhe zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse. Më konkretisht, gjendja e përgjithshme si dhe problematikat e konstatuara në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Lezhë dhe në organet e policisë në varësi të saj pasqyrohen më poshtë:

### ***Kushtet e ambienteve të shoqërimit:***

**Në Komisarlatin e Policisë Lezhë**, dhomat e shoqërimit dhe ato të sigurisë, nuk janë të ndërtuara sipas kërkesave të ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e të Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 763, datë 27.09.2011.

Brenda mjediseve të këtij Komisarlati, të ndara nga pjesa tjetër e mjediseve të institucionit me një derë hekuri, kishte 4 dhoma shoqërimit, 2 për të rritur, një për të mitur dhe një për femra. Njëra prej dhomave të shoqërimit për të rriturit përdorej për persona të shoqëruar që shfaqnin shenja agresiviteti. Tri prej dhomave ishin me përmasa 4x5 m, të pajisura me tavolina dhe me karrige, përveç dhomës së shoqërimit të shpjeguar më lartë, e cila nuk ishte e pajisur me orendi. Dhoma për femra, ishte e organizuar me paradhomë dhe dhomë ku të dy mjediset ishin shumë të vogla. Nga stafi i Komisarlatit u informuam se kjo dhomë, duke mos pasur mundësi për dritë natyrale, ishte strukturuar në këtë formë. Kishte dritare të pajisura me skarë dhe rrjetë hekuri, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Të katër dhomat kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dyert ishin prej hekuri, të cilat, kishin mundësi për t’u mbyllur nga jashtë, dhe kishin një hapësirë në pjesën e sipërme të pajisur me rrjetë hekuri. Të 4 dhomat ishin të palyera, të papastra dhe me lagështirë. Tualetet ishin brenda dhomave, të cilat, gjithashtu, ishin tepër të papastra, gjë që vihej re që në momentin e hyrjes në mjediset e shoqërimit, pasi karakterizoheshin nga një erë e rëndë papastërtie. Këto dhoma nuk mbuloheshin me kamera monitorimi. Në korridor ishin vendosur postera me të drejtat e personave të shoqëruar. Në ditën e inspektimit ishte vetëm një person i shoqëruar, i cili ndodhej në dhomën për të rritur për persona me shfaqje agresiviteti. Grupi i inspektimit mori kontakt me personin në mënyrë private, por ai refuzoi të fliste me ekspertët e grupit të monitorimit.

**Në Komisarlatin e Policisë Kurbin**, jashtë mjediseve të komisarlatit kishte 2 dhoma shoqërimit të ndara përkatësisht për femra dhe të mitur, dhe tjetra për meshkuj. Në ditën e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Dhomat e shoqërimit ishin me përmasa 4x3 m, me dritare me përmasa që siguronin ndriçim natyral të pjesshëm (një pjesë e dritares ishte e mbyllur me kompensatë). Të tri dhomat kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dhomat ishin të pajisura me 2 karrige dhe tavolinë, të palyera dhe të pastra, por me lagështirë. Dyert e dhomave të shoqërimit ishin brenda standardeve. Nuk kishte tualet në këtë ambient. Në korridor ishin afishuar postera me të drejtat e personave të shoqëruar.

**Në Stacionin e Policisë Mamurras**, nuk kishte dhoma shoqërimit, brenda mjediseve të Stacionit. Në ditën e inspektimit, nga personeli në detyrë, grupi i ekspertëve u informua se të gjithë personat shoqëroheshin dhe/ ose ndaloheshin në mjediset përkatëse të Komisarlatit të Kurbin. Megjithatë, grupi i inspektimit vuri re se në mjedisin e Stacionit të Policisë Mamurras ishte një dhomë e cila mbyllej me derë skare hekuri me dry, e cila ishte me përmasa 2 x 3 m, pa dritare dhe pa orendi, për të cilën ekspertët u informuan se nuk përdorej, përveç rasteve, kur personat e shoqëruar shfaqnin shenja agresiviteti.

**Në Komisarlatin e Policisë Mirditë**, kishte 3 dhoma shoqërimit, të cilat ndodheshin brenda godinës së komisarlatit. Të tri dhomat kishin lagështirë, ishin të palyera, por ishin të pastra, pasi

punonjësit e Komisarariatit u vunë në lëvizje për pastrim gjatë kohës që grupi i monitorimit u pengua të hynte në mjediset e këtij Komisaritati. Dhomat e shoqërimit siguronin hapësirë në përmasa dhe kishin dritare që siguronin dritën natyrale të nevojshme. Drita artificiale gjithashtu, sigurohej nga rrjeti elektrik. Brenda dhomave kishte 2 karrige dhe një tavolinë, si edhe poster me të drejtat e personave të shoqëruar. Në ambientet e dhomave të shoqërimit nuk kishte tualet. Në ambientet e shoqërimit nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera. Në kohën e inspektimit kishte 2 persona, njëri i ndaluar dhe tjetri i mitur i shoqëruar.

Gjithashtu, në po këtë komisarjat, grupi i inspektimit, konstatoi se në fund të korridorit hyrës në godinë, në anën e majtë, ndodhej një dhomë me derë skare hekuri, e mbyllur me dry, e cila ishte pa dritare me një dhomë tjetër brenda saj të ndarë edhe ajo me derë skare hekuri. Dhoma nuk kishte orendi dhe nga ana e personelit, grupi i inspektimit u bë me dije se kishte dalë jashtë funksionit, pavarësisht faktit se të dy personat e lartpërmendur, të gjendur në komisarjat si, përkatësisht, të shoqëruar dhe ndaluar, na konfirmuan në privatësi se kishin kaluar të gjithë natën në këtë mjedis.

### ***Kushtet në ambientet e sigurisë:***

**Në Komisarjatit e Policisë Lezhë**, mjedisi i dhomave të sigurisë ishte në të njëjtin korridor me dhomat e shoqërimit, ndarë prej tyre me një derë hekuri. Kishte 4 dhoma sigurimi; 1 për femra, 1 për të mitur dhe të tjerat për meshkuj të rritur, të cilat sipas informacionit të marrë nga personeli i Komisarariatit ishin parashikuar për 6 persona. Gjatë inspektimit në këto dhoma kishte 11 persona të ndaluar dhe të arrestuar, gjë që tregon mbipopullimin në këto mjedise.

Dhomat e sigurisë ishin të pajisura me dhomë/ paradhomë, me ndriçim natyral të mjaftueshëm, si dhe me ndriçim artificial. Komunikimi i shpejtë me personelin e shërbimit në rast nevojë bëhej i mundur me pajisjen e çdo dhome me zile funksionale. Dhomat ishin të pajisura me krevate, sipas standardeve, por shtresat ishin të vjetra, ndërsa çarçaf nuk kishte.

Dhomat nuk ishin të pajisura me sistem ngrohjeje. Paradhoma ndahej nga mjedis tjetër me skarë hekuri, që mbyllej nga ana e brendshme e paradhomës, pa dorezë. Banjat në çdo dhomë ishin funksionale, por të amortizuara dhe relativisht të pastra. Në çdo paradhomë kishte lavamanë, të cilët gjithashtu, ishin funksionalë. Të ndaluarit dhe të arrestuarit mund të laheshin me ujë të rrjedhshëm dhe të ngrohtë sa herë që dëshironin ta bënin një gjë të tillë në një mjedis të veçantë, të pastër ku gjendej dushi. Posterat me të drejtat ligjore të të ndaluarve dhe të arrestuarve ishin të vendosura në korridor dhe brenda dhomave.

Korridori i ambientit të sigurisë nuk ishte i pajisur me sistem monitorimi.

### ***Trajtimi i të ndaluarve/ arrestuarve në ambientet e sigurisë:***

Të ndaluarit/ arrestuarit trajtoheshin me ushqim tri herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Urdhrin e Përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë.

Në këtë komisariat, të ndaluarit/ arrestuarit kishin ujë të rrjedhshëm në çdo kohë në dhomat e sigurisë dhe ujë të ngrohtë në dushin brenda mjedisit të dhomave të sigurisë. Ndërkohë që, pajisja e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjentë, pasta dhe furça dhëmbësh, etj., nuk ofrohej nga institucioni, ndaj personat pajiseshin nga familja.

Në Komisarlatin e Lezhës, siç u informuam nga personeli, por edhe nga personat e intervistuar gjatë inspektimit, mungonte literatura informuese/ didaktike/ letrare, ndonëse kjo është një e drejtë e personave të ndaluar/ arrestuar. Gjithsesi, nga intervistimi i të ndaluarve/ arrestuarve rezultoi se pak prej tyre kishin dëshirë për të lexuar.

Nuk ofrohej mundësia për ajrim në ambient të jashtëm.

Sa i përket trajtimit mjekësor të të ndaluarve/ arrestuarve, nga informacioni që morëm nga stafi drejtues i Komisarlatit të Policisë Lezhë, në organikën e institucionit, është një mjek i përgjithshëm, i cili ishte prezent edhe në kohën e inspektimit. Grupi monitorues konstatoi se vizitat për të ndaluarit/ të arrestuarit kryheshin rregullisht nga mjeku, i cili plotësonte më pas edhe kartelat mjekësore, sipas legjislacionit në fuqi. Në momentin e inspektimit, të gjithë të ndaluarit/ arrestuarit e intervistuar, shpreheshin shumë të kënaqur nga shërbimi shëndetësor, si dhe nga gatishmëria e tij për të ofruar shërbim në çdo kohë, edhe jashtë orarit zyrtar të punës.

Grupi i inspektimit vërejti se, dhoma ku mjeku kryente vizitat ishte e papërshtatshme, me kubaturë të vogël, e pajisur vetëm me dritë artificiale, një krevat e një tavolinë, të cilat nuk ofronin aspak ambient komod për kryerjen e vizitave. Mungonte frigoriferi për mbajtjen e ilaçeve të posaçme dhe aparati i tensionit ishte siguruar privatisht nga mjeku. Dollapi ku mbaheshin ilaçet ishte thujse bosh, mungonin të gjitha llojet e ilaçeve, përveç një sasive shumë të vogël analgjezikësh. Këtë problem e ngriti edhe mjeku i institucionit, i cili e shihte të pamundur dhënien e shërbimit shëndetësor në institucion, për shkak të mungesave të theksuara të ilaçeve në përgjithësi dhe të atyre të urgjencës në veçanti.

Për sa i përket dokumentacionit të mjekut, si regjistrat e vizitave, të konsultave, ashtu dhe kartelat e të ndaluarve/ arrestuarve mbaheshin me rregull dhe të kyçura me çelës. Vlen të theksohet fakti se, pavarësisht mungesave dhe kushteve jo të favorshme për mjekun, shërbimi i kryer prej tij ishte për t'u vlerësuar.

### ***Ambientet e intervistimit:***

Në Komisarlatin e Policisë Lezhë, kishte një dhomë të posaçme dhe të përshtatshme për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës dhe për takim me avokatët.

Gjatë inspektimit u këqyrën të gjitha zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha Komisarlatet në fjalë, por këto mjedise nuk ishin të monitoruara me kamera vëzhgimi. Në përgjithësi, në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/ merren në pyetje. Vlen të theksohet fakti se në zyrën e pritjes së popullit të Stacionit të Policisë Mamurras, u gjend një shkop gome i vjetër mbi kasafortë dhe në Komisarlatin e Kurbinin, në zyrën e informacionit, u gjendën një këmbë karrigeje dhe një shkop



rreth 50 cm, i mbështjellë me natriban, për të cilët, grupi i inspektimit bëri menjëherë me dije personat përkatës.

Vlen të theksohet fakti se pothuajse në të gjitha Komisarariatet vijon problematika e mbajtjes së provave materiale nëpër zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore, e cila është pasojë e mungesës së ambienteve të veçantë për ruajtjen e provave materiale.

### ***Monitorimi i ambienteve të shoqërimit, të sigurisë dhe hetimit:***

Sistemi i monitorimit audio-viziv përbën një ndër aspektet më të rëndësishme sa i përket parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky sistem monitorimi ishte i pjesshëm apo mungonte në pothuajse të gjitha Komisarariatet e Policisë së Qarkut Lezhë të inspektuara.

### ***Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar, si edhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia:***

Në zbatim të Ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e të Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jenë e pajisur me regjistrat përkatës; Regjistri për Personat e Shoqëruar dhe Regjistri për Personat e Ndaluar/ arrestuar. Të gjitha Komisarariatet e inspektuara ishin të pajisura me regjistrat e lartpërmendur. Megjithatë, vlen të përmendet fakti se Stacioni i Policisë Mamurras kishte një model jo të përditësuar të regjistratit të personave të shoqëruar, i cili datonte i sekretuar që prej vitit 2003. Edhe në Komisariatin e Policisë Lezhë, ky regjistër ishte i pa përditësuar.

Në të gjitha regjistrat e këqyruar u vunë re problematikat e mëposhtme:

- Jo të gjitha rubrikat plotësoheshin apo plotësoheshin saktë si në Regjistrin e Personave të Shoqëruar, ashtu edhe në Regjistrin e Personave të Ndaluar/ Arrestuar.
- Në rubrikën e njoftimit të familjarëve, në pjesën më të madhe të rasteve, kishte mungesë informacioni sa i përket emrit, atësisë, mbiemrit dhe numrit të telefonit të personit të njoftuar. Nga verifikimet e bëra, në pothuajse të gjitha rastet, në të gjitha komisarariatet u pa se numrat e vendosura të telefonit, në fakt nuk ishin të familjarëve të njoftuar, por të vetë personit të shoqëruar.
- Në Regjistrat e Personave të Shoqëruar, në të gjitha Komisarariatet e inspektuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, arsyeja e shoqërimit përfshinte edhe kryerjen e veprës penale nga ana e shtetasit, si p.sh. vjedhje, drejtim i automjetit në gjendje të dehur, arrestim në flagrancë, i shpallur në kërkim, fyerje për shkak të detyrës, etj.

Sa i përket trajtimit të të shoqëruarve/ ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve të kryera nga policia, në Komisariatin e Mirditës u vunë re shkelje të legjislacionit në fuqi lidhur me shoqërimin dhe ndalimin/ arrestimin e personave.

Siç u theksua edhe më lartë, në këtë Komisariat, në kundërshtim të plotë me ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe ligjin Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, grupi i inspektimit u përball me një pengesë të qenësishme për të zhvilluar detyrën nga ana e Shefit të Komisarariatit, i cili në momentin e inspektimit, fizikisht, nuk ndodhej në Komisariat. Shefi komunikoi me grupin e inspektimit nëpërmjet specialistit të informacionit dhe nuk pranoi të komunikonte drejtpërsëdrejti, pavarësisht përpjekjeve të grupit të inspektimit. Specialisti i informacionit, u mundua të pengonte edhe këqyrjen e regjistrave përkatës, pasi, sipas tij, nuk kishte marrë leje nga Shefi i Komisarariatit për t’i vënë në dispozicion të grupit inspektues.

Gjatë inspektimit, ekspertët morën kontakt privatisht me personin A.M. i gjendur në njërën prej dhomave të shoqërimit, i cili na bëri me dije se ishte ndaluar për drejtim mjeti pa patentë rreth orës 12:30-1 të mëngjesit të ditës së inspektimit. Gjithashtu, ai bëri me dije se kishte kaluar të gjithë natën, deri pak minuta para takimit të ekspertëve, në një dhomë me hekura në fund të korridorit të katit të parë, e cila nuk kishte as krevat, as karrige apo orendi të tjera. Këtë mjedis ai e kishte ndarë edhe me të shoqëruarin G.B., i mitur, në kundërshtim me Neni 101 “Shoqërimi në Polici”, pika 3 e ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

Grupi i ekspertëve kërkoi takim edhe me të miturin e shoqëruar G.B. Grupi i ekspertëve konstatoi se i mituri ishte në dhomën e Shefit të Rendit dhe të Sigurisë, ku 2 OPGJ po i merrnin deklaratë pa praninë as të prindërit, të kujdestarit ligjor, të psikologut apo edhe të avokatit, në kundërshtim me nenin 27 të ligjit Nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”. Gjendja psikologjike e të miturit ishte tejet e rënduar, gjë që u vërtetua edhe në përlojtjen e tij gjatë intervistimit me grupin e inspektimit, në kundërshtim me frymën e ligjit Nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, si dhe të nenit 21 të po këtij ligji. Edhe ai pohoi se sapo kishte ardhur në zyrën ku gjendej dhe ishte shoqëruar rreth orës 12:30-1 të mëngjesit të ditës së inspektimit, duke tejkaluar kështu afatin ligjor të përcaktuar për një person të shoqëruar, i cili gjithsesi, nuk duhet t’i kalojë 10 orët, që nga momenti i shoqërimit. Kishte kaluar të gjithë natën, deri pak minuta para takimit të ekspertëve, në një dhomë me hekura në fund të korridorit të katit të parë, e cila nuk kishte as krevat, as karrige apo orendi të tjera. Këtë mjedis ai e kishte ndarë me të ndaluarin A.M. I mituri bëri me dije grupin e ekspertëve që nuk kishte komunikuar me asnjërin prej familjarëve që prej momentit të ndalimit, deri në momentin e kontaktimit me ekspertët. Grupi i inspektimit bëri me dije OPGJ-të që po punonin me të miturin se ishin në shkelje flagrante të legjislacionit në fuqi.

Menjëherë, grupi i inspektimit vijoi të këqyrte regjistrat përkatës, ku, orari i shoqërimit të personave në fjalë ishte shënuar 03:00 e mëngjesit dhe në këtë regjistër nuk ishte plotësuar emri i OPGJ-së që do të trajtonte çështjen, në kundërshtim me ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 103. Për më tepër, të dy personat e mësipërm, kishin të shënuar të njëjtin person në rubrikën e familjarit të njoftuar dhe numri i celularit të shënuar, pasi u provua nga ana e grupit të inspektimit, nuk ekzistonte. Rrjedhimisht, deduktohet që familjarët e personave të shoqëruar, veçanërisht të të miturit, nuk ishin njoftuar, në kundërshtim me nenin 107, pika 2 të ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

### *Ndihma juridike dhe psikologjike:*

Gjatë inspektimit u konstatua se në të gjitha rastet kur të ndaluarit/ arrestuarit madhorë që nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu është bërë me dije se mund t'u ofrohej një avokat kryesisht. Lista me emrat dhe kontaktet e avokatëve që pajtohen kryesisht nuk ishin të afishuara në asnjërin prej Komisariateve të inspektuar.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e menjëhershme në analizë të situatës së përshkruar më lartë në Komisariatin e Mirditës, duke marrë masat administrative përkatëse ndaj personelit.
2. Marrja e masave për nxjerrjen reale jashtë përdorimit të dhomës së sigurisë në Komisariatin e Mirditës, për të penguar abuzivizma të mëtejshëm me personat e shoqëruar/ ndaluar/ arrestuar në këtë Komisariat.
3. Marrja e masave për ndërtimin e një tualeti për dhomat e shoqërimit në Komisariatin e Policisë Mirditë, sipas parashikimit dhe parametrave të legjislacionit në fuqi.
4. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në dhomat e shoqërimit të Komisariateve të Policisë në varësi të Drejtorisë së Policisë Qarku Lezhë.
5. Marrja e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në dhomat e sigurisë në Komisariatin e Policisë Lezhë, duke u fokusuar në respektimin e hapësirës personale sipas parashikimit dhe parametrave të legjislacionit në fuqi.
6. Marrja e masave të menjëhershme për veçimin e të miturve nga të rriturit në dhomat e sigurisë në Komisariatin e Policisë Lezhë, sipas parashikimit dhe parametrave të legjislacionit në fuqi.
7. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të sigurisë në Komisariatin e Policisë Lezhë.
8. Marrja e masave për riparimin apo rikonstruksionin e dhomave të shoqërimit, veçanërisht dhomën e shoqërimit për femra, si edhe tualeteve përkatëse, në Komisariatin e Policisë Lezhë sipas parashikimit dhe parametrave të legjislacionit në fuqi.
9. Marrja e masave për pajisjen e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale nga Komisariati i Policisë Lezhë.
10. Marrja e masave për hapjen edhe të një dhome tjetër shoqërimi në Komisariatin e Policisë Kurbin, si dhe riparimin e dy dhomave ekzistuese, të gjitha këto sipas parashikimit dhe parametrave të legjislacionit në fuqi.
11. Marrja e masave për ndërtimin e një tualeti për dhomat e shoqërimit në Komisariatin e Policisë Kurbin sipas parashikimit dhe parametrave të legjislacionit në fuqi.
12. Marrja e masave për rikonstruksionin e dhomës së këqyrur nga grupi i inspektimit në Stacionin e Policisë Mamurras dhe standardizimin e saj sipas parashikimit dhe parametrave të legjislacionit në fuqi.
13. Marrja e masave për pajisjen e dhomës së mjekut në Komisariatin e Policisë Lezhë sipas kritereve të përcaktuara në Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.

14. Marrja e masave për furnizimin me ilaçe dhe aparat për matjen e tensionit në Komisarlatin e Policisë Lezhë.
15. Marrja e masave për ndalimin e sendeve, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/ merren në pyetje, si edhe krijimin e mjediseve të posaçme për mbajtjen e provave materiale në të gjitha Komisarlatet e Policisë së përmendura më lartë.
16. Marrja e masave për plotësimin me përgjegjësi të plotë të regjistrave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/ arrestuar në të gjitha rubrikat e tyre në të gjitha Komisarlatet e Policisë së përmendura më lartë.
17. Marrja e masave të menjëhershme për zbatimin me përpikëri të ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 101, lidhur me shoqërimin e personave, me qëllim dhënien fund të praktikës së konstatuar në të gjitha Komisarlatet e inspektuara, sipas së cilës, në regjistrin e personave të shoqëruar përfshihen edhe persona të dyshuar për vepra penale.
18. Marrja e masave të menjëhershme për trajnimin e personelit në të gjitha Komisarlatet e inspektuara lidhur me zbatimin e ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, për shoqërimin e personave, si edhe me zbatimin e ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

#### **6.4. Komisarlati i Rinasit, Drejtorinë e Kufirit dhe të Emigracionit - Datë 05.06.2014 / Nr. Dok. 201401200**

Më datë 05.06.2014, FRONTEX në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Emigracionit koordinuan operacionin e riatdhesimi të shtetasve shqiptar nga vende të BE dhe shteteve të zonës Shengen. Qëllimi i këtij operacioni ishte largimi nga territori vendeve anëtare të BE dhe vendeve të zonës Shengen të shtetasve shqiptarë për të cilët është dhënë vendim për riatdhesim. MKPT ishte pjesë e grupit monitorues të këtij procesi riatdhesimi, për të ushtuar rolin e vet ligjor dhe kushtetues, në përmbushjen e Direktivës 2008/ 115/ EC të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta ndërmjet vendeve të BE dhe vendeve të treta për monitorim të pavarur nga MKPT të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës.

#### ***Shënime paraprake mbi operacionin e riatdhesimit***

Në përmbushje të misionit të tij, në këtë operacion riatdhesimi, MKPT u përfaqësua nga Drejtuesi në Detyrë, i cili kishte si detyrë funksionale monitorimin e respektimit të Kartës të Drejtave Themelore dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të cilat sigurojnë respektimin e dinjitetit njerëzor të të gjithë personave pjesëmarrës në programin e riatdhesimit.

Gjatë këtij operacioni u riatdhesuan 51 shtetas shqiptar nga Franca dhe Finlanda.

MKPT, e ftuar të marrë pjesë në monitorimin e këtij procesi u informua gjerësisht lidhur me procedurat e riatdhesimit paraprakisht nga ana FRONTEX dhe më pas nga Drejtoria e Kufirit dhe e Emigracionit.

Më datat 25-30 maj 2014, MKPT mori pjesë aktive në trajtimin “Operacionet e Përbashkëta të Kthimit” organizuar nga FRONTEX dhe Drejtoria e Kufirit dhe Emigracionit në Qendrën

Operacionale “Delta” në Vlorë. Ky trajnim ishte një praktikë e mirë informuese dhe përcaktuese në suksesin e operacionit të riadhesimit.

Monitorimi i procesit të riadhesimit është shumë i rëndësishëm për të garantuar:

- Kthimin në mënyrë njerëzore duke respektuar plotësisht të drejtat themelore
- Respektimin rigoroz të standardeve të BE-së
- Respektimin rigoroz të ligjit shqiptar
- Sigurinë dhe mbrojtjen e stafit (shoqëruesit dhe pjesëmarrësit e tjerë)

### ***Monitorimi i Procesit të riadhesimit***

Përfaqësuesi i MKPT-së udhëtoi me avion charter nga Tirana në Lilles, Francë, monitoroi procedurat e dorëzimit në Lilles si dhe gjatë fluturimit Lilles-Tiranë, procedurat dhe zbatimin e planit operacional në mbarëvajtjen e udhëtimit dhe shoqërimit të personave në bord. Dy ditë para nisjes, Departamenti i Kthimit në Drejtorinë e Kufirit dhe Emigracionit i ofroi MKPT-së gjithë informacionin e duhur lidhur me operacionin e kthimit. Takimi paraparak ishte caktuar në orën 7:00, të datës 05.06.2014 në Komisaratin e Policisë së Kufirit Rinas, me prezencën e Drejtuesit të Operacionit, Koordinatorit të Grupit të Shoqërimit, si dhe mjekut të caktuar të ndjekë operacionin. Nisja nga aeroporti i Rinasit u bë në orën 9:00, të datës 05.06.2014. Para nisjes, MKPT u informua lidhur me listën e personave që do riadhesoheshin. Lista emërore përbëhej nga 51 persona, në të cilën ishin shënuar ditëlindja dhe kombësia e tyre. Në këtë listë ishin të përfshirë 4 femra dhe 3 të mitur.

Gjatë udhëtimit Drejtuesi i Operacionit dhe Koordinatori i Grupit të Shoqërimit bënë planin e shpërndarjes dhe sigurisë sipas metodologjisë dhe rekomandimeve të FRONTX, duke i caktuar detyrat stafit të sigurisë: oficerja femër u caktua në shoqërim të shtetaseve femra; për familjet u dha porosia që të vendosen më vete; ndërsa për personat me raporte sigurie, vendosja u caktua në fund të avionit dhe me personel të dubluar.

### ***Transferimi nga autobusi, në minibus për në aeroplan***

Pati një vonesë të vogël gjatë transferimit, i cili bëhej me minibusë deri tek dera e avionit nën shoqërimin e policëve të huaj. Tek dera e avionit të riadhesuarit priteshin nga Koordinatori i Grupit të Shoqërimit dhe shoqëroheshin nga dy policë të tjerë deri në vendet përkatëse.

Të parët u shoqëruan në aeroplan shtetasit e kthyer nga Finlanda të ndjekur nga shtetasit e kthyer nga Franca. Shoqërimi nga autobusi deri tek dera e avionit bëhej pa pranga, por vetëm me një shoqërim nga krahu deri tek vendi përkatës në avion.

Procesi i imbarkimit vijoi qetësisht. E fundit u shoqërua një familje e përbërë nga 5 persona, nga të cilët 3 ishin të mitur. Ata u shoqëruan nga personeli femër dhe u ulën në vendet e para të avionit pa u ndarë. Fëmijëve iu krijua një atmosferë miqësore dhe policët qëndruan larg të qenit vizual.

Në bord ishte dhe një çift të rinjsh të cilët u ulën në ndenjësë pranë njeri-tjetrit. Ndërsa dy femrat e tjera u ulen në rreshtin e dytë të avionit, pranë të cilave qëndroi oficerja femër.

Pas sistemimit të të gjithë shtetasve në vendet e veta, u futën valixhet dhe sende të tjera personale të pasagjerëve, si dhe dokumentacioni përkatës. Më tej Drejtuesi i Operacionit dhe Koordinatori i Grupit të Shoqërimit pyetën pasagjerët nëse dikush kishte ndonjë nevojë apo ankesë. Dy persona të cilët kërkuan të shkonin në tualet, pranuan se mund të prisnin sa të nisej avioni e pastaj u shoqëruan nga policët. Gjithashtu, pasagjerëve iu komunikua se sendet personale, përfshirë dhe lekët, i janë dhënë palës shqiptare dhe se do t'i shpërndaheshin në momentin e arritjes në Shqipëri.

Procesi i imbarkimit përfundoi në orën 13:00.

Gjatë udhëtimit gjithçka shkoi mirë. Të gjithëve iu ofrua ushqim i bollshëm për drekë i shoqëruar me pije të ftohta. Personat u shoqëruan në banjë sipas kërkesave të tyre, por duke iu ruajtur privatësia.

### *Debriefing*

Më të arritur në Tiranë, në orën 16:07, u zhvillua takimi informues ku ishte i pranishëm Drejtori i Kufirit, dhe drejtues të tjerë të lartë të Policisë së Kufirit dhe Emigracionit, gjatë të cilit u theksua se operacioni u krye me sukses dhe pa probleme. Rezultatet e trajnimit ishin pozitive. U konsiderua shumë e rëndësishme prania e polices femër gjatë procesit të riatdhesimit pasi në bord të avionit kishte gra dhe fëmijë.

Për sa më sipër rekomandohet:

1. Marrja e masave që në operacione të tjera të përbashkëta të riatdhesimit të ketë një numër më të madh të stafit policor femra si pjesë e skuadrës;
2. Marrja e masave që gjatë procesit të imbarkimit dhe dorëzimit, familjet me fëmijë duhet të imbarkohen të fundit, kjo për të siguruar një prezencë më të ulët të policisë, në mënyrë që të reduktohet në maksimum presioni psikologjik që mund të krijojë tek fëmijët, prezenca e uniformave blu.
3. Marrja e masave që të sigurohet prania në bord e një psikologu apo punonjëseje sociale, ekspertë të të drejtave të fëmijëve, kur në listat e personave që do riatdhesohen të ketë edhe fëmijë.
4. Marrja e masave për përfshirjen dhe lajmërimin paraprak të MKPT-së nga ana e Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit, në të gjitha operacionet e riatdhesimit, si në rastet kur kjo drejtori është organizatori direkt, ashtu dhe në rastet e partneritetit me vendet e BE.

#### **6.5. DPQ Peshkopi dhe komisariate të varësisë:**

Komisariati i Policisë Burrel, datë 18.06.2014 / Nr. Dok. 201401259

Komisariati i Policisë Bulqizë, datë 18.06.2014 / Nr. Dok. 201401260

Komisariati i Policisë Peshkopi (DPQ), datë 18.06.2014 / Nr. Dok. 201401258

#### ***Shënime paraprake***

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, grupi i ekspertëve, u takua fillimisht me titullarët e subjekteve të lartpërmendura, për t'i komunikuar qëllimin e inspektimit. Vlen të theksohet fakti se të gjithë drejtuesit e organeve të inspektuara treguan bashkëpunim gjatë gjithë kohës që grupi ishte në inspektim.

Gjithashtu, pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i ekspertëve, mori takim privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi ambientet e shoqërimit e të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse. Më konkretisht, gjendja e përgjithshme si dhe problematikat e konstatuara në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Dibër dhe në organet e policisë në varësi të saj pasqyrohen më poshtë:

#### ***Kushtet e ambienteve të shoqërimit:***

**Në Komisarlatin e Policisë Peshkopi**, zyrtarisht ekzistonte një dhomë shoqërimi, e cila në momentin e inspektimit nuk përdorej, pasi ishte kthyer në mjedis magazinimi. Grupi i inspektimit, pas takimeve me disa prej efektivëve të këtij komisariati, kuptoi se për shkak të mos funksionimit të dhomës së shoqërimit, rolin e kësaj të fundit e kryenin dy dhoma në fillim të mjedisit të dhomave të sigurisë, në të djathtë, të cilat ndaheshin nga korridori me një derë skare hekuri. Të dy dhomat që kryenin rolin e dhomave të shoqërimit, ishin pa orendi dhe mbylleshin me derë hekuri me dry nga jashtë, tërësisht në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.

Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

Gjatë inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

**Në Komisarlatin e Policisë Bulqizë**, kishte një dhomë shoqërimi, e cila përpos derës së hyrjes në mjedis, kishte një skarë hekuri që mbyllej me dry nga jashtë. Kjo skarë e ndante dhomën në dy ambiente; dhomë dhe paradhomë. Brenda mjedisit pas skarës, kishte vetëm një stol të gjatë dhe një dhomë tjetër e errët, e cila, sipas punonjësve dhe shefit të këtij komisariati ishte jashtë funksionit. Në mjedisin e paradhomës kishte postera me të drejtat e personave të shoqëruar.

Për sa më lartë, grupi i inspektimit, bëri me dije Shefin e Komisarlatit se kjo dhomë ishte tërësisht në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e

Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.

Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

Gjatë momentit të inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

**Në Komisarariatit e Policisë Burrel**, kishte një dhomë shoqërimi, e cila ishte me derë hekuri që mbyllej nga jashtë me dry. Nuk kishte dritare dhe kishte dy mjedise njëri pas tjetrit, të dy këto të pa-pajisur me orendi. Shefi i Komisarariatit, si edhe Shefi i Rendit në këtë komisarariat, duke qenë të vetëdijshëm për mos përmbushjen e kërkesave ligjore për dhomat e shoqërimit, si mjedis për këtë të fundit, përdornin një klasë, me hapësirë dhe dritë natyrale, të pajisur me tavolina dhe karrige, e pastër dhe me postera për të drejtat e personave të shoqëruar varur në mur. Drejtuesit i bënë me dije grupit të inspektimit se kjo klasë përdorej për shoqërimin e personave, pasi edhe tualeti, sipas kërkesave ligjore, ishte pranë këtij mjedisi.

Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

Gjatë inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

#### ***Kushtet në ambientet e sigurisë:***

**Në Komisarariatit e Policisë Peshkopi**, kishte 14 dhoma sigurimi, 10 prej të cilave ishin në përdorim. Gjatë inspektimit në këto dhoma kishte 7 persona të ndaluar dhe të arrestuar. Dhomat e sigurisë ishin tërësisht në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011. Ato ishin në përmasa minimaliste, me dritare tepër të vogla për të siguruar një frymëmarrje normale, gjë që përkeqësohej edhe nga një lagështirë e theksuar si brenda, ashtu edhe jashtë dhomave. Personat e ndaluar/ arrestuar flinin në dyshekë pa krevate, tepër të vjetër, me shtroje tepër të vjetruara ku mungonin çarçafët dhe jastëkët.

Në korridorin e errët dhe me lagështirë të theksuar, ndodhej mjedisi i përbashkët i tualetit dhe dushit. Ky mjedis me dy tualete dhe një dush, karakterizohej nga amortizimi i theksuar, lagështira dhe papastërtia, të cilat e bënë tejet të vështirë funksionin që duhej të kryenin, pavarësisht se të ndaluarit/arrestuarit konfirmuan se mund të laheshin me ujë të rrjedhshëm dhe të ngrohtë sa herë që kërkonin një gjë të tillë.

Korridori i ambientit të sigurisë nuk ishte i pajisur me sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

Posterat me të drejtat ligjore të të ndaluarve dhe të arrestuarve ishin të vendosura në korridor dhe brenda dhomave, si edhe lista me emrat dhe kontaktet e avokatëve të disponueshëm.

**Në Komisarariatit e Policisë Burrel**, kishte 12 dhoma sigurie, të vendosura jashtë godinës së Komisarariatit. Pavarësisht përpjekjeve të personelit të këtij komisaritati për mbajtjen pastër të



mjedisit, u vu re një amortizim i theksuar. Dhomat ishin plotësisht jashtë standardeve: me parket të amortizuar, pa krevat, pa sistem ngrohje dhe pa banja. Gjatë ditës së inspektimit në njërin prej dhomave ndodhej një person i ndaluar, i cili flinte mbi dyshek dhe mbulohej me batanije të vjetra pa çarçafë. Në korridorin me lagështirë të tejskajshme, i cili vende-vende pikonte, ndodhej edhe mjedisi i përbashkët i tualetit dhe dushit. Ky i fundit ishte në amortizim të plotë, gjë që e bënte tejet të vështirë funksionin që duhej të kryente.

Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

Kishte postera me të drejtat ligjore të të ndaluarve dhe të arrestuarve.

### ***Trajtimi i të ndaluarve/ arrestuarve në ambientet e sigurisë:***

Të ndaluarit/ arrestuarit, në të dy komisariatet e lartpërmendura, trajtoheshin me ushqim tri herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Urdhrin e Përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë.

Në të dy komisariatet me dhoma sigurie, të ndaluarit/ arrestuarit kishin ujë të rrjedhshëm në çdo kohë që ata e kërkonin një gjë të tillë, pavarësisht se kjo ofrohej vetëm në mjediset e përbashkëta të tualeteve dhe dusheve. Për shkak edhe të lagështirës dhe problematikës që mund të shkaktonte në instalimet elektrike, uji i ngrohtë sigurohej vetëm kur kërkohej nga të ndaluarit/ arrestuarit, përndryshe, bojlerët nuk ishin në punë. Ndërkohë që në të dy komisariatet, pajisja e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjente, pasta dhe furça dhëmbësh, etj., ishte e pamjaftueshme, pothuajse inekzistente.

Në të dy institucionet e lartpërmendura mungonte literatura informuese/ didaktike/ letrare, ndonëse kjo është një e drejtë e personave të ndaluar/ arrestuar.

Në asnjërin prej komisariateve të inspektuar nuk ofrohej mundësia për ajrim në ambient të jashtëm. Mjedisi përkatës në Komisaratin e Peshkopisë ishte mbyllur për shkak të mungesës së sigurisë dhe amortizimit.

Sa i përket trajtimit mjekësor të të ndaluarve/ arrestuarve, nga informacioni që u morr nga stafi drejtues si në Komisaratin e Policisë Peshkopi, ashtu edhe në atë të Burrelit, në organikën e institucionit, nuk parashikohej pozicioni i mjekut. Në Komisaratin e Burrelit, një mungesë e tillë plotësohej, sipas nevojës, me anë të mjekut të IEVP Burrel, kurse në Komisaratin e Policisë Peshkopi, këtë rol e kryente një ndihmësmjek. Gjatë inspektimit, grupi monitorues konstatoi se vizitat për të ndaluarit/ të arrestuarit kryheshin rregullisht nga mjeku, në të dy komisariatet, i cili plotësohte më pas edhe kartelat mjekësore, sipas legjislacionit në fuqi. Ekzistonte gjithashtu, edhe një regjistër vizitash, i cili, së bashku me kartelat mbaheshin në një dollap me çelës.

Në vrojtimin e dhomës së mjekut, në Komisaratin e Burrelit, grupi i inspektimit vuri re se e njëjta dhomë përdorej si për vizitat me avokatin, prokurorin, ashtu edhe me mjekun. Rrjedhimisht, ambienti ishte i papërshtatshëm për kryerjen e vizitave, për shkak edhe të mungesës së krevatit të vizitave, dollapit për mbajtjen e medikamenteve, mungesës së ilaçeve bazë të urgjencës, si edhe të ilaçeve të tjera të domosdoshme për një shërbim efikas shëndetësor, si dhe mungonte aparati i tensionit. Nuk kishte frigorifer për mbajtjen e ilaçeve të posaçme. Në

Komisariat e Peshkopisë, dhoma e mjekut ishte e pastër, e rregullt, por e amortizuar si e gjithë ndërtesa në tërësi. Mungonte krevati i vizitave. Kishte një dollap të vjetër ku ilaçet mbaheshin me dry. Grupi i inspeksionit u informua nga nd/ mjeku i këtij institucioni se nuk kishin mungesa në ilaçe, dhe se institucioni ishte kompletuar edhe me ato të urgjencës. Megjithatë, në intervistat me të ndaluarit/ arrestuarit, ekspertët konstatuan se shërbimi mjekësor jo në çdo rast ishte prezent.

#### ***Ambientet e intervistimit:***

Në Komisaratin e Policisë Peshkopi, ashtu si edhe në Komisaratin e Policisë Burrel kishte dhoma të posaçme për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës dhe për takim me avokatët. Siç shprehet edhe më lartë, në Komisaratin e Policisë Burrel, kjo dhomë përdorej edhe nga mjeku.

Gjatë inspeksionit u këqyrën zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha Komisaritet në fjalë, por këto mjedise nuk ishin të monitoruara. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/ merren në pyetje.

Vlen të theksohet fakti se në të gjitha Komisaritet vijon problematika e mbajtjes së provave materiale nëpër zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore, e cila është pasojë e mungesës së ambienteve të veçantë për ruajtjen e provave materiale.

#### ***Monitorimi i ambienteve të shoqërimit, të sigurisë dhe hetimit:***

Sistemi i monitorimit audio-viziv përbën një ndër aspektet më të rëndësishme sa i përket parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky sistem monitorimi mungonte në të gjitha Komisaritet e Policisë që ekspertët monitoruan.

#### ***Libri i personave të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar, si edhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia:***

Në zbatim të ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur, ndër të tjera, edhe me Regjistrin për Personat e Shoqëruar dhe Regjistrin për Personat e Ndaluar/ arrestuar. Të gjitha Komisaritet e inspektuara ishin të pajisura me regjistrat e lartpërmendur, pavarësisht se të gjithë regjistrat e inspektuar ishin të pa përditësuar.

Në të gjitha regjistrat e këqyruar u vunë re problematikat e mëposhtme:

- Jo të gjitha rubrikat plotësoheshin apo plotësoheshin saktë si në Regjistrin e Personave të Shoqëruar, ashtu edhe në Regjistrin e Personave të Ndaluar/ Arrestuar.
- Në rubrikën e njoftimit të familjarëve, në pjesën më të madhe të rasteve, kishte mungesë informacioni sa i përket emrit, atësisë, mbiemrit dhe numrit të telefonit të personit të njoftuar. Në Komisaritet e Policisë së Peshkopisë dhe Bulqizës, në pothuajse asnjë rast

nuk kishte numër telefoni të personave të familjes të njoftuar për shoqërimin, kurse në Komisarlatin e Policisë Burrel, kjo rubrikë mungonte.

- Në Regjistrat e Personave të Shoqëruar, në të gjitha Komisarlatet e inspektuara, në kundërshtim me ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, arsyeja e shoqërimit përfshin kryerjen e veprës penale nga ana e shtetasit, si p.sh. vjedhje, drejtim i automjetit në gjendje të dehur, arrestim në flagrancë, i shpallur në kërkim, fyerje për shkak të detyrës, prodhim/ shitje të lëndëve narkotike, prodhim dhe armëmbajtje pa leje etj.

Gjithashtu, vlen të theksohet fakti se në Komisarlatin e Policisë Peshkopi, ishin vënë në funksion edhe 2 regjistra të tjerë, në vijim të ndryshimit të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, i cili sanksionon të drejtat e personave të ndaluar/ arrestuar si vijon:

1. E drejta e takimit me familjarët për personat e dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, deri në transferimin e tyre në IEVP;
2. E drejta e vazhdimit të trajtimit me ushqim me gji të fëmijëve nga nënat e tyre që janë në dhomat e sigurisë.

Sa i përket trajtimit të të shoqëruarve/ ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve të kryera nga policia, në Komisarlatin e Policisë Peshkopi, në intervistat e kryera me 2 të mitur të arrestuar, pati pretendim për dhunë psikologjike të OPGJ-ve të Komisarlatit të Policisë Bulqizë, ku këta të mitur ishin arrestuar, përkatësisht për punonjësit e policisë B.A., dhe A.T. Të dy këta të mitur pretendonin se ishin marrë në pyetje pa praninë e një avokati, një personi të familjes dhe/ apo të psikologut. Njëri prej tyre pretendonte në thëniet e tij se avokati, i cili kishte firmosur deklarinimin e tij, e kishte bërë këtë veprim pa qenë në dijeni të situatës, pasi kishte firmosur kur procedurat kishin mbaruar me të miturin. Ndërkohë që i mituri tjetër nuk kishte pranuar ta firmoste deklaratën.

### ***Ndihma juridike dhe psikologjike:***

Gjatë inspektimit u konstatua se në të gjitha rastet kur të ndaluarit/ arrestuarit madhorë që nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu ishte ofruar një avokat. Lista me emrat dhe kontaktet e avokatëve ishin të afishuara.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e menjëhershme në analizë të situatës së pretenduar nga dy të miturit e arrestuar, siç përshkruhet më lartë në Komisarlatin e Policisë Bulqizë, duke marrë masat administrative përkatëse ndaj personelit të përfshirë.
2. Mbyllja e menjëhershme të dhomave të sigurisë në Komisarlatin e Policisë Burrel dhe Peshkopi, pasi qëndrimi i shtetasve në këto kushte, përbën trajtim degradues, si edhe cenon dinjitetin e çdo personi që mbahet në këto ambiente.
3. Marrja e masave të menjëhershme për ndërtimin apo rikonstruksionin e dhomave të shoqërimit në të gjitha Komisarlatet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Marrja e masave për ndërtimin e tualeteve për dhomat e shoqërimit në Komisaritet e inspektuara, sipas parashikimit dhe parametrave të legjislacionit në fuqi.
5. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit në të gjitha Komisaritet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
6. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret ku ndodhen dhomat e ndalim/ arrestimit në të gjitha Komisaritet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
7. Marrja e masave për pajisjen e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale nga Komisaritet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
8. Marrja e masave për krijimin e dhomës së mjekut në Komisaritin e Policisë Burrel, sipas kritereve të përcaktuara ligjore.
9. Marrja e masave për përmirësimin e kushteve të dhomës së mjekut në Komisaritin e Policisë Peshkopi, sipas kritereve të përcaktuara ligjore.
10. Marrja e masave për furnizimin me ilaçe dhe aparat për matjen e tensionit në Komisaritet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
11. Marrja e masave për përditësimin e regjistrave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/ arrestuar në të gjitha Komisaritet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
12. Marrja e masave për plotësimin me përgjegjësi të plotë të regjistrave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/ arrestuar në të gjitha rubrikat e tyre në të gjitha Komisaritet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
13. Marrja e masave të menjëhershme për zbatimin me përpikëri të ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 101, lidhur me shoqërimin e personave, me qëllim dhënie fund të praktikës së konstatuar në të gjitha Komisaritet e inspektuara, sipas së cilës, në regjistrin e personave të shoqëruar përfshihen edhe persona të dyshuar për vepra penale.
14. Marrja e masave të menjëhershme për trajnimin e personelit në të gjitha Komisaritet e inspektuara lidhur me zbatimin e ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, për shoqërimin e personave, si edhe me zbatimin e ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

#### **6.6. DPQ Kukës dhe komisaritate të varësisë:**

Komisariati i Policisë Krumë, datë 19.06.2014 / Nr. Dok. 201401261

Komisariati i Policisë Kukës (DPQ), datë 19.06.2014 / Nr. Dok. 201401262

Komisariati i Policisë Tropojë, datë 20.06.2014 / Nr. Dok. 201401263

#### ***Shënime paraprake***

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, grupi i ekspertëve, në secilin prej subjekteve të lartpërmendura, u takua fillimisht me titullarin e institucionit, për t'i komunikuar qëllimin e inspektimit. Vlen të theksohet fakti se të gjithë drejtuesit e institucioneve të inspektuara treguan bashkëpunim gjatë gjithë kohës që grupi ishte në inspektim, pavarësisht se në një rast, ekspertëve iu kërkua autorizim nga Avokati i Popullit për të kryer detyrën ligjore në zbatimin të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Gjithashtu, pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i ekspertëve, mori takim privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi ambientet e shoqërimit e të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse. Më konkretisht, gjendja e përgjithshme si dhe problematikat e konstatuara në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Kukës dhe në organet e policisë në varësi të saj pasqyrohen më poshtë:

***Kushtet e ambienteve të shoqërimit:***

**Në Komisarlatin e Policisë Kukës**, kishte 2 dhoma shoqërimi, të paetiketuara si të tilla, ndërkohë që sipas legjislacionit në fuqi, duhet të jenë 3 dhoma të etiketuara për të mitur, të rritur dhe femra. Të dy dhomat e shoqërimit nuk ishin të pastra, por kishin hapësirë, dritë natyrale dhe artificiale të mjaftueshme, dhe dritare dhe dyer sipas parametrave ligjorë. Kishin orenditë e nevojshme si tavolinë dhe karrige, por posterat e vendosur brenda këtyre ambienteve ishin të vjetër.

Kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

Gjatë momentit të inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Vlen të theksohet fakti se punonjësit e këtij komisarlati shprehën shqetësimin e tyre lidhur me vendosjen e dhomave të shoqërimit në të njëjtin korridor me ashtuquajturat “dhomat e përgjimit” dhe ato të njohjes.

**Në Komisarlatin e Policisë Krumë**, nuk kishte dhoma shoqërimi. Megjithatë, shefi i këtij Komisarlati, informoi grupin inspektues se, duke parë nevojën për këto dhoma, ai kishte marrë iniciativën e përshtatjes së një pjese të mjedisit të këtij komisarlati në dy dhoma shoqërimi, pranë të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, ndodhej edhe tualeti. Në momentin e inspektimit, dhomat ishin ende të papërfunduara.

Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

Gjatë inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

**Në Komisarlatin e Policisë Tropojë**, nuk kishte dhoma shoqërimi. Një mungesë kjo, që ndjehej si nga stafi i këtij komisarlati, ashtu sikurse u vu në dukje edhe nga ekspertët e grupit të inspektimit.

Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi në mjediset e brendshme të komisarlatit. Ky sistem ishte vetëm në mjediset e jashtme.

Gjatë momentit të inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

### ***Kushtet në ambientet e sigurisë:***

**Në Komisariatin e Policisë Kukës**, kishte 6 dhoma sigurie, 4 prej të cilave ishin për të rritur, një për të mitur dhe një për femra. Dhomat e sigurisë ishin tërësisht në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011. Problematika e vënë në dukje nga ekspertët e grupit të inspektimit lidhur me dhomat e sigurisë ishte mbyllja e derës së paradhomë-dhomës prej skare hekuri me dry nga jashtë, në kundërshtim me bazën ligjore të shprehur më lartë, për të cilën ekspertët e MKPT-së bënë me dije edhe drejtuesit e këtij komisarati.

Në korridorin e dhomave të sigurisë, sipas standardeve ligjore, ndodhej edhe mjedisi i përbashkët i dushit. Ky mjedis me një tualet, një dush dhe një lavaman me çezmë me ujë të rrjedhshëm ishte i pastër dhe i mirëmbajtur.

Gjatë inspektimit, në dhomat e sigurisë ndodheshin 5 persona të ndaluar/ arrestuar.

Korridorin e ambientit të dhomave të sigurisë ishte i pajisur me sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

Posterat me të drejtat ligjore të të ndaluarve dhe të arrestuarve ishin të vendosura në korridor dhe brenda dhomave, si edhe lista me emrat dhe kontaktet e avokatëve të disponueshëm ishte gjithashtu i afishuar.

**Në Komisariatin e Policisë Tropojë**, nga Shefi i Rendit të këtij komisarati, grupit i inspektimit iu bë me dije se ky komisarati kishte 3 dhoma sigurie, të cilat në bazë të një marrëveshjeje me IEVP Tropojë, ndodheshin në mjediset e këtij të fundit. Ekspertët u informuan se në këtë IEVP, përkrah efektivëve të policisë së burgjeve, ishin edhe efektivët e Policisë së Shtetit. Një fakt i tillë nuk u konstatua nga ekspertët gjatë monitorimit në IEVP Tropojë, institucion i monitoruar në të njëjtën ditë nga i njëjti grup monitorimi. Megjithatë, ekspertët kërkuan kopje të marrëveshjes së përmendur nga ana e Shefit të Rendit të Komisariatit të Policisë Tropojë, e cila u vu menjëherë në dispozicion të grupit të inspektimit. Akt-Marrëveshja mes Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë “Mbi kalimin e ambienteve të paraburgimit dhe ndihmëse në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, nr. 5740, datë 03.10.2007, dhe më pas akt-marrëveshja e nënshkruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në zbatim të akt-marrëveshjes së sipër-cituar mes dy Ministrive, nr. 1414, datë 01.09.2007, përcakton se mjediset e kaluara në vartësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë:

1. Godina e Repartit të Policisë së Rendit 2 katesh me të gjitha ambientet e saj;
2. Sheshi para godinës (lulishtja e pasme);
3. Sipërfaqja sipër godinës, deri para Stacionit të PMNZSH Tropojë;
4. Ambientet e kuzhinës së policisë.

Në asnjërën prej akt-marrëveshjeve nuk bëhej fjalë për situatën e bashkë-administrimit të dhomave të sigurisë së Komisarariatit të Policisë Tropojë brenda mjediseve të IEVP Tropojë. Për më tepër, një fakt i tillë nuk iu bë me dije ekspertëve as gjatë takimit me drejtuesit e IEVP Tropojë.

Në mjediset e brendshme të këtij komisaritati nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi. Ai ishte vetëm për mjedisin e jashtëm.

#### ***Trajtimi i të ndaluarve/ arrestuarve në ambientet e sigurisë:***

Të ndaluarit/ arrestuarit, në të dy komisarariatet e lartpërmendura, trajtoheshin me ushqim tri herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Urdhrin e Përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Të dy komisarariatet, si në Kukës, ashtu edhe në Tropojë, bënë me dije grupin e monitorimit se ushqimi ofrohej nga kuzhinat e IEVP-ve përkatëse. Grupi i inspektimit u informua më tej se ushqimi për personat e ndaluar/ arrestuar mbështetej financiarisht nga buxheti i Komisariateve për llogari të të cilëve gatuhej.

Në Komisariatin e Policisë Kukës, të ndaluarit/ arrestuarit kishin ujë të rrjedhshëm edhe mund të bënin dush në çdo kohë. Ndërkohë që pajisja e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjentë, pasta dhe furça dhëmbësh, etj., ishte e pamjaftueshme.

Në të dy institucionet e lartpërmendura mungonte literatura informuese/ didaktike/ letrare, ndonëse kjo është një e drejtë e personave të ndaluar/ arrestuar.

Në këtë komisarariat nuk ofrohej mundësia për ajrim në ambient të jashtëm.

Sa i përket trajtimit mjekësor të të ndaluarve/ arrestuarve, nga informacioni që morëm nga stafi drejtues i Komisarariatit të Policisë Kukës, në organikën e institucionit, nuk parashikohej pozicioni i mjekut dhe se rolin e psikologut e kryente një jurist. Në rolin e mjekut ishte një ndihmësmjek. Gjatë inspektimit, grupi monitorues konstatoi se vizitat për të ndaluarit/ arrestuarit kryheshin rregullisht nga ndihmësmjeku, i cili plotësonte më pas edhe kartelat mjekësore, sipas legjislacionit në fuqi. Ekzistonte gjithashtu, edhe një regjistër vizitash, i cili, së bashku me kartelat mbaheshin në një dollap me çelës.

Në vrojtimin e dhomës së mjekut, në Komisariatin e Policisë Kukës, grupi i inspektimit vuri re se ambienti ishte i përshtatshëm për kryerjen e vizitave, ishte i pastër, i rregullt, kishte dollap për medikamentet, dhe ekspertët u bënë me dije se këto të fundit, përfshirë këtu edhe medikamentet e urgjencës, nuk mungonin.

#### ***Ambientet e intervistimit:***

Në Komisariatin e Policisë Kukës, ku gjendeshin dhoma sigurie, kishte dhoma të posaçme për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës dhe për takim me avokatët.

Gjatë inspektimit u këqyrën zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha Komisaritet e inspektuara si më lartë, por në këto mjedise nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/ merren në pyetje.

Vlen të theksohet fakti se në të gjitha Komisaritet vijon problematika e mbajtjes së provave materiale nëpër zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore, e cila është pasojë e mungesës së ambienteve të veçantë për ruajtjen e provave materiale.

### ***Monitorimi i ambienteve të shoqërimit, të sigurisë dhe hetimit:***

Sistemi i monitorimit audio-viziv përbën një ndër aspektet më të rëndësishme sa i përket parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky sistem monitorimi, përveçse në mjediset e Komisaritetit të Policisë Kukës, mungonte në të gjitha Komisaritet e tjera të Policisë që ekspertët monitoruan.

### ***Libri i personave të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar, si edhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia:***

Në zbatim të Ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur, ndër të tjera, edhe me Regjistrin për Personat e Shoqëruar dhe Regjistrin për Personat e Ndaluar/ arrestuar. Të gjitha Komisaritet e inspektuara ishin të pajisura me regjistrat e lartpërmendur, pavarësisht se të gjithë regjistrat e inspektuar ishin të pa përditësuar.

Në të gjitha regjistrat e këqyruar u vunë re problematikat e mëposhtme:

- Jo të gjitha rubrikat plotësoheshin apo plotësoheshin saktë si në Regjistrin e Personave të Shoqëruar, ashtu edhe në Regjistrin e Personave të Ndaluar/ Arrestuar.
- Në Komisaritetin e Policisë Tropojë, regjistri i personave të ndaluar/ arrestuar ishte tepër i vjetër, gjë që vërtetohej edhe nga emërtimi “regjistri themeltar i të paraburgosurve”. Gjithashtu, grupi i ekspertëve konstatoi 2 regjistra të personave të shoqëruar, njëri i sekretuar dhe tjetri jo. Për këtë të fundit u morën masa të menjëhershme për eliminimin e tij.
- Në rubrikën e njoftimit të familjarëve, në pjesën më të madhe të rasteve, ka mungesë informacioni sa i përket emrit, atësisë, mbiemrit dhe numrit të telefonit të personit të njoftuar.
- Në disa raste, rubrika e arsyes së shoqërimit ishte e paplotësuar.
- Komisariteti i Policisë Tropojë kishte mungesa të theksuara në regjistrat që duhet të mbajë një komisaritet, veçanërisht ku ka dhoma sigurie, bazuar në manualin e miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.
- Në Regjistrat e Personave të Shoqëruar, në të gjitha Komisaritet e inspektuara, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, arsyeja e shoqërimit përfshin kryerjen e veprës penale nga ana e shtetasit, si p.sh. vjedhje, drejtim i automjetit në gjendje të dehur/ pa patentë, person i shpallur në kërkim, aksident me



pasoja, prodhim/ shitje të lëndëve narkotike, dhunë në familje, konflikt me persona të tjerë, prishje e rendit dhe qetësisë publike etj.

Gjithashtu, vlen të theksohet fakti se, në vijim të ndryshimit të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, i cili sanksionon të drejtat e personave të ndaluar/ arrestuar si vijon:

1. E drejta e takimit me familjarët për personat e dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, deri në transferimin e tyre në IEVP;
2. E drejta e vazhimit të trajtimit me ushqim me gji të fëmijëve nga nënat e tyre që janë në dhomat e sigurisë,

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka urdhëruar të gjitha strukturat e saj mbi përdorimin e 2 regjistrave të tjerë për të dokumentuar sanksionimet e lartpërmendura. Pavarësisht se ky urdhër ishte marrë nga Komisaritet e Policisë të inspektuara, regjistrat në fjalë nuk ishin vënë në përdorim nga të gjitha komisaritet.

#### ***Ndihma juridike dhe psikologjike:***

Gjatë inspektimit u konstatua se në të gjitha rastet kur të ndaluarit/ arrestuarit madhorë që nuk kanë mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat dhe kërkojnë ndihmë juridike, atyre iu ishte ofruar një avokat. Lista me emrat dhe kontaktet e avokatëve që pajtohen kryesisht ishin të afishuara.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për heqjen e drynit që mbyll nga jashtë dyert prej skare hekuri të paradhomë-dhomave të sigurisë sipas legjislacionit në fuqi në Komisaritetin e Policisë Kukës.
2. Marrja e masave për krijim e dhomës së tretë të shoqërimit dhe etiketimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi në Komisaritetin e Policisë Kukës.
3. Marrja e masave për përfundimin e dhomave të shoqërimit dhe pajisjen e tyre sipas legjislacionit në fuqi në Komisaritetin e Policisë Krumë.
4. Marrja e masave për krijimin e dhomave të shoqërimit në përputhje me legjislacionin në fuqi në Komisaritetin e Policisë Tropojë.
5. Marrja e masave për eliminimin e problematikës së vendndodhjes së dhomave të shoqërimit pranë dhomave të përgjimit dhe njohjes në Komisaritetin e Policisë Kukës.
6. Marrja e masave për parashikimin e pozicionit të mjekut dhe psikologut në organikën e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Kukës.
7. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit në të gjitha Komisaritetet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së, ku ky sistem mungon.
8. Marrja e masave të menjëhershme për krijim e dhomave të ndalim/ arrestimit në Komisaritetin e Policisë Tropojë dhe interpretimin e saktë të akt-marrëveshjeve të sipërcituara.
9. Marrja e masave për pajisjen e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale nga Komisariteti i Policisë Kukës, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Marrja e masave për përditësimin e regjistrave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në të gjitha Komisariatet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
11. Marrja e masave për vënien në funksion të 2 regjistrave për të dokumentuar sanksionimin e të drejtës së takimit me familjarët për personat e dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, deri në transferimin e tyre në IEVP, dhe të drejtës së vazhimit të trajtimit me ushqim me gji të fëmijëve nga nënat e tyre që janë në dhomat e sigurisë në të gjitha Komisariatet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
12. Marrja e masave për plotësimin me të gjithë regjistrat e duhur sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011 në Komisaratin e Policisë Tropojë.
13. Marrja e masave për plotësimin me përgjegjësi të plotë të regjistrave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në të gjitha rubrikat e tyre në të gjitha Komisariatet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
14. Marrja e masave të menjëhershme për zbatimin me përpikëri të Ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 101, lidhur me shoqërimin e personave, me qëllim dhënien fund të praktikës së konstatuar në të gjitha Komisariatet e inspektuara, sipas së cilës, në regjistrin e personave të shoqëruar përfshihen edhe persona të dyshuar për vepra penale.
15. Marrja e masave të menjëhershme për trajnimin e personelit në të gjitha Komisariatet e inspektuara lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, për shoqërimin e personave, si edhe me zbatimin e ligjit nr. Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

#### **6.7. DPQ Berat dhe komisariate të varësisë:**

Komisariati i Policisë Kuçovë, datë 13.10.2014 / Nr. Dok. 201401924

Komisariati i Policisë Çorovodë, datë 13.10.2014 / Nr. Dok. 201401925

Komisariati i Policisë Berat (DPQ), datë 14.10.2014 / Nr. Dok. 201401926

#### ***Shënime paraprake***

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, grupi i autorizuar nga Avokati i Popullit, në secilin prej subjekteve të lartpërmendura, u takua fillimisht me titullarin e organit, ose me personin e autorizuar nga titullari për t’i komunikuar qëllimin e inspektimit.

Vlen të theksohet fakti se jo në të gjitha rastet drejtuesit e organeve të inspektuara treguan bashkëpunim gjatë kohës që grupi ishte në inspektim, në zbatim të ligjit nr. Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Gjithashtu, pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, mori takim privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi ambientet e shoqërimin e të sigurisë dhe zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse. Më konkretisht, gjendja e përgjithshme si dhe problematikat e konstatuara në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Berat dhe në organet e policisë në varësi të saj pasqyrohen më poshtë:

### ***Kushtet në ambientet e shoqërimit***

**Në Komisarariatit e Policisë Berat**, kishte 2 dhoma shoqërimit jashtë mjediseve të komisarariatit, pikërisht në hyrje të tij, të etiketuara një dhomë për të mitur dhe një dhomë për të rritur. Përmasat e dhomave ishin 3x4 m, të pajisura me tavolina dhe me karrige, sipas standardeve. Kishte dritare të pajisura me skarë dhe rrjetë hekuri, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Të tri dhomat kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Posterat ishin të pranishëm. Dyert ishin prej druri sipas standardeve. Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

**Në Komisarariatit e Policisë Kuçovë**, brenda mjediseve të komisarariatit kishte 1 dhomë shoqërimit. Në ditën e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Dhoma e shoqërimit ishte e pastër, e pajisur me tavolinë dhe karrige, me përmasa 4x3 m, me dritare me përmasa që siguronin ndriçim të nevojshëm natyral, ku mungonin xhamat e dritareve. Për këtë të fundit, Shefi i Komisarariatit informoi grupin e inspektimit se dritarja do të vendosej shumë shpejt, pasi ishte porositur. Dhoma kishte ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dera e dhomës të shoqërimit ishin prej druri, sipas standardeve të miratuara. Në fund të korridorit kishte një tualet funksional. Në dhoma, sikurse edhe në korridor, ishin afishuar postera me të drejtat e personave të shoqëruar. Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

**Në Komisarariatit e Policisë Çorovodë**, brenda mjediseve të komisarariatit kishte 1 dhomë shoqërimit, e cila ishte relativisht e pastër, me dritare që siguronte dritë natyrale të nevojshme. Dhoma kishte ndriçim artificial nga rrjeti elektrik dhe ishte e pajisur me karrige dhe tavolinë. Dera ishte prej druri sipas standardeve. Tualeti ndodhej në afërsi të dhomës së shoqërimit, pranë dhomave të sigurisë, të cilat, sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe nga vetë personeli i Komisarariatit, duhet të ishin të mbyllura. Në dhomën e shoqërimit kishte të afishuar postera me të drejtat e personave të shoqëruar. Në kohën e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

### ***Kushtet në ambientet e sigurisë***

**Komisariati i Policisë Berat** kishte 2 dhoma sigurimi, të cilat në bazë të marrëveshjes së lidhur mes Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë të vitit 2012 “Për mbajtjen dhe trajtimin e përkohshëm të arrestuarve/ ndaluarve të komisariateve të policisë Berat, Sarandë dhe Tropojë në ambientet e IEVP, të Ministrisë së Drejtësisë”, ishin brenda mjediseve të IEVP-së. Në momentin e inspektimit në të dy dhomat sigurisë të lokalizuara në fund të korridorit të dhomave të IEVPS-së, ndodheshin 7 persona, përkatësisht 4 në një dhomë dhe 3 në dhomën tjetër. Ashtu si edhe në të gjithë mjedisin e IEVP-së, edhe 2 dhomat e sigurisë ishin të vogla për të akomoduar 4 persona, pa dritë natyrale, pa mundësi ajrimi, me shtroje tepër të vjetra dhe shtretër të amortizuar. Në dhoma kishin një tavolinë dhe 3 ose 4 karrige duke bërë kështu që mjedisi të mos lejonte lëvizjen e lirshme të personave brenda në dhomë. Nuk kishte sistem ngrohjeje.

Korridorin e ambientit të IEVP-së, i cili përfshinte edhe 2 dhomat e sigurisë, ishte tejet i amortizuar me tela të rrymës elektrike të ekspozuara, të cilat përbënin rrezikshmëri të lartë. Kishte kamera vëzhgimi.

Të ndaluarit/ arrestuarit mund të përdornin tualetet dhe dushet e përbashkëta ashtu sikurse edhe të paraburgosurit. Grupi i inspektimit konstatoi se për të gjithë personat në IEVP, duke përfshirë këtu edhe 2 dhomat e sigurisë kishte vetëm 2 tualete, të cilat ishin tejet të amortizuara dhe dushi bëhej me grafik në 2 dushet e përbashkëta ku lagështira ishte në ekstremitet.

Qëndrimi i shtetasve në këto kushte, përveçse është në kundërshtim të plotë me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, por përbën trajtim degradues, si edhe cenon dinjitetin e çdo personi që shoqërohet në këto ambiente.

**Në Komisarlatin e Policisë Çorovodë dhe Kuçovë**, sipas informacionit të marrë si nga DPPSH, ashtu edhe nga vetë drejtuesit e këtyre Komisariateve, me të cilët grupi i inspektimit mori takim, dhomat e sigurisë duhet të ishin mbyllur e të mos përdreshin. Megjithatë, në të dy rastet, grupi i inspektimit vuri re se këto dhoma nuk ishin të mbyllura dhe të vulosura për të treguar mospërdorimin e tyre, por në momentin e inspektimit u gjetën të hapura. Në të dy Komisarlatet grupi i inspektimit u bë me dije se këto dhoma nuk përdreshin dhe ishin të hapura për shkak të ajrosjes. Megjithatë, veçanërisht në Komisarlatin e Policisë Çorovodë, grupi i inspektimit pati dyshimin që këto dhoma ishin përdorur së fundmi prej personelit të këtij Komisarlati.

#### ***Trajtimi i të ndaluarve/ arrestuarve në ambientet e sigurisë***

Të ndaluarit/ arrestuarit trajtoheshin me ushqim tri herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Urdhrin e Përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi ofrohej nga kuzhina e IEVP-së së Beratit.

Të ndaluarit/ arrestuarit në dhomat e sigurisë brenda IEVP Berat, pavarësisht kushteve tepër të këqija si në tualetet, ashtu edhe në dushet e përbashkëta, kishin ujë të rrjedhshëm dhe të ngrohtë në çdo kohë. Ndërkohë që pajisja e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjente, pasta dhe furça dhëmbësh, etj., ishte e pamjaftueshme, pothuajse inekzistente.

Grupi i inspektimit, siç u informua nga personeli, por edhe nga personat e intervistuar gjatë inspektimit, vuri re se mungonte literatura informuese/ didaktike/ letrare, ndonëse kjo është një e drejtë e personave të ndaluar/ arrestuar. Të ndaluarve/ arrestuarve u ofrohej mundësia për ajrim në ambient të jashtëm, megjithatë, nga intervistat e bëra, grupi i inspektimit konstatoi se kjo gjë nuk ndodhte.

Sa i përket trajtimit mjekësor të të ndaluarve/ arrestuarve, grupi i inspektimit konstatoi se mjeku i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Berat e kryente me vështirësi detyrën e tij, për shkak edhe të mospasjes së mjediseve të përshtatshme për vizita. Nga këqyrja e dokumentacionit të mjekut të këtij institucioni u konstatua se nuk kishte një regjistër vizitash, ndërkohë që kartelat e personave të ndaluar/ arrestuar ishin të plotësuar me rregull. Gjithashtu u vu re se mangësi kishte edhe në medikamente kryesisht ato të urgjencës, ndërkohë që për rastet me sëmundje kronike kishte pretendime nga të ndaluar/ arrestuar, se ato i siguronin vetëm nga familja.

Grupi i inspektimit konstatoi se regjistrat që duhet të mbaheshin nga Komisarati i Policisë Berat, lidhur me mjediset e sigurisë, bazuar edhe në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, nuk mbaheshin në të njëjtin mjedis të mbyllur me kyç. Kjo iu bë me dije edhe Shefit të Komisariatit, si edhe përgjegjëses së dhomave të sigurisë. Megjithatë, të gjitha regjistrat, ishin hapur dhe të plotësuar me rregull, sipas edhe urdhrin të lartpërmendur.

Gjatë inspektimit, në intervistat e bëra me personat e ndaluar/ arrestuar, grupi i inspektimit u bë me dije se pavarësisht se kishin kaluar më shumë se 24 orë në mjediset e sigurisë, 4 prej 7 personave nuk kishin marrë takim me askënd, përfshirë këtu edhe mjekun, avokatin apo edhe OPGJ. Një gjë e tillë u vërtetua edhe nga regjistrat përkatës.

Gjithashtu, gjatë inspektimit, në Komisaratin e Policisë Çorovodë, grupi i inspektimit konstatoi se personave të shoqëruar u hiqeshin sendet personale, përfshirë këtu edhe celularin, në kundërshtim të plotë me legjislacionin në fuqi.

Korridori i ambientit të dhomave të sigurisë ishte i pajisur me sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

### ***Ambientet e intervistimit***

Në mjediset e I EVP Berat, ku ndodheshin edhe dhomat e sigurisë së Komisariatit të Policisë Berat, kishte 2 dhoma, të cilat përdorreshin si për takimin me familjarët, ashtu edhe për takimin me avokatët dhe për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës, gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.

Gjatë inspektimit u këqyrën të gjitha zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha Komisaritet në fjalë, por këto mjedise nuk ishin të monitoruara. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/ merren në pyetje, megjithatë, u gjendën prova materiale, të cilat ndodheshin aty për shkak të mungesës së mjediseve të magazinimit.

### ***Monitorimi i ambienteve të shoqërimit, të sigurisë dhe hetimit***

Sistemi i monitorimit audio-viziv përbën një ndër aspektet më të rëndësishme sa i përket parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky sistem monitorimi me kamera vëzhgimi mungonte në të gjitha Komisaritet e vëzhguara nga grupi i inspektimit.

### ***Libri i personave të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar, si edhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia***

Në zbatim të Ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur, ndër të tjera, edhe me Regjistrin për Personat e Shoqëruar dhe Regjistrin për Personat e Ndaluar/ arrestuar. Të gjitha Komisaritet e inspektuara ishin të pajisura me regjistrat e lartpërmendur, përveç Komisaritetit të Çorovodës, i cili nuk kishte regjistër për personat e ndaluar/ arrestuar. Si Komisariteti i Kuçovës, ashtu edhe ai i Beratit nuk kishin të përditësuar regjistrin për evidentimin e personave të ndaluar/ arrestuar.

Në kundërshtim të plotë me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 4577/ 1 prot., datë 18.09.2014 “Tërheqje vëmendje për shoqërimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e Policisë së Shtetit”, në të gjitha regjistrat e këqyruar u vunë re problematikat e mëposhtme:

- Jo të gjitha rubrikat plotësohen apo plotësohen saktë. Në rubrikën e njoftimit të familjarëve, në pjesën më të madhe të rasteve, ka mungesë informacioni sa i përket emrit, atësisë, mbiemrit dhe numrit të telefonit të personit të njoftuar.
  - Në Komisaritetin e Policisë Kuçovë, zërat që kanë të bëjnë me njoftimin e familjarëve të personit të shoqëruar ishin pothuajse në çdo rast të paplotësuar. Në një rast nuk ishte plotësuar orari i largimit dhe në një tjetër emri i OPGJ-së.
  - Në Komisaritetin e Policisë Çorovodë, zëri që ka të bëjë me numrin e telefonit të personit të lajmëruar nga personi i shoqëruar ose nuk ekziston, ose është numri i vetë personit të shoqëruar.
  - E njëjta problematikë vlen edhe për Komisaritetin e Policisë Berat.
- Në rubrikën e arsyes së shoqërimit, kjo e fundit përfshin pothuajse në çdo rast kryerjen e veprës penale nga ana e shtetasit të shoqëruar, si p.sh. vjedhje, drejtim i automjetit në gjendje të dehur/ pa patentë, person i shpallur në kërkim, prodhim/ shitje të lëndëve narkotike, dhunë në familje, konflikt me persona të tjerë, prishje e rendit dhe qetësisë publike etj. Në çdo rast, në të tre Komisaritetet e inspektuara, personat përgjegjës për këto regjistra, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe me tërheqjen e vëmendjes nga DPPSH, pranojnë se personat vijnë si të shoqëruar dhe gjatë qëndrimit të tyre në mjediset e Komisaritetit, OPGJ-të përkatëse plotësojnë dokumentacionin e duhur për të bërë ndalimin/ arrestimin e tij/ saj.
- Grupi i inspektimit konstatoi se në disa raste, personat e shoqëruar janë ndaluar/ arrestuar në kufijtë e afatit ligjor prej 10 orësh.

### ***Ndihma juridike dhe psikologjike***

Gjatë inspektimit, ekspertët u bënë me dije nga stafi i Komisaritateve të inspektuara se detyrimi ligjor për të njoftuar personin e ndaluar/ arrestuar madhorë që nëse nuk kanë mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat dhe kërkojnë ndihmë juridike, atyre iu ofrohet një avokat kryesisht, në çdo rast përmbushej. Megjithatë, lista me emrat dhe kontaktet e avokatëve nuk ishin të afishuara.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për hapjen e dhomave të shoqërimit në Komisaritet e Policisë, Berat, Kuçovë dhe Çorovodë sipas kërkesave të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze dhe të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
2. Marrja e masave për mbylljen dhe vulosjen e dhomave të sigurisë në Komisaritet e Policisë Kuçovë dhe Çorovodë.
3. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit të Komisariateve të Policisë Berat, Kuçovë dhe Çorovodë.
4. Marrja e masave të menjëhershme për mbylljen e dhomave të sigurisë brenda I EVP Berat, pasi qëndrimi i shtetasve në këtë ambient është degradues dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.
5. Marrja e masave për pajisjen e dhomës së mjekut në Komisaritin e Policisë Berat, sipas kritereve të përcaktuara në Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.
6. Marrja e masave për pajisjen e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale në Komisaritin e Policisë së Beratit.
7. Marrja e masave për përditësimin e regjistrave të personave të ndaluar/ arrestuar në të gjitha Komisaritet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
8. Marrja e masave për plotësimin me përgjegjësi të plotë të regjistrave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/ arrestuar në të gjitha rubrikat e tyre në të gjitha Komisaritet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
9. Marrja e masave për zbatimin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, lidhur me mbajtjen e regjistrave të dhomave të sigurisë në një mjedis të vetëm të mbyllur me kyç.
10. Marrja e masave të menjëhershme për zbatimin me përpikëri të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 4577/ 1 prot., datë 18.09.2014 “Tërheqje vëmendje për shoqërimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e Policisë së Shtetit” sa i takon institutit të shoqërimit të personave.
11. Marrja e masave të menjëhershme për trajnimin e personelit në të gjitha Komisaritet e inspektuara lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, për shoqërimin e personave, si edhe me zbatimin e Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.
12. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e mjekut me një regjistër vizitash të sekretuar, e cila duhet plotësuar për të gjitha vizitat që mjeku kryen në këtë institucion.

#### **6.8. DPQ Gjirokastër dhe komisariate të varësisë:**

Komisariati i Policisë Tepelenë, datë 10.11.2014 / Nr. Dok. 201402159

Komisariati i Policisë Përmet, datë 10.11.2014 / Nr. Dok. 201402160

Komisariati i Policisë Gjirokastër (DPQ), datë 11.11.2014 / Nr. Dok. 201402161

#### ***Shënime paraprake***

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, grupi i autorizuar nga Avokati i Popullit, në secilin prej subjekteve të lartpërmendura, u takua fillimisht me titullarin e organit, ose me personin e autorizuar nga titullari, për t'i komunikuar qëllimin e inspektimit.

Vlen të theksohet fakti se në të gjitha rastet drejtuesit e organeve të inspektuara treguan bashkëpunim gjatë kohës që grupi ishte në inspektim, në zbatim të ligjit nr. Nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Gjithashtu, pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, mori takim privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi ambientet e shoqërimit e të sigurisë dhe zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse. Më konkretisht, gjendja e përgjithshme si dhe problematikat e konstatuara në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastër dhe në organet e policisë në varësi të saj pasqyrohen më poshtë:

#### ***Kushtet e ambienteve të shoqërimit:***

**Në Komisariatin e Policisë Tepelenë**, kishte 3 dhoma shoqërimi jashtë mjediseve të komisarariatit, pikërisht në hyrje të tij, të etiketuara si një dhomë për të mitur, një dhomë për femra dhe një dhomë për të rritur. Përmasat e dhomave ishin 4x4 m, të pajisura me tavolina, por pa karrige, përveç dhomës për femra, e cila kishte edhe tavolinë, edhe karrige. Kishte dritare të pajisura me rrjetë hekuri, përmasat e të cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Të tri dhomat kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Posterat ishin të pranishëm. Dyert në dhomat për femrat dhe të miturit ishin prej druri, por mbylleshin nga jashtë me shul. Kurse dera e dhomës për të rritur ishte nga ana e jashtme prej druri dhe nga pjesa brenda dhomës prej hekuri. Nga jashtë edhe kjo derë mbyllej me shul dhe kishte edhe një dritare të vogël sipër shulit. Të tri dhomat ishin në kushte jo të mira higjieno-sanitare. Tualeti nuk gjendej pranë mjediseve të dhomave të shoqërimit, por në një distancë të largët me to.

Në momentin e inspektimit kishte 2 persona të shoqëruar. Grupi i inspektimit mori kontakt me personat në privatësi dhe u informua se njërit prej tyre i ishte bërë kontroll dhe i ishte marrë celulari, si edhe sendet e tjera personale. Ai, gjithashtu, pohoi se ishte sjellë në mjediset e shoqërimit me pranga dhe se nuk kishte njoftuar personat e familjes. Grupi i inspektimit kërkoi shpjegime lidhur me rastin në fjalë dhe shkeljen e bërë lidhur me sekuestrimin e sendeve private, si edhe me shoqërimin në pranga të personit, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, dhe u informua nga Shefi i Komisarariatit se personi i shoqëruar është marrë në këtë cilësi, pasi në mëngjesin e ditës së inspektimit në një fshat të Tepelenës kishte ndodhur një ngjarje e rëndë dhe personat e shoqëruar ishin marrë në cilësinë e personave që kanë njohuri mbi rrethanat e ngjarjes.



Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

**Në Komisariatin e Policisë Përmet**, brenda mjediseve të komisarariatit kishte 3 dhoma shoqërimi të etiketuara si një dhomë për të mitur, një dhomë për femra dhe një dhomë për të rritur. Dhomat e shoqërimit ishin të pastra, të pajisura me tavolinë dhe karrige, me përmasa 4x4 m, me dritare me përmasa që siguronin ndriçim të nevojshëm natyral, të pajisura me skara hekuri. Dhomat kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dyert e dhomave të shoqërimit ishin prej druri, sipas standardeve të miratuara. Në dhomat e shoqërimit për femra dhe të mitur kishte edhe lavaman me ujë të rrjedhshëm. Në korridorin e dhomave të shoqërimit kishte një tualet funksional. Në dhoma, sikurse edhe në korridor, ishin afishuar postera me të drejtat e personave të shoqëruar.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

**Në Komisariatin e Policisë Gjirokastrë**, brenda mjediseve të komisarariatit kishte 2 dhoma shoqërimi, të etiketuara si një për të rritur dhe një për femra dhe të mitur. Dhoma e shoqërimit për të rritur ishte relativisht e pastër, me dritare që siguronte dritë natyrale të nevojshme. Dhoma kishte ndriçim artificial nga rrjeti elektrik dhe ishte e pajisur vetëm me një stol pa tavolinë. Dera ishte prej druri sipas standardeve. Tualeti ndodhej në korridor. Ndërkohë që, dhoma e shoqërimit për femra dhe të mitur kishte 2 mjedise, ku njëri prej të cilëve ishte i pajisur me krevate dhe shtroje për të fjetur. Në mjedisin tjetër kishte vetëm një tavolinë pa karrige. Tualeti ndodhej brenda dhomës së shoqërimit, por edhe ai si i gjithë mjedisi i dhomës së shoqërimit për femra dhe të mitur, ishte në kushte të këqija higjieno-sanitare. Dera ishte prej druri sipas standardeve. Në të dy dhomat e shoqërimit kishte të afishuara postera me të drejtat e personave të shoqëruar.

Në kohën e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

### ***Kushtet në ambientet e sigurisë:***

**Në Komisariatin e Policisë Gjirokastrë**, kishte 8 dhoma sigurimi, përfshirë këtu 1 për femra dhe për të mitur. Gjatë inspektimit në këto dhoma kishte 6 persona të ndaluar dhe të arrestuar. Dhomat e sigurisë ishin brenda të gjitha standardeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Ato ishin të pajisura me dhomë/ paradhomë, me ndriçim natyral të mjaftueshëm dhe ndriçim artificial. Dhomat ishin të pajisura me krevate, sipas standardeve, por shtresat ishin të vjetra. Dhomat ishin të pajisura me sistem qendror ngrohjeje. Dhoma dhe paradhoma ndaheshin me skarë hekuri, që mbyllej nga ana e brendshme e paradhomës, pa dorezë. Korridori i ambientit të sigurisë ishte i pajisur me sistem monitorimi. ËC-të në çdo dhomë ishin funksionale dhe të pastra. Në çdo paradhomë kishte lavamanë, të cilët gjithashtu, ishin funksionale. Të ndaluarit dhe të arrestuarit mund të laheshin në dushin e posaçëm për ta, me ujë të rrjedhshëm dhe të ngrohtë gjatë gjithë kohës, por kushtet higjieno-sanitare të tij linin për të dëshiruar. Posterat me të drejtat ligjore dhe detyrimet e të ndaluarve dhe të arrestuarve ishin të vendosura në korridor dhe brenda dhomave. Të afishuara brenda dhomave ishin edhe oraret e aktivitetit ditor. Dhomat nuk ishin të pajisura me zile, pavarësisht se edhe nga komunikimi që grupi i inspektimit pati me personat e

ndaluar/ arrestuar, u informua se komunikimi me personelin e shërbimit në rast nevojë bëhej i mundur dhe pa probleme.

**Në Komisarifat e Policisë Tepelenë dhe atë të Përmetit**, sipas informacionit të marrë si nga DPPSH, ashtu edhe nga vetë personeli drejtues i këtyre Komisariateve, dhomat e sigurisë ishin mbyllur e nuk përdorshin.

***Trajtimi i të ndaluarve/ arrestuarve në ambientet e sigurisë:***

Të ndaluarit/ arrestuarit trajtoheshin me ushqim tri herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Urdhrin e Përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi ofrohej nëpërmjet kuzhinës së Komisarifatit të Gjirokastrës. Grupi i inspektimit pa se cilësia e ushqimit ishte shumë e mirë, por vuri re se kampionët e ushqimit nuk mbaheshin në mjedis frigoriferik të kyçur, gjë që iu bë me dije si drejtuesit të komisarifatit, ashtu edhe mjekut dhe personelit të kuzhinës.

Të ndaluarit/ arrestuarit në dhomat e sigurisë së Komisarifatit të Gjirokastrës kishin ujë të rrjedhshëm dhe të ngrohtë në çdo kohë. Ndërkohë që pajisja e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjente, pasta dhe furça dhëmbësh, etj., ishte e pamjaftueshme, pothuajse inekzistente.

Grupi i inspektimit, siç u informua nga personeli, por edhe nga personat e intervistuar gjatë inspektimit, vuri re se mungonte literatura informuese/ didaktike/ letrare, ndonëse kjo është një e drejtë e personave të ndaluar/ arrestuar. Të ndaluarve/ arrestuarve u ofrohej mundësia për ajrim sipas standardeve të përcaktuar në Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.

Sa i përket trajtimit mjekësor të të ndaluarve/ arrestuarve, grupi i inspektimit konstatoi se nd/mjeku i Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë e kryente detyrën e tij në një mjedis të përshtatshëm për vizita, në një dhomë me higjienë të mirë, e pajisur me një krevat jo të përshtatshëm për vizita mjekësore. Nga këqyrja e dokumentacionit të tij, u konstatua se kishte një regjistër vizitash, ndërkohë që kartelat e personave të ndaluar/ arrestuar ishin të plotësuara me rregull, por vetëm në një kopje e cila i bashkëngjitej dokumenteve të dosjes personale që përcilleshin në IEVP.

Një shembull i mirë ishte fakti që bazuar në një marrëveshje bashkëpunimi mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë, në spitalin e qytetit të Gjirokastrës kishte një dhomë të posaçme për personat e ndaluar/ arrestuar, e cila në momentet që nuk kishte pacientë të ndaluar/ arrestuar, mbetej e kyçur.

Grupi i inspektimit konstatoi se regjistrat që duhet të mbaheshin nga Komisarifat e Policisë Gjirokastrë, lidhur me mjediset e sigurisë, bazuar edhe në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”,

mbaheshin në të njëjtin mjedis të mbyllur me kyç. Të gjitha regjistrat ishin hapur dhe të plotësuar me rregull, sipas edhe urdhrin të lartpërmendur.

Korridori i ambientit të dhomave të sigurisë ishte i pajisur me sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

### ***Ambientet e intervistimit***

Në mjediset e dhomave të sigurisë në Komisarariat e Policisë Gjirokastër, kishte 1 dhomë të posaçme për takimin me avokatët, si dhe për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës, në përputhje kjo edhe me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.

Gjatë inspektimit u këqyrën të gjitha zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha Komisarariatet e lartpërmendura. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/ merren në pyetje.

### ***Monitorimi i ambienteve të shoqërimit, të sigurisë dhe hetimit***

Sistemi i monitorimit audio-viziv përbën një ndër aspektet më të rëndësishme sa i përket parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky sistem monitorimi me kamera vëzhgimi përveçse në Komisarariat e Policisë Gjirokastër, në komisarariatet e tjera, mungonte.

### ***Libri i personave të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar, si edhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia***

Në zbatim të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur, ndër të tjera, edhe me Regjistrin për Personat e Shoqëruar dhe Regjistrin për Personat e Ndaluar/ Arrestuar. Të gjitha Komisarariatet e inspektuara ishin të pajisura me regjistrat e lartpërmendur, përveç Komisarariatit të Tepelenës, i cili nuk kishte regjistër për personat e ndaluar/ arrestuar. Si Komisariati i Gjirokastrës, ashtu edhe ai i Përmetit nuk kishin të përditësuar regjistrin për evidentimin e personave të ndaluar/ arrestuar.

Në kundërshtim të plotë me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 4577/ 1 prot., datë 18.09.2014 “Tërheqje vëmendje për shoqërimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e Policisë së Shtetit”, në të gjitha regjistrat e këqyruar u vunë re problematikat e mëposhtme:

- Jo të gjitha rubrikat plotësohen apo plotësohen saktë.
  - Në rubrikën e njoftimit të familjarëve, në pjesën më të madhe të rasteve, ka mungesë informacioni sa i përket emrit, atësisë, mbiemrit dhe numrit të telefonit

të personit të njoftuar. Një dukuri e tillë veçanërisht u vu re në Komisariatin e Policisë Gjirokastër dhe atë Tepelenë.

- Në Komisariatin e Policisë Tepelenë kishte problematika edhe të shkuarjes së të dhënave në rubrikat e gabuara. Në 4 rastet e fundit të shënuara u vu re se nuk ishte plotësuar asgjë lidhur me emrat e familjarëve, numrat e tyre të telefonit, apo oficerin përkatës të policisë gjyqësore.
- Rubrika e arsyes së shoqërimit, pothuajse në çdo rast, plotësohet për shoqërime të personave të cilët kanë kryer një vepër/ kundërvajtje penale nga ana e shtetasit të shoqëruar, si p.sh. vjedhje, prishje rendi dhe qetësie publike, lidhje e paligjshme e energjisë elektrike, konflikt pronësie, person i shpallur në kërkim, prodhim/ shitje të lëndëve narkotike, dhunë në familje, etj. Në çdo rast, në të tre Komisaritet e inspektuara, personat përgjegjës për këto regjistra, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe me tërheqjen e vëmendjes nga DPPSH, pranojnë se personat vijnë si të shoqëruar dhe gjatë qëndrimit të tyre në mjediset e Komisaritatit, OPGJ-të përkatëse plotësojnë dokumentacionin e duhur për të bërë ndalimin/ arrestimin e tij/ saj.
- Grupi i inspektimit konstatoi se në të tre Komisaritet e inspektuara, nga regjistri i personave të shoqëruar rezulton se ka shumë raste në të cilat personat e shoqëruar kanë qëndruar më shumë se kufijtë e afatit ligjor prej 10 orësh në mjediset e shoqërimit. Siç ishin edhe rastet konkrete në Komisariatin e Policisë Tepelenë.

### ***Ndihma juridike dhe psikologjike***

Gjatë inspektimit, ekspertët u bënë me dije nga stafi i Komisariateve të inspektuara se detyrimi ligjor për të njoftuar personin e ndaluar/ arrestuar madhor që nëse nuk ka mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat dhe kërkon ndihmë juridike, atij i ofrohet një avokat kryesisht, përmbushej. Megjithatë, lista me emrat dhe kontaktet e avokatëve që pajtohen kryesisht nuk ishin të afishuara në çdo rast.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për analizimin e situatës së konstatuar nga grupi i inspektimit në Komisariatin e Policisë Tepelenë dhe marrjen e masave përkatëse.
2. Marrja e masave për heqjen e shulave në dyert e dhomave të shoqërimit në Komisaritet e Policisë, Tepelenë dhe rregullimin e derës së dhomës së shoqërimit për të rritur sipas kërkesave të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.
3. Marrja e masave për hapjen e një dhome tjetër shoqërimi, dhe lyerjen dhe pastrimin e mjediseve ekzistuese në Komisariatin e Policisë Gjirokastër për të krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze dhe të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
4. Marrja e masave për pajisjen e dhomave të shoqërimit me orënditë e nevojshme sipas kërkesave të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe

Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore” në Komisaritet e Policisë Tepelenë dhe Gjirokastrë.

5. Marrja e masave për hapjen e tualeteve të përshtatshme sipas kërkesave të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore” pranë dhomave të shoqërimit në Komisaritin e Policisë Tepelenë.
6. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit të Komisariateve të Policisë Tepelenë dhe Përmet.
7. Marrja e masave për pajisjen e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale në Komisaritin e Policisë Gjirokastrë.
8. Marrja e masave për instalimin e zileve sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore” në dhomat e sigurisë në Komisaritin e Policisë Gjirokastrë.
9. Marrja e masave të menjëhershme që kartelat mjekësore të të ndaluarve/ arrestuarve në Komisaritin e Policisë Gjirokastrë të hartohen në dy kopje, në mënyrë që njëra prej tyre të mbahet si dokumentacion në zyrën e mjekut.
10. Marrja e masave për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare të dhomave të shoqërimit, veçanërisht në Komisaritet e Policisë Tepelenë dhe Gjirokastrë.
11. Marrja e masave për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare të dushit në mjediset e dhomave të sigurisë së Komisaritatit të Policisë Gjirokastrë.
12. Marrja e masave për përditësimin e regjistrave të personave të ndaluar/ arrestuar në të gjitha Komisaritet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
13. Marrja e masave për plotësimin me përgjegjësi të plotë të regjistrave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/ arrestuar në të gjitha rubrikat e tyre në të gjitha Komisaritet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së, në zbatim të shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 4577/ 1 prot., datë 18.09.2014 “Tërheqje vëmendje për shoqërimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e Policisë së Shtetit”.
14. Marrja e masave për zbatimin me përpikëri të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 4577/ 1 Prot., datë 18.09.2014 “Tërheqje vëmendje për shoqërimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e Policisë së Shtetit” sa i takon institutit të shoqërimit të personave.
15. Marrja e masave për respektimin me përpikëri të afatit ligjor prej 10 orësh të personave të shoqëruar në secilin prej Komisariateve të inspektuara nga MKPT dhe marrjen e masave përkatëse në rastet e konstatuara në shkelje.
16. Marrja e masave për trajnimin e personelit në të gjitha Komisaritet e inspektuara lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, për shoqërimin e personave, si edhe me zbatimin e Ligjit Nr. Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

## **6.9. DPQ Tiranë dhe komisariate të varësisë**

Drejtoria e Policisë Qarkut Tiranë, datë 24.10.2014 / Nr. Dok. 201402369  
Komisariati i Policisë Nr. 1, datë 22.10.2014 / Nr. Dok. 201402370  
Komisariati i Policisë Nr. 2, datë 24.10.2014 / Nr. Dok. 201402371  
Komisariati i Policisë Nr. 3, datë 24.10.2014 / Nr. Dok. 201402372  
Komisariati i Policisë Nr. 4, datë 03.12.2014 / Nr. Dok. 201402373  
Komisariati i Policisë Nr. 5, datë 22.10.2014 / Nr. Dok. 201402374  
Komisariati i Policisë Nr. 6, datë 03/ 11.12.2014 / Nr. Dok. 201402375  
Komisariati Kavajë, datë 23.04.2014 / Nr. Dok. 201400839  
Stacioni i Policisë Rrogozhinë, datë 23.04.2014 / Nr. Dok. 201400838

### ***Shënime paraprake***

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, grupi i autorizuar nga Avokati i Popullit, në secilin prej subjekteve të lartpërmendura, u takua fillimisht me titullarin e organit, ose me personin e autorizuar nga titullari për t'i komunikuar qëllimin e inspektimit.

Vlen të theksohet fakti se në të gjitha rastet drejtuesit e organeve të inspektuara treguan bashkëpunim gjatë kohës që grupi ishte në inspektim, në zbatim të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Gjithashtu, pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, mori takim privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi ambientet e shoqërimit e të sigurisë dhe zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse. Më konkretisht, gjendja e përgjithshme si dhe problematikat e konstatuara në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe në organet e policisë në varësi të saj pasqyrohen më poshtë:

### ***Kushtet e ambienteve të shoqërimit:***

**Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë**, kishte 3 dhoma shoqërimi brenda mjediseve të Drejtorisë për të mitur, femra dhe meshkuj të rritur. Dhoma për të mitur ishte më përmasa 3mx3m me dy karrige. Dhoma e shoqërimit për femra dhe ajo për të rritur meshkuj ishin me përmasa 3mx5m dhe të pajisura me 18 dhe 16 karrige pa tavolina. Përgjithësisht dhomat ishin në kushte të varfra higjieno-sanitare. Dritaret ishin me skarë dhe rrjetë hekuri. Drita natyrale dhe ajo artificiale ishin të mjaftueshme. Në momentin e inspektimit kishte 2 persona të shoqëruar. Kishte sistem monitorimi me kamera.

**Në Komisariatin e Policisë Nr. 1**, kishte 1 dhomë shoqërimi brenda mjediseve të komisarariatit. Përmasa e dhomës ishte 3x4 m, në kushte të varfra higjieno-sanitare, e pajisur me 5 karrige të lidhura në seri, me një kthinë pranë dritares, e cila lë vend për pretendime abuzimi, e gjitha kjo jashtë standardeve të paracaktuara. Kishte një dritare me skarë hekuri, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Po brenda dhomës kishte edhe një dritare tjetër, e cila ndante këtë mjedis me një zyrë tjetër, që kishte skarë dhe rrjetë hekuri. Dhoma kishte ndriçim artificial nga rrjeti elektrik, por instalimet elektrike ishin të zbuluara dhe rrjedhimisht ishin një rrezik real për personat që rrinin në këtë mjedis. Një gjë e tillë u pranua edhe nga vetë personeli i

këtij Komisaritati. Posterat ishin të pranishëm. Dera ishte me skarë hekuri, jashtë standardeve. Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

**Në Komisaritin e Policisë Nr. 2**, brenda mjediseve të komisaritatit kishte 3 dhoma shoqërimi të etiketuar për femra, meshkuj dhe të mitur. Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar. Dhomat e shoqërimit ishin relativisht të pastra, të pajisura me tavolinë, karrige, dhe me një kolltuk tek dhoma e të miturve dhe e femrave. Përmasat e dhomave ishin 4x3 m, me dritare me përmasa që siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Dhomat kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dyert e dhomave të shoqërimit ishin prej druri, sipas standardeve të miratuara. Në dhoma, sikurse edhe në korridor, ishin afishuar postera me të drejtat e personave të shoqëruar. Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

**Në Komisaritin e Policisë Nr. 3**, brenda mjediseve të komisaritatit kishte 2 dhoma shoqërimi, të etiketuara një për femra dhe të mitur dhe një për të rritur, relativisht të pastra. Dhomat kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik. Dhoma për femrat dhe të miturit kishte 12 karrige të lidhura me njëra-tjetrën, nuk kishte tavolinë, me dritare që siguronte dritë natyrale të nevojshme dhe dera prej druri sipas standardeve. Ndërsa dhoma për të rriturit kishte derë hekuri me shul nga jashtë. Brenda kjo dhomë kishte 7 karrige të lidhura me njëra-tjetrën, por nuk kishte tavolinë. Dritarja nuk lejonte dritë të mjaftueshme natyrale. Kishte të afishuar postera me të drejtat e personave të shoqëruar. Në kohën e inspektimit kishte 3 persona të shoqëruar. Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

**Në Komisaritin e Policisë Nr. 4**, brenda mjediseve të komisaritatit kishte 1 dhomë shoqërimi, plotësisht jashtë standardeve të paracaktuara. Dhoma kishte derë me një dritare skare hekuri dhe që mbyllej me shul nga jashtë. Dhoma kishte 2 stola dhe nuk kishte tavolinë. Dritarja ishte me përmasa të vogla për të siguruar dritë natyrale, dhe drita që vinte nga ndriçimi artificial ishte gjithashtu i pakët. I njëjti mjedis për personat e shoqëruar përdorej edhe për personat e ndaluar/arrestuar. Në kohën e inspektimit kishte 2 të mitur të shoqëruar, të cilët nuk ishin në këto ambiente dhe 2 persona të ndaluar/arrestuar brenda këtij mjedisi. Nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi. Të miturit ishin shoqëruar gjatë natës së datës 15.12.2014 rreth orës 01.00. jashtë kriterëve ligjore të nenit 101 të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe ishin mbajtur gjatë gjithë natës në stol në korridor. Nuk ishte plotësuar regjistri i personave të shoqëruar sipas kriterëve ligjore për këtë rast dhe familjarët ishin lajmëruar vetëm në mëngjesin e ditës së nesërme, rreth orës 09.00. Në momentin e inspektimit grupi inspektues u takua me prindërit të cilët ishin të shqetësuar pasi nuk kishin qenë në dijeni për vendndodhjen e fëmijëve të tyre gjatë gjithë natës. Të miturit u lanë të lirë dhe iu bashkuan familjareve rreth orës 10 të paradites.

**Në Komisaritin e Policisë Nr. 5**, brenda mjediseve të komisaritatit kishte 2 dhoma shoqërimi, të etiketuara një për të mitur dhe femra dhe një për të rritur meshkuj. Dhoma për femra dhe të mitur ishte me derë druri, sipas standardeve, por e pa pajisur me orendi. Kishte tualet brenda, i cili ishte i papastër. Dhoma për të rritur meshkuj ishte pa derë, e pajisur me një tavolinë dhe 2 karrige tepër të amortizuara dhe një dollap. Gjithashtu, nga ky mjedis kishte hyrje një zyrë, e cila përdorej për mbajtje dokumentacioni. Brenda kësaj dhome kishte edhe një tualet, i cili ishte tepër i papastër. Grupi i inspektimit konstatoi se këto dhoma ndaheshin nga pjesa tjetër e komisaritatit

me një derë të madhe skare hekuri. Gjithashtu, u konstatua se brenda të njëjtit mjedis kishte edhe një dhomë tjetër, e cila ishte e pajisur me 2 stola, dritë natyrale dhe artificiale të mirë, por personeli i komisariatit informoi grupin e inspektimit se ky mjedis nuk përdorej për shoqërim.

**Në Komisarjatit e Policisë Nr. 6**, grupi i inspektimit u informua nga Shefi i Komisarjatit që nuk kishte dhoma shoqërimi, ndërkohë, nga stafi që shoqëroi ekspertët, u bë me dije se kontejneri i vendosur pranë godinës së komisariatit, brenda oborrit, përdorej për dhomë shoqërimi. Grupi i inspektimit hyri brenda kontejnerit, i cili kishte një numër të madh dollapësh, një TV dhe 2 karrige të thyera dhe i mungonte ndriçimi artificial. Brenda kishte bishta cigareje, që tregonin praninë paraprake të personave. Me qëllim verifikimin nëse në kontejner mbaheshin persona të shoqëruar, grupi i ekspertëve të MKPT-së kreu një inspektim tjetër në orën 21.30 të datës 11.12.2014, ku sërish nuk gjeti persona të shoqëruar. Sërish u gjendën sende që tregonin praninë e personave në të (bishta cigaresh, një shishe uji 1.5 litroshe dhe një çadër).

**Në Komisarjatit e Policisë Kavajë**, brenda mjediseve të komisariatit, kishte 3 dhoma shoqërimi respektivisht për femra, meshkuj dhe të mitur. Dhomat e shoqërimit, ndaheshin nga mjediset e tjera me një derë zgarë hekuri me dry dhe në momentin e inspektimit kjo derë ishte e mbyllur. Në korridor kishte kamera sigurie dhe postera me të drejtat e personave të shoqëruar dhe të ndaluar. Këto të fundit ishin edhe në dhomat e shoqërimit. Dhomat ishin të përmasave 4x4 m, me dritare që siguronin ndriçim të plotë natyral. Dhoma për meshkujt kishte vetëm karrige, të cilat ishin tejet të amortizuara dhe të pista. Nuk kishte tavolinë. Ndërkohë që, dhomat e shoqërimit për femrat dhe fëmijët ishin më të pastra, por nuk ishin të pajisura me karrige/ stola dhe tavolinë. Dyert ishin prej druri me mundësi mbylljeje me çelës. Në korridor ndodhej edhe një tualet funksional.

**Në Stacionin e Policisë Rrogozhinë** grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishte as dhoma shoqërimi e as sigurie.

### *Kushtet në ambientet e sigurisë*

**Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë** kishte 8 dhoma sigurie; një për femra, një për të mitur dhe 6 për të rritur meshkuj, të gjitha sipas standardeve të paracaktuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”. Dhomat ishin me përmasa sipas manualit të lartpërmendur me dritë natyrale dhe artificiale të mjaftueshme. Në momentin e inspektimit kishte 30 persona të ndaluar/arrestuar. Disa prej tyre ishin edhe me masë sigurie.

Kishte sistem ngrohje qendrore.

Korridori i dhomave të sigurisë, ashtu si edhe i gjithë mjedisi, ishte sipas standardeve të paracaktuara në manual. Kishte sistem njoftimi me zile për çdo dhomë dhe sistem monitorimi me kamera.

Përveç tualeteve të vendosura nëpër dhoma, kishte edhe tualet të përbashkët dhe dush në kushte shumë të mira.



**Komisariati i Policisë Nr. 1** kishte 3 dhoma sigurie, me përmasa 1.5mx2m, të cilat ishin të pajisura me dyshekë e shtroje të vjetra, pa krevate. Dritaret ishin tepër të vogla për të siguruar dritë natyrale dhe ajrim dhe drita artificiale tepër e dobët. Në momentin e inspektimit u konstatuan 2 persona. Brenda mjedisit të dhomave të sigurisë ndodhej edhe një mjedis tjetër, ajrimi dhe takimi, i cili ishte me dritare që siguronte ndriçim të bollshëm natyral, por pa xhama. Kjo dhomë ishte e pajisur me karrige dhe tavolinë.

Nuk kishte sistem ngrohjeje.

Korridorin e dhomave të sigurisë, ashtu si edhe vetë dhomat, nuk plotësonin asnjë standard të paracaktuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.

Të ndaluarit/ arrestuarit mund të përdornin një tualet të përbashkët, i cili ishte tejet i amortizuar dhe në kushte tepër të këqija higjieno-sanitare.

Qëndrimi i shtetasve në këto kushte, përveçse është në kundërshtim të plotë me Urdhrin e lartpërmendur të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por përbën trajtim degradues, si edhe cenon dinjitetin e çdo personi që qëndron në këto ambiente.

**Komisariati i Policisë Nr. 2**, kishte 3 dhoma sigurie, 2 prej tyre me përmasa 1.10mx2.65m dhe 1.67mx2.65m, dhoma e tretë ishte me përmasa më të mëdha se 2 të sapo përmendurat. Të tre dhomat kishin krevate dhe shtroje, por të gjitha këto ishin tejet të amortizuara. Dritaret ishin tepër të vogla për të siguruar dritë natyrale dhe ajrim dhe drita artificiale tepër e dobët, pothuajse inekzistente. Në ditën e inspektimit u konstatua 1 person i ndaluar/ arrestuar.

Nuk kishte sistem ngrohjeje.

Korridorin e dhomave të sigurisë, ashtu si edhe vetë dhomat, nuk plotësonin asnjë standard të paracaktuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.

Të ndaluarit/ arrestuarit mund të përdornin një tualet të përbashkët, i cili ishte tejet i amortizuar dhe në kushte tepër të këqija higjieno-sanitare.

Qëndrimi i shtetasve në këto kushte, përveçse është në kundërshtim të plotë me Urdhrin e lartpërmendur të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por përbën trajtim degradues, si edhe cenon dinjitetin e çdo personi që qëndron në këto ambiente.

**Komisariati i Policisë Nr. 3** kishte 2 dhoma sigurie, dhe një dhomë teknike. Të dy dhomat ishin me përmasa 3mx2m, vetëm me shtroje, pa krevat, të cilat ishin tejet të vjetruara. Dritaret ishin me përmasa tepër të vogla për të lejuar dritën natyrale dhe ndriçimi artificial ishte tepër i zbehtë, pothuajse i papërfillshëm. Ajrimi në këto kushte ishte i pamundur. Në momentin e inspektimit u konstatua 7 persona të ndaluar/ arrestuar.

Nuk kishte sistem ngrohjeje dhe as sistem vëzhgimi me kamera.

Korridor i dhomave të sigurisë, ashtu si edhe vetë dhomat, nuk plotësonin asnjë standard të paracaktuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.

Të ndaluarit/ arrestuarit mund të përdornin një tualet të përbashkët, i cili ishte tejet i amortizuar dhe në kushte tepër të këqija higjieno-sanitare.

Qëndrimi i shtetasve në këto kushte, përveçse është në kundërshtim të plotë me Urdhrin e lartpërmendur të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por përbën trajtim degradues, si edhe cenon dinjitetin e çdo personi që qëndron në këto ambiente.

**Komisariati i Policisë Nr. 5** kishte 3 dhoma sigurie, dhe 2 dhoma për paraqitje për njohje. Dhomat ishin me përmasa 2.5mx2.5m, në kushte shumë të varfra higjieno-sanitare, ku jo të gjithë personat kishin krevat dhe pjesa më e madhe e personave flinin me shtroje në dysheme, të cilat ishin tejet të vjetruara. Dritaret ishin me përmasa tepër të vogla për të lejuar dritën natyrale dhe ndriçimi artificial ishte i zbehtë. Ajrimi në këto kushte ishte i pamundur. Në ditën e inspektimit u konstatuan 8 persona të ndaluar/ arrestuar, 6 prej të cilëve ishin me masë sigurie “arrest në burg”.

Nuk kishte sistem ngrohjeje dhe as sistem vëzhgimi me kamera.

Korridor i dhomave të sigurisë ishte në përputhje me standardet e paracaktuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.

Të ndaluarit/ arrestuarit mund të përdornin një tualet të përbashkët, i cili ishte tejet i amortizuar dhe në kushte tepër të këqija higjieno-sanitare.

Qëndrimi i shtetasve në këto kushte, përveçse është në kundërshtim të plotë me Urdhrin e lartpërmendur të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por përbën trajtim degradues, si edhe cenon dinjitetin e çdo personi që qëndron në këto ambiente.

**Komisariati i Policisë Nr. 6** kishte 1 dhomë sigurie, dhe 2 dhoma të kyçura me dry, për të cilat u tha që personeli nuk kishte mundësi t’i hapte, pasi nuk dispononte çelës. Megjithatë, nga këqyrja që ekspertët e MKPT-së bënë, u konstatua se nuk kishte persona. Dhoma e hapur ishte me përmasa 1.5mx2.5m, në kushte shumë të varfra higjieno-sanitare, ku nuk kishte krevat, por vetëm shtroje, të cilat ishin tejet të vjetruara. Dritarja ishte me përmasa tepër të vogla për të lejuar dritën natyrale dhe ajrimi në këto kushte ishte i pamundur. Në ditën e inspektimit nuk u konstatuan persona të ndaluar/ arrestuar, por duke marrë në konsideratë faktin që MKPT konstatoi ushqime të paprekura brenda në dhomë, personeli sqaroi se personi ishte në gjykatë dhe do të kthehej sërish.

Nuk kishte sistem ngrohjeje dhe as sistem vëzhgimi me kamera, pavarësisht se mjedisi i dhomës së sigurisë ishte jashtë godinës së komisariatit, në hyrje të tij.

Korridor i dhomave të sigurisë ishte tepër i vogël dhe plotësisht jashtë standardeve të paracaktuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.

Të ndaluarit/ arrestuarit nuk kishin një tualet për nevojat personale.

Qëndrimi i shtetasve në këto kushte, përveçse është në kundërshtim të plotë me Urdhrin e lartpërmendur të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por përbën trajtim degradues, si edhe cenon dinjitetin e çdo personi që qëndron në këto ambiente.

**Komisariati i Policisë Kavajë** kishte 3 dhoma sigurie, përkatësisht për femra, meshkuj dhe të mitur. Në momentin e inspektimit kishte 4 të ndaluar, të gjithë të rritur meshkuj. Pavarësisht se dhomat ishin të ndërtuara sipas standardeve të përcaktuara në Manualin e lartpërmendur, shtrojat ishin të amortizuara, ashtu si edhe banjat brenda ambientit të banimit. Të ndaluarit i konfirmuan grupit të inspektimit se i kryenin nevojat personale në një mjedis tjetër dhe jo brenda dhomave të tyre. Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë ndodheshin 2 persona në çdo dhomë, njëri prej të cilëve flinte në krevat dhe tjetri në dysheme, mbi 2 dyshekë njëri sipër tjetrit. Mjediset e banimit ishin shumë të papastra. Për të ndaluarit kishte një dush dhe uji i ngrohtë ishte i disponueshëm me kërkesë të të ndaluarve/ arrestuarve. Mjedisi i dushit ishte i amortizuar. Kamerat ishin të vendosura në korridor.

Në asnjërin prej njërive policore të përmendura më lart, përveç Drejtorisë së Qarkut, dhe Komisarariatit të Kavajës, nuk ofrohej mundësia për dush. Një trajtim degradues dhe në kundërshtim të plotë me Urdhrin e lartpërmendur të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

#### ***Trajtimi i të ndaluarve/ arrestuarve në ambientet e sigurisë:***

Të ndaluarit/ arrestuarit trajtoheshin me ushqim tri herë në ditë, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Urdhrin e Përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi ofrohej kryesisht me sistemin catering.

Të ndaluarit/ arrestuarit në dhomat e sigurisë në të gjitha njësitë e mësipërme, kishin ujë të rrjedhshëm, por jo të ngrohtë në tualetet e përbashkëta, përveç Drejtorisë së Qarkut Tiranë, e cila kishte ujë të rrjedhshëm dhe të ngrohtë në çdo kohë. Ndërkohë që pajisja e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale si sapun, detergjente, pasta dhe furça dhëmbësh, etj., ishte e pamjaftueshme, pothuajse inekzistente.

Grupi i inspektimit, siç u informua nga personeli, por edhe nga personat e intervistuar gjatë inspektimit, vuri re se mungonte literatura informuese/ didaktike/ letrare, ndonëse kjo është një e

drejtë e personave të ndaluar/ arrestuar. Të ndaluarve/ arrestuarve nuk u ofrohej mundësia për ajrim në ambient të jashtëm.

Sa i përket trajtimit mjekësor të të ndaluarve/ arrestuarve, grupi i inspektimit konstatoi se në të gjitha komisariatet kishte mangësi si në kryerjen e vizitave mjekësore për të ndaluar/ arrestuarit të cilat në shumicën e rasteve të të intervistuarve, mjeku apo ndihmësmjeku nuk kishte kontaktuar me ta, ashtu dhe sa i përket plotësimit të regjistrit të vizitave apo/ dhe kartelave mjekësore.

Në Drejtorinë e Qarkut Tiranë organika e sektorit shëndetësor ishte e plotësuar me një mjekë dhe një ndihmës mjek. Nga këqyrja e dokumentacionit u konstatua se në shumicën e rasteve që kishin kartela të plotësuara mungonte hedhja e të dhënave në regjistrin e vizitave dhe anasjelltas. Gjithashtu, grupi inspektues konstatoi se në disa raste në regjistrin e vizitave kishte hapësira të lëna bosh e të pa plotësuara. Në të gjitha Komisaritet dhe në Drejtorinë e Qarkut dokumentacioni i mjekut mbahej i mbyllur me kyç.

Për sa i përket mjekimeve, të ndaluar/ arrestuarit pretendonin se kishte mangësi si të medikamenteve të urgjencës ashtu edhe atyre kronike dhe në shumicën e rasteve ato siguroheshin nga familja, megjithëse nga inspektimi i grupit tonë monitorues, u konstatua se kishte një larmishmëri medikamentesh në Drejtorinë e Qarkut të cilat mbaheshin në një dollap në dhomën e mjekes.

Në Komisaritin e Kavajës, nga të dhënat paraprake që u mor nga stafi drejtues, pavarësisht se i parashikuar, mungonte mjeku, gjë që u vërtetua edhe në takimet që u kryen me të ndaluarit/ arrestuarit. Nga stafi i Komisaritatit u tha se mjeku vinte në çdo rast që kishte të ndaluar/ arrestuar, gjë që nuk u konfirmua nga personat që ndodheshin në dhomat e sigurisë gjatë momentit të inspektimit. Regjistri i vizitave ishte plotësuar deri më 20/ 03/ 2014, po ashtu edhe kartelat mjekësore, të cilat mbaheshin të mbyllura me çelës. Kushtet e dhomës së mjekut ishin të papërshtatshme, me kubaturë të vogël ambienti, dollap ilaçesh në kushte jo të mira, me mungesë medikamentesh bazë dhe të urgjencës. Pavarësisht se frigoriferi ishte fizikisht në dhomën e mjekut, ai përdorej për funksione jashtë qëllimit për të cilin ishte vendosur.

Grupi i inspektimit konstatoi se, në të gjitha njësitë policore të inspektuara regjistrat që duhet të jenë prezentë dhe plotësohen në dhomat e sigurisë, bazuar edhe në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, mbaheshin me rregull dhe ishin të pranishëm. Në Komisaritet e Policisë Nr. 2 dhe 3, si edhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut mungonin regjistrat e parashikuar rishtazi në ndryshimin e bërë manualit të lartpërmendur. Në Komisaritin e Policisë nr. 6 pavarësisht se kutia për kërkesë/ ankesa ishte prezent, regjistri nuk ishte i pranishëm.

Gjatë inspektimit, në intervistat e bëra me personat e ndaluar/ arrestuar, grupi i inspektimit konstatoi se në disa prej komisariateve kishte persona, të cilët e kishin marrë masën e sigurisë dhe vijonin të qëndronin në mjediset e sigurisë pa u transferuar në paraburgim. Gjithashtu, pati raste që të ndaluarit/ arrestuarit bënë me dije grupin e inspektimit se mjeku nuk i kishte vizituar. Një gjë e tillë u vërtetua edhe nga regjistrat përkatës.

Gjithashtu, në disa prej komisariateve, si në intervista, por edhe nga biseda me stafin, grupi i inspektimit konstatoi se personave të shoqëruar u hiqen sendet personale, përfshirë këtu edhe celularin, në kundërshtim të plotë me legjisllacionin në fuqi.

Korridoret e ambienteve të dhomave të sigurisë në njësitë policore të lartpërmendura nuk ishin të pajisur me sistem monitorimi me kamera vëzhgimi, përveç Drejtorisë së Policisë së Qarkut.

#### ***Ambientet e intervistimit:***

Në mjediset e dhomave të sigurisë në njësitë policore të lartpërmendura, përveç Komisarariatit nr. 5, Komisarariatit të Kavajës dhe Drejtorisë së Policisë së Qarkut, nuk kishin dhoma për takimin me avokatët dhe për marrjen në pyetje të shtetasve nga organi i akuzës, gjë që bie në kundërshtim me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”. Në njësitë policore që nuk kishin dhomat e lartpërmendura, këtë funksion e kryenin zyrat e përgjegjësve të dhomave të sigurisë.

Gjatë inspektimit u këqyrën të gjitha zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha Komisarariatet në fjalë, por këto mjedise nuk ishin të monitoruara. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/ merren në pyetje, megjithatë, u gjendën prova materiale, të cilat ndodheshin aty kryesisht për shkak të mungesës së mjediseve të magazinimit.

#### ***Monitorimi i ambienteve të shoqërimit, të sigurisë dhe hetimit:***

Sistemi i monitorimit audio-viziv përbën një ndër aspektet më të rëndësishme sa i përket parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky sistem monitorimi me kamera vëzhgimi mungonte në të gjitha Komisarariatet e vëzhguara nga grupi i inspektimit, përveç Drejtorisë së Policisë së Qarkut dhe Komisarariatit të Kavajës.

#### ***Libri i personave të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar, si edhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia:***

Në zbatim të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur, ndër të tjera, edhe me Regjistrin për Personat e Shoqëruar dhe Regjistrin për Personat e Ndaluar/ arrestuar. Të gjitha Komisarariatet e inspektuara ishin të pajisura me regjistrat e lartpërmendur, përveç Komisarariatit të Policisë nr. 4, i cili nuk kishte regjistër personash të ndaluar/ arrestuar. Si Drejtoria e Policisë së Qarkut, ashtu edhe Komisariami i Policisë nr. 3, nr. 5 dhe nr. 1, nuk e kishin të përditësuar regjistrin për evidentimin e personave të ndaluar/ arrestuar.

Në kundërshtim të plotë me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 4577/ 1 prot., datë 18.09.2014 “Tërheqje vëmendje për shoqërimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e Policisë së Shtetit”, në të gjitha regjistrat e këqyrur u vunë re problematikat e mëposhtme:

- Jo të gjitha rubrikat plotësohen apo plotësohen saktë.
  - Në rubrikën e njoftimit të familjarëve, në pjesën më të madhe të rasteve, ka mungesë informacioni sa i përket emrit, atësisë, mbiemrit dhe numrit të telefonit të personit të njoftuar.
  - Në Komisariatin e Policisë nr. 1, rubrika e fundit lidhur me pretendimet e personave të shoqëruar nuk plotësohet në asnjë rast. E njëjta gjë ndodhte edhe në Komisariatin e Policisë nr. 2.
  - Në Komisariatin e Policisë nr. 4, në rastet e 2 të miturve të shoqëruar në orët e para të mëngjesit, nuk ishin njoftuar familjarët duke vënë shënimin “nuk lajmëroi njeri se ishte vonë”.
- Në rubrikën e arsyes së shoqërimit, kjo e fundit përfshin pothuajse në çdo rast kryerjen e veprës penale nga ana e shtetasit të shoqëruar, si p.sh. vjedhje, drejtim i automjetit në gjendje të dehur/ pa patentë, person i shpallur në kërkim, prodhim/ shitje të lëndëve narkotike, dhunë në familje, konflikt me persona të tjerë, prishje e rendit dhe qetësisë publike etj. Në çdo rast, në të gjitha njësitë policore të inspektuara, personat përgjegjës për këto regjistra, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe me tërheqjen e vëmendjes nga DPPSH, pranojnë se personat vijnë si të shoqëruar dhe gjatë qëndrimit të tyre në mjediset e Komisariatit, OPGJ-të përkatëse plotësojnë dokumentacionin e duhur për të bërë ndalimin/ arrestimin e tij/ saj.
- Grupi i inspektimit konstatoi se në pothuajse të gjitha njësitë policore të inspektuara, personat e shoqëruar janë lënë të lirë ose janë ndaluar/ arrestuar në kufijtë e afatit ligjor prej 10 orësh, ose duke i tejkaluar ato.
- Në Komisariatin e Policisë nr. 4, grupi i inspektimit konstatoi një regjistër të pasekretuar, të vendosur në korridorin para dhomës së shoqërimit, i cili kishte dinamikën e hyrje-daljeve të personave nga dhoma e shoqërimit në këtë njësi policore.
- Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut, në mjediset para dhomave të shoqërimit dhe hyrjes në mjediset e dhomave të sigurisë, kishte një regjistër i pasekretuar për të cilin grupi i inspektimit nuk mori një shpjegim të saktë se përse mbahej dhe cili ishte qëllimi i tij.

### ***Ndihma juridike dhe psikologjike:***

Gjatë inspektimit, ekspertët u bënë me dije nga stafi i njësive policore të inspektuara se detyrimi ligjor për të njoftuar personin e ndaluar/ arrestuar madhorë që nëse nuk kanë mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat dhe kërkojnë ndihmë juridike, atyre iu ofrohet një avokat kryesisht, në çdo rast përmbushej. Megjithatë, lista me emrat dhe kontaktet e avokatëve që pajtohen kryesisht nuk ishin të afishuara në çdo rast.

Ndihma psikologjike pavarësisht se është një detyrim ligjor, në rastin e intervistimit të të miturve të shoqëruar apo ndaluar në komisaritet e policisë jo gjithmonë realizohet në Komisaritet e Drejtorisë Qarkut Tiranë. Në rastin e dy të miturve të shoqëruar në mbrëmjen e datës 15.12.2014 në Komisariatin nr. 4 nuk ishte siguruar ndihmë psikologjike ndaj të të miturve.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e menjëhershme në analizë të situatës së konstatuar në Komisarlatin e Policisë nr. 4 sa i takon trajtimin të të dy të miturve të shoqëruar në këtë institucion, si edhe marrjen e masave përkatëse disiplinore për personat përgjegjës.
2. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me heqjen nga përdorimi të regjistrave të pa sekretuar të konstatuar nga ekspertët e MKPT-së në Drejtorinë e Policisë së Qarkut, si edhe në Komisarlatin e Policisë nr. 4.
3. Marrja e masave për uljen e mbipopullimit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, Komisarlatet nr. 3 dhe nr. 5.
4. Marrja e masave të menjëhershme për mbylljen e kontejnerit, i cili përdoret për dhomë shoqërimi në Komisarlatin e Policisë nr. 6.
5. Marrja e masave për rikonstruksionin e të gjitha mjediseve të dhomave të sigurisë në të gjitha njësitë policore të lartpërmendura, përveç Drejtorisë së Policisë së Qarkut dhe Komisarlatit të Policisë Kavajë sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze dhe të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
6. Marrja e masave për rikonstruksionin e të gjitha mjediseve të tualeteve të përbashkëta dhe dusheve në të gjitha njësitë policore të lartpërmendura, përveç Drejtorisë së Policisë së Qarkut, sipas standardeve të paracaktuara në legjislacionin në fuqi.
7. Marrja e masave për pajisjen e dhomave të shoqërimit me të gjitha mjetet e nevojshme dhe me dritë natyrale dhe artificiale në të gjitha njësitë policore të lartpërmendura, sipas standardeve të paracaktuara në legjislacionin në fuqi.
8. Marrja e masave për të hapur 3 dhoma shoqërimi dhe rregullimin e dhomës aktuale në Komisarlatin nr. 1, sipas standardeve të paracaktuara në legjislacionin në fuqi.
9. Marrjen e masave për ta bërë dhomën e shoqërimit për meshkuj të rritur në Komisarlatin nr. 3, sipas standardeve të paracaktuara në legjislacionin në fuqi.
10. Marrja e masave për të hapur 3 dhoma shoqërimi dhe rregullimin e dhomës aktuale të shoqërimit në Komisarlatin nr. 4, sipas kërkesave të kuadrit të lartpërmendur ligjor.
11. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit në të gjitha njësitë policore të lartpërmendura, përveç Drejtorisë së Policisë së Qarkut dhe Komisarlatit të Kavajës.
12. Marrja e masave për pajisjen e të ndaluarve/ arrestuarve me mjete të higjienës personale në të gjitha njësitë policore ku ka dhoma sigurie.
13. Marrja e masave për përditësimin e regjistrave të personave të ndaluar/ arrestuar në njësitë policore të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
14. Marrja e masave për hapjen dhe vënien në funksionim të regjistrave për personat e ndaluar/ arrestuar në njësitë policore të cilat nuk e kanë.
15. Marrja e masave për hapjen dhe vënien në funksionim të regjistrave të parashikuar në ndryshimet e fundit të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.

16. Marrja e masave për hapjen dhe vënien në funksionim të regjistrit për kërkesë/ ankesat në Komisarlatin e Policisë nr. 6.
17. Marrja e masave për plotësimin me përgjegjësi të plotë të regjistrave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/ arrestuar në të gjitha rubrikat e tyre në të gjitha njësitë policore të lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
18. Marrja e masave të menjëhershme për zbatimin me përpikëri të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe shkresës së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 4577/ 1 prot., datë 18.09.2014 “Tërheqje vëmendje për shoqërimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e Policisë së Shtetit” sa i takon institutit të shoqërimit të personave.
19. Marrja e masave të menjëhershme për trajnimin e personelit në të gjitha Komisarlatet e inspektuara lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, për shoqërimin e personave, si edhe me zbatimin e Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.
20. Marrja e masave të menjëhershme për mundësimin e literaturës informuese/ didaktike/ letrare si dhe ajrimin në ambient të jashtëm për personat e ndaluar/ arrestuar.
21. Marrja e masave për të garantuar trajtimin mjekësor të të ndaluarve/ arrestuarve, si dhe për plotësimin me korrektësi të regjistrave të vizitave dhe kartelave mjekësore.
22. Marrja e masave për garantimin e ndihmës psikologjike gjatë intervistimit të të miturve në Komisarlatet e Policisë së Qarkut Tiranë dhe njoftimin e familjareve të tyre që në momentet e para të shoqërimit apo ndalimit në ambientet e policisë.

#### **6.10. DPQ Vlorë dhe komisarlate të varësisë**

Komisariati i Policisë Delvinë, datë 11.11.2014 / Nr. Dok. 201402222

Komisariati i Policisë Sarandë, datë 12.11.2014 / Nr. Dok. 201402223

Komisariati i Policisë Himarë, datë 13.11.2014 / Nr. Dok. 201402224

Komisariati i Policisë Vlorë (DPQ), datë 13.11.2014 / Nr. Dok. 201402225

#### ***Shënime Paraprake***

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, grupi i punës zhvilloi fillimisht takimin me drejtuesit e këtyre institucioneve dhe u komunikoi atyre qëllimin e vizitës. Nga ana e drejtuesve të këtyre organeve u shpreh gatishmëri për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit inspektues. Në vijim të inspektimit, ekipi pati konsultime të frytshme me Shefin e Komisarlatit të Policisë Sarandë, Shefat e Rendit dhe të Sigurisë Publike në Komisarlatet e Policisë Vlorë dhe Delvinë si dhe me zyrtarë të tjerë të këtyre njësive policore.

Në bisedë me personelin e policisë, grupi monitorues u njoh me nivelin e zbatimit të detyrave të lëna në kuadër të tërheqjes së vëmendjes nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë lidhur me institutin e shoqërimit dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, në ambientet e Policisë së Shtetit drejtuar Drejtorive të Policisë në Qarqe me anë të dok. Nr. 4577 prot. datë 18.09.2014. Përgjatë inspektimit grupi i punës konstatoi se, megjithëse në këtë Drejtori Policie ishin marrë disa masa, vazhdonin të ishin prezente disa problematika dhe konkretisht:



Grupi i punës mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës si dhe kontaktoi privatisht me personat e privuar nga liria. Inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

### ***Kushtet e ambienteve të shoqërimit***

Në Komisarariatet e Policisë Sarandë dhe Delvinë dhomat e vjetra të shoqërimit janë nxjerrë jashtë funksionit me Urdhër Nr.239, datë 28.05.2012 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit në vite. Mbajtja dhe trajtimi i personave të shoqëruar në këto komisariate policie sipas Urdhrit do të kryhej në ambientet e zyrave të punonjësve të policisë, të përcaktuar në këtë urdhër, në një kohë sa më shpejtë të jetë e mundur dhe jo detyrimisht 10 orë. Po ashtu në Urdhër specifikohet se personat nuk duhet të qëndrojnë të mbyllur dhe pa prezencën e punonjësit të policisë.

**Në Stacionin e Policisë Himarë** kishte vetëm një dhomë shoqërimi, me dimensione 3x3m, me dritare me dimensione 80x50cm, derë hekuri me dry dhe shul, pa ndriçim nga rrjeti, pa ngrohje, të pa lyer dhe të papastër. Dhoma e shoqërimit nuk ishte e pajisur me orenditë e nevojshme si tavolina, karrige apo stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Sipërfaqja dhe hapësira e dhomës së shoqërimit nuk ishte e bollshme për qëndrimin e personave si dhe nuk kishte dritare për realizimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Pavarësisht se kjo dhomë e vjetër e shoqërimit ishte nxjerrë jashtë funksionit me Urdhër Nr.239, datë 28.05.2012 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ajo vazhdonte të përdorej edhe në ditën e inspektimit.

**Në Komisariatin e Policisë Vlorë**, mjediset e shoqërimit janë në katin e parë të një godine dy katëshe, jashtë ndërtesës së Komisarariatit të Policisë. Ambienti i shoqërimit kishte një paradhomë dhe dhomë, me dimensione 3.5x3.5m dhe 4x4m, me dritare normale hapësira e të cilave lejonte ajrimin e ndriçimin e plotë natyral. Paradhoma ishte me derë hekuri me shul dhe me dry, me ndriçim nga rrjeti elektrik, e lyer, e pastër, por pa ngrohje. Dhomat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme si tavolina dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Brenda ambientit kishte tualet, i cili ishte jashtë funksionit, pasi nuk kishte ujë dhe pajisjet ishin të dëmtuara. Dhomat nuk ishin të ndara më vete, për femra, meshkuj dhe të mitur, sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Në ambientet e shoqërimit të shtetasve ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Në momentin e inspektimit kishte 2 persona të shoqëruar.

Përdorimi i ambienteve të papërshtatshme është konstatuar edhe më parë nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë inspektimeve të bëra. Për përmirësimin e kushteve të tyre i janë bërë disa rekomandime Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë dhe Komisariateve të varësisë, por rekomandimet, megjithëse janë mirëpritur në parim, në realitet nuk kanë gjetur zbatim praktik pasi rezulton se nuk është bërë asgjë konkrete për përmirësimin e tyre.

### ***Kushtet e ambienteve të sigurisë***

Në strukturën e **Komisariatit të Policisë Delvinë** nuk ka ambient të sigurisë dhe personat e ndaluar/ arrestuar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Vlorë.

Në **Komisariatit e Policisë Sarandë** dhomat e vjetra të sigurisë janë nxjerrë jashtë funksionit me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si ambiente jashtë standardit, në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit dhe organizmave ndërkombëtarë (CPT). E megjithatë gjatë inspektimit, në një nga dhomat e sigurisë u gjend një person i arrestuar. Punonjësit e policisë pretendonin se ky shtetas qëndronte në këto ambiente, për arsye se këto dhoma së fundmi ishin vënë përsëri në përdorim. Personi i arrestuar do të qëndronte në ato ambiente deri sa të arrinte urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Burgjeve, në të cilin do të përcaktohej IEVP-ja ku ky person do të vuajë masën e sigurisë apo dënimin. Në përgjithësi koha e qëndrimit të këtyre personave të arrestuar, në këto ambiente, varioonte nga 5 deri në 15 ditë. Mundësitë e këtij komisarati për t'i dërguar të arrestuarit në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Vlorë ishin të pakta për faktin e largësisë dhe se në kushtet aktuale këto ambiente konsideroheshin funksionale për përdorim dhe të ligjshme.

Punonjësit e policisë në Komisarariatit e Policisë Sarandë ishin të bindur se mbajtja e personave të ndaluar/ arrestuar apo të dyshuarve si autorë të veprave penale në ambientet e nxjerra jashtë funksionit nuk përbënte shkelje të urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.239, datë 28.05.2012. Vlenë të theksohet se këto ambiente nuk plotësojnë standardet, pasi nuk ofrojnë një ambient të ndarë më vete për femrat, meshkujt dhe të miturit. Dhoma e sigurisë nuk plotësonte normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme nuk ishte 10 metër katror, nuk ishte e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>. Për më shumë mungonin pajisjet dhe orënditë e nevojshme për jetesë si krevat, tavolinë stola etj. Dyshekët, batanijet dhe jastëkët ishin tepër të vjetër dhe të pa pastër. Në dhomë nuk kishte pajisje audio-vizive (kamera) për mbikëqyrjen e mbajtjen në kontroll të personit të arrestuar dhe ndaluar.

Në Komisarariatit e Policisë Vlorë kishte një ambient me dy dhoma sigurie, me dimensione të njëjta 4x3 m, me dritare me dimensione 50x30 cm me zgarë hekuri dhe rrjet teli, me dyer metalike me dry dhe shul. Dhomat kanë një korridor me dimensione 5x1.2 m në hyrje të të cilit kishte dy dyer prej zgare hekuri.

Dhomat e sigurisë ishin jashtë parametrave të përcaktuara në Ligjin Nr.9749, datë 04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe Manualin *“Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”*, pasi ambienti nuk ishte i ndarë më vete për femrat, meshkujt dhe të miturit. Dhomat nuk plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, pasi mungonin pajisjet dhe orënditë e nevojshme për jetesë si krevat, tavolinë, stola etj. Dyshekët, batanijet dhe jastëkët ishin tepër të vjetër dhe të papastër. Dritaret e dhomave nuk siguronin ajrim dhe ndriçim natyral të plotë. Në ambient nuk kishte pajisje audiovizive (kamera) për mbikëqyrjen e mbajtjen në kontroll të personit të arrestuar dhe ndaluar. Brenda ambientit kishte një tualet, me dush në gjendje pune, por nuk kishte ujë të rrjedhshëm për t'u larë.

Gjendja në të cilën ndodhej ambienti i sigurisë në Komisarariatit e Policisë Vlorë është tepër shqetësuese, për faktin se në këtë ambient ka një fluks të madh të personave të ndaluar/ arrestuar, duke qenë se ai është në funksion të komisariateve të policisë si dhe të stacioneve rajonale të policisë të Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë.

Punonjësit e policisë të kësaj drejtorie informuan se, për ndërtimin e dhomave të reja të sigurisë, sipas standardeve të përcaktuara në aktet normative, ekzistonte një projekt, por nuk kishte fonde të mjaftueshme për realizimin e tij.

Në momentin e inspektimit në këto ambiente ndodheshin 4 persona të ndaluar/ arrestuar, brenda afateve të vlerësimit të masës së sigurisë.

### ***Trajtimi i të ndaluarve/ arrestuarve në ambientet e sigurisë***

Në Komisarlatin e Policisë Sarandë u konstatua se të ndaluarit/ arrestuarit nuk kishin mundësi të bënin dush me ujë të ngrohtë apo akses për larje e pastrim të vazhdueshëm për arsye të mungesës së pajisjeve hidrosanitare në banja.

Të ndaluarve/ arrestuarve nuk u ofrohej mundësia të lexonin shtypin e ditës, i cili mund të sigurohej me shpenzimet e veta. Nuk lejohej dëgjimi i radiove individuale të cilat ushqehen me bateri dhe janë me kufje. Nuk kishte ambient për ushtrimin e rriteve fetare si dhe nuk lejoheshin të mbanin letër dhe laps për të shkruar, pastë e furçë dhëmbësh, pastë rroje, tubet dhe brisqe rroje të klasifikuar. Gjithashtu ata nuk merrnin nga Komisarlati i Policisë sapun, detergjente, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqirë e mjete të tjera për ruajtjen e higjienës e pastërtisë vetjake e të ambientit ku qëndronin, sipas normave e rregullave për këtë qëllim.

Meqenëse dritaret e dhomave nuk siguronin ajrim normal, nuk ishin krijuar kushte për ajrim e ventilim, që të mundësonin sjelljen e një sasive të mjaftueshme ajri me qëllim qarkullimin e tij. Nuk kishte ambient ajrimi më vete, ndaj personave të ndaluar dhe arrestuar nuk u ofrohej mundësia e ajrimit, sipas gjithë kërkesave të ligjit.

Në Komisarlatin e Policisë Vlorë u konstatua se të ndaluarit/ arrestuarit kishin rreth një muaj që nuk trajtoheshin me ushqim, sipas pikës 2.4 të kapitullit “Për trajtimin ushqimor” dhe pikës 16 të kapitullit “Për të drejtat e personave të arrestuar/ ndaluar në ambientet e policisë së shtetit”. Mos trajtimi i personave të ndaluar / arrestuar me ushqim nga ana e institucionit kishte ardhur si rezultat i mbarimit të kontratës dhe mos renovimit të saj nga ana e Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë dhe firmës ofruese të shërbimit ushqimor.

Gjatë gjithë kësaj periudhe të ndaluarit/ arrestuarit ishin trajtuar vetëm me ushqimin që u silllej nga familjarët.

Të ndaluarve/ arrestuarve iu bëhej kontrolli mjekësor sipas kërkesave të ligjit (brenda 24 orëve) shoqëruar me kartelën mjekësore për secilin. Në organikën e Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë kishte një mjek të përgjithshëm dhe një ambient (dhomë) të përshtatshëm për të bërë vizita. Medikamentet e kutisë së ndihmës së shpejtë siguroheshin në mënyrë të vazhdueshme me fondet e Drejtorisë së Policisë.

Të ndaluarve/ arrestuarve u ofrohej mundësia të lexonin shtypin e ditës, i cili sigurohej me shpenzimet e veta, si dhe u lejohej mbajtja e letrës dhe lapsit për të shkruar, pasta dhe furça e dhëmbëve, pasta e rrojës dhe brisqe rroje të plastifikuar.

Të ndaluarve/ arrestuarve nuk u sigurohej nga komisariatet e policisë sapun, detergjente, letër higjienikë, letra për fshirjen e duarve ose peshqir e mjete të tjera për ruajtjen e higjienës vetjake e të ambientit ku qëndrojnë.

Brenda dhomave të sigurisë nuk kishte të vendosur postera për të drejtat e personave të ndaluar dhe arrestuar në gjuhën shqipe dhe në disa gjuhë të huaja.

### ***Ambientet e intervistimit***

Në Komisaratin e Policisë Vlorë dhe Sarandë nuk kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve nga përfaqësuesit e akuzës dhe avokati. Në të dy komisariatet nuk kishte një ambient të veçantë intervistimi, të monitoruar, për kryerjen e veprimeve procedurale nga Oficerët e Policisë Gjyqësore .

Në zyrat e oficerëve të policisë nuk u gjetën sende apo prova materiale prania e të cilave ekspozon dhunë tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.

### ***Monitorimi i ambienteve të shoqërimit të sigurisë dhe hetimit***

Në asnjë Komisariat Policie nuk ka sistem monitorimi filmik për të mbajtur të mbikëqyrur ambientet e shoqërimit, të sigurisë dhe të intervistimit. Vlen të theksohet se Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ai ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Libri i personave të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia:

Në Stacionin e Policisë Himarë u konstatua se, libri i shoqërimit nuk ishte i ndërtuar sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, pasi ky regjistër ishte i një formati të vjetër dhe përdorej njëkohësisht si për regjistrimin e personave të shoqëruar ashtu dhe për ato të ndaluar/ arrestuar. Si rrjedhojë nuk mund të plotësoheshin të gjitha rubrikat ku duhet të pasqyrohen të dhëna për personat e shoqëruar pasi instituti i shoqërimit ka të tjera specifika dhe kërkesa ligjore nga ai i të ndaluarve/ arrestuarve.

Në komisaratin e Policisë Sarandë nuk mbahej regjistër personash të shoqëruar me shpjegimin nga ana e shefit të Komisaritatit se, meqë nuk kishin ambiente të miratuara si dhoma shoqërimi, ky komisariat nuk realizonte dot shoqërim të shtetasve në kuadër të nenit 11 pika 6 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Lidhur me këtë praktikë dhe ligjshmërisë së saj, sipas MKPT-së, kërkohet një vlerësim dhe qëndrim i qartë nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë.

Në Komisaritatet e Policisë Delvinë dhe Vlorë u konstatua se, librat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të shtetasve ishin modeluar sipas kërkesave të Ligjit Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për

Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, pasi në ishin hapur të gjitha rubrikat ku duhet të pasqyroheshin të dhëna për personat e shoqëruar, ndaluar/ arrestuar, por u konstatuan se kishin raste që rubrikat e tij nuk plotësohen sipas kërkesave të përcaktuara në ligj. Më konkretisht, rubrika e njoftimit të familjarëve, përsëri nuk plotësohej saktë, pasi shkruhej “u njoftua familja” dhe nuk hidheshin të plota të dhënat e personit që mori njoftimin. Vlen të theksohet se njoftimi i familjarëve të të shoqëruarit për shoqërimin e tij në polici dhe arsyet ligjore, përbën detyrim ligjor për punonjësit e policisë, i cili është parashikuar në nenin 107 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Punonjësit e policisë pretendonin se bëhej njoftimi i familjarëve, mirëpo fakti që nuk pasqyrohet në libër ky veprim, lë vend për dyshim të arsyeshëm që ky veprim nuk kryhej.

Në ballafaqimin që grupi i monitorimit i bëri praktikave të punës së policisë me librat e shoqërimit të shtetasve, rezulton se, në disa raste, janë shoqëruar në polici persona jashtë kriterëve ligjore të përcaktuara në nenet 11/ 6, 101/ 1/ “a” dhe “b” dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Vazhdohej të trajtoheshin si të shoqëruar persona që dyshohej se kishin kryer vepra penale si, vrasje, vjedhje, kundërshtim të punonjësve të policisë, persona që ishin në kërkim, persona për shkak të konflikteve midis tyre, për prishje rendi, për rrahje, për dhunë në familje, shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor etj., megjithëse këta persona kishin qenë të identifikuar.

Grupet e personave të shoqëruar në mënyrë të paligjshme të konstatuar gjatë inspektimit mund të kategorizohen si më poshtë :

- Persona që kishin kryer apo dyshohej se kishin kryer vepra penale si, vrasje, kundërshtim të punonjësve të policisë, vjedhje, prishje të rendit dhe qetësisë publike, rrahje, dhunë në familje etj. Në këto raste policia duhet të veprojë sipas dispozitave ligjore, neni 253 i K.Pr.Penale.
- Persona për të cilët lind nevoja për të marrë prej tyre informacion për parandalimin e një rreziku, për të identifikuar persona që mund të kenë dijeni për rrezikun apo incidentin dhe për të identifikuar shkelësit e mundshëm të ligjit. Në këto raste nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar e drejta ligjore për “njoftim për paraqitje në polici”, e parashikuar në nenin 100 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe jo të bëhet shoqërimi i tyre në organin e policisë.
- Persona në kërkim. Vlen të theksohet se për këtë kategori personash ndaj të cilëve është nxjerrë urdhër ekzekutimi i një vendimi penal, si dhe në rastet kur një person ka kryer më parë apo dyshohet si autor i mundshëm i një vepre penale (është fjala kur nuk jemi në kushtet e flagrancës), personat duhet të ndalohen sipas neneve 253 dhe 464 të K.Pr.Penale
- Persona të shoqëruar për shkak të një konflikti, veprim i cili nuk është i parashikuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit”. Meqenëse qëllimi i shoqërimit nga policia në këtë rast është për parandalimin e ndonjë krimi të mundshëm ndërmjet të konfliktuarve, grupi inspektues nuk i konsideron veprimet e policisë si jo korrekte, por kjo nuk do të thotë që këta persona të trajtohen me statusin e personave të shoqëruar. Personat e kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale apo menjëherë pas kryerjes së saj, duhet të arrestohen menjëherë sipas nenit 251 të K.Pr.Penale dhe pa e mbajtur atë në gjendje

shoqërimi 10 orë. Ndërsa ndaj personave që tregojnë rrethana të dobishme për hetimin, nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar e drejta ligjore e parashikuar në nenin 312 i K.Pr.Penale dhe nenin 100 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” duke i thirrur ata me urdhër apo fletë thirrje dhe paralajmëruar për shoqërim të detyrueshëm në rast mosparaqitje pa patur pengesë të ligjshme.

Në shumë raste arsyeja e shoqërimit në Komisaritet e Policisë vijon të jetë “për verifikim”. Kjo lloj arsyeje e shoqërimit është e përgjithshme dhe ka nevojë që të specifikohet konkretisht se për çfarë verifikimi konkret bëhet fjalë. Nga verifikimet e bëra në librat e shoqërimit dhe pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se, arsyeja e shoqërimit shënohet “për verifikim” edhe kur në fakt personi shoqërohet për rastet e tjera përmendura më lart.”

Bazuar në informacionet e marra nga vetë punonjësit e policisë vërehet se të shoqëruarve, në të gjitha organet e policisë u bëhet kontrolli personal dhe u hiqen e bllokohen sendet personale. Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 106, pika 3 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” në të cilin është parashikuar se: “Punonjësi i policisë bën kontrollin dhe këqyrjen fizike, me qëllim marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të sëmurë mendorë, të dehurve, të droguarve ose ndaj personave me sëmundje ngjitëse”. Ndërsa lidhur me bllokimin e sendeve personale, në nenin 108 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” është përcaktuar se: “Sendet mund të bllokohen vetëm nëse është krejtësisht i pashmangshëm evitimi i kërcënimit të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike”.

Gjithashtu, gjatë këtij inspektimi përsëri u konstatua se në shumicën e Komisariateve të Policisë nuk respektoheshin kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Kodin e Procedurës Penale, lidhur me orën e ndalimit apo arrestimit të shtetasve. Duke vendosur në procesverbalet e arrestimit dhe të ndalimit orën e përpilimit të procesverbaleve të arrestimit apo ndalimit dhe jo orën faktike kur u është privuar liria. Në fakt, atyre nuk u llogaritej në kohën e paraburgimit dhe më pas edhe atë të vuajtjes së dënimit koha e qëndrimit si të shoqëruar, gjatë së cilës policia bën verifikime apo veprimet e ndryshme procedurale, kohë e cila mund të shkojë deri në 10 orë. Në bazë të neneve 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Mbajtjen në këtë gjendje punonjësit e policisë e justifikojnë me mendësinë se, “në qoftë se do t’i arrestojnë personat që në momentin e parë, atëherë nuk mund të kryejnë asnjë veprim procedural për të provuar veprën e kryer”. Ky qëndrim dhe justifikim nuk ka mbështetje ligjore, përkundrazi bëhet në kundërshtim me dispozitat e K.Pr.Penale. Sipas neneve 30 dhe 294 të K.Pr.Penale, policia gjyqësore, atributet e të cilës i kanë edhe punonjësit e Policisë së Shtetit, “edhe pas referimit të veprës penale te prokurori, ka të drejtë të kryejë me iniciativën e vet funksionet e tij ligjore si, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme të veprës penale, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal”.

Këto problematika vijojnë të jenë të pranishme pavarësisht rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe Letër-Porosisë së Drejtorit të Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Nr. 4577, dt. 18.09.2014 “Për shoqërimin dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar gjatë veprimtarisë së Policisë së Shtetit”. Në përmbajtje të kësaj të fundit parashikohet që, personat e dyshuar si autorë të veprave penale dhe ata të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, të mos trajtohen e mbahen si të shoqëruar, por ndaj tyre të aplikohet menjëherë masa e arrestit në flagrancë apo e ndalimit.

Gjatë intervistave me personat e ndaluar dhe arrestuar grupi i punës një rëndësi të veçantë i kushtoi mënyrës së trajtimit fizik të këtyre personave gjatë qëndrimit në këto ambiente. Gjatë intervistave nuk pati pretendime për ushtrim të dhunës fizike nga punonjës të Policisë së Shtetit në ambientet e dhomave të sigurisë. Sipas informacionit të marrë nga punonjësit e policisë që punojnë në ambientet e sigurisë rezulton se në dhomat e sigurisë mbahen persona të paraburgosur ndaj të cilëve është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”, si dhe persona të ndaluar për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim të formës së prerë, të dhënë në mungesë. Ata nuk dërgoheshin në kohë në institucionet e paraburgimit dhe ato të burgimit në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për shkak të pengesave që krijon vazhdimisht kjo Drejtori. Koha e qëndrimit të tyre në ambientet e policisë pas caktimit të masave të sigurimit ose pas ndalimit shkon deri në 15 ditë.

Libri i ankesave të qytetarëve të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar ishte hapur në të gjithë Komisarariatet e Policisë në varësi të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë , por ai nuk është plotësuar është vënë në funksion.

### ***Ndihma juridike dhe psikologjike***

Gjatë inspektimit nuk u konstatuan raste kur të ndaluarit/ arrestuarit madhorë, që nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, të jenë pyetur pa praninë e mbrojtësit. Ndërsa për të ndaluarit/ arrestuarit e mitur, për të cilët ndihma juridike dhe psikologjike është e detyrueshme u konstatua se në organikën e Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë është parashikuar një specialist psikolog.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Në organikën e Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë kishte një mjek i përgjithshëm i cili brenda ambienteve të Komisarariatit të Policisë Vlorë kishte një ambient (dhomë) të përshtatshëm për të bërë vizita.

Gjatë vizitës monitoruese në këtë Institucion dhe bisedat në privatësi me personat në dhomat e sigurisë, u konstatua se mjeku kishte përmbushur detyrën e tij duke kryer vizita mjekësore për të gjithë personat e ndaluar/ arrestuar që gjendeshin në Komisariatin Vlorë.

Dhoma e vizitës së mjekut nuk gjendej brenda në regjim, ndaj dhe mjeku ishte i detyruar t'i kryente vizitat e tij ose brenda në dhomat e sigurisë, ose në raste të rralla në dhomën e tij.

Nga këqyrja e dokumentacionit të mjekut u konstatua se ekzistonte regjistri i vizitave mjekësore i cili mbahej me rregull nga ana e tij. Gjithashtu, kartelat mjekësore plotësoheshin për çdo të ndaluar/ arrestuar dhe një kopje e tyre mbahej në dhomën e mjekut.

Mbulimi i këtij shërbimi me ilaçe bëhej nga vetë institucioni për sëmundjet kronike dhe kryesisht për ato të urgjencës, por kishte raste të cilët në mënyrë preferenciale, zgjidhnin ta siguronin mjekimin e tyre nga familja.

Në Komisarlatin e Policisë Sarandë nuk kishte as dhomë për mjekun dhe as mjek dhe si rezultat nuk realizohej kontrolli mjekësor brenda 24 orëve sipas kërkesave të ligjit pasi ky komisarlat deri para pak kohësh nuk kishte ambiente sigurie të miratuara për mbajtjen e persona të ndaluar/ arrestuar.

Në Komisarlatin e Policisë Delvinë, nuk ka as dhomë për mjekun dhe as mjek, pasi ky komisarlat nuk ka ambiente sigurie ku qëndrojnë persona të ndaluar/ arrestuar.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit në Komisarlatet e Policisë Vlorë, Sarandë dhe Delvinë dhe Stacionin e Policisë Himarë sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
2. Marrja e masave për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë në Komisarlatin e Policisë Vlorë dhe Sarandë sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, Manualit “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”.
3. Marrja në analizë të procedurave dhe ligjshmërisë së rivënies në përdorim të dhomave të sigurisë në Komisarlatin Sarandë kushtet aktuale të të cilit përbëjnë trajtim degradues, si edhe cenojnë dinjitetin e çdo personi që mbahet në këto ambiente.
4. Marrja e masave të menjëhershme për sigurimin e shërbimit mjekësorë në Komisarlatin e Policisë Sarandë në mënyrë që të realizohet për personat e ndaluar/ arrestuar kontrolli mjekësor brenda 24 orëve sipas kërkesave të ligjit.
5. Marrja e masave të menjëhershme për trajtimin e të ndaluarve/ arrestuarve në Komisarlatin e Vlorës me ushqim, sipas kërkesave të përcaktuara në aktet normative.
6. Marrja e masave për pajisjen dhe plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar në Komisarlatet Sarandë dhe Delvinë dhe Stacionin e Policisë Himarë.
7. Marrja e masave për vënien në përdorim, sa më parë të jetë e mundur të librit të ankesave për personat e shoqëruar, ndaluar/ arrestuar në të gjithë Komisarlatet e Policisë në vartësi të Drejtorisë Policisë së Qarkut Vlorë.
8. Marrja e masave për respektimin e dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe të mos trajtohen fillimisht si të shoqëruar.
9. Marrja e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të intervistimit në të gjithë Komisarlatet e Policisë në vartësi të Drejtorisë Policisë së Qarkut Vlorë.



10. Marrja e masave për krijimin e dhomave të monitoruara të intervistimit të shtetasve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore, në Drejtorinë e Policisë Qarkut Vlorë dhe në komisariatet në varësi të saj.

**6.11. DPQ Fier dhe komisariate të varësisë:**

Komisariati i Policisë Lushnje, datë 16.12.2014 / Nr. Dok. 201402528

Komisariati i Policisë Mallakastër, datë 16.12.2014 / Nr. Dok. 201402527

Komisariati i Policisë Fier (DPQ), datë 16.12.2014 / Nr. Dok. 201402526

***Shënime Paraprake***

Përpara vizitës, grupi i monitorimit mbledhi të gjithë informacionin ligjor të nevojshëm për procesin e monitorimit (kode, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra dhe udhëzime). Monitorimi kaloi nëpër fazën e planifikimit të problematikës ku do përqendrohej, metodologjisë që do përdorej, identifikimin real të performancës, të treguesve që kanë bërë progres dhe të atyre treguesve që kanë nevojë për përmirësim.

Monitorimi kishte si objekt inspektimin, kryerjen e vizitave, vëzhgimin, mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave, veprimeve dhe praktikave të ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimit e të Ndalarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, dhe marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të tij”, si dhe të verifikimit të përmbushjeve të rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë sipas standardeve ligjore, heqjen nga përdorimi të dhomave që nuk plotësojnë kriteret e domosdoshme, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit gjatë shoqërimit apo ndalim/ arrestimit të shtetasve.

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, grupi i punës zhvilloi fillimisht takimin me drejtuesit e këtyre institucioneve dhe u komunikoi atyre qëllimin e vizitës. Nga ana e drejtuesve të këtyre organeve u shpreh gatishmëri për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit inspektues. Në vijim të inspektimit, ekipi pati konsultime të frytshme me Shefin e Komisarariatit të Policisë Lushnje, Shefat e Rendit dhe të Sigurisë Publike në Komisarariatet e Policisë Fier dhe Mallakastër si dhe me zyrtarë të tjerë të këtyre njësive policore nga ku mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës si dhe kontaktoi privatisht me personat e privuar nga liria. Grupi i punës gjithashtu inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Në bisedë me personelin e policisë, grupi monitorues u njoh me nivelin e zbatimit të detyrave të lëna në kuadër të tërheqjes së vëmendjes nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë lidhur me institutin e shoqërimit dhe respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, në ambientet e Policisë së Shtetit drejtuar Drejtorive të Policisë në Qarqe me anë të dok. Nr. 4577 prot. datë 18.09.2014. Përgjatë inspektimit grupi i punës konstatoi se, megjithëse në këtë Drejtori Policie ishin marrë disa masa, vazhdonin të ishin prezente disa problematika dhe konkretisht:

### ***Kushtet e ambienteve të shoqërimit***

Në **Komisariatit e Policisë Fier**, mjediset e shoqërimit janë ndërtuar rishtaz dhe sipas gjithë kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Ato janë të ndara në mënyrë të veçantë për femrat, meshkujt dhe të miturit. Sipërfaqja dhe hapësira e dhomave të shoqërimit, për femra dhe të mitur ishte e bollshme për qëndrim. Dhomat kishin dritare për sigurimin e ajrimit e ndriçimit të plotë natyral. Gjithsesi orenditë në këto dhoma (tavolinat dhe karriget) ishin dëmtuar deri në pikën ku ishin bërë të papërshtatshme. Dhoma e shoqërimit për të mitur ishte bosh, pa tavolinë dhe karrige. Kishte një tualet, pajisjet e të cilit ishin të dëmtuara duke e bërë atë jo funksional. Dyert vazhdonin të ishin me material hekuri, por të pa mbyllura me shul dhe dryna. Referuar pikës 4 të Letër-Porosisë Nr. 703, datë 07.08.2008 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhomat e shoqërimit duhet të jenë “... pa dyer të blinduara e pa hekura, me dritare të përmasave normale që të lejojë hyrjen e dritës e të ajrimit të plotë natyral, me tavolina e karrige pune, të lyera e të pastra, sipas kriterëve që duhet të plotësojë një zyrë pritje”.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Lidhur me kushtet e ambienteve të shoqërimit në **Komisariatet e Policisë Lushnje dhe Mallakastër**, nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit është rekomanduar ndërtimi i ambienteve të reja sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” me qëllim për të krijuar kushtet për trajtim të përshtatshëm dhe dinjitoz. Por, nga inspektimi i kryer konstatohet se pavarësisht mirëmbajtjes që bëhet nga ana e punonjësve të këtyre komisariateve gjendja është pothuajse e njëjtë dhe konkretisht:

Në Komisariatit e Policisë Lushnje vazhdon të ketë vetëm një dhomë shoqërimi me përmasa 5m x 4.5m, me derë druri, me dy dritare me përmasa 1.2m x 1.3m, të cilat krijojnë mundësinë për ajrim e ndriçim të plotë natyral. Dhoma ishte në fazë të rikonstruksionit ku po punohej për rregullimin, lyerjen dhe pajisjen e saj sipas standardit. Kjo dhomë ishte përdorur vetëm për personat e shoqëruar madhorë meshkuj, ndërsa të shoqëruarit e mitur dhe femra mbaheshin në korridoret e Komisariatit të Policisë, ose në zyrat e punonjësve të policisë. Meqenëse nuk kishte tualet të veçantë për personat e shoqëruar, në rast nevojë ato dërgoheshin në tualetin e Komisariatit të Policisë, i cili përdoret edhe nga punonjësit e këtij komisariati.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Gjithashtu dhe në Komisariatit e Policisë Mallakastër ishte në ndërtim e sipër një ambient shoqërimi me paradhomë dhe dhomë shoqërimi me përmasa 4m x 4m, dhe me ndriçim natyral. Nga stafi u informuam se ky ambient do të përdorej vetëm për personat e shoqëruar madhorë meshkuj, ndërsa të shoqëruarit e mitur dhe femra do vazhdojnë të mbahen në korridoret e komisariatit. Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

### ***Kushtet e ambienteve të sigurisë***

Në strukturën e Komisariatit të Policisë Mallakastër nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e ndaluar/ arrestuar dërgohen në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Fier ose Lushnjë.

Në Komisarlatin e Policisë Fier kishte gjashtë dhoma sigurie. Dhomat ishin të ndërtuara sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualit “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, pasi ishin të ndara më vete, për meshkuj, femra dhe të mitur. Dhomat plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte 10 metër katror, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>. Këto ambiente ishin të pajisura me orenditë e nevojshme për jetesë, si krevat, tavolinë, stola etj. Kishte akses për larje e pastrim të vazhdueshëm në banjën e përbashkët ku uji i ngrohtë sigurohej gjatë gjithë kohës. Dyshekët, batanijet dhe jastëkët ishin në gjendje të mirë, por këto të fundit kërkonin larje më të shpeshtë. Dritaret e dhomave mundësonin sjelljen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Kishte zile të emergjencës, e cila mundësonte komunikimin me shërbimin e policisë në një moment nevojë të ngutshme. Për të ndaluarit/ arrestuarit bartës të sëmundjeve ngjitëse, kishte ambiente më vete të ndarë dhe të izoluar nga të tjerët. Në momentin e inspektimit në këto ambiente ndodheshin 3 persona të cilët ishin brenda afateve për vlerësim të masës së sigurisë nga ana e Prokurorisë.

Në Komisarlatin e Policisë Lushnjë, situata brenda ambientit të sigurisë vazhdonte të ishte shqetësuese, pasi dhomat ishin të nëndheshme, me mundësi të pakët ajrimi dhe me shumë lagështirë. Gjendja në të cilën ato ndodheshin krijonte premisat për dëmtim të rëndë për shëndetin e personave të ndaluar/ arrestuar, të cilët ka raste që qëndrojnë disa ditë (10-15 ditë), por dhe të punonjësve të policisë që shërbejnë në këto ambiente. Edhe pse nga punonjësit e këtij Komisarlati Policie nuk mungonte kujdesi për higjienën, përsëri dhomat nuk plotësonin standardet e përcaktuara në ligj. Dhomat nuk ishin të pajisura me orenditë e nevojshme për jetesë si krevat, tavolinë, stola etj. Dyshekët, batanijet dhe jastëkët ishin të vjetra dhe të papastra. Tualalet ishte i pastër dhe me ujë të rrjedhshëm, por nuk ishte i ndarë më vete për meshkuj dhe femra. Të ndaluarit/ arrestuarit kishin akses për t’u larë pasi dushi ishte në gjendje pune. Në këto ambiente nuk kishte ndriçim natyral dhe ventilim. Nuk kishte zile të emergjencës, për pasojë mungonte mundësia e komunikimit me shërbimin e policisë në një moment pasigurie. Nuk kishte ambient më vete, për të ndaluarit/ arrestuarit që mund të ishin bartës të sëmundjeve ngjitëse. Kishte ambient ajrimi më vete dhe personat e ndaluar/ arrestuar dilnin në ajrim sipas kërkesave të ligjit (jo më pak se dy orë në ditë). Nuk kishte pajisje për mbikëqyrjen e ambienteve me kamera. Në momentin e inspektimit në këto ambiente ndodheshin 5 persona nga të cilët 2 ishin brenda afateve për vlerësim të masës së sigurisë dhe 3 të tjerë në pritje të transferimit të tyre në IEVP.

### ***Trajtimi i të ndaluarve/ arrestuarve në ambientet e sigurisë***

Grupi i monitorimit intervistoi 8 personat e ndaluar/ arrestuar, nga të cilët nuk kishte asnjë të gjinisë femër. Personat e intervistuar nga grupi i monitorimit konfirmuan se ishin trajtuar në mënyrë korrekte përgjatë kohës së qëndrimit në arrest policor. Nga të intervistuarit nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike.

Gjendja psikologjike e të intervistuarve ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi. Të intervistuarit nuk dëshmuuan frikë, intimidim, për të raportuar keqtrajtimin e tyre.

Shtetasit e intervistuar ishin, në çdo rast, në gjendje të raportnin identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt. Të arrestuarit e Komisarariatit Fier shpjeguan se, gjatë ndalimit/ arrestimit të tyre kishin qenë prezent edhe punonjës policie pa uniformë, por të identifikuar përpara këtyre të fundit.

Në grupin e personave të ndaluar/ arrestuar, nga grupi i monitorimit nuk u konstatuan persona të mitur.

Pjesa më e madhe e personave të intervistuar nga grupi i monitorimit konfirmoi se procesi i ndalimit/ arrestimit, dërgimit në komisarariat, deri në vendosjen në dhomat e sigurisë ishte kryer në përputhje me procedurat ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, Ligjin “Për policinë e shtetit” dhe Manualin e Rregullave dhe Procedurave Standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe të ndaluar, në njësitë policore”, miratuar me Urdhrin nr. 763, datë 27.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjatë intervistave të kryera nga grupi i monitorimit nuk u pretendua prej shtetasve të ndaluar/ arrestuar për mospërputhje mes kohës (orës) kur ishin ndaluar apo arrestuar me orën e shënuar në procesverbalet e arrestimit në flagrancë.

Nga informacionet e mbledhura gjatë vizitës, u konstatua se, personave të ndaluar/ arrestuar u ishte dhënë mundësia për të folur me një të afërm mbas arrestimit. Megjithatë, nga këqyrja e librit të evidentimit të personave të ndaluar/ arrestuar u konstatua se një numri të konsiderueshëm të personave të ndaluar/ të arrestuar nuk iu ishte ofruar mundësia të njoftonin familjarët menjëherë pas privimit të tyre nga liria. Në regjistrat përkatës mungonte pasqyrimi i njoftimit të familjarëve në kolonën përkatëse.

Gjatë vizitës u konstatua që në ambientet e dhomave të sigurisë së Komisariateve Fier dhe Lushnje nuk kishte aparat telefonik, me qëllim që të ndaluarit/ arrestuarit të komunikonin me familjarët e tyre.

Të ndaluarit/ arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët Nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Në të dy Komisarariatet e Policisë Fier dhe Lushnje ushqimi sigurohej nga jashtë përmes një kompanie private.

Të ndaluarve/ arrestuarve në Komisariatin e Lushnjës nuk u ofrohej mundësia të lexonin shtypin e ditës, i cili mund të sigurohej me shpenzimet e veta. Nuk lejohej dëgjimi i radiove individuale të cilat ushqehen me bateri dhe janë me kufje. Nuk kishte ambient për ushtrimin e riteve fetare, si dhe nuk lejohej të mbanin letër dhe laps për të shkruar, pastë e furçë dhëmbësh, pastë rroje, tubet dhe brisqe rroje të klasifikuar. Gjithashtu ata nuk merrnin nga Komisariatit i Policisë Lushnje sapun, detergjente, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqirë e mjete të tjera për ruajtjen e higjienës e pastërtisë vetjake e të ambientit ku qëndronin, sipas normave e

rregullave për këtë qëllim. Këto produkte në pjesën më të madhe të ndaluarve/ arrestuarve u siguroheshin nga familjet.

### ***Ndihma juridike***

Nga kontaktet dhe informacionet e mbledhura gjatë vizitës u vërejt që disa prej të intervistuarve gëzonin aksesin për një avokat që në momentin e parë të privimit nga liria, duke bërë të mundur që avokati të ishte i pranishëm gjatë marrjes në pyetje nga ana e policisë. Megjithatë nga intervistat e zhvilluara u vërejtën vonesa në aksesin për të patur avokat, duke marrë deklarata formale nga personat e ndaluar/ të arrestuar pa praninë e mbrojtësit. Një pjesë e personave të arrestuar pretenduan që pavarësisht se kishin kërkuar praninë e një mbrojtësi kryesisht, përgjatë kohës së qëndrimit të tyre në dhomat e sigurisë nuk kishin marrë asnjë kontakt me të. Gjithashtu u konstatua fakti që të ndaluarit/ arrestuarit, e kishin të pamundur për të bërë zgjedhjen e mbrojtjes, pasi lista e avokatëve mbrojtës nuk ishte e afishuar.

Brenda dhomave të sigurisë si në komisariatit e Fierit, ashtu dhe në atë të Lushnjës, kishte të vendosur postera për të drejtat e personave të ndaluar dhe arrestuar në gjuhën shqipe, si dhe në disa gjuhë të huaja.

Gjatë vizitës së bërë në ambientet e komisariateve të policisë, u konstatua se në korridore, zyra të oficerëve të policisë gjyqësore ashtu dhe brenda dhomave të shoqërimit dhe sigurisë ishin afishuar të drejtat e personave të shoqëruar/ të ndaluar/ të arrestuar. Gjatë intervistave të bëra me shtetasit e ndaluar/ të arrestuar, një pjesë e tyre pohuan se ishin njohur me të drejtat e tyre nga ana e punonjësve të policisë që në momentin e parë të ndalimit/ arrestimit. Megjithatë gjatë intervistave të kryera u konstatuan raste të personave të ndaluar/ të arrestuar të cilët nuk kishin marrë informacionin e nevojshëm për ekzistencën e të drejtave të tyre, që në momentin e parë të privimit të lirisë.

Mungesa e informacionit të shtetasve të shoqëruar, të ndaluar/ të arrestuar për të drejtat e tyre është shoqëruar me mungesë të aksesit për të njoftuar familjarët për faktin e privimit të lirisë si dhe/ ose me mungesë të aksesit për avokat që nga momenti i fillimit të privimit të lirisë ndaj shtetasit të ndaluar/ arrestuar. Kjo dukuri konstatohet lehtësisht në mosplotësimin e rubrikave të posaçme në librin e evidentimit të personave të ndaluar/ arrestuar. Gjithashtu gjatë marrjes në pyetje nga grupi i monitorimit, u konstatuan raste që shtetasit e arrestuar nuk ishin njohur me të drejtën për të mos folur, si dhe me të drejtën për avokat mbrojtës.

### ***Ambientet e marrjes në pyetje dhe të hetimit***

Në Komisariatit e Policisë Fier kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve nga përfaqësuesit e akuzës dhe avokati, ndërsa ambient të veçantë hetimi të monitoruar me kamera për kryerjen e veprimeve procedurale nga Oficerët e Policisë Gjyqësore nuk kishte në asnjë nga komisariatet në varësi të Drejtorisë Policisë Qarkut Fier.

Në zyrat e oficerëve të policisë nuk u gjetën sende apo prova materiale, prania e të cilave ekspozon dhunë tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.

Duke përjashtuar Komisarlatin e Policisë Fier, në komisarlatet e tjera nuk ka sistem monitorimi filmik për mbajtjen në vëzhgim të ambienteve të shoqërimit, të sigurisë dhe të hetimit. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Në organikën e Drejtorisë së Policisë Qarkut Fier kishte një mjek të përgjithshëm i cili punonte një ambient (dhomë) të përshtatshme për të bërë vizita. Medikamentet e kutisë së ndihmës së shpejtë siguroheshin në mënyrë të vazhdueshme me fondet e Drejtorisë së Policisë. Nuk kishte ambulancë për raste urgjence, apo për rastet kur policia kryente operacione policore.

Të ndaluarve/ arrestuarve në Komisarlatin e Fierit iu bëhej kontrolli mjekësor sipas kërkesave të ligjit (brenda 12 orëve) shoqëruar me plotësimin e kartelës mjekësore për secilin. Në momentin e inspektimit, mjeku i Institucionit nuk u gjend në detyrë, ndaj dhe gjithë informacioni në lidhje me shërbimin shëndetësor u mor nga stafi drejtues dhe personeli i dhomave të sigurisë. Nga intervistat me të ndaluar/ arrestuarit që gjendeshin në dhomat e sigurisë u konstatua se mjeku kishte ndjekur të gjithë procedurën e nevojshme, që nga vizita mjekësore e personave të ndaluar/ arrestuar të cilët gjendeshin në dhomat e sigurisë deri në plotësimin e dokumentacionit përkatës.

Shërbimi shëndetësor në Komisarlatin e Lushnjës mbulohej nga mjeku i DPQ Fier. Sipas informacionit të dhënë nga personeli i dhomave të sigurisë në këtë komisarlat, mjeku kryente vizita tre herë në javë në këtë Institucion.

Në momentin e vizitës monitoruese, pas shqyrtimit të dosjeve personale të personave të ndaluar/ arrestuar që ndodheshin në dhomat e sigurisë, grupi i ekspertëve, konstatoi se vizitat mjekësore të mjekut nuk kryheshin brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në këto dhoma, sikurse përcaktohet në Manualin e Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin e Personave të ndaluar/ arrestuar. Grupi inspektues konstatoi se këto kartela plotësoheshin me vonesë nga ana e mjekut, për shkak edhe të largësisë dhe pranisë së tij me kohë të pjesshme në Komisarlatin e Lushnjës.

Ashtu siç është përshkruar edhe në Manualin e rregullave dhe procedurave standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe ndaluar në njësitë policore (Kreu II, pika 7), për personat e arrestuar/ ndaluar përpara akomodimit në sistemin e dhomave të sigurisë duhet të bëhej marrja në pyetje dhe verifikimi nga ana e mjekut për shenja dhune, keqtrajtimi apo sëmundje të ndryshme. Gjithashtu dispozitat parashikojnë që çdo person i ndaluar/ arrestuar duhet të jetë subjekt i një vizite mjekësore (kundrejt dëshirës) nga mjeku/ ndihmësmjeku i drejtorisë apo komisarlatit të policisë brenda 12 orëve nga ndalimi/ arrestimi. E drejta për të pasur akses për mjek (duke përfshirë edhe mjekë të zgjedhur nga vetë i ndaluar/ arrestuari) shoqërohet në Manual edhe nga e drejta për të përfituar shërbim mjekësor falas gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e sigurisë (Kreu III, pika 1.9, 1.10). Zbatimi i duhur i këtyre dispozitave përbën garanci ndaj keqtrajtimit të mundshme nga policia..

***Libri i personave të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia***

Në të tre komisariatet e policisë të DPQ Fier konstatohet se, libri i shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të shtetasve është ndërtuar sipas kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, pasi në ta janë hapur të gjitha rubrikat ku duhet të pasqyrohen të dhëna për personat e shoqëruar, ndaluar/ arrestuar, por disa prej rubrikave nuk plotësohen sipas kërkesave të ligjit dhe konkretisht:

Në rubrikën ku flitet për arsyet e shoqërimit vërehet se, në të gjithë komisariatet e policisë, në shumicën e rasteve personat e shoqëruar trajtohen si të dyshuar për kryerjen e një vepre penale. Trajtimi i tyre në këtë mënyrë vjen në kundërshtim me nenin 11 pika 6 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” sipas të cilit, i shoqëruar konsiderohet një person që ka shkelur një rregull administrativ dhe jo një person që dyshohet si autor i një vepre penale apo i arrestuar në flagrancë.

Në rubrikën e njoftimit të familjarëve, jo gjithmonë pasqyrohet saktë, emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar si dhe fakti i shoqërimit, ndalimit apo arrestimit. Konstatohet se kjo rubrikë plotësohet duke shënuar “u njoftua familja, babai, djali, e ëma” pa specifikuar emrin e personit që u njoftua, ora e njoftimit dhe numri i telefonit të tij. Pavarësisht se nga punonjësit e policisë u pretendua se familjarët e personave të mbajtur në komisariatet e policisë njoftohen, gjykojmë se ky pretendim duhet provuar duke bërë plotësimin e rubrikës së njoftimit të familjarëve sipas kërkesave të lartpërmendura.

Gjithashtu fenomeni i konstatuar nga Avokati i Popullit lidhur me orën faktike të ndalimit apo arrestimit në flagrancë të shtetasve është prezent në këtë Drejtori Policie dhe komisariatet në varësi të saj. Nga krahasimi që bëri grupi i inspektimit ndërmjet orës së vendosur në procesverbalet e ndalimit apo arrestimit në flagrancë, të dy shtetasve G.H dhe E.N të arrestuar me dt.12 dhe 13 Dhjetorë që ndodheshin në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lushnje gjatë momentit të inspektimit, me orën që ishte shënuar në rubrikën e ndalim/ arrestimit në librin e të ndaluarve/ arrestuarve, u arrit në konkluzionin se në procesverbalet e ndalimit apo arrestimit në flagrancë nuk shënohej ora e çastit të ndalimit faktik të personit, por shënohej ora e përpilimit të procesverbalit.

Libri i ankesave të qytetarëve të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar janë të pranishëm në komisariate, por nuk janë vënë në funksionim pasi mungon shënimi dhe prania e ankesave.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për përfundimin e ndërtimit dhe vënien e tyre në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisarariatet e Policisë Mallakastër dhe Lushnjë sipas kërkesave të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
2. Marrja e masave për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë në Komisarariatit të Policisë Lushnjë sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”,

Manualit “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore” .

3. Marrja e masave të nevojshme për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar/ arrestuar nga policia të informohen plotësisht për të drejtat themelore që nga fillimi i heqjes së lirisë së tyre.
4. Marrja e masave të menjëhershme për sigurimin e shërbimit mjekësor në Komisariatin e Policisë Lushnjë në mënyrë që të realizohet për personat e ndaluar/ arrestuar kontrolli mjekësor brenda 12 orëve sipas kërkesave të ligjit.
5. Marrja e masave për pajisjen dhe plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar në Komisarimatet Mallakastër, Lushnjë dhe Fier.
6. Marrja e masave për vënien në përdorim, sa më parë të jetë e mundur, të librit të ankesave për personat e shoqëruar, ndaluar/ arrestuar në të gjithë Komisarimatet e Policisë në vartësi të Drejtorisë Policisë së Qarkut Fier.
7. Marrja e masave për respektimin e dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve, duke mos i trajtuar fillimisht si të shoqëruar.
8. Marrja e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të marrjes në pyetje në Komisarimatet e Policisë Lushnjë dhe Mallakastër.
9. Marrja e masave për krijimin e dhomave të monitoruara të marrjes në pyetje të shtetasve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore, në Drejtorinë e Policisë Qarkut Fier dhe në komisarimatet në varësi të saj.
10. Marrja e masave të nevojshme nga organet policore për informimin e personave të ndaluar/ arrestuar për të drejtën e një avokati mbrojtës, si dhe për mundësinë reale për të kontaktuar me një të tillë, përpara se të kryhet hetimi.
11. Marrja e masave të nevojshme për të siguruar që të gjithë personat e shoqëruar/ ndaluar/ arrestuar nga policia, të kontaktojnë me familjarët në momentin më të parë të arrestimit/ ndalimit, si dhe ta pasqyrojnë qartësisht këtë fakt në procesverbalet përkatëse dhe në regjistrat e shtetasve të shoqëruar/ ndaluar/ arrestuar.

#### **6.12. Rekomandim mbi situatën e mbipopullimit në Drejtoritë e Policisë së Qarqeve dhe Komisarimatet në varësi të tyre - Datë 06.01.2014 / Nr. Dok. 201402451**

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet ligjore për të kryer inspektime në të gjitha institucionet e privimit të ligjshëm të lirisë, gjatë vitit 2014, ka kryer inspektime në të gjitha njësitë policore në rang vendi.

Nga inspektimet e bëra, njësitë policore të cilat kanë në funksion ambiente për mbajtjen e personave të ndaluar dhe të arrestuar, si edhe kapacitetet e tyre zyrtare<sup>21</sup>, rezultojnë të jenë:

Nr.	Njësia Policore	Kapaciteti zyrtar (persona)	Të ndaluar/ të arrestuar në momentin e inspektimit

<sup>21</sup> Sipas shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Nr. 6426/ 1 Prot., datë 14.11.2014.



Nr.	Njësia Policore	Kapaciteti zyrtar (persona)	Të ndaluar/ të arrestuar në momentin e inspektimit
1.	Komisariati i Policisë Krujë	5	1
2.	Komisariati i Policisë Kavajë	4	4
3.	Komisariati i Policisë Durrës	9	4
4.	Komisariati i Policisë Elbasan	5	16
5.	Komisariati i Policisë Lezhë	4	11
6.	Komisariati i Policisë Peshkopi	8	7
7.	Komisariati i Policisë Mat	4	1
8.	Komisariati i Policisë Kukës	9	5
9.	Komisariati i Policisë Tropojë	2	0
10.	Komisariati i Policisë Berat	2	7
11.	Komisariati i Policisë Nr. 1	4	2
12.	Komisariati i Policisë Nr. 5	5	8
13.	Komisariati i Policisë Nr. 3	3	7
14.	Komisariati i Policisë Nr. 2	4	1
15.	Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë	10	30
16.	Komisariati i Policisë Korçë	7	9
17.	Komisariati i Policisë Gjirokastër	9	8
18.	Komisariati i Policisë Sarandë	4	1
19.	Komisariati i Policisë Vlorë	5	2
20.	Komisariati i Policisë Lushnjë	10	5
21.	Komisariati i Policisë Fier	8	3

Sikurse pasqyrohet në tabelë, një pjesë e komisariateve të policisë në momentin e inspektimit rezultojn në mbipopulluar. Komisarati i Elbasanit, i Lezhës, i Beratit, i Korçës, Komisarati nr. 3, 5 dhe Drejtoria e Qarkut Tiranë, janë qartazi mbi kapacitetin zyrtar.

Për të studiuar edhe më mirë fluksin ditor në dhomat e sigurisë, krahas inspektimeve, MKPT i drejtoi një kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme e Policisë së Shtetit, më datë 9.10.2014, mbi ngarkesën ditore për çdo komisarjat që ka dhomë sigurie, për një periudhë kohë dy javore, nga data 24 shtator deri më datën 8 tetor. Statistikat e marra në përgjigje të kërkesës, të rirënditura sipas ditëve kur është kryer inspektimi në komisarjatet përkatëse, paraqiten në vijim:

Nr.	Njësia Policore	Kapaciteti zyrtar (persona)	Datat sipas muajve														
			Shtator							Tetor							
			24	25	26	27	28	29	30	1	2	3	4	5	6	7	8
22.	Komisariati i Policisë Krujë	5	1	1	1	3	3	3	2	1	1	1	-	-	-	-	-
23.	Komisariati i Policisë Kavajë	4	4	1	1	1	1	2	-	1	-	-	-	-	-	-	-
24.	Komisariati i Policisë Durrës	9	12	8	12	11	13	16	12	6	7	8	8	9	7	5	5

25.	Komisariati i Policisë Elbasan	5	12	14	16	16	5	6	4	4	9	9	9	9	9	1	9
26.	Komisariati i Policisë Lezhë	4	11	9	4	7	8	7	5	6	5	6	3	7	8	8	4
27.	Komisariati i Policisë Peshkopi	8	3	1	1	1	-	-	-	-	-	1	1	-	-	-	-
28.	Komisariati i Policisë Mat	4	-	-	-	-	-	1	1	1	-	-	-	-	-	-	3
29.	Komisariati i Policisë Kukës	9	3	1	-	1	2	11	-	3	1	3	3	3	4	5	2
30.	Komisariati i Policisë Tropojë	2	2	2	1	-	2	2	3	1	-	1	2	2	1	-	1
31.	Komisariati i Policisë Berat	2	3	2	1	1	1	2	2	2	-	-	3	3	2	2	1
32.	Komisariati i Policisë Nr. 1	4	-	2	2	2	3	3	8	3	3	-	-	2	2	4	4
33.	Komisariati i Policisë Nr. 5	5	3	6	6	6	6	3	6	5	6	3	6	6	6	6	6
34.	Komisariati i Policisë Nr. 3	3	4	4	7	7	7	3	6	6	6	6	8	8	7	7	8
35.	Komisariati i Policisë Nr. 2	4	3	4	4	4	4	6	14	5	3	3	5	7	7	8	8
36.	Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë	10	10	10	10	11	16	16	31	24	19	19	23	19	25	27	31
37.	Komisariati i Policisë Korçë	7	12	9	9	6	1	3	2	3	4	4	4	7	7	12	12
38.	Komisariati i Policisë Gjirokastrë	9	2	2	-	-	-	3	2	-	2	3	3	2	-	2	6
39.	Komisariati i Policisë Sarandë	4	2	2	4	4	3	2	5	5	4	4	4	4	3	4	4
40.	Komisariati i Policisë Vlorë	5	9	7	9	5	5	6	6	5	8	9	7	7	6	7	3
41.	Komisariati i Policisë Lushnjë	10	4	7	2	-	1	-	2	1	-	-	-	-	1	1	1
42.	Komisariati i Policisë Fier	8	1	5	3	2	4	2	3	2	5	3	2	3	-	6	6

Sikurse pasqyrohet më lartë, pjesa më e madhe e komisariateve kanë pasur mbipopullim në pjesën më të madhe të periudhës së marrë në shqyrtim. Drejtoria e Qarkut Tiranë, Komisarati i Lezhës, ai i Elbasanit, i Durrësit, i Korçës, si edhe Komisaritet nr. 3 dhe nr. 5 të Qarkut Tiranë, thuajse gjatë gjithë 10 ditëshit të përzgjedhur në mënyrë rastësore, kanë punuar në mbipopullim. Po ashtu, krahasuar edhe me mbipopullimin në momentin e inspektimit të MKPT-së, rezulton se

Drejtoria e Qarkut Tiranë, Komisarati i Lezhës, i Elbasanit, si edhe Komisaritet nr. 3 dhe nr. 5 të Qarkut Tiranë punojnë në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar.

### ***Problematikat e mbipopullimit***

Mbipopullimi nëpër mjediset e sigurisë në njësitë policore në vend është një problematikë e pranishme, e prekshme dhe që ka nevojë imediate për t'u adresuar, pasi cenon respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, dëmton cilësinë e shërbimeve të ofruara ndaj kësaj kategorie, dhe krijon premisa për trajtim çnjerëzor dhe degradues.

Përgjatë inspektimeve të kryera, titullarët e njësive policore të inspektuara u kanë pohuar ndihmëskomisionerëve MKPT-së se mbipopullimi është një problematikë e pranishme që i mbivendoset kushteve të papërshtatshme të dhomave të sigurisë në komisariate. Rast përjashtimor nga më sipër janë komisaritet që kanë pasur investime për dhomat e sigurisë, të tilla si Komisarati i Durrësit e ai i Kukësit. Në njësitë e tjera policore, dhomat e sigurisë të cilat nuk i plotësonin standardet sipas Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011 “Për miratimin e Manualit të Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e të Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, janë mbyllur, duke bërë që personat e ndaluar/ arrestuar të transferohen në njësitë policore që kanë dhoma sigurie. Rrjedhimisht, në këto të fundit, është konstatuar situata e mbipopullimit.

Gjithashtu, gjatë inspektimeve MKPT ka konstatuar edhe raste të personave me masë sigurie, të cilët vijonin të qëndronin në dhomat e sigurisë në Komisaritet, në kundërshtim me kuadrin ligjor<sup>22</sup>. Sipas informacionit të marrë, personat me masë sigurie mund të qëndrojnë disa ditë deri në 10-20 ditë në komisariate, para se të transferohen në institucionet përkatëse të paraburgimit. Ndërkohë që sipas Nenit 258 par. 1, i KPP, një person i dyshuar për kryerjen e një veprë penale mund të mbahet nga policia në bazë të kompetencave të tyre deri në 48 orë, e cila brenda kësaj periudhe duhet t'ia referojë prokurorit përkatës. Bazuar në Nenin 257 të KPP brenda afatit kohor 48 orë nga momenti i arrestimit, prokurori duhet ta referojë tek gjyqtari përkatës dhe ky i fundit ka një afat prej 48 orësh nga momenti i paraqitjes së kërkesës, për të shpallur vendimit për vleftësimin e masës dhe caktimin e masës së sigurimit bazuar kjo, në Nenin 258 par. 2 dhe Nenin 259 të KPP. Pothuajse në çdo rast, titullarët e njësive policore të takuar nga MKPT shprehën shqetësimin e vonësive në transferimin e personave me masë sigurie në paraburgim për shkak se edhe IEVP-të kanë mbipopullim të tejskajshëm.

Një problematikë tjetër, e cila rëndon situatën e personave të ndaluar/ arrestuar, është edhe qëndrimi i tyre fizik brenda mjediseve të IEVP-ve, për shkak të marrëveshjeve të bëra mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas të cilave, IEVP-të ofrojnë mjedise për dhoma sigurie, të cilat menaxhohen nga komisaritetet përkatëse. Situata të tilla janë konstatuar në IEVP Tropojë, IEVP Berat, dhe IEVP Sarandë, ku përveç faktit të mbipopullimit dhe mjediseve jashtë standardit të vetë IEVP-ve, vendosja edhe e personave të ndaluar/ arrestuar aty e ngarkon situatën edhe më shumë.

---

<sup>22</sup> Bazuar në Nenin 259 të KPP, par. 3, 4, personat për të cilët gjykata ka vendosur masën e sigurisë “arrest me burg” duhet të transferohen në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në pritje të gjykimit.

Përveç sa më sipër, në bazë të regjistrave të inspektuar nga MKPT, rezulton se, në momentin e inspektimit, pjesa më e madhe e personave në dhomat e sigurisë, por edhe ata të transferuar, janë ndaluar/ arrestuar për vepra penale të tilla si:

- Drejtim mjete pa leje drejtimi (këtu pjesa më e madhe e personave të intervistuar ishin të mitur),
- Drejtim i automjetit në gjendje të dehur,
- Lidhje e paligjshme e energjisë elektrike,
- Dhunë në familje,
- Prodhim/ shpërndarje lëndësh narkotike, etj.

Duhet theksuar fakti që 3 veprat e para janë të përfshira rishtazi në Kodin Penal. Rrjedhimisht, një faktor tepër i rëndësishëm për mbipopullimin rezulton të jetë ashpërsimi i politikës penale, e cila nuk është mjete i vetëm për të fuqizuar rendin publik, e aq më pak shtetin e së drejtës. Tendencat evropiane janë për përfshirjen e dënimeve alternative, veçanërisht kur bëhet fjalë për të miturit.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për respektimin në frymë dhe letër të Kodit të Procedurës Penale, kryesisht Neni 251 dhe neni 255 lidhur me procedurat dhe detyrimet e OPGJ-ve gjatë ndalimit/ arrestimit të personave.
2. Marrja e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, respektimit të Kodit të Procedurës Penale, Nenin 259 të KPP, par. 3, 4, lidhur me afatet sa i takon ndalimit/ arrestimit të personave.
3. Marrja e masave për alokimin e fondeve lidhur me rikonstrukcionin në përputhje me standardet dhe vënien në funksionim të dhomave të mbyllura të sigurisë.
4. Marrja e masave për adresimin e çështjes së dhomave të sigurisë brenda IEVP-ve, si një praktikë jo e mirë, që rëndon situatën e vetë IEVP-ve, por edhe të personave të ndaluar/ arrestuar.

## **7. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014 në Forcat e Armatosura**

### **7.1. Batalioni i Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë - Datë 02.12.2014 / Nr. Dok. 201500026**

#### ***Shënime paraprake***

Vizita inspektuese në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë, u krye në kuadër të planit të vizitave periodike monitoruese të Avokatit të Popullit për vitin 2014. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues, kreu fillimisht takimin me Drejtuesin e Institucionit, i cili tregoi bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të vizitës, në zbatim të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Ekspertëve të grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhej të monitoronin.

Pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, mori takim privatisht me ushtarakun e vetëm me masë “*ndalim disiplinor*” që gjendej në Institucion, inspektoi dhomat e sigurisë dhe ambientet e përbashkëta të këtyre dhomave, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Më konkretisht, gjendja e përgjithshme si dhe problematikat e konstatuara në këtë Institucion, pasqyrohet më poshtë:

#### ***Kushtet në ambientet e sigurisë***

Në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk Tiranë kishte dhoma të sigurisë, që shërbenin për mbajtjen e ushtarakëve të cilëve iu jepej masa “*ndalim disiplinor*” sipas ligjit Nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit e të Drejtimit të FA të RSH”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9183, datë 05.02.2004 “Për Disiplinën Ushtarake në Forcat e Armatosura në RSH”.

Në këtë institucion, dhomat e sigurisë gjendeshin në një korridor të gjatë, i cili ndahej nga ambientet e tjera të kësaj godine me një derë hekuri. Në fund të korridorit të pambuluar me kamera vëzhguese, gjendej një skarë e cila shërbente për takimet me familjarët. Ambienti i takimit nuk përmbushte standardet në lidhje me kushtet higjieno-sanitare dhe pajisjen e saj me orendi të përshtatshme për të funksionuar si e tillë.

Nga të gjitha dhomat e sigurisë vetëm 4 prej tyre ishin funksionale. Dhomat kishin një hapësirë 6×5m me ndriçim natyral dhe artificial të mjaftueshëm, por të ftohta e me nivel të lartë lagështie, pasi në to mungonte ngrohja. Ato ishin të pajisura me 3 krevate me shtroja të vjetruara, e me banja në kushte jo të mira higjieno-sanitare. Në njërën syresh, lavamani ishte i thyer. Në banja kishte ujë të rrjedhshëm, por mungonte uji i ngrohtë. Në dhoma mungonin zilet elektronike.

Gjatë inspektimit në këto dhoma gjendej vetëm një person me masën “ndalim disiplinor”, i cili nuk kishte ankesa në lidhje me procedurën e ndjekur për masën e dhënë e as për kushtet e trajtimit të tij në dhomat e sigurisë.

Grupi inspektues konstatoi se posterat me të drejtat dhe detyrimet e ushtarakëve me masën “ndalim disiplinor” mungonin.

Nuk kishte një ambient të posaçëm për ajrim të ushtarakëve me masën “ndalim disiplinor”, por sipas stafit, atyre u jepej mundësia për të dalë herë pas here jashtë dhomave të sigurisë.

Në këtë Institucion, grupi inspektues konstatoi se plotësimi i regjistrave të ushtarakëve të ndaluar në të gjitha rubrikat e tyre ishte i mangët.

### ***Trajtimi i personave me masën “ndalim disiplinor” në ambientet e sigurisë***

Gjatë vizitës monitoruese, në dhomën e përgjegjës të dhomave të sigurisë në BPU u konstatua se mbahej një shkop gome dhe pranga, mjete këto që konsiderohen objekt intimidimi dhe presioni psikologjik.

Personat me masën “ndalim disiplinor” trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë, në mensën e Institucionit. Ambientet e mensës dhe kuzhinës mbaheshin të pastra e në to nuk u konstatuan mangësi.

Në dhomat e sigurisë së këtij Institucioni kishte ujë të rrjedhshëm në çdo kohë. Ndërkohë që pajisja e ushtarakëve të ndaluar me mjete të higjienës personale si sapun, detergjente, pasta, furça dhëmbësh, etj., ishte pothuajse inekzistente.

Grupi inspektues konstatoi se mungonte literatura informuese/ didaktike/ letrare, ndonëse kjo është një e drejtë e këtyre personave me masa të “ndalimit disiplinor”.

Sa i përket trajtimit mjekësor, grupi i inspektimit konstatoi se ky shërbim ofrohej rregullisht nga mjeku i Institucionit. Në rastet kur për problemet shëndetësore të personave paraqitej nevoja për konsultë ose trajtim më të specializuar, shërbimi ofrohej në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar Tiranë.

Dokumentacioni që administronte personeli i dhomave të sigurisë në këtë Institucion, ishte i përbërë nga libri i ndalimit disiplinor, libri i procesverbaleve, dhe libri i sendeve të ndalura. Nga shqyrtimi i këtyre regjistrave, u konstatua se kolonat për hyrjet dhe daljet e personave me masën disiplinore, në disa raste ishin të paplotësuara.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për rikonstrukcionin e dhomave të ndalimit disiplinor në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë dhe për pajisjen e tyre me zile elektrike.
2. Marrja e masave për afishimin e posterave me të drejtat dhe detyrimet e ushtarakëve me masën “ndalim disiplinor” dhe sigurimin e ngrohjes në dhomat e sigurisë.

3. Marrja e masave për sigurimin e paketave të plota të produkteve për higjienën personale.
4. Marrja e masave për përmirësimin e kushteve në dhomën e takimit me familjarët sipas standardeve të vendosura nga “Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore” si dhe protokollat e saj shtesë, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996.
5. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridorin ku ndodhen dhomat e sigurisë.
6. Marrja e masave për plotësimin me përgjegjësi të plotë të të gjitha rubrikave në regjistrat për ndalimin disiplinor.
7. Marrja e masave të menjëhershme për heqjen e mjeteve të forcës, shkop gome dhe pranga nga zyra e përgjegjësit të dhomave të sigurisë së Batalionit të Policisë Ushtarake Tiranë.

## **7.2. Komanda e Forcave Tokësore Vau i Dejës, Shkodër - Datë 10.12.2014 / Nr. Dok. 201500023**

### ***Shënime paraprake***

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues, kreu fillimisht takimin me një nga autoritetet e autorizuar nga Drejtuesi i Institucionit, i cili tregoi bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të vizitës, në zbatim të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Ekspertëve të grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhej të monitoronin.

Pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, inspektoi dhomat e sigurisë dhe ambientet e përbashkëta të këtyre dhomave, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Më konkretisht, gjendja e përgjithshme si dhe problematikat e konstatuara në këtë Institucion, pasqyrohet më poshtë:

### ***Kushtet në ambientet e sigurisë:***

Në Komandën e Forcave Tokësore, Reparti Ushtarak Nr.1010 Vau i Dejës, Shkodër kishte dhoma të sigurisë, që shërbenin për mbajtjen e ushtarakëve të cilëve iu jepej masa “ndalim disiplinor” sipas ligjit Nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit e të Drejtimit të FA të RSH”, i ndryshuar dhe ligjit Nr. 9183, datë 05.02.2004 “Për Disiplinën Ushtarake në Forcat e Armatosura në RSH”.

Dhoma e sigurisë ku zbatohet masa e “ndalimit disiplinor”, gjendej në një ambient të veçantë të godinës së këtij Institucioni. Ajo ishte e ndarë në një paradhomë dhe një dhomë. Të dyja kishin dyer hekuri dhe dritare të cilat shërbenin për kontroll nga ana e oficerit të rojës. Dhoma kishte një krevat marinar, tavolinë dhe dy karrige. Brenda saj kishte edhe një banjë, e cila ishte e rregullt, por shkarkimi i ujit në ËC rezultoi të kishte probleme. Paradhoma ishte e pajisur me tavolinë, karrige dhe një banjë me dush. Dritaret në të dyja këto ambiente ishin të plota dhe

siguronin ndriçim natyral të mjaftueshëm. Edhe ndriçimi artificial në këto ambiente ishte i bollshëm. Ngrohja në këto ambiente mungonte. Dhomat ishin të pastra dhe të mirëmbajtura.

Në korridor ishin shpallur të drejtat dhe detyrimet e ushtarakëve me masën “ndalim disiplinor” si dhe orari i veprimeve të tyre.

Mungonte dhoma e takimit me familjarët e ushtarakëve të ndaluar.

Për ajrimin e personave me ndalim disiplinor shërbente një hapësirë të përmasave 1.5 x 3m e rrethuar me rrjetë alumini, jashtë godinës ku ndodheshin paradhoma dhe dhoma e sigurisë.

Paradhoma dhe dhoma e sigurisë ku mbaheshin ushtarakët e ndaluar, nuk ishin të pajisura me zile dhe mungonte monitorimi me kamera vëzhguese në korridoret e tyre.

Gjatë inspektimit në këto ambiente nuk u gjend asnjë ushtarak me masën “ndalim disiplinor”.

Në këtë Institucion u konstatua se plotësimi i dokumentacionit të përgjegjës të dhomave të sigurisë ishte i mangët, për sa i përket datës dhe orës së fillimit të zbatimit të masës dhe përfundimin e saj.

#### ***Trajtimi i personave me masën “ndalim disiplinor” në ambientet e sigurisë:***

Personat me masën “ndalim disiplinor” trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë, në mensën e Institucionit. Ambientet e mensës dhe kuzhinës mbaheshin të pastra dhe në to nuk u konstatuan mangësi.

Në dhomat e sigurisë së këtij Institucioni kishte ujë të rrjedhshëm në çdo kohë.

Sa i përket trajtimit mjekësor, grupi i inspektimit konstatoi se ky shërbim ofrohej rregullisht nga mjeku i Institucionit. Në rastet kur për problemet shëndetësore të personave paraqitej nevoja për konsultë ose trajtim më të specializuar, shërbimi ofrohej në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar Tiranë.

Dokumentacioni që administronte personeli i dhomave të sigurisë në këtë Institucion, ishte i përbërë nga libri i ndalimit disiplinor, libri i procesverbaleve, dhe libri i sendeve të ndalura. Nga shqyrtimi i këtyre regjistrave, u konstatua se kolonat për hyrjet dhe daljet e personave me masë disiplinore, në disa raste ishin të paplotësuara.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për rikonstruksionin e dhomave të ndalimit disiplinor në Komandën e Forcave Tokësore, Reparti Ushtarak Nr.1010 Vau i Dejës, Shkodër dhe për pajisjen e tyre me zile elektrike.
2. Marrja e masave për sigurimin e ngrohjes në ambientet e sigurisë.
3. Marrja e masave për krijimin e dhomës së takimit me familjarët sipas standardeve të vendosura nga “Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat e Njeriut dhe Lirive



Themelore” si dhe protokollet e saj shtesë, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996.

4. Marrja e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e paradhomës dhe dhomës së sigurisë.
5. Marrja e masave për plotësimin me përgjegjësi të plotë të të gjitha rubrikave në regjistrat për ndalimin disiplinor.

## **8. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014 në Spitalet Psikiatrike**

### **8.1. Spitali Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan - Datë 23.06.2014 / Nr. Dok. 201401340**

#### *Shënime paraprake*

Kapaciteti maksimal i Spitalit Psikiatrik “Sadik Dinçi” është 310 shtretër, përfshirë këtu persona të shtruar, për vlerësim diagnoze e mjekimi, apo persona që kanë vite të shtruar në këtë spital dhe që tashmë janë kthyer në rezident të tij. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 332 persona, një numër që tregon dukshëm mbipopullimin në institucion.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtorin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të pacienteve, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni.

Nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve iu bë me dije se, Spitali Psikiatrik Elbasan ka një zonë mbulimi prej 1 363 903 banorësh, ku përfshihen rrethet e Elbasanit, Gramshit, Librazhdit, Peqinit, Korçës, Devollit, Pogradecit, Lushnjës dhe Durrësit. Ky spital është i ndarë në 8 pavijone, si dhe një pavijon pranimi. Pavijonet 2 dhe 8-të vazhdonin të trajtonin persona me prapambetje mendore në kundërshtim me ligjin për shëndetin mendor dhe aktet nënligjore të tij. Kishte tre pavijone (I, III, IV) ku trajtoheshin persona, të cilët kanë vite rezidentë në këtë spital, të quajtur ndryshe “kronikë”, tre pavijone të tjerët (V, VI dhe VII-ta), ku trajtoheshin, si persona që shtroheshin për herë të parë, ashtu edhe persona që kanë vite që janë rezidentë në këtë institucion, për shkak të braktisjes që i është bërë nga familja. Po ashtu, në këtë institucion ka një pavijon pranimi, i cili megjithëse duhej të funksiononte si i tillë, vetëm për shtrimet për herë të parë dhe rastet akute, ai mban prej kohësh pacientë “kronikë”, si burra ashtu edhe gra, duke bërë tepër të vështirë shtrimet e reja në pavijonet e tjera.

Në varësi të këtij institucioni janë edhe dy shtëpiza të mbështetura: Shtëpiza “Drita” Elbasan, ku banojnë 10 paciente gra, dhe Shtëpiza “Jeta” Cërrik ku banojnë 6 gra dhe 7 burra. Këto shtëpiza janë të kompletuar me staf mjekësor, infermierë dhe kujdestarë.

Vlen për t’u theksuar se, nga ana e infrastrukturës, godina e spitali kishte bërë përmirësime të dukshme, si për sa i përket ambienteve të përbashkëta të jashtme, ashtu edhe atyre të brendshme.

## ***Trajtimi***

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e pacientëve, në identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative, apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe shërbimin shëndetësor që i ofrohet të gjithë personave që shtrohen në këtë spital. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të shtruarit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Në spitalin psikiatrik Elbasan, në momentin e inspektimit, nuk kishte ankesa lidhur me ushqimin, veçanërisht në drejtim të cilësisë së gatimit.

Në bazë të informacionit që grupi i inspektimit mori nga stafi psiko-social, në gjashtëmujorin e fundit në këtë institucion kishte 8 raste për të cilët kërkohet heqja e zotësisë për të vepruar. Lidhur me këtë, stafi psiko-social nuk është vënë në dijeni për të gjithë procedurën e ndjekur, i cili, në bazë të legjislacionit në fuqi, është pjesë e ekipit multidisiplinar të institucionit. Rrjedhimisht, ky i fundit kishte problematika të funksionimit në bazë të parimit të transparencës brenda institucionit.

## ***Masat mbrojtëse***

Gjatë vizitës së monitorimit, grupi i ekspertëve konstatoi se në këtë institucion mungon sektori juridik, i cili, për shkak edhe të problematikave të lartpërmendura, bëhet një strukturë e domosdoshme. Prania e një sektori të tillë do të bënte të mundur mbrojtjen ligjore të interesave të institucionit, por edhe të personave të trajtuar në institucion, të cilët jo në pak raste mbeten të pambrojtur/ përfaqësuar ligjërisht dhe vulnerabël ndaj abuzimeve institucionale dhe/ apo familjare.

Komisioni i mjekëve për konsultat e shtrimit, formohej vetëm nga dy mjekë të këtij spitali, ndërkohë që mjeku psikiatër me formimin përkatës është lënë jashtë këtij komisioni, duke mos marrë pjesë në asnjë lloj vendimmarrjeje për pacientët që kërkojnë shtrim në këtë spital. Po ashtu, pranimi i të sëmurëve në urgjencën e spitalit vazhdon, kryesisht, të bëhet tërësisht në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e njeriut, duke u sjellë në spital me pranga nga forcat e rendit, të pashoqëruar nga familjarët dhe me argumentimin se janë rrezik për veten apo të tjerët. Shtrimi i personit në spital vendoset në bazë të konsultës, por në pjesën më të madhe të rasteve, në kundërshtim me parimin e trajtimit të personit me probleme të shëndetit mendor në komunitet, ky i fundit pranohet direkt për shtrim. Regjistri i konsultave dhe shtrimeve mbahej rregullisht nga krye infermierja e pavijonit të pranimit.

Po ashtu, grupi i ekspertëve konstatoi se, një problematikë e theksuar që ka mbetur ende pa u zgjidhur, është mungesa e infermierëve dhe kujdestarëve në organikën e këtij spitali, numri i të cilëve mbetet ende shumë i vogël në raport me numrin e pacientëve për pavijon. Vlen të theksohet se, kishte një dallim të theksuar të këtij raporti nga njëri pavijon në tjetrin.

Në këtë institucion nuk kishte një sistem monitorimi me kamera, në asnjë ambient të tij.

Për sa i përket masave të kufizimit fizik apo veçimit të personave nën trajtim, ato ishin të rralla ose thuajse mungonin fare. Atyre u ofrohej mundësia për t'u takuar me familjarët apo të afërmit sa herë ata dëshironin, megjithëse kjo ndodhte në përgjithësi për shtrimet e reja. Ndërkohë që, për rastet që kishin vite që qëndronin në këtë institucion, pothuajse plotësisht të braktisur nga familjarët, takimet ishin të rralla apo inekzistente.

Nga drejtuesi i këtij institucioni, si dhe nga monitorimi që bënë ekspertët e grupi të inspektimit, rezultoi se mungonin rastet zyrtare me shtrim të pavullnetshëm.

Ankesat dhe kërkesat e pacienteve menaxhoheshin nga stafi psiko social. Më pas, ishte ky staf që bënte raportimin e problematikave që ngrinin personat nën trajtim me anë të ankesë/ kërkesës së tyre.

Në gjithë hapësirat e përbashkëta, brenda në pavijon, korridore apo ambiente të tjera të këtij institucioni mungonin posterat, informacioni në lidhje me të drejtat e njeriut si dhe numri i telefonit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

### ***Kushtet materiale***

Ashtu siç u përmend edhe më lart, godinat e spitalit ishin rikonstruktuar pjesërisht, por gjatë vizitës së ekspertëve brenda në pavijone, u vu re se ato ishin të amortizuara, me lagështirë, por që stafi përkatës mendohej të mbante një higjienë të mirë.

Në fillim, grupi i inspektimit vizitoi pavijonin e pranimit që ndodhej në katin e parë të ndërtesës, me kapacitet maksimal 8 persona. Në momentin e vizitës ndodheshin gjashtë pacientë kronikë dhe tre akutë. Kushtet materiale në këtë pavijon ishin të mira, por aty mbaheshin persona të shtruar prej muajsh në spital tërësisht në kundërshtim me ligjin për shëndetin mendor dhe aktet nënligjore të nxjerra kohët e fundit në zbatim të tij. Pavijonet II dhe VIII kishin përkatësisht 32 dhe 25 pacientë me diagnozë "Prapambetje Mendore", të cilët mbaheshin në këtë institucion në kundërshtim me Ligjin nr. 44/ 2012 "Për shëndetin mendor". Me gjithë kërkesat e vazhdueshme që drejtuesit e këtij institucioni i kanë bërë organeve përkatëse për gjetjen e një zgjidhjeje për këtë kategori personash, situata mbetet ende e njëjtë. Pavijonet III, IV, V dhe VI mbanin përkatësisht nga 35, 36, 35 dhe 26 persona, ndërkohë që në pavijonet I dhe VII numri të shtruar ishin përkatësisht 67 dhe 71 persona. Në pavijonin VII mbaheshin bashkë pacientë "kronikë" dhe akutë. Kjo përbënte një problematikë të theksuar në lidhje me menaxhimin dhe trajtimin e tyre sa më adekuat.

Jo të gjitha pavijonet respektonin standardin e hapësirës jetike për person, duke marrë në konsideratë edhe faktin e mbipopullimit në to. Tualetet ishin të përbashkëta për çdo pavijon, të amortizuara dhe me lagështirë. Duset, në përgjithësi, në të gjitha pavijonet ishin të amortizuara, në kushte jo të mira higjieno-sanitare dhe me lagështirë të theksuar.

Në asnjë prej pavijoneve të këtij spitali nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

Në çdo pavijon, dhomat kishin dritë natyrale mjaftueshëm dhe ishin të pajisura me krevate në gjendje të mirë. Grupi i inspektimit konstatoi se dhomat në disa pavijone ishin të pajisura me

komodina, në disa të tjera jo. Dyshekët, çarçafët e batanijet ishin siguruar nga ndihmat humanitare të shoqatave të huaja vullnetare.

Kuzhina ishte e rregullt dhe e pastër, e pajisur me orenditë e nevojshme. Kampionet e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe me dry.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar, gjë që bënte të mundur aksesin e personave nën trajtim për të kryer normalisht nevojat e tyre.

Në institucion kishte sistem qendror ngrohjeje.

Lavanderia, ishte e rikonstruktuar së fundmi dhe ishte në funksionim të plotë.

Brenda oborrit të këtij spitali kishte edhe dy qendra ditore “Tulipan” dhe “Rilindja”, të cilat ishin të pajisura me orenditë e përshtatshme. Ato ishin të pastra dhe të rregullta, ku në mure ekspozoheshin punime të ndryshme artizanale dhe artistike të personave nën trajtim, duke ofruar kështu një ambient qetësues dhe komod.

Ambulanca megjithëse në funksion, ishte e amortizuar.

Dhomat e infermierisë në të gjithë pavijonet, me gjithë përpjekjet e personelit për t’i mbajtur ato pastër e me rregull, ishin të pajisura me orendi të amortizuara. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, por mungonte uniti dhe autoklava, materialet dhe instrumentet dentare. Rrjedhimisht, edhe ky shërbim kishte mangësi.

### ***Shërbimi social dhe aktivitetet***

Organika e këtij shërbimi është e përbërë nga katër psikologe dhe dy punonjëse sociale. Puna e tyre ndahet sipas pavijoneve në përgatitjen e dosjeve për çdo pacient, si ato që shtrohen për herë të parë, ashtu edhe për ata rezident prej vitesh në këtë institucion. Ata gjithashtu punonin me plane individuale trajtimi për secilin prej tyre

Stafi psiko-social organizonte aktivitetet më së shumti në qendrat ditore të spitalit. Ato zhvilloheshin nga ora 09:00-14:00, të cilat përfshinin pikturë, punime me dorë sidomos për gratë, festa fetare, si dhe aktivitete jashtë ambienteve të spitalit, si piknik, kinema etj.

Në këtë institucion mungonin kurset e formimit profesional, por aty zhvilloheshin aktivitete kreative të punës artizanale dhe artistike.

Të gjitha aktivitetet që zhvilloheshin brenda një viti në këtë institucion, mbështeteshin nga Shoqata Shpresë për Shqipërinë, organizata të huaja vullnetare si dhe nga shoqëria civile.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e sektorit shëndetësor përbëhej nga katër mjekë me kohë të plotë, ku vetëm njëri prej tyre ka formimin katër-vjeçar si psikiatër, ndërkohë që dy kanë formim një vjeçar, dhe tjetri është me formimin mjek i përgjithshëm me një stazh pune disavjeçare në këtë spital. Në

organikën e spitalit përfshihen edhe dy mjekë që punojnë në Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor, Elbasan. Gjithashtu, pjesë e stafit janë edhe tre mjekë të përgjithshëm vullnetarë, të cilët mbulojnë nevojat e spitalit për shërbim 24 orësh. Nga konstatimet e grupit inspektues rezultoi se një nga mjekët psikiatër, i është drejtuar institucionit me kërkesa të vazhdueshme për të qenë pjesë e shërbimit 24 orësh, por kjo nuk i është pranuar, duke lenë vend për pretendime.

Gjatë inspektimit në këtë institucion, u vu re se kishte një sërë problematikash që çonin në një shërbim jo të mirë shëndetësor për të gjithë personat e shtruar në këtë spital. Duke filluar nga mbipopullimi dhe qarkullimi i ulet i shtretërve, gjë që e ka kthyer këtë spital me tepër në një rezidence për persona me probleme të shëndetit mendor se sa një shërbim spitalor sipas ligjit dhe akteve nën ligjore për shëndetin mendor.

Po ashtu, mjekët e këtij spitali përballen çdo ditë me vështirësi në kryerjen e analizave, ekzaminimeve dhe konsultave të pacientëve në spitali e përgjithshëm të Elbasanit, ku jo rrallë herë e stigmatizojnë këtë kategori të sëmurësh. Gjithashtu tejet të vështirë e bën këtë shërbim edhe numri shumë i vogël i infermiereve dhe kujdestarëve, sidomos për pavijonet me mbi 70 pacientë ku për çdo turn shërbimi ka nga një infermier dhe një ose asnjë kujdestar. Kjo bëhet edhe më problematike për turnet e pasdites dhe të darkës.

Prej vitesh në këtë institucion mbetet një problematike e theksuar, mungesa e ilaçeve si: Antipsikotikë, Antidepresivë, Anksiolitikë, Hipno-sedativë, ashtu dhe stabilizuesit e humorit. Nga informacioni i marrë prej stafit të këtij spitali, nga ana e shërbimit laboratorik në spitalin e përgjithshëm mungon pajisja dhe kitet për kryerjen rutinë të matjes së nivelit në gjak për dy stabilizuesit e humorit Tegretol dhe Karbonat Litiumi.

Kohët fundit nga ana e institucionit, ishte marrë një aparat EKG-je, i cili nuk ishte vënë në punë për shkak të mungesës së personelit të specializuar në kryerjen e këtij ekzaminimi.

Shërbimi stomatologjik është i kompletuar me një stomatolog, por siç e kemi përmendur edhe me sipër ky shërbim nuk ofron tjetër veçse ekstraksione, pasi ka mungesa në materiale e instrumente dentare

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti ato të mjekeve, u konstatua se kartelat e reja të miratuara me ligjin e ri kishin filluar të viheshin në përdorim. Për sa i përket regjistrat të konsultave në pranim u vu re se ai plotësohej me përshkrim të gjatë të gjendjes së pacientit, ndërkohë që aty duheshin pasqyruar të dhëna në lidhje me gjeneralitetet, të dhëna për dokumentet përcjellëse, diagnoza përcjellëse dhe ajo e vendosur nga konsulta dhe në fund mjekimi i rekomanduar. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermiereve, ishin të mbajtura me rregull dhe të pasqyruara saktë.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në spital dhe respektimin e hapësirës personale, duke rritur numrin e daljeve, sipas legjisllacionit në fuqi.
2. Marrja e masave të menjëhershme për zbatimin e kriterëve bazë për shtrim në spital, vetëm kur personi referohet nga QKSHM.

3. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me gjetjen e një zgjidhjeje për rreth 57 persona me prapambetje mendore, rezidentë të këtij spitali prej vitesh, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
4. Hartimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me zgjidhjen e problematikës së personave me prapambetje mendore, rezidentë të spitalit psikiatrik “Sadik Dinçi”, Elbasan.
5. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me krijimin e një sektori juridik, si pjesë e qenësishme dhe funksionale e organikës së institucionit, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të personave nën trajtim, si edhe të vetë institucionit.
6. Marrja e masave urgjente për shtimin në organikë të infermierëve dhe kujdestarëve në këtë institucion.
7. Marrja e masave për përfshirjen e mjekut psikiatër, me të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në funksion të një shërbimi sa me efikas, duke e bërë pjesë të konsultave dhe shërbimit 24 orësh.
8. Marrja e masave për ndarjen e pacienteve akutë nga ato rezidentë në këtë institucion, në mënyrë që të lehtësohet edhe puna e personelit në pavijonet përkatëse.
9. Marrja e masave të vendosjes së një sistemi monitorues kamerash vëzhgimi në të gjithë ambientet e këtij institucioni, si një ndër aspektet më të rëndësishme të parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
10. Marrja e masave për ndarjen në mënyrë proporcionale të personelit në pavijone, në raport me numrin e pacienteve për pavijon.
11. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me lagështirën në pavijone, dushe dhe tualete dhe përmirësimin e këtyre të fundit.
12. Marrja e masave për zbatimin e ligjit për shëndetin mendor për sa i përket ekipit multidisiplinar duke përfshirë stafin psiko-social në vendimmarrjen për të gjitha rastet që trajtohen në këtë institucion, me fokus të veçantë vendimet e rëndësishme të heqjes së zotësisë për të vepruar dhe dhënies së kujdestarisë për persona që trajtohen në këtë spital.
13. Marrja e masave të menjëhershme për lehtësimin kryerjeve të analizave laboratorike, të ekzaminimeve dhe konsultave në spitalin e përgjithshëm, duke patur akses të menjëhershëm nga ana e personave që kërkojnë këto lloje shërbimesh shëndetësore.
14. Marrja e masave urgjente për furnizimin me medikamente të grupit të antipsikotivë atipik, antidepresivë, stabilizuesve të humorit dhe anksiolitikë e hipno-sedativë të grupeve të ndryshme.
15. Marrja e masave të menjëhershme në vënien në funksion të plotë të aparatit të EKG-së.
16. Marrja e masave për kompletimin e dhomës së stomatologes me instrumente dhe materiale dentare.
17. Marrja e masave të menjëhershme për të filluar plotësimin e regjistrit të konsultave sipas zërave të pasqyruar në të.

## 8.2. Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë - Datë 14.11.2014 / Nr. Dok. 201402312

### *Shënime paraprake*

Kapaciteti maksimal i Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” është 180 shtretër, përfshirë këtu persona të shtruar, për vlerësim diagnoze e mjekimi, apo persona që kanë vite të shtruar në këtë spital dhe që tashmë janë kthyer në rezident të tij. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 163 persona, nga të cilët 110 “kronik” dhe 53 akut dhe sub-akut.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesen e institucionit, e cila u shpreh e gatshme për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të pacienteve, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni.

Nga ana e drejtueses së institucionit, ekspertëve iu bë me dije se, Spitali Psikiatrik Vlorë kishte një zonë mbulimi, ku përfshihen rrethet e Vlorës, Sarandës Tepelenës, Gjirokastrës, Përmetit, Skraparit, Beratit, Fierit. Ky spital ishte i ndarë në 6 pavijone, si dhe një pavijon pranimi. Pavijonet 1, 2 dhe 3 me kapacitet zyrtar me 37 shtretër, pavijoni 4 me kapacitet zyrtar 72 shtretër, ku mbahen pacientë “kronik” gra, pavijoni 6 dhe 7 me kapacitet zyrtar me 37 shtretër, ku mbahen pacientë akut-subakut burra, si dhe pavijoni i pranimit me kapacitet zyrtar 14 shtretër. Vlen të theksohet se brenda këtyre shifrave, ka 40 pacientë me Prapambetje Mendore, të cilët trajtohen në këtë spital totalisht në kundërshtim me ligjin për shëndetin mendor.

Gjithashtu në varësi të këtij institucioni janë edhe dy shtëpiza të mbështetura ku banojnë përkatësisht me nga 10 paciente burra dhe gra. Këto shtëpiza janë të kompletuar me staf mjekësor, infermierë dhe kujdestarë.

Vlen për t’u theksuar se, nga ana e infrastrukturës, godinat e spitali ishin tej mase të amortizuara, përveç pavijonit të pranimit. Ndërkohë që pritej që së shpejti të hapet spitali i ri me pavijone për pacientët akut dhe sub-akut.

### *Trajtimi*

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e pacientëve, në identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative, apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe shërbimin shëndetësor që i ofrohet të gjithë personave që shtrohen në këtë spital. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të shtruarit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Në spitalin psikiatrik Vlorë, në momentin e inspektimit, nuk kishte ankesa lidhur me ushqimin, veçanërisht në drejtim të cilësisë së gatimit.

Në bazë të informacionit që grupi i inspektimit mori nga stafi drejtues i këtij institucioni një problematikë të theksuar përbënin edhe personat abuzues me substanca narkotike apo/ dhe

alkoolin, të cilëve pasi u ofrohej një shërbim urgjence bëheshin kontingjent personash rezident në këtë spital. Ndërkohë që problematikë e hershme ishin rreth 9 pacientë të cilët, nuk i takonin zonës së mbulimit të Vlorës dhe që janë kthyer në rezidentë të këtij spitali.

### ***Masat mbrojtëse***

Gjatë vizitës së monitorimit, grupi i ekspertëve konstatoi se në këtë institucion ekzistonte sektori juridik, i cili bënte të mundur mbrojtjen ligjore të interesave të institucionit, por edhe të personave të trajtuar në institucion, të cilët jo në pak raste mbeten të pambrojtur/ përfaqësuar ligjërisht dhe vulnerabël ndaj abuzimeve institucionale dhe/ apo familjare. Gjithashtu, grupit monitorues iu vu në dispozicion rregullorja e brendshme e institucionit e miratuar. Sa i përket masave shtrënguese në këtë institucion u gjetën vetëm këmbësia të forcës, ndërkohë që për veçimin e pacientëve nuk zbatohet një protokoll i veçantë pasi mungonte dhoma e izolim/veçimit. Sipas stafit drejtues këto raste, pasi dokumentoheshin në një regjistër të veçantë, mbaheshin në dhomat e pavijoneve duke u mbikëqyrur vazhdimisht nga infermierë apo/ dhe kujdestarë të spitalit.

Komisioni i mjekëve për konsultat e shtrimit, formohej nga tre mjekë të këtij spitali, ku fillimisht pacienti ndiqej në observim dhe në varësi të gjendjes procedohej për shtrimin në spital ose kthimin në shtëpi duke i rekomanduar vazhdimin e mjekimit ambulator. Edhe këto të fundit bëhen pas një konsulte të zgjeruar me tre mjekë psikiatër. Nga informacioni i marrë nga drejtuesja e këtij institucioni, në këtë spital, zbatoheshin shtrimet e pavullnetshme në përputhje me ligjin e ri për shëndetin mendor dhe aktet nën ligjore të tij. Megjithatë, gjatë vizitës monitoruese u vu re se kishte mjekë të cilët nuk kryenin procedurat ligjore për shtrim të pavullnetshëm, në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe në shkelje të ligjit nr. 44/ 2012 “Për Shëndetin Mendor” dhe aktet nën ligjore të tij, me pretendimin se procedurat për revokimin e kësaj mase zgjasin deri në një muaj, kohë gjatë së cilës pacienti mund të ishte i rehabilituar për të dalë nga spitali. Kjo gjë që i shtynte mjekët të mundoheshin që brenda disa ditëve të bindin pacientin për miratimin e shtrimit, duke firmosur edhe në kartelë.

Një problematikë e konstatuar në këtë spital ishte pranimi i të sëmurëve në urgjencën e spitalit, në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e njeriut, duke u sjellë në spital me pranga nga forcat e rendit, të pashoqëruar nga familjarët dhe me argumentimin se përbëjnë rrezik për veten apo/ dhe komunitetin. Po ashtu, problem përbënin edhe vendimet e gjykatës për heqjen e zotësisë për të vepruar të pacientëve të këtij spitali, ku stafi nuk ishte pjesë e procesit dhe në rast se merrej një vendim i tillë, ky i fundit nuk vihej në dijeni.

Në këtë institucion nuk kishte një sistem monitorimi me kamera, në asnjë ambient të tij.

Pacientëve të shtruar në këtë spital u ofrohej mundësia për t’u takuar me familjarët apo të afërmit sa herë ata dëshironin. Ndërkohë që, për rastet që kishin vite që qëndronin në këtë institucion, pothuajse plotësisht të braktisur nga familjarët, takimet ishin të rralla apo inekzistente.

Ankesat dhe kërkesat e pacienteve menaxhoheshin nga stafi psiko-social. Më pas, ishte ky staf që bënte raportimin e problematikave që ngrinin personat nën trajtim me anë të ankesë/ kërkesës së tyre.



Në hapësirat e përbashkëta, brenda në pavijon, korridore apo ambiente të tjera të këtij institucioni mungonin posterat, informacioni në lidhje me të drejtat e njeriut si dhe numri i telefonit të Institucionit të Avokatit të Popullit, përveç se në hyrjen e pranimit dhe dhomës së konsultave.

### ***Kushtet materiale***

Godinat e spitalit ishin tej mase të amortizuara me lagështirë, dhe ambiente ku mbaheshin pacientë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Përjashtim bënte pavijoni i pranimit, kushtet e të cilit ishin më optimale.

Në fillim, grupi i inspektimit vizitoi pavijonin e pranimit që ndodhej në një godinë më vete. Në katin e parë të kësaj godine ndodhej edhe dhoma e konsultave, salla e mjekëve, si dhe një sallë rehabilitimi ku zhvillohin aktivitete stafi psiko-social me pacientët e pranimit. Kjo e fundit ishte e kompletuar me orendi dhe e pastër.

Në katin e dytë të kësaj ndërtese ndodhej pavijoni i pranimit kapacitet maksimal 14 shtretër. Në momentin e vizitës ndodheshin 7 pacientë gra dhe 7 burra. Kushtet materiale në këtë pavijon ishin të mira, dhe dhomat ishin të pajisura me orenditë e domosdoshme. Pacientët nuk kishin ankesa në lidhje me ushqimin apo trajtimin që i bëhej nga stafi i spitalit. Banjat dhe dushet në këtë pavijon ishin të rregullta e të mirëmbajtura.

E ndryshme paraqitej situata në pavijonet e tjera ku kushtet higjiena sanitare ishin përgjithësisht të mira por orenditë mungonin, krevatet ishin të amortizuara, sallat me hapësirë jetike në kundërshtim me standardet e jo në zbatim të respektimit të të drejtave të njeriut. Grupi inspektues konstatoi se këto salla mbanin nga 15-18 pacientë, ato kishin dritare të mëdha që siguronin ndriçim natyral të mjaftueshëm, por lagështira ishte evidente deri në rrjedhje të ujit nga tavani i njëjës dhomë. Ngrohja megjithëse realizohej me kaloriferë ishte e pamjaftueshme për gjithë atë hapësirë. Banjat ishin pa pllaka e me rubinete të prishura, ndërsa dushet ishin në një ambient 4×4m me gjashtë poste por totalisht jashtë standardit, ndaj dhe shërbimi që këta ambiente ofronin në këtë këndvështrim ishte çnjerëzor dhe degradues. Dyshekët, çarçafët e batanijet ishin siguruar nga ndihmat humanitare të shoqatave të huaja vullnetare.

Në këtë spital mbahen edhe pacientë të cilët nuk trajtohen me terapi medikamentoze, por janë rezidentë të këtij spitali prej vitesh duke shkaktuar një mbingarkesë të theksuar pune për stafin e spitalit që kujdeset për ta si dhe kosto financiare për buxhetin e këtij spitali. Këta pacientë që përbëjnë një numër të konsiderueshëm prej 39 personash me diagnozë “Prapambetje Mendore”, “Status Postmeningoencefalitis”, “Cerebroathia Congenitale”, apo/ dhe Epilepsi”, të cilët ishin të shpërndarë në pavijonet 1,2,3,4 të burrave dhe grave, qëndronin prej vitesh në spital tërësisht në kundërshtim me ligjin për shëndetin mendor dhe aktet nënligjore të nxjerra kohët e fundit në zbatim të tij. Me gjithë kërkesat e vazhdueshme që drejtuesit e këtij institucioni i kanë bërë organeve përkatëse për gjetjen e një zgjidhjeje për këtë kategori personash, situata mbetet ende e njëjtë.

Në asnjë prej pavijoneve të këtij spitali nuk kishte sistem monitorimi me kamera vëzhgimi.

Kuzhina mungonte në këtë institucion, pasi ushqimi siguroheshe me katering sipas një kontrate të spitalit me një restorant të qytetit. Ndërkohë që ekzistonte mensa, si ambient ngrënie për pacientët. Ajo ishte e rregullt dhe e pastër, mungonte ngrohja, si dhe pajisjet e orenditë e domosdoshme ishin të amortizuara. Aty gjendeshin edhe disa dollap të cilët shërbenin si gardëroba të personelit. Kampionet e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe me dry.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar, gjë që bënte të mundur aksesin e personave nën trajtim për të kryer normalisht nevojat e tyre.

Autoambulanca ekzistonte në këtë spital dhe në ndihmë të stafit kishte edhe një fugon, i cili shërbente për aktivitetet që zhvillonte stafi psiko-social me pacientët jashtë institucionit. Mungonte sistemi qendror i ngrohjes, por ngrohja në pavijone sigurohej me kaloriferë e në disa të tjerë me kondicionerë, gjë që ishte e pamjaftueshme për hapësirat e sallave të cilat kishin një kubaturë 12×5.5 m.

Lavanderia ishte tërësisht e amortizuar dhe thuhet jashtë funksionit, duke manifestuar një problematikë tjetër në lidhje me larjen dhe tharjen e teshave në këtë institucion.

Dhomat e infermierisë në të gjithë pavijonet, me gjithë përpjekjet e personelit për t'i mbajtur ato pastër e me rregull, ishin të pajisura me orendi të amortizuara. Dhoma e stomatologut ishte jashtë standardit, me pajisje bazë, si poltrona, materiale dhe instrumentet dentare shumë të vjetra, ndërkohë që mungonin uniti dhe autoklava. Rrjedhimisht, në këtë institucion nuk ofrohej një shërbim i përshtatshëm stomatologjik.

### ***Shërbimi social dhe aktivitetet***

Organika e këtij shërbimi ishte e përbërë nga dy psikologe, një punonjëse sociale dhe një terapist okupacional. Puna e tyre ndahej sipas pavijoneve në përgatitjen e dosjeve për çdo pacient, si ato që shtroheshin për herë të parë, ashtu edhe për ata rezident prej vitesh në këtë institucion. Ata gjithashtu punonin me plane individuale trajtimi për secilin prej tyre.

Stafi psiko-social organizonte aktivitetet në sallat përkatëse të pavijoneve por edhe jashtë institucionit, në komunitet. Ato zhvilloheshin nga ora 09:00-14:00, të cilat përfshinin pikturë, punime me dorë sidomos për gratë, festa fetare, ditëlindje të pacientëve, si dhe aktivitetet që zhvilloheshin jashtë ambienteve të spitalit, si piknik, kinema etj.

Në këtë institucion mungonin kurset e formimit profesional, por aty zhvilloheshin aktivitete kreative të punës artizanale dhe artistike.

Të gjitha aktivitetet që zhvilloheshin brenda një viti në këtë institucion, mbështeteshin nga Shoqata Shpresë për Shqipërinë, organizata të huaja vullnetare si dhe nga shoqëria civile.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e sektorit shëndetësor përbëhej nga shtatë mjekë me kohë të plotë, ku vetëm tre prej tyre kishin formimin katër-vjeçar si psikiatër, ndërkohë që të tjerët kishin formim një vjeçar ose

ishin me formimin mjek i përgjithshëm me një stazh pune disavjeçare në këtë spital. Për sa i përket pjesës tjetër të kujdesit shëndetësor, ai ishte i kompletuar me një numër të mjaftueshëm infermierësh, kujdestarësh e sanitaresh.

Në momentin e vizitës monitoruese, nga të gjithë të sëmurët që trajtoheshin në këtë spital për probleme të shëndetit mendor, të diagnostikuar me sëmundje të tjera kronike ishin 20 diabetikë, 26 me patologji kardiake, 3 nefrologjike, 3 dermatologjike, etj.

Gjatë inspektimit në këtë institucion, u vu re se një problematikë e mbartur ndër vite ishte numri i konsiderueshëm i pacienteve me diagnoza të ndryshme, që janë kthyer në rezidentë të këtij spitali.

Grupi i inspektimit konstatoi gjithashtu se, në këtë spital kishte një kabinet radiologjik, mikrokirurgjie dhe stomatologjik, si dhe një laborator klinik-biokimik të cilët gjithashtu ishin të kompletuar me staf mjekësor dhe që ofronin një shërbim efikas, përveç kabinetit stomatologjik, i cili siç e përmendem edhe më sipër ishte krejtësisht jashtë standardeve. Në këtë institucion mungonte aparati i EKG-së. Ndërkohë që, nga stafi i këtij institucioni nuk u paraqiten ankesa në lidhje me kryerjen e analizave, ekzaminimeve dhe konsultave të pacientëve në spitali e përgjithshëm të Vlorës. Ato kryheshin në kohë dhe pa vështirësi nga stafi i shërbimeve të tjera.

Gjatë inspektimit në farmacinë e spitalit u vu re se ajo ishte e kompletuar me larmishmëri Antipsikotikësh, Antidepresivësh, Anksiolitikësh, Hipno-sedativësh, si dhe Stabilizues të humorit. Gjithashtu, u vure se nuk kishte mangësi të medikamenteve për sëmundjet e tjera kronike, kardiake, endokrinologjike, neurologjike, dermatologjike, etj.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti ato të mjekeve, u konstatua se kartelat e reja të miratuara me ligjin e ri kishin filluar të viheshin në përdorim. Ato plotësoheshin me rregull dhe në përputhje me aktet nënligjore të Ligjit Nr. 44/ 2012 “Për Shëndetin Mendor”. Gjithashtu, të gjithë regjistrat e këtij institucioni, regjistri i shtrimeve, regjistri i observacionit, regjistri i shtrimeve të pavullnetshme, regjistri i vizitave dhe konsultave për paraburgimin e burgun e Vlorës, regjistri i vizitave me referim nga QKSHM Vlorë, regjistri për lajmërimin e familjarëve si dhe regjistri i pacientëve që silleshin në spital nga forcat e rendit, ishin të gjitha të plotësuara me rregull dhe rigorozitet nga stafi i këtij spitali. Të mbajtura me rregull dhe të pasqyruara saktë ishin edhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve.

Për sa më sipër u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të pacientëve në këtë spital dhe respektimin e hapësirës jetike të tyre.
2. Marrja e masave lidhur me gjetjen e një zgjidhjeje për rreth 39 persona me Prapambetje Mendore, 9-të pacientëve që nuk i takojnë zonës së mbulimit të këtij spitali, të cilët janë rezidentë prej vitesh, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
3. Hartimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me zgjidhjen e problematikës së personave me Prapambetje Mendore, rezidentë të spitalit psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë.
4. Marrja e masave për hapjen e spitalit të ri me pavijonet për pacientë akut dhe subakut.

5. Marrja e masave të menjëhershme për sigurimin e një dhome të posaçme izolimi në përputhje me ligjin e ri për shëndetin mendor dhe akteve nënligjore të tij.
6. Marrja e masave të menjëhershme për zbatimin e procedurave për të gjitha shtrimet e pavullnetshme sipas ligjit Nr. 44/ 2012 "Për Shëndetin Mendor" dhe akteve nënligjore të tij.
7. Marrja e masave për vendosjen e një sistemi monitorues kamerash vëzhgimi në të gjithë ambientet e këtij institucioni, si një ndër aspektet më të rëndësishme të parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
8. Marrja e masave të menjëhershme lidhur me lagështirën e theksuar në pavijone, dushe dhe tualete dhe përmirësimin e këtyre të fundit.
9. Marrja e masave për përfshirjen e stafit të këtij spitali në proceset gjyqësore për heqjen e zotësisë për të vepruar të pacientëve të këtij institucioni si dhe vënien në dijeni të këtij stafi kur gjykata merr një vendim të tillë.
10. Marrja e masave të menjëhershme për hapjen e një kabineti stomatologjik të pajisur me të gjitha mjetet e domosdoshme, unit, autoklavë, materiale dhe instrumente dentare, për të ofruar një shërbim adekuat stomatologjik dhe konform standardeve.
11. Marrja e masave të menjëhershme pajisjen e këtij institucioni me një aparat EKG-je, si domosdoshmëri për kryerjen e një ekzaminimi të tillë, për të gjithë pacientët që trajtohen prej vitesh me Antipsikotikë.
12. Marrja e masave të menjëhershme për rikonstrukcionin e lavanderisë së spitalit dhe vënien në funksion të plotë të tij.

### **8.3. Spitali Psikiatrik Shkodër - Datë 11.12.2014 / Nr. Dok. 201402546**

#### ***Shënime paraprake***

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Spitalin Psikiatrik Shkodër për vitin 2014. Nga ana e drejtueses së institucionit, u informuam se kapaciteti maksimal në këtë spital ishte 35 shtretër. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 27 persona, nga të cilët dy persona kishin rreth katër muaj që mbaheshin në këtë spital për arsye të mungesës së përkrahjes familjare dhe sociale, dhe tre të tjerë që kishin përkatësisht 3, 5 dhe 6 vjet që mbaheshin në këtë spital me masën "mjekim i detyruar", revokimi i së cilës kishte hasur vështirësi për shkak të vonesave administrative të Gjykatës së Rrethit Shkodër". Pjesa tjetër e personave që trajtoheshin në këtë institucion ishin pacientë akut dhe subakut.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesen e institucionit, e cila u shpreh e gatshme për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e pacienteve, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni.

Nga ana e drejtueses së institucionit, ekspertëve iu bë me dije se Spitali Psikiatrik Shkodër kishte një zonë mbulimi të gjerë ku përfshiheshin rrethet e Shkodrës, Malësisë së Madhe, Bajram Currit, Pukës, Lezhës, Krumës, Kukësit, Rrëshenit, Peshkopisë, Laçit dhe Burrelit. Ky spital

ishite i ndarë në 3 pavijone: pavijoni i burrave me kapacitet zyrtar 15 shtretër, pavijoni i grave me kapacitet zyrtar 12 shtretër si dhe ai i pranimit me kapacitet zyrtar 8 shtretër.

Vlen të theksohet fakti se ky ishte një spital i ndërtuar para dy vitesh, duke përmbushur përgjithësisht standardet e një spitali psikiatrik me parametra bashkëkohorë. Ndaj dhe në këtë spital nuk kishte më rezidentë, përveç 5 rasteve të lartpërmendura. Pas ndërtimit të ri të këtij spitali të gjithë rezidentët ishin akomoduar në shtëpizën e mbështetur “Mimoza” me kapacitet 10 persona dhe katër shtëpi të tjera me kapacitet 52 persona. Kishte edhe raste të cilët ishin kthyer në komunitet me mbështetjen e shoqërisë civile dhe shoqatave humanitare të huaja dhe vendase.

### ***Trajtimi***

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e pacientëve të këtij spitali, në identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative, apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si edhe shërbimin shëndetësor që i ofrohet të gjithë personave të shtruar. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të shtruarit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës e dhunës.

Në spitalin psikiatrik Shkodër, në momentin e inspektimit, nuk kishte ankesa lidhur me ushqimin apo cilësinë e gatimit.

Në bazë të informacionit që grupi i inspektimit mori nga stafi drejtues i këtij institucioni një problematikë përbënin 2 personat që kishin mbi 3 muaj që trajtoheshin në këtë spital dhe 3 të tjerët të cilët trajtoheshin prej vitesh në këtë spital me masën “mjekim i detyruar”.

### ***Masat mbrojtëse***

Gjatë vizitës monitoruese, grupi i ekspertëve konstatoi se ky institucion që në momentin kur është ndërtuar, kishte kaluar në varësi të Drejtorisë së Shëndetit Publik Shkodër. Rrjedhimisht sektori juridik, i cili duhet të bënte të mundur mbrojtjen ligjore të interesave të institucionit, por edhe zbatimin e procedurave ligjore të detyrueshme në kuadrin e Ligjit nr.44/ 2012 “Për Shëndetin Mendor”, mbulohej nga një juriste e DSHP-së. Megjithatë gjatë vizitës monitoruese, grupi i ekspertëve konstatoi se juristja nuk ishte marrë me çështjet e shtrimeve të pavullnetshme në këtë spital, por vetëm me përfaqësime ligjore për rastet me masën “mjekim të detyruar”, dhe nuk kishte të qartë rolin e saj në procedurat ligjore që duhet të zbatohen nga ana e institucionit konform Nenit 21, 22, 23, 24 të Ligjit nr.44/ 2012 “Për Shëndetin Mendor”. Sipas ligjit të mësipërm, brenda 48 orëve të mbajtjes në spital të pacientëve në kushte të trajtimit të pavullnetshëm, titullari i institucionit ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, referuar nga shefi i shërbimit, me asistencën e personelit juridik, duhet t’i drejtohet gjykatës së rrethit për të vlerësuar procedurën e kryer në rastin e trajtimit të pavullnetshëm të pacientit dhe vazhdimin e këtij trajtimi. Gjithashtu dhe në çdo çast, kur kanë rënë shkaqet shëndetësore që çuan në shtrim të pavullnetshëm të pacientit, titullari i institucionit me asistencën e juristit duhet të parashtojë pranë gjykatës kompetente kërkesën për revokimin e vendimit të gjykatës e cila vlerësoi dhe urdhëroi mbajtjen e pacientit në trajtim të pavullnetshëm.

Për sa i përket masave shtrënguese në këtë institucion, nga ana e shefes së spitalit u bë me dije se mungonin mjetet e kufizimit fizik, ndërkohë që për veçimin e pacientëve nuk zbatohet një protokoll i veçantë pasi mungonte dhoma e izolim/ veçimit. Gjithashtu, nuk kishte një regjistër të veçantë për persona të cilët shtroheshin në spital me shtrim të pavullnetshëm.

Komisioni i mjekëve për konsultat e shtrimit, formohej nga një mjekje e cila ishte edhe shefja e këtij spitali. Pas një vlerësimi paraprak, pacienti ndiqej në observim dhe në varësi të gjendjes procedohej për shtrimin në spital ose kthimin në shtëpi duke i rekomanduar vazhdimin e mjekimit ambulator. Edhe për këto të fundit vendimin e merrte e vetme mjekja e këtij spitali.

Nga informacioni i marrë nga drejtuesja e këtij institucioni, në spital nuk zbatoheshin shtrimet e pavullnetshme në përputhje me ligjin e ri për shëndetin mendor dhe aktet nën ligjore të tij. Gjatë vizitës monitoruese u konstatua se mjekja e këtij spitali nuk kryente procedurat ligjore për shtrime të pavullnetshme, në përputhje me ligjin nr. 44/ 2012 “Për Shëndetin Mendor” dhe aktet nën ligjore të tij, me pretendimin se procedurat për revokimin e kësaj mase zgjasin deri në një muaj, kohë gjatë së cilës pacienti mund të ishte i rehabilituar për të dalë nga spitali. Kjo gjë e shtynte mjeken e këtij institucioni dhe stafin psiko-social të mundoheshin që brenda dy-tre ditësh të bindnin pacientin për miratimin e shtrimit duke firmosur edhe në kartelë. Kjo është një problematikë e vërejtur edhe në spitalet psikiatrike të vendeve të rajonit, dhe zgjidhja gjithashtu është ofruar po në të njëjtën mënyrë. Gjithsesi duhet theksuar që pavarësisht vonesave të trajtimit të çështjeve nga gjykatat, spitalet duhet të zbatojnë procedurat e shtrimit të pavullnetshëm në përputhje me frymën e ligjit.

Një problematikë e konstatuar në këtë spital ishte pranimi i të sëmurëve në urgjencën e spitalit, në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke u sjellë në urgjencën e tij me pranga nga ana e forcave të rendit, të pashoqëruar nga familjarët dhe me argumentimin se përbëjnë rrezik për veten apo/ dhe komunitetin. Po ashtu, problem përbënin edhe vendimet e gjykatës për heqjen e masës “mjekim i detyruar”. Për raste të tilla, mjekja e këtij spitali pas një vlerësimi profesional që bënte rastit, i drejtohej gjykatës me një kërkesë për revokimin e kësaj mase, por nga ana e gjykatës kishte zvarritje në kryerjen e kësaj procedure.

Në këtë institucion kishte një sistem monitorimi me kamera, por jo i plotë në të gjitha ambientet e tij dhe nuk lejonte hapjen e këtyre të fundit për çdo rast dhe në çdo kohë.

Pacientëve të shtruar në këtë spital u ofrohej mundësia për t’u takuar me familjarët apo të afërmit sa herë ata dëshironin.

Ankesat dhe kërkesat e pacienteve menaxhoheshin nga stafi psiko-social. Më pas, ishte ky staf që bënte raportimin e problematikave që ngrinin personat nën trajtim me anë të ankesë/ kërkesës së tyre.

Në hapësirat e përbashkëta, brenda në pavijon, korridore apo ambiente të tjera të këtij institucioni mungonin posterat, informacioni në lidhje me të drejtat e njeriut si dhe numri i telefonit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

### ***Kushtet materiale***

Godina këtij spitali ishte e re dhe e mirë organizuar si infrastrukturë, e rregullt dhe e pastër. Nga ana e stafit mjekësor të këtij spitali ishin bërë përpjekje për mirëmbajtjen e tij, gjë që ishte evidente në të gjitha ambientet e inspektuara. Në katin e parë të kësaj godine ndodheshin pavijoni i pranimit në njërën anë, dhe në anën tjetër një sallë e ergoterapisë ku zhvillohin aktivitetet e stafit psiko-social me pacientët e pranimit. Në katin e dytë ndodheshin dy pavijone për pacientët akut dhe subakut.

Në fillim, grupi i ekspertëve të MKPT-së vizitoi pavijonin e pranimit, i cili kishte 4 dhoma, me 2 shtretër secila dhomë. Në këtë kat ndodhej edhe dhoma e konsultave, dhoma e infermierisë dhe mensa e pavijonit të pranimit. Këto ambiente ishin të mbajtura pastër dhe me rregull.

Dhoma e infermierisë ishte e pajisur me një dollap ku mbaheshin ilaçet e terapisë ditore si dhe ato të urgjencës.

Mensa e pranimit ku shpërndahej ushqimi në 4 vakte për të gjithë personat që trajtoheshin në këtë pavijon, ishte e pastër dhe e pajisur me 3 tavolina e 12 karrige.

Gjithashtu, salla e ergoterapisë ku zhvilloheshin takimet e stafit psiko-social me personat që trajtoheshin në këtë spital, pasditet e lira me shikimin e programeve televizive, dhe biseda të ndryshme mes tyre, ishte e rregullt, e pastër dhe e pajisur me orendi dhe një kuzhinë të vogël.

Në katin e dytë ndodheshin pavijonet e burrave dhe të grave. Të dy këta pavijone ishin simetrike nga ana infrastrukturore, me salla rehabilituese secila me banja me nga 2 poste dhe 3 poste për duset, të cilat kishin ujë të rrjedhshëm dhe të ngrohtë gjatë gjithë ditës. Pavijoni grave kishte 9 dhoma dhe në momentin e vizitës ndodheshin 10 persona, ndërsa pavijoni i burrave kishte 8 dhoma ku gjendeshin 9 persona. Edhe këto ambiente ishin të mirëmbajtura dhe të pastra, në respektim të standardeve evropiane si për sa i përket hapësirës jetike, ashtu dhe kushteve higjieno-sanitare në të cilat trajtoheshin këta persona. Shtrojat, si dyshekët, çarçafët dhe batanijet ishin të reja dhe të mirëmbajtura.

Kuzhina në këtë institucion, ishte gjithashtu e rregullt dhe e pastër. Aty përgatiteshin 4 vakte, menyja e të cilave ishte e afishuar. Kampionët ushqimorë mbaheshin në kushte frigoriferike, por jo të mbyllura me kyç. Kjo kuzhinë ishte e pajisur me të gjithë orenditë e domosdoshme dhe konform standardeve.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte siguruar, duke u mundësuar personave nën trajtim plotësimin normal të nevojave të tyre.

Institucioni kishte një sistem qendror ngrohje, i cili siguronte ngrohje 24 orë në 24 për personat që trajtoheshin në këtë spital.

### ***Shërbimi social dhe aktivitetet***

Organika e këtij shërbimi ishte e përbërë nga 4 psikologe dhe një punonjëse sociale. Puna e tyre ndahej sipas pavijoneve, në përgatitjen e dosjeve për çdo pacient, si të atyre që shtroheshin në pavijonin e pranimit, ashtu edhe për ata të cilët trajtoheshin në dy pavijonet e tjera. Ata gjithashtu, punonin me plane individuale trajtimi për secilin prej tyre.

Psikologët dhe punonjësit social merrnin kontakt çdo ditë me personat që trajtoheshin në këtë spital. Pacientët ndiqeshin prej stafit psiko-social në të gjitha aktivitetet ditore, duke i ndërgjegjësuar si në kujdesin për higjienën personale, ashtu dhe në marrjen e terapisë dhe të ushqimit. Aktivitet më të shpeshta që zhvilloheshin në sallat rehabilituese kishin të bënin kryesisht me ndjekjen e televizorit, punimet artistike dhe me dorë për gratë, lojërat me letra ose domino për burrat, këshillimet individuale apo/ dhe në grup, etj.

Gjithashtu, punonjësit e këtij stafi, punonin si ekip multidisiplinar sa i përket njohjes me shtrimet e reja, plotësimit të kartelave dhe planeve individuale të trajtimit të tyre, bazuar në ligjin e ri për shëndetin mendor dhe akteve nën ligjore të tij.

Krahas aktiviteteve në spital, punonjësit e këtij sektori zhvillonin edhe aktivitete të ndryshme social-kulturore jashtë tij. Këto aktivitete ishin të mbështetura nga Shoqata Humanitare vendase dhe të huaja. Një mbështetje e veçantë, nga ana e këtij stafi i jepej gjithashtu personave që dilnin nga spitali dhe atyre që dërgoheshin në Shtëpitë e Mbështetura.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit psiko-social u konstatua se ekzistonin dosje personale për të gjithë personat që trajtoheshin në këtë institucion të cilat ishin të mbajtura dhe të plotësuar me rregull.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e sektorit shëndetësor nuk ishte e plotësuar me mjekë, ndërkohë që pjesa tjetër e stafit ishte e kompletuar me një numër të mjaftueshëm infermierësh, kujdestarësh e sanitaresh. Ky institucion kishte vetëm një mjekë që shërbente me kohë të plotë. Për sa i përket shërbimit 24 orësh, herë pas here në ndihmë të saj, viheshin mjekë të Qendrës Komunitare ose një mjekë e cila aktualisht vazhdonte specializimin pranë Shërbimit të Psikiatrisë në QSU “Nënë Tereza” Tiranë.

Farmacia ishte e kompletuar me larmi Antipsikotikësh, Antidepresivësh, Anksiolitikësh, Hipnosedativësh, si dhe Stabilizues të humorit. Nuk kishte mangësi në medikamente edhe për sëmundjet e tjera kronike, kardiake, endokrinologjike, neurologjike, dermatologjike, etj. Dhomat e infermierisë në të gjithë pavijonet ishin të mbajtura pastër dhe me rregull.

Shërbimet e tjera për institucionin, si shërbimi stomatologjik, ai laboratorik klinik-biokimik dhe ekzaminimet imazherike, EKG, apo konsultat me specialistë të fushave të tjera të kujdesit shëndetësor, ofroheshin nga Spitali Rajonal i Shkodrës. Ekzistonte një marrëveshjeje bashkëpunimi e këtij të fundit me Spitalin Psikiatrik, e cila u vlerësua nga ana e drejtueses dhe stafit të këtij institucioni, si shumë e frytshme dhe korrekte nga palët.



Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti ajo e mjekes, u konstatua se kartelat e reja kishin filluar të viheshin në përdorim. Ato plotësoheshin me rregull dhe në përputhje me aktet nënligjore të Ligjit Nr. 44/ 2012 “Për Shëndetin Mendor”. Gjithashtu, të gjithë regjistrat e këtij institucioni, ishin të plotësuar me rregull dhe rigorozitet nga stafi i këtij spitali. Të mbajtura me rregull dhe të pasqyruara saktë ishin edhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për mundësimin e zhvillimit të një trajnimi të të gjithë mjekëve psikiatër pranë shërbimeve të shëndetit mendor me shtretër në Shkodër, Elbasan dhe Vlorë me mbështetjen edhe të Shërbimit të Psikiatrisë pranë QSU “Nënë Tereza” Tiranë, në lidhje me shtrimet e pavullnetshme në këto institucione në zbatim të neneve 19, 20, 21, 22, 23, 24 të Ligjit Nr. 44/ 2012 ”Për Shëndetin Mendor”.
2. Marrja e masave të menjëhershme për zbatimin e procedurave për shtrimet e pavullnetshme sipas ligjit Nr. 44/ 2012 ”Për Shëndetin Mendor” dhe akteve nënligjore të tij.
3. Marrja e masave të menjëhershme nga ana e DSHP-së Shkodër për atashimin e një juristi nga ana e këtij institucioni pranë spitalit psikiatrik, i cili të asistojë institucionin në zbatimin e procedurave ligjore konform Nenit 21, 22, 23, 24 të Ligjit nr.44/ 2012 “Për Shëndetin Mendor”, për t’ju drejtuar gjykatës së rrethit për vlerësimin e procedurave të kryera në rastin e trajtimit të pavullnetshëm të pacientëve dhe vazhdimin e këtij trajtimi, si dhe për parashtrimin pranë gjykatës kompetente të kërkesave për revokim të vendimeve të gjykatës të cilat vlerësuan dhe urdhëruan mbajtjen e pacientëve në trajtim të pavullnetshëm.
4. Marrja e masave të menjëhershme për përshpejtimin e revokimit të masës mjekim i detyruar për personat që trajtohen me këtë masë në Spitalin Psikiatrik të Shkodrës me mbështetjen ligjore të juristit të DSHP-së deri në sigurimin e një juristi pranë këtij Institucioni.
5. Marrja e masave të menjëhershme për sigurimin e një dhome të posaçme izolimi në përputhje me ligjin e ri për shëndetin mendor dhe akteve nënligjore të tij.
6. Marrja e masave për furnizimin e këtij institucioni me mjete të kufizimit fizik konform standardeve evropiane dhe akteve nën ligjore të ligjit për shëndetin mendor.
7. Marrja e masave për vendosjen e një sistemi monitorues me kamera vëzhgimi në të gjitha ambientet e këtij institucioni dhe vënien në funksion të plotë të tij.
8. Marrja e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së këtij institucioni me mjekë psikiatër.
9. Marrja e masave lidhur me mbajtjen e kampioneve ushqimore në kuzhinën e institucionit, të kyçura me dry.
10. Marrja e masave për përfshirjen e stafit të këtij spitali në proceset gjyqësore, për heqjen e zotësisë për të vepruar të pacientëve të këtij institucioni, si dhe për vënien në dijeni të këtij stafi kur gjykata merr një vendim të tillë.

## **9. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014 në Qendra**

### **9.1. Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit - Datë 03.10.2014 / Nr. Dok. 201401745**

#### *Shënime paraprake*

Kapaciteti zyrtar i Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve është 150 persona për vitin 2014. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 30 persona; 5 familje dhe 7 individë të kombësive të ndryshme (Kosovarë, Turq, Bullgarë, etj.)

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesen e institucionit, e cila u shpreh e gatshme për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e personave në qendër, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni.

Nga ana e drejtueses së institucionit, ekspertëve iu bë me dije se Qendra Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve është një qendër e hapur, e cila strehon azilkërkuesit në Republikën e Shqipërisë. Ajo informoi se një pjesë e mirë e rekomandimeve të një viti më parë, janë marrë seriozisht në konsideratë dhe janë përmbushur brenda mundësive financiare që kjo qendër ka.

#### *Trajtimi*

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e azilantëve të strehuar në qendër, në identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me azilantët, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, në momentin e inspektimit, nuk pati ankesa lidhur me trajtimin, ushqimin apo çështje të tjera lidhur me qëndrimin e personave në këtë qendër. Ata shprehën shqetësimin lidhur me çështjen e veshmbathjeve, të cilat pavarësisht përpjekjeve të stafit të këtij institucioni ishin të pamjaftueshme.

#### *Masat mbrojtëse*

Të gjithë personat e akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve që u intervistuan nga grupi i inspektimit, pohuan se mund të dilnin sa herë të dëshironin nga institucioni dhe se mund të zhvillonin aktivitetet e tyre personale pa probleme.

Ajo çka u vu re nga grupi i monitorimit, por që ishte edhe një problematikë e shprehur nga stafi i qendrës, ishte mungesa e një juristi, i cili duhej të merrej edhe pjesën e dokumentacionit që secilit individ të strehuar në qendër i duhet, duke marrë në konsideratë faktin se kjo qendër strehon shtetas të huaj. Një problematikë tjetër e pazgjidhur është edhe qëndrimi afatgjatë i

personave në këtë qendër. Nga intervistat e bëra, rezultoi se një pjesë e mirë e familjeve me banim në qendër kishin më shumë se 7 vjet që qëndronin aty. Grupi i inspektimit u shpreh se qëndrimi afatgjatë në një qendër të tillë, pavarësisht se e hapur, nuk ndihmon aspak në integrimin e këtyre familjeve në shoqëri.

Sa i përket çështjes së sigurisë, Qendra Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve, megjithëse ishte një qendër e hapur për azilkërkuesit, ishte e pajisur me kamera vëzhgimi vetëm në mjediset e jashtme, jo në ato të mjediseve të banimit. Ndërkohë që siguria e ambienteve të qendrës bëhej ndërmjet një kompanie sigurie private. Sistemi i kamerave monitorohej nga punonjësi i sigurisë.

### ***Kushtet materiale***

Kjo qendër përbëhej nga gjashtë godina njëkatëshe ku dy prej tyre përdoreshin si zyra administrative, njëra godinë ishte mensa, një godinë biblioteka, lavanderia, dushet, magazina dhe pjesa tjetër fjetore për azilkërkuesit.

Duhet theksuar fakti se, nisur nga rekomandimet e një viti më parë të MKPT-së, drejtuesja e kësaj qendre, ka bërë të mundur thithjen e fondeve për të rikonstruktuar një pjesë të mjediseve. Grupi i inspektimit pa nga afër punimet që vijonin në disa prej mjediseve të banimit, sikurse pa edhe mjediset e përfunduara. Këto të fundit përfshinin dhoma me 2-3 shtretër të rinj dhe me shtroje të reja, pajisur me dollapë dhe komodina, si edhe tavolina. Në njërin prej godinave, mjediset e banimit ishin të strukturuar me apartamente me dy dhoma dhe një tualet i mirë pajisur me dush brenda.

Duke marrë në konsideratë faktin se në qendër mund të ketë edhe fluks të madh personash, sapo ishin përfunduar edhe tualetet dhe dushet e përbashkëta, me pajisje të reja dhe funksionale.

Në përgjithësi, dhomat e banuara kishin dritë natyrale dhe artificiale dhe ishin të pajisura me orenditë e nevojshme. Nuk u konstatua prani e insekteve apo e brejtësve.

Nga të gjitha intervistat e kryera, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishte mungesa në furnizimin e azilkërkuesve me shtroje, mjete të tjera të higjienës personale dhe asaj të përbashkët, por kishte probleme me pajisjen me veshmbathje.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte pa kufizim oraresh dhe nuk u konstatuan probleme as me energjinë elektrike. Për këtë të fundit kishte edhe një gjenerator në raste ndërprerjeje të energjisë.

Kishte lavanderi, e cila funksiononte me grafik për personat e akomoduar në qendër.

Në institucion nuk kishte sistem qendror ngrohjeje. Rrjedhimisht, gjatë dimrit, ngrohja bëhej me mjete të tjera të siguruara nga stafi i qendrës, sikurse ndodhte edhe gjatë periudhës së verës.

Kishte një mjedis ambulator (dhomë mjeku), i cili, ashtu si edhe pjesa tjetër e qendrës, ishte duke u rikonstruktuar. Gjithashtu kishte një sasi të konsiderueshme të medikamenteve mjekësore, që i viheshin në dispozicion azilkërkuesve në raste emergjente apo si ndihmë e parë.

Grupi i monitorimit konstatoi se kishte një mjedis të jashtëm, i cili përdorej për basketboll dhe kalçeto, por nuk kishte një kënd lodrash për fëmijët.

Qendra Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve kishte edhe një bibliotekë, e cila shërbente edhe si sallë për kurset e kompjuterit. Mjedi i bibliotekës ishte i pastër dhe i rregullt me një numër të konsiderueshëm titujsh, si edhe me kompjuter, të gjithë në gjendje pune.

Grupi i inspektimit vuri re se kuzhina e qendrës dhe mensa ishin relativisht të pastër dhe të rregullt. Menyja e përditshme ishte e afishuar. Për të rriturit ofrohen 3 vakte në ditë dhe për fëmijët 4. Kampionët ushqimor ruheshin në një ambient frigoriferik. Ashtu sikurse u konstatua në vend nga grupi i inspektimit, edhe nga intervistat e bëra me azilantët e akomoduar në qendër, ushqimi ishte i një cilësie të lartë. Në momentin e inspektimit nuk kishte kërkesa të posaçme lidhur me dietën ushqimore, pavarësisht se stafi ishte i përgatitur edhe për këtë çështje.

### ***Aktivitetet***

Duke marrë në konsideratë faktin se kjo është qendër e hapur, personat e strehuar në të ishin të lirë të punonin, të dilnin nga qendra, apo edhe të kryenin aktivitete të tjera personale. Pavarësisht kësaj, stafi i kësaj qendre, organizonte herë pas here aktivitete të përbashkëta, të tilla si ditëlindje, gjatë verës vajtje në pishina, ndeshje futbollit dhe basketbollit, etj.

Kjo qendër kishte nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Arsimit lidhur me arsimimin 9-vjeçar të fëmijëve të strehuar në këtë qendër. Nga intervistat me vetë fëmijët, grupi i inspektimit u bë me dije se ata ndiqnin shkollën rregullisht.

Biblioteka funksiononte dhe kishte një numër të konsiderueshëm titujsh. Tërheqja dhe kthimi i librave bëhej duke shënuar të dhënat përkatëse në një kartelë personale.

Gjithashtu, në mjediset e mensës kishte një ambient të përbashkët për ndjekjen e programeve televizive.

Sipas organikës së miratuar, qendra ka vetëm një psikolog dhe një punonjës social, duke lënë jashtë kështu pozicione të tilla tepër të rëndësishme për natyrën e funksionimit të saj si edukatorë, kujdestarë, juristë dhe të paktën edhe një punonjës social dhe psikolog. Duke marrë në konsideratë faktin se në këtë qendër kishte familje, të cilat ishin prej vitesh të strehuara aty, dhe mënyrës së funksionimit të kësaj qendre, grupi i inspektimit konkludoi se stafi është tepër i vogël për të plotësuar të gjitha nevojat e qendrës, pavarësisht faktit se drejtuesja e institucionit dhe stafi aktual, punonin me turne për të mbuluar të paktën pjesën më të madhe të ditës.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit, grupi i inspektimit vuri re se stafi i qendrës kishte punuar fort për të krijuar një regjistër elektronik themeltar për të gjithë personat e strehuar në qendër. Gjithashtu ishte krijuar dhe një regjistër themeltar i sekretuar përpos atij elektronik. Secili prej tyre kishte një dosje specifike me të gjithë dokumentacionin e duhur.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e qendrës nuk parashikonte as mjek dhe as stomatolog, pra, ky shërbim nuk ofroj nga stafi i qendrës. Megjithatë, me rikonstruktimin e mjedisëve të qendrës, ishte parashikuar një dhomë e veçantë për mjekun me të gjitha pajisjet e duhura. Në momentin e inspektimit, për shkak se kjo dhomë ishte duke u rikonstruktuar, edhe medikamentet, përfshirë këtu edhe ato të urgjencës, ndodheshin në një mjedis tjetër me çelës.

Shërbimi shëndetësor ofrohej nga mjeku i familjes i Qendrës Shëndetësore Nr. 10, që mbulon zonën ku qendra është e vendosur. Edhe nga intervistat e zhvilluara, grupi i inspektimit u bë me dije se ky shërbim jepet në kohë, sipas kërkesave. Sa i takon shërbimit stomatologjik, ai ofrohet në bazë të procedurave të prokurimit.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë. Por në raste emergjente, përdoreshin makinat e qendrës për transportimin e azilkërkuesve pranë qendrave spitalore.

Gjithashtu ishin të hapura Librezat Shëndetësore për të gjithë azilkërkuesit e akomoduar në qendër, dhe skema e rimbursimit të ilaçeve ishte në funksion të plotë. Medikamentet mjekësore të rimbursueshme përfitoheshin me të njëjtën praktikë si shtetasit e tjerë të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa medikamentet mjekësore të parimbursueshme bliheshin sipas procedurave të prokurimit publik.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për shtimin e stafit të kësaj qendre me minimalisht një punonjës social, një psikolog, një edukator, një kujdestar, një jurist dhe staf mjekësor. Ky i fundit minimalisht të jetë me kohë të pjesshme.
2. Marrja e masave për përfundimin e rikonstruksionit të mjedisit të brendshëm banues të qendrës.
3. Marrja e masave për hartimin e një marrëveshjeje me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me ofrimin e mundësive për formim profesional në Qendrat e Formimit Profesional në varësi të kësaj Ministrie, si edhe mundësi për punësim pranë Zyrave Rajonale të Punësimit, përsëri në varësi të kësaj Ministrie për të gjithë personat e strehuar në QKPA, që janë të interesuar.
4. Marrja e masave për trajtimin e personave të strehuar në QKPA me ndihmë ekonomike siç parashikohet në ligjin nr. 10060, datë 26.01.2009, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998, "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë".
5. Marrja e masave lidhur me furnizimin me veshmbathje sipas stinës dhe grup-moshave të personave të strehuar në qendër.
6. Marrja e masave për integrimin në shoqëri të personave të strehuar në qendër, gjë që duhet të reflektohet edhe në një qëndrim më afat-shkurtër të këtyre personave në mjediset e kësaj qendre.
7. Marrja e masave për krijimin e një këndi lodrash për fëmijët.
8. Marrja e masave për ruajtjen e kësaj qendre me personel nga DPPSH.

## **9.2. Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut - Datë 08.10.2014 / Nr. Dok. 201401744**

### ***Shënime paraprake***

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut për vitin 2014. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 13 viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit (VT/ VMT), në raport me kapacitetin zyrtar të kësaj qendre prej 100 shtretërish.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e personave në qendër, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni.

Nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve iu bë me dije se Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut është një qendër e mbyllur, e sigurisë së lartë, e cila strehon personat e identifikuar në bazë të Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/ Viktimave të Mundshme të Trafikimit.

Kjo qendër është ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”, i cili, ndër të tjera, përveçse nuk parashikon detyrat funksionale të këtij institucioni apo shërbimet që ofrohen në të, parashikon në pikën 3 të tij se në këtë qendër trajtohen edhe emigrantë klandestinë që kalojnë përmes Shqipërisë. Grupi i inspektimit vë re QKPVT-ja, bazuar edhe në ligjin nr. 90/2012, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” duhet të ndryshojë bazën ligjore të funksionimit, duke marrë në konsideratë vërejtjet sa më lartë.

### ***Trajtimi***

Grupi i monitorimit pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e VT/ VMT të strehuara në qendër, në identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me VT/ VMT, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Ajo çka u vu re nga grupi i monitorimit, por që ishte edhe një problematikë e shprehur nga stafi i qendrës, kishte të bënte me mungesa të stafit të qendrës dhe kryesisht bëhej fjalë për juristin dhe psikologun, të cilët aktualisht në qendër punonin me kohë të pjesshme. Si juristi në fjalë, ashtu edhe psikologja, sipas Urdhrit shkresor nr. 387/ 15 prot., datë 27.04.2014, punonin edhe në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, pavarësisht se paga e tyre jepej nga QKPVT. E njëjta problematikë vërehej edhe për pozicionin e sanitares, e cila sipas Urdhrit nr. 571, datë 12.03.2014, emërohej tek Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, kurse pagesa i bëhet nga QKPV-të. Të dy këto urdhra krijojnë një problematikë të theksuar sa i përket mbarëvajtjes dhe trajtimit të VT/ VMT në qendër. Veçanërisht, duke marrë në konsideratë

problematikën ligjore dhe atë të shëndetit mendor që ky target-grup ka, prezenca e juristit dhe e psikologes është domosdoshmëri.

Në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, në momentin e inspektimit, nuk pati ankesa lidhur me trajtimin, ushqimin apo çështje të tjera lidhur me qëndrimin e personave në këtë qendër. Ato shprehën shqetësimin lidhur me çështjen e veshmbathjeve, të cilat ishin të pamjaftueshme.

### ***Masat mbrojtëse***

Të gjithë personat e akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, që u intervistuan nga grupi i inspektimit, pohuan se ndodheshin aty me vullnetin e tyre dhe se një pjesë kishin edhe procese penale si rrjedhojë e të cilave ndodheshin aty.

Sa i përket çështjes së sigurisë, Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut, për vetë natyrën e saj si qendër e mbyllur, ruhet nga policë të Policisë së Shtetit, bazuar kjo në një marrëveshje të vitit 2003 mes Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (në atë kohë Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale), IOM dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme (në atë kohë Ministria e Rendit Publik). QKPVT, pavarësisht rëndësisë së saj, nuk ishte e pajisur me kamera vëzhgimi, as në mjediset e jashtme, dhe as në ato të mjediseve të banimit.

### ***Kushtet materiale***

Kjo qendër përbëhet nga dy godina. Gjatë monitorimit në të dy godinat, grupi i inspektimit konstatoi se në ishin afishuar me postera, por jo vetëm, të drejtat e VT/ VMT, të drejtat dhe detyrimet e personelit të punësuar pranë qendrës, pjesë të rregullores së brendshme të qendrës, etj.

Në godinën e parë, e cila kryesisht ka zyrat e administratës, si edhe disa mjedise të tjera të përbashkëta për përfitueset e kësaj qendre, ishin kryer disa punime dhe situata e mjediseve të brendshme ishte pak më e mirë se tek godina e dytë. Rrjedhimisht, kjo godinë përdorej nga përfitueset për banim gjatë periudhës së dimrit për të shmangur lagështirën dhe mjedisin tejet të amortizuar të godinës së dytë. Për këtë qëllim përdorresh 6 dhoma, kryesisht me krevate marinarë, të pajisur me shtroje, por të gjitha këto tejet të amortizuara. Mungesa e fondeve për këtë qëllim ishte prezente.

Në mjediset e kësaj godine kishte një mjedis të përbashkët (atelie), i cili më parë ishte përdorur për të organizuar kurse kompjuteri, parukerie, etj. Në momentin e inspektimit kishte rreth 6 kompjuter, ku vetëm 2 prej të cilëve punonin dhe mirëmbajtja e tyre ishte problematike për faktin e mungesës së fondeve për këtë qëllim, si edhe të problematikës me energjinë elektrike.

Po në këtë godinë kishte edhe tualete, të cilat, pavarësisht se në kushte të mira higjieno-sanitare, nuk ishin të gjitha funksionale. Gjithashtu, në këtë mjedis kishte edhe makina larëse, vetëm njëra prej të cilave në funksion.

Në inspektimin e godinës së dytë, grupi i ekspertëve konstatoi lagështirë të theksuar në secilin prej mjediseve të brendshme, amortizim të dyerve të dhomave të përfituesve, etj. Secila prej dhomave të banimit të përfituesve ishin të pajisura me krevate me shtroje, komodina dhe dollapë, por të gjitha këto ishin tejet të amortizuara.

Edhe kjo godinë kishte mjedise të përbashkëta, të tilla si dhoma e televizorit, klasa, etj., por të gjitha përveçse me lagështirë, kishin edhe mobilim tejet të vjetër dhe amortizuar. Tualetet dhe dushet, të gjitha të përbashkëta, edhe këto, pavarësisht higjienës, kishin nevoja imediate për t'u ndryshuar.

Përfitueset kishin mungesa në drejtim të pajisjes me veshmbathje të përshtatshme për ta, ku mungesa e fondeve bënte që në këtë drejtim stafi të priste vetëm nga donacione të ndryshme. Gjatë monitorimit u konstatua që nuk mungonin produktet higjieno-sanitare dhe furnizimi me ujë të pijshëm ishte 24 orësh. Sa i takon energjisë elektrike, stafi i kësaj qendre bëri me dije grupin e ekspertëve që kishin problematika të shumta. Ndërprerja e energjisë, si edhe luhatjet në voltazh, kishin sjellë edhe në djegien e disa prej pajisjeve të pakta elektronike që kjo qendër disponon.

QKPVT, duke marrë në konsideratë instalimet e konstatuara nga grupi i ekspertëve, duhet të kishte ngrohje qendrore. Në fakt, u konstatua se përveç faktit që një pjesë e pajisjeve të instaluara në mur ishin dëmtuar rëndë, mungesa e fondeve për të vënë në punë kaldajën, bënte që ngrohja të sigurohej nga mjete të tjera ngrohëse.

Në lidhje me ushqimin e ofruar personave të strehuar në qendër, grupi i inspektimit konstatoi se kuzhina, pavarësisht se e pajisur me mjetet e domosdoshme, ishte edhe ajo në gjendje të amortizuar dhe me lagështirë. Ushqimi ishte i larmishëm dhe i bollshëm, si dhe kampioni i ushqimit ditor ruhej në mjedis frigoriferik, por pa dry. Mensa ishte një mjedis tjetër brenda kësaj godine me rreth 8 tavolina ngrënieje, ku amortizimi ishte sërish i pranishëm.

Trajtimi mjekësor kryhej nga mjeku i kësaj qendre, i cili kishte edhe një dhomë të posaçme brenda godinës së dytë. Dhoma kishte një krevat vizitash, një dollap për mbajtjen e medikamenteve dhe një tjetër për mbajtjen e dosjeve për secilën përfituese.

Grupi i monitorimit konstatoi se kishte një kënd lodrash për fëmijë me mjete të pakta dhe të amortizuara.

### ***Aktivitetet***

Duke marrë në konsideratë faktin se kjo është qendër e mbyllur e sigurisë së lartë, aktivitetet e mundshme jashtë qendrës janë të vështira për t'u realizuar, pasi kërkojnë staf dhe fonde shtesë.

Që prej inspektimit të fundit, dhe rekomandimit lidhur me nënshkrimin e një marrëveshjeje me Ministrinë e Arsimit lidhur me arsimimin 9-vjeçar të fëmijëve të strehuar në këtë qendër, nga stafi, grupi i inspektimit u informua se një rekomandim i tillë nuk kishte gjetur zbatim. Në momentin e inspektimit, në qendër ndodhej vetëm një fëmijë i moshës parashkollore, i cili nuk frekuentonte as çerdhe dhe as kopsht.



Shtatë prej përfitueseve në qendër vijonin kurse formimi profesional në Qendrën e Formimit Profesional nr. 4, në Tiranë tre herë në javë për parukeri, kuzhinier, rrobaqepësi, etj. Në momentin e inspektimit pritej të fillonte java antitrafik dhe qendra do të ishte e angazhuar me hapjen e një ekspozite të punimeve me dorë të përfitueseve. Për këtë qëllim ishte blerë bazë materiale.

Gjatë këqyrjes së dokumentacionit, grupi i inspektimit vuri re se çdo përfituese kishte informacione të detajuara mbi shërbimet psiko-sociale që i ofroheshin. Gjithsesi, informacionet e mbajtura për këshillimet individuale e në grup, provonin që këshillimet ishin informacion mbi bisedat e kryera, ndërkohë që mungonin qëllimet dhe objektivat specifike të ndërhyrjes, teknikat e përdorura, përshkrimet mbi gjendjen e statusit mendor, etj.

### ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e qendrës kishte të parashikuar një mjekë, e cila punonte me kohë të plotë në institucion, rrjedhimisht, edhe shërbimi jepej në kohë dhe me cilësi. Vizitat kryheshin në dhomën e vizitave dhe medikamentet, përfshirë këtu edhe ato të urgjencës, ndodheshin në një dollap pa çelës. Për sa i përket rasteve për të cilat nevojitej konsultë e specializuar, shërbimi ofrohej pa vonesa nga mjekë specialistë të QSU “Nënë Tereza” Tiranë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të mjekës së këtij institucioni, u konstatua se ekzistonte një regjistër vizitash si dhe kartelat për secilën përfituese të cilat ishin plotësuar me rregull dhe mbaheshin mbi tryezën e punës së mjekes. Gjatë punës së saj në këtë institucion, mjekja kryente edhe trajnime informale me përfitueset në lidhje me shëndetin riprodhues dhe masat mbrojtëse. Këto trajnime zhvilloheshin një herë në javë.

Medikamentet siguroheshin nëpërmjet buxhetit të qendrës dhe për çdo person ishin hapur kartelat mjekësore. Shërbimi stomatologjik kryhej rregullisht nga një subjekt privat, bazuar në marrëveshjen që kjo qendër kishte lidhur me klinikën përkatëse.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë. Por në raste emergjente, përdoreshin makinat e qendrës për transportimin e VT/ VMT pranë qendrave spitalore.

Në këtë institucion asnjë nga përfitueset nuk ishte e pajisur me librezë shëndetësore, ndaj dhe skema e rimbursimit të ilaçeve nuk funksiononte, por rastet të cilat kishin probleme shëndetësore trajtoheshin me mjekime që vetë qendra i siguronte me fondet e veta. Ndërkohë që një përfituese e cila ishte e diagnostikuar me Skizofreni kronike, trajtohej me grup të dytë invaliditeti “KEMP”, gjë që i jepte mundësi të merrte me mjekimin përkatës sipas kësaj të fundit.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”, bazuar në ligjin nr. 90/ 2012, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, për të parashikuar detyrat funksionale të këtij institucioni, shërbimet që ofrohen në të, si edhe përcaktimin e përfitueseve sipas

Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/ Viktimave të Mundshme të Trafikimit.

2. Marrja e masave për punësimin me kohë të plotë të një juristi dhe një psikologu.
3. Marrja e masave për rikonstrukcionin e plotë të godinës numër dy e cila është tejet e amortizuar.
4. Marrja e masave për hartimin e një marrëveshjeje me Ministrinë e Arsimit lidhur me arsimimin e përfitueseve të kësaj qendre dhe/ apo fëmijëve të tyre brenda sistemit 9-vjeçar.
5. Marrja e masave për ofrimin e mundësive për punësim pranë Zyrës Rajonale të Punësimit, Tiranë, duke marrë në konsideratë faktin se përfitueset marrin formim profesional në Qendrën e Formimit Profesional nr. 4, Tiranë.
6. Marrja e masave për plotësim të përshtatshëm të dosjeve personale me detaje për ndërhyrjet këshillimore sipas standardeve profesionale.
7. Marrja e masave lidhur me furnizimin me veshmbathje sipas stinës dhe grup-moshave të personave të strehuar në qendër.
8. Marrja e masave për përmirësimin e këndit të lodrave për fëmijë.
9. Marrja e masave për rikonstrukcionin e sistemit të ngrohjes në të dyja godinat.
10. Marrja e masave për rregullimin e tualeteve që nuk funksionojnë, si edhe përmirësimin e mjediseve të dusheve.
11. Marrja e masave për pajisjen me libreza shëndetësore dhe vënien në funksion të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjitha përfitueset e këtij institucioni.
12. Marrja e masave për rregullimin e makinave larëse që nuk funksionojnë.
13. Marrja e masave për rregullimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterëve.

### **9.3. Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç - Datë 05 dhe 18.11.2014 / Nr. Dok. 201402003**

#### ***Shënime paraprake***

Qendra e Mbyllur për Të Huajt, Kareç është ngritur me VKM nr. 1083, datë 28.10.2009, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 83 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me qëllim strehimin e të huajve e parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi. Qendra e Mbyllur është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Migracionit dhe Ripranimeve, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme. Rregullorja e brendshme e Qendrës është miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Kapaciteti zyrtar i kësaj qendre është 125 persona.

Në ditën e parë të inspektimit, në mjediset e institucionit ndodheshin 64 shtetas të huaj, prej nga 55 shtetas nga Siria, 6 shtetas nga Eritrea, 1 nga Ukraina, 1 nga Nigeria dhe 1 shtetas nga Iraku. 54 prej tyre ishin në proces ripranimi nga shteti Grek, 9 ishin pa dokumente dhe 1 ishte në proces gjyqësor. Në ditën e dytë të inspektimit ishin 61 persona.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit

të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e personave në qendër, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura. Nga ana e drejtuesit së institucionit, grupit të ekspertëve iu bë me dije një sere problematikash mbi mënyrën e funksionimit të qendrës, si dhe me mënyrën që ishin adresuar ato. Për këtë qëllim ishte ngritur një grup i jashtëm pune i cili ishte në proces hartimi të raportit.

Një problematikë kryesore kishte të bënte me rastet e largimit të të huajve nga qendra si rrjedhojë e kushteve fizike të godinës e murit rrethues si dhe numrit të kufizuar të stafit të sigurisë. Deri në ditën e vizitës kishin ndodhur disa raste largimi me një numër total prej 30 vetash, 22 prej të cilëve ishin kapur dhe rikthyer në Qendër. Nga ana e Drejtorit të Qendrës, autoritetit epror i ishte kërkuar marrja e masave për rritjen e sigurisë së Institucionit, por ende nuk ishte marrë ndonjë hap konkret.

Një problematikë tjetër kishte të bënte me pamundësinë për të parandaluar problemet shëndetësore infektive përmes një vlerësimi adekuat mjekësor në momentin e pranimit në institucion, si rrjedhojë e mungesës së parashikimit të mjekut në organikë, funksion ky që mbulohej nga një kryeinfermier, ai dhe sekretar e arshivist. Në lidhje me këtë çështje, grupi inspektues u informua se dy javë para vizitës së parë në këtë institucion, nga ana e stafit ishin konstatuar raste me probleme pruriti (kruarje), që pas diagnostikimit nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Durrës, Sektorit i Higjienës, kishte rezultuar të ishte Skabies (zgjebe). Theksojmë se për këtë diagnozë, stafi i Institucionit që kishte kontakt të drejtpërdrejtë me të huajt, u informua për herë të parë në ditën e monitorimit më datë 05.11.2014. Pas konstatimit dhe diagnostikimit të bërë, ishin marrë disa masa për trajtimin dhe mjekimin e rasteve të evidentuara me Skabies. Personave që kishin manifestuar simptoma të kësaj sëmundjeje, u ishte aplikuar mjekim për lyerje lokale me Benzil Benzoat 200ml/ flakoni, një herë të parë, ndërsa herët e tjera-sikurse u pohua nga kryeinfermieri- me kërkesë të tyre. Teshat e të huajve ishin larë me lavatriçe dhe tharë në kushte mjedisore, ndërkohë që protokollin parandalimit të përhapjes së kësaj sëmundjeje parashikon asgjësimin e teshave, kur ato nuk lahen në temperatura të lartë e kur nuk thahen në tharëse mekanike rrobash. Sipas Drejtorit, më datë 24/ 09/ 2014, nga ana e Drejtorisë së Shëndetit Publik Durrës, Sektorit i Higjienës ishte kryer dezinfektimi i gjithë ambienteve të brendshme të institucionit.

Si rrjedhojë e sa më sipër, grupi monitorues vendosi që të mos hynte në regjimin e brendshëm ditën e parë të monitorimit, por të merrte informacion shkresor e verbal nga stafi, dhe të kontaktonte me të huajt në mjediset e ajrimit të jashtëm. Me qëllim verifikimin e mjediseve të brendshme të Institucionit u ri ngrit një grup tjetër monitorues më datë 18.11.2014.

### ***Trajtimi***

Gjatë dy vizitave monitoruese, grupi inspektues pati për objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të huajve të strehuar në qendër, si dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të presionit psikologjik apo të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative ndaj kësaj kategorie. Nga informacioni i marrë, nga bisedimi në grup dhe në privatësi me të huajt, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast flagrant torture apo përdorimi të tepruar të forcës.

Në Qendrën e Mbyllur për Të Huajt, Kareç, në momentin e inspektimit, pati ankesa nga ana e të huajve lidhur me trajtimin si të dënuar që u bëhej atyre në Shqipëri duke i vendosur në qendër të mbyllur, pa iu dhënë mundësia për të marrë leje të përkohshme disa ditore qëndrimi që t'u mundësonte largimin nga territori i Shqipërisë, praktikë kjo e njohur në vende të tjera të rajonit.

Një ankesë e dalë nga kontaktet e grupit inspektues me të huajt, ishte mungesa e një përkthyesi në gjuhën e tyre (arabisht), gjë që vështirësonte komunikimin dhe njohjen me rregulloren dhe të drejtat e tyre si dhe me komunikimin e përditshëm e kryerjen e aktiviteteve. Komunikimi i përditshëm realizohej përmes stafit në gjuhën angleze me të huajt që e njihnin atë, të cilët shërbenin si përkthyes për të tjerët. Për të adresuar këtë shqetësim, nga ana e drejtorit të institucionit ishin bërë përpjekje për të pajisur stafin me një listë prej 60 fjalësh e shprehjesh bazike në anglisht, të shkruara në mënyrën e shqiptimit, me përkthim në shqip për secilën syresh.

Sa i përket trajtimit brenda në Qendër, shqetësimet kryesore ishin të lidhura me normën ushqimore, mënyrën e gatimit, si dhe llojin e asortimenteve të përdorura (jo në përputhje me besimin e tyre fetar). Ky shqetësim ishte adresuar me marrjen e një kuzhinieri të ri gjë që u verifikua në ditën e dytë të vizitës monitoruese. Norma gjithsesi ngelej po e njëjtë (350 gramë bukë në ditë).

Një tjetër shqetësim kishte të bënte me çështjen e veshmbathjeve, shtrujave dhe mjeteve të higjienës personale, të cilat pavarësisht përpjekjeve të stafit të këtij institucioni, rezultonin të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e të huajve të strehuar. Për të trajtuar këto shqetësime nga ana e institucionit ishin kërkuar donacione, ndërkohë që të huajve u ishte mundësuar të përgatisnin lista individuale me kërkesa për produkte, të cilat i drejtoheshin psikologes së institucionit, e cila mundësonte blerjen e tyre jashtë institucionit kundrejt pagesës me faturë nga fondet personale të të huajve.

Në mungesë të aparateve kartofonike, telefonatat ishin mundësuar përmes kartave rimbushëse me impulse nga celulari personal i psikologes. Kjo e fundit e kishte deklaruar numrin si në funksion të të huajve të Qendrës. Të huajt e ndaluar ishin mirënjohës për ndihmën e dhënë nga psikologja me miratimin e Drejtorit të institucionit, por kishin ankesa për sasinë e minutave që mund të flisnin, pasi çmimi për impuls me vendet e tyre të origjinës rezultonte të ishte shumë i lartë.

Ankesa të tjera kishin të bënin me pamundësinë për t'u informuar mbi ato çfarë ndodhin jashtë qendrës e në vendet e tyre të origjinës në mungesë të televizorëve e të pajisjeve satelitore.

Gjithashtu ankesa kishte edhe për mungesën e aktiviteteve kulturore, argëtuese e sportive. I vetmi aktivitet sportiv ishte ai me top në një fushë të papërshtatshme për lojëra me këmbë. Aktivitetet për të miturit, fëmijët e rritur dhe gratë ishin në mungesë.

### ***Masat mbrojtëse***

Sipas Rregullores për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Mbyllur dhe Rregullores së Brendshme të qendrës, të huajt e ndaluar në këtë qendër kanë të drejtën të përfitojnë asistencë individuale mjekësore, ligjore e sociale, ndërkohë që në organikën prej 24 personash të kësaj

qendre nuk ishin të parashikuara prania e një mjeku, juristi, apo psikologu. Deri diku punën e juristit e kryente drejtori i institucionit, punën e mjekut e kryente kryeinfermieri, ndërsa për të mbuluar funksionin e psikologut ishte punësuar një sociologe, e cila në fakt gëzonte vlerësimin dhe mirëbesimin e të gjithë të huajve të kontaktuar e të stafit, pasi ndihmonte në plotësimin e nevojave jetike të të huajve dhe funksiononte si një hallkë ndërlidhëse e rregullatore midis dy palëve në institucion.

Funksiononte sistemi i pritjes dhe i kontrollit fizik, me specialistë për pritje dhe intervistim. Në qendër ndodheshin dosjet personale të të huajve të ndaluar, regjistri i pranimeve në qendër, regjistri i takimeve, regjistri i hyrje/ daljeve në qendër, regjistri i dorëzimit të shërbimit, si dhe procesverbalet për marrjen në dorëzim të sendeve personale dhe vlerave monetare. Ambienti ku depozitoheshin vlerat monetare dhe sendet personale funksiononte sipas rregullores. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve nuk u konstatuan parregullsi. Çdo gjë regjistrohej në regjistrin përkatës.

Sa i përket çështjes së sigurisë, Qendrën e Mbyllur për Të Huajt, Kareç, ishte e pajisur me kamera vëzhgimi në mjediset e jashtme e të brendshme, por jo në ato të mjediseve të banimit. Asnjë prej kamerave të jashtme nuk ishte në funksion. Sistemi i kamerave monitorohej nga punonjësi i sigurisë së sallës operative.

Vizitat me familjarët, avokatët përfaqësuesit diplomatikë etj., kryheshin sipas parashikimeve në rregullore.

Masat e sigurisë me izolim jepeshin nga Drejtori i Institucionit për një periudhë jo më të gjatë se 24 orë, dhe kjo masë zbatohet në dhomat e izolimit. Në ditët e inspektimit nuk kishte shtetas të huaj me këtë masë. Kryesisht masat jepeshin me përjashtim nga aktivitetet e përbashkëta.

Ekzistonte një sektor i veçantë për të huajat femra, dhe të miturit, ndarë nga sektori i meshkujve. Në rast familjesh, të huajt akomodoreshin me të afërmit e tyre.

Lidhur me funksionimin e sistemit të ankesë/ kërkesave, këto bëheshin në mënyrë verbale nga të huajt tek psikologja ose tek punonjësi i sigurisë së turnit, të cilët merrnin masa për të njoftuar drejtorin e institucionit. Ky i fundit kthente përgjigje brenda 24 orëve.

Në institucion gjendeshin pesë ambiente të cilat ishin parashikuar për takimet me familjarët, por ato ishin bosh e nuk funksiononin si të tilla.

### ***Kushtet materiale***

Kjo qendër përbëhet nga një godinë dy katëshe, me një pjesë të parashikuar për zyra administrative dhe pjesa tjetër regjim me 24 dhoma banimi, 4 dhoma veçimi, bibliotekë, lavanderi, dushe, ambient rekreacioni, magazina e ajrosje të jashtme.

Grupi i inspektimit vizitoi dhomat të cilat ishin të pajisura me materiale bazë e banja për secilën prej tyre. Dhomat ishin të parashikuara për përkatësisht 2, 4 dhe 8 persona. Dhomat e banuara

kishin dritë natyrale dhe artificiale. Nuk u konstatuan raste personash që flinin përtokë dhe as prani e insekteve apo e brejtësve.

Ndriçimi artificial ishte problematik jashtë e brenda institucionit. Gjeneratori me të cilin ishte e pajisur kjo qendër kishte nevojë për shërbime. Ventilimi ishte mundësuar, por problem ngelej ngrohja, pasi kaldaja nuk ishte vënë funksion pasi shpenzonte 24litra në orë.

Në të gjithë regjimin ishte i dukshëm problemi i lagështirës, kryesisht si rrjedhojë e problemeve me izolimin e tarracës së institucionit dhe mungesës së ngrohjes.

Dushet realizoheshin në 2 dushet e përbashkëta të cilat ishin të pajisura me bojlerë për të mundësuar ujin e ngrohtë. Dushet kryheshin me grafik, por ato rezultonin të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat në përputhje me kapacitetin e Qendrës.

Në përgjithësi, në të gjitha intervistat e kryera, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishte mungesa në furnizimin e azilkërkuesve me shtroje, por kishte nevoja për çarçafë, batanije e peshqirë. Institucioni furnizonte me shampo, sapunë e brisqe rroje, por kishte probleme me pajisjen me veshmbathje përfshirë këtu këpucët, si dhe me mjete të tjera të higjienës së përbashkët.

Si lavanderi shërbente një lavatriçe për të gjithë të huajt e ndaluar, ndërsa tharja e rrobave kryhej në zonën rekreative për fëmijë e të rritur e cila e kishte humbur funksionin e saj.

Kishte një mjedis ambulator (dhoma e kryeinfermierit), e mbajtur pastër, por e varfër në medikamente për sëmundje kronike e akute.

Grupi i monitorimit konstatoi se kishte një mjedis të jashtëm ajrimi, i cili përdorej për ecje e lojëra me top, por duke qenë se ishte me bar të gjatë e shkurre nuk ishte i përshtatshëm për kalçeto. Nuk kishte një kënd lodrash për fëmijët.

Qendra e Mbyllur për të Huajt kishte edhe një bibliotekë, e cila kishte Bibël, Kuran, një libër për terrorizmin, etj., në një total prej 40 zërash. Në bibliotekë nuk ishin rregullorja e organizimit të funksionimit të qendrës dhe as rregullorja e brendshme e saj.

Në qendër ishte një ambient kulturi i cili funksiononte si i tillë.

Grupi i inspektimit vuri re se kuzhina e qendrës dhe mensa ishin relativisht të pastra dhe të rregullta. Mensa kishte 16 tavolina e 44 karrige, ndërsa në kuzhinë mungonte lavastovilja dhe materiale të tjera lehtësuese. Menyja e përditshme ishte e afishuar. Kampionet ushqimorë mbaheshin në dollap me dy, pra jo në kushte frigoriferike.

Në institucion nuk kishte dyqan për të mundësuar blerjet. Këto siguroheshin siç u përshkrua më lart nga psikologja e institucionit me blerje jashtë institucionit.

## ***Aktivitetet***

Ajrimi në këtë institucion kryhej në minimalen e parashikuar, 2 orë në ditë, prej orës 11.00-13.00, përfshirë këtu dhe aktivitetin sportiv.

Të huajt e ndaluar kishin mundësi të zhvillonin ritet fetare në ambientin e kultit, në të cilin shërbente herë pas here një imam nga Vlora.

Biblioteka funksiononte kryesisht për librat fetarë, pasi librat e tjerë ishin në shqip.

Sipas organikës së miratuar, qendra kishte vetëm specialistë për pranim dhe intervistim, duke lënë jashtë kështu pozicione të tilla tepër të rëndësishme për natyrën e funksionimit të saj si psikologë, edukatorë, dhe juristë. Duke marrë në konsideratë faktin se në këtë qendër vijnë edhe familje, grupi i inspektimit konkludoi se stafi është tepër i vogël për të plotësuar të gjitha nevojat e qendrës, pavarësisht faktit se punonjësit e institucionit përpiqeshin maksimalisht për të mbuluar nevojat.

## ***Shërbimi shëndetësor***

Organika e stafit mjekësor në këtë institucion përbëhej nga një kryeinfermier me kohë të plotë. Organika e qendrës nuk parashikonte mjek duke e bërë kështu të vështirë diagnostikimin dhe trajtimin adekuat të problematikave shëndetësore. Në organikë nuk parashikohej as pozicioni i stomatologut, pra ky shërbim nuk ofrohej nga stafi i qendrës.

Rastet me sëmundje infektive trajtoheshin nga Sektori i Higjienës, pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik Durrës.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë. Por në raste emergjente, përdroreshin makinat e qendrës për transportimin e të huajve pranë qendrave spitalore.

Sa i përket pajisjes së këtij institucioni me medikamente, ato ishin të varfra për trajtimin e sëmundjeve kronike e atyre akute.

Nga këqyrja e dokumentacionit të ndihmësmjekut të këtij institucioni, ekzistonin dy regjistra, njëri i vizitave dhe tjetri i mjekimit të cilat ishin plotësuar me rregull. Gjithashtu nga të gjithë të huajt që mbaheshin në këtë institucion vetëm tre prej tyre ishin të pajisur me kartela, nga të cilët njëri ishte i diagnostikuar me Neurozë Depresive dhe dy të tjerët me Gjendje Neurotike, të cilët merrnin mjekim përkatës me anksiolitik dhe hipno-sedativë. Në vizitën e dytë monitoruese, grupi konstatoi se kishin filluar përpjekjet nga ana e kryeinfermierit për të pajisur të gjithë të huajt me kartela shëndetësore.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Marrja e masave për shtimin e stafit të kësaj qendre me minimalisht një punonjës social, një psikolog, një përkthyes të gjuhës arabe, një jurist dhe një mjek. Ky i fundit minimalisht të jetë me kohë të pjesshme.

2. Marrja e masave për pajisjen me shtroje, veshmbathje e pajisje të higjienës personale e të përbashkët të të gjithë shtetasve të huaj që janë të akomoduar në këtë qendër.
3. Marrja e masave lidhur me furnizimin me veshmbathje sipas stinës dhe grup-moshave të personave të strehuar në qendër.
4. Marrja e masave për plotësimin e të gjitha dhomave të të huajve me dollapë e komodina për mbajtjen e sendeve personale.
5. Marrja e masave për të pajisur institucionin me aparate kartofonike sikurse është parashikuar në rregulloret e institucionit.
6. Marrja e masave për të plotësuar ambientet rekreative të brendshme e të jashtme me pajisjet e nevojshme për aktivitete sportive për shtetasit e huaj të mitur e fëmijë të rritur të akomoduar në qendër.
7. Marrja e masave për pajisjen me televizorë të ambienteve të përbashkëta të brendshme si dhe lidhjen me antenë satelitore për të mundësuar informimin e të huajve me ngjarjet nga vendet e tyre e në botë në gjuhët që ata kuptojnë.
8. Marrja e masave për lyerjen e godinës, brenda dhe jashtë për arsye të dezinfektimit.
9. Marrja e masave për izolimin e tarracës për të parandaluar lagështirën në institucion.
10. Marrja e masave për vënien në funksionim të kamerave të perimetrit të jashtëm.
11. Marrja e masave për të rritur sigurinë e zgarave të dritareve dhe të rrethimit.
12. Marrja e masave për ruajtjen e kampioneve ushqimorë në kushte frigoriferike.
13. Marrja e masave për pajisjen me lavastovilje e materiale lehtësuese për kuzhinën e institucionit.
14. Marrja e masave të menjëhershme për të parashikuar një mjek dhe një stomatolog në organikën e sektorit shëndetësor në mënyrë që në institucion të ofrohet një shërbim shëndetësor i plotë dhe efikas.
15. Marrja e masave të menjëhershme për furnizimin e Institucionit me ilaçe të urgjencës dhe ilaçe për sëmundjet kronike.



## *Aneks 1*

### **BASHKËPUNIMI I MKPT- së ME SHOQATAT E SHOQËRISË CIVILE**

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në realizim të funksioneve të tij ligjore, gjatë vitit 2014 bashkëpunoi ngushtësisht me Organizata të Shoqërisë Civile aktive dhe të specializuara të fushës. Këto OJF kanë mbështetur rregullisht MKPT duke ofruar ekspertizë cilësore me mjekë, psikologë, ekspertë edukimi, etj., sipas standardeve të OPCAT, gjatë kryerjes së vizitave të rregullta në Institucionet e ekzekutimit të Vendimeve penale dhe në Njësitë Policore. Në përfundim të vizitave monitoruese, ekspertët e OJF-ve kanë përgatitur raporte dhe rekomandime mbi gjetjet të cilat i kanë ndarë me MKPT-në dhe Institucionet përkatëse

#### ***Bashkëpunime të tjera***

**Në datë 24 prill 2014**, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në bashkëpunim me MKPT-në, realizoi trajnimin e vëzhguesve të cilët do të angazhoheshin për të realizuar monitorimet në komisaritet e policisë, vendet e paraburgimit dhe burgjet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjatë trajnimit të zhvilluar pranë ambienteve të Hotel “Mondial” Tiranë, vëzhguesit e KShH-së u pajisën me njohuri të përditësuara mbi: problematikën në këtë fushë, nxjerrë nga raportet e KShH-së, si dhe të aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë që veprojnë aty; legjislacionin shqiptar lidhur me të drejtat e personave të privuar nga liria në ambientet policore, parë nën dritën e standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare të të drejtave të njeriut; legjislacionin lidhur me të drejtat e personave të privuar nga liria në institucionet penitenciare, parë nën dritën e standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare të të drejtave të njeriut; parimet e metodologjisë së vëzhgimit dhe të raportimit; elementët që duhen mbajtur parasysh përpara, gjatë dhe pas realizimit të monitorimit etj. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të projekteve “Për më shumë fuqizim të mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri”, i cili u mbështet financiarisht nga Civil Rights Defenders dhe nga projektit "Së bashku kundër torturës në polici dhe burgje në Shqipëri, financuar nga Komisioni Evropian në Tiranë.

**Në datë 29 Maj 2014**, u mbajt një takim me qëllim bashkërendimin e aktiviteteve mbështetëse që do të zbatohen nga Shoqata Përthyerje dhe Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë në bashkëpunim me Avokatin e Popullit në kuadër të projektit “Përmirësimi i të Drejtave të Njeriut në burgjet dhe institucionet e paraburgimit në Shqipëri” financuar nga Ambasada Daneze në Shqipëri. Në këtë takim të zhvilluar në sallën e Konferencave pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, morën pjesë përfaqësues të Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), përfaqësues nga Shoqata Përthyerje si dhe Menaxheri i Grantit, përfaqësues i Ambasadës Daneze.

**Në datë 02 Qershor 2014 MKPT**, në sallën e Konferencave pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, Shoqata Përthyerje në bashkëpunim me MKPT organizoi një Seminar me Stafin e Avokatit të Popullit për Çështjet e Shëndetit Mendor në Burgje dhe Paraburgime. Seminari kishte për qëllim identifikimin e çështjeve të menaxhimit të IEVP-ve në lidhje me veprime që kanë si objekt të dënuarit dhe të paraburgosurit me probleme të Shëndetit Mendor, eksplorimin e lidhjes së këtyre aspekteve me të Drejtat e Njeriut dhe me nevojën për marrjen e masave që

synojnë mbrojtjen e Shëndetit Mendor gjatë burgimit, si dhe prezantimin e praktikave më të mira në fushë.

**Në datat 4 – 6 Qershor dhe 12-13 Qershor 2014,** Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në bashkëpunim me MKPT-në, si dhe me përfaqësues të Policisë së Shtetit realizuan, trajnimin me tematikë parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit në komisaritet e policisë. Pjesëmarrës në këto trajnime ishin rreth 172 punonjës të niveleve të mesëm dhe bazë nga të gjitha rrethet e vendit. Qëllimi i trajnimit të zhvilluar pranë ambienteve të Hotel “Mondial” Tiranë, ishte ndërgjegjësimi i punonjësve të policisë për respektimin sa më korrekt të të drejtave të personave të shoqëruar, arrestuar dhe ndaluar, si dhe rritja e profesionalizmi i tyre për të luftuar në mënyrë efektive format e torturës dhe keqtrajtimit ndaj këtyre personave. Objektivat e këtyre trajnimeve ishin njohja e punonjësve të policisë me konceptet teorike dhe shembuj të praktikës gjyqësore të lidhura me torturën dhe keqtrajtimin e ushtruar nga punonjësit e policisë kundrejt personave të shoqëruar, arrestuar/ ndaluar, si edhe sjellja në vëmendje e shembujve konkretë të konstatuara nga misionet e monitorimit nga institucionet/ organizatat e pavarura monitoruese në këtë fushë. MKPT bëri një prezantim mbi punën e Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës si dhe mbi institutin e shoqërimit dhe ndalim/ arrestimit sipas legjislacionit në fuqi. Një kontribut të veçantë në këtë trajnim dha edhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Këto aktivitete u zhvilluan në kuadër të projektit "Së bashku kundër torturës në polici dhe burgje në Shqipëri" financuar nga Komisioni Evropian në Tiranë.

**Në datë 09 Qershor 2014** në sallën e Konferencave pranë Institucionit të Avokatit të Popullit MKPT, Shoqata Përthyerje, Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë dhe MKPT, si dhe Menaxheri i Grantit zhvilluan një takim të përbashkët me qëllim diskutimin dhe ndarjen e planit të Inspektimeve dhe Vizitave Monitoruese të përbashkëta në Institucionet e Paraburgimeve, Burgjeve dhe Komisariateve të Policisë përgjatë periudhës kohore Qershor 2014-Dhjetor 2014.

**Në datën 24 Tetor 2014,** Shoqata Përthyerje në bashkëpunim të ngushtë me Avokatin e Popullit përmes MKPT-së dhe Sektorin e Trajnimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, organizoi në ambientet e Sektorit të Trajnimeve, Trajnimin e Drejtuesve të IEVP-ve mbi “Të Drejtat e Njeriut në Burgje dhe Paraburgime në Shqipëri”. Qëllimi i trajnimit ishte dhënia e informacionit rreth rolit të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, identifikimi i çështjeve dhe sfidave aktuale në lidhje me të drejtat e njeriut në burgje si dhe rritja e njohurive në lidhje me Të Drejtat e Njeriut në burgje, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare. MKPT bëri një prezantim mbi punën e Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës si dhe gjetjet kryesore e rekomandimet e bëra për vitin 2013 e ato të vitit 2014. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit “Përmirësimi i të Drejtave të Njeriut në Burgjet dhe Qendrat e Paraburgimit në Shqipëri”.

**Në datën 20-21 Nëntor 2014** Shoqata Përthyerje në bashkëpunim të ngushtë me Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Sektorin e Trajnimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, organizoi Trajnimin e Parë Rajonal 2 ditor në Tiranë për 30 përfaqësues staf të IEVP-ve “Jordan Misja”, “Ali Demi”, “Mine Peza” dhe Vaqarr. Ky trajnim kishte për qëllim rritjen e njohurive në fushën e Të Drejtave të Njeriut në Burgje dhe Paraburgime në Shqipëri”. Në trajnim u ofrua informacion rreth rëndësisë së Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, si dhe u identifikuan çështje dhe sfida aktuale në lidhje me të drejtat e

njeriut në burgje, me synim përmirësimin e njohurive në lidhje me Të Drejtat e Njeriut në burgje e Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare. Aktiviteti u zhvillua në ambientet e I.E.V.P Tiranë, në kuadër të projektit “Përmirësimi i të Drejtave të Njeriut në Burgjet dhe Qendrat e Paraburgimit në Shqipëri”, financuar nga Ambasada Daneze në Shqipëri.

**Në datën 18-19 Dhjetor 2014** Shoqata Përthyerje në bashkëpunim të ngushtë me Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Sektorin e Trajnimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, organizoi Trajnimin e Dytë Rajonal dy ditor në IEVP Elbasan me 30 përfaqësues të stafeve të IEVP-ve Elbasan, Drenovë, dhe Peqin. Ky trajnim kishte për qëllim rritjen e njohurive në fushën e Të Drejtave të Njeriut në Burgje dhe Paraburgime në Shqipëri”. Në trajnim u ofrua informacion rreth rëndësisë së Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, si dhe u identifikuan çështje dhe sfida aktuale në lidhje me të drejtat e njeriut në burgje, me synim përmirësimin e njohurive në lidhje me Të Drejtat e Njeriut në burgje e Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare. Aktiviteti u zhvillua në ambientet e I.E.V.P Elbasan, në kuadër të projektit “Përmirësimi i të Drejtave të Njeriut në Burgjet dhe Qendrat e Paraburgimit në Shqipëri”, financuar nga Ambasada Daneze në Shqipëri.

**Në datën 19 Dhjetor 2014**, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në bashkëpunim me Mekanizmin për Parandalimin e Torturës (MPT) organizuan një mision vlerësimi në Institucionin e Paraburgimit të Vlorës në sektorin e të miturve. Objektivi i misionit të vlerësimit ishte vlerësimi i qasjes së re të të punuarit me të miturit e paraburgosur, ndryshimet konkrete të mundshme të metodologjisë së punës së stafit që punon me të miturit, si dhe ndryshimet e mundshme të sjelljes së të miturve. Grupi i vlerësimit u takua me drejtorin dhe personelin tjetër drejtues të institucionit të Vlorës, me të miturit e paraburgosur, si dhe gjithashtu ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës. Ky mision vlerësimi u realizua në kuadër të projektit “Përmirësimi i kushteve të burgjeve për riintegrimin e të miturve të dënuar e paraburgosur në Shqipëri, Maqedoni e Kosovë”, zbatuar nga Komiteti Holandez i Helsinkit.

**Në datën 22-23 Dhjetor 2014** Shoqata Përthyerje në bashkëpunim të ngushtë me Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Sektorin e Trajnimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, organizoi Trajnimin e Tretë Rajonal dy ditor në IEVP Fushë Krujë me 30 përfaqësues të stafeve të IEVP-ve Fushë Krujë, Shën Koll, Lezhë dhe Krujë. Ky trajnim kishte për qëllim rritjen e njohurive në fushën e Të Drejtave të Njeriut në Burgje dhe Paraburgime në Shqipëri”. Në trajnim u ofrua informacion rreth rëndësisë së Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, si dhe u identifikuan çështje dhe sfida aktuale në lidhje me të drejtat e njeriut në burgje, me synim përmirësimin e njohurive në lidhje me Të Drejtat e Njeriut në burgje e Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare. Ky aktivitet u zhvillua në ambientet e I.E.V.P Fushë-Krujë, në kuadër të projektit “Përmirësimi i të Drejtave të Njeriut në Burgjet dhe Qendrat e Paraburgimit në Shqipëri”, financuar nga Ambasada Daneze në Shqipëri.

## *Aneks 2*

### **AKTIVITETE TË MKPT-së**

**Në datë 7 Prill 2014**, MKPT mori pjesë në takimin e Grupit të Punës mbi Reformën në Burgje të drejtuar nga Z. Artur Zoto, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve dhe Znj. Silda Anagnosti, Prania e OSBE-së në Shqipëri. Takimi u zhvillua në ambientet e ICITAP në Tiranë. Gjatë takimit u pasqyruan aktivitetet e përditësuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, dhe nga pjesëmarrësit u diskutuan çështje specifike mbi kujdesin ndaj personave me probleme të shëndetit mendor në sistemin e burgjeve.

**Në datat 9-10 Prill 2014**, MKPT mori pjesë në një takim të organizuar nga APT dhe OSBE Zvicëre, si pjesë e një përfaqësie të përzgjedhur me MKPT të rajonit, me qëllimin për të diskutuar dhe parapërgatitur disa rekomandime dhe sugjerime teknike mbi nevojat dhe fushat ku MKPT-të mund të përfitojnë prej një përfshirjeje e ndihme më të thelluar nga ana e OSBE/ODIHR. Takimi u zhvillua në Hofburg Palace në Vjenë, Austri. Gjatë aktivitetit doli në pah rëndësia e modeleve të ndryshme të MKPT-ve, baza ligjore, si dhe transparenca e bashkëpunimi me CPT-në në shkëmbimin e vazhdueshëm të eksperiencave në parandalimin e torturës, trajtimin çnjerëzor e degradues në institucionet ku kufizohen të drejtat dhe liritë e njeriut. Në këtë seancë diskutimesh, nga ana e MKPT-ve, në bashkëpunim me ekspertë të APT-së, SPT-së dhe CPT-së u miratuan 19 Rekomandime, të cilat iu paraqitën asamblesë dhe ambasadorëve të shteteve përkatëse të OSBE-së. Nga këto 19 Rekomandime, 5 Rekomandime të pranuar ishin iniciativë e MKPT-së së Shqipërisë. Rekomandimet iu paraqitën edhe nivelit të lartë të Këshillit të Ministrave të OSBE-së, i cili u mbledh në Bazel të Zvicrës në datat 2-3 Dhjetor.

**Në datat 10-11 Prill 2014**, MKPT mori pjesë në Takimin Suplementar për Dimensionin e Të Drejtave të Njeriut, të zhvilluar nga OSBE/ ODIHR me pjesëmarrjen e përfaqësive të shteteve anëtare të OSBE/ ODIHR, MPT-ve dhe OJF-ve përkatëse. Takimi i zhvilluar në Vjenë, Austri, u fokusua mbi nivelin e ratifikimit dhe e zbatimit të OPCAT-it në shtetet pjesëmarrëse. Një pjesë e rëndësishme e këtij takimi ishte dhe roli i OJF-ve dhe bashkëpunimi në nivel kombëtar për parandalimin e torturës.

**Në datën 22 Prill 2014**, MKPT zhvilloi një takim me pjesëmarrje të gjerë të OJF-ve dhe palëve të interesuara, ku u pasqyrua Raporti Vjetor 2013 mbi Aktivitetin e Institucionit të Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës. Takimi u zhvillua në sallën e konferencave pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Në takim u diskutuan gjetjet gjatë inspektiveve, rekomandimet e hartuara, rastet e dhunës dhe trajtimi i tyre, si dhe bashkëpunimi me OJF-të në realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

**Në datë 8 Maj 2014**, MKPT mori pjesë në takimin e grupit të punës mbi reformën në burgje të drejtuar nga Z. Artur Zoto, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve dhe Znj. Silda Anagnosti, Prania e OSBE-së në Shqipëri. Gjatë takimit të zhvilluar në ambientet e ICITAP në Tiranë, u bënë komente dhe rekomandime mbi Strategjinë Afatmesme të Burgjeve (2014-2017), si dhe u diskutua Plani i Veprimit.

**Në datë 17 Tetor 2014**, MKPT në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve organizoi një ceremoni simbolike në IEVP “Mine Peza” me qëllim fillimin e procesit të instalimit të kutive postare për ankesat e të burgosurve në të gjitha IEVP-të e vendit. Në aktivitet merrnin pjesë Avokati i Popullit, z. Igli Totozani, Drejtoresha e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës, Znj. Jorida Rustemi, Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, z. Bledar Skënderi, Drejtori i IEVP “Mine Peza”, si dhe përfaqësues të tjerë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Ky bashkëpunim vjen në kuadër të përmbushjes së kompetencave kushtetuese dhe ligjore që lidhen me veprimtarinë e të dy institucioneve, respektivisht Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Instalimi i njëres prej kutive postare për depozitimin e ankesave të të burgosurve u krye në ambientin e ajrimit të IEVP “Mine Peza”, si një lehtësi për të burgosurit që mund ta përdorin në çdo kohë gjatë ajrimit apo aktiviteteve të tjera. Në të gjitha IEVP-të, këto kuti do të jenë të pozicionuara në regjimin e brendshëm, si një mjet më shumë në rritjen e transparencës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ndaj të drejtave të të burgosurve për të dërguar kërkesa apo ankesa të natyrave të ndryshme në adresë të Avokatit të Popullit të Shqipërisë apo çdo institucioni dhe organizate tjetër që punon në fushën e të drejtave të njeriut.

**Në datat 20 dhe 21 Tetor 2014**, në Shkup të Maqedonisë, u organizua takimi i radhës i punës së grupeve mjekësore brenda Rrjetit të Mekanizmave të Parandalimit të Torturës me fokus zbatimin e Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës në institucionet psikiatrike. Në këtë takim pune, MKPT-ja e Shqipërisë raportoi mbi gjetjet e deritanishme të inspektimeve në institucionet psikiatrike, si dhe në strukturat që ofrojnë këto shërbime në IEVP-të shqiptare. Në këtë takim, MKPT-ja Shqiptare mori zyrtarisht për një periudhë një vjeçare Presidencën e Rrjetit të MKP-ve të Evropës Jug-lindore.

**Në datën 22 Tetor 2014**, MKPT mbajti një konferencë për shtyp në prani të mediave me objekt marrjen zyrtarisht për një periudhë një vjeçare të Presidencës së Rrjetit të MKPT-ve të Evropës Jug-lindore. Ky rrjet është jetësuar në vitin 2013, bazuar në Deklaratën e Bashkëpunimit të nënshkruar nga Institucionet e Ombudsmanëve të Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Hungarisë, Greqisë dhe Rumanisë, me qëllim rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimit të eksperiencave dhe organizimit të aktiviteteve të tjera të përbashkëta për një përmbushje sa më të qenësishme të mandatit të MKPT-ve në rajon, siç edhe specifikohen në “Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtitimit apo Dënimit të Egër, Çnjerëzor dhe Degradues (OPCAT).

**Në datat 27 dhe 28 Nëntor 2014**, në Pallatin e Serbisë në Beograd, Ombudsmeni i Republikës së Serbisë, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në bashkëpunim me misionin e OSBE-së në Serbi, organizoi aktivitetin dy ditor “Forumi i parë i OPCAT për Evropën Juglindore” i cili u pasua nga “ Konferenca për parandalimin e torturës dhe të formave të tjera të keqtrajtitimit e ndëshkimit”. Në këto aktivitete morën pjesë Kryetari i Nënkomitetit të Parandalimit të Torturës (SPT), Zv. Presidenti i Komitetit për Parandalimin e Torturës, Kryetari i Divizionit për Migracionin dhe Të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, drejtues dhe përfaqësues të Mekanizmave të Rrjetit Juglindor, NGO etj. Qëllimi i takimeve ishte vendosja e kontakteve të drejtpërdrejta midis aktorëve të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe MKPT-ve të rajonit, si dhe vlerësimi i nevojave dhe mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria në përmbushje të “Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtitimit apo Dënimit të Egër, Çnjerëzor dhe Degradues

(OPCAT). MKPT-ja shqiptare u përfaqësua me dy pjesëmarrës. Gjatë Forumit të OPCAT-it, Drejtuesja e Mekanizmit Shqiptar për Parandalimin e Torturës, mbajti një fjalim përshëndetës në rolin e Kryetares së Rrjetit të Mekanizmave të Evropës Jug-Lindore.

**Në datën 27 nëntor 2014**, në IEVP Kavajë, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës mori pjesë në aktivitetin “Tryezë mbi transparencën dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile” organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me mbështetjen e UNICEF. Aktiviteti kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe transparencës me shoqërinë civile, si edhe prezantimin e dokumentit të prioriteteve të përbashkëta për vitin 2015. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të UNICEF, Delegacionit të Komisionit të BE-së në Shqipëri, Zv/ Ambasadori i Britanisë së Madhe, Kryetarja e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, etj., të cilët mbajtën edhe fjalën përshëndetëse të rastit. Përfaqësuesja e MKPT-së mbajti një fjalë lidhur me rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në rritjen e transparencës, si edhe gjetjet e deritanishme lidhur me situatën në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

**Në datën 5 Dhjetor 2014** Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën Ndërkombëtare “Shëndeti mendor në sistemin penitenciar në Shqipëri dhe praktikat më të mira në Evropë, si një reflektim i detyrimeve pozitive të shtetit në kuadër të të drejtave të njeriut”. Në këtë konferencë drejtuesja e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Znj. Jorida Rustemi mbajti një fjalim përshëndetës, përmes të cilit solli informacion rreth situatës aktuale të shëndetit mendor në paraburgime e burgje, si dhe përgëzoi nismën e projektit i cili ka për qëllim të avancojë trajtimin e shëndetit mendor dhe respektimin e të drejtave të njeriut për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor brenda sistemit penitenciar në Shqipëri.

**Aneks 3**

**TABELA E INSPEKTIMEVE TË KRYERA NGA MKPT GJATË VITIT 2014  
BAZUAR NË PLANIN VJETOR TË INSPEKTIMEVE  
NË BASHKËPUNIM ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE**

<b>Emri i institucionit</b>	<b>Data e inspektimit</b>	<b>Organizata pjesëmarrëse në monitorim</b>
IEVP Rrogozhinë	01.02.2014	—
IEVP Peqin	11.02.2014	—
IEVP Zahari, Krujë	03.04.2014	Instituti Evropian i Tiranës
Instituti i të Miturve Kavajë	16.04.2014	—
Komisariati i Policisë Krujë	22.04.2014	—
Stacioni i Policisë Fushë-Krujë	22.04.2014	—
Komisariati i Policisë Durrës (DPQarkut)	23.04.2014	—
Komisariati i Policisë Shijak	23.04.2014	—
Komisariati i Policisë Kavajë	23.04.2014	—
Komisariati i Policisë Rrogozhinë	23.04.2014	—
IEVP 325	30.04.2014	Instituti Evropian i Tiranës
IEVP Vaqar	07.05.2014	Instituti Evropian i Tiranës
IEVP Kosovë, Lushnjë	14.05.2014	Instituti Evropian i Tiranës
Komisariati i Policisë Peqin	18.05.2014	—
Komisariati i Policisë Gramsh	18.05.2014	—
Komisariati i Policisë Cërrik	18.05.2014	—
Komisariati i Policisë Librazhd	19.05.2014	—
Komisariati i Policisë Elbasan (DPQarkut)	19.05.2014	—
Komisariati i Policisë Lezhë (DPQarkut)	23.05.2014	Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë
Komisariati i Policisë Kurbin	23.05.2014	Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë
Komisariati i Policisë Mirditë	23.05.2014	Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë
Stacioni i Policisë Mamurras	23.05.2014	Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë
Stacioni i Policisë Shëngjin	23.05.2014	Shoqata e Avokatëve Penalistë të Shqipërisë
IEVP Peqin	13.06.2014	Shoqata Përthyerje Komiteti Shqiptar i Helsinkit
IEVP Shën Koll, Lezhë	16.06.2014	Shoqata Përthyerje Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Komisariati i Policisë Peshkopi (DPQarkut)	18.06.2014	—
Komisariati i Policisë Burrel	18.06.2014	—
Komisariati i Policisë Bulqizë	18.06.2014	—

<b>Emri i institucionit</b>	<b>Data e inspektimit</b>	<b>Organizata pjesëmarrëse në monitorim</b>
IEVP Kukës	19.06.2014	Shoqata Përthyerje
Komisariati i Policisë Kukës (DPQarkut)	19.06.2014	—
Komisariati i Policisë Has	19.06.2014	—
Komisariati i Policisë Tropojë	20.06.2014	—
IEVP Tropojë	20.06.2014	Shoqata Përthyerje
Spitali psikiatrik Elbasan	23.06.2014	—
IEVP paraburgim Elbasan	23.06.2014	Shoqata Përthyerje
IEVP Jordan Misja (313)	30.06.2014	Instituti Evropian i Tiranës Shoqata Përthyerje
IEVP Durrës	31.07.2014	Shoqata Përthyerje
IEVP Durrës	29.09.2014	Shoqata Përthyerje
Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit	03.09.2014	—
IEVP Fushë-Krujë	01.10.2014	Shoqata Përthyerje
IEVP Burrel	06.10.2014	Shoqata Përthyerje
Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut	08.10.2014	—
Komisariati i Policisë Kuçovë	13.10.2014	—
Komisariati i Policisë Çorovodë	13.10.2014	—
Komisariati i Policisë Berat	14.10.2014	—
IEVP Berat	14.10.2014	Shoqata Përthyerje
IEVP Mine Peza	17.10.2014	Shoqata Përthyerje
Komisariati i Policisë Nr. 1, Tiranë	22.10.2014	—
Komisariati i Policisë Nr. 5, Tiranë	22.10.2014	—
Komisariati i Policisë Nr. 3, Tiranë	24.10.2014	—
Komisariati i Policisë Nr. 2, Tiranë	24.10.2014	—
Drejtorja e Policisë së Qarkut Tiranë	24.10.2014	—
Komisariati i Policisë Ersekë	28.10.2014	—
Komisariati i Policisë Devoll	28.10.2014	—
IEVP Drenovë	29.10.2014	Shoqata Përthyerje
Komisariati i Policisë Korçë	30.10.2014	Shoqata Përthyerje
Komisariati i Policisë Tepelenë	10.11.2014	—
Komisariati i Policisë Përmet	10.11.2014	—
IEVP Tepelenë	10.11.2014	Shoqata Përthyerje
Komisariati i Policisë Gjirokastër	11.11.2014	—
Komisariati i Policisë Delvinë	11.11.2014	—



<b>Emri i institucionit</b>	<b>Data e inspektimit</b>	<b>Organizata pjesëmarrëse në monitorim</b>
IEVP Sarandë	12.11.2014	Shoqata Përthyerje
Komisariati i Policisë Sarandë	12.11.2014	—
Stacioni i Policisë Himarë	13.11.2014	—
IEVP Vlorë	13.11.2014	Shoqata Përthyerje
Komisariati i Policisë Vlorë	13.11.2014	Shoqata Përthyerje
Spitali Psikiatrik Vlorë	14.11.2014	—
Reparti Ushtarak Bunavi, Vlorë	14.11.2014	—
Reparti Ushtarak nr. 1200 Zall Herr, Tiranë	02.12.2014	—
Batalioni i Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë	02.12.2014	—
Komisariati i Policisë Rinas	02.12.2014	—
Ambienti i të Deportuarve Rinas	02.12.2014	—
Komisariati i Policisë nr. 4	03.12.2014	Shoqata Përthyerje Shoqata e Avokatëve Penalistë Shqiptarë
Komisariati i Policisë nr. 6	03.12.2014	Shoqata Përthyerje Shoqata e Avokatëve Penalistë Shqiptarë
Komisariati i Policisë Kufitare dhe Emigracionit Rinas	4/ 17.12.2014	—
Institucioni i Veçantë Shëndetësor i Burgjeve	09.12.2014	Shoqata Përthyerje
Komisariati i Policisë Pukë	10.12.2014	—
Reparti Ushtarak nr.1010 Vau i dejës	10.12.2014	—
Komisariati i Policisë Malësi e Madhe	11.12.2014	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Komisariati i Policisë Shkodër (DPQarkut)	11.12.2014	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Spitali Psikiatrik Shkodër	11.12.2014	—
IEVP Drenove	12.12.2014	—
Komisariati i Policisë Lushnjë	16.12.2014	—
Komisariati i Policisë Fier (DPQarkut)	16.12.2014	—
Komisariati i Policisë Mallakastër	16.12.2014	—
IEVP Elbasan	16.12.2014	—
*IEVP Vlorë	19.12.2014	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
IEVP Rrogozhinë	28.12.2014	—
IEVP Rrogozhinë	30.12.2014	Shoqata Përthyerje

**Aneks 4**

**TABELA E REKOMANDIMEVE TË DËRGUARA NGA MKPT  
MBI GJETJE TË VITIT 2014**

<b>Nr.</b>	<b>Nr. Doculive</b>	<b>Data e nisjes</b>	<b>Objekti i Rekomandimit</b>	<b>Institucioni që i është dërguar Rekomandimi</b>	<b>Statusi i Rekomandimit Pranuar/ Refuzuar/ Pa përgjigje</b>	<b>Zbatuar ose jo.</b>
1	201400174	04.02.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të IEVP Rrogozhinë	Pranuar	Pjesërisht
2	201400237	14.02.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të IEVP Peqin	Pranuar	Pjesërisht
3	201401020	11.04.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të IEVP Kosovë, Lushnjë	Pranuar	Pjesërisht
4	201400765	14.05.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të Institutit të të miturve Kavajë	Pranuar	Pjesërisht
5	201400843	14.05.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës	Pranuar	Pjesërisht
6	201400840	14.05.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës	Pranuar	Pjesërisht
7	201400842	14.05.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës	Pranuar	Pjesërisht
8	201400841	14.05.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës	Pranuar	Pjesërisht
9	201400926	15.05.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të IEVP "Ali Demi" (325)	Pranuar	Pjesërisht
10	201401019	29.05.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të IEVP Vaqar	Pranuar	Pjesërisht
11	201401125	12.06.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Lezhë	Pranuar	Pjesërisht
12	201401126	12.06.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;	Pranuar	Pjesërisht

				Drejtorit të Policisë së Qarkut Lezhë		
13	201401127	12.06.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Lezhë	Pranuar	Pjesërisht
14	201401128	12.06.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Lezhë	Pranuar	Pjesërisht
15	201401131	24.06.2014	Për marrjen në analizë të ngjarjes së ndodhur në Komisarriatin nr.4, DPQ Tiranë, me shtetasin A.B.	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë	Pranuar	Plotësisht
16	201401246	09.07.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të IEVP Zahari Krujë	Pranuar	Pjesërisht
17	201401263	17.07.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Kukës	Pranuar	Pjesërisht
18	201401262	17.07.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Kukës	Pranuar	Pjesërisht
19	201401261	17.07.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Kukës	Pranuar	Pjesërisht
20	201401240	17.07.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të IEVP Shën Koll, Lezhë	Pranuar	Pjesërisht
21	201401260	17.07.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Dibër	Pranuar	Pjesërisht
22	201401258	17.07.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Dibër	Pranuar	Pjesërisht
23	201401259	17.07.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Dibër	Pranuar	Pjesërisht
24	201401340	25.07.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Ministrit të Shëndetësisë; Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; Drejtorit të Spitalit Psikiatrik Elbasan	Pa përgjigje nga Ministri i Shëndetësisë; Pranuar nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Pranuar nga Drejtori i	Pjesërisht

					Spitalit	
25	201401085	12.08.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Elbasan	Pranuar	Pjesërisht
26	201401086	12.08.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Elbasan	Pranuar	Pjesërisht
27	201401084	12.08.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Elbasan	Pranuar	Pjesërisht
28	201401087	12.08.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Elbasan	Pranuar	Pjesërisht
29	201401083	12.08.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Elbasan	Pranuar	Pjesërisht
30	201401474	14.08.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Peqin	Pranuar	Pjesërisht
31	201401359	14.08.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Kukës	Pranuar	Pjesërisht
32	201401357	14.08.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Elbasan	Pranuar	Pjesërisht
33	201401358	21.08.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Tropojë	Pranuar	Pjesërisht
34	201401356	25.08.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP "Jordan Misja" (313)	Pranuar	Pjesërisht
35	201401463	25.08.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Durrës	Pranuar	Pjesërisht
36	201401200	28.08.2014	Me iniciativë lidhur me inspektimin e procedurave të kthimit të emigrantëve të paligjshëm nga Zona Shengen	Drejtorit të Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit	Pranuar	Pjesërisht
37	201401744	13.11.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut	Pranuar	Pjesërisht
38	201401925	13.11.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Berat	Pranuar	Pjesërisht
39	201401926	13.11.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Berat	Pranuar	Pjesërisht
40	201401924	13.11.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;	Pranuar	Pjesërisht

				Drejtorit të Policisë së Qarkut Berat		
41	201401923	19.11.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Berat	Pranuar	Pjesërisht
42	201401740	19.11.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Durrës	Pranuar	Pjesërisht
43	201401745	19.11.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkerkuesit	Pranuar	Pjesërisht
44	201401999	04.12.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Korçë	Pranuar	Pjesërisht
45	201402000	04.12.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Korçë	Pranuar	Pjesërisht
46	201402001	04.12.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Korçë	Pranuar	Pjesërisht
47	201402160	04.12.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Gjirokastrë	Pranuar	Pjesërisht
48	201402159	04.12.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Gjirokastrë	Pranuar	Pjesërisht
49	201402161	04.12.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Gjirokastrë	Pranuar	Pjesërisht
50	201401977	17.12.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP "Mine Peza" (302)	Pranuar	Pjesërisht
51	201401904	06.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Fushë-Krujë	Pranuar	Pjesërisht
52	201402370	06.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë	Pranuar	Pjesërisht
53	201402374	06.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë	Pranuar	Pjesërisht
54	201402372	06.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë	Pranuar	Pjesërisht
55	201402371	06.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të	Drejtorit të Përgjithshëm të	Pranuar	Pjesërisht

			personave që gjenden në institucion	Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë		
56	201402369	06.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë	Pranuar	Pjesërisht
57	201402312	06.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Ministrit të Shëndetësisë; Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; Kryetarit të KKSHM; Drejtorit të Spitalit Psikiatrik Vlorë	Përgjigje nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Pjesërisht
58	201402373	06.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë	Pranuar	Pjesërisht
59	201402375	06.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë	Pranuar	Pjesërisht
60	201400839	06.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë	Pranuar	Pjesërisht
61	201400838	06.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë	Pranuar	Pjesërisht
62	201402451	06.01.2015	Mbi situatën e mbipopullimit në Komisaritet e Drejtorive të Policisë së Qarqeve	Ministrit të Punëve të Brendshme; Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit	Pranuar	Pjesërisht
63	201402452	06.01.2015	Mbi situatën e mbipopullimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale	Ministrit të Drejtësisë; Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve	Pranuar	Pjesërisht
64	201402002	14.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Drenovë	Pranuar	Pjesërisht
65	201402366	14.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Vlorë	Pranuar	Pjesërisht
66	201402546	14.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Ministrit të Shëndetësisë; Kryetarit të KKSHM; Drejtoreshës së DSHP Shkodër Shefes së Spitalit Psikiatrik Shkodër	Pranuar	Pjesërisht
67	201401905	19.01.2014	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Burrel	Pranuar	Pjesërisht
68	201402365	19.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Tepelenë	Pranuar	Pjesërisht
69	201402313	19.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Sarandë	Pranuar	Pjesërisht

70	201402003	20.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç	Pranuar	Pjesërisht
71	201402224	21.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Vlorë	Pranuar	Pjesërisht
72	201402223	21.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Vlorë	Pranuar	Pjesërisht
73	201402225	21.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Vlorë	Pranuar	Pjesërisht
74	201402222	21.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Vlorë	Pranuar	Pjesërisht
75	201500083	22.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të Institucioni i Veçantë Shëndetësor i Burgjeve	Pranuar	Pjesërisht
76	201402528	26.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier	Pranuar	Pjesërisht
77	201402526	26.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier	Pranuar	Pjesërisht
78	201402527	26.01.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier	Pranuar	Pjesërisht
79	201500026	17.02.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Ministres së Mbrojtjes; Komandantit të Batalionit të Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë	Pranuar	Pjesërisht
80	201500023	17.02.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Ministres së Mbrojtjes; Komandantit të Komandës së Forcave Tokësore, Vau i Dejës Shkodër	Pranuar	Pjesërisht
81	201500038	18.02.2015	Përmirësimi i kushteve të trajtimit të personave që gjenden në institucion	Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; Drejtorit të I EVP Rrogzhinë	Pranuar	Pjesërisht